

Tabela e Përmbajtjes

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE	24
1.1. Struktura e Sektorit Elektro-Energjetik Shqiptar.....	24
1.2. Prodhimi i energjisë elektrike	26
1.2.1. Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2025.....	26
1.2.2. Të dhënat teknike kryesore dhe energjia elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2025.	31
1.2.3. Masat e marra nga për garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike gjatë vitit 2025 nga KESH sh.a.....	37
1.2.4. Centrali fotovoltaik i Digës së Qyrsaqit (HEC Vau i Dejës)	38
1.2.5. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi.....	38
1.2.6. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike	38
1.2.7. Prodhimi nga centralet fotovoltaike dhe hidrike që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2025.....	40
1.2.8. Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese.....	41
1.3. Transmetimi i energjisë.....	46
1.3.1. Bilanci energjetik	46
1.3.2. Veprimtaria e OST sh.a.....	48
1.3.2.1. Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit.....	48
1.3.3. Gjendja e përgjithshme e sistemit elektroenergjetik, referuar raportimit të OST sh.a.	52
1.3.4. Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së	54
1.3.4.1. Sistemet e kontrollit dhe monitorimit automatik	55
1.3.4.2 Menaxhimi i fluksit të energjisë	56
1.3.4.3 Analiza e kontigjencave dhe trajtimi i tyre	56
1.3.4.4 Menaxhimi i qëndrueshmërisë dinamike	57
1.3.4.5. Niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektiva e sigurisë së furnizimit për një periudhë 5 deri në 20-vjeçare.....	58
1.3.4.6. Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi	59
1.3.4.7. Plani i masave dhe realizimi i investimeve për forcimin e sigurisë së sistemit elektroenergjetik duke u bazuar në rekomandimet e raportit përfundimtar të ENTSO-E mbi ngjarjen e ndodhur në sistemin elektroenergjetik shqiptar më datë 21 Qershor 2024.....	61
1.3.4.8. Parashikimi i investimeve për jo më pak se 5 (pesë) vitet e ardhshme, që OST sh.a. apo çdo palë tjetër planifikon të realizojë në lidhje me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkonjeksionit	63
1.3.4.9. Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit	66
1.3.4.10. Masat e marra nga OST sh.a. për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve	

në furnizimin me energji elektrike, si dhe për rritjen e sigurisë së furnizimit në rast nevojë	67
1.3.4.11. Plani i sistemit të mbrojtjes së OST sh.a. në rast të një situatë emergjente	67
1.3.4.12. Masat e Planit të Mbrojtjes të Sistemit	68
1.3.4.13. Masat e marra për garantimin e gatishmërisë dhe sigurisë së sistemit brenda të gjithë kufijve operativë, përfshirë sistemet primare dhe ato sekondare, si edhe për sa i përket sigurisë kibernetike dhe infrastrukturave kritike	71
1.4. Shpërndarja e Energjisë Elektrike.....	73
1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.).....	73
1.4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike	73
1.4.3 Struktura e konsumit të energjisë elektrike 2025.....	75
1.4.4 Profili i konsumit të energjisë elektrike gjatë vitit 2025.....	78
1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike të furnizuar, shitur dhe humbur, për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2025	79
1.4.6 Humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes.	81
1.4.7 Siguria operative e rrjetit, si dhe masat e marra për garantimin e furnizimit me energji elektrike dhe sigurisë së sistemit brenda të gjithë kufijve operativë, përfshirë sistemet primare dhe ato sekondare	84
1.4.8 Kapacitetet transmetuese dhe transformuese në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike.....	86
1.4.9 Parashikimi i investimeve, që planifikohen të realizohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.....	86
1.4.10 Asetet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	89
1.5 Furnizuesi i Shërbimit Universal.	90
2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE	94
2.1. Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike.....	94
2.1.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike.....	94
2.1.2 Monitorimet periodike të OST sh.a.	95
2.1.3 Disbalancat në tregun e energjisë elektrike	96
2.1.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a., në Treg të rregulluar dhe të liberalizuar (parregulluar) gjatë vitit 2025	97
2.2. Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)	101
3. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX)	103
3.1. Operimi i Bursës Shqiptare të Energjisë.....	103
3.2. Anëtarësimi në Bursë për Zonën e Ofertimit Shqipëri	103
3.3. Anëtarësimi në Bursë për Zonën e Ofertimit Kosovë.....	104
3.4. Operimi i tregut.....	105

3.5. Operimi i tregtimit në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë (IDA)	106
3.6. Klerimi	108
3.7. Masat e marra nga Operatorët në zbatim të Rregullores së Sigurisë Kibernetike	115
4. LICENCIMI DHE DHËNIA E AUTORIZIMEVE GJATË VITIT 2025	119
4.1 Procedurat e Licencimit gjatë vitit 2025	119
4.1.1 Licencimet dhe kërkesat e trajtuara gjatë vitit 2025	120
4.1.2 Licencimi në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.....	123
4.2 Licencimi në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	123
4.3 Njohja e licencave	124
4.4 Vendimet e ERE-s në lidhje me zgjatjen e afatit të vendimmarrjes për aplikimet e paraqitura, pezullimin e afateve të vendimmarrjes, refuzimin e aplikimeve për licencim dhe heqjen e licencave.	126
4.4.1 Zgjata e afatit të vendimmarrjes	126
4.4.2 Pezullimi i afateve të vendimmarrjes.....	127
4.4.3 Refuzim i aplikimit për licencim	127
4.4.4 Ndjekja e procedurave për heqjen e licencave për shkak të mosshlyerjes së pagesës rregullatore.....	127
4.4.5 Heqja e licencës me kërkesë të të licencuarit.....	128
4.4.6 Rishikim i akteve nënligjore për procedurat e licencimit	128
4.5 Dhënia e Autorizimeve nga ERE për Vitin 2025.....	128
5. AKTIVITETI I ERE-S NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR	131
5.1 Vlerësimi i aktiviteteve të shoqërive të rregulluara si dhe shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2025.....	131
5.1.1. Mbi tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025 – 2027.....	131
5.1.2. Mbi tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.....	131
5.1.3. Mbi çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë për vitin 2025.....	132
5.1.4. Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW.....	132
5.1.5. Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025.	134
5.1.6. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025 për shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.	138
5.1.7. Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga Shoqëria Alb gaz sh.a. për vitin 2025.	139
5.1.8. Mbi miratimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike	

(NEMO) për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë.....	139
5.1.9. Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2025	141
5.1.9.1. Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a.	141
5.2. Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE dhe çmimet e energjisë elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2025	141
5.2.1. Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE	141
5.2.2. Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2025	142
6. SITUATA E GAZIT NË BOTË, EUROPEË, RAJON DHE NË VENDIN TONË....	144
6.1. Problemet kryesore për gazin natyror.	144
6.2. Dekarbonizimi.....	152
6.3. Masat e mara nga Europa për gjendjen e gazit pas ndërprerjes së gazit Rus.....	152
6.3.1. Në vendin tonë.	154
6.4. Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP)	154
6.4.1. Ekselencë gjatë 5 viteve të operacioneve të kryera nga TAP.	155
6.4.2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve.....	156
6.4.3. Niveli i parë i zgjerimit të kapacitetit të TAP-it.....	157
6.4.4. Elektrifikimi nëpërmjet zgjerimit dhe dekarbonizimit.....	158
6.4.5. Zhvillime të tjera në Shqipëri.....	158
6.4.5.1. TAP - Albgaz sh.a.	158
6.4.6. TAP po lehtëson ndërlidhjen digjitale në Evropën Juglindore	159
6.4.7. Vëllimet e Transportuara nga TAP	160
6.4.8. Aktet nënligjore të miratuara nga ERE për gazin natyror gjatë vitit 2025	161
6.5.1. Zhvillimet e fundit	171
6.5.1.1. Projekti i Gazifikimit të Korçës	171
Marrëveshja e Pikës Dalëse në Fier (TAP Exit)	171
6.4.9. Memorandume dhe Bashkëpunime me Palë të Treta.....	172
6.5. Ndikimi i Hidrogjenit.....	173
6.6.1. Zhvillime të tjera.....	173
6.6.2. Objektivat që Synohen të Arrihen në Sektorin e Gazit.....	175
6.6.3. Projektet e Parashikuara nga Albgaz sh.a.	175
6.7. Gazifikimi i qytetit të Korçës.....	177
6.8. Në lidhje me raportin e Pajtushmërisë për Albgaz sh.a.	178
6.9. Objektiva për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror	179
6.10. Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare	180

7. ZHVILLIMI I POLITIKAVE DHE MBIKËQYRJES SË BURIMEVE TË RINOVUESHME	182
7.1. Lidhur me përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet hidrike	182
7.2 Lëshimi i Garancive të Origjinës.....	183
7.3 Metodologjia e Përcaktimit të Detyrimit për Energjinë e Rinovueshme	183
7.3.1 Metodologjia mbi Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike.....	184
7.4 Raportimet nga te Licencuarit ne Aktivitetin e Prodhimit te Energjise Elektrike	184
8. AKTIVITETI I ERE-S NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONДАР DHE NDRYSHIME TË TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2025.	186
8.1. Vendimet kryesore të ERE-s në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2025	186
8.2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve.....	193
8.3 Proceset Gjyqësore në të Cilat ERE ka Qenë Palë Gjatë Vitit 2025	193
8.3.1 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë Gjatë Vitit 2025	193
8.3.2 ERE në Cilësinë e Palës Paditëse Gjatë Vitit 2025.....	194
8.3.3 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur Gjatë Vitit 2025	194
8.4. Transparenca	195
8.4.1 Seancat dëgjimore për aktet e ERE.....	195
8.5 Ndryshimet që i janë bërë kuadrit rregullator gjatë vitit 2025.....	195
9. RAPORT MBI VEPRIMTARINË E ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR PAJTUESHMËRINË DHE VLERËSIMIN E IMPAKTIT RREGULLATOR VITI 2025	198
9.1. Raportin Vjetor të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sh.a.	198
9.2. Raportin Vjetor të Pajtuëshmërisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike “OST” sh.a.	199
9.3. Raportin Vjetor të Pajtuëshmërisë për Operatorin e TAP (Trans Adriatic Pipeline) ...	200
9.4. Raportin Vjetor të Pajtuëshmërisë në sektorin e Gazit Natyror nga “Albgaz” sh.a., ...	200
10. VEPRIMTARIA E ERE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT	202
10.1. Veprimtaria e ERE për Mbrojtjen e Konsumatorit për Vitin 2025.....	202
10.2 Ankesat për dëm ekonomik	205
10.3 Ankesat për vlera referuese.....	206
10.4 Ankesat për Lidhje të Re.....	207
10.5 Ankesat për mbifaturim	207
10.6. Ankesa për keqtarifimin.....	208
10.7. Ankesa për keqfaturim.....	208
10.8. Ankesa të Ndryshme	208

10.9. Seancat Dëgjimore dhe Efikasiteti.....	209
10.10. Veprimtaria e FSHU sh.a.....	209
10.10.1. Kërkesat dhe Ankesat në FSHU sh.a.	209
10.10.2. Shërbimi i Konsumatorit.....	211
10.10.3. FSHU sh.a. si Furnizues i Mundësisë së Fundit	212
10.10.4. Konsumatorët dhe Furnizuesit në Treg të Lirë	212
10.11. Standardet e Cilësisë në Rrjetin e Transmetimit.....	213
10.12. Standardet e Matjes për Cilësinë e furnizimit dhe performancën në Rrjetin e Shpërndarjes.....	215
10.13. Konsumatorët Vetëprodhues.....	218
11. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE	220
11.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare.....	220
11.2. Pjesëmarrja Aktive si Anëtare në Organizma Ndërkombëtare	220
11.3. Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.....	221
11.4. Marrëdhëniet me Publikun	221
12. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ERE-S	223
12.1. Pjesëmarrja gjinore në ERE	225
12.2. Rekrutimi dhe Trajnimi i Stafit në ERE	225
13. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE GJATË VITIT 2025 ...	226
13.1. Administrimi i burimeve financiare të ERE-s gjatë vitit 2025	226
13.2. Zërat kryesorë të shpenzimeve të ERE-s	226
13.3. Auditimi i ERE-s.....	226
13.4 Buxheti për vitin 2026	227
14. MBI RAPORTIMIN E ERE NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË “REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ERE PËR VITIN 2025”	228
15. ECURIA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË BE-së PËR VITIN 2025..	234
16. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2024-2026.....	235
Aneks 1: Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare	240
Aneks 2: Raporti i Performancës	269

Tabela e Figurave

Figura 1. Skema e Sistemit Elektro-Energjetik.....	25
Figura 2. Prodhimi neto vendas për vitin 2025 (MWh).....	28
Figura 3. Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2025 (MWh).....	29
Figura 4. Prodhimi vendas (MWh) për periudhën 10 vjeçare 2016-2025 në raport me mesataren e prodhimit të kësaj periudhe.....	30
Figura 5. Struktura e impianteve prodhuese të shoqërisë publike KESH sh.a. dhe fuqia totale e instaluar (MW).....	31
Figura 6. Prodhimi bruto i energjisë elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit në GWh (2016-2025) .	32
Figura 7. Prodhimi bruto i energjisë elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (GWh) gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024.....	33
Figura 8. Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2025 (mmnd)	33
Figura 9. Niveli mesatar mujor (mmnd) i liqenit të Fierzës për vitin 2025 në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991–2024.....	35
Figura 10. Prurjet mesatare mujore (m³/s) në liqenin e HEC-it të Fierzës gjatë vitit 2025, si dhe niveli mesatar i shfrytëzimit të Fierzës gjatë vitit 2025	36
Figura 11. Rezerva energjitike çdo fund muaji dhe prodhimi mujor 2025 (GWh).....	36
Figura 12. Struktura e furnizimit e ndarë në % sipas burimeve të KESH sh.a për zbatimin e Detyrimit të Shërbimit Publik	37
Figura 13. Numri i centraleve fotovoltaike për vitet 2020-2025	40
Figura 14. Kapaciteti i instaluar (MW) i centraleve fotovoltaike për vitet 2020-2025.....	40
Figura 15. Prodhimi (MWh) i centraleve fotovoltaike për vitet 2020-2025	40
Figura 16. Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar për vitin 2025	47
Figura 17. Gjatësia e linjave të transmetimit (km) për vitin 2025	49
Figura 18. Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë	49
Figura 19. Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar (centralet, nënstacionet, linjat 400, 220, 150 dhe 110 kV)	50
Figura 20. Skema njëfazore e sistemit elektroenergjetik shqiptar në nivelet 400, 220, 150 dhe 110 kV .	51
Figura 21. Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për periudhën 2026 - 2029	58
Figura 22. Skenarët e parashikimi të kërkesës për energji elektrike 2026-2042.....	59
Figura 23. Struktura e shitjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a.	73
Figura 24. Konsumi i energjisë elektrike në Shqipëri (MWh) për periudhën 10 vjeçare 2016-2025	74
Figura 25. Konsumi i energjisë elektrike në Shqipëri (MWh) për periudhën 10 vjeçare 2016-2025	74
Figura 26. Raportet e faturimit sipas kategorive të klientëve gjatë vitit 2025	76
Figura 27. Konsumi i klientëve fundorë që shërbehen nga FSHU sh.a., kundrejt konsumit total në vend për vitet 2024 – 2025 (GWh)	77
Figura 28. Struktura e shitjes së energjisë elektrike për grup konsumatorësh “FSHU” sh.a.	78

Figura 29. Profili me bazë orare dhe piku/minimumi i ngarkesës për muajin dhjetor 2025 (MWh).....	78
Figura 30. Profili me bazë orare dhe piku/minimumi i ngarkesës për muajin maj 2025 (MWh)	79
Figura 31. Shpërndarja e furnizimit me energji elektrike sipas drejtorive rajonale për vitin 2025 (në %)	81
Figura 32. Humbjet mujore në sistemin e shpërndarjes për vitet 2024 dhe 2025, krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike për vitin 2025	81
Figura 33. Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes për periudhën 2016-2025.....	82
Figura 34. Grafiku i humbjeve vjetore (teknike dhe joteknike) në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2016-2025	82
Figura 35. Humbjet totale të energjisë elektrike në sistemin Elektroenergjetik OST sh.a + OSSH sh.a kundrejt konsumit vendas për periudhën 2016-2025	83
Figura 36. Bilanci Elektroenergjetik i vitit 2025 sipas raportimeve të OST sh.a., dhe OSSH sh.a.	83
Figura 37. Fuqia e instaluar në MVA për vitet 2015-2025 në sistemin e shpërndarjes	86
Figura 38. Furnizimi me energji elektrike të ndara sipas drejtorive rajonale në MWh për vitin 2025	90
Figura 39. Niveli i arkëtimeve mujore të furnizimit si shërbim publik për periudhën 10 vjeçare 2016-2025 (Burimi: FSHU sh.a.).....	91
Figura 40. Arkëtime totale 10 vjeçare të FSHU për periudhën (2016 – 2025) në lekë.....	92
Figura 41. Niveli i arkëtimeve në % për periudhën (2016 – 2025).....	92
Figura 42. Faturimi/arkëtimi 10 vjeçar (2016-2025), në lekë me TVSH.....	92
Figura 43. Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2025.....	95
Figura 44. Disbalancat mujore negative dhe pozitive për vitin 2025 (MWh).....	97
Figura 45. Disbalancat mujore negative dhe pozitive për vitin 2024 (MWh).....	97
Figura 46. Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet në Shqipëri për vitin 2025 ALPEX sh.a.	105
Figura 47. Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet në Shqipëri-Kosovë ALPEX sh.a., për vitin 2025	106
Figura 48. Të dhëna mbi eksportet- importet e Shqipërisë në bashkimin e tregut për vitin 2025. (Burimi ALPEX sh.a.)	106
Figura 49. Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet për Tregun e Ankandëve brenda së njëjtës Ditë si Bashkim Tregjesh Shqipëri-Kosovë për vitin 2025	107
Figura 50. Të dhëna mbi çmimin mesatar klerues për Tregun e Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë si Bashkim Tregjesh Shqipëri-Kosovë për vitin 2025	108
Figura 51. Të dhëna mbi çmimin mesatar klerues për Tregun e Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë si Bashkim Tregjesh Shqipëri-Kosovë për vitin 2025	108
Figura 52. Të dhëna mbi klerimin e transaksioneve në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë për vitin 2025.....	109
Figura 53. Çmimi Klerues orar në €/MWh – 2025	113
Figura 54. Volumet në MWh 2025	113
Figura 55. Volumet ditore mesatare të tregtuara për vitin 2025	114
Figura 56. Volumet në blerje të tregtuara për vitin 2025	114

Figura 57. Të dhënat krahasimore të çmimeve mesatare të nxjerra në tregun vendas me ato të Bursës Hungareze HUPX dhe ato të HENEX	114
Figura 58. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	125
Figura 59. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	125
Figura 60. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	126
Figura 61. Nr. i licencave të miratuara për të gjitha veprimtaritë sipas viteve	126
Figura 62. Tarifat dhe Çmimet e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror për vitin 2025	132
Figura 63. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për klientët 35 kV për vitet 2024 – 2025.....	134
Figura 64. Kurba lëvizëse e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kv, për periudhën 2024-2025.	135
Figura 65. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2024-2025	135
Figura 66. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për mbulimin e nevojës së klientëve FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për periudhën 2024-2025.....	136
Figura 67. Kurba lëvizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga FMF, për vitet 2024-2025.	137
Figura 68. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga FMF sipas nivelit të tensionit për vitin 2025, për shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime.....	138
Figura 69. Sasia e energjisë elektrike të shitur nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.....	141
Figura 70. Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara ndër vite për periudhën 2009 - 2025.	142
Figura 71. Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 2016 – 2025.....	142
Figura 72. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jo-familjarë në vendet e rajonit për vitin 2025	143
Figura 73. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2025	143
Figura 74. Kërkesa e IEA-s për gaz natyror deri në vitin 2050 si për SPA ashtu edhe për (SPD) STEPS.	145
Figura 75. Bilanci global i kërkesës dhe furnizimit me gaz sipas skenarëve të ndryshëm, furnizimi i ndarë sipas ciklit jetësor	147
Figura 76. Prodhimi global i gazit natyror, i ndarë sipas rajonit.....	149
Figura 77. Gazësjellësi TAP	155
Figura 78. Sasitë specifike të kapacitetit shtesë që u rezervuan pas Testit të Tregut 2021	157
Figura 79. Vendimet e ERE për vitin 2025 në raport me vitin 2024	186
Figura 80. Proceset gjyqësore ndaj shoqërive debitore 2025.....	194
Figura 81. Proceset gjyqësore ere palë e paditur 2025.....	194
Figura 82. Performanca e furnizimit me energji elektrike në rrjetin e transmetimit 2020 -2025	215
Figura 83. Treguesit e cilësisë së furnizimit në TL+TM+TU për vitin 2025	216

Tabela e Tabelave

Tabela 1. Të dhëna mbi prodhuesit dhe prodhimin e tyre (MWh) për vitin 2025 krahasuar me vitin 2024	27
Tabela 2. Niveli i liqenit të HEC-it të Fierzës (mmnd) për periudhën 2016-2025	34
Tabela 3. Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi, prodhuesit e pavarur dhe prodhimi i tyre (MWh) për vitin 2025	38
Tabela 4. Numri i centraleve fotovoltaike, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh) deri në fund të vitit 2025	39
Tabela 5. Centralet e reja fotovoltaike të cilat janë futur në operim gjatë vitit 2025, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh).	41
Tabela 6. Centralet e reja hidrike të cilat janë futur në operim gjatë vitit 2025, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh).....	41
Tabela 7. Të dhëna mbi fuqinë e instaluar (MW) dhe prodhimin (MWh) e realizuar nga burimet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2025	42
Tabela 8. Të dhëna mbi fuqinë e instaluar (MW) dhe prodhimin (MWh) e realizuar nga burimet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes	45
Tabela 9. Centralet hidrike në OSSH sh.a. dhe OST sh.a., të cilat kanë dalë në treg të lirë gjatë vitit 2025, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh).....	46
Tabela 10. Bilanci energjetik i OST sh.a. për vitin 2025 krahasuar me atë të viteve 2016–2025 (MWh) 47	
Tabela 11. Kapaciteti i instaluar sipas nënstacioneve (MVA).....	52
Tabela 12. Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2026 – 2042	59
Tabela 13. Centralet që kanë lidhur marrëveshje për lidhje deri në vitin 2025 dhe priten të energjizohen gjatë viteve 2026-2027.....	60
Tabela 14. Centrale që kanë nënshkruar marrëveshje për lidhje ose amenduar Marrëveshjen e Lidhjes në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2025	60
Tabela 15. Centrale që kanë marrë opinion paraprak për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2025.....	61
Tabela 16. Vlerat e importit dhe eksportit në kapacitete transmetuese.....	63
Tabela 17. Kërkesa për përpunim u bë me sukses P202603240049	66
Tabela 18. Profili me bazë orare dhe piku/minimumi i ngarkesës për muajin maj 2025 (MWh).....	80
Tabela 19. Projektet e përfunduara përgjatë vitit 2025 dhe ato në zbatim në sistemin e shpërndarjes.....	85
Tabela 20. Të dhëna mbi asetet kryesore të OSSH sh.a. për vitin 2025	90
Tabela 21. Blerje energjie elektrike nga KESH sh.a. sipas detyrimit të shërbimit publik për vitin 2025 (sasia në MWh, çmimi/MWh dhe vlerat në Euro)	98
Tabela 22. Shitje energjie elektrike nga KESH sh.a. për shkak të prurjeve të mëdha (sasia në MWh, çmimi/MWh dhe vlerat në Euro)	98
Tabela 23. Furnizimi me energji elektrike për FSHU nga KESH sh.a. për furnizimin e klientëve fundor të lidhur në nivel tensioni 0.4.....	99
Tabela 24. Furnizimi me energji elektrike për FSHU nga KESH sh.a. për furnizimin e klientëve FMF të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV.....	99

Tabela 25. Furnizimi me energji elektrike për FSHU nga KESH sh.a. për furnizimin e ujësjellsave.	100
Tabela 26. Totali i shitjeve të kryera gjatë vitit 2025 nga KESH sh.a., për optimizimin e portofolit ekonomik të saj.	100
Tabela 27. Totali i blerjeve të kryera gjatë vitit 2025 nga KESH sh.a., për optimizimin e portofolit ekonomik të saj.	101
Tabela 28. Çmimi mesatar orar në €/MWh për Tregun e Ditës në Avancë viti 2025.....	109
Tabela 29. Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në zonën e ofertimit të Shqipërisë për Tregun e Ditës në Avancë.	110
Tabela 30. Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në zonën e ofertimit të Shqipërisë për Tregun e Ditës në Avancë.	111
Tabela 31. Klerimi i Transaksioneve në Tregun DAM në Zonën e Ofertimit Shqipëri viti 2025	112
Tabela 32. Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX sh.a. në Zonën e Ofertimit Shqipëri për të dyja tregjet	112
Tabela 33. Të dhënat krahasimore të çmimeve mesatare të nxjerra në tregun vendas me ato të Bursës Hungareze HUPX dhe ato të HENEX	122
Tabela 34. Të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike gjatë 2025	123
Tabela 35. Të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike gjatë 2025	124
Tabela 36. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2024-2025, për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.	138
Tabela 37. Treguesit kryesorë të cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe performancës së sigurisë së rrjetit për vitin 2025	214

MESAZHI I DREJTUESIT

I nderuar Zoti Kryetar i Kuvendit, Të nderuara Zonja dhe Zotërinj Deputetë,

Në emër të Bordit të Enti Rregullator i Energjisë, kemi nderin t'ju paraqesim sot Raportin Vjetor mbi gjendjen dhe zhvillimet e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në Republikën e Shqipërisë për vitin 2025.

Paraqitja e këtij raporti përpara Kuvendit nuk është thjesht një detyrim ligjor për institucionin tonë. Për ne është edhe një moment i rëndësishëm transparence dhe përgjegjësie përpara përfaqësuesve të qytetarëve shqiptarë. Përmes këtij raporti synojmë të ndajmë me ju jo vetëm të dhëna dhe tregues të sektorit energjetik, por sfidat me të cilat pjesëmarrësit e këtij sektori janë përballur dhe kanë punuar për të garantuar stabilitetin dhe zhvillimin e tij.

Sektori energjetik është një nga shtyllat më të rëndësishme të ekonomisë dhe të jetës së përditshme të qytetarëve. Çdo familje, çdo biznes dhe çdo institucion mbështetet te funksionimi i qëndrueshëm i këtij sistemi. Pikërisht për këtë arsye, roli rregullator i institucionit tonë ka për qëllim të garantojë që ky sektor të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme, transparente dhe në interes të konsumatorit.

Viti 2025 ishte një vit me zhvillime të rëndësishme për sektorin energjetik shqiptar, duke sjellë njëkohësisht sfida dhe përparime. Nga njëra anë, sistemi energjetik u përball me kushte hidrologjike jo të favorshme dhe me një treg energjetik rajonal gjithnjë e më dinamik. Nga ana tjetër, u shënuan hapa të rëndësishëm në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe në diversifikimin e burimeve të energjisë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhimit të energjisë elektrike në vend arriti në 3,475 MW, duke shënuar një rritje prej 262 MW krahasuar me vitin paraardhës. Ky është një tregues i qartë i investimeve dhe i interesit në rritje për zhvillimin e sektorit energjetik.

Një zhvillim veçanërisht i rëndësishëm është rritja e prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme. Energjia nga burimet fotovoltaike tashmë përfaqëson rreth 18% të kapacitetit të instaluar në vend dhe gjatë vitit 2025 gjeneroi një prodhim prej 832.3 GWh. Ky është një hap i rëndësishëm drejt një sistemi energjetik më të pastër dhe më të qëndrueshëm.

Megjithatë, gjatë këtij viti sektori u përball edhe me sfida të rëndësishme natyrore. Prurjet në kaskadën e Drinit rezultuan rreth 21% nën mesataren shumëvjeçare. Pavarësisht kësaj situate, përmes menaxhimit të kujdesshëm të burimeve hidrike dhe bashkëpunimit ndërmjet operatorëve të sistemit, prodhimi neto vendas arriti në 7,467 GWh, duke mbetur mbi mesataren e dekadës së fundit.

Në aspektin teknik, sistemi energjetik shqiptar ka vijuar të përmirësojë performancën e tij. Në sistemin e transmetimit të operuar nga OST sh.a., humbjet teknike u ulën në 1.9%, ndërkohë që sasia e energjisë së transmetuar u rrit me mbi 3%.

Ndërkohë, në rrjetin e shpërndarjes të administruar nga OSSH sh.a., humbjet zbritën në 16.96%. Ky është një tregues i përmirësimit të vazhdueshëm të menaxhimit të rrjetit dhe i masave të ndërmarra për reduktimin e humbjeve.

Siguria dhe stabiliteti i sistemit energjetik kanë qenë një prioritet i vazhdueshëm. Përvoja e ndërprerjeve rajonale të energjisë gjatë vitit 2024 në disa vende të rajonit tregoi edhe një herë sa e rëndësishme është të investohet në qëndrueshmërinë e sistemit dhe në bashkëpunimin me rrjetet evropiane. Në këtë drejtim, investimet dhe përmirësimet teknike të realizuara në rrjet kanë synuar rritjen e sigurisë së sistemit dhe përputhjen me standardet e ENTSO-E.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm është konsolidimi i tregut të organizuar të energjisë përmes bursës energjetike ALPEX. Gjatë vitit 2025, volumi i energjisë së tregtuar në këtë platformë u rrit me rreth 32%. Ky është një tregues i rritjes së besimit të aktorëve të tregut dhe i funksionimit gjithnjë e më transparent të tregtimit të energjisë.

Në sektorin e gazit natyror, projekti Trans Adriatic Pipeline vijon të mbetet një element strategjik për rajonin dhe për sigurinë energjetike të Evropës. Gjatë vitit 2025, ky projekt shënoi pesë vite operimi tregtar.

Nga pikëpamja institucionale, viti 2025 ka qenë një vit me aktivitet intensiv për Bordin e ERE-s. Gjatë këtij viti me 52 javë kalendarike, janë zhvilluar 53 mbledhje dhe janë miratuar 353 vendime rregullatore që lidhen me funksionimin e tregut të energjisë, zhvillimin e burimeve të rinovueshme dhe përmirësimin e kuadrit rregullator të sektorit.

Në qendër të veprimtarisë sonë mbetet gjithmonë ekuilibri mes interesave të konsumatorit, të licencuarve dhe politikave energjetike kombëtare.

Një tjetër tregues i transformimit gradual të sektorit energjetik është zhvillimi i mobilitetit elektrik. ERE, në përputhje me rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, por edhe me zgjerimin e integritetit të makinave elektrike në tregun shqiptar, ka miratuar strukturën tarifore për kategorinë e konsumatorëve që përdorin energjinë për karikimin e makinave elektrike.

Të nderuar deputetë,

Raporti që paraqesim sot nuk është vetëm një përmbledhje shifrash dhe treguesish. Ai është mbi të gjitha pasqyrë e një pune të vazhdueshme institucionale për të garantuar që sistemi energjetik i vendit të funksionojë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe në shërbim të qytetarëve. Bordi i ERE-s ka ushtruar përgjegjësitë e tij duke ruajtur pavarësinë institucionale dhe duke u mbështetur në analiza profesionale dhe në praktikën më të mira rregullatore evropiane. Në një kohë kur transformimi energjetik po bëhet një nga sfidat më të mëdha të ekonomive moderne, Shqipëria ka mundësinë të ndërtojë një sistem energjetik më të qëndrueshëm, më të diversifikuar dhe më të integruar me tregun evropian. Në këtë proces, institucioni ynë mbetet i përkushtuar të luajë rolin e tij për të garantuar funksionimin e drejtë të tregut, mbrojtjen e konsumatorëve dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm për investimet.

Ju falenderojmë për vëmendjen dhe për mbështetjen tuaj ndaj punës së institucionit tonë.

HYRJE

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është autoriteti i vetëm rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, i cili funksionon në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, Ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe akte të tjera ligjore të miratuara në zbatim të tyre.

ERE ushtron aktivitetin e saj në zbatim të ligjit me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të pjesëtarëve të tregut për të siguruar furnizimin me energji, me cilësi dhe me kosto sa më të ulët të klientëve. ERE merr në konsideratë interesat dhe të drejtat e klientëve, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, në të njëjtën kohë kryen licensimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektor, monitoron tregun e energjisë, harton kuadrin rregullator, shqyrton në përputhje me metodologjitë respektive aplikimet e tarifave dhe çmimeve, e nëpërmjet autoritetit vendimmarrës të saj, dhe në zbatim të ligjit, vepron rast pas rasti duke e shprehur vullnetin nëpërmjet vendimmarrjeve të Bordit të Komisionerëve.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, është përgatitur ky raport mbi “Gjendjen e sektorit të energjisë dhe veprimtarinë e ERE-s gjatë vitit 2025”.

Ky raport i përgatitur nga ERE paraqet në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2025, si dhe krahasimet e disa prej treguesve kryesorë të këtij viti me vitet paraardhës.

Prodhimi i energjisë elektrike edhe përgjatë vitit 2025 vijoi të realizohet nga shoqëritë publike KESH sh.a. dhe HEC Lanabregas sh.a., si dhe nga subjektet private të licencuara në këtë aktivitet, të tilla si prodhuesit me përparësi, prodhuesit e pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 dhjetor 2025 është rreth 3,475 MW. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritjeje krahasuar me vitin 2024, prej rreth 262 MW. Rritja e kapacitetit të instaluar përgjatë vitit vjen si rezultat i shtimit të burimeve të rinovueshme fotovoltaike dhe atyre hidrike të energjisë elektrike.

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit është rreth 2,905 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 6,402,430 MWh, si dhe e centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është rreth 570 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 1,065,159 MWh.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1,563 MW dhe përbën rreth 45% të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1,912 MW dhe përbën rreth 55% të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

Përgjatë vitit 2025, prodhimi nga impiantet fotovoltaike ka filluar të zërë një pjesë të rëndësishme. Rritja e kapacitetit gjenerues nga këto impiante kontribuon në diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike në vend, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbulimin e nevojave energjetike.

Kapaciteti i instaluar i impianteve fotovoltaike për vitin 2025 arrin në 631,07 MW, duke përbërë rreth 18% të kapacitetit total të centraleve të instaluar në vend, ndërsa prodhimi i realizuar prej tyre është 832.3 GWh, duke përfaqësuar 11% të prodhimit total vendas për vitin 2025.

Për vitin 2025 përlllogariten gjithsej 53 centrale fotovoltaike në prodhim, me një rritje progresive që prej vitit 2020, ku aktualisht 42 prej tyre zotërojnë kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me FTL sh.a.; 9 prej tyre operojnë në treg të lirë me çmim të parregulluar, si dhe shoqëria

Karavasta Solar sh.p.k., e cila ia shet të gjithë sasinë e energjisë së prodhuar shoqërisë publike KESH sh.a.

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për këtë vit është 7,467,589 MWh, nga i cili rezulton:

- 3,452,265 MWh u prodhuan nga KESH sh.a.
- 4,015,324 MWh u prodhuan nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. zë 46.2% të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë, ndërsa prodhimi nga prodhuesit e tjerë zë rreth 53.8%.

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2025, me sasinë e prodhuar prej 7,467 GWh, rezulton mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2016–2025. Prodhimi i realizuar për vitin 2025 është rreth 388 GWh më i lartë se mesatarja e prodhimit për këtë periudhë. Në të njëjtën kohë vërehet se prodhimi i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2025 ka një rënie të lehtë krahasuar me prodhimin e vitit 2024, e cila rezulton të jetë 369 GWh.

Nga pikëpamja hidrologjike, viti 2025 ka qenë një vit i thatë. Ky element vlerësohet duke marrë në konsideratë prurjet e ujit në kaskadën e lumit Drin. Prurjet mesatare gjatë vitit 2025 në liqenin e Fierzës rezultuan rreth 145 m³/s, ose pothuajse njësoj krahasuar me periudhën respektive të vitit 2024, prej 140 m³/s, por këto prurje, krahasuar me mesataren shumëvjeçare të 30-viteve (1995–2024) prej 183 m³/s, kanë rezultuar rreth 21% më të ulëta.

Rezerva energjetike në kaskadën e lumit Drin në fillim të vitit 2025 ishte 477 GWh, ose sa 52% e rezervës së fillimit të vitit 2024 prej 913 GWh. Në terma mesatarë, rezerva energjetike mesatare mujore për vitin 2025 rezulton në 574 GWh, ose rreth 323 GWh më pak krahasuar me vitin 2024, ose rreth 32% më e ulët krahasuar me mesataren shumëvjeçare mujore (1995–2024) prej 846 GWh.

Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike zotërohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST sh.a.), i cili është personi juridik i licensuar nga ERE për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, si dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 54 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Operatori i Sistemit të Transmetimit është një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë dhe interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare.

Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 150 kV, 110 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkonjeksionit.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit sipas nivelit të tensionit janë: (i) Linjat e transmetimit 400 kV janë 445.7 km, (ii) Linjat e transmetimit 220 kV janë 1,363 km, (iii) Linjat e transmetimit 150 kV janë 34.4 km, si dhe linjat e transmetimit 110 kV janë 1,701 km. Gjithashtu, OST sh.a. zotëron 17 nënstacione transformuese me fuqi totale të instaluar 4,721 MVA.

Sikurse evidentohet në të dhënat e mësipërme, përgjatë vitit 2025 kemi një zgjerim të sistemit të transmetimit krahasuar me vitin 2024. Konkretisht, për vitin 2025 kemi vënien në operim të 66 km linja të reja 220 kV, si dhe vënien në operim të nënstacionit 220/20 kV të Hoxharës me fuqi të instaluar 100 MVA në njësinë operative Fier.

Vënia në funksionim e nënstacionit të Hoxharës ndikon pozitivisht në mënyrë të drejtpërdrejtë për të përthithur energjinë elektrike të gjeneruar nga impiantet prodhuese fotovoltaike të energjisë elektrike, të cilat janë të konsiderueshme në këtë zonë.

Sikurse ERE ka raportuar në paraqitjen e raportit të vitit 2024 lidhur me ngjarjen e rënies së pjesshme të sistemit shqiptar dhe atij rajonal të transmetimit në datën 21 qershor 2024, në vijim të raportit të ENTSO-E, përgjatë vitit 2025 OST sh.a. ka hartuar një plan masash dhe investimesh, duke integruar rekomandimet e ENTSO-E në praktikën e përditshme operative dhe në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të sistemit të transmetimit.

Në vijim masat e marra për këtë qëllim:

- Rishikimi i rregullores dhe procesit operacional për kontrollin e bimbës pranë Linjave të Tensionit të Lartë.
- Vlerësimi i analizave N-1 të incidenteve në rrjetet fqinje në kohë reale përmes EMS-SCADA.
- Vlerësimi i rregullt i qëndrueshmërisë së tensionit në planifikimin operacional.
- Identifikimi i treguesve të performancës për stabilitetin e tensionit.
- Rishikimi i mbrojtjeve ndaj mbingarkesës në linjat ajrore të tensionit të lartë.
- Menaxhimi i tensionit të transformatorëve HV/MV dhe VHV/HV.
- Vlerësimi i tensionit dhe fuqisë reaktive në fazën e projektimit të sistemit.
- Implementimi i kontrollit automatik emergjent për pajisjet e kompensimit të fuqisë reaktive.

Vlen të përmendim se energjia totale e transmetuar për vitin 2025 përlllogaritet 10,095 GWh, ose 3.32% më shumë energji elektrike e transmetuar se viti 2024. Në të njëjtën kohë, niveli i humbjeve në sistemin e transmetimit për vitin 2025 është 193 GWh, ose 1.9% e energjisë elektrike të transmetuar, krahasuar me nivelin 2.02% të vitit 2024. Ky nivel humbjesh rezulton më i ulët krahasuar me vitin 2024, me një diferencë prej 0.12% më pak. Ulja e nivelit të humbjeve në sistemin e transmetimit për vitin 2025, ndërkohë që kemi një rritje të energjisë elektrike të transmetuar për këtë vit, është një tregues pozitiv dhe përmirësim i performancës në këtë drejtim.

Shpërndarja e energjisë elektrike në vendin tonë kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i licencuar nga ERE sipas dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Asetet e OSSH sh.a. përfshijnë të dhëna mbi elementet kryesorë të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në operim deri në fund të vitit 2025 janë si vijon:

- Numri total i kabinave elektrike në rrjetin e shpërndarjes është 26,738 krahasuar me 26,151 të vitit 2024.
- Gjatësia totale e linjave të tensionit të mesëm në sistemin e shpërndarjes është 17,550 km krahasuar me 17,505 të vitit 2024.
- Gjatësia totale e rrjetit të tensionit të ulët në sistemin e shpërndarjes është 26,971 km.
- Gjatësia totale e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të mesëm dhe në tension të ulët rezulton në 44,521 km dhe 31,802 km kabëll koaksial.

Energjia totale e hyrë në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2025 është 8,251,420 MWh, nga e cila 1,399,486 MWh janë humbjet në këtë rrjet. Këto humbje zënë 16.96% të energjisë në rrjetin e shpërndarjes dhe, krahasuar me vitin 2024, ku humbjet ishin në nivelin 17.93%, rezultojnë gati

1% më të ulëta. Ulja e vijueshme e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes vit pas viti ka sjellë një konsolidim të operatorit të rrjetit në performancën e tij pozitive në sektorin e energjisë elektrike në vendin tonë.

Konsumi total vjetor i energjisë elektrike në vend përbëhet nga konsumi i klientëve në tregun e rregulluar dhe konsumi i klientëve në tregun e pa rregulluar. Për vitin 2025, konsumi total i energjisë elektrike në vendin tonë arriti në 8,345 GWh, krahasuar me vlerën 8,170 GWh të vitit 2024.

Një pjesë në konsumin vendas ka filluar të zërë edhe një kategori konsumatorësh që lidhen në rrjetin e shpërndarjes si njësi karikimi për makinat elektrike, të cilat janë bërë një element i rëndësishëm në transport që reflektohen edhe në strukturën e konsumit të energjisë elektrike në vendin tonë.

Përgjatë këtij viti Shqipëria ka pasur një rritje të përdorimit të makinave elektrike. Ky zhvillim ka sjellë edhe një zgjerim të infrastrukturës së karikimit në vend. Kështu, rezultojnë se gjatë vitit 2025 janë të instaluar 225 njësi karikimi, 47 njësi më shumë se viti 2024.

Konsumi total i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2025 është 8,345 GWh që rezultojnë të jetë 174,539 MWh, ose 2.09% më i lartë se konsumi i arritur përgjatë vitit 2024. Konsumi i energjisë elektrike për vitin 2025, krahasuar me konsumin e vitit 2021, i cili është dhe konsumi maksimal i arritur në Shqipëri, rezultojnë më i ulët në sasinë 69,779 MWh, ose rreth 0.8% më pak. Në të njëjtën kohë, konsumi total i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2025 është rreth 6.4% më i lartë se konsumi mesatar vjetor 10-vjeçar.

Konsumi total i energjisë elektrike në vend përgjatë vitit 2025 është mbuluar nga gjenerimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, si dhe nga importi i realizuar në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Struktura e konsumit të energjisë elektrike në vendin tonë vijon të bazohet në kategoritë e konsumatorëve: familjarë, privatë, buxhetorë, jobuxhetorë, si dhe konsumi vetjak.

Numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2025 është 1,377,204 dhe pjesën më të madhe të tyre e furnizon FSHU sh.a., ku përqindjen më të madhe e zënë klientët familjarë, rreth 85.7% të numrit total të klientëve të FSHU sh.a. Si rezultat i daljes në treg të lirë të konsumatorëve të lidhur në tension të mesëm, deri në fund të vitit 2025 rezultojnë në treg të lirë një numër prej 4,372 konsumatorësh.

Në shpërndarjen demografike të klientëve të FSHU sh.a., pjesa më e madhe është në Tiranë, me rreth 28% të të gjithë klientëve që ka FSHU sh.a., duke ruajtur pothuajse të njëjtën vlerë me atë të vitit 2024.

Struktura e klientëve të FSHU sh.a. reflektohet edhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2025. Klientët familjarë zënë pjesën më të madhe në FSHU sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar, ose rreth 52% të të gjithë faturimit të realizuar për këtë vit.

Niveli total i arketimeve i raportuar nga FSHU sh.a. është 99% kundrejt energjisë elektrike të faturuar. Ky nivel arketimesh për vitin 2025 rezultojnë të jetë në nivele të larta, element ky që evidenton se është arritur një stabilitet për sa i përket përmbushjes së këtij treguesi të rëndësishëm për gjithë sektorin e energjisë elektrike në vendin tonë.

Edhe për vitin 2025, ERE vijoi aktivitetin edhe në fushën e shqyrtimit dhe miratimit të tarifave dhe çmimeve në sektorin e energjisë dhe të gazit natyror. Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë për periudhën rregullatore 1 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2027 mbetet e pandryshuar përgjatë vitit 2025; kjo tarifë, në vlerën 0.85 lekë/kWh, është miratuar me vendimin nr. 279, datë 16.12.2024.

Gjithashtu dhe për OSSH sh.a. përgjatë vitit 2025 nuk ka pasur ndryshim të tarifave, ERE me vendimin e Bordit nr. 288, datë 23.12.2024, vendosi të zgjasë fuqinë juridike të vendimit nr. 73, datë 13.04.2022, edhe për vitin 2025.

Bordi i ERE me vendimin nr. 10, datë 08.01.2025, vendosi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga FSHU sh.a., për periudhën 1 shkurt 2025 - 31 dhjetor 2025, ku çmimi për klientët familjarë që konsumojnë deri në 700 kWh/muaj është 8.5 lekë/kWh dhe çmimi për ata klientë familjarë që konsumojnë sasinë prej 701 kWh/muaj e më tej për të gjithë sasinë e konsumuar është 9.5 lekë/kWh. Ndërkohë, çmimet për konsumatorët jofamiljarë mbeten të pandryshuara.

Duke marrë në konsideratë zhvillimin e tregut të karikimit të makinave elektrike ERE me vendimin nr. 255, datë 15.10.2025 miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhura në nivelin e tensionit 0.4 kV, që do të aplikohet nga 1 nëntor 2025 në 22 lek/kWh dhe në orët pik në 25.3 lek/kWh.

Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për vitin 2025 rezulton të jetë 15.34 lekë/kWh. ERE me vendimin nr. 33, datë 10.02.2025, miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025 për klientët e FMF të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, prej 18.26 lekë/kWh.

Po ashtu me vendimin nr. 34, datë 10.02.2025, u përcaktua se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga FMF për vitin 2025 prej 9.33 lekë/kWh për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV dhe 11.77 lekë/kWh për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

Në sektorin e gazit natyror ERE me vendimin nr. 280, datë 16.12.2024, vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh. a., për vitin 2025". Tarifa e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. edhe për vitin 2025 do vijojë të jetë ajo prej 28 lekë/m3 ose 2.64 lekë/kWh.

Duke marrë në konsideratë shtyrjen e hyrjes në fuqi të Rregullores CACM deri më 1 korrik 2026, si dhe faktin që shoqëria ALPEX sh.a. vijon të ushtrojë funksionet e NEMO-s deri në përzgjedhjen e Operatorit të ri të Emëruar të Tregut, ERE vlerësoi të arsyeshme që shoqëria të vazhdojë ushtrimin e aktivitetit të NEMO-s me tarifat e miratuara me vendimin nr. 299, datë 30.12.2024. Bordi i ERE-s mori vendimin nr. 323, datë 15.12.2025, mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 299, datë 30.12.2024, për vitin 2026.

Menaxhimi dhe operimi i tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike për zonat e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës realizohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë (ALPEX sh.a.).

Gjatë vitit 2025 u anëtarësuan gjithsej 11 Anëtarë Burse, 7 në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 4 në Zonën e Ofertimit të Kosovës. Për shkak të mos realizimit të aktiviteteve të tyre tregtare të mjaftueshme në ALPEX, u tërhoqën gjithsej 5 Anëtarë Burse, 3 në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 2 në Zonën e Ofertimit të Kosovës. Numri i përgjithshëm i Anëtarëve të Bursës në ALPEX në fund të vitit 2025, që vijojnë të jenë aktiv, arriti në 41, në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë 26 dhe në Zonën e Ofertimit të Kosovës 15. Të gjithë Anëtarët e Bursës janë të regjistruar në Tregun e Ditës në Avancë. Në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë janë të regjistruar gjithsej 28 Anëtarë Burse, 16 në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 12 në Zonën e Ofertimit të Kosovës.

Gjatë vitit 2025 u rrit aktiviteti i tregtimit si në numër të ofertave ashtu dhe në volumin e tyre me rreth 32% krahasuar me vitin 2024. Për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje për vitin 2025 ishte 1,648 GWh, krahasuar me 1,132 GWh në vitin 2024, ndërkohë oferta në shitje ka qenë

1,677 GWh, krahasuar me 1,128 GWh në vitin 2024.

Për bashkimin e tregut Shqipëri - Kosovë, oferta në blerje për vitin 2025 ishte 2,811 GWh, krahasuar me 1,534 GWh ose 45% më shumë krahasuar me vitin 2024, ndërkohë oferta në shitje ka qenë 2,719 GWh, krahasuar me 1,868 GWh ose 31% më tepër se në vitin 2024.

Gjatë vitit 2025 kemi rritje për të gjithë treguesit e tregut të energjisë elektrike krahasuar me vitin 2024.

Volumet në blerje janë rritur me 42,036 MWh dhe në vlerë janë rritur me 6,245,454 Euro.

Volumet në shitje janë rritur me 325,862 MWh dhe në vlerë janë rritur me 35,655,688 Euro.

Volumet në total janë rritur me 367,898 MWh dhe në vlerë janë rritur me 41,901,142 Euro.

Viti 2025 shënon një pikë kthese në pikëpamjet afatgjata të gazit natyror pas disa vitesh mungesë, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë riaktivizoi Skenarin e Politikave Aktuale (SPA) në Perspektivën e saj Botërore të Energjisë ose (WEO) 2025.

SPA kishte qenë një skenar standard deri në vitin 2020, por u hoq gjatë periudhës së Covid-19 për shkak të ndryshimeve të shpejta të politikave dhe çrregullimeve të tregut. Rivendosja e tij sinjalizon pasiguri në rritje mbi shpejtësinë e tranzicionit energjetik dhe interes të ripërtërirë për të kuptuar se si evoluon bota nga pikëpamja e energjisë.

Gazi për energji mbeti një nxitës kryesor, së bashku me kërkesën në rritje nga sektorët e transportit dhe industrisë, duke përmirësuar lidhjen e tregut pavarësisht pasigurive të vazhdueshme gjeopolitike.

Gjatë vitit 2025 në vendin tonë kanë ushtruar aktivitetet në fushën e gazit natyror TAP AG dhe Albgaz sh.a.

Aksionerët e TAP AG për vitin 2025 janë, SOCAR (Azerbajxhan) me 20%, BP (Angli) me 20%, SNAM S.p.A (Itali) me 20%, Fluxys (Belgjikë) me 20%, Enagas (Spanja) me 20%. Struktura e aksioneve të TAP mbetet e njëjtë edhe për vitin 2025, ku secili prej aksionerëve ka aksione të barabarta prej 20%.

Më 15 nëntor 2025, TAP shënoi 5 vjet operacione tregtare. Përgjatë këtyre viteve TAP transportoi mbi 54 miliardë metra kub gaz dhe u bë gjatë vitit 2025, burimi i dytë i vetëm i gazit natyror për Italinë, duke përfaqësuar 16% të importeve totale dhe 25% të importeve të gazit përmes tubacioneve.

Në vitin 2025, ERE ka vijuar forcimin e kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke miratuar akte nënligjore të rëndësishme në zbatim të ligjeve nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar. Gjatë vitit, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 53 mbledhje, ku janë shqyrtuar dhe miratuar 353 vendime.

Ndër to përmendim miratimin e 5 akteve të cilët harmonizojnë sektorin energjetik shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian, pjesë e paketës së Acquis Communautaire dhe që garantojnë menaxhim më efikas të kapaciteteve dhe rrjetit elektrik, rrisin sigurinë e furnizimit dhe përmirësojnë funksionimin e tregut të energjisë në Shqipëri.

- **Vendimi nr. 93, datë 28.04.2025 - Për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (CACM)”.** Me këtë vendim, Bordi i ERE miratoi “Rregulloren për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (CACM)”, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/1222, në zbatim të Vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

- **Vendimi nr. 290, datë 13.11.2025 - Mbi miratimin e Rregullores “Për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata”.** Bordi i ERE vendosi të miratojë “Rregulloren për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata”, të propozuar nga OST sh.a., e cila përbën transpozim të drejtpërdrejtë të Rregullores (BE) 2016/1719 (FCA Guideline), në përputhje me Vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.
- **Vendimi nr. 291, datë 13.11.2025 - Mbi miratimin e “Një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”.** Bordi i ERE vendosi të miratojë “Udhëzuesin për Balancimin e Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga OST sh.a., në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/2195 dhe Vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.
- **Vendimi nr. 347, datë 29.12.2025 - Për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen”.** Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 29.12.2025, miratoi “Kodin e Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen”, i cili transponon Rregulloren (BE) 2017/2196, në zbatim të Vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.
- **Vendimi nr. 348, datë 29.12.2025 - Për miratimin e “Udhëzuesit mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.** Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 348, datë 29.12.2025, miratoi “Udhëzuesin për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, i cili transponon Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/1485, në zbatim të Vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Sekretariati i komunitetit të Traktatit të Energjisë (ENC), ka përgëzuar miratimin e Kodeve nga ERE dhe po ashtu në publikimin më të fundit i janarit 2026, “Vlerësimi i kuadrit ligjor të REMIT në Palët Kontraktuese”, ENC ka vlerësuar se, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka bërë progres të konsiderueshëm në zbatimin e parimeve të REMIT, përmes miratimit të rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut dhe përfshirjes së dispozitave përkatëse në kuadrin ligjor ekzistues. ERE ushtron kompetenca të plota për monitorimin e tregut me shumicë, mbledhjen e të dhënave, hetimin e abuzimeve dhe vendosjen e sanksioneve, duke reflektuar një nivel të mirë të përafrimit me kërkesat bazë të REMIT. ERE vlerësohet se ka hedhur bazat e nevojshme rregullatore dhe operationale, duke krijuar kushtet për avancimin e mëtejshëm drejt një zbatimi të plotë dhe efektiv të standardeve evropiane në tregun e energjisë.

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të ERE është dhe licencimi në veprimtaritë/aktivitet e sektorit të energjisë elektrike apo të gazit natyror. Në këtë vit, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike janë licencuar 24 subjekte, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike janë licencuar 7 subjekte, si dhe në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike janë realizuar 12 licencime.

Në fushën e njohjes së licencave të lëshuara nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër, Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë, një shteti Anëtar të Bashkimit European, ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe, për njohjen reciproke të licencave ndërmjet ERE dhe autoritetit përkatës rregullator, për vitin 2025 janë realizuar 2 njohje licensash, 1 për aktivitetin e furnizimit dhe 1 për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Mbrojtja e konsumatorit dhe për vitin 2025 ka qenë një nga shtyllat themelore të veprimtarisë së ERE-s dhe një prioritet i vazhdueshëm institucional, duke i kushtuar një vëmendje të vazhdueshme dhe angazhim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore dhe administrative. Garantimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve u siguron atyre trajtim të drejtë, të përgjegjshëm dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit e shërbimit të energjisë elektrike, si dhe u krijojnë atyre kushtet e nevojshme për të marrë vendime objektive dhe të mirëinformuara mbi

shërbimet që përfitojnë.

Gjatë vitit 2025, pranë ERE-s janë paraqitur gjithsej 244 ankesa dhe kërkesa për informacion ose orientim, që lidhen me çështje dhe shqetësime të konsumatorëve. Prej tyre, 161 janë regjistruar dhe trajtuar si ankesa, ndërsa 83 kanë qenë kërkesa për orientim ose parashtrësia të paplota, të cilat nuk plotësonin kriteret minimale për çeljen e një hetimi administrativ.

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së vitit 2025, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), me vendimin nr. 276/2025, ka miratuar Planin e Masave për zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve. Bëjmë me dije se, sa i përket rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përmbushur, pjesa tjetër janë në proces përmbushjeje dhe në vazhdimësi për ndjekje, ndërsa një pjesë kërkojnë realizim të plotë, i cili është i lidhur me ndryshimet që pritet të ndodhin në legjislacionin primar dhe që do të ndikojnë në përditësimin e kuadrit rregullator nga ERE. Në mënyrë të veçantë, ERE ka përmbushur detyrimet që lidhen me përmirësimin e kuadrit rregullator përmes miratimit të akteve dhe metodologjive përkatëse, forcimin e monitorimit të tregut të energjisë, si dhe rritjen e transparencës institucionale përmes publikimit të vendimeve, përditësimit të vazhdueshëm të informacionit dhe zbatimit të programeve të transparencës. Gjithashtu, janë ndërmarrë masa konkrete në drejtim të forcimit të sigurisë kibernetike në sektor, përmes mbledhjes dhe analizimit të informacionit nga operatorët dhe ndjekjes së zbatimit të kërkesave rregullatore përkatëse.

Në vijim të zbatimit të rekomandimeve, ERE ka ndërmarrë veprime në mbështetje të konsumatorëve dhe zhvillimit të tregut, përfshirë aktivitete informuese dhe promovuese për përdorimin e instrumenteve që rrisin transparencën dhe konkurrencën, si Platforma e Krahimit të Çmimeve, si dhe iniciativa për ndërgjegjësimin mbi eficiencën e energjisë dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme. Procesi për ngritjen e platformës digjitale për trajtimin e ankesave është në fazë përgatitore, me hapat paraprakë të realizuar, ndërsa janë ndërmarrë masa në funksion të informimit dhe mbrojtjes së konsumatorit. Njëkohësisht, është vijuar me shqyrtimin e planeve të investimeve të operatorëve të rrjetit dhe monitorimin e zhvillimeve në tregun e organizuar të energjisë, për të cilin gjithashtu ERE ka ofruar platformën digjitale për hedhjen e të dhënave nga pjesëmarrësit e tregut.

Për vitin 2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka përcaktuar një sërë objektivash strategjike të përditësuar, të cilët synojnë konsolidimin e reformave të ndërmarra në sektorin energjetik dhe avancimin e mëtejshëm drejt një tregu të qëndrueshëm, të liberalizuar dhe të integruar në nivel europian. Këto objektiva reflektojnë jo vetëm detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, por edhe nevojat në zhvillim të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Një nga prioritetet kryesore mbetet vijimi i liberalizimit dhe monitorimit të tregut të energjisë. Në këtë drejtim, ERE synon të forcojë transparencën dhe integritetin në tregun me shumicë, duke garantuar një mjedis konkurrues dhe të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit. Kjo përfshin rritjen e kapaciteteve monitoruese dhe përmirësimin e mekanizmave rregullatorë për të parandaluar abuzimet dhe për të siguruar funksionimin efikas të tregut.

Paralelisht, zhvillimi i burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE) përbën një shtyllë thelbësore të strategjisë së ERE për vitin 2026. ERE synon të nxisë integrimin e këtyre burimeve në treg, duke krijuar kushte të favorshme për investime dhe duke lehtësuar përfshirjen e energjisë së pastër në sistemin elektroenergjetik. Kjo lidhet ngushtë me objektivat kombëtare dhe europiane për tranzicionin drejt energjisë së gjelbër.

Në funksion të këtyre zhvillimeve, përmirësimi i kuadrit teknik dhe rregullator mbetet një tjetër drejtim kyç. ERE do të punojë për përshtatjen e rregulloreve dhe standardeve teknike me dinamikën e reja të tregut dhe me kërkesat që vijnë nga integrimi i burimeve të rinovueshme, duke garantuar një funksionim të sigurt dhe efikas të rrjeteve energjetike.

Një rol të rëndësishëm zë edhe integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërinstitucional. ERE do të vijojë përpjekjet për përafrimin e kuadrit rregullator me atë të Bashkimit Evropian, si dhe për forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe organizatat ndërkombëtare, në mënyrë që të sigurohet një integrim sa më i plotë në tregun rajonal dhe evropian të energjisë.

Për herë të parë, në objektivat strategjike përfshihet edhe dimension i barazisë gjinore dhe përfshirjes, duke synuar ruajtjen e një mjedisi pune të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë punonjësit, për të ndërtuar një kulturë organizative të qëndrueshme.

Në aspektin rregullator, një tjetër fokus do të jetë vlerësimi i metodologjive aktuale të tarifave për operatorët e rrjetit, me qëllim përshtatjen e tyre me aktualitetin dhe kërkesat e tregut dhe garantimin e një strukturë tarifore më të drejtë dhe më transparente për të gjithë aktorët.

Gjithashtu, gjatë vitit 2026 do të emërohet Operatori i Nominuar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), në përputhje me rregullat e alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongjestioneve (CACM). Ky proces është thelbësor për funksionimin e tregut të organizuar të energjisë dhe për integrimin me tregjet europiane.

Pjesë e objektivave të ERE-s për vitin 2026 është edhe plotësimi i kuadrit rregullator, përfshirë kodet e rrjetit, duke i harmonizuar ato me zhvillimet më të fundit të legjislacionit në fuqi.

Një tjetër objektiv i rëndësishëm është rishikimi i rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim për përditësimin në harmoni me praktikën më të mira rregullatore.

Së fundmi, ERE synon të hartojë një strategji të dedikuar për mbrojtjen e konsumatorit, e cila do të jetë në përputhje me strategjinë kombëtare në këtë fushë. Kjo strategji do të vendosë në qendër interesin e konsumatorit, duke garantuar të drejta të plota, informim të saktë dhe mbrojtje nga praktikën e padrejtë në tregun e energjisë.

Në përfundim, shprehim angazhimin e plotë të të gjitha strukturave të ERE-s, që institucioni do të vijojë punën për të përmbushur të gjitha detyrimet që burojnë nga aktet ligjore në fuqi, ku ndër më kryesoret janë: Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; Ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe akte të tjera ligjore të miratuara në zbatim të tyre.

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

1.1. Struktura e Sektorit Elektro-Energjistik Shqiptar

Sektori i energjisë elektrike në Shqipëri përfshin këto veprimtari: prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, operimin e tregut të energjisë, tregtimin dhe furnizimin me energji elektrike. Këto veprimtari realizohen nga subjekte të licencuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), në përputhje me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëritë publike KESH sh.a. dhe HEC Lanabregas sh.a., të cilat janë shoqëri me kapital 100% shtetëror, si dhe nga subjektet private të licencuara në këto aktivitete, të tilla si: prodhuesit me përparësi, prodhuesit e pavarur dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike.

Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore. Në përputhje me nenin 58 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, OST sh.a. është certifikuar dhe licencuar për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E, Organizatës Europiane të operatorëve të Sistemit të Transmetimit.

Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore dhe është licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Në të njëjtën kohë, ERE, në mbështetje të neneve 16 dhe 72 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2020, ka vendosur miratimin e Programit të Pajtueshmërisë të shoqërisë OSSH sh.a.

Operimi i tregut të energjisë elektrike në vendin tonë, me fillimin e operimit të ALPEX sh.a. në vitin 2023, bëhet bazuar në modelin e tregut të miratuar me VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, ndryshuar me VKM nr. 872, datë 27.12.2022.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të thjeshtuar skema e sistemit elektroenergjetik shqiptar.

Skema e Sistemit Elektro-Energjetik




Figura 1. Skema e Sistemit Elektro-Energjetik

(Burimi: ERE)

1.2. Prodhimi i energjisë elektrike

Prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri realizohet nga shoqëri publike dhe private të licencuara për këtë aktivitet. Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe aktet e tjera të miratuara nga ERE përcaktojnë detyrat për ushtrimin e veprimtarive të shoqërive publike dhe atyre private që ushtrojnë këtë veprimtari.

KESH sh.a. vijon të jetë shoqëria më e madhe prodhuese e energjisë elektrike në Shqipëri. Përgjatë vitit 2025 ka përmbyshur detyrimin e shërbimit publik, bazuar në VKM-në nr. 456, datë 29.6.2022, e ndryshuar, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Për periudhën që mbulon kjo VKM, KESH sh.a., për menaxhimin e kaskadës dhe sigurimin e energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve në treg të rregulluar, ka kryer procedurat sipas këtij vendimi për depozitimin dhe shkëmbimin e tepricave të energjisë elektrike, pasi ka plotësuar nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. Bazuar në këtë vendim, teprica e energjisë së prodhuesit publik është sasia e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, që tejkalon sasinë e pambuluar të humbjeve totale mujore në rrjetin e shpërndarjes, sipas bilancit energjetik të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a. dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. paguan shoqërinë publike të prodhimit për shërbimin e shkëmbimit/depozitimit. Metodologjia për përcaktimin e vlerës së kësaj pagese miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë publike të prodhimit, me propozimin e shoqërive. Kjo marrëdhënie rregullohet në kontratën dypalëshe ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a., dhe mban në konsideratë metodologjinë e përcaktimit të vlerës së pagesës dhe rregullat e tregut të balancimit në fuqi.

Prodhuarit me përparësi dhe prodhuarit e pavarur të energjisë elektrike janë subjekte të licencuara ndër vite nga ERE, që shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të privatizimit, marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të energjisë elektrike.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri më 31 dhjetor 2025 është rreth 3,475 MW. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritjeje krahasuar me vitin 2024, prej rreth 262 MW. Rritja e kapacitetit të instaluar përgjatë vitit vjen si rezultat i shtimit të burimeve të rinovueshme fotovoltaike dhe atyre hidrike të energjisë elektrike.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1,563 MW dhe përbën rreth 45 % të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1,912 MW dhe përbën rreth 55 % të kapacitetit total të instaluar në vendin tonë.

Sikurse evidentojnë këto shifra, si rezultat i zhvillimit të sektorit privat në prodhimin e energjisë elektrike, nga viti në vit rritet pjesa e kontributit të këtyre prodhuesve në vendin tonë.

1.2.1. Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2025

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2025 është **7,467,589 MWh**, nga i cili:

- **3,452,265 MWh** u prodhuan nga KESH sh.a.
- **4,015,324 MWh** u prodhuan nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. gjatë vitit 2025 përbën 46.2% të prodhimit total të energjisë elektrike në vend, duke shënuar një ulje prej 9.5 % krahasuar me vitin 2024, kur ky tregues ishte 55.7%. Nga ana tjetër, prodhimi i realizuar nga prodhuesit e tjerë të

energjisë përbën rreth 53.8% të prodhimit total në vitin 2025, në rritje krahasuar me 44.3% që zinte në vitin 2024.

Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, ashtu edhe në rrjetin e shpërndarjes.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit është rreth 2,905 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 6,402 GWh.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është rreth 570 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 1,065 GWh.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2025 KRAHASUAR ME 2024		Rrjeti	Prodhiimi 2024 (MWh)	Prodhiimi 2025 (MWh)
P.Pub	Prodhuës Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	4,371,085	3,452,265
P.Pav	Prodhuës të Pavarur Hidro (Prodhuës në treg të lirë)	Lidhur në OST+OSSH	1,157,174	1,260,056
P.Pav	Prodhuës të Pavarur Fotovoltaikë (Prodhuës në treg të lirë)	Lidhur në OSSH+OST	158,105	697,607
PPE	Prodhuës me Përparesi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	1,206,516	1,143,712
	Prodhuës me Përparesi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	876,046	779,210
	Prodhuës me Përparesi Fotovoltaikë (Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	67,700	134,739
Totali			7,836,626	7,467,589

Tabela 1. Të dhëna mbi prodhuesit dhe prodhimin e tyre (MWh) për vitin 2025 krahasuar me vitin 2024

Në tabelën më sipër paraqiten të dhëna mbi prodhimin e energjisë elektrike për të gjitha kategoritë e prodhuesve që janë në operim. Nga këto të dhëna evidentohet që për vitin 2025 ka një rënie të lehtë të prodhimit të energjisë elektrike krahasuar me vitin 2024, e cila rezulton të jetë 369 GWh.

Në të njëjtën kohë, në tabelën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për vitin 2025, duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjisë elektrike të KESH sh.a., si prodhuës publik, prodhimin e “KARAVASTA SOLAR” sh.p.k., prodhimin e HEC-eve në rrjetin e OSSH sh.a. dhe OST sh.a., si dhe centraleve fotovoltaikë në rrjetin e OSSH sh.a. dhe OST sh.a..

Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh.a. ka vijuar të zërë peshën kryesore në prodhimin vendas edhe përgjatë vitit 2025.

PRODIMI NETO VENDAS 2025 (MWh)	Viti 2025
HEC-et / PPE në rrjetin e OSSH sh.a.	762,007
HEC-et / PPE në rrjetin e OST sh.a.	935,380
HEC-et e pavarur IPP në rrjetin e OST sh.a.	1,186,211
HEC-et e pavarur IPP në rrjetin e OSSH sh.a.	73,845
HEC Lanabregas	17,202
HEC Ashta	208,332
Centralet Fotovoltaike (kontratë me FTL) në rrjetin e OSSH sh.a.	134,739
Centralet Fotovoltaike (në treg të lirë) në rrjetin e OSSH sh.a. + OST sh.a.	438,383
Centrali Fotovoltaik "KARAVASTA SOLAR" sh.p.k.	259,224
Prodhimi neto prodhuesi publik KESH sh.a	3,452,265
TOTAL VENDAS 2025	7,467,589




Figura 2. Prodhimi neto vendas për vitin 2025 (MWh)

(Burimi: OST sh.a.; KESH sh.a.; FTL sh.a.)




Figura 3. Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2025 (MWh)

Të dhënat e reflektuara në tabelën e mësipërme, tregojnë se prodhimi vendas i energjisë elektrike në Shqipëri paraqet luhatje të dukshme gjatë vitit, të lidhura kryesisht me kushtet hidrologjike. Prodhimi është më i ulët gjatë muajve të verës, veçanërisht në periudhën korrik-shtator, ndërsa rritet ndjeshëm në muajt e fundit të vitit, duke arritur kulmin në dhjetor. Pjesa më e madhe e prodhimit sigurohet nga hidrocentralet, veçanërisht nga KESH sh.a. dhe HEC-et private apo me koncesion, çka tregon varësinë e lartë të sistemit energjetik nga burimet hidrike. Ndërkohë, impiantet fotovoltaike kanë një kontribut më të vogël, por shfaqin rritje të prodhimit gjatë muajve me më shumë rrezatim diellor.

Tabela më poshtë paraqet krahasimin 10-vjeçar të prodhimit vendas të energjisë elektrike për periudhën 2016-2025 me mesataren e prodhimit të së njëjtës periudhë.




Figura 4. Prodhimi vendas (MWh) për periudhën 10 vjeçare 2016-2025 në raport me mesataren e prodhimit të kësaj periudhe.

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, rezultojnë se në vitin 2025 është regjistruar një sasi prodhimi prej 7,467 GWh, e cila është rreth 369 GWh më e ulët krahasuar me prodhimin e realizuar në vitin 2024, në masën 7,836 GWh, çka lidhet me ndryshimet në kushtet hidrologjike.

Prodhimi bruto vendas historik për Kaskadën e Drinit për periudhën 1995–2024 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë.

Nga pikëpamja hidrologjike, vitin 2025 ka qenë një vit i thatë me prurje nën mesataren 30-vjeçare. Duhet theksuar se që në fillim të vitit 2025, situata hidrike ka qenë e vështirë pasi periudha relativisht e thatë filloi që nga pjesa e II e 2024, duke startuar vitin 2025 me nivel të ulët shfrytëzimi në liqenin e Fierzës dhe rrjedhimisht me rezervë të kufizuar energjetike. Gjatë 2025, prurjet kanë rezultuar thuajse të njëjta me vitin 2024 dhe më të ulëta se në tre vitet e fundit. Gjatë kësaj periudhe është regjistruar vetëm një luhetje e madhe hidrike në muajin nëntor, i cili ka sjellë dhe rritje të konsiderueshme të prurjeve në basenin e Fierzës dhe Koman-Vau i Dejës. Rrethana të tjera reshjesh në prurje të mëdha hidrike nuk ka pasur.

Prodhimi bruto nga hidrocentralet e Kaskadës së Lumit Drin për vitin 2025 rezultoi 3,404,844 MWh ose rreth -17.5% më e ulët krahasuar me 2024 prej 4,124,239 MWh, duke nxjerrë në pah situatën e vështirë hidrike, që përshkroi vitin 2025, veçanërisht pjesën 6-mujore mjaft të thatë hidrike.

Prodhimi maksimal bruto i energjisë elektrike nga hidrocentralet e Kaskadës për vitin 2025 është shënuar në muajin dhjetor, në sasinë 485 GWh, ndërkohë që prodhimi bruto minimal mujor i energjisë elektrike gjatë vitit 2025 është regjistruar në muajin shtator, në sasinë 183 GWh.

Prurjet mesatare gjatë vitit 2025 në liqenin e Fierzës, të ndikuara kryesisht nga reshjet e tre mujorit të fundit të vitit, rezultuan rreth 145 m³/s ose pothuajse njësoj krahasuar me periudhën respektive të vitit 2024, prej 140 m³/s. Krahasuar me mesataren shumëvjeçare të 30-viteve (1995-2024) prej 183 m³/s, prurjet e këtij viti kanë rezultuar rreth -21 % më të ulëta.

Gjatë 6-mujorit të parë 2025, prurjet në liqenin e Fierzës ishin 160 m³/s, më të ulëta krahasuar

me të njëjtën periudhë të vitit 2024 ku prurjet ishin 180 m³/s. Gjatë 6-mujorit të dytë të 2025, prurjet përmirësohen disi në 120 m³/s, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024 prej 100 m³/s, duke ekuilibruar situatën e prurjeve ndërmjet dy viteve. Pavarësisht përmirësimit të moderuar në pjesën e II, viti 2025 klasifikohet si vit i pafavorshëm hidrologjikisht, krahasuar edhe me mesataren shumëvjeçare 1995-2024.

Sipas raportimeve të KESH sh.a., rezerva energjetike në fillim të vitit 2025 ishte 477 GWh, ndërsa fundi i vitit u mbyll me 727 GWh, duke akumuluar shtesë neto rezervë hidrike prej rreth 250 GWh. Rezerva energjetike e fillim vitit 2025 prej 477 GWh ishte sa 52 % e rezervës së fillim vitit 2024 prej 913 GWh. Në terma mesatarë, rezerva energjetike mesatare mujore për vitin 2025 rezulton në 574 GWh ose rreth 323 GWh më pak krahasuar me vitin 2024, 32% më i ulët krahasuar me mesataren shumëvjeçare mujore (1995-2024) prej 846 GWh.

Në këto kushte, të gjitha prurjet e ardhura në kaskadë janë menaxhuar me kujdes dhe pa shkarkime pa prodhim nga tunelet, duke ruajtur rezervën energjetike për stinën e verës ku prurjet janë relativisht të ulëta dhe kërkesa për energji është e lartë.

Referuar treguesve të mësipërm të raportuar nga shoqëria KESH sh.a., rezulton se në tërësi viti 2025 ka qenë një vit relativisht i thatë, ku ecuria e reshjeve dhe e prurjeve natyrore nuk ka qenë e qëndrueshme.

1.2.2. Të dhënat teknike kryesore dhe energjia elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2025.

Shoqëria publike KESH sh.a. ka në zotërim tre hidrocentrale të Kaskadës së Lumit Drin, Termocentralin e Vlorës, termocentralet lundruese Tigri 1 dhe Tigri 3, si dhe impiantin fotovoltaiik “Qyrsaq”. Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a., së bashku me kapacitetin e instaluar të secilit prej tyre, paraqitet në të dhënat më poshtë. Në tabelë evidentohet numri i agregateve, kapaciteti i instaluar për secilin agregat, si dhe fuqia e përgjithshme e instaluar për secilin central.

Implantet prodhuese të KESH sh.a	Fierzë	Koman	Vau i Dejës	TEC Vlora	Centrali fotovoltaiik Qyrsaq	Tigri 1 & Tigri 3
Numri i Agregatëve	4	4	5	2		2
Fuqia e Agregatëve në MW	125	150	50	70+28		50+60
Fuqia totale e instaluar e impiantit në MW	500	600	250	98	5	110
Fuqia totale e instaluar e KESH sh.a. në MW	1563					

Figura 5. Struktura e impianteve prodhuese të shoqërisë publike KESH sh.a. dhe fuqia totale e instaluar (MW)

(Burimi: KESH sh.a.)

Kapaciteti total i instaluar në zotërim nga KESH sh.a. arrin në rreth 1,563 MW, nga të cilat kapaciteti i instaluar i HEC-ve në Kaskadën e Lumit Drin është 1,350 MW, TEC-i i Vlorës 98 MW, termocentralet lundruese Tigri 1 & Tigri 3 me kapacitet 110 MW, si dhe ai i impiantit

fotovoltaik “Qyrsaq” 5.14 MW.




Figura 6. Prodhimi bruto i energjisë elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit në GWh (2016-2025)

(Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.)

Prodhimi maksimal bruto i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., krahasuar me periudhën 10-vjeçare 2016–2025, është arritur në vitin 2018, në sasinë 5,851 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike në vitin 2018 është 2,447 GWh më i lartë se prodhimi i arritur në vitin 2025, i cili rezulton në sasinë 3,404 GWh. Ky tregues paraqet në mënyrë të qartë shkallën e lartë të varësisë nga kushtet hidrologjike dhe, për rrjedhojë, ekzistencën e riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë.

Varësia e prodhimit të energjisë elektrike (për shkak se ky prodhim bazohet kryesisht në burime hidrike) bën të nevojshëm vijimin e diversifikimit të burimeve të prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe Planin e Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të energjisë, miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar prodhimi bruto mujor i energjisë elektrike për vitin 2025 nga hidrocentralet e Kaskadës së Lumit Drin, në administrim të shoqërisë KESH sh.a., krahasuar kjo me vitin 2024.




Figura 7. Prodhimi bruto i energjisë elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (GWh) gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024

(Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.)

Prodhimi bruto maksimal i KESH sh.a. është regjistruar në muajin dhjetor, me sasinë 485 GWh, dhe prodhimi minimal në muajin shtator, me sasinë 183 GWh. Sikurse evidentohet, diferenca ndërmjet prodhimit maksimal mujor të realizuar (485 GWh) dhe atij minimal (183 GWh) për vitin 2025 vijon të jetë e konsiderueshme, në vlerën 302 GWh. Gjithashtu, krahasuar me prodhimin mujor të vitit 2024, diferenca më e madhe e prodhimit të energjisë nga kaskada është në muajin korrik, ku evidentohet një diferencë prodhimi prej 243 GWh.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat në metra mbi nivelin e detit të liqenit të Fierzës gjatë vitit 2025.




Figura 8. Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2025 (mmnd)

(Burimi: KESH sh.a.)

Baseni i HEC-it të Fierzës është baseni më i madh ujqor në Kaskadën e Lumit Drin dhe shërben si rregullator vjetor i rezervës hidrike të kësaj kaskade. Niveli i ujit në basenin e Fierzës ndikon drejtpërdrejt në shfrytëzimin e të gjithë kaskadës mbi lumin Drin.

Niveli në liqenin e Fierzës në datë 1 janar 2025 rezultoi në kuotën 269.22 mbi nivelin e detit ose -15.27 m më i ulët, krahasuar me treguesin respektiv të 2024, prej 284.49 mbi nivelin e detit. Ndërsa krahasuar me të njëjtin tregues shumëvjeçar (1995-2024) rezulton -7.87 m më i ulët. Kjo për shkak të thatësirës së tejzgjatur dhe mungesës së reshjeve, veçanërisht në pellgun ujëmbledhës të HEC Fierzës.

Në tregues periudhe, niveli mesatar i Fierzës gjatë 6-mujorit i të vitit 2025 rezulton 275.38 mmnd. Në krahasim me mesataren shumëvjeçare (1995-2024) prej 283.82 mmnd, niveli mesatar i liqenit të Fierzës gjatë 6-mujorit i 2025 rezulton me gati -8.44 m më i ulët.

Periudha 6-mujore i mbyllet me nivelin në liqenin e Fierzës me datë 1 korrik 2025 në kuotën 278.79 mmnd, ose rreth -14.61 m më i ulët se viti 2024 prej 293.40 mmnd. Po kështu, krahasuar me treguesin shumëvjeçar të 30-viteve prej 289.97 mmnd, rezulton me -11.18 m më i ulët.

Niveli i Fierzës në fund të vitit, më 31 dhjetor 2025 ishte 278.76 m, me një rritje krahasuar me fillimin e vitit prej +9.54 m, dhe +1.67 m krahasuar me mesataren shumëvjeçare. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e eventit hidrik të ndodhur gjatë muajit nëntor. Niveli maksimal i Fierzës për vitin 2025 është regjistruar në dhjetor 282.63 metra, ndërsa niveli minimal në fundin e muajit tetor 257.03 metra.

Sikurse evidentohet kuota maksimale e arritur përgjatë vitit 2025 është vetëm 282.63 mmnd. Viti 2025 ka qenë një vit jo i mirë nga pikëpamja hidrologjike dhe si e tillë nuk është arritur në asnjë periudhë të vitit kuota maksimale në këtë liqen prej 296 metër mbi nivelin e detit.

Të dhënat 10-vjeçare për periudhën (2016-2025) mbi nivelin e liqenit të HEC-it të Fierzës paraqiten më poshtë, duke evidentuar kuotat mesatare minimale mujore dhe mesatare maksimale mujore.

NIVELI I FIERZËS PËR PERIUDHËN 10 VJEÇARE 2016-2025												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2016	289.9	274.1	291.8	296.5	296.2	295.6	290.5	285.4	283.3	288.4	288.9	281.6
2017	271.5	274.1	280.9	278.7	281.6	272.4	270.2	268.0	271.0	264.6	269.6	289.9
2018	289.7	274.1	295.0	296.5	296.4	296.0	294.0	287.5	277.9	270.2	266.5	267.3
2019	267.3	274.1	272.7	279.9	289.9	292.7	287.6	278.5	274.2	268.6	273.2	275.6
2020	271.6	272.0	283.5	288.6	293.6	291.7	284.6	276.5	273.5	274.1	268.7	272.7
2021	291.7	294.1	292.6	294.3	296.7	291.7	282.7	274.3	271.3	267.7	267.8	275.1
2022	270.7	268.3	260.7	282.5	289.0	288.0	281.5	270.4	271.4	267.9	281.7	291.7
2023	293.2	286.4	291.5	295.6	296.1	296.3	291.4	281.3	270.8	263.5	280.1	284.5
2024	286.5	287.4	287.4	292.6	296.1	294.9	289.4	280.6	271.9	270.6	265.1	267.3
2025	272.7	273.2	268.4	277.6	281.1	280.5	276.4	270.1	270.1	264.9	268.9	281.2
	Niveli mesatar minimal mujor vitet 2016-2025											
	Niveli mesatar maksimal mujor vitet 2016-2025											

Tabela 2. Niveli i liqenit të HEC-it të Fierzës (mmnd) për periudhën 2016-2025

(Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.)

Më poshtë paraqitet grafikisht niveli mesatar mujor i ujit (në metra) në rezervuarin e Fierzës për vitin 2025, krahasuar me nivelet mesatare mujore historike për periudhën 1991–2024.




Figura 9. Niveli mesatar mujor (mmnd) i liqenit të Fierzës për vitin 2025 në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991–2024

(Burimi: KESH sh.a.)

Sikurse shihet, në muajin dhjetor 2025 niveli mesatar mujor i ujit në liqenin e Fierzës ka arritur kuotën 281.18 metra, që përfaqëson nivelin mesatar maksimal mujor të regjistruar gjatë vitit. Siç evidentohet më sipër, përgjatë periudhës janar - nëntor 2025, niveli i ujit në liqenin e Fierzës ka qenë nën nivelin mesatar mujor shumëvjeçar. Ndërsa gjatë periudhës së muajit dhjetor, e cila u karakterizua nga prurje të larta për shkak të reshjeve të fundit të muajit nëntor, niveli i ujit ka qenë mbi mesataren mujore historike.

Mesatarja shumëvjeçare e nivelit të ujit në liqenin e Fierzës përbën një tregues kryesor në planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike në të gjithë Kaskadën e Lumit Drin.

Në figurën në vijim, paraqiten prurjet mesatare të ujit për vitin 2025 në liqenin e Fierzës, si dhe niveli mesatar i shfrytëzimit të këtij rezervuari gjatë vitit.




Figura 10. Prurjet mesatare mujore (m^3/s) në liqenin e HEC-it të Fierzës gjatë vitit 2025, si dhe niveli mesatar i shfrytëzimit të Fierzës gjatë vitit 2025

(Burimi: KESH sh.a)

Në grafikun e figurës më poshtë rezerva energjitike e çdo fund muaji në Kaskadën e Lumit Drin gjatë vitit 2025, si dhe prodhimi mujor i energjisë elektrike për të njëjtin vit.




Figura 11. Rezerva energjitike çdo fund muaji dhe prodhimi mujor 2025 (GWh)

(Burimi: KESH sh.a)

Rezerva energjetike në fillim të vitit 2025 rezultoi në nivelin 477 GWh, ndërsa në fund të vitit arriti në 727 GWh, duke reflektuar një rritje neto të rezervës hidrike prej +250 GWh gjatë vitit. Megjithatë, niveli i rezervës në fillim të vitit 2025 ishte dukshëm më i ulët krahasuar me vitin pararendës, pasi 477 GWh përfaqëson vetëm rreth 52% të rezervës së regjistruar në fillim të vitit 2024, e cila ishte 913 GWh. Në terma mesatarë, rezerva energjetike mujore për vitin 2025 vlerësohet në rreth 574 GWh, çka rezulton rreth 323 GWh më pak krahasuar me mesataren mujore të vitit 2024. Po ashtu, kjo vlerë paraqitet rreth 32% më e ulët në raport me mesataren shumëvjeçare mujore për periudhën 1995–2024, e cila rezulton në 846 GWh. Në këto kushte, të gjitha prurjet e ardhura në kaskadë janë menaxhuar pa shkarkime pa prodhim energjie nga tunelet,

duke ruajtur rezervën energjetike për stinën e verës ku prurjet janë relativisht të ulëta dhe kërkesa për energji është e lartë.

KESH sh.a., si një nga ofertuesit kryesorë të shërbimeve ndihmëse në sistemin elektroenergjetik, ka kontribuar në sigurimin e një operimi të qëndrueshëm dhe të besueshëm të rrjetit elektroenergjetik shqiptar. Në total, KESH sh.a. ka ofruar energji balancuese për OST sh.a., në sasinë 196,583 MWh. Nëpërmjet kontratës me KOSTT, janë ofruar edhe shërbime ndihmëse për sistemin elektroenergjetik të Kosovës, në sasinë prej 17,380 MWh.

1.2.3. Masat e marra nga për garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike gjatë vitit 2025 nga KESH sh.a.

Referuar kushteve hidrike dhe situatës së tregjeve, edhe gjatë vitit 2025, shoqëria KESH sh.a. është angazhuar në marrjen e masave dhe shfrytëzimin e mekanizmave, në funksion të përmbushjes së Detyrimit të Shërbimit Publik për furnizim të pandërprerë të klientëve tariforë dhe njëkohësisht me synimin për një ekspozim sa më të ulët ndaj importeve/tregjeve të energjisë.

Përveç prodhimit të brendshëm, Korporata raporton se shfrytëzoi edhe mekanizma të tjerë si, (i) Mekanizmi i tepricave, (ii) shkëmbim energji elektrike në Bursën ALPEX, KEK si dhe Optimizimi i kostove në proceset e blerjes së energjisë, duke ndjekur sinjalet e tregjeve të energjisë, konkretisht të bursës HUDEX, e cila jep një parashikim të çmimeve për javën, muajin dhe vitin në avancë;

Duke qenë se viti 2025 u karakterizua si vit i thatë, për shkak të mungesës së reshjeve dhe prurjeve nën mesataren shumëvjeçare, shoqëria KESH sh.a. raporton se siguri i energjisë elektrike për furnizimin e pandërprerë të konsumatorëve tariforë është realizuar përmes një kombinimi të burimeve vendase dhe importit.

Struktura e furnizimit për vitin 2025 pasqyron ndikimin e drejtpërdrejtë të kushteve hidrologjike të pafavorshme, të cilat rritën varësinë nga importi dhe nga tregu i organizuar i energjisë elektrike. Megjithatë, përmes menaxhimit racional të rezervave ujore dhe diversifikimit të burimeve të furnizimit, KESH sh.a. raporton se arriti të garantojë furnizimin e pandërprerë të konsumatorëve në kuadër të Detyrimit të Shërbimit Publik, duke minimizuar njëkohësisht ndikimin financiar nga ekspozimi ndaj çmimeve të tregut.




Figura 12. Struktura e furnizimit e ndarë në % sipas burimeve të KESH sh.a për zbatimin e Detyrimit të Shërbimit Publik

(Burimi: KESH sh.a)

1.2.4. Centrali fotovoltaiik i Digës së Qyrfaqit (HEC Vau i Dejës)

Impianti PV Diga e Qyrfaq gjatë vitit 2025 nuk ka qenë operativ në prodhim, për shkak të defektit të shkaktuar gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024. Shoqëria KESH sh.a. ka informuar se po merr masat procedurale dhe teknike për rehabilitimin dhe kthimin në aktivitet prodhues të impiantit brenda vitit 2026.

1.2.5. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese të pavarura dhe ato me përparësi për vitin 2025 është 4,015,324 MWh, ose rreth 53.8% e prodhimit total vendas.

Kapaciteti i instaluar total i centraleve prodhuese të pavarura është 1,097.6 MW, ndërsa prodhimi i tyre për vitin 2025 arrin në 1,957,663 MWh. Ky prodhim përfshin HEC-et dhe centralet fotovoltaike të lidhura në rrjetin e OST sh.a. dhe OSSH sh.a.

Të dhënat mbi grupimet e këtyre prodhuesve janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR DHE ATO ME PËRPARËSI		Rrjeti	Prodhimi 2025 (MWh)
P.Pav	Prodhues të Pavarur Hidro (Prodhues në treg të lirë)	Lidhur në OST+OSSH	1,260,056
P.Pav	Prodhues të Pavarur Fotovoltaike (Prodhues në treg të lirë)	Lidhur në OSSH+OST	697,607
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	1,143,712
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	779,210
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaike (Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	134,739
Totali			4,015,324

Tabela 3. Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi, prodhuesit e pavarur dhe prodhimi i tyre (MWh) për vitin 2025

1.2.6. Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike

Përgjatë vitit 2025, një pjesë të rëndësishme zë dhe prodhimi nga impiantet fotovoltaike. Rritja e kapacitetit gjenerues nga këto impiante kontribuon në diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbulimin e nevojave energjitike të vendit.

Kapaciteti i instaluar i impianteve fotovoltaike për vitin 2025 arrin në 631,07 MW, duke përbërë rreth 18 % të kapacitetit total të centraleve të instaluar në vend, ndërsa prodhimi i realizuar prej tyre është 832.3 GWh, duke përfaqësuar 11% të prodhimit total vendas për vitin 2025. Për vitin 2025 përlllogariten gjithsej 52 centrale fotovoltaike në prodhim, me një rritje progresive që prej vitit 2020, ku aktualisht 42 prej tyre zotërojnë kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me FTL sh.a.; 9 prej tyre operojnë në treg të lirë me çmim të parregulluar.

Në mënyrë të detajuar, numri i centraleve fotovoltaike, pikëlidhjet e tyre, fuqia e instaluar dhe prodhimi i energjisë nga këto impiante për vitin 2025 paraqitet në tabelat e mëposhtme dhe në mënyrë krahasimore me vitet 2020-2025.

PRODHIMI GJATE VITIT 2025 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHUR NË RRJETIN E SHPËRNDARJES KONTRATË ME FTL (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI
Seman – 2	2.00	“SEMAN2SUN” sh.p.k	35 kV	4,036
Topojë	2.00	“SONNE” sh.p.k	35 kV	3,949
Topojë 2	2.00	“AED SOLAR” sh.p.k	35 kV	3,962
Topojë (Sheq Marinas)	2.00	“AGE SUNPOWER” sh.p.k	35 kV	3,984
Topojë (Sheq Marinas) 2	2.00	“Seman Sunpower” sh.p.k	35 kV	4,210
SemanIsolar	2.00	“SEMANISOLAR” sh.p.k	35 kV	3,894
ES 2019	2.00	“ES 2019” sh.p.k	35 kV	4,350
SMART WATT	2.00	“Smart Watt” sh.p.k.	35 kV	4,327
Tren Bilisht	2.00	“R T S” sh.p.k.	35 kV	3,792
STATKRAFT Renewbles Albania PV Lndrues banje	2.00	“STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA” sh.a.	35 kV	2,030
Korca Photovoltaic Park	2.00	“KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k.	35 kV	3,803
NTSP	2.00	“NTSP” sh.p.k	35 kV	3,814
Sun Beat System	2.00	“SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k	35 kV	3,797
Tren Sun System	2.00	“TREN SUN SYSTEM” sh.p.k.	35 kV	3,856
ERENI SOLAR	2.00	“ERNI SOLAR” sh.p.k.	35 kV	4,890
GREEN ENERGY BILISHTI	2.00	“GREEN ENERGY BILISHTI” sh.p.k	35 kV	4,791
ALBSOLAR	2.00	“ALBSOLAR” sh.p.k	35 kV	4,457
Pv -Plug	2.00	“AEE” sh.p.k.	10 kV	4,159
SUN ENERGY SOLUTIONS	1.95	“Sun Energy Solutions” sh.p.k.	35 kV	4,453
2 T & 2 B 1979	2.00	“Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k	10 kV	3,953
SUN POWER 2017	2.00	“SUNPOWER 2017” sh.p.k	35 kV	3,828
SUN AVENUE	2.00	“SUN AVENUE” sh.p.k	35 kV	3,915
BIGWIND	2.00	“BIGWIND” sh.p.k.	35 kV	3,585
HYDROPOWER	2.00	“HYDROPOWER” sh.p.k.	35 kV	3,743
CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)	2.00	“CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” sh.p.k	35 kV	4,034
DIMAX	2.00	“DIMAX ALBANIA” sh.p.k	35 kV	4,022
ALB SUN ENERGY	2.00	“ALB SUN ENERGY” sh.p.k	35 kV	3,785
IDI 2005	2.00	“IDI 2005” sh.p.k	35 kV	4,777
FU-GEN	2.00	“FU-GEN” sh.p.k.	35 kV	4,023
MAGNA SOLAR POWER	2.00	“MAGNA SOLAR POWER” sh.p.k.	20 kV	3,890
PARKU FOTOVOLTAIK NOVA PROSPECT	2.00	“ Nova Prospect” sh.p.k.	10 kV	2,560
SUN SMIRACLE	2.00	“ SUN’S MIRACLE” sh.p.k.	35 kV	4,131
G. S. K.	2.00	“G.S.K” sh.p.k	35 kV	2,941
FV GOMSIQE	1.98	“Mountain’s Green Energy” sh.p.k	35 kV	2,668
HPG ENERGY	2.00	“HPG ENERGY” sh.p.k.	35 kV	1,227
PV SOLAR HORIZON	2.00	“SOLAR HORIZON” sh.p.k	35 kV	459
PV SLR ALBANIA	2.00	“SLR ALBANIA” sh.p.k	35 kV	116
PV ZENINA	2.00	“ZENINA”sh.p.k.	35 kV	112
PV SAMASOL	2.00	“SAMASOL”sh.p.k.	35 kV	110
PV REBESOL	2.00	“REBESOL”sh.p.k.	35 kV	113
PV 3 AD	2.00	“3AD Energy” sh.p.k.	35 kV	86
PV EB ENERGY	2.00	“EB ENERGY” sh.p.k.	35 kV	104
Total	83.93			134,739
PRODHIMI GJATE VITIT 2025 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHUR NË RRJETIN E SHPËRNDARJES NË TREG TË LIRË (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI
EZ-5 Solar Park	10.00	“EZ-5 ENERGY” sh.p.k,	35 kV	10,149
SGX ENERGY/3484	10.00	“SGX ENERGY” sh.p.k.,	35 kV	9,108
FV GREEN NAT SOLAR PARK BALLSH 2/3371	100.00	“GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k.,	35 kV	19,790
FV GREEN NAT SOLAR PARK BALLSH 1/3370			6 kV	13,511
FV KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT/3532	12.00	“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k.,	35 kV	1,798
Prodhim i injektuar nga Veteprodhuesit 35 kV. Treg te Parregulluar, PRO FIX/940			35 kV	265
Prodhim i injektuar nga Veteprodhuesit 20 kV. Treg te Parregulluar			20 kV	2,864
Total	132.00			77,365
PRODHIMI GJATE VITIT 2025 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHUR NË RRJETIN E TRANSMETIMIT NË TREG TË LIRË (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI
Spv Blue 1	50.00	“SPV BLUE 1” sh.p.k,	110 kV	120,830
Nova Solar	50.00	“NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k,	110 kV	113,099
Erseka Solar Park 1	20.00	“Erseka Solar Park 1” sh.p.k,	110 kV	47,264
Spv Blue 2	50.00	“SPV BLUE 2” sh.p.k	220 kV	30,906
Sunny Side Solar	100.00	“Sunny Side Energy” sh.p.k	220kV	48,919
*** Karavasta Solar	140.00	“KARAVASTA SOLAR” sh.p.k	220 kV	259,224
Total	410.00			620,242

Tabela 4. Numri i centraleve fotovoltaike, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh) deri në fund të vitit 2025




Figura 13. Numri i centraleve fotovoltaike për vitet 2020-2025




Figura 14. Kapaciteti i instaluar (MW) i centraleve fotovoltaike për vitet 2020-2025




Figura 15. Prodhimi (MWh) i centraleve fotovoltaike për vitet 2020-2025

1.2.7. Prodhimi nga centralet fotovoltaike dhe hidrike që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2025

Prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2025

është 182,031 MWh dhe paraqitet në mënyrë të detajuar në figurat më poshtë. Ashtu sikurse pasqyrohet, gjatë vitit 2025 kanë hyrë në prodhim gjithsej 21 impiante, ku 13 prej tyre centrale fotovoltaike dhe 8 centrale hidrike, me një kapacitet total të instaluar prej 262 MW. Kjo fuqi e instaluar është shtuar nga burime hidrike me 80,02 MW dhe nga burime fotovoltaike me 181,98 MW.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga këto impiante përbën rreth 2.43 % të prodhimit total vendas të energjisë elektrike për vitin 2025.

SHOQËRITË FOTOVOLTAIKE	KAPACITETI I INSTALUAR MW	LIDHJA	PRODHIMI VJETOR 2025 MWh
“G.S.K” sh.p.k	2.00	35 kV	2,941
“Mountain’s Green Energy” sh.p.k	1.98	35 kV	2,668
“HPG ENERGY” sh.p.k.	2.00	35 kV	1,227
“SOLAR HORIZON” sh.p.k	2.00	35 kV	459
“SLR ALBANIA” sh.p.k	2.00	35 kV	116
“ZENINA” sh.p.k.	2.00	35 kV	112
“SAMASOL” sh.p.k.	2.00	35 kV	110
“REBESOL” sh.p.k.	2.00	35 kV	113
“3AD Energy” sh.p.k.	2.00	35 kV	86
“EB ENERGY” sh.p.k.	2.00	35 kV	104
“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k.	12.00	35 kV	1,798
“Sunny Side Energy” sh.p.k	100.00	220 kV	48,919
“SPV BLUE 2” sh.p.k	50.00	220 kV	30,906
Total	181.98		89,560

Tabela 5. Centralet e reja fotovoltaike të cilat janë futur në operim gjatë vitit 2025, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh).

SHOQËRITË HIDRIKE	KAPACITETI I INSTALUAR MW	LIDHJA	PRODHIMI VJETOR 2025 MWh
“M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k.	15.00	110 kV	32,390
“Egantia Hydropower” sh.p.k	48.90	110 kV	42,575
“H.K HEC Grabova 2” sh.p.k.	10.80	110 kV	8,853
“Vokopola Energji” sh.p.k	2.30	35 kV	4,372
“BUSHI-LUFI” sh.p.k.	0.30	6 kV	416
“ACHELO” sh.p.k.	1.90	35 kV	2,232
“AB-01 ENERGJI” sh.p.k	0.83	10 kV	915
“MER ENERGJI” sh.p.k.	1.30	35 kV	717
Total	80.02		92,471

Tabela 6. Centralet e reja hidrike të cilat janë futur në operim gjatë vitit 2025, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh).

1.2.8. Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhura në sistemin e transmetimit për vitin 2025 është rreth 2,905 MW, me prodhim total 6,402,429 MWh.

Prodhimi i detajuar për secilin prej këtyre centraleve gjatë vitit 2025 paraqitet në tabelën në vijim.

CENTRALET HIDRIKE TË LIDHUR NË RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI	
HEC "Fierze"	500.00	"KESH" sha	220 kV	3,375,176.81	
HEC "Koman"	600.00		220 kV		
HEC "V. Dejes"	250.00		220 kV		
Tec "Vlora "	98.00		220 kV		0.00
Central Fotovoltaik i Digës së Qyrsaqit, Vau i Dejës	5.14		220 kV		0.00
Tigri 1 TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në Gjirin e Vlorës	50.00	"Kurum International" sh.a.	220 kV	77,087.64	
Tigri 3 TEC i lundrueshëm i instaluar në portin e Triportit në Gjirin e Vlorës	60.00				
HEC "Ulez"	33.20		110 kV		
HEC "Shkopet"	28.00		110 kV		
HEC "Bistrica 1"	22.50		110 kV		
HEC "Bistrica 2"	5.00		110 kV	360,555	
HEC"Peshqesh"	34.00	220 kV	89,451		
HEC"Fangu"	74.60	220 kV	212,976		
HEC "Banje"	73.00	"Devoll Hydropower" sha	110 kV		162,355
HEC "Moglice"	183.00	"Devoll Hydropower" sha	110 kV		279,878
HEC "Qami-1"	1.73	"Lajthiza Invest "sh.p.k	110 kV	2,463	
HEC "Gojan"	15.00	"M.C. ENERGJI GOJAN" sh.p.k.	110 kV	32,390	
HEC "Gostinat"	48.90	"Egantia Hydropower" sh.p.k	110 kV	42,575	
HEC "Ashta"	48.20	"ENERGJI ASHTA" sh.p.k	110 kV	208,332	
HEC "Bishnica 1,2"	2.50	"HEC Bishnica 2" sh.p.k	110 kV	3,570	
HEC "Bishnica 1, 2"	2.50	"HEC Bishnica 2" sh.p.k	110 kV	5,646	
HEC "Dardhe"	5.80	"Wenerg " sh.p.k	110 kV	15,333	
HEC "Truen"	2.50	"TRUEN" sh.p.k	110 kV		
HEC"Ternove"	8.39	"TEODORI 2003" sh.p.k	110 kV	6,854	
HEC"Gjorice"	29.61	"DITEKO" sh.p.k	110 kV	109,570	
HEC "Slabinje 2C"	3.40	"Hidropower Elektrik" sh.p.k	110 kV	12,202	
HEC "Slabinje 2D"	4.89		110kV	8,302	
HEC "Slabinje 2E"	3.80		110 kV	11,855	
HEC "Slabinje"	13.80	"Power-Elektrik-Slabinje" sh.p.k	110 kV	32,026	
HEC"Bele 1"	5.00	"Euron Energy" sh.p.k	110 kV	126,892	
HEC"Topojan 2"	5.80				
HEC"Bele 2"	11.00	"Alb-Energy" sh.p.k			
HEC"Topojan 1"	2.90				
HEC"Orgjost I Ri"	4.80	"Energal" sh.p.k			
HEC "Cerruje-1"	2.30	"Energy partners AI" sh.p.k	110 kV	16,753	
HEC "Cerruje-2"	2.80				
HEC "Rrupe"	3.60				
HEC "Rapuni 1,2"	8.10	"C & S Construction Energy" sh.p.k	110 kV		30,192
HEC "Rapuni 3,4"	8.85	"C & S Energy" sh.p.k	110 kV		27,095
HEC"Llapaj"	13.62	"Gjo-Spa POWER"sh.p.k	110 kV	40,694	
HEC"Lengarice"	8.94	"Lengarica & Energy" sh.p.k	110 kV	20,395	
HEC"Lura 1"	6.54	"Erdat Lura" sh.p.k	110 kV	35,856	
HEC"Lura 2"	4.02		110 kV		
HEC"Lura 3"	5.66		110 kV		
HEC"Malla"	5.46	"Gjurr Rec" sh.p.k	110 kV	11,530	
HEC "Prella "	14.97	"Prelle Energji"	110 kV	33,425	
HEC "Cemerica 1"	0.88	"REJ ENERGY" sh.p.k	110 kV	11,083	
HEC "Cemerica 2"	1.08		110 kV		
HEC "Cemerica 3"	2.10		110 kV		
HEC "TUÇ"	4.47	MC Inerte Lumzi	110 kV	27,569	
HEC "Lumzi"	11.00		110 kV		
HEC "Denas"	14.50	"Denas Power" sh.p.k	110 kV	29,272	
HEC Llënga "1"	1.73	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110 kV	10,366	
HEC Llënga 2	0.30		110 kV		
HEC Llënga 3	1.50		110 kV		
HEC "Shpella Poshte 2"	2.30	Liria Energji sh.p.k	110 kV	9,645	
HEC "Germani 1"	4.80	SA'GA-MAT sh.p.k	110 kV	10,837	
HEC "Germani 2"	1.50		110 kV		
HEC "Lashkiza 1"	4.08		110 kV		
HEC "Lashkiza 2"	0.88	HEC Lashkiza sh.p.k	110 kV	6,062	
HEC "Seta 1+2"	7.45	"Hydro Seta" sh.p.k	110 kV	34,294	
HEC "Seta 3"	2.72		110 kV		
HEC "Seta 4"	4.72		110 kV		
HEC "Darsi 1,2"	14.96	Henz Energy sh.p.k	110 kV	33,456	
HEC "Egnatia"	5.00	REMI sh.p.k	110 kV	10,728	
HEC "Seka & Zais/684"	14.96	SEKA Hydropower sh.p.k	110 kV	56,159	
HEC "ARSTI"	3.13	HEC Arsti sh.p.k	110 kV	12,828	
HEC "KASKADA GJADER T1/344"	25.00	S.P.E. Gjader sh.p.k	110 kV	20,115	
HEC "KASKADA GJADER T2/334"			110 kV	7,421	
HEC-et "Dragobia&Cereni/686"			110 kV	58,809	
HEC "Veleshica 1,2"	13.90	"Kalisi Hydropower"sh.p.k	110 kV	43,262	
HEC Grabova 2T1/ 153	10.80	"HLK HEC Grabova 2" sh.p.k.	110 kV	8,853	
CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHUR NË RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI	
Spv Blue 1	50.00	"SPV BLUE 1" sh.p.k.	110 kV	120,830	
Nova Solar	50.00	"NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k.	110 kV	113,099	
Erseka Solar Park 1	20.00	"Erseka Solar Park 1" sh.p.k.	110 kV	47,264	
Spv Blue 2	50.00	"SPV BLUE 2" sh.p.k	220 kV	30,906	
Sunny Side Solar	100.00	"Sunny Side Energy" sh.p.k	220kV	48,919	
Karavasta Solar	140.00	"KARAVASTA SOLAR" sh.p.k	220 kV	259,224	
KAPACITETI I INSTALUAR I GJITHË PRODHUESVE NË RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)	2,904.98	PRODHIMI TOTAL		6,402,429.64	

Tabela 7. Të dhëna mbi fuqinë e instaluar (MW) dhe prodhimin (MWh) e realizuar nga burimet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2025

(Burimi: FTL sh.a., OST sh.a.)

Përsa i përket centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit, vlen për tu cituar se ka përfunduar marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike me mbështetje, shoqëria “HEC Bishnica 2” sh.p.k., me kapacitet të instaluar 2.5 MW, së cilës i ka përfunduar kontrata 15-vjeçare me FTL sh.a. Që prej muajit korrik të vitit 2025, kjo shoqëri ka filluar të shesë energjinë e prodhuar në tregun e lirë.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna mbi fuqinë e instaluar dhe prodhimin e realizuar nga burimet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes.

HEC "Tucep"	0.40	"Tucep" sh.p.k	10kV	2,959
HEC "Treska4"	3.60		35kV	7,811
HEC "Treska3"	0.40	"HEC-Treska" sh.p.k	35kV	1,056
HEC "Treska 21"	0.62		35kV	1,962
HEC "Sotire 1 & 2"	2.20	"Hydro Energy Sotira" sh.p.k	35kV	3,930
HEC "Shutine"	2.40	"Shutine energji" sh.p.k	10kV	3,244
HEC "Cekrez 1,2"	0.66	"Zall Herr Energji 2011" sh.p.k	6kV	4,798
HEC "Qarr"	1.00	"HEC Qarr & Kaltan" sh.p.k	35kV	3,549
HEC "Bisak"	1.30	"Bardhigjani" sh.p.k	6kV	3,267
HEC "Shales"	1.08		35kV	1,481
HEC "Strelec"	1.17	"Gjoka Konstruktion -Energji" sh.p.k	35kV	4,172
HEC "Bica"	3.10	"En.Ku" sh.p.k	10kV	7,715
HEC "Leskovik 1"	1.07	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	186
HEC "Leskovik 2"	1.10		10kV	266
HEC "Tamarë"	0.75	"WTS Energji" sh.p.k	10kV	0
HEC "Begi"	1.00	"Marjaka" sh.p.k	6kV	784
HEC "Vithkuq" 2	1.55		35kV	0
HEC "Vithkuq" 1	1.17	"FAVINA I." sh.p.k	10kV	6,689
HEC "Selea"	1.98	"Selea Energji" sh.p.k	10kV	6,389
HEC "Kumbull- Merkurth"	0.83	"DN & NAT Energy" sh.p.k	6kV	1,676
HEC "Sasaj"	8.60	"Energjo - Sas" sh.p.k	35kV	1,416
HEC "Radove"	2.50	"M.T.C. Energy" sh.p.k	10kV	6,271
HEC "Gurshpat 1"	0.84	"Gurshpat Energy" sh.p.k	10kV	3,779
HEC "Gurshpat 2"	0.83		10kV	4,150
HEC "Bistrica 3"	1.57	"BISTRICA 3 ENERGY" sh.p.k	6kV	7,719
HEC "Hurdhas 1"	1.71	Hydropowerplant Construction sh.p.k	6kV	11,303
HEC "Perrollaj"	0.50	"Fatum" sh.p.k	10kV	749
HEC "Koxheraj"	0.62	"Koxherri Energji" sh.p.k	10kV	1,602
HEC "Kacni"	3.87	"Kisi-Bio-Energji" sh.p.k	20kV	6,321
HEC "Lena 1"	1.95		35kV	
HEC "Lena 2"	2.30	"Gama Energy" sh.p.k	35kV	7,205
HEC "Lena 2A"	0.25		35kV	
HEC "Driza"	3.41	"Mesopotam Energy" sh.p.k	35kV	2,320
HEC Strelea 1,2,3	5.35	"Strelea Energy" sh.p.k	35kV	11,510
HEC "Ujanik 2"	2.50	"HP Ujaniku Energy" sh.p.k	35kV	4,167
HEC "Nishove"	1.36	"Nishova Energy" sh.p.k	35kV	292
HEC "Shitka"	1.30	"Perparimi SK" sh.p.k	10kV	1,263
HEC "Ballenje"	1.90	"Ballenja Power Martanesh" sh.p.k	35kV	2,932
HEC "Gavran 1"	1.00	"Gavran Energy" sh.p.k	35kV	2,073
HEC "Gavran 2"	1.22	"Gavran Energy" sh.p.k	35kV	2,091
HEC "Kasollet e Selces 1"	4.00	"Xhengo Energji" sh.p.k	35kV	7,980
HEC "Holta Kabash"	2.20		35kV	
HEC "Holta Porocan"	3.30	HEC Kabash Porocan sh.p.k	35kV	12,021
HEC "Lusen 1"	0.32	"Eurobiznes" sh.p.k	35kV	617
HEC "Ura e Fanit"	1.00	"Aven As Energji" sha	35kV	6,162
HEC "Gorice"	1.75	"THE BLUE STAR" sh.p.k	35kV	4,220
HEC "Kabash 1&2"	5.80	"Energji Unvers" sh.p.k	35kV	4,981
HEC "Tucep 2"	1.70	"DUKA T2" sh.p.k	35kV	3,510
HEC "Dobrenje Tomorrice"	2.40	DAAB Energy Group sh.p.k	35kV	2,186
HEC "Razdoli"	0.77	Hydro Vizion sh.p.k	35kV	1,827
HEC "Dragostunje"	3.10	"HEC-i Dragostunje" sh.p.k	35kV	17,373
HEC "Stebleve"	3.40	"PURE ENERGY STEBLEVA" sh.p.k	35kV	1,496
HEC "Zerrec 1"	0.55		35kV	
HEC "Zerrec 2"	1.32	"EnRel Hydro" sh.p.k	35kV	4,127
HEC "Shëngjon 1"	0.65		35kV	
HEC "Shëngjon 2"	0.36	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	2,370
HEC "Blac"	1.30	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	1,343
HEC "Qarrishit"	0.30	"IDI-2005" sh.p.k	35kV	856
HEC "Vendresh"	0.46	"HP VENDRESH ENERGY" sh.p.k	35kV	398
HEC "Antena"	1.11	"DERBI-E" sh.p.k	35kV	2,252
HEC "Kamenicë"	0.97	HP Kamenica sh.p.k	10kV	2,475
HEC "Qytezë"	0.25	Muso Hc Qytezë	10kV	1,846
HEC "Marjan Gura e Vesheve"	0.63	Marituda sh.p.k	10kV	1,149
HEC "Skatinë"	2.68	Skatine- HEC sh.p.k	10kV	4,414
HEC "Kaparje"	0.20	ABV Konstruktion sh.p.k	10kV	0
HEC "Letaj"	0.54	Asi-Tre sh.p.k	10kV	925
HEC "Nica"	2.27	MP-HEC sh.p.k	35kV	1,154
HEC "Meshurdhe"	1.30	SIMA-Com sh.p.k	10kV	5,928
HEC "Thane 2"	2.00	AFRIMI K sh.p.k	35kV	6,627
HEC "OSOJE"	1.90	OSOJA HPP sh.p.k	35kV	7,129
HEC "Voskopojë"	1.90	FAVINA I sh.p.k	35kV	6,041
HEC "Nderfishas "	1.13	"SGD Energy" sh.p.k	35kV	1,665
HEC "Rreshen"	0.38	Nikolli Energy sh.p.k	10kV	1,264
HEC "Gurra"	0.50	Uleza Nderitim sh.p.k	6kV	963
HEC "Vile"	1.99	Hydro Power Pamariti sh.p.k	35kV	4,708
HEC "Dukona"	0.80	Dukona sh.p.k	20kV	453
HEC "Prevali"	1.75	Gega-G sh.p.k	35kV	7,012
HEC "Camerice"	0.80	Rei Energy sh.p.k	35kV	4,840
HEC "Stor"	2.00	Era Hydro sh.p.k	35kV	7,709
HEC "Mivas"	1.94	Elva 2001 sh.p.k	35kV	3,837
HEC "Spathare"	1.04	Lucente koncesionare sh.p.k	10kV	3,055
HEC "Miraka"	0.60	Kuerci Blace sh.p.k	10kV	1,028
HEC "Shengjun"	2.00	Irarba Energji sh.p.k	10kV	2,092
HEC "Dobrunje"	0.84	W.T.S. Energji sh.p.k	10kV	3,048
HEC "Muras"	2.00	Mateo& Co sh.p.k	10kV	7,172
HEC "Trojet"	0.90	Trojet Energji sh.p.k	10kV	3,184
HEC "Denti"	0.85	ASI TRE sh.p.k	35kV	1,457
HEC "Kamican"	1.86	IDI 2005 sh.p.k	35kV	5,902
HEC "Vardar"	1.97	Gerti sh.p.k	35kV	11,430
HEC "Stavec"	6.52	Koka Ergi Stavec sh.p.k	35kV	26,410
HEC "Kalis"	2.14	ERDY Energy sh.p.k	35kV	8,159
HEC "Gjinar"	0.83	Erdi Gas sh.p.k	10kV	1,150
HEC "Bacha 1"	3.36	Krol Mbret sh.p.k	35kV	11,126
HEC "Plepi"	2.28	Domit Tee sh.p.k	35kV	2,429
HEC "Zall Xhuxhe 1 & 2"	4.70	HEC Zall Xhuxhe sh.p.k	35kV	5,821
HEC "Pishat"	1.91	GRENTech ENERGY SYSTEMS sh.p.k	35kV	3,617
HEC "Lingjanea 1&2"	4.90	"Rei-Energji" sh.p.k	35kV	3,906
HEC "Guri i Zi"	1.72	"Aris Albania" sh.p.k	35kV	2,754
HEC "Drita"	1.98	"Brecani R.O.S.P." sh.p.k	20kV	7,644
HEC "EME"	0.45	"HEC EME" sh.p.k	6kV	1,116
HEC "Terfoje"	1.98	"HEC TERFOJA" sh.p.k	10kV	10,401
HEC "Borie Lura 1"	1.80	"AGETA" sh.p.k	20kV	1,252
HEC "Mali"	1.49	"TIRANA ENERGI" sh.p.k	20kV	7,142
HEC "Shelli"	1.52	"ARIS ALBANIA" sh.p.k	35kV	3,995
HEC "Daznjane"	1.52		35kV	2,131
HEC "Vokopola 1"	0.30	"Vokopola Energji" sh.p.k	6kV	0
HEC "Shutrej 1&2"	1.97	"ATEANI ENERGY" sh.p.k	6kV	3,460
HEC KRONZ	0.43	"LASTER ENERGY" sh.p.k.	10kV	1,239
HEC "Bushit"	0.25	"BUSHI-LUFTI" sh.p.k.	10kV	236
HEC "Tuc"	4.47	"M.C INERTE LUMZI" sh.p.k.	35 kV	3,932
HEC "Mireshti"	1.90	"GERTI" sh.p.k.	10 kV	3,188
HEC "Zall-Xhuxhe 2"	1.25	"HEC ZALL XHUXHE" sh.p.k.	35 kV	3,220
HEC "Thirre"	1.82	"SANG I" sh.p.k	20 kV	4,306
HEC "Pakem"	1.75	"DRINI BULQIZI" sh.p.k.	35 kV	5,477
HEC "Kekelye"	0.15	"Kekelye 2020" sh.p.k.	10 kV	704
HEC "Valbonë"	2.10	"IPLANI HC" sh.p.k	10 kV	8,865
HEC "Vokopola 3 "	2.30	"Vokopola Energji" sh.p.k	35 kV	4,372
HEC "Bushit 1"	0.30	"BUSHI-LUFTI" sh.p.k.	6 kV	416
HEC "Kotorri"	1.90	"ACHELO" sh.p.k.	35 kV	2,232
HEC "Gastru"	0.83	"AB-01 ENERGI" sh.p.k	10 kV	915
HEC "Faqekuq 3"	1.30	"MER ENERGI" sh.p.k.	35 kV	717

CENTRALET HIDRIKE TË LIDHUR TË LIDHUR NË RRJETIN E SHPËRNDARJES NË TREG TË LIRË (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI
HEC "ORENIE"	0.88	"Junma" sh.p.k	10kV	1,217
HEC "Tervol"	10.60	"HEC i Tervoli" sh.p.k	35kV	26,537
HEC "Xhyre, Librazhd"	0.57	"Amal" sh.p.k	10kV	1,522
HEC "Cernalev Kukes"	2.95		35kV	8,472
HEC "Cernalev Kukes"	3.27	"HIDROALBANIA Energi" sh.p.k	35kV	9,095
HEC "Borje- Oreshke"	1.50		35kV	15,757
HEC "Shpelle "	0.40	"Sarolli" sh.p.k	10kV	1,043
HEC "Gjanc"	3.70	"Spahiu Gjanc" sh.p.k.	35 kV	1,393
HEC "Vithkuq" 2	1.55	"FAVINA.1." sh.p.k	35 kV	3,217
HEC "Lenic"	0.40	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10kV	417
HEC "Dishnice"	0.20	"Dishnica Energi" sh.p.k	10kV	159
HEC "Corovode"	0.20	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10kV	127
HEC "Selca"	1.98	"Selca Energi" sh.p.k	10kV	2,776
HEC "Benë"	1.00	"Marjaka" sh.p.k	6kV	416
HEC "Bogove"	2.50	"Wonder power" sha	35 kV	1,642
HEC "Leskovik 1"	1.07	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	36
HEC "Leskovik 2"	1.10		10kV	0
HEC "Lubonje"	0.30	"Elektro Lubonja" sh.p.k	10kV	20
CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHUR NË RRJETIN E SHPËRNDARJES (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI
Seman - 2	2.00	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	4,035.87
Topojë	2.00	"SONNE" sh.p.k	35 kV	3,949.26
Topojë 2	2.00	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	3,961.89
Topojë (Sheq Marinas)	2.00	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	3,984.47
Topojë (Sheq Marinas) 2	2.00	"Seman Sunpower" sh.p.k	35 kV	4,209.60
SemanSolar	2.00	"SEMANISOLAR" sh.p.k	35 kV	3,894.50
ES 2019	2.00	"ES 2019" sh.p.k	35 kV	4,349.99
SMART WATT	2.00	"Smart Watt" sh.p.k.	35 kV	4,327.49
Tren Bilisht	2.00	"R T S" sh.p.k.	35 kV	3,792.28
STATKRAFT Renewables Albania PV Lendres banje	2.00	"STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA" sha.	35 kV	2,030.27
Korca Photovoltaic Park	2.00	"KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK" sh.p.k.	35 kV	3,803.48
NTSP	2.00	"NTSP" sh.p.k	35 kV	3,813.95
Sun Beat System	2.00	"SUN BEAT SYSTEM" sh.p.k	35 kV	3,797.18
Tren Sun System	2.00	"TREN SUN SYSTEM" sh.p.k.	35 kV	3,856.24
ERENI SOLAR	2.00	"ERENI SOLAR" sh.p.k.	35 kV	4,890.22
GREEN ENERGY BILISHTI	2.00	"GREEN ENERGY BILISHTI" sh.p.k	35 kV	4,790.92
ALBSOLAR	2.00	"ALBSOLAR" sh.p.k	35 kV	4,457.17
Pv -Plug	2.00	"AEE" sh.p.k.	10 kV	4,158.79
SUN ENERGY SOLUTIONS	1.95	"Sun Energy Solutions" sh.p.k.	35 kV	4,452.93
2 T & 2 B 1979	2.00	"Joint Venture 2B 1979 dhe 2T" sh.p.k	10 kV	3,952.89
SUN POWER 2017	2.00	"SUNPOWER 2017" sh.p.k	35 kV	3,828.40
SUN AVENUE	2.00	"SUN AVENUE" sh.p.k	35 kV	3,914.83
BIGWIND	2.00	"BIGWIND" sh.p.k.	35 kV	3,584.62
HYDROPOWER	2.00	"HYDROPOWER" sh.p.k.	35 kV	3,743.38
CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)	2.00	"CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)" sh.p.k	35 kV	4,033.79
DIMAX	2.00	"DIMAX ALBANIA" sh.p.k	35 kV	4,022.44
ALB SUN ENERGY	2.00	"ALB SUN ENERGY" sh.p.k	35 kV	3,784.51
IDI 2005	2.00	"IDI 2005" sh.p.k	35 kV	4,777.21
FU-GEN	2.00	"FU-GEN" sh.p.k.	35 kV	4,022.71
MAGNA SOLAR POWER	2.00	"MAGNA SOLAR POWER" sh.p.k.	20 kV	3,889.80
PARKU FOTOVOLTAIK NOVA PROSPECT	2.00	"Nova Prospect" sh.p.k.	10 kV	2,560.36
SUN SMIRACLE	2.00	"SUN'S MIRACLE" sh.p.k.	35 kV	4,131.48
G. S. K.	2.00	"G.S.K" sh.p.k	35 kV	2,941.34
FV GOMSIQE	1.98	"Mountain's Green Energy" sh.p.k	35 kV	2,667.85
HPG ENERGY	2.00	"HPG ENERGY" sh.p.k.	35 kV	1,227.04
PV SLR HORIZON	2.00	"SOLAR HORIZON" sh.p.k	35 kV	459.05
PV SLR ALBANIA	2.00	"SLR ALBANIA" sh.p.k	35 kV	115.85
PV ZENINA	2.00	"ZENINA" sh.p.k.	35 kV	111.77
PV SAMASOL	2.00	"SAMASOL" sh.p.k.	35 kV	110.22
PV REBESOL	2.00	"REBESOL" sh.p.k.	35 kV	113.05
PV 3 AD	2.00	"3AD Energy" sh.p.k.	35 kV	86.02
PV EB ENERGY	2.00	"EB ENERGY" sh.p.k.	35 kV	104.02
EZ-5 Solar Park	10.00	"EZ-5 ENERGY" sh.p.k.	35 kV	10,148.88
SGX ENERGY/3484	10.00	"SGX ENERGY" sh.p.k.,	35 kV	9,108.18
FV GREEN NAT SOLAR PARK BALLSH 2/3371	100.00	"GreeN Nat Solar Park Ballsh" sh.p.k.,	35 kV	19,789.88
FV GREEN NAT SOLAR PARK BALLSH 1/3370			6 kV	13,510.88
FV KUKËS INTERNATIONAL AIRPORT/3532	12.00	"GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" sh.p.k.	35 kV	1,798.42
Prodhimi i injektuar nga Veteproduhuesit 35 kV. Treg te Parregulluar, PRO FIX/940			35 kV	264.64
Prodhimi i injektuar nga Veteproduhuesit 20 kV. Treg te Parregulluar			20 kV	2,863.94
KAPACITETI I INSTALUAR I GJITHË PRODHUESVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES (MWh)	570.22	PRODIMI TOTAL		1,065,159.00

Tabela 8. Të dhëna mbi fuqinë e instaluar (MW) dhe prodhimin (MWh) e realizuar nga burimet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes

Gjatë vitit 2025, infrastruktura energjetike e lidhur në rrjetin e shpërndarjes ka konsoliduar një kapacitet të instaluar prej 570 MW, të gjeneruar nga burime hidrike dhe fotovoltaike, me një prodhim total prej 1,065,159 MWh. Në nivel kombëtar, kapaciteti i përgjithshëm i instaluar (i integruar në rrjetet OST dhe OSSH) llogaritet në 3,475 MW.

Sa i përket liberalizimit të tregut, procesi ka vijuar me daljen në treg të lirë të 18 HEC-eve të lidhura në shpërndarje, me kapacitet 34.17 MW, të cilat më parë operonin me kontrata shit-blerjeje me shoqërinë FTL sh.a.

Në total, numri i centraleve hidrike që kanë kaluar në tregun e lirë gjatë këtij viti (përfshirë rrjetin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit) arriti në 19 impiante, me një fuqi të instaluar prej 36.67 MW. Prodhimi i tyre prej 77,415 MWh përbën përafërsisht 1% të bilancit total të energjisë elektrike të prodhuar në vend për vitin 2025.

Në tabelën më poshtë jepen të dhënat për secilin prej HEC-eve, pikëlidhjet respektive dhe sasia totale e energjisë së prodhuar prej tyre në treg të lirë.

HECET TË LIDHUR NË RRJETIN E SHPËRNDARJES TË CILËT KANË DALË NË TREG TË LIRË GJATË VITIT 2025 (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI PRODHIM
HEC "ORENJE"	0.88	"Juana" sh.p.k	10 kV	1,217
HEC "Tervol"	10.60	"HEC i Tervoli "sh.p.k	35 kV	26,537
HEC "Xhyre, Librazhd"	0.57	"Amal" sh.p.k	10 kV	1,522
HEC "Cernalev Kukes"	2.95	"HIDROALBANIA Energji" sh.p.k	35 kV	8,472
HEC "Cernalev1Kukes"	3.27		35 kV	9,095
HEC "Borje- Oreshke"	1.50		35 kV	15,757
HEC "Shpelle "	0.40	"Sarolli" sh.p.k	10 kV	1,043
HEC "Gjanç"	3.70	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	35 kV	1,393
HEC "Vithkuq" 2	1.55	"FAVINA.1." sh.p.k	35 kV	3,217
HEC "Lenie"	0.40	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10 kV	417
HEC "Dishnice"	0.20	"Dishnica Energji" sh.p.k	10 kV	159
HEC "Çorovode"	0.20	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10 kV	127
HEC "Selca"	1.98	"Selca Energji" sh.p.k	10 kV	2,776
HEC "Benë"	1.00	"Marjakaj" sh.p.k	6 kV	416
HEC "Bogove"	2.50	"Wonder power" sha	35 kV	1,642
HEC "Leskovik 1"	1.07	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10 kV	36
HEC "Leskovik 2"	1.10		10 kV	0
HEC "Lubonje"	0.30	"Elektro Lubonja" sh.p.k	10 kV	20
Total	34.17			73,845

HECET TË LIDHUR NË RRJETIN E TRANSMETIMIT TË CILËT KANË DALË NË TREG TË LIRË GJATË VITIT 2025 (MWh)	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	12- MUJORI PRODHIM
HEC "Bishnica 1,2"	2.50	"HEC Bishnica 2 "sh.p.k	110 kV	3,570
Total	2.50			3,570

Tabela 9.Centralet hidrike në OSSH sh.a. dhe OST sh.a., të cilat kanë dalë në treg të lirë gjatë vitit 2025, pikëlidhjet e tyre (kV), fuqia e instaluar (MW) dhe prodhimi (MWh)

1.3. Transmetimi i energjisë

Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri operon si një infrastrukturë kritike që siguron lëvizjen e energjisë përmes një rrjeti të integruar të tensionit të lartë dhe shumë të lartë, i cili përfshin nivelet nominale 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV. Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, ky sistem operon në paralel me rrjetet e vendeve fqinje, duke garantuar kështu stabilitetin e shkëmbimeve ndërkufitare dhe sigurinë e furnizimit në nivel rajonal. Teknikisht, sistemi përfshin një tërësi linjash, strukturash mbështetëse, si dhe pajisje transformuese e kyçëse/shkyçëse, të cilat shërbejnë si nyje lidhëse për lëvrimin e energjisë elektrike drejt rrjetit të shpërndarjes apo klientëve.

1.3.1. Bilanci energjetik

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin energjetik të OST sh.a. për vitin 2025, si dhe për periudhën 2016–2024, për qëllime krahasuese. Sikurse evidentohet, energjia totale në sistemin e transmetimit për vitin 2025 rezulton 10,288 GWh, me një rritje prej 529 GWh krahasuar me vitin 2024.

	Bilanci Energjetik i OST sh.a.	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
I	Energjia Totale në Sistemin e Transmetimit (GWh)	8,462	7,577	9,848	7,943	8,130	10,685	9,547	10,148	9,961	10,288
I.1	- Prodhimi vendas	6,636	4,174	8,076	4,767	4,892	8,432	6,504	8,226	7,836	7,467
I.2	- Energji në marrje (import në interkoneksion)	1,827	3,403	1,772	3,177	3,238	2,253	3,044	1,922	2,668	3,375
II	Energjia Totale e Transmetuar (GWh)	8,272	7,419	9,606	7,775	7,958	10,685	9,547	9,927	9,759	10,095
II.1	- Energji në dhënie (eksport në interkoneksion)	1,869	488	2,685	770	963	2,800	2,123	2,842	2,334	2,497
II.2	- Energji e transmetuar për OSSH sh.a.	5,901	6,148	5,963	6,137	6,184	6,606	6,546	6,492	6,881	7,186
II.3	- Energji e transmetuar për klientët e lidhur në rrjetin e transmetimit	503	781	957	867	811	1,049	679	594	543	411
III	Humbjet në Sistemin e Transmetimit + Nevojat Vetjake (GWh)	190	158	242	169	172	228	200	220	201	193
III.1	Humbjet në Sistemin e Transmetimit+Nevojat Vetjake (%)	2.25	2.08	2.46	2.12	2.12	2.13	2.09	2.17	2.02	1.9

Tabela 10. Bilanci energjetik i OST sh.a. për vitin 2025 krahasuar me atë të viteve 2016–2025 (MWh)

Niveli i humbjeve në sistemin e transmetimit për vitin 2025 është 193 GWh, ose 1.9 % e energjisë elektrike të transmetuar, krahasuar me nivelin 2.02 % të vitit 2024. Ky nivel humbjesh rezulton më i ulët krahasuar me vitin 2024, me një diferencë prej 0.12% më pak. Gjithashtu, energjia totale e transmetuar për vitin 2025 përllogaritet 10,095 GWh, ose 3.32% më shumë energji elektrike e transmetuar se viti 2024.




Figura 16. Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar për vitin 2025

Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar jepet në mënyrë të detajuar në figurën më sipër. Sasia totale e energjisë elektrike e hyrë në sistemin e transmetimit për vitin 2025 është rreth 10,288 GWh, nga e cila rreth 7,740 GWh kanë hyrë në sistemin e shpërndarjes.

Energjia elektrike në sistemin e shpërndarjes injektohet nga sistemi i transmetimit dhe nga impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Sistemi i transmetimit ka injektuar, për vitin 2025, në rrjetin e shpërndarjes sasinë prej 7,186 GWh, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura drejtpërdrejtë në rrjetin e shpërndarjes kanë injektuar në këtë rrjet sasinë neto të energjisë elektrike prej rreth 554 GWh.

1.3.2. Veprimtaria e OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. është personi juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike. Ai ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 54 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Në Shqipëri, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është një shoqëri publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë rrjetin e transmetimit, përfshirë edhe interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, me qëllim sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për përmbushjen e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

OST sh.a. ushtron veprimtarinë e tij të ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacion.

OST sh.a. përgjatë këtij viti ka garantuar kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- Furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe të klientëve të lidhur drejtpërdrejtë në rrjetin e transmetimit.
- Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit.
- Tranzitimin dhe shkëmbimin e nevojshëm me vendet e rajonit.

OST sh.a. dispeçeron sistemin elektroenergjetik shqiptar nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit, si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera fqinje.

1.3.2.1. Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 150 kV dhe 110 kV, si dhe nënstacionet lidhëse midis tyre, që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe për interkonjeksion.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit për vitin 2025, janë:

- | | |
|--------------------------------|------------|
| • Linjat e transmetimit 400 kV | 445.7 km |
| • Linjat e transmetimit 220 kV | 1,363.1 km |
| • Linjat e transmetimit 150 kV | 34.4 km |
| • Linjat e transmetimit 110 kV | 1,701 km |

Në krahasim me vitin 2024 është rritur gjatësia e linjave të transmetimit 220 kV me 66 km.

Në përbërje të linjave të mësipërme bëjnë pjesë edhe linjat e interkonjeksionit me vendet fqinje, si:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Koman (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë)

- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierzë (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplik (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)

Gjatësitë e linjave (km) sipas tensionit - Viti 2025




Figura 17. Gjatësia e linjave të transmetimit (km) për vitin 2025

- Linjë e interkonjeksionit 150 kV Bistricë (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).

Kapaciteti teknik i shkëmbimit me vendet fqinje ka rezultuar i mjaftueshëm për realizimin e shkëmbimeve të nevojshme dhe të tranzitimeve të kërkuara në çdo kohë. Megjithatë, në periudha të caktuara ka kongestion të kapaciteteve transmetuese në interkonjeksion, të cilat janë menaxhuar sipas rregullave të përbashkëta të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të miratuar nga Rregullatorët e Rajonit.




Figura 18. Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë




Figura 19. Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar (centralet, nënstacionet, linjat 400, 220, 150 dhe 110 kV)




Figura 20. Skema njvëljëshe e sistemit elektroenergetik shqiptar në nivelet 400, 220, 150 dhe 110 kV

Më poshtë janë listuar nënstacionet kryesore të sistemit të transmetimit. Aktualisht, rezultojnë 17 nënstacione me një fuqi totale të instaluar 4721 MVA. Në krahasim me vitin 2024, përgjatë vitit 2025 është shtuar nënstacioni 220/20 kV i Hoxharës, me fuqi të instaluar 100 MVA në njësinë operative Fier.

Vënia në funksionim e nënstacionit të Hoxharës ndikon pozitivisht në mënyrë të drejtpërdrejtë për të përthithur energjinë elektrike të gjeneruar nga impiantet prodhuese fotovoltaike të energjisë elektrike, të cilat janë të konsiderueshme në këtë zonë.

Nr.	Nënstacioni	Fuqia e Instaluar (MVA)	Njësia Operative
1	400 kV	N/st 400/220kV Koman	Shkodër
2		N/st 400/220kV/110kV Tirana 2	Tiranë
3		N/st 400/220kV Elbasan 2	Elbasan
4		N/st 400/110kV Zemblak	Korçë
5	220 kV	N/st 220/110kV V.Dejës	Shkodër
6		N/st 220/110kV Fierzë	Shkodër
7		N/st 220/110kV Koplik	Shkodër
8		N/st 220/110kV Burrel	Shkodër
9		N/st 220/110kV/20kV Tirana 1	Tiranë
10		N/st 220/110kV Sharrë	Tiranë
11		N/st 220/110kV Rrashbull	Tiranë
12		N/st 220/110kV Elbasan 1	Elbasan
13		N/st 220/110kV Fier	Fier
14		N/st 220/110kV Babicë	Fier
15		N/st 220/110kV Shumat	Burrel
16	150 kV	N/st 110/150kV Bistrica 1	Fier
17	220 kV	N/st 220/20kV Hoxhare	Fier
Total		4721	

Tabela 11. Kapaciteti i instaluar sipas nënstacioneve (MVA)

1.3.3. Gjendja e përgjithshme e sistemit elektroenergjetik, referuar raportimit të OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është një shoqëri publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit. Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë edhe interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, me qëllim sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për përmbushjen e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

OST siguron shërbim për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit, bazuar në standardet përkatëse, si dhe në praktikën e aplikuar nga ENTSO-E.

Siguria operative e rrjetit

Sistemi i transmetimit operohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe sigurohet të përmbushë të gjitha udhëzimet dhe politikat e ENTSO-E, veçanërisht parashikimet e marrëveshjes për operimin e zonës sinkrone të ENTSO-E, si dhe udhëzuesin mbi Sigurinë dhe Operimin e Sistemit të Transmetimit (SO GL).

Gjatë vitit 2025, OST sh.a. raporton se ka siguruar operimin e rrjetit në mbështetje planifikimin dhe menaxhimin e operimit të sistemit elektroenergjetik, me qëllim sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit. Në këtë kuadër, përfshihet planifikimi i mbulimit të kërkesës për energji elektrike me bazë ditore dhe orare, skedulimi i prodhimit për çdo central dhe kontrolli i nivelit të sigurisë së operimit të sistemit, duke përdorur kriterin e sigurisë “n-1”. Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit lidhet edhe me menaxhimin e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, si dhe me menaxhimin në kohë reale të gjenerimit dhe kërkesës për energji elektrike, në mënyrë që të ruhet balanca ndërmjet prodhimit, shkëmbimeve dhe konsumit të energjisë.

Në kuadër të operimit të sistemit realizohet gjithashtu shkëmbimi dhe harmonizimi i skedulimit të shkëmbimeve të energjisë me operatorët e sistemeve të transmetimit fqinjë për ditën pasardhëse, si dhe llogaritja e shkëmbimeve të realizuara të energjisë për çdo interkonjektor për ditën paraardhëse. Paralelisht me këto procese kryhet analiza e vazhdueshme e funksionimit të sistemit energjetik dhe koordinimi me përdoruesit e rrjetit dhe OST-të e rajonit për ndërmarrjen e masave të nevojshme në funksion të ruajtjes së sigurisë së operimit. Aktiviteti përfshin gjithashtu parashikimin e punës së sistemit energjetik në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, si dhe përcaktimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare për çdo kufi dhe drejtim të fluksit të energjisë, me bazë vjetore, mujore dhe ditore, në bashkëpunim me OST-të fqinje.

Gjatë operimit të sistemit, monitorohen dhe analizohen nga OST parametrat kryesorë të funksionimit të tij, përfshirë nivelet e tensionit dhe flukset e fuqisë në raport me limitet e sigurisë operacionale të përcaktuara në Kodin e Transmetimit dhe në rregulloren e miratuar me vendimin e ERE nr. 207, datë 18.12.2017, për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike. Gjithashtu monitorohet frekuenca e sistemit në përputhje me diapazonin e përcaktuar prej ± 200 mHz sipas të njëjtave kërkesa rregullatore, si dhe disponueshmëria e rezervave të fuqisë aktive dhe reaktive për përballimin e ngjarjeve të paplanifikuara dhe ruajtjen e kufijve të sigurisë operacionale gjatë operimit të sistemit.

Nivelet e tensionit

Në dispozitat e Kodit të Transmetimit dhe të Rregullores së miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 207, datë 18.12.2017, për “Cilësinë e Furnizimit dhe Performancën e Sigurisë së Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike” përcaktohet se OST sh.a. duhet të respektojë diapazonet e tensioneve, për nivelin 400 kV diapazoni i lejuar është nga 0.9 pu deri më 1.05 pu dhe për nivelin e tensionit 220/150/110 kV diapazoni i lejuar është 0,90 pu deri në 1,118 pu.

Niveli i tensionit në rrjetin e transmetimit varet nga zhvillimi i rrjetit, topologjia e tij, si dhe nga shpërndarja e gjenerimeve dhe e konsumit në këtë rrjet. Problematike për OST sh.a. mbetet profili i lartë i tensionit në rrjetin 400 kV, i cili është më i lartë se kufiri i sipërm i vlerave të lejuara në Kodin e Transmetimit. Ky shqetësim nuk afekton vetëm OST sh.a., por përfshin Operatorët e Transmetimit të Evropës Juglindore në Bosnje, Mal i Zi, Serbi, Maqedoni dhe Kosovë. Gjithsesi, rezultatet tregojnë se investimet me shunt-reaktorë në rrjetin tonë kanë sjellë përmirësime të konsiderueshme, duke mundësuar që niveli i tensionit në rrjetin 400 kV t'i përafrohet vlerave të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, vijon të mbetet e nevojshme që të ketë përmirësime të mëtejshme. Profili i tensionit në rrjetin 220 kV dhe 110 kV për vitin 2025 ka qenë brenda diapazoneve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit.

Kontrolli i frekuencës

Kontrolli i frekuencës për Sistemin e Transmetimit menaxhohet tashmë në mënyrë të automatizuar nga FCR dhe aFRR. Nëse është e nevojshme, ndonjëherë rezervat shtesë aktivizohen manualisht (mFRR ose RR). Veprimet parandaluese, FCR dhe aFRR, janë vazhdimisht aktive për të kundërvepruar në rast të imbalancave të sistemit. Veprimet kurative mFRR dhe RR aktivizohen në mënyrë manuale nga Operatorët e QKD. Në zbatim të kërkesave dhe përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, OST sh.a. i merr shërbimet balancuese nga Përdoruesit e kualifikuar si OSHB.

Nëpërmjet modulit LFC (Load Frequency Control), pjesë e paketës AGC, aplikacion i cili mbledh, analizon dhe i përgatit të dhëna hyrëse, llogarit gabimin e kontrollit të zonës (devijimin nga vlerat e planifikuara - ACE) dhe nga ajo llogarit ndryshimin total të kërkuar të energjisë së OST-së në Shqipëri. Devijimi nga vlerat e planifikuara i dërgohet si kërkesë për kontribut të gjitha njësive të OSHB-ve që kanë fituar ankandin për të ofruar shërbimin në atë moment dhe janë integruar në kontrollin e LFC.

Gjatë vitit 2025, vlerat e frekuencës në zonën e monitorimit të OST sh.a. janë mbajtur brenda diapazoneve të parashikuara në Kodin e Transmetimit dhe rregulloret e tjera në fuqi.

Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive

Gjatë procesit të vlerësimit të mjaftueshmërisë në zonën e përgjegjësisë, OST vlerëson mundësinë e plotësimit të kërkesës totale të vendit, duke konsideruar gjenerimin e disponueshëm nga të gjithë gjeneruesit, në kombinim me aftësinë e linjave të interkonjeksionit, sipas skenarëve të ndryshëm operacionalë, duke marrë parasysh nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive dhe reaktive.

Vlerësimi i rezervave kryhet në përputhje me metodën deterministike dhe duke observuar vlerat historike. Në zbatim të përcaktimeve të Kodit të Transmetimit, Manualit të Operimit të ENTSO-E (SO-GL), si dhe Vendimit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020, “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, OST prokuron rezervën balancuese të nevojshme për ruajtjen e balancës së zonës së kontrollit në mënyrë të vazhdueshme.

1.3.4. Operimi i zonës së përgjegjësisë së OST-së

Planifikimi

Në funksion të kryerjes së operimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të energjisë elektrike, OST, si çdo vit, edhe për vitin 2025, ka realizuar planifikimin operativ, duke u bazuar në përcaktimet e Kodit të Transmetimit. Objektivi kryesor i planifikimit të sistemit të transmetimit është të sigurojë zhvillimin e duhur të këtij sistemi në terma afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Bashkëpunimi me OSSH-në, SGU-të dhe bashkëpunimi ndërmjet OST-ve të rajonit është shumë i rëndësishëm për të siguruar vazhdimësinë e sigurisë operationale.

Në kuadër të planifikimit operacional, OST realizon analiza të koordinuara operative të sigurisë sipas afateve të mëposhtme:

- a. një vit përpara;
- b. javën përpara;
- c. ditën përpara; dhe
- d. brenda ditës.

Planifikimi, një vit më parë (afatmesëm)

Planifikimi afatmesëm mbulon aktivitetet që fillojnë nga viti në vazhdim. Në këtë hark kohor, OST fokusohet në planifikimin e ndërprerjeve, të cilat duhet të koordinohen nëse ndikojnë në funksionimin e sistemeve fqinje. Kjo përfshin asetet e veta, si dhe njësitë gjeneruese ose objektet e tjera të rëndësishme.

Rëndësia e aseteve që kërkojnë koordinim përcaktohet në bazë të një metodologjie, e cila përfshin aspekte cilësore dhe sasiore, si afërsia me kufijtë e një zone kontrolli ose ndikimi në vlerat elektrike, sipas rezultateve nga simulimet e fluksit të energjisë.

Planifikimi për javën/ditën përpara (afatshkurtër)

Planifikimi afatshkurtër përfshin disa nënprocese. Procesi i një jave në avancë merret me planifikimin e ndërprerjeve me njoftim të shkurtër (kërkesa për javën në vazhdim) dhe aktivizimin e centraleve shtesë, të cilat janë të nevojshme për të ruajtur sigurinë e sistemit.

Alokimi i kapaciteteve fillon dy ditë përpara dhe përcakton kapacitetet maksimale të transferimit ndërmjet zonave të ndryshme të ofertës. Vlerësimi përsëritet një ditë para dhe brenda ditës.

Procesi i ditës në vazhdim përqendrohet në planifikimin e veprimeve përmirësuese për të parandaluar të gjitha kongestionet që mund të ndodhin ditën e nesërme. Në mënyrë tipike,

veprimet korrigjuese planifikohen për zonën e mbulimit të OST sh.a. dhe më pas koordinohen me të gjithë fqinjët përkatës.

Rezultatet nga planifikimi i ditës në vijim përditësohen brenda ditës, bazuar në parashikimet e reja. Analizat në planifikimin e ditës në vijim bazohen në modele të gjendjes së qëndrueshme.

Planifikimi brenda ditës (operimi në kohë reale)

Në operimin në kohë reale, operatori i OST monitoron dhe vlerëson sigurinë e sistemit të transmetimit nëpërmjet analizave të gjendjes së qëndrueshme. Verifikohen veprimet parandaluese dhe korrigjuese të përcaktuara nga planifikimi operacional. Nëse identifikohen kongestionet e mundshme ose shkelje të niveleve të tensionit, operatori duhet të ndërmarrë veprime të arsyeshme korrigjuese për të zgjidhur problemet.

Për shkak të kufizimeve kohore, vlerësimi duhet të kryhet pa mbështetjen e një mjeti optimizimi. Nëse ndodh një kontingjencë reale, operatori duhet të rivendosë sigurinë N-1 sa më shpejt që të jetë e mundur. Në rast situatash emergjente, zbatohen veprimet e përcaktuara në planin e mbrojtjes.

Kontrolli i frekuencës është i automatizuar. Veprimet manuale nga operatori janë të nevojshme vetëm në rast të devijimeve të mëdha të frekuencës, ose kur rezervat për kontrollin e frekuencës janë pothuajse të shteruara.

Protokolli i bashkëpunimit operativ për operimin në kohë reale

Monitorimi i parametrave kryesorë të sistemit elektroenergjetik, si rryma, tensioni në linja dhe në transformatorë, dhe veçanërisht në linjat e rajonit të Tiranës, realizohet nga dy qendrat dispeçer të OST dhe OSSH, secila në zonën përkatëse të vëzhgimit. Këto qendra komunikojnë dhe koordinojnë veprimet operative për të mbajtur sistemin në gjendje të qëndrueshme.

- Në rast avarie, operatorët e nënstacioneve (OST, OSSH) marrin menjëherë dhe pa vonesë sinjalet e veprimit të mbrojtjeve dhe raportojnë në qendrat dispeçer përkatëse. Mbi bazën e vlerësimit të tyre, kur gjykohet e arsyeshme, dispeçeria e OST dhe OSSH bashkëpunon për rikyçjen pa vonesë të elementit të stakuar.
- Në funksion të zvogëlimit të kohës së ndërprerjes, vlerësohet maksimalisht çdo informacion tjetër që merret në rrugë operative në lidhje me elementin e stakuar.
- Në rastet kur prova e rikyçjes rezulton e pasuksesshme, të dy qendrat dispeçer marrin masa për rikonfigurimin përfundimtar të skemës, sipas regjimeve të vendosura pas avarisë, si më sipër, me kufizimet e detyruara të energjisë.

1.3.4.1. Sistemet e kontrollit dhe monitorimit automatik

OST mundëson gjithashtu kontrollin automatik të rrjetit të transmetimit nëpërmjet sistemeve të kontrollit lokal (të instaluar në nënstacione), si dhe nëpërmjet sistemeve SCADA/EMS, të cilat operohen nga operatorët e Qendrës Kombëtare Dispeçer. Këto sisteme mundësojnë monitorimin dhe operimin në kohë reale të të gjithë nënstacioneve 400/220 kV, si dhe të pjesës më të madhe dhe më të rëndësishme të nënstacioneve 110 kV. Krahas nënstacioneve, monitorohen dhe operohen edhe centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit.

Aktualisht, OST monitoron në kohë reale në sistem këto të dhëna: a) Flukset e fuqisë aktive dhe reaktive; b) Tensionet në zbara; c) Rrymat në linja, transformatorë dhe elementë të tjerë të sistemit të transmetimit; d) Frekuencat dhe gabimet e kontrollit të rivendosjes së frekuencës në zonën e vet të LFC; e) Monitorimin dhe kontrollin e Bllokut AK (OST–KOSTT); f) Rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive; g) Gjenerimin dhe konsumin.

Krahas operimit në kohë reale të sistemit të transmetimit, në sistemin SCADA/EMS janë të implementuara aplikacionet e rrjetit EMS. EMS është paketa e aplikacioneve të rrjetit, e cila, nëpërmjet studimeve të brendshme të sistemit, bazuar në gjendjen aktuale të tij dhe në parametrat e çdo elementi të sistemit energjetik të përfshirë në SCADA, optimizon gjendjen e sistemit.

Ndër funksionet e tjera, EMS mbulon: a) Suport në vendimmarrje; b) Kontroll mbi gjenerimin; c) Planifikimin e energjisë; d) Analizat e sigurisë; e) Suport për manovrimet të mundshme; f) Monitorimin e rrjetit energjetik.

Në qendrën e kontrollit të OST sh.a. është implementuar paketa AGC (Automatic Generation Control), modul i cili rregullon prodhimin e gjeneratorëve në mënyrë që të mbajë frekuencën dhe shkëmbimin në vlerat e skeduluara. Ky modul është konfiguruar duke iu përmbajtur manualeve operacionale të publikuara nga ENTSO-E.

OST sh.a. disponon një rrjet telekomunikacioni të dedikuar për operimin e sigurt të sistemit. Gjithashtu, OST sh.a. ka një qendër rezervë të kontrollit, e cila është e lidhur në rrjetin e telekomunikacionit të sigurisë dhe e pajisur me pajisje kontrolli. Të gjitha të dhënat që merren në distancë, thirren ose përftohen, përpunohen në mënyrë të dyfishtë përmes kanaleve të ndryshme.

1.3.4.2 Menaxhimi i fluksit të energjisë

OST kontrollon parametrat operacionale brenda zonës së vet të përgjegjësisë dhe në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operative nga zona e observimit, e cila përfshin pjesë të OST-ve fqinje. Çdo element i sistemit të transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë.

Për të qenë në gjendje të përballojë avaritë në sistem, OST përgatit veprime përmirësuese individuale dhe të koordinuara, të cilat zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të sigurisë operative dhe për të suportuar kthimin në normalitet në rastet e gjendjes së alarmit ose emergjencës.

1.3.4.3 Analiza e kontigjencave dhe trajtimi i tyre

OST sh.a. përfiton analiza sigurie nga Qendra e Koordinimit të Sigurisë – SCC Ltd. Belgrade (Koordinatori Rajonal i Sigurisë për Evropën Juglindore), nëpërmjet një kontrate si përdorues i shërbimeve të SCC Ltd. Belgrade. Kjo kontratë përfshin 5 (pesë) shërbimet e mëposhtme:

- Vlerësimi dhe përmirësimi i modelit të rrjetit individual dhe/ose të përbashkët (IGM/CGM);
- Llogaritja e koordinuar e kapacitetit ndërkufitar;
- Koordinimi i analizës së sigurisë (përfshirë masat parandaluese dhe përmirësuese);
- Vlerësimi i mjaftueshmërisë dhe besueshmërisë së punës në terma afatshkurtër dhe afatmesëm;
- Koordinimi i planifikimit të remonteve.

Siguria e operimit të sistemit është arsyeja kryesore për realizimin e analizave të kontigjencës, të cilat OST i kryen duke simuluar stakimin e elementeve të sistemit të transmetimit. Kjo analizë zhvillohet duke përdorur modelin individual të OST-së dhe modelin e përbashkët të rrjetit, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative. Njëkohësisht, përgatiten veprimet përmirësuese që mund të nevojiten para ose pas një incidenti, në varësi të rezultateve të analizës.

Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave janë:

- Sigurimi i masave parandaluese dhe/ose përmirësuese në lidhje me veprimet e nevojshme për ruajtjen e sigurisë së operimit, për të gjitha kontigjencat e besueshme që ndikojnë në sistemin e transmetimit.
- Koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese, sa herë që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar – ruajtjen e sigurisë operative në sistem dhe në interkonjeksion.
- Mbështetja në të dhënat e duhura dhe informacion në kohë reale, si edhe në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të përbashkët të rrjetit rajonal dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave dhe informacioneve të nevojshme ndërmjet OST, OSHEE dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.

1.3.4.4 Menaxhimi i qëndrueshmërisë dinamike

OST monitoron qëndrueshmërinë dinamike të sistemit të transmetimit në terma të tensionit dhe frekuencës, përmes studimeve off-line dhe matjeve në zona të gjera, duke përfshirë shkëmbimin e të dhënave përkatëse me OST-të e tjera, kur është e nevojshme. Qëllimi është që të jetë në gjendje të marrë masa korrigjuese të përshtatshme kur siguria operative e sistemit është në rrezik.

Qëllimi i studimeve dinamike off-line është të sigurojë informacionin e duhur për operatorët e OST-së në lidhje me gjendjen aktuale të sistemit dhe parashikimin e zhvillimeve të mundshme, në situatën normale (N) dhe në rast të kontigjencave të besueshme (N-1).

Përveç kësaj, studime të tilla ndihmojnë në marrjen e vendimeve për ndërmarrjen e veprimeve përmirësuese, sa më efikase, me qëllim parandalimin e incidenteve apo korrigjimin e pasojave të tyre, nëse ato ndodhin.

1.3.4.5. Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm

Bazuar në të dhënat historike dhe duke marrë në konsideratë rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të kërkesës së konsumatorëve, prodhimin nga PVE dhe PPE, si dhe sasinë e energjisë së nevojshme për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit, është përgatitur tabela e bilancit të energjisë për vitet (2026–2029), siç paraqitet në tabelat e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2026
I.	Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	1079	929	908	853	804	750	863	802	687	724	834	1104	10,336
a)	Prodhim vendas	"	939	732	682	584	654	512	601	519	429	465	538	871	7,527
b)	Energji në marrje	"	140	197	226	268	149	238	262	283	257	259	296	233	2,809
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	1,055	909	893	846	798	729	830	762	661	704	803	1,074	10,064
a)	Energji elektrike e dhene	"	334	294	290	324	285	142	107	78	132	178	161	309	2,633
b)	Energji elektrike për OSHEE sh.a.	"	677	578	542	451	437	511	644	644	493	475	596	726	6,771
c)	Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	44	38	61	71	77	76	80	40	36	52	46	40	660
III.	Humbjet në rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet në GWh	"	24	20	15	7	5	21	33	40	25	20	31	29	272
b)	Humbjet në %	%	2.25%	2.15%	1.68%	0.81%	0.68%	2.81%	3.84%	5.04%	3.68%	2.75%	3.69%	2.64%	2.63%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2027
I.	Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	1098	946	925	869	818	764	879	818	700	738	850	1124	10,529
a)	Prodhim vendas	"	954	744	693	594	665	520	610	528	436	472	546	885	7,647
b)	Energji në marrje	"	144	202	232	275	153	244	269	290	264	266	304	239	2,882
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	1,075	926	913	869	820	741	839	766	669	716	813	1,092	10,239
a)	Energji elektrike e dhene	"	355	312	309	344	302	150	113	83	141	189	171	328	2,797
b)	Energji elektrike për OSHEE sh.a.	"	671	573	537	447	433	507	638	639	489	471	591	720	6,717
c)	Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	49	42	67	78	85	83	87	44	40	57	51	44	726
III.	Humbjet në rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet në GWh	"	23	19	12	0	-2	23	40	52	31	22	37	32	290
b)	Humbjet në %	%	2.12%	2.06%	1.33%	-0.05%	-0.24%	3.03%	4.56%	6.41%	4.42%	2.94%	4.38%	2.83%	2.75%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2028
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	1117	963	942	886	833	779	896	834	714	752	867	1144	10,727
a)	Prodhim vendas	"	970	755	704	603	676	529	620	536	443	479	555	899	7,769
b)	Energji ne marrje	"	148	208	238	283	157	250	276	298	271	273	311	245	2,957
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	1,096	945	934	895	844	754	850	770	678	730	824	1,111	10,432
a)	Energji elektrike e dhene	"	377	331	328	365	321	160	121	88	149	200	181	348	2,970
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	666	568	533	443	430	503	633	634	485	467	587	714	6,663
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	54	46	74	86	93	91	96	48	44	63	56	48	798
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	21	18	8	-9	-11	24	46	64	36	23	43	33	295
b)	Humbjet ne %	%	1.86%	1.84%	0.83%	-1.05%	-1.33%	3.11%	5.16%	7.68%	5.04%	2.99%	4.96%	2.90%	2.75%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2029
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	1137	980	960	903	848	794	913	850	728	767	884	1165	10,928
a)	Prodhim vendas	"	985	768	716	613	686	537	630	545	450	487	564	913	7,894
b)	Energji ne marrje	"	151	213	244	290	161	257	283	306	278	280	320	252	3,034
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	1,120	966	958	923	870	769	862	775	688	745	836	1,131	10,642
a)	Energji elektrike e dhene	"	400	352	348	388	341	170	128	94	159	213	193	370	3,154
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	661	564	529	440	426	499	628	629	481	463	582	709	6,610
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	59	50	81	95	102	101	106	53	48	69	61	53	878
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	17	15	2	-20	-22	24	51	75	40	22	48	33	286
b)	Humbjet ne %	%	1.47%	1.49%	0.20%	-2.22%	-2.59%	3.05%	5.62%	8.84%	5.54%	2.91%	5.41%	2.86%	2.61%

Figura 21. Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për periudhën 2026 - 2029

1.3.4.5. Niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektiva e sigurisë së furnizimit për një periudhë 5 deri në 20-vjeçare

Në kuadër të studimit “Parashikimi i Kërkesës për Energji Elektrike 2022–2042”, të përgatitur nga OST, është realizuar parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për një horizont kohor deri në vitin 2042 (periudhë 20-vjeçare), sipas skenarëve të ndryshëm të marrë në konsideratë.

Metodologjia e përdorur bazohet fillimisht në parashikimin e kërkesës totale për energji në vend, dhe më pas konkretisht në kërkesën për energji elektrike, përmes aplikimit të modelit të përdoruesve fundorë (end-use model). Ky model vlerëson kërkesën e ardhshme për energji për çdo sektor të ekonomisë, bazuar në skenarët afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimeve social-ekonomike, teknologjike dhe demografike.

Parashikimi i kërkesës është realizuar për tre skenarë të ndryshëm energjetikë. Skenari i moderuar përmban projeksionet e ardhshme të parametrave të ndryshëm, bazuar në metodën e krahasimit me vendet më të zhvilluara (benchmarking) dhe në përputhje me objektivat strategjike zyrtarë. Ky skenar është emërtuar si Skenari i Referencës.

Pesë faktorët themelorë që ndikojnë në kërkesën për energji elektrike dhe rrjedhimisht në përcaktimin e skenarëve janë:

1. Popullsia
2. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB)
3. Niveli i gazifikimit
4. Eficienca e energjisë
5. Depërtimi i automjeteve elektrike

Në varësi të ndryshimeve të këtyre faktorëve, në drejtim të rritjes ose reduktimit të projeksionit të kërkesës për energji, janë zhvilluar edhe dy skenarë alternativë: përkatësisht, Skenari i Lartë dhe Skenari i Ulët i kërkesës për energji elektrike.

Rezultatet e parashikimit të kërkesës totale për energji elektrike në vend, sipas skenarëve përkatës, paraqiten në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm:

Kërkesa për energji elektrike (TWh)	2026	2027	2030	2032	2035	2037	2040	2042
Skenari i lartë	9.150	9.298	10.024	10.507	11.144	11.569	12.201	12.622
Skenari referencë	8.914	9.015	9.498	9.821	10.130	10.337	10.626	10.819
Skenari i ulët	8.693	8.750	9.015	9.191	9.226	9.249	9.274	9.290

Tabela 12. Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2026 – 2042




Figura 22. Skenarët e parashikimi të kërkesës për energji elektrike 2026-2042

Kërkesa për energji elektrike e paraqitur më sipër i referohet kërkesës totale në vend, ndërkohë që një pjesë e saj nuk furnizohet drejtpërdrejtë nga sistemi i transmetimit. Kjo përfaqëson pjesën e kërkesës nga konsumatorët në rrjetin e shpërndarjes, që kompensohet lokalisht nga prodhimi i centraleve gjenerues të lidhur pikërisht në rrjetin e shpërndarjes.

1.3.4.6. Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi

Të dhënat e parashtruara më poshtë, sikurse raportuar nga OST sh.a., paraqesin centralët e energjisë elektrike, të cilat janë lidhur në rrjetin e transmetimit në vitin 2025, janë në fazë ndërtimi, ose kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe janë:

Nr.	Gjeneruesi	Kapaciteti (MWac/ MWdc)	Shoqëria Aplikuese
1	HECet Stavec	14.77	KOKA&ERGI sh.p.k
2	HEC-et Kalivarë	5.597	BE-IS ENERGY sh.p.k
3	HEC-et Bushtrica	10.03	ELENERGJI sh.p.k.+BUSHTRICA 2017 sh.p.k
4	HECet Guri i Bardhë 1,2	9.3	Gealb Energy sh.p.k
5	HEC GRABOVA 1	14.9	GRABOVA HYDROPOWER SHPK
6	Park Fotovoltaik Sheq Marinas	40.56	ALBANIA POWER CORE SHPK
7	Park Eolik Spille	72.6	Verbund Green Power Albania shpk
8	TEC ROSKOVEC	170	FIER THERMOELECTRIC SHA
9	Prosol Solar	21	PROSOL SHPK
10	Gjorica Solar Park	41	Infotelecom-Albsolar4 sh.p.k
11	Eco Park Vau i Dejes	45.4	Eco Park Vau I Dejes shpk
12	Erseka Solar Park 3 Lot 2	22.26	ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 2 shpk
13	AKERNI Solar	100	AKERNI SOLAR SHPK
14	Erseka Solar Park 3 Lot 1	45.415	ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 1 shpk
15	Park Fotovoltaik Power Energy	32	POWER ENERGY SHPK
16	EZ-5 SOLAR 2	40	EZ-5 ENERGY 2 SHPK
17	PV Blue 3	42.5	SPV BLUE 3 SHPK
18	Park Fotovoltaik Vodice	24	Get Solar Solution shpk
19	PVPP Fortis Erseke	62	Fortis Energy and Construction shpk

Tabela 13. Centralet që kanë lidhur marrëveshje për lidhje deri në vitin 2025 dhe priten të energjizohen gjatë viteve 2026-2027

Nr.	Emri Centralit	Kapaciteti i Instaluar (MWac/MWdc)	Shoqëria
1	Amendim nr.1 HECet Gostimë	48.864	Egnatia Hydropwer shpk
2	Amendim nr.1 PV Blue 2	58.8	SPV BLUE 2 SHPK
3	Park Eolik Spille	72.6	Verbund Green Power Albania shpk
4	TEC ROSKOVEC	170	FIER THERMOELECTRIC SHA
5	SUNNY SIDE SOLAR PARK	122	SUNNY SIDE ENERGY SHPK
6	Prosol Solar	21	PROSOL SHPK
7	Amendim HEC-et Bushtrica 1 dhe Bushtrica 2	10.03	Elenergji shpk dhe Bushtrica 2017 shpk
8	Gjorica Solar Park	41	Infotelecom-Albsolar4 sh.p.k
9	Eco Park Vau i Dejes	45.4	Eco Park Vau i Dejes shpk
10	Erseka Solar Park 3 Lot 2	22.26	ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 2 shpk
11	AKERNI Solar	100	AKERNI SOLAR SHPK
12	Erseka Solar Park 3 Lot 1	45.415	ERSEKA SOLAR PARK 3 LOT 1 shpk
13	Park Fotovoltaik Power Energy	32	POWER ENERGY SHPK
14	EZ-5 SOLAR 2	40	EZ-5 ENERGY 2 SHPK
15	PV Blue 3	42.5	SPV BLUE 3 SHPK
16	Amendimi nr.2 HECet Gostime	48.864	Egnatia Hydropower shpk
17	Park Fotovoltaik Vodice	24	Get Solar Solution shpk
18	PVPP Fortis Erseke	62	Fortis Energy and Construction shpk

Tabela 14. Centrale që kanë nënshkruar marrëveshje për lidhje ose amenduar Marrëveshjen e Lidhjes në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2025

Nr.	Emri Centralit	Kapaciteti i Instaluar (MWac/MWdc)	Shoqëria
1	Impiant PV Povelce	12	KATOBETA sh.p.k.
2	Park Fotovoltaik Solen	128	Solen Energy shpk
3	Vau i Dejes Solar	100	Deja Solar shpk
4	GRAMOZI GREEN ENERGY SOLAR	38	GRAMOZI GREEN ENERGY SH.P.K
5	Qarr-Pepellash Solar Park	45 AC	ALBPOWER SHPK
6	ALB ENERGY SOLAR PARK	40	ALB ENERGY GROUP SHPK
7	EURON SOLAR PV	100	EURON SOLAR PV SHPK
8	KAIL SOLAR	60	KAIL ENERGY shpk
9	Park Fotovoltaik Solen	149.6	Solen Energy shpk
10	DH SOLAR PARK	35	DH SOLAR PARK SHHPK
11	PV GREEN JUPITER	26.5	MD GREEN ENERGY SHPK
12	PV GREEN SATURN	21.9	MD GREEN ENERGY SHPK
13	PV GREEN NEPTUN	26.2	MD GREEN ENERGY SHPK
14	HD SOLAR PARK GJIROKASTER	60	HD SOLAR PARK SHPK
15	3x Energy Sol	85	3x Energy shpk
16	Nova Solar	15	NOVA SOLAR SYSTEM SHPK
17	Park Fotovoltaik Saranda 1	59	Park Sol Energy shpk

Tabela 15. Centrale që kanë marrë opinion paraprak për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2025

Sikurse evidentohet në listën e mësipërme, një numër i konsiderueshëm burimesh të energjisë elektrike parashikohen të ndërtohen dhe të lidhen në sistemin e transmetimit, fakt që do kërkojë një zhvillim më dinamik të rrjetit për të integruar këto burime në sistemin elektroenergjetik shqiptar në vitet në vijim. Për këtë qëllim OST sh.a. ka planifikuar për periudhën 2025-2027, investime në vlerën rreth 16 miliardë lekë, ku përfshihen ndërtimi apo rikonstruksioni i nënstacioneve, linja 220 kV dhe 400 kV, linja 110 kV, IT, cybersecurity, telekomunikacion, etj. Shoqëria ka realizuar gjatë vitit 2025 investime lidhur me integrimin e burimeve të reja të energjisë në zona të caktuara të vendit, si dhe ka parashikuar rikonstruksionin apo ndërtimin e nënstacioneve të reja duke rritur kapacitetet transmetuese për integrimin e këtyre burimeve të reja në periudhën pasardhëse.

1.3.4.7. Plani i masave dhe realizimi i investimeve për forcimin e sigurisë së sistemit elektroenergjetik duke u bazuar në rekomandimet e raportit përfundimtar të ENTSO-E mbi ngjarjen e ndodhur në sistemin elektroenergjetik shqiptar më datë 21 Qershor 2024

Ngjarja e ndodhur në sistemin elektroenergjetik shqiptar dhe atë rajonal më datë 21 qershor 2024, u analizua në mënyrë të detajuar nga ENTSO-E, i cili në raportin përfundimtar ka identifikuar një sërë rekomandimesh me qëllim forcimin e sigurisë operative, rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit dhe parandalimin e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.

Këto rekomandime përfshijnë masa teknike, operacionale dhe organizative, të fokusuara në përmirësimin e monitorimit të rrjetit, vlerësimin e stabilitetit të tensionit, koordinimin rajonal, si dhe rishikimin e procedurave dhe pajisjeve mbrojtëse të sistemit të transmetimit.

Në këtë kuadër, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) raporton se ka hartuar një plan masash dhe investimesh, duke integruar rekomandimet e ENTSO-E në praktikën e përditshme operative dhe në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të sistemit të transmetimit.

Në kuadër të përmbushjes së kërkesave rregullatore dhe operacionale për garantimin e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik, OST sh.a. ka vijuar gjatë periudhës raportuese zbatimin e një sërë masash teknike dhe organizative që lidhen me monitorimin, mirëmbajtjen dhe analizën operacionale të rrjetit të transmetimit, në përputhje me Kodin e Transmetimit, standardet e ENTSO-E dhe aktet rregullatore të miratuara nga ERE.

Në këtë drejtim, është intensifikuar procesi i kontrollit të linjave të transmetimit përmes inspektimeve mujore të detyrueshme të trasave të linjave të tensionit të lartë, gjatë të cilave verifikohet gjendja e elementëve kryesorë të infrastrukturës, si shtyllat, përcjellësit, trosi mbrojtës, morsetat, izolatorët dhe tokëzimet. Gjithashtu, kontrollohen distancat e sigurisë me tokën, objektet dhe kurorat e pemëve, si dhe gjendja e trasës nën linjë, sinjalistika paralajmëruese dhe prania e ndërhyrjeve apo objekteve të reja pranë linjave. Përveç kontrolleve të planifikuara, realizohen edhe inspektime jashtë radhe pas dukurive të forta natyrore, si reshje intensive, ngrica, borë apo stuhi.

Paralelisht, OST sh.a. vijon monitorimin e sigurisë së sistemit në kohë reale përmes sistemeve EMS-SCADA, të cilat mundësojnë vlerësimin e incidenteve sipas kriterit N-1, përfshirë ndikimet e mundshme nga rrjetet fqinje. Elementët e këtyre rrjeteve që mund të ndikojnë në stabilitetin e sistemit përfshihen në listën e emergjencave si emergjenca të jashtme, dhe mbi to realizohen simulimet operacionale përkatëse. Ky proces është i konsoliduar dhe vijon të përmirësohet përmes investimeve teknologjike dhe shkëmbimit të vazhdueshëm të të dhënave operacionale me operatorët e sistemeve të transmetimit të vendeve fqinje.

OST sh.a. realizon gjithashtu vlerësime periodike të qëndrueshmërisë dinamike të sistemit në aspektin e tensionit dhe frekuencës përmes studimeve off-line dhe analizave të bazuara në matje me shtrirje të gjerë të sistemit. Këto analiza kryhen të paktën një herë në vit ose në raste të ndryshimeve të rëndësishme në rrjet, me qëllim identifikimin e kufijve të stabilitetit dhe përcaktimin e masave korrigjuese për ruajtjen e niveleve të tensionit dhe sigurisë së operimit. Në këtë kuadër, kryhen gjithashtu analiza të vazhdueshme për identifikimin e treguesve të performancës që lidhen me stabilitetin e tensionit dhe faktorët që mund të ndikojnë në të, duke mbajtur në konsideratë edhe zhvillimet dhe standardet e reja që publikohen nga ENTSO-E.

Në aspektin e mbrojtjes së rrjetit, OST sh.a. ka vijuar procesin e verifikimit dhe rikontrollimit të rregullimeve të mbrojtjeve në linjat ajrore të tensionit të lartë, në përputhje me aktet rregullatore në fuqi, ndërsa në vijim, pas përfundimit të procesit të transpozimit të Paketës së Pastër të Energjisë në legjislacionin kombëtar, do të vlerësojë dhe rishikojë aktet nënligjore dhe procedurat përkatëse që preken nga ky proces.

Menaxhimi i tensionit në rrjet realizohet përmes rregullimit të transformatorëve të fuqisë të pajisur me ULTC, të cilët operohen manualisht ose automatikisht nga dhomat e kontrollit në nënstacione, sipas kërkesave operacionale të Qendrës Kombëtare të Dispeçimit. Paralelisht, gjatë vlerësimit të mjaftueshmërisë së sistemit, OST sh.a. analizon aftësinë për përmbushjen e kërkesës totale të vendit për energji elektrike duke konsideruar gjenerimin e disponueshëm dhe kapacitetet e interkonjeksioneve, si dhe vlerëson rezervat aktive dhe reaktive në përputhje me metodologjinë deterministike, Kodin e Transmetimit, rregulloren SO-GL të ENTSO-E dhe vendimet e ERE-s.

Në funksion të menaxhimit të fuqisë reaktive dhe përmirësimit të profileve të tensionit në rrjet, sistemi i transmetimit është i pajisur me pajisje kompensimi si shunt kapacitorë dhe shunt reaktorë. Kapacitetet aktuale përfshijnë njësi prej 120 MVar në nivelin 220 kV në nënstacionin Tirana 2 dhe njësi prej 120 MVar në nivelin 400 kV në nënstacionet Zemblak dhe Tirana 2, të cilat kanë kontribuar në përmirësimin e profileve të tensionit në rrjetin 400 kV dhe në afrimin e tyre me vlerat e përcaktuara në Kodin e Transmetimit. Ndërkohë, OST sh.a. vijon operimin sipas procedurave ekzistuese edhe gjatë periudhës tranzitore që lidhet me rikonfigurimin e zonave të ofertimit dhe ndryshimet e mundshme në strukturën e Qendrës së Koordinimit të Sigurisë.

1.3.4.8. Parashikimi i investimeve për jo më pak se 5 (pesë) vitet e ardhshme, që OST sh.a. apo çdo palë tjetër planifikon të realizojë në lidhje me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkonjeksionit

2025	AL → XK	XK → AL	GR → AL	AL → GR	ME → AL	AL → ME
NTC	200	200	200	200	200	200

Tabela 16. Vlerat e importit dhe eksportit në kapacitete transmetuese

Nga pikëpamja strategjike, nisur nga vlerat e NTC të reflektuara në tabelën më sipër, projektet që përforcojnë lidhjet interkonjektive me rajonin, duke krijuar kushte më të mira për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajonin e Evropës Juglindore, janë:

- ***Ndërtimi i linjës së re 400 kV Rrashbull – Hoxharë – Fier (mbyllja e unazës 400 kV)***

Bazuar në studimin e Masterplanit për Zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit, në përgjigje të aplikimeve për lidhje me rrjetin të një numri të lartë burimesh energjie të rinovueshme në rajonin e Fierit dhe më gjerë, si dhe në harmoni me planet afatgjata për zhvillimin e rrjetit 400 kV në vend dhe në rajon, OST sh.a. ka planifikuar implementimin e projektit të mbylljes së unazës 400 kV të vendit.

Projekti i plotë do të përfshijë investimet e mëposhtme:

- Ndërtimi i një linje të re 400 kV ndërmjet nënstacioneve Fier, Hoxharë dhe Rrashbull – rreth 100 km e gjatë me përcjellës ACSR 2x490/65 mm².
- Zgjerimi në 400 kV dhe fuqizimi i nënstacionit Rrashbull me transformatorë të rinj 400/110 kV.
- Fuqizimi i nënstacionit Fier dhe instalimi i autotransformatorit të dytë 400/220 kV, 400 MVA.
- Zgjerimi në tension 400 kV dhe përforcimi i nënstacionit ekzistues 220/110 kV Hoxharë.
- Lidhja e nënstacionit Hoxharë me skemë hyrje/dalje në linjën e re 400 kV Fier – Rrashbull.

Nisur nga fakti se projekti i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tirana 2 – Rrashbull (i përfunduar), ka njërin qark me përcjellës me seksion 490/65 mm² dhe tjetrin me përcjellës 2x490/65 mm² (me perspektivë për të kaluar këtë qark të dytë në 400 kV sapo të zbatohet ky Projekt – duke eliminuar kështu nevojën për një linjë të re 400 kV Tirana 2 - Rrashbull).

Ndikimi i këtij projekti mund të kategorizohet në tre drejtime kryesore:

- Rritja e sigurisë së furnizimit me energji;
- Integrimi në rrjet i burimeve të rinovueshme të energjisë (BRE);
- Rritja e kapacitetit transmetues ndërkufitar.

Linjat e reja 400 kV do të mbyllin unazën e brendshme të transmetimit 400 kV dhe do të forcojnë gradualisht rolin e rrjetit 400 kV, si korridori kryesor për transmetimin e energjisë në drejtimin Veri-Jug dhe anasjelltas, i cili është vendimtar për zhvillimin e çdo projekti interkonjeksioni të ardhshëm të Shqipërisë.

- ***Ndërtimi i linjës së re të interkonjeksionit 400 kV midis Shqipërisë (NS Fier) dhe Greqisë (NS Thesproti)***

Ky projekt konsiston në ndërtimin e një linje transmetimi ajrore të re 400 kV midis Republikës së Shqipërisë (Nënstacionit Fier) dhe Republikës së Greqisë (Nënstacionit Thesproti).

Për pjesën shqiptare, projekti do të përfshijë masat e mëposhtme:

- Ndërtimi i linjës së re të transmetimit 400 kV me një qark (faza e parë) midis Fierit (territori shqiptar) dhe pikës së kufirit shqiptaro-grek – rreth 125 km e gjatë me përcjellës ACSR 2x490/65 mm².
- Zgjerimi dhe fuqizimi i nënstacionit 400 kV Fier.
- Për pjesën greke (rreth 91 km), linja e re do të lidhet në nënstacionin e ri 400 kV Thesprotia, për të vijuar më tej deri në nënstacionin Arachtos, ku lidhet kabli ekzistues nënujor midis Greqisë dhe Italisë.

Rezultatet kryesore të pritshme të këtij projekti janë:

- Fuqizimi i korridorit ekzistues të flukseve të energjisë në drejtimin Veri-Jug, nga sistemet energjetike në veri të Shqipërisë për në Greqi dhe më gjerë;
- Përmirësimi i lidhjes së sistemit elektroenergjetik shqiptar me rajonin;
- Zgjerimi i nënstacionit Fier, i cili do të bëhet një nyje shumë e rëndësishme për lidhjen e burimeve të rinovueshme të energjisë;
- Rritja e kapacitetit neto të transmetimit (NTC) midis Shqipërisë dhe Greqisë;
- Reduktimi i humbjeve në sistemin e transmetimit;
- Rritja e mundësisë së tregtimit për pjesëmarrësit e tregut rajonal të energjisë;
- Ulja indirekt e emetimeve të CO₂ në rajon;
- Ulja e varësisë së sistemit energjetik shqiptar nga ndryshimi i kushteve hidrologjike;
- Rritja e shkallës së sigurisë rajonale të furnizimit me energji elektrike dhe përmirësimi i treguesve të cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

Projekti aktualisht është në fazën e studimit të fizibilitetit dhe impaktit mjedisor-social.

• ***Zgjerimi në 400 kV i Nst Fierzë dhe interkonjeksioni i ri 400 kV Shqipëri-Kosovë***

Projekti konsiston në zgjerimin dhe dixhitalizimin e NS Fierzë me një transformator të ri *phase-shift* 400/220 kV dhe një linjë të re interkonjeksioni 400 kV me Kosovën.

Për pjesën shqiptare, projekti do të përfshijë investimet e mëposhtme:

- Ndërtimi i një nënstacioni të ri 400/220/110 kV pranë nënstacionit ekzistues të Fierzës;
- Instalimi i transformatorit phase-shift 400/220 kV, 600 MVA;
- Rikonfigurimi i linjave 220 kV dhe 400 kV që do të lidhen me këtë nënstacion;
- Lidhja në interkonjeksionet ekzistuese 400 kV Koman – Kosova B dhe 220 kV Fierzë – Prizren 2;
- Lidhja me rrjetin e transmetimit 110 kV në zonë;
- Ndërtimi i linjës së re të interkonjeksionit 400 kV ndërmjet NS Fierza e re 400/220 kV dhe NS Prizren4 të re 400 kV në Kosovë me përcjellës ACSR 2x490/65 mm² (25 km në territorin shqiptar).

Ndikimi i këtij projekti shtrihet në tre drejtime kryesore:

- Siguria e përmirësuar e furnizimit me energji elektrike;
- Rritja e kapacitetit ndërkufitar midis Shqipërisë dhe Kosovës;
- Burimet e rinovueshme të energjisë (kryesisht eolike) të integruara në rrjet.

Ndërkohë vijon puna për përfundimin e investimeve të poshtë-listuara,

- ***Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan 2 (Shqipëri) – Manastir (Maqedoni) dhe Elbasan 2 – Fier, si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan 2 dhe Fier.***

Financimi i këtij projekti është siguruar nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar për Zhvillim. Ky projekt përforcon lidhjet interkonjektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon. Gjithashtu, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën jugore të Shqipërisë, ku parashikohet të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian, krijon mundësi të mira për lidhje nëpërmjet kabllit nënujor me Italinë. Projekti përfshin:

- Ndërtimin e një linje të re transmetimi 400 kV me një qark, për të implementuar një lidhje mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, si dhe për të përforcuar lidhjen ekzistuese të transmetimit 220 kV, e cila është e tejngarkuar dhe e vjetër, midis Elbasanit dhe Fierit. Traseja e linjës Elbasan–Manastir (Bitola) do të ketë një gjatësi përafërsisht 56 km, ndërsa linja Elbasan–Fier përafërsisht 74 km.
- Ndërtimin e nënstacionit të ri Elbasan 3, dhe përforcimin e zgjerimit të nënstacionit ekzistues të Fierit. Nënstacioni i ri Elbasan 3 do të zgjerojë nënstacionin ekzistues 400/220 kV Elbasan 2, me një impiant në nivelin 400 kV, për të lidhur linjat Tiranë 2, Zemblak, Fier dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe për instalimin e një shunt reaktori. Gjithashtu, nënstacioni Fier do të zgjerohet dhe do të pajiset me transformatorë 400/220 kV dhe një impiant në nivelin 400 kV, për të lejuar lidhjen 400 kV drejt Elbasanit 3.

Ky projekt aktualisht është në fazë implementimi.

- ***Rikonstruksioni i linjës së interkonjeksionit 220 kV Vau i Dejës (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi).***

Ndërtimi i kabllit HVDC midis Italisë dhe Malit të Zi mundëson tregtimin e tepricave të gjenerimit të ardhshëm në zonën e Ballkanit dhe në të njëjtën kohë, sjell forcimin e mëtejshëm të rrjetit të transmetimit në rajon.

Shumë iniciativa të reja për ndërtimin e centraleve me burime të rinovueshme janë duke u zhvilluar në veri të Shqipërisë dhe, për këtë arsye, nevojiten përforcime të linjave ekzistuese të interkonjeksionit për të siguruar shkëmbimet ndërkufitare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është rritja e kapacitetit transmetues të kësaj linje. Linja aktuale është ndërtuar në vitin 1972, me kapacitet transmetues të ulët, rreth 278 MVA, por pas rikonstruksionit pritet që kapaciteti i saj të rritet ndjeshëm nëpërmjet vendosjes së përçuesve me teknologji të fundit.

Përfitimet që arrihen nga kryerja e këtij investimi janë:

- Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së rrjetit shqiptar dhe të Malit të Zi;
- Rritja e shkëmbimit ndërkufitar midis dy vendeve;
- Rritja e Kapaciteteve Neto të Transferimit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, në dritën e shkëmbimeve të energjisë elektrike midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë, në kuadër të shkëmbimeve të sigurisë;
- Reduktimi i kongjestionave të rrjetit;
- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike;
- Ulje të humbjeve teknike;

- Reduktimin e niveleve të CO₂

- ***Ndërtimi i një linje të re ajrore 110 kV ndërmjet Shqipërisë (Nst Bajram Curri) dhe Kosovës (Nst Deçan)***

Ky projekt vjen në kuadër të marrëveshjeve dhe memorandumëve të nënshkruara ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë në fushën energjetike, si dhe të bashkëpunimit ndërmjet dy kompanive të transmetimit, OST dhe KOSTT, si një proces i vazhdueshëm dhe shumëplanësh, në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale që këta operatorë mbulojnë, marrëveshjeve dypalëshe në fuqi dhe detyrimeve që lindin nga asociimi i përbashkët në nisma rajonale dhe më gjerë.

OST, në bashkëpunim me operatorin e transmetimit të Kosovës, KOSTT, kanë finalizuar studimin e parafizibilitetit për ndërtimin e linjës së re të interkonjeksionit me nivel tensioni 110 kV, e cila do të lidhë në formë unaze nënstacionet në zonën verilindore të vendit me zonat me konsum të lartë të Kosovës, si Deçani, Prizreni, etj.

Në këtë mënyrë do të shfrytëzohet fakti i diversifikimit të prodhimit të energjisë, duke pasur parasysh se Kosova bazohet kryesisht në prodhimin nga burimet termike me lëndë të parë linjtit.

Gjithashtu, ky projekt do të:

- Rrisë sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike, duke përmirësuar parametrat që lidhen me reduktimin e ndërprerjeve në atë rajon;
- Sjellë përmirësim të niveleve të tensionit, si dhe reduktim të humbjeve.

Linja e re 110 kV do të jetë me përçues me seksion 240 mm², me një gjatësi totale prej rreth 33 km, nga të cilat 14 km në territorin e Shqipërisë dhe 19 km në territorin e Kosovës.

1.3.4.9. Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, OST sh.a. raporton se ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të rritur sigurinë e furnizimit të energjisë, duke përfunduar në kohë të gjitha punimet dhe remontet e planifikuara, si dhe duke përgatitur sistemin energjetik për të menaxhuar në mënyrë fleksibël kërkesën për energji. Kur këto të fundit janë shfaqur, është realizuar ndërhyrja për eliminimin e tyre dhe kthimin e skemës në gjendje normale.

Punimet për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit që realizohen nga OST sh.a. klasifikohen në tre kategori:

- punime të planifikuara në përputhje me grafikun vjetor të remonteve;
- punime jashtë rradhe (të planifikuara);
- punime për eliminimin e avarive të shfaqura në sistem.

Rezultati i punimeve të realizuara për mirëmbajtjen e rrjetit pasqyrohet edhe nga treguesit e paraqitur në tabelën në vijim.

Emërtimi	Stakim e gjithsej	Tranzitor e	Qëndrueshmë	Kushte atmosf.	Defekt linje	Pajisje primare	Pajisje sekondare	SHAM SHAF	OSHEE te tjere	Të ndryshme	Kohezgja tja
Linja 400 kV	27	22	5	6	1	0	12	0	0	8	0 h
Linja 220 kV	66	53	13	14	7	1	39	0	0	5	29h5m
Linja 110 kV	279	210	69	61	17	19	137	5	5	35	200h5m
Linja gjithsej	372	285	87	81	25	20	188	5	5	48	229h10m

Tabela 17. Avaritë në sistemin e transmetimit

1.3.4.10. Masat e marra nga OST sh.a. për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike, si dhe për rritjen e sigorisë së furnizimit në rast nevojë

Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve të furnizimit, si dhe masa të tjera në rast nevojë për të ruajtur sigurinë e punës së sistemit, që ndërmerren nga OST-ja për të garantuar sigurinë operationale, kanë si objektiv kryesor përmbushjen e kriterit (N-1) dhe ruajtjen e limiteve të sigorisë operationale.

Veprimet përmirësuese parandaluese zbatohen normalisht në fazën e planifikimit të operimit, për të ruajtur gjendjen normale të sistemit në situatën e ardhshme operative dhe për të parandaluar përhapjen e avarive jashtë zonës së përgjegjësisë së OST-së.

Veprimet përmirësuese parandaluese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispečimit (të agregatëve) ose të lejimit të tregtimit në kah të kundërt, kur është e mundur;
- Ndryshime në topologjinë e rrjetit;
- Komutime manuale të pajisjeve të energjisë reaktive (reaktorët, blloqet e kondensatorëve statikë), ose ndryshimin e nivelit të set-point të kontrollorëve të tyre;
- Kërkesë për suport shtesë të energjisë reaktive nga centralet.

Veprimet përmirësuese korrigjuese janë veprime që zbatohen menjëherë ose relativisht shpejt pas ndodhjes së një emergjence, e cila çon në një gjendje të ndryshme nga situata normale. Me anë të këtyre veprimeve korrigjuese, sistemi kthehet përsëri në gjendje normale.

Veprimet përmirësuese korrigjuese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispečimit ose të tregtimit në kah të kundërt, duke përfshirë aktivizimin e rezervave të OST-së;
- Kontroll të pajisjeve të energjisë reaktive (reaktorët, blloqet e kondensatorëve, etj.);
- Menaxhim të tensionit përmes gjenerimit ose absorbimit të energjisë reaktive nga centralet;
- Veprime të skemave të sistemit të mbrojtjes, p.sh., ndryshimi i topologjisë së rrjetit, kufizim i prodhimit apo i ngarkesës, në varësi të specifikimeve të mbrojtjes.

Konstatohet se kryesisht stakimet e linjave 110 kV që ndodhin gjatë periudhës së dimrit janë stakime tranzitore, të cilat kanë ardhur si pasojë e mbingarkimeve në nyjet 110 kV dhe në segmentet e linjave hyrëse të këtyre nyjeve, dhe zakonisht rikyçen brenda pak minutave.

1.3.4.11. Plani i sistemit të mbrojtjes së OST sh.a. në rast të një situatë emergjente

Në kuadër të rritjes së sigorisë së furnizimit dhe për menaxhimin e situatës energjetike në nyjet kritike të sistemit, për periudha të caktuara kohore – kryesisht gjatë sezonit të verës dhe gjatë sezonit të dimrit (gjatë periudhës së festave të fundvitit) – OST sh.a. ka ndërmarrë masa shtesë për përballimin e situatave dhe për bashkëveprim me OSSH sh.a., me qëllim një operim sa më efikas në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë dhe sigorisë së sistemit.

Masat shtesë të ndërmarra konsistojnë në:

- Ngritja e grupeve të përbashkëta të punës me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë;
- Analizë e detajuar e ngarkesës së rrjetit të transmetimit në rajonet e përcaktuara si kritike;

- Analizë dhe renditje e veprimeve operative për regjim normal dhe në rast stakimi të mundshëm të linjave apo autotransformatorëve, sipas rasteve të identifikuara si më problematike;
- Mbajtja në gatishmëri të vazhdueshme të brigadave të linjave dhe brigadave të remonteve të OST-së për të mundësuar normalizimin e skemave të furnizimit në kohën më të shkurtër të mundshme, në rast stakimi të linjave në gjendje avarie të zgjatur, apo për çdo anomali tjetër që ndikon në gjendjen e pajisjeve komutuese;
- Nxitja e strukturave përgjegjëse të angazhuara drejtpërdrejtë në shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit, për rritjen e angazhimit dhe vigjilencës, si dhe për të qenë të përditësuar me problematikat ekzistuese në rrjetin e OST-së;
- Mirëorganizimi i strukturave dhe shtimi i kapaciteteve njerëzore, nëse është e nevojshme, për mbarëvajtjen e rrjetit gjatë këtyre periudhave;
- Komunikim dhe bashkëveprim i vazhdueshëm me dispeçerinë e OSHEE-së.

Në kushte normale operimi, Siguria Operacionale nënkupton aftësinë për të siguruar funksionimin normal të sistemit, për të kufizuar kohëzgjatjen dhe numrin e çrregullimeve, për të parandaluar shqetësime të mëdha dhe për të kufizuar pasojat e një shqetësimi të madh, në rast se ky ndodh.

Plani i Mbrojtjes së Sistemit është i rëndësishëm në kuadër të marrjes së masave të menjëhershme për normalizimin e gjendjes së sistemit, si dhe me qëllim lehtësimin e rivendosjes së tij pas një shqetësimi të madh (black-out), për rikthimin e sistemit në funksionim normal.

1.3.4.12. Masat e Planit të Mbrojtjes të Sistemit

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit paraqiten si veprime emergjente përmirësuese. Në planin e mbrojtjes së sistemit të hartuar nga OST sh.a., janë të përmbledhura të gjitha masat teknike dhe organizative të marra, për të parandaluar përhapjen apo përkeqësimin e një incidenti në Sistemin e Transmetimit, me qëllim shmangien, zgjerimin e avarisë dhe rënien e Sistemit. Plani i Mbrojtjes së Sistemit i hartuar nga OST përfshin:

- Skemën e kontrollit automatik nga mbi/nën-frekuenca;
- Skemën e kontrollit automatik nga kolapsi i tensionit;
- Procedurat që ndiqen gjatë aktivizimit të planit të mbrojtjes, si dhe kushtet e aktivizimit të veprimeve përmirësuese;

Në vijim, jepen shembuj të masave të aplikueshme të Planit të Mbrojtjes së Sistemit në rastet e kufizimeve për ngarkesën, frekuencën, flukset e energjisë dhe të tensionit:

- Kufizime të ngarkesës/frekuencës;
- Lëshimi ose ndalimi i njësive të prodhimit të energjisë;
- Rritja ose zvogëlimi (automatiksht ose me kërkesë) i nivelit të prodhimit të njësive gjeneruese;
- Përshtatja e mënyrës së kontrollit të LFC- Load Frequency Control (Kontrolli i Ngarkesës dhe Frekuencës) aktive;
- Përdorimi manual apo automatik i reduktimeve, shkarkimit të ngarkesës;
- Ndryshimet e pikave të punës të rregullatorëve të tensionit të transformatorëve në nivelin e shpërndarjes;

- Kufizime të flukseve të energjisë elektrike;
- Anullimi i remonteve të elementëve të rrjetit dhe vënia në punë sa më urgjentisht të jetë e mundur;
- Stakimi automatik i njësisë (gjeneruese) që aktivizohet nga stakimi i një linje relevante të transmetimit;
- Tregtimi në kah të kundërt me zonat e përgjegjësisë;
- Ngrirja e shkëmbimeve të planifikuara;
- Reduktimi i programit të shkëmbimit;
- Reduktimi i kapaciteteve të interkonjeksionit;
- Shkarkimi manual i ngarkesës i objekteve me marrëveshje për ndërprerje;
- Shkarkimi automatik i objekteve me marrëveshje për ndërprerje, shkaktuar nga stakimi i një linje transmetimi;
- Shkarkimi i mëtejshëm i ngarkesës në varësi të situatës.

Kufizimet e tensionit:

- Kërkesa për vlera maksimale apo minimale të gjenerimit të fuqisë aktive dhe reaktive;
- Zvogëlimi i fuqisë aktive në favor të prodhimit shtesë të fuqisë reaktive;
- Parandalimi i njësive me ofrimin, injektimin e energjisë reaktive shtesë;
- Ndalimi i mirëmbajtjes, dhe kyçja e elementeve që më parë ishin në remont;
- Bllokimi i pozicionit të rregullatorëve të tensionit në transformatorët me rregullim nën ngarkesë.

Gjithashtu, në kuadër të rritjes së sigurisë së furnizimit për menaxhimin e situatës energjetike në nyjet kritike të sistemit, për periudha të caktuara kohore, janë edhe investimet e planifikuara në rrjetin e OST, të cilat kanë si qëllim primar rritjen e sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Në funksion të saj, gjatë vitit 2025 kanë përfunduar investimet e mëposhtme:

1. Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe 110 kV Burrel–Bulqizë dhe rehabilitimi i N/St Burrel dhe Bulqizë;
2. Ndërtimi i linjës 110 kV dopjo qark Elbasan–Fibër;
3. Ndërtimi i linjës së re 110 kV dopjo qark Elbasan–Cërrik;
4. Rikonstruksioni i shtyllave metalike të linjave 220 kV;
5. Rikonstruksioni i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh–Marinëz dhe Ballsh–Drenovë;
6. Spostimi i linjës 35 kV (L30-24) Elbasan 1-Fabrika e Çimentos në pikën e intersektimit me linjën 110 kV Elbasan 1- Kusarth;
7. Kalimi në kabllor i segmentit të parë të linjës 110 kV Farkë–Ibë;
8. Ndërtimi i linjës 220 kV Tirana2 – Rrashbull (Pjesë e projektit Efçensa e Energjisë);
9. Furnizim dhe vendosje e qarkut të dytë të linjës 220 kV TEC Fier–Babicë–TEC Vlorë;
10. Rikonstruksioni i shtyllave metalike të linjave të tensionit të lartë 400 kV Elbasan-Zemblak-kufi;

11. Furnizim dhe instalim i kontenierit të assembluar me çela 20 kV në N/st. Tirana 1.

Gjithashtu, në proces implementimi me fondet e saj që pritet të përfundojnë brenda viteve 2026-2027 janë edhe projektet e mëposhtme:

1. Ndërtimi i linjës 110 kV Selitë – Tirana3 (Pjesë e projektit Efijensa e Energjisë);
2. Zhvillimi i skemës dhe rikonstruksioni i Nënstacionit 220/110/35/20 kV Sharrë;
3. Faza e dytë e punimeve në N/st Hoxharë (220/110/20 kV);
4. Instalim qarku 110 kV në linjën ekzistuese Bushat–Velipojë;
5. Ndërtimi i linjës së re 110 kV Gjiri i Lalzit–Fushë Kuqe;
6. Spostimi i linjave që preken nga gjurma e aksit rrugor Thumanë–Vorë–Kashar dhe instalimi i shtyllave në linjën Fier–Rrashbull;
7. Ndërtimi i dy trakteve të reja të linjës 220 kV në N/St Fier dhe Babicë;
8. Punime primare dhe vendosje autotransformatori 410/230 kV në N/st Koman;
9. Ndërtimi i linjës kabllore 110 kV Tirana 1 – Zogu i Zi si dhe trakti përkatës në N/st Tirana 1;
10. Rikonstruksioni i linjës 110 kV Laç-1 - Fushë Kuqe dhe traktit përkatës në N/st F.Kuqe;
11. Rikonstruksioni i segmentit të parë të linjës 110kV Ballsh -Memaliaj.

Projektet e OST me fondet e saj të përcaktuara gjatë viteve 2023-2025 dhe që pritet të fillojnë në 2026 janë:

- a) Ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110 kV Traktora me një autotransformatorë 1 x 150MVA (ngjitur me nënstacionin ekzistues Traktora 110/20 kV);
- b) Fuqizimi i linjave 110 kV Fier-Kafaraj-Vlorë-Babicë;
- c) Ndërtimi i linjës 110 kV Zogu i Zi – Tirana Qendër dhe Punime në N/st Tirana Qendër;
- d) Linja e re 110 kV dopjo qark Sharrë - Selitë dhe traktet përkatëse;
- e) Zgjerimi i N/st Tirana1 (Trakt i ri transformatori 220 kV, ndërtim i seksionit të tretë 20 kV);
- f) Linja e re 110 kV Gjiri i Lalzit – Porto Romano;
- g) Rikonstruksioni i linjës 110 kV Fier – Marinëz;
- h) Ndërtimi i linjës kabllore me dy qarqe 110 kV Rrashbull–Shkozë, rreth 2 km;
- i) Ndërtimi i linjës së re 110 kV HEC Lurë – Shumat;
- j) Ndërtimi i linjës së re 110 kV Laç 2 - (Lezhë) - Bushat i ri dhe demontimi i linjës ekzistuese;
- k) Ndërtimi i linjës së re 110 kV Çorovodë – Këlcyrë;
- l) Ndërtimi i linjës së re 110 kV kabllore Tirana 1 – Traktora dhe linjës së re 110 kV Tirana 3 – Traktora;
- m) Ndërtimi i linjës 110 kV Sarandë - N/St Xarrë, me linjë me shtylla dopjo qark dhe shtrirje të përcjellësit në një qark, si dhe trakti përkatës i linjës 110 kV në NST Sarandë;
- n) Furnizimi i N/st Piqerras 110/20/10kV me tension 110 kV;

- o) Ndërtimi i linjës 110 kV Vlora 2 – Xarrë, pjesërisht i ri dhe pjesërisht shtrirje përcjellësi në shtyllëzim ekzistues;
- p) Ndërtimi i një segmenti të ri linje 110 kV për të anashkaluar qytetin e Gjirokastrës;
- q) Ndërtimi i linjës së re kabllore Shkozet – Marina Durrës – Rrashbull;
- r) Kalimi në dopjo qark i segmentit të linjës 110kV Skuraj – Rubik, ndërtimi i traktit përkatës në N/st Rubik;
- s) Furnizimi i N/st Tepelenë nga Linja 110 kV Memaliaj - Këlcyrë dhe rikonstruksioni i trakteve në N/st Tepelenë;
- t) Furnizimi i N/st Akerni 110/35/20 kV me tension 110 kV;
- u) Furnizimi i N/st Fieri 2 me tension 110 kV;
- v) Lidhja e zbarave 110 kV e nënstacionit 220/110 kV Hoxharë me nënstacionin 110 kV Hoxharë OSHEE;
- w) Rikonstruksioni i linjës 110 kV Lushnjë – Kavajë;
- x) Rikonstruksioni i linjës 110 kV Kashar – Kamëz – Laç 1;
- y) Shtim trakti i tretë në N/St Kombinat;
- z) Ndërrim i përcjellësit të linjës 220 kV Burrel – Elbasan 1 me përcjellës HTLS;
- aa) Zgjerimi skemës dhe blerja e një autotransformatori 220/110 /35 kV 120 MVA për N/st Shumat
- bb) Rehabilitimi/rindërtimi i nënstacioneve ekzistuese 110 kV:
 - a) Rikonstruksioni i sistemit të linjave dhe zbarave të N/st Ballsh;
 - b) Rehabilitimi i anës 110kV N/st F. Kruje dhe godina (Faza 1);
 - c) Ndërtimi i sistemit të ri të zbarave 110 kV në N/st Kafaraj dhe 3 trakte të reja të linjës;
 - d) Rikonstruksioni i trakteve të reja të nënstacionit të Ersekës dhe plotësimi i skemës;
 - e) Dy trakte të reja hyrëse-dalëse 110 kV në nënstacionin e Drenovës;
 - f) Dy trakte të reja hyrëse-dalëse 110 kV në nënstacionin Krahësi;
 - g) Dy trakte të reja hyrëse-dalëse 110 kV në nënstacionin e Këlcyrës;
 - h) Dy trakte të reja hyrëse-dalëse 110 kV në nënstacionin e vjetër të Gjirokastrës.
- cc) Zgjerim i N/st F. Krujë me një auto 220/110 kV dhe traktit të ri 220 kV nga fabrika e çimentos (faza 2).

1.3.4.13. Masat e marra për garantimin e gatishmërisë dhe sigurisë së sistemit brenda të gjithë kufijve operativë, përfshirë sistemet primare dhe ato sekondare, si edhe për sa i përket sigurisë kibernetike dhe infrastrukturave kritike

a) Masat e marra për garantimin e gatishmërisë për sistemet primare dhe ato sekondare

Masat e marra nga OST në kuadër të përballimit të shqetësimeve, ngjarjeve ose incidenteve për garantimin e gatishmërisë dhe sigurisë së sistemit brenda kufijve operativë përfshirë sistemet primare dhe sekondare, për vitin 2025 përfshijnë:

- Zbatimi me përpikmëri i programit të punës për çdo Njësi Operative sipas programit, kryhet dy herë në vit për çdo pajisje evidentimi i problematikave të dala nga kontrolli dhe matja për çdo pajisje primare dhe ndërhyrjet për eliminimin e çdo problematike të konstatuar.
- Monitorimin e vazhdueshëm të parametrave operativë të sistemit (tensione, ngarkesa, frekuencë, flukse fuqie) përmes sistemit SCADA/EMS dhe ndërhyrjen në kohë reale për mbajtjen e tyre brenda kufijve të lejuar operativë.
- Kryerjen e analizave dhe studimeve të sigurisë së sistemit (N-1, ngarkesa maksimale/minimale, skenarë avarie) për identifikimin e rreziqeve potenciale dhe marrjen e masave parandaluese përkatëse.
- Aktivizimin dhe mirëmbajtjen e rezervave aktive dhe reaktive, si dhe koordinimin me prodhuesit dhe OST-të fqinje për përballimin e situatave të ngarkesave të larta ose incidenteve ndërkufitare.
- Hartimin, përditësimin dhe zbatimin e planeve të emergjencës dhe procedurave operative për menaxhimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, përfshirë humbjen e elementeve kritike të sistemit.
- Trajnimin e vazhdueshëm të personelit operativ dhe teknik, si dhe zhvillimin e simulimeve për rritjen e gatishmërisë në raste emergjente.
- Bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale me OST-të fqinje dhe institucionet përkatëse, në përputhje me marrëveshjet operationale dhe kërkesat e rrjetit rajonal.
- Realizimi i punimeve të remontit dhe mirëmbajtjes së linjave, nënstacioneve, pajisjeve primare, skemave të mbrojtjes me rele dhe pajisjeve të tjera kritike për sigurimin e funksionimit të pandërprerë dhe rritjen e besueshmërisë së sistemit.
- Identifikimi i prioriteteve dhe investimeve për rritjen e sigurisë së sistemit të transmetimit. Investimet e OST për vitin 2025 janë fokusuar në përmirësimin e sigurisë së sistemit, duke përfshirë rinovimin e pajisjeve kritike, zgjerimin e kapaciteteve të rezervave, përforcimin e lidhjeve ndërkufitare dhe modernizimin e sistemeve të kontrollit dhe mbrojtjes. Këto investime synojnë rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të transmetimit, duke minimizuar rreziqet e ndërprerjeve dhe duke përmirësuar gatishmërinë për incidente të mundshme.

1.4. Shpërndarja e Energjisë Elektrike

1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.)

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e energjisë elektrike tek klientët. Kufiri i sistemit të shpërndarjes me sistemin e transmetimit është i përcaktuar në Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike, si mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin për të cilin është licencuar.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. është organizuar në 11 zona shpërndarjeje dhe 42 agjenci.

Sipas të dhënave të OSSH sh.a., energjia totale e hyrë në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2025 është 8,251 GWh, nga e cila 16.96% janë humbjet në rrjetin e shpërndarjes ose 1,399 GWh.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat mbi treguesit kryesorë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2025.

Pershkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Progresive 2025
Energjia e injektuar nga OST ne rrjetin e Shperndarjes	705,125	646,647	612,191	510,630	467,103	541,222	646,595	637,602	519,546	554,508	591,199	753,894	7,186,262
Energji elektrike e injektuar ne OST nga Hec-et Lokale	68,728	29,685	62,018	77,682	50,190	22,693	16,246	14,434	13,331	21,191	77,067	57,964	511,229
Energji e transmetuar per OSSH Sh.a Bilanc NET	636,397	616,963	550,173	432,948	416,914	518,528	630,349	623,168	506,215	533,318	514,132	695,930	6,675,033
Energji e Blere nga OSSH Sh.a	776,926	700,867	671,425	573,814	520,776	577,300	669,015	656,412	536,602	584,824	649,952	822,279	7,740,191
Prodhim i injektuar ne shperndarje BREE-t	140,529	83,904	121,252	140,866	103,862	58,771	38,666	33,244	30,387	51,507	135,820	126,349	1,065,158
Prodhim nga HEC-et e mesem	1,806	1,661	1,883	1,619	1,289	1,316	1,042	863	722	812	1,887	2,303	17,202
Prodhim nga HEC-et private dhe koncesionet	124,708	67,527	93,890	105,911	74,212	28,771	10,608	7,843	7,688	30,111	110,059	100,679	762,007
Energjia e injektuar nga Imp. Fotovoltaike	5,971	7,052	9,427	12,717	14,135	16,145	16,370	15,121	13,859	10,557	6,123	7,263	134,739
Prodhim i injektuar ne OSSH nga BREE-t ne Treg te Parregulluar	7,962	7,564	15,802	20,108	13,709	12,084	10,344	9,070	7,882	9,865	17,681	16,010	148,081
Prodhim i injektuar nga Veteproduhuesit ne Treg te Parregulluar	82	99	250	511	517	456	302	347	236	161	71	95	3,129
Energjia Totale ne rrjetin e Shperndarjes	845,654	730,552	733,443	651,496	570,965	599,993	685,261	670,846	549,933	606,015	727,019	880,243	8,251,420
Energji Totale e perdorur ne Rrjetin e Shperndarjes	688,956	607,256	586,708	549,294	483,219	514,089	573,312	574,161	480,441	500,021	596,409	698,069	6,851,934
Humbjet totale ne rrjetin e shperndarjes	156,698	123,295	146,735	102,202	87,746	85,904	111,949	96,686	69,492	105,994	130,611	182,174	1,399,486
Humbjet totale ne rrjetin e shperndarjes (%)	18.53%	16.88%	20.01%	15.69%	15.37%	14.32%	16.34%	14.41%	12.64%	17.49%	17.97%	20.70%	16.96%
Humbjet teknike ne njesite TL	8,913	8,964	9,052	8,602	5,108	7,587	7,299	7,505	7,068	8,107	10,318	13,019	101,542
Humbjet teknike ne njesite TL (%)	1.05%	1.23%	1.23%	1.32%	0.89%	1.26%	1.07%	1.12%	1.29%	1.34%	1.42%	1.48%	1.23%
Energji e perdorur per konsumin vetjak te Njesive te TL	503	457	447	389	324	353	416	370	349	403	446	528	4,985
Energji per Zonat e Shperndarjes	836,238	721,131	723,944	642,505	565,533	592,052	677,547	662,971	542,516	597,505	716,255	866,696	8,144,893
Humbjet ne zonat e Shperndarjes	147,785	114,331	137,683	93,600	82,637	78,317	104,651	89,181	62,425	97,887	120,293	169,155	1,297,944
Humbje ne zonat e OSSH Sh.a (%)	17.67%	15.85%	19.02%	14.57%	14.61%	13.23%	15.45%	13.45%	11.51%	16.38%	16.79%	19.52%	15.94%
Humbjet Teknike	108,401	84,036	92,705	66,164	55,922	59,013	77,519	73,698	50,273	56,995	75,253	107,472	907,452
Humbjet Teknike (%)	12.96%	11.65%	12.81%	10.30%	9.89%	9.97%	11.44%	11.12%	9.27%	9.54%	10.51%	12.40%	11.14%
Humbjet Jo Teknike	39,384	30,296	44,978	27,436	26,716	19,303	27,132	15,483	12,151	40,892	45,039	61,683	390,492
Humbjet Jo Teknike (%)	4.66%	4.15%	6.13%	4.21%	4.68%	3.22%	3.96%	2.31%	2.21%	6.75%	6.20%	7.01%	4.73%
Energji e Totale Shitur nga FSHU Sh.a	571,139	525,006	474,453	430,091	390,216	437,597	500,479	506,978	418,082	427,018	468,580	581,415	5,731,054
Energji per klientet e dal ne treg te parregulluar-FTL	35,716	39,421	36,698	27,994	28,600	34,770	38,278	35,725	33,344	36,936	35,373	42,777	425,633
Energji per klientet e dal ne treg te parregulluar-Fumizues te tjerë	12,770	12,389	12,849	13,130	13,723	15,521	17,424	16,351	15,131	14,184	14,168	15,026	172,666
Demi Ekonomik (aplikimi vendimit te ERE 232/2019)	100	299	243	8	167	3,155	469	302	204	289	775	358	6,368
Energji e injektuar ne OST nga Hec-et ne rrjetin e OSSH	68,728	29,685	62,018	77,682	50,190	22,693	16,246	14,434	13,331	21,191	77,067	57,964	511,229

Figura 23. Struktura e shitjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a.

1.4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike

Konsumi total vjetor i energjisë elektrike në vend përbëhet nga konsumi i klientëve në tregun e rregulluar dhe konsumi i klientëve në tregun e pa rregulluar. Për vitin 2025, konsumi total i energjisë elektrike në vendin tonë arriti në 8,345 GWh.

Konsumi total për periudhën 10 vjeçare nga viti 2016 deri në vitin 2025, paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:




Figura 24. Konsumi i energjisë elektrike në Shqipëri (MWh) për periudhën 10 vjeçare 2016-2025

Siç vërehet në paraqitjen grafike, konsumi më i ulët i energjisë elektrike i regjistruar në vendin tonë për këtë 10 vjeçar është viti 2016, me 7,094 GWh, ndërsa konsumi më i lartë i energjisë elektrike vijon të mbetet ai i regjistruar në vitin 2021, me 8,414 GWh. Konsumi total i realizuar për vitin 2025 është 8,345 GWh, që rezultojnë të jetë 174,539 MWh ose 2.1% më i lartë se konsumi i arritur përgjatë vitit 2024. Konsumi i energjisë elektrike për vitin 2025 krahasuar me konsumin e vitit 2021, i cili është dhe konsumi maksimal i arritur në Shqipëri, rezultojnë më i ulët, në sasinë 69,779 MWh ose rreth 0.8% më pak. Në të njëjtën kohë, konsumi total i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2025, është rreth 6.4 % më i lartë se konsumi mesatar vjetor 10 vjeçar i pasqyruar në tabelë.

Konsumi total i energjisë elektrike në vend përgjatë vitit 2025 është mbuluar nga gjenerimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a., prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike, prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, si dhe nga importi i realizuar në tregun rajonal të energjisë elektrike.




Figura 25. Konsumi i energjisë elektrike në Shqipëri (MWh) për periudhën 10 vjeçare 2016-2025

Në tabelën e mësipërme evidentohet prodhimi neto vendas dhe balanca import – eksport. Sikurse paraqitet në të dhënat e mësipërme, prodhimi neto vendas për vitin 2025 rezulton të jetë 7,467 GWh, ndërkohë që konsumi total i vendit rezulton të jetë 8,345 GWh, me një balancë neto në drejtimin import 877 GWh.

Balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për vitin 2025 prej 877 GWh (hyrje), rezulton si diferencë e eksportit të realizuar në sasinë prej 2,498 GWh dhe importit të realizuar në vlerën 3,375 GWh. Kjo për faktin se sistemi elektroenergetik shqiptar e bazon prodhimin e energjisë elektrike në burimet hidrike, ku për periudhat me reshje arrin të eksportojë energji elektrike dhe në periudhat e thata gjatë vitit realizon import të energjisë elektrike për të mbuluar kërkesën në vend, thënë ndryshe profili i prodhimit në vendin tonë nuk përkon gjithmonë për të njëjtat periudha me profilin e konsumit në vend, gjë për të cilën do të kontribuonte pozitivisht diversifikimi i burimeve gjeneruese të energjisë elektrike.

1.4.3 Struktura e konsumit të energjisë elektrike 2025

Struktura e konsumit të energjisë elektrike në vendin tonë vijon të bazohet për nga numri që ata zënë në konsumatorë familjarë, jofamiljarë.



Figura 39. Numri i klientëve familjarë, jo familjarë dhe total në OSSH sh.a për vitin 2025

Të dhënat e paraqitura më sipër për vitin 2025 tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve për këtë vit është 1,377,204 dhe pjesën më të madhe të klientëve e furnizon FSHU sh.a., ku përqindjen më të madhe e zënë klientët familjarë, rreth 85% të numrit total të klientëve të FSHU sh.a.

Në shpërndarjen demografike të klientëve të FSHU sh.a. për vitin 2025 pjesa më e madhe është në Tiranë, me rreth 28% të të gjithë klientëve që ka FSHU sh.a duke ruajtur pothuajse të njëjtën vlerë me atë të vitit 2024.

Struktura e klientëve të FSHU sh.a. reflektohet edhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2025. Klientët familjarë zënë pjesën më të madhe në FSHU sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2025, ose rreth 52 % të të gjithë faturimit të realizuar për vitin 2025.




Figura 26. Raportet e faturimit sipas kategorive të klientëve gjatë vitit 2025

(Burimi: FSHU sh.a.)

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve konsumit total të energjisë elektrike në vend.




Figura 27. Konsumi i klientëve fundorë që shërbehen nga FSHU sh.a., kundrejt konsumit total në vend për vitet 2024 – 2025 (GWh)

Rritja e konsumit të energjisë elektrike në vend reflekton një zgjerim të moderuar të kërkesës për energji elektrike, që mund të lidhet me rritjen e aktivitetit ekonomik, shtimin e konsumit familjar apo zgjerimin e aktiviteteve të bizneseve.

Kategoria e konsumit familjar vazhdon të zërë pjesën më të madhe të konsumit të energjisë elektrike. Në vitin 2024, familjet konsumuan 3,408 GWh, ndërsa në vitin 2025 ky konsum u rrit në 3,640 GWh ose me rreth 6.3%.

Në sektorin e furrave të bukës dhe prodhimit të produkteve të miellit vërehen ndryshime të dukshme ndërmjet kategorive. Kategoria I, shënoi një ulje të konsiderueshme të konsumit nga 31.36 GWh në vitin 2024 në 16.13 GWh në vitin 2025. Nga ana tjetër, Kategoria II, shënoi rritje konsumi nga 29.85 GWh në 43.21 GWh. Po ashtu, edhe Kategoria III, regjistron një rritje nga 12.19 GWh në 17.37 GWh.

Sa i përket objekteve të kultit dhe bashkësive fetare, konsumi i energjisë elektrike mbetet pothuajse i pandryshuar. Në vitin 2024 ai ishte 5.79 GWh, ndërsa në vitin 2025 arriti në 5.88 GWh, duke treguar një stabilitet në këtë kategori.

Konsumi i konsumatorëve jo familjarë gjithashtu ka shënuar rritje, nga 1,419 GWh në vitin 2024 në 1,517 GWh në vitin 2025. Ky zhvillim mund të lidhet me rritjen e aktivitetit të sektorit privat, zgjerimin e bizneseve dhe rritjen e kërkesës për energji elektrike në sektorët ekonomikë.

Ndërkohë, ambientet e përbashkëta private shënuan një ulje të lehtë të konsumit nga 7.20 GWh në vitin 2024 në 7.09 GWh në vitin 2025, duke treguar një ndryshim minimal në këtë kategori.

Niveli i Tensionit	Grupet e Klienteve	Nr. i fat	Çmimi (Lek/kWh)			Sasia e energjive të faturuar				Te ardhurat nga energjia e faturuar			
			Aktive	Reaktive	Ne Pik	Aktive (kWh)	Reaktive (kVAh)	Ne Pik (kWh)	Demi Ekonomik (kWh)	Aktive (Lek)	Reaktive (Lek)	Ne Pik (Lek)	Demi Ekonomik (Lek)
Tension Ulet	Kategoria I-Vetem Furra Buke/ prodhim mielli	577	7.60	1.14	8.74	16,132,527	966,783	514,372	-	122,607,205	1,856,234	4,495,611	-
	Kategoria II-Vetem Furra Buke, produkte mielli shoqeruese, pasteci	877	9.50	1.92	10.93	43,209,031	483,052	1,260,400	-	410,485,795	927,459	13,776,172	-
	Kategoria III-Vetem Furra Buke, Produktet Mielli shoqeruese, Pasteci,sherbim Kafes ekopes)	279	12.00	1.92	13.80	17,369,108	407,378	858,259	-	208,429,296	782,165	11,843,974	-
	Objekte fetare TU	1,160	9.50	1.92	9.50	5,881,417	43,264	179,728	-	55,873,462	83,067	1,709,682	-
	Konsumator jo familjar	186,228	14.00	1.92	16.10	1,857,006	94	33,184	-	25,971,602	180	534,262	-
	Ambjentet e Përbashkëta private					7,086,574	-	-	-	67,322,403	-	-	-
	Kliente të lidhur në TU (jo familjare)	189,121				1,547,192,281	38,274,459	59,346,490	-	21,268,877,184	73,484,022	941,782,903	-
	Familjare	36,599	9.50			1,145,505,874	-	-	-	10,881,219,796	-	-	-
	Familjare	1,143,413	8.50			2,390,861,566	380	-	-	20,322,931,022	730	-	-
	Ambjente të Përbashkëta Familjare	-	9.50			104,113,841	-	-	-	989,081,490	-	-	-
	Familjare	1,180,012				3,640,481,281	-	-	-	32,193,232,307	730	-	-
	Total në TU	1,369,133				5,187,673,562	38,274,459	59,346,490	-	53,462,109,490	73,484,752	941,782,903	-
	Sherbime fikse të tarifuar për konsumin "0 kWh"					-	-	-	-	676,253,000	-	-	-
	Total i shërbimit me tarifë fikse					-	-	-	-	676,253,000	-	-	-
	SHUMA	1,369,133				5,187,673,562	38,274,459	59,346,490		54,138,362,490	73,484,752	941,782,903	
	në konsumatorëve FSHU sh.a. dhe struktura shitjes së OSHI sipas Bilancit të Energjisë					5,247,020,052				66,184,356,174			

Figura 28. Struktura e shitjes së energjisë elektrike për grup konsumatorësh “FSHU” sh.a.

1.4.4 Profili i konsumit të energjisë elektrike gjatë vitit 2025

Përgjatë vitit 2025 konsumi më i lartë i energjisë elektrike në vend u arrit në muajin dhjetor duke kapur vlerën 804,442 MWh. Në këtë muaj piku i ngarkesës u arrit më datë 31 në orën 18:00 (1,910 MWh) ndërsa minimumi i ngarkesës ishte më datë 1 ora 04:00 (532 MWh). Konsumi më i ulët i energjisë elektrike në vend u arrit në muajin Maj duke shënuar vlerën 530,318 MWh. Gjatë këtij muaji piku i ngarkesës u arrit më datë 21 në orën 18:00 (981 MWh) ndërsa minimumi i ngarkesës ishte më datë 26 ora 04:00 (470 MWh). Më poshtë paraqiten të dhënat me bazë orare të ngarkesës minimale, maksimale dhe mesatare për muajin Dhjetor dhe Maj.

Treguesit e ngarkesës maksimale dhe minimale të arritur përgjatë vitit 2025, sikurse dhe konsumi minimal dhe maksimal i arritur përgjatë vitit tregojnë për një profil ngarkese dhe konsumi të luhatshëm në mënyrë të ndjeshme në vendin tonë.




Figura 29. Profili me bazë orare dhe piku/minimumi i ngarkesës për muajin dhjetor 2025 (MWh)




Figura 30. Profili me bazë orare dhe piku/minimumi i ngarkesës për muajin maj 2025 (MWh)

1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike të furnizuar, shitur dhe humbur, për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2025

Më poshtë paraqiten të dhënat lidhur me treguesit e energjisë elektrike të furnizuar, shitur dhe të humbur (në MWh), për çdo zonë dhe agjenci të OSSH sh.a. gjatë vitit 2025.

Drejtoria Rajonale/Agjensia	2025			
	Energjia e hyrë MWh	Energjia e shitur MWh	Humbjet MWh	Humbjet në %
Tirana1	1,083,969	954,678	129,292	11.9%
Tirana2	996,278	913,450	82,828	8.3%
Tirana3	751,422	671,461	79,960	10.6%
Dr. Rajonale Tiranë	2,831,669	2,539,589	292,080	10.3%
Durres	468,903	407,339	61,564	13.1%
Kavaje	201,761	174,813	26,947	13.4%
Kruje	160,893	121,374	39,519	24.6%
Shijak	195,174	158,103	37,071	19.0%
Dr. Rajonale Durrës	1,026,732	861,630	165,102	16.1%
Ballsh	45,570	40,736	4,833	10.6%
Fier	424,492	382,550	41,941	9.9%
Patos	87,789	75,934	11,855	13.5%
Dr. Rajonale Fier	557,850	499,221	58,630	10.5%
Elbasan	376,813	333,862	42,952	11.4%
Gramsh	27,496	24,132	3,364	12.2%
Librazhd	78,265	65,858	12,407	15.9%
Peqin	53,056	40,529	12,528	23.6%
Dr. Rajonale Elbasan	535,631	464,380	71,251	13.3%
Bilisht	38,313	33,105	5,208	13.6%
Kolonje	21,751	19,739	2,011	9.2%
Korce	266,033	226,781	39,252	14.8%
Pogradec	86,817	78,602	8,215	9.5%
Dr. Rajonale Korçë	412,913	358,227	54,686	13.2%
Delvine	18,419	15,744	2,675	14.5%
Gjirokaster	115,121	95,518	19,603	17.0%
Permet	24,113	20,836	3,277	13.6%
Saranda	169,229	146,666	22,563	13.3%
Tepelene	32,181	23,233	8,948	27.8%
Dr. Rajonale Gjirokastrë	359,063	301,997	57,066	15.9%
Koplik	83,943	44,431	39,512	47.1%
Lezhe	205,398	149,640	55,758	27.1%
Puke	27,599	16,379	11,219	40.7%
Shkoder	451,552	317,570	133,981	29.7%
Dr. Rajonale Shkodër	768,492	528,021	240,471	31.3%
Berat	133,997	115,740	18,257	13.6%
Kuçove	73,752	64,354	9,398	12.7%
Lushnje	221,503	186,026	35,477	16.0%
Skrapar	36,639	31,288	5,351	14.6%
Dr. Rajonale Berat	465,891	397,408	68,483	14.7%
Has	37,520	21,461	16,060	42.8%
Kukes	125,092	81,161	43,930	35.1%
Tropoje	78,135	39,699	38,436	49.2%
Dr. Rajonale Kukës	240,747	142,321	98,426	40.9%
Bulqize	57,815	50,291	7,524	13.0%
Diber(Peshkopë)	90,150	66,879	23,272	25.8%
Lac	242,939	175,108	67,831	27.9%
Mat (Burrel)	70,903	56,882	14,021	19.8%
Mirdite	67,270	51,838	15,432	22.9%
Dr. Rajonale Burrel	529,077	400,998	128,079	24.2%
Himare	52,462	47,479	4,983	9.5%
Selenice	47,245	23,023	24,222	51.3%
Vlore	317,584	282,654	34,930	11.0%
Dr. Rajonale Vlorë	417,292	353,157	64,135	15.4%

Tabela 18. Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo agjenci të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2025




Figura 31. Shpërndarja e furnizimit me energji elektrike sipas drejtorive rajonale për vitin 2025 (në %)

Sikurse evidentohet edhe në figurë, pjesën më të madhe të konsumit të energjisë elektrike në vend për vitin 2025 vijon ta zëjë Drejtoria Rajonale Tiranë me 35%, ndërkohë që pjesën më të vogël të konsumit vijon edhe për këtë vit që ta kenë sërish Drejtoritë Rajonale Kukës me 2,96 % dhe Gjirokastrë me 4%.

1.4.6 Humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes.




Figura 32. Humbjet mujore në sistemin e shpërndarjes për vitet 2024 dhe 2025, krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike për vitin 2025

Në tabelën e mësipërme jepet një krahasim i nivelit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, me targetat e vendosura në VKM-në nr. 758, datë 09.12.2021, “Për një ndryshim në vendimin nr.

253, datë 24.04.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik”.

Sikurse evidentohet, humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes të raportuara nga OSHEE sh.a. për vitin 2025 janë 16.96 %, me një diferencë prej 0,97 % me vitin 2024 dhe 1.14% më të ulta se targeti i vendosur në VKM-në nr. 758, datë 09.12.2021, “Për një ndryshim në vendimin nr. 253, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik”. Targeti i humbjeve të vendosura në VKM 758/2021 për vitin 2025 është 18.1 %.

Më poshtë paraqiten në mënyrë të detajuar humbjet totale për periudhën 10-vjeçare 2016-2025 në sistemin e shpërndarjes dhe të ndara sipas humbjeve teknike dhe joteknike.




Figura 33. Humbjet vjetore në sistemin e shpërndarjes për periudhën 2016-2025
(Burimi: OSSH sh.a.)




Figura 34. Grafiku i humbjeve vjetore (teknike dhe joteknike) në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2016-2025
(Burimi: OSSH sh.a.)




Figura 35. Humbjet totale të energjisë elektrike në sistemin Elektroenergjetik OST sh.a + OSSH sh.a kundrejt konsumit vendas për periudhën 2016-2025

Në figurën e mësipërme paraqitet ecuria e humbjeve totale të energjisë elektrike, e cila përfshin humbjet në sistemin e shpërndarjes edhe ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 10-vjeçare 2016 – 2025. Të dhënat tregojnë se humbjet e energjisë elektrike në vlera absolute kanë përgjithësisht trend zbritës dhe ky trend ka vijuar edhe për vitin 2025. Për vitin 2025, humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit janë 1,592 GWh. Krahasuar me vitin 2024, vihet re një ulje e humbjeve totale të energjisë elektrike me 22 GWh. Në të njëjtën kohë, duhet evidentuar fakti se rritja e konsumit të energjisë elektrike për vitin 2025, krahasuar me vitin 2024, shkon në rreth 175 GWh më shumë.

Bazuar në të dhënat e mësipërme të tabelave dhe informacioneve periodike apo specifike të operatorëve të tregut të energjisë, është ndërtuar Bilanci Energjetik për vitin 2025 si më poshtë:




Figura 36. Bilanci Elektroenergjetik i vitit 2025 sipas raportimeve të OST sh.a., dhe OSSH sh.a.

Krahasimi i bilancit energjetik të vitit 2025 me atë të vitit 2024, evidenton disa zhvillime të rëndësishme në strukturën e prodhimit të energjisë elektrike, në mënyrën e furnizimit të tregut dhe në balancën e përgjithshme të sistemit elektroenergjetik në vend. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025 sistemi energjetik ka operuar duke reflektuar ndryshime, si në nivelin e konsumit të

energjisë ashtu edhe në kontributin e prodhimit vendas dhe në përdorimin e tregut rajonal të energjisë për balancimin e kërkesës. Nga analiza e konsumit total rezulton se në vitin 2024 kërkesa për energji elektrike në Shqipëri ka qenë rreth 8,170 GWh, ndërsa në vitin 2025 kjo vlerë rezulton të jetë rreth 8,345 GWh. Kjo tregon një rritje të moderuar të konsumit, me rreth 174,5 GWh ose afërsisht 2.1% krahasuar me vitin pararendës. Rritja e kërkesës për energji elektrike lidhet kryesisht me zgjerimin gradual të tregut të energjisë dhe rritjen e numrit të konsumatorëve aktivë në sistem me rreth 2%. Megjithatë, ritmi i rritjes mbetet relativisht i qëndrueshëm dhe në linjë me tendencat e viteve të fundit të kërkesës për energji elektrike në vend. Një ndryshim i rëndësishëm midis dy viteve konstatohet në strukturën e prodhimit vendas të energjisë. Në vitin 2024 prodhimi neto vendas rezulton rreth 7,836 GWh, kundrejt 7,467 GWh për vitin 2025, duke mbuluar pjesën më të madhe të kërkesës së brendshme për energji. Ky nivel relativisht i lartë i prodhimit vendas lidhet kryesisht me kontributin e hidrocentraleve publike dhe atyre koncesionare, të cilat përbëjnë bazën e sistemit elektroenergjetik shqiptar. Nga struktura e bilancit energjetik rezulton se prodhimi vendas ka qenë relativisht më i ulët. Kjo diferencë shpjegohet kryesisht me variacionet hidrologjike që ndikojnë drejtpërdrejtë në prodhimin hidroenergjetik, duke qenë se sistemi energjetik shqiptar mbetet në një masë të konsiderueshme i varur nga burimet hidrike. Në të dy vitet evidentohet gjithashtu, roli në rritje i prodhuesve privatë dhe i burimeve të rinovueshme në strukturën e prodhimit të energjisë. Bilanci energjetik i vitit 2025, evidenton një kontribut të shtuar nga prodhimi fotovoltai, çka tregon vijimin e një diversifikimi gradual të burimeve të prodhimit të energjisë në vend. Në vitin 2025 kjo tendencë vazhdon të konsolidohet, duke reflektuar zhvillimet në investimet në energjitë të rinovueshme dhe zgjerimin gradual të kapaciteteve të prodhimit nga burime alternative, edhe pse hidrocentralet vazhdojnë të përbëjnë burimin dominues të prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri. Në vitin 2024 energjia e siguruar nga FTL sh.a. rezulton rreth 2,596 GWh, duke përfshirë energjinë e blerë nga prodhuesit privatë, nga centralet në rrjetin e transmetimit dhe nga tregu i liberalizuar i energjisë. Në vitin 2025, sipas strukturës së bilancit energjetik, energjia e siguruar nga FTL rezulton 2,311 GWh ose rreth 285 GWh më pak.

Në tërësi, krahasimi i bilancit energjetik të viteve 2024 dhe 2025, tregon se sistemi elektroenergjetik shqiptar vazhdon të karakterizohet nga një varësi e konsiderueshme nga prodhimi hidroenergjetik, çka e bën atë të ndjeshëm ndaj kushteve hidrologjike dhe variacioneve sezonale të prodhimit. Në të njëjtën kohë, evidentohet një tendencë e qartë drejt diversifikimit gradual të burimeve të prodhimit, rritjes së rolit të prodhuesve privatë dhe integritit më të madh të tregut vendas të energjisë me tregun rajonal. Këto zhvillime përbëjnë një element të rëndësishëm në procesin e transformimit të sektorit energjetik në Shqipëri, në drejtim të rritjes së sigurisë së furnizimit, eficiencës së sistemit dhe zhvillimit të një tregu më konkurrues të energjisë elektrike.

1.4.7 Siguria operative e rrjetit, si dhe masat e marra për garantimin e furnizimit me energji elektrike dhe sigurisë së sistemit brenda të gjithë kufijve operativë, përfshirë sistemet primare dhe ato sekondare

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas, si dhe zhvillon rrjetin e shpërndarjes në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe kërkesën për energji elektrike.

Për të siguruar një furnizim të pandërprerë dhe me cilësi, si dhe për të rritur sigurinë e sistemit nga ana e OSSH-së është raportuar se janë marrë një sërë masash teknike të paraqitura më poshtë:

- Rritje të fuqisë së instaluar në N/Stacione;
- Ndërtim i N/Stacioneve të reja;
- Përmirësime skemash dhe kalim gradual të rrjetit 6,10 kV në rrjetin 20 kV;

- Rikonstruksione të thella me zëvendësimin e pajisjeve të vjetra (instalime që nga viti 1960) të amortizuara me pajisje të reja;
- Montim të pajisjeve komutuese 110/35 kV aty ku nuk ka patur apo ku kanë qenë jashtë funksionit;
- Rikonstruksione të plota të linjave 35 kV (zëvendësim shtyllash, izolacioni dhe përcjellësi);
- Tokëzimin e neutrit, në anën e 20kV, të transformatorëve 110/20 kV në të gjitha nënstationet;
- Eliminimin e një niveli tensioni aty ku është e mundur në rastet e N/st me më shumë se 3 nivele tensioni.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten ndërhyrjet në nënstatione dhe linjat 35 kV të përfunduara në vitin 2025, dhe atë që kanë nisur dhe janë ende në zbatim të cilat kanë synim përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, rritjen e sigurtisë dhe të cilësisë së furnizimit me energji elektrike si dhe reduktimin e humbjeve.

NR.	Projekti Emërtimi	Vlera e punimeve të kontraktuara	Shënime
1	Ndërtimi i nënstationit të Ri Velipojë 110/35/20 kV, 2x20/25 MVA	438,746,692.54	Përfunduar
2	Ndërtim nënstationit të Ri Fier 2 110/20 kV, 2x40/50 MVA	593,981,950.20	Në zbatim
3	Fuqizimi i nënstationit Pogradec 110/35/10 kV në 110/35/10/20 kV, 1x110/20/10 kV, 20/25 MVA dhe 1x110/35/10 kV, 20/25 MVA	346,823,233.18	Përfunduar
4	Rikonstruksion dhe fuqizim i nënstationit Kuçovë 110/35/20/10/6kV, 1x110/35/20 kV, 20/25 MVA; 1x110/35/6 kV, 20/25 MVA; 1x110/10/6 kV, 20/25 MVA	630,484,449.23	Përfunduar
5	Rikonstruksion dhe fuqizim i nënstationit Çorovodë e Re 110/35/10 kV, 1x110/35/10 kV, 31.5 MVA	148,419,628.20	Përfunduar
6	Rikonstruksion i nënstationit Lezhë nga 110/10 kV në 110/20/10 kV, 1x110/20/10 kV, 40/50 MVA	205,895,768.61	Përfunduar
7	Fuqizimi i nënstationit 110/20 kV Zogu i Zi (2x40/50) MVA	627,480,498.74	Përfunduar
8	Rikonstruksion dhe fuqizim i nënstationit Kafaraj 110/35/6 kV, (2x40/50) MVA	704,711,651.02	Në zbatim
9	Ndërtimi i nënstationit të ri Akëmi 110/35/20 kV, dhe zhvillimi i linjës 35 kV Akëmi-Aeroporti i Vlorë (1x20/25 kV)	493,379,151.12	Në zbatim
10	Ndërtim i nënstationit të ri Xarë 110/20/10 kV (2 x 20/25 MVA)	588,901,086.90	Në zbatim
11	Ndërtim i nënstationit të ri Piqeras 110/20/10 kV (1 x 20/25 MVA)	399,998,125.60	Në zbatim
12	Zhvillimi i linjës me dy qarqe 35 kV (me izolacion 110 kV), nënstationit Kafaraj Fier – Hoxharë (traseja e linjës ekzistuese 35 kV)	562,086,238.78	Në zbatim
13	Ndërtimi i linjës 35 kV nënstationet 220 kV Elbasan-Mjekës-Cërrujë-Gramsh	587,699,112.00	Në zbatim
14	Ndërtim i linjës 35 kV N.St Koplik 220kV – N.St Vukpalaj me dy qarqe	299,800,000.00	Në zbatim
15	Ndërtim i linjës së re 35 kV N.St Vukpalaj - Tamare, dhe N.stacion i ri 35/10 kV në Tamare	449,800,000.00	Në zbatim

Tabela 19. Projektet e përfunduara përgjatë vitit 2025 dhe ato në zbatim në sistemin e shpërndarjes.

Projektet e investimit në rrjetin e shpërndarjes përfshijnë projekte të përfunduara përgjatë vitit 2025, ashtu edhe projekte që janë aktualisht në zbatim, me qëllim rritjen e kapaciteteve të transformimit dhe përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike. Këto projekte konsistojnë kryesisht në rikonstruksionin dhe fuqizimin e nënstacioneve ekzistuese, ndërtimin e nënstacioneve të reja si dhe zhvillimin e linjave të reja 110/35/20/10 kV në Velipojë, Pogradec, Kuçovë, Çorovodë e Re, Lezhë, dhe Kafaraj, Akëri, Xarë, Piqeras, Elbasan - Gramsh, Koplik dhe Tamarë, të cilat lidhin nënstacionet ekzistuese dhe të reja, duke përmirësuar kapacitetin e transmetimit dhe besueshmërinë e rrjetit.

1.4.8 Kapacitetet transmetuese dhe transformuese në sistemin e shpërndarjes të energjisë elektrike.

Rritja e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese ka qenë ndër prioritetet e OSSH sh.a përgjatë vitit 2025. Kjo është realizuar nëpërmjet ndërhyrjeve për ndërtimin e nënstacioneve të reja, apo fuqizimit të atyre ekzistuese, si dhe ndërhyrjeve në rehabilitimin e linjave 35 kV.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet rritja e fuqisë së instaluar për periudhën 2015-2025:

Viti	2015	2016	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
S totale e instaluar (MVA)	3041.35	3454.65	3574.15	3609.4	3683.35	3833	3911.2	4075.2	4150.8

Figura 37. Fuqia e instaluar në MVA për vitet 2015-2025 në sistemin e shpërndarjes

Grafiku paraqet ecurinë e fuqisë totale të instaluar (MVA) ndër vite, duke reflektuar investimet e vazhdueshme të kompanisë për rritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese. Nga të dhënat vërehet një trend në rritje të fuqisë së instaluar, që lidhet drejtpërdrejtë me ndërtimin e nënstacioneve të reja, fuqizimin e nënstacioneve ekzistuese dhe rehabilitimin e linjave 35 kV.

Ndërhyrjet e realizuara nga ana e OSSH sh.a., kanë kontribuar në përmirësimin e kapacitetit të rrjetit të shpërndarjes për të përballuar kërkesën në rritje për energji elektrike, duke rritur njëkohësisht sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit. Rritja e fuqisë së instaluar ndër vite tregon për një zhvillim gradual të infrastrukturës së shpërndarjes, në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe nevojat e konsumatorëve për energji elektrike.

Krahasuar me vitin 2024, në vitin 2025 vërehet një rritje e fuqisë totale të instaluar. Në vitin 2024, fuqia e instaluar ishte 4075.2 MVA, ndërsa në vitin 2025 arriti në 4150.8 MVA, duke shënuar një rritje prej 75 MVA. Rritja e fuqisë me rreth 75 MVA brenda vitit 2025 ka bërë një sistem më të sigurt dhe më fleksibël, duke i paraprirë dhe perspektivës së rritjes së ngarkesës në të ardhmen.

1.4.9 Parashikimi i investimeve, që planifikohen të realizohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

Nisur nga kushtet e temperaturave të ulta gjatë sezonit të dimrit apo temperaturave të larta gjatë sezonit turistik veror, krahas masave të marra nga ana e operatorit të shpërndarjes për tejkalimin e tyre në kushte emergjence, janë konstatuar disa nyje kritike që kanë nevojë për ndërhyrje të domosdoshme më konkretisht:

- ***Zhvillimi i rrjetit 20 kV i cili do të lidhet me nënstacionet 110/35/20 kV Orikum dhe 110/35/20 kV Himarë***

OSSH sh.a raporton si domosdoshmëri kalimin nga tensioni 10 kV në tensionin 20 kV, pra energjizimin e fiderave 20 kV dhe kabinave të transformimit 20/0.4 kV, gjë që jep një impakt pozitiv në furnizimin e pandërprerë të të gjithë zonës bregdetare të Jugut, duke realizuar një skemë elastike 20 kV dhe mirëfilli të komutueshme edhe në raste avarish. Ekzistojnë të gjitha kapacitetet e duhura teknike, mbajtëse dhe transmetuese, për qëllimin në fjalë. Realizimi i skemës me tension

20 kV sjell një impakt tjetër pozitiv pasi shmang përfundimisht domosdoshmërinë për funksionimin e nënstacionit Mobile 35/10 kV që aktualisht ndodhet në Borsh. Një pjesë e ngarkesës tashmë është kaluar në rrjetin 20 kV dhe duhet të vijohet me punimet për zhvillimin e rrjetit 20 kV.

- **Zhvillimi i rrjetit 20 kV në zonën e Velipojës**

Me ndërtimin e nënstacionit të ri 110/35/20 kV në zonën e Velipojës, është i nevojshëm kalimi i ngarkesave në 20 kV me furnizim nga nënstacioni i ri. Aktualisht punimet në këtë nënstacion janë përfunduar dhe për energjizimin e tij pritet përfundimi i punimeve në linjën 110 kV Bushat i ri - Velipojë nga ana e OST sh.a. Ky nënstacion do të shërbejë për furnizimin e zonës bregdetare të Velipojës si dhe për uljen e ngarkesës në linjën 35 kV Shkodra 2 – Velipojë – Hidrovor Vilu.

- **Rikonstrukcion dhe fuqizim i linjës 35 kV Bistrica II – Delvinë**

Linja L30-23 “Bistrica II - Delvinë” furnizohet nga HEC “Bistrica II”.

Kjo linjë ka një numër të konsiderueshëm shtyllash centrifugale në një gjendje të rëndë teknike (krahët e shtyllave me beton të thërrmuar) me izolacion të dobët nga ana 35 kV (izolatorë varës) si edhe gjendja teknike e përcjellësave lë për të dëshiruar.

Linja L30 - 23 “Bistrica II - Delvinë” është 6.2 km dhe furnizon në skemë fundore n/stacionin Delvinë, herë pas here, shfaq avari për arsyet e sipërcituara, duke ndikuar negativisht në performancën e OSSH.

Në rrethin Delvinë priten zhvillime urbanistike të rëndësishme, të cilat do të kërkojnë domosdoshmërisht garantimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike, mbështetur gjithashtu edhe në rritjen e ngarkesave në vlerat 3%, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se kapacitetet transmetuese të HEC “Bistrica 2”, nga ana 35 kV, nuk përballon rritjen e ngarkesës që parashikohet, ndaj si ndërhyrje e domosdoshme, duhen marrë masa për:

- Rikonstrukcion kapital, fuqizimin, i linjës ajrore 35 kV dhe konkretisht ndërtimi i linjës së re me izolacion 110 kV.

Rikonstrukcioni do të sjellë një impakt pozitiv lidhur me uljen në minimum të numrit të avarive dhe furnizimin e pandërprerë me energji të konsumatorëve.

- **Fuqizim i nënstacionit “Kashar” 110/20 kV.**

Nënstacioni ekzistues 110/20 kV “Kashar” aktualisht ka të instaluar tre transformatorë fuqie me nivel tensioni 110/20 kV; 3x (1x40) MVA, i cili konsiderohet një nënstacion i një rëndësie të veçantë për numrin e konsiderueshëm të fiderave dalës 20 kV, që furnizojnë ndër të tjera konsumatorët industrial që shtrihen përgjatë autostradës Tiranë – Durrës, si dhe ndikon ndjeshëm në paralelizimin me fiderat e tjerë 20 kV që dalin nga nënstacionet e tjera si “Tirana 1 220 kV”, “Selitë”, “Qendër”, “Vorë” dhe në të ardhmen me nënstacionin e ri “Valias”, që është në fazë ndërtimi.

Duke pasur parasysh zhvillimet e mëtejshme infrastrukturore dhe urbanistike në zonë, përmirësimin e rrjetit shpërndarës 20 kV duke ndikuar në rishpërndarjen e ngarkesave 20 kV, OSSH sh.a. ka parashikuar ndërhyrjen e domosdoshme për:

- Montimin e një transformatori të ri fuqie 110/20 kV; 40/50 MVA me traktin e plotë nga ana 110 kV;
- Ndërtimin e një sale të re 20 kV, në vazhdim të sallës ekzistuese si dhe kompletimin e saj me çela të reja 20 kV.

Montimi i transformatorit të sipërcituar, përveç një impakti pozitiv në rritjen e kapaciteteve mbajtëse nga ana 20 kV të vetë nënstacionit, do të sjellë rritjen e kapaciteteve transmetuese, daljen

e fiderave të rinj 20 kV, si dhe rishpërndarjen e ngarkesave ekzistuese nga ana 20 kV në zonë, zvogëlimin e gjatësive të fiderave si dhe uljen e ngarkesave duke krijuar mundësi të reja komutuese në paralelizimin e fiderave mes njëri-tjetrit edhe në raste avarish. Një investim i tillë ndikon ndjeshëm edhe në unazimet (pikat e paralelit) mes fiderave dalës nga nënstacionet “Tirana 1,220 kV” dhe “Selitë”; “Kombinat (Qelq)” dhe “Sallmone”.

- **Rikonstruksioni dhe fuqizimi i nënstacionit 110/35/20/6 kV Shkozë, Durrës.**

Ky projekt ka si qëllim fuqizimin e nënstacionit 110/35/20/6 kV Shkozë, duke i paraprirë fazës së parë të projekteve turistike në qytetin e Durrësit, duke qenë edhe nënstacioni kryesor i furnizimit me energji elektrike të këtij qyteti duke përfshirë:

- Impiant i ri 20 kV për të gjitha seksionet;
- Demontim i të gjithë portaleve të jashtëm 35 kV dhe zëvendësimi me çela të reja të brendshme 40.5 kV;
- Instalim i të gjithë impianteve shpërndarëse TM, 35/20/6 kV;
- Izolacion i impiantit 6 kV i njëjtë me atë të 20 kV;
- Panelet e rinj të mbrojtjes, kontrollit, komandimit për transformatorët e fuqisë, trakteve 110 kV të transformatorëve, si dhe atyre TM 35/20/6 kV;
- Ndërtimi i godinës së re të shërbimeve, demontimi i portaleve 35 kV dhe atyre 20 kV jashtë pune, demontimi i godinës ekzistuese;
- Zëvendësimi i traktit të jashtëm 35kV në impiant të brendshëm, daljet kabllore 35 kV deri tek shtyllat e para për linjat 35 kV: Fllakë, Kavajë, Shijak dhe Durrës.

- **Rikonstruksion dhe fuqizim i nënstacionit 110/20/6 kV Shkodra-1.**

Nënstacioni 110/20/6 kV Shkodra – 1, furnizohet me dy linja 110 kV, L1 - 110 – 19 Rrenc – V. Dejës dhe L2 – 110-8/2 Shkodra – 2, gjendja e të cilit është amortizuar. Fuqizimi i këtij nënstacioni lind si domosdoshmëri e zhvillimit të vrullshëm që ka qyteti i Shkodrës dhe rritjen dhe sigurinë e kapaciteteve furnizuese të konsumatorëve që ka ky nënstacion.

Për këtë arsye është projektuar rikonstruksioni dhe fuqizimi i këtij nënstacioni me transformator të ri fuqie 110/20 kV 40 MVA, seksion të ri 20 kV, panele të rinj mbrojtje, kontrolli, komandimi, si për traktet e linjës, ashtu edhe për ato të transformatorëve të fuqisë, panele matje, kontroll monitorim lokal, punime civile rikonstruksion i ndërtesës ekzistuese, bazamente për pajisjet e fuqisë, sheshi i nënstacionit etj.

Fuqizimi i nënstacionit 110/20/6 kV Shkodër do të përmbajë:

- Transformatorë fuqie, 40 MVA, 110/20kV.

Impianti TM 20kV:

- çela kryesore TR fuqie, 24 kV të kompletuara me matje/mbrojtje;
- çela matje 24 kV të kompletuara me matje/mbrojtje;
- çelë seksionimi, 24 kV, e kompletuar;
- çelë N.V. 24 kV, e kompletuar;
- çela 24 kV, të kompletuara me matje/mbrojtje;
- Panele të rinj të kompletuar, kontrolli, komandimi, matje;
- Shërbimet ndihmëse etj.

1.4.10 Asetet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna mbi asetet në administrim nga OSSH sh.a. për vitin 2025, si nënstationet, linjat, kabinat dhe transformatorët në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Të dhënat mbi asetet e OSSH sh.a. përfshijnë të dhëna mbi elementet kryesor të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, si: numrin e nënstationeve, numrin e transformatorëve, gjatësinë e linjave ajrore dhe kabllore, si dhe numrin e kabinave elektrike, tipi dhe numri i kabinave dhe fuqia e instaluar e tyre.

- Numri total i kabinave elektrike në rrjetin e shpërndarjes është 26,738, krahasuar me 26,151 të vitit 2024.
- Gjatësia totale e linjave të tensionit të mesëm në sistemin e shpërndarjes është 17,550 km, krahasuar me 17,505 të vitit 2024.
- Gjatësia totale e rrjetit të tensionit të ulët në sistemin e shpërndarjes është 26,971 km.
- Gjatësia totale e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të mesëm dhe në tension të ulët rezulton në 44,521 km dhe 31,802 km kabëll koaksial.

Në mënyrë më të detajuar të dhënat jepen në tabelat më poshtë:

KABINAT	TIPI DHE NUMRI I KABINAVE												NUMRI TOTAL I KABIN AVE
	METALIKE			MURATURE			BOX			SHTYLLLORE			
	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20k V	
Gjithsej (Total)	321	267	11	2439	3818	4491	63	106	2217	6645	6204	156	26,738
Pronesi OSSH	243	193	3	1,541	2,598	2,167	41	59	2,066	1,971	2,435	97	13,414
Pronesi Jo e OSSH	78	74	8	898	1,220	2,324	22	47	151	4,674	3,769	59	13,324

NËNSTACIONE, KABINA DHE TRANSFORMATORË

Numri i Nënstationeve (nr.vendodhjeve)	177
Numri i transformatorëve në nënstatione	313
Numri i Kabinave total	26,738
Numri i Transformatorëve TM /TU	27,406

Gjatësia Totale e rrjetit TM (km)	17,550.9
Linja 35 kV (km) Ajrore	1,244.6
Linja 35 kV (km) Kabllore	17.5
Linja 20 kV (km) Ajrore	278
Linja 20 kV (km) Kabllore	2,831
Linja 10 kV (km) Ajrore	7,680

Linja 10 kV (km) Kablllore	264
Linja 6 kV (km) Ajrore	5,012
Linja 6 kV (km) Kablllore	224

Gjatesia Totale e rrjetit TU (km)	26,971
Ajror me përcjellës të zhveshur (km)	15,752
Ajror me kabëll ABC (km)	6,500
Kabllor PVC, XLPE	4,719

Tabela 20. Të dhëna mbi asetet kryesore të OSSH sh.a. për vitin 2025

1.5 Furnizuesi i Shërbimit Universal.

Më poshtë paraqitet një grafik i cili pasqyron energjinë e furnizuar në MWh për 11 drejtoritë rajonale




Figura 38. Furnizimi me energji elektrike të ndara sipas drejtorive rajonale në MWh për vitin 2025

Në vitin 2025, shpërndarja e energjisë së furnizuar në 11 drejtoritë rajonale evidenton qartë strukturën e konsumit dhe kërkesës për energji elektrike në nivel kombëtar.

Drejtoria Rajonale Tiranë zë peshën kryesore në këtë shpërndarje me rreth 2,831 GWh energji të furnizuar, duke u dalluar ndjeshëm nga të gjitha rajonet e tjera.

Në vend të dytë renditet Drejtoria Rajonale Durrës me mbi 1,026 GWh dhe më pas, Drejtoria Rajonale Shkodër paraqet një volum të konsiderueshëm prej rreth 768,000 MWh, duke reflektuar rolin e saj në rajonin verior.

Një grup i ndërmjetëm përfshin drejtoritë rajonale të Fierit, Elbasanit, Burrelit, Beratit, Vlorës dhe Korçës, të cilat regjistrojnë nivele relativisht të përafërta të energjisë së hyrë, që variojnë nga rreth 400 deri në 560 GWh. Këto vlera tregojnë një kërkesë të qëndrueshme për këto drejtori rajonale.

Në fund të renditjes qëndrojnë Drejtoria Rajonale Gjirokastrë dhe Drejtoria Rajonale Kukës me rreth 359 GWh dhe 241 GWh energji të hyrë. Këto nivele më të ulëta janë në përputhje edhe me densitetin më të vogël të popullsisë në këto zona.




Figura 39. Niveli i arkëtimeve mujore të furnizimit si shërbim publik për periudhën 10 vjeçare 2016-2025 (Burimi: FSHU sh.a.)

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga FSHU sh.a. rezulton në masën 86.9% ndaj energjisë elektrike të faturuar gjatë vitit në analizë, ndërsa arrin në 99% nëse përfshihen edhe arkëtimet nga detyrimet e mbartura për periudhën 2007–2024. Krahësuar me vitin 2024, niveli i arkëtimeve për vitin 2025 paraqet një ulje prej rreth 1.5%. Kjo rënie lidhet kryesisht me faktin se gjatë vitit 2024 është realizuar një nivel më i lartë arkëtimi i detyrimeve të mëparshme dhe të prapambetura, duke sjellë si rrjedhojë reduktimin e stokut të këtyre detyrimeve në total.




Figura 40. Arkëtime totale 10 vjeçare të FSHU për periudhën (2016 – 2025) në lekë

Niveli i Arkëtimeve (%) 2016-2025												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70
2017	85.20	87.60	105.70	94.50	105.70	91.80	104.80	97.40	94.60	103.80	92.70	100.10
2018	96.39	95.69	105.82	98.92	111.64	100.16	105.00	102.12	93.03	108.76	96.24	108.94
2019	90.7	92.6	99.8	102.4	102.50	94.00	104.40	99.30	93.90	104.70	89.60	110.70
2020	91.4	91.6	77.5	106.8	101.80	102.20	96.80	95.30	96.60	101.10	91.50	101.80
2021	86.4	88.9	102.1	91	101.20	110.70	96.90	94.10	90.70	114.70	96.90	101.50
2022	90.6	84.3	102.7	90.5	98.00	97.90	99.90	105.00	100.60	104.50	102.30	102.90
2023	92.3	94.2	100.2	92.9	113.7	95.70	93.60	101.60	101.20	113.80	103.80	96.70
2024	92	95	101.2	104.3	110.9	96.60	105.00	93.40	94.40	110.10	102.10	106.90
2025	94.7	93.4	95.6	101	103.6	102.20	101.70	94.30	101.50	105.30	97.00	101.80

Figura 41. Niveli i arkëtimeve në % për periudhën (2016 – 2025)




Figura 42. Faturimi/arkëtimi 10 vjeçar (2016-2025), në lekë me TVSH
(Burimi: FSHU sh.a.)

Në vitin 2024, faturimi vjetor arriti në 76.9 mil lekë, ndërsa në vitin 2025 ky tregues shënon një rënie në 75.5 mil lekë, që përfaqëson një ulje prej 1.4 mil lekë. Këto vlera përkthehen në një rënie të lehtë, duke treguar një ngadalësim të moderuar të volumit të faturuar në sistem.

Në të njëjtën periudhë, arkëtimi vjetor zbriti nga 77.4 mil lekë në vitin 2024, në 75.1 mil lekë në vitin 2025, duke reflektuar një ulje prej 2.3 mil lekë, duke treguar një tkurrje më të ndjeshme krahasuar me faturimin.

Në figurën më sipër, janë paraqitur të dhënat e faturim - arkëtimeve të energjisë elektrike përgjatë periudhës 10 vjeçare 2016 - 2025. Për vitin 2025, diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit është 0,4 miliardë lekë, ose 0,52 % e vlerës së energjisë elektrike të faturuar. Ulja e ndjeshme e diferencës ndërmjet energjisë elektrike të faturuar dhe asaj të arkëtuar ka filluar në vitin 2015 dhe ka vijuar të jetë një proces i konsoliduar në vitet në vijim.

Në aspektin dinamik, të dhënat tregojnë se pas nivelit relativisht të lartë të arritur në vitin 2024, si faturimi ashtu edhe arkëtimi në vitin 2025 karakterizohen nga një rënie e moderuar, me ndikim më të dukshëm në arkëtim.

2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Tregu i energjisë elektrike në vendin tonë me fillimin e operimit të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike ALPEX sh.a. më datë 12.04.2023, funksionon bazuar në VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, ndryshuar me VKM nr. 872, datë 27.12.2022.

Përgjatë vitit 2025 ka vijuar procesi për liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike me daljen në treg të lirë të klientëve të lidhur në tensionin 10 kV dhe po ashtu me krijimin e kushteve teknike dhe të kuadrit nënligjor për daljen në treg të lirë për klientët e lidhur në nivelin e tensionit të mesëm 6 kV, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse.

2.1. Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

2.1.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike

Në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neni 7, neni 20, gërma ç), d), f) dhe g), neni 22, neni 58, pika 9, neni 62, pika 4, si dhe neni 72, gërma dh); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, neni 13; si dhe kushtet e licencave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licencuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhrave të ERE-s.

Në mënyrë që të sigurohen raportime sa më korrekte dhe në kohë nga të licencuarit dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 203, datë 12.12.2019, u miratuan “Rregullat për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”. Në këto rregulla janë përcaktuar procedurat dhe formatet e raportimit sipas të cilave të licensuarit kanë raportuar në mënyrë periodike.

Përfaqësuesit e ERE-s janë anëtarë të grupeve të punës së organizmave ndërkombëtare me të cilat ERE ka vendosur tashmë marrëdhënie bashkëpunimi. Në këtë kuadër, ERE dërgon informacionin e siguruar nga raportimet periodike në institucionet e organizatat e ndryshme bashkëpunuese me të, si dhe merr pjesë në takime, që janë në objektin e punës së saj. Këto të dhëna të monitoruara dhe të analizuara shërbejnë gjithashtu si kontribut në praktikat e këtyre institucioneve, si dhe në plotësimin e pyetësorëve dhe korrespondencave. Në mënyrë që të rritet transparencja në tregun e energjisë elektrike, ERE ka vijuar të monitorojë zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017, i cili ka miratuar “Rregullat për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike” duke mbajtur edhe korrespondencat përkatëse me operatorët përgjegjës.

Të dhënat kryesore (4) katër mujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike kanë vijuar të publikohen dhe për vitin 2025 rregullisht në faqen e internetit të ERE-s, sipas parashikimeve të nenit 19, gërma k, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Këto të dhëna japin informacione dhe raporte të detajuara lidhur me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin e energjisë elektrike, centralet e reja hidrike dhe fotovoltaike që kanë hyrë në operim përgjatë vitit, kapacitetin total të instaluar të tyre dhe tregun e energjisë elektrike në vendin tonë.

Përgjatë vitit është vijuar me raportimet ditore të nivelit të liqenit të Fierzës, prodhimin e kaskadës, prurjet, orët e punës së agregatëve, avaritë e ndodhura si dhe rezervën energjitike të kaskadës së lumit Drin.

Edhe gjatë vitit 2025 OST sh.a. ka raportuar periodikisht në zbatimin e detyrave të lëna në vendimarrjen e Bordit nr. 194/2019 për dhënien në përdorim të një pjese të infrastrukturës së

fibrës optike nga OST sh.a. Po ashtu, është bërë me dije se nuk është regjistruar asnjë ndërpreje kritike në shërbimet SCADA, EMS apo komunikimet ndërmjet nënstacioneve. Performanca e sistemeve të komunikimit përgjatë vitit vlerësohet me tregues stabiliteti dhe sigurie në nivele të larta raporton OST sh.a.

Gjithashtu përgjatë gjithë vitit ALPEX sh.a., ka raportuar në ERE mbi operimin e bursës dhe pjesëtarët e rinj të regjistruar në bursë për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës. Për tregun e ankandeve brenda së njëjtës ditë dhe të ditës në avancë janë evidentuar volumet dhe çmimet mesatare të tregtuara dhe të realizuara për çdo muaj të vitit 2025 për të dyja vendet por edhe për bashkimin e tregjeve Shqipëri-Kosovë.

Vlen për t'u theksuar se gjatë vitit 2025, ALPEX sh.a., ashtu edhe pjesëtarët e regjistruar që operojnë në bursë nuk kanë raportuar në ERE problematika që lidhen me operimin e bursës. Volumet e tregtuara të energjisë elektrike në Tregun e Ditës në Avancë dhe të ankandeve të realizuara Brenda së Njëjtës Ditë kanë patur një trend rritës për vitin 2025 të cilat janë të pasqyruara në kapitullin 3.

Për të siguruar zbatimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore të detyrimeve që lidhen me transparencën në tregun e energjisë, ERE ka monitoruar periodikisht faqet e internetit të operatorëve kryesorë në tregun e energjisë. Rezulton se për vitin 2025 këto detyrime zbatohen kryesisht nga operatorët në kuadër të rritjes së transparencës.

Nga ana e OST sh.a. është vënë re përmirësimi i informacionit dhe të dhënave që publikohen në kuadër të transparencës, në faqen e saj të internetit dhe nëpërmjet platformës së transparencës së ENTSO-E, kjo për faktin se OST sh.a. është anëtare e ENTSO-E dhe ka detyrimin e publikimit të informacionit dhe në platformën e transparencës së kësaj organizate.

2.1.2 Monitorimet periodike të OST sh.a.

I. Alokimi i kapaciteteve në interkonjeksione

Në tabelën e mëposhtme paraqiten alokimet e kapaciteteve të interkonjeksionit sipas kufijve.

Ankandit	Perioda	Shqipëri - Mali Zi						Shqipëri - Greqi						Shqipëri - Kosovë					
		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit	
		Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import
		[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]
Janar	01.01.2025-31.01.2025	238	50	238	50	1.5	5.21	0	0	0	0	0	0	150	150	150	150	1.53	0.29
Shkurt	01.02.2025-28.02.2025	0	0	0	0	0	0	250	50	250	50	1.7	6	150	150	150	150	1.8	0.22
Mars	01.03.2025-31.03.2025	50	50	50	50	2.16	1.89	260	100	260	100	1.1	5.86	150	150	150	150	0.41	0.33
Prill	01.04.2025-30.04.2025	0	14	0	14	0	3.55	250	0	250	0	1.12	0	150	150	150	150	0.17	0.69
Maj	01.05.2025-31.05.2025	0	0	0	0	0	0	250	0	250	0	2	0	150	150	150	149	0.32	0.51
Qershor	01.06.2025-30.06.2025	0	10	0	10	0	0.77	210	0	210	0	1.1	0	150	150	149	150	0.27	0.27
Korrik	01.07.2025-31.07.2025	0	0	0	0	0	0	265	0	265	0	0.88	0	150	150	150	150	0.26	0.58
Gusht	01.08.2025-31.08.2025	0	0	0	0	0	0	265	0	265	0	0.17	0	150	150	150	150	0.04	0.88
Shtator	01.09.2025-30.09.2025	0	0	0	0	0	0	250	0	250	0	0.16	0	150	150	148	150	0.08	1.16
Tetor	01.10.2025-31.10.2025	0	0	0	0	0	0	100	0	100	0	0.68	0	150	150	150	150	0.33	1.42
Novendor	01.11.2025-30.11.2025	0	0	0	0	0	0	250	0	250	0	0.36	0	150	150	150	150	0.8	1.55
Dhjetor	01.12.2025-31.12.2025	0	0	0	0	0	0	250	0	250	0	0.6	0	150	150	150	150	1.1	0.6

Ankandit	Perioda	Shqipëri - Mali Zi				Shqipëri - Greqi				Shqipëri - Kosovë			
		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit	
		Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import
		[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]
Viti 2025	01.01.2025-31.12.2025	200	200	200	200	2.57	2.72	200	200	200	200	3.7	4.57

Figura 43. Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2025

(Burimi: OST sh.a.)

Të dhënat mbi alokimin e kapaciteteve ndërkufitare për vitin 2025 tregojnë një zhvillim të ndryshëm në krahasim me vitin 2024 në tre interkonjeksionet kryesore të sistemit

elektroenergjetik shqiptar: Shqipëri–Mali i Zi, Shqipëri–Greqi dhe Shqipëri–Kosovë. Në interkonjeksionin me Malin e Zi, gjatë vitit 2025 vihet re një nivel më i ulët aktiviteti krahasuar me vitin 2024, ku alokimi i kapaciteteve është realizuar vetëm në disa muaj të vitit, kryesisht në fillim të tij. Në vitin 2025 çmimet e ankandeve rezultuan përgjithësisht më të ulëta krahasuar me vitin 2024.

Në interkonjeksionin Shqipëri–Greqi, i cili përfaqëson një nga linjat më të rëndësishme për shkëmbimet rajonale të energjisë, gjatë vitit 2025 janë ofruar kapacitete relativisht më të larta dhe më të qëndrueshme për eksport, duke arritur deri në rreth 250–265 MW në disa periodha të vitit.

Sa i përket interkonjeksionit Shqipëri–Kosovë, në vitin 2025 vërehet një përdorim më i qëndrueshëm i kapaciteteve gjatë gjithë vitit, me nivele të ofruara dhe të shitura që mbeten pothuajse konstante në rreth 150 MW në të dy drejtimet. Në vitin 2024, përdorimi i këtij interkonjeksioni ishte më i kufizuar dhe i përqëndruar kryesisht në muajt e parë të vitit. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025 është vërejtur një stabilizim i përdorimit të kapaciteteve në disa interkonjeksione, ndërkohë që çmimet e ankandeve kanë rezultuar mesatarisht më të ulëta krahasuar me vitin 2024.

Për alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, gjatë vitit 2025 janë ndjekur procedurat sipas rregullave të harmonizuara të Zyrës së Koordinimit të Alokimit të Kapaciteteve të interkonjeksionit për Evropën Juglindore (SEE CAO-s).

Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, në Rregulloren e Ankandit për Alokimin e Kapaciteteve në SEE CAO, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 197, datë 26.11.2020.

Vlen të theksojmë se nuk ka pasur ankimim nga Pjesëmarrësit e Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.

2.1.3 Disbalancat në tregun e energjisë elektrike

Në zbatim të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë, 02.07.2020, OST sh.a. duke filluar nga 1 prilli 2021 vijon operimin e tregut të balancimit të energjisë elektrike. Bazuar në këto rregulla realizohet llogaritja dhe faturimi i disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu, të cilët janë përgjegjës për disbalancat që shkaktojnë, në bazë orare. Gjithashtu, rregullat vendosin parime të qarta të një tregu konkurrues dhe dinamik për sa i përket balancimit të energjisë elektrike.

Disbalancat e pjesëmarrësve të tregut edhe gjatë vitit 2025 janë llogaritur dhe faturuar në bazë mujore për interval kohe prej 1 ore. Përgjatë vitit 2025 i është lënë detyrë operatorëve si KESH sh.a., OST sh.a., ALPEX sh.a. dhe pjesëmarrësve të tregut për marrjen e masave teknike për të mundësuar implementimin e intervalit 15 minutësh të tregut të balancimit. Operimi i tregut të balancimit gjithashtu është objekt i monitorimit të vazhdueshëm të ERE-s.

Në zbatim të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” të miratuara me vendim të ERE-s nr. 106, datë, 02.07.2020, për periudhën Janar - Dhjetor 2025, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga Sistemi i Matjeve Tregtare i OST sh.a. dhe të nominimeve të pjesëmarrësve të Tregut Balancues në platformën elektronike të Menaxhimit të Tregut, janë bërë llogaritjet e Disbalancave në bazë orare/ditore.

Tabela me të dhënat si më poshtë:

Viti 2025	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Disbalancat Negative	21,042	23,271	25,716	20,117	29,275	20,482	20,589	19,955	19,043	29,431	32,287	28,671
Disbalancat Pozitive	49,114	31,419	53,910	38,100	29,489	24,828	26,820	29,166	28,845	39,928	39,309	29,737




Figura 44. Disbalancat mujore negative dhe pozitive për vitin 2025 (MWh)

MWh	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Disbalancat Negative	17,908	11,665	20,833	17,080	18,323	21,396	20,900	21,507	18,570	18,086	22,722	19,459
Disbalancat Pozitive	47,241	38,127	38,715	31,588	31,084	26,577	20,728	19,068	28,807	21,479	23,415	36,684

Figura 45. Disbalancat mujore negative dhe pozitive për vitin 2024 (MWh)

Nga ana e OST sh.a. është raportuar mbi ecurinë e tregut të balancimit dhe sasitë e disbalancave të pjesëmarrësve të tregut për çdo muaj të vitit 2025, sasitë në MWh dhe kostot përkatëse që ato shkaktojnë në sistem, shkëmbimet dhe transaksionet e tyre dhe mënyrën e përllogaritjes së këtyre disbalancave nga ana e OST sh.a., për pjesëmarrësit e tregut balancues nga ku rezulton se sasitë e disbalancave negative dhe pozitive në MWh janë më të larta për vitin 2025 fakt që varet nga numri më i madh i pjesëmarrësve në treg. Gjithsesi në përputhje me gjetjet e këtyre informacioneve ERE do të vijojë përgjatë vitit 2026 me rishikimin e rregullave të tregut të balancimit në bashkëpunim me OST sh.a. dhe pjesëmarrësit e tregut.

Rezulton se përgjatë vitit 2025, muaji nëntor ka regjistruar nivelin më të lartë të disbalancave negative ndërsa muaji shtator nivelin më të ulët të këtyre disbalancave. Marsi rezultoi muaji me nivelin më të lartë të disbalancave pozitive dhe qershori me nivelin më të ulët.

2.1.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a., në Treg të rregulluar dhe të liberalizuar (parregulluar) gjatë vitit 2025

KESH sh.a. gjatë vitit 2025 ka raportuar se ka shitur/blerë dhe shkëmbyer energji elektrike në treg, ku një vend të rëndësishëm e zë përmbushja e detyrimit ligjor për furnizimin e FSHU sh.a. me çmimin e përcaktuar 2.34 Lekë/kWh. Përgjatë vitit 2025 KESH sh.a. ka shitur energji elektrike për klientët e FMF të lidhur në nivelin e tensionit 6/10/20 kV me 12 lek/kWh. Gjithashtu përgjatë këtij viti KESH sh.a. ka shitur energji për furnizimin me energji elektrike të ujës jellësive me çmimin e përcaktuar 5.7 Lekë/kWh si dhe ka kryer transaksione shit/blerje energjie me operatorët si OST sh.a., KOSTT, bursën ALPEX sh.a., etj për optimizimin e portofolit ekonomik të saj.

Energjia elektrike e blerë në treg të liberalizuar sipas detyrimit për shërbimin publik të vendosur në VKM 456/2022, e ndryshuar, përllogaritet në sasinë 1,812,145 MWh me një çmim mesatar 127,5 Euro/MWh ku në total arrin vlerën monetare 272,237,908 Euro për vitin 2025. Vlen për tu theksuar se gjatë muajve prill dhe maj shoqëria KESH sh.a., nuk ka realizuar transaksione

energjitike për blerje në treg të parregulluar ndërkohë që përgjatë muajve tetor dhe nëntor ka realizuar shitje për shkak të prurjeve të mëdha, respektivisht 11,008 MWh për muajin tetor dhe 45,691 MWh për muajin nëntor me çmim mesatar të ponderuar 98.3 Eur/MWh ku në total arrin vlerën monetare të arkëtuar prej 6,688,321 Euro të pasqyruara në tabelat e mëposhtme me sasitë përkatëse në MWh dhe vlerën monetare respektive.

Këto transaksione realizohen bazuar në “Rregulloren e Tregtimit të Energjisë Elektrike nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare KESH sh.a.” miratuar me vendimin nr. 2762/8, datë 06.06.2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e pronarit të KESH sh.a. dhe “Rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.” të miratuar me vendimin nr. 5233/1 prot., datë 12.06.2020, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit.

Më poshtë po paraqesim tabelat me të dhëna të transaksioneve më të detajuara të kryera gjatë vitit 2025 nga KESH sh.a., duke përfshirë totalin e shitjeve e blerjeve në mënyrë të përmblodhur të realizuara për optimizimin e portofolit ekonomik të shoqërisë.

Blerje energji elektrike sipas detyrimit për shërbim publik të vendosur me VKM 456/2022 & 449/2023							
Shoqëria	Periudha	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
			MWh	Euro/MWh	Euro	Euro	Euro
Janar	01-31.01.2025	Blerje	122,400.00	150.68	18,442,678.32	3,688,535.66	22,131,213.98
Shkurt	01-28.02.2025	Blerje	87,600.00	157.74	13,818,460.56	2,763,692.11	16,582,152.67
Mars	01-31.03.2025	Blerje	98,016.00	118.18	11,583,818.30	2,316,763.66	13,900,581.96
Prill	01-30.04.2025	Blerje	-	-	-	-	-
Maj	01-31.05.2025	Blerje	-	-	-	-	-
Qershor	01-30.06.2025	Blerje	217,351.00	110.66	24,051,528.76	4,810,305.75	28,861,834.51
Korrik	01-31.07.2025	Blerje	346,207.00	131.24	45,437,296.16	9,087,459.23	54,524,755.39
Gusht	01-31.08.2025	Blerje	363,761.00	122.30	44,488,017.87	8,897,603.57	53,385,621.44
Shtator	01-30.09.2025	Blerje	251,103.00	115.49	28,999,612.20	5,799,922.44	34,799,534.64
Tetor	01-31.10.2025	Blerje	191,120.00	125.73	24,029,103.25	4,805,820.65	28,834,923.90
Nëntor	01-30.11.2025	Blerje	68,387.00	121.57	8,314,117.80	1,662,823.56	9,976,941.36
Dhjetor	01-31.12.2025	Blerje	67,200.00	114.59	7,700,290.80	1,540,058.16	9,240,348.96
TOTALE		Blerje	1,813,145.00	127.55	226,864,924.02	45,372,984.80	272,237,908.82

Tabela 21. Blerje energjie elektrike nga KESH sh.a. sipas detyrimit të shërbimit publik për vitin 2025 (sasia në MWh, çmimi/MWh dhe vlerat në Euro)

(Burimi KESH sh.a.)

Shoqëria	Periudha	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera TVSH
			MWh	Euro/MWh	Euro	Euro	Euro
Janar	01-31.01.2025	Shitje					
Shkurt	01-28.02.2025	Shitje					
Mars	01-31.03.2025	Shitje					
Prill	01-30.04.2025	Shitje					
Maj	01-31.05.2025	Shitje					
Qershor	01-30.06.2025	Shitje					
Korrik	01-31.07.2025	Shitje					
Gusht	01-31.08.2025	Shitje					
Shtator	01-30.09.2025	Shitje					
Tetor	01-31.10.2025	Shitje	11,008.00	94.62	1,041,535.20	208,307.04	1,249,842.24
Nëntor	01-30.11.2025	Shitje	45,691.00	99.19	4,532,065.77	906,413.15	5,438,478.92
Dhjetor	01-31.12.2025	Shitje					
TOTALE		Shitje	56,699.00	98.30	5,573,600.97	1,114,720.19	6,688,321.16

Tabela 22. Shitje energjie elektrike nga KESH sh.a. për shkak të prurjeve të mëdha (sasia në MWh, çmimi/MWh dhe vlerat në Euro)

(Burimi KESH sh.a.)

Furnizimi me energji elektrike për klientët fundorë të lidhur në nivel tensioni 0.4 KV							
Muaj	Shoqëria	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
			MWh	Lek/MWh	Lek	Lek	Lek
Janar	FSHU	Shitje	462,242	2340	1,081,645,961	216,329,192.16	1,297,975,152.99
Shkurt		Shitje	493,990	2340	1,155,937,349	231,187,469.76	1,387,124,819
Mars		Shitje	395,219	2340	924,811,927	184,962,385.48	1,109,774,312.90
Prill		Shitje	293,554	2340	686,916,360	137,383,272.00	824,299,632.00
Maj		Shitje	279,536	2340	654,113,401	130,822,680.25	784,936,081.50
Qershor		Shitje	411,790	2340	963,588,025.76	192,717,605.15	1,156,305,630.91
Korrik		Shitje	470,047	2340	1,099,909,715.45	219,981,943.09	1,319,891,658.54
Gusht		Shitje	483,136	2340	1,130,539,174.40	226,107,834.88	1,356,647,009.28
Shtator		Shitje	393,589	2340	920,998,005.88	184,199,601.18	1,105,197,607.05
Tetor		Shitje	397,109	2340	929,235,948.81	185,847,189.76	1,115,083,138.58
Nentor		Shitje	310,965	2340	727,658,488.53	145,531,697.71	873,190,186.24
Dhjetor		Shitje	519,852	2340	1,216,454,082.39	243,290,816.48	1,459,744,898.86
Totale	Janar- Dhjetor		4,911,029	2,340	11,491,808,440	2,298,361,688	13,790,170,127

Tabela 23. Furnizimi me energji elektrike për FSHU sh.a. nga KESH sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë të lidhur në nivel tensioni 0.4 kV.

(Burimi KESH sh.a.)

Furnizimi me energji elektrike për klientët FMF të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 KV							
Muaj	Shoqëria	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
			MWh	Lek/MWh	Lek	Lek	Lek
Janar	FSHU	Shitje	5,121	12,000	61,457,236.80	12,291,447.36	73,748,684.16
Shkurt		Shitje	10,799	12,000	129,587,640.00	25,917,528.00	155,505,168.00
Mars		Shitje	8,976	12,000	107,712,571.20	21,542,514.24	129,255,085.44
Prill		Shitje	7,024	12,000	84,286,195.82	16,857,239.16	101,143,434.99
Maj		Shitje	7,088	12,000	85,050,257.28	17,010,051.46	102,060,308.74
Qershor		Shitje	8,355.72	12,000	100,268,626.08	20,053,725.22	120,322,351.30
Korrik		Shitje	7,907.72	12,000	94,892,680.32	18,978,536.06	113,871,216.38
Gusht		Shitje	5,990.86	12,000	71,890,315.20	14,378,063.04	86,268,378.24
Shtator		Shitje	5,355.72	12,000	64,268,647.20	12,853,729.44	77,122,376.64
Tetor		Shitje	13,539.50	12,000	162,473,961.60	32,494,792.32	194,968,753.92
Nentor		Shitje					-
Dhjetor		Shitje					-
Totale	Janar- Dhjetor		80,157	12,000	961,888,132	192,377,626	1,154,265,758

Tabela 24. Furnizimi me energji elektrike për FSHU sh.a. nga KESH sh.a. për furnizimin e klientëve FMF të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV

(Burimi KESH sh.a.)

Furnizimi me energji elektrike Ujësjiellës							
Muaj	Shoqëria	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
			MWh	Lek/MWh	Lek	Lek	Lek
Janar	FSHU	Shitje	8,146.70	5700	46,436,190.00	9,287,238.00	55,723,428.00
Shkurt		Shitje	15,846.71	5700	90,326,247.00	18,065,249.40	108,391,496.40
Mars		Shitje	15,757.18	5700	89,815,926.00	17,963,185.20	107,779,111.20
Prill		Shitje	11,053	5700	62,999,774.40	12,599,954.88	75,599,729.28
Maj		Shitje	15,555.84	5700	88,668,270.90	17,733,654.18	106,401,925.08
Qershor		Shitje	16,422.87	5700	93,610,381.80	18,722,076.36	112,332,458.16
Korrik		Shitje	18,108.65	5700	103,219,326.66	20,643,865.33	123,863,191.99
Gusht		Shitje	17,706.99	5700	100,929,844.14	20,185,968.83	121,115,812.97
Shtator		Shitje	14,357.59	5700	81,838,251.60	16,367,650.32	98,205,901.92
Tetor		Shitje	17,242.88	5700	98,284,421.70	19,656,884.34	117,941,306.04
Nentor		Shitje	13,301.83	5700	75,820,453.57	15,164,090.71	90,984,544.29
Dhjetor		Shitje	16,835.83	5700	95,964,219.83	19,192,843.97	115,157,063.79
Totale	Janar- Dhjetor		180,336	5,700.00	1,027,913,308	205,582,662	1,233,495,969

Tabela 25. Furnizimi me energji elektrike për FSHU sh.a. nga KESH sh.a. për furnizimin e ujësjiell ujësjiellësve.

(Burimi KESH sh.a.)

TOTALI I SHITJEVE PËR OPTIMIZIM TË PORTOFOLIT EKONOMIK TË SHOQËRISË KESH SH.A.					
Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
	MWh	Eur/MWh	Eur	Eur	Eur
Shitje energji elektrike me procedura bazuar në rregulloren e Tregtimit Janar-Dhjetor 2025	30,450.00	177.48	5,404,221.50	1,080,844.30	6,485,065.80
Shitje energji elektrike për ofrim shërbime ndihmëse KOST Janar- Dhjetor 2025	66,197.75	148.72	9,844,674.26	-	9,844,674.26
Shitje energji elektrike për ofrim shërbime ndihmëse OST Janar- Dhjetor 2025	134,295.52	138.79	18,639,533.98	3,727,906.80	22,367,440.78
Shitje energji elektrike për ofrim shërbime ndihmëse CGES 2025	198.00	131.55	26,046.39		26,046.39
Shitje ne Burse ALPEX	29,407.51	78.03	2,294,684.80	-	2,294,684.80
Shitje energji elektrike Tec Vlera Janar-Dhjetor 2025	1,211.55	111.34	134,895.02	26,979.00	161,874.02
Shitje energji elektrike Karavasta për furnizim Janar-Dhjetor 2025	790.78	105.00	83,031.87	16,606.37	99,638.24
TOTALI	262,551.10	138.74	36,427,087.82	4,852,336.47	41,279,424.29

Tabela 26. Totali i shitjeve të kryera gjatë vitit 2025 nga KESH sh.a., për optimizimin e portofolit ekonomik të saj.

(Burimi KESH sh.a.)

TOTALI I BLERJEVE PËR OPTIMIZIM TË PORTOFOLIT EKONOMIK TË SHOQËRISË KESH SH.A.					
Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
	MWh	Eur/MWh	Eur	Eur	Eur
Blerje energji elektrike me procedura bazuar në rregulloren e Tregimit Janar- Dhjetor 2025	(30,450.00)	126.53	(3,852,865.50)	(770,573.10)	(4,623,438.60)
Blerje energji elektrike për ofrim shërbime ndihmëse KOST Janar- Dhjetor 2025	(17,380.25)	17.87	(310,613.45)	-	(310,613.45)
Blerje energji elektrike për ofrim shërbime ndihmëse OST Janar- Dhjetor 2025	(196,583.17)	24.70	(4,856,522.98)	(1,047,036.96)	(6,282,221.79)
Blerje energji elektrike për ofrim shërbime ndihmëse CGES 2025	(5.00)	26.26	(131.30)		(131.30)
Blerje në Bursë ALPEX	(17,957.13)	85.94	(1,543,235.57)	-	(1,543,235.57)
Blerje energji elektrike nga HEC ASHTA, bazuar në kontratën	(175.55)	73.75	(12,946.81)	(2,589.36)	(15,536.18)
TOTALI	(262,551.10)	40.28	(10,576,315.62)	(1,820,199.43)	(12,775,176.89)
EFEKTI FINANCIAR NGA OPTIMIZIMI I SHITJES DHE BLERJES	-	98.46	25,850,772.20	3,032,137.05	28,504,247.40

Tabela 27. Totali i blerjeve të kryera gjatë vitit 2025 nga KESH sh.a., për optimizimin e portofolit ekonomik të saj.

(Burimi KESH sh.a.)

2.2. Rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT)

Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë në bashkëpunim me Palët Kontraktuese, me vendimin e datës 7 Gusht 2020, bazuar në përcaktimet e Rregullores 1227/2011 mbi integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë vendosi mbi adoptimin nga palët Kontraktuese të Rregullores 1227/2011 për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT).

Në vijim me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 17.05.2021, u miratua rregullorja për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (REMIT), e cila përcakton kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe të ndikojnë në tregjet me shumicë të energjisë.

Në të njëjtën kohë, REMIT ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

Rregullorja përcakton në mënyrë të detajuar mënyrën dhe procedurat që do të ndiqen nga ERE për monitorimin e funksionimit të tregut me shumicë të energjisë, si dhe veprimtari të caktuara të pjesëmarrësve në këtë treg në funksion të eliminimit të abuzimit nëpërmjet zhvillimit të tij, nxitjes së konkurrencës dhe aplikimit të standarteve të transparencës. Në të njëjtën kohë Rregullorja ndihmon në funksionimin e duhur të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

ERE bashkëpunon në nivel rajonal me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Grupit të Punës së REMIT në kryerjen e monitorimit të tregjeve të energjisë me shumicë. ERE gjithashtu do të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës, apo ndonjë organ tjetër për këtë qëllim.

Pjesëmarrësit e tregut që hyjnë në transaksione me produkte të energjisë me shumicë në Shqipëri, ose shprehin interesin për të hyrë në transaksione të tilla përmes procedurave të tregtimit, duhet të regjistrohen në regjistrin REMIT të ERE-s.

Përgjatë vitit 2025, ERE në zbatim të rregullores REMIT, ka vijuar me përditësimin e regjistrit të veçantë në faqen zyrtare të internetit në seksionin <https://remit.ere.gov.al/>. Në fundin e vitit 2025 u realizua funksionimi i platformës së dedikuar për regjistrimin në REMIT dhe çdo shoqëri e interesuar për regjistrim duhet ta kryejë atë manualisht nëpërmjet një manuali të publikuar në faqen e ERE-s në seksionin Tregu i Energjisë/REMIT/Manuali për përdorimin e platformës së monitorimit.

Në këtë rubrikë gjendet dokumentacioni përkatës i rregullores, përfshirë dhe regjistrin e pjesëmarrësve të tregut. Ky regjistër deri në datën 31.12.2025, ka patur të regjistruar 87 pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike krahasuar me 68 të regjistruar në vitin 2024. Nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar 46 prej tyre ushtrojnë veprimtarinë prodhim + tregtim + furnizim, 37 prej tyre tregtim + furnizim, 2 prej tyre veç furnizim dhe 2 të tjerë shpërndarje e transmetim.

Regjistri i REMIT është i lidhur edhe në faqen e web të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vienë, si pjesë e parashikimeve të Vendimit të ECRB.

Për vitin 2025 nuk rezulton që të ketë pasur ndonjë kërkesë nga pjesëtarët e tregut, për të hapur raste të monitorimit apo të aplikimit të klauzolave për sanksione, të rregullores REMIT, në tregun e energjisë elektrike në vendin tonë.

3. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX)

3.1. Operimi i Bursës Shqiptare të Energjisë

Bursa shqiptare e energjisë e operuar nga shoqëria ALPEX sh.a. ka filluar operimin që në vitin 2023, në zonën e ofertimit në Shqipëri, dhe në vitin 2024 në zonën e ofertimit në Kosovë. ALPEX sh.a operon bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX sh.a. – Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”, si dhe vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 23.03.2023 “Mbi miratimin e disa shtesave në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022”.

3.2. Anëtarësimi në Bursë për Zonën e Ofertimit Shqipëri

Gjatë vitit 2025 u anëtarësuan gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) Anëtarë Burse, 7 (shtatë) në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 4 (katër) në Zonën e Ofertimit të Kosovës. Për shkak të mos realizimit të aktiviteteve të tyre tregtare të mjaftueshme në ALPEX sh.a., u tërhoqen nga regjistrimi gjithsej 5 (pesë) Anëtarë Burse, 3 në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 2 në Zonën e Ofertimit të Kosovës. Numri i përgjithshëm i Anëtarëve të Bursës në ALPEX sh.a. në fund të vitit 2025, arriti në 41 (dyzet e një), 26 (njëzet e gjashtë) në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 15 (pesëmbëdhjetë) në Zonën e Ofertimit të Kosovës. Të gjithë Anëtarët e Bursës janë të regjistruar në Tregun e Ditës në Avancë. Në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë janë të regjistruar gjithsej 28 (njëzet e tetë) Anëtarë Burse, 16 (gjashtëmbëdhjetë) në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 12 (dymbëdhjetë) në Zonën e Ofertimit të Kosovës.

Më poshtë lista e anëtarëve të regjistruar në ALPEX sh.a. përgjatë vitit 2025:

1. “Operatori i Sistemit të Transmetimit” – OST sh.a.
2. “Furnizuesi i Tregut të Lirë” – FTL sh.a.
3. “Furnizuesi i Shërbimit Universal” – FSHU sh.a.
4. “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” – KESH sh.a.
5. “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” – OSSH sh.a.
6. “Ener Trade” sh.p.k.
7. “EZ-5 Energy” sh.p.k.
8. “GEN-I TIRANA” sh.p.k.
9. “ReNRGY Trading Group” sh.p.k.
10. “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k.
11. “NOA Energy Trade” sh.p.k.
12. “Danske Commodities Albania” sh.p.k.
13. “GSA” sh.p.k.
14. “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k.
15. “Devoll Hydropower” sh.a.
16. “SPV BLUE 1” sh.p.k.
17. “Ensco Trading” (Albania) sh.p.k.
18. “Alb Energy Trade” sh.p.k.
19. “Albesp Trading & Consulting” sh.p.k.
20. “AXPO Albania” sh.a.

21. “Sole 24 Dooel” Shkup - Dega në Shqipëri sh.p.k.
22. “5GX Energy” sh.p.k.
23. “SPV BLUE 2” sh.p.k.
24. “Sunny Side Energy” sh.p.k.
25. “Egnatia Hydropower” sh.p.k.
26. “GREEN Value” sh.p.k.

A. Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit

1. “Raiffeisen Bank Albania” sh.a.
2. “Tirana Bank” sh.a.

Deri më 31 dhjetor 2025 për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë janë trajnuar dhe kanë përfunduar me sukses procesin e certifikimit si agjentë tregtarë të emëruar nga Anëtarët e Bursës dhe që janë aktivisht përfaqësues të këtyre Anëtarëve, 63 (gjashtëdhjetë e tre) agjentë tregtarë.

3.3. Anëtarësimi në Bursë për Zonën e Ofertimit Kosovë

ALPEX sh.a. ka vijuar me anëtarësimin e anëtarëve për zonën e ofertimit në Kosovë, ku Anëtarë të Përgjithshëm të Klerimit në Kosovë rezultojnë të jenë ProCredit Bank Kosovë, Banka Kombëtare Tregtare Kosovë si dhe Raiffesin Bank Kosova.

Numri i Anëtarëve të Bursës të regjistruar është - 15 (pesëmbëdhjetë):

1. “Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut” – KOSTT sh.a.
2. “Korporata energjetike e Kosovës” – KEK sh.a.
3. Ndërmarrjes Hidroekonomike “Ibër-Lepenc” sh.a.
4. “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” – “KESCO” sh.a.
5. “Future Energy Trading and Exchange Dynamics” sh.p.k. – Kosovo
6. “Enerco” sh.p.k.
7. “GSA ENERGJI” sh.p.k.
8. “GEN-I TIRANA” sh.p.k. - Dega në Kosovë
9. “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. - Dega në Kosovë
10. “Energy Financing Team” sh.p.k.
11. “Renrgy Trading Group Pristina” sh.p.k.
12. “ETMT ENERGY” sh.p.k.
13. “InterenergoD.o.o – Kosova” sh.p.k.
14. “VoltKos” sh.p.k.
15. “MCM COMMODITIES” sh.p.k.

A. Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit

1. ProCredit Bank Kosovë
2. BKT Kosovë
3. Raiffesin Bank Kosova

3.4. Operimi i tregut.

Gjatë këtij viti, ALPEX sh.a. ka vënë në përdorim për Anëtarët e Bursës Platformën e Tregtimit ETSS dhe për Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit Platformën EMCS. Këto Platforma kanë qënë të suksesshme për përdoruesit përkatës dhe kanë performuar pa cënuar funksionimin normalisht të aktivitetit. Tregtimi dhe klerimi është kryer çdo ditë sipas kalendarit përkatës të publikuar në faqen e internetit të ALPEX sh.a.: www.alpex.al. Për sa i përket problematikave të hasura gjatë vitit 2025, ALPEX sh.a. nuk ka raportuar për ngjarje të tilla.

ALPEX, pas miratimit nga ERE të disa ndryshimeve të Rregullave të Tregtimit, aplikoi ankandin e dytë me qëllim ruajtjen e tregut nga çmimet që konsiderohen të gabuara ose të paqëndrueshme, këto në referencë me Kufirin Minimal të Lejuar të Çmimit 0 (zero) euro/MWh dhe Kufirin Maksimal të Lejuar të Çmimit për Tregun e Ditës në Avancë, çmimin 900 (nëntëqind) euro/MWh. Gjatë gjithë vitit 2025, ankandi i dytë u aktivizua 3 (tre) herë. Pas ankandit të dytë, çmimi ka rezultuar brenda parametrave normale të tregut duke qenë një mekanizëm efikas për mbrojtjen e tregut nga çmime të cilat nuk replikojnë sinjalet e tregut.

Gjatë vitit 2025 u rrit aktiviteti i tregtimit si në numër të ofertave ashtu dhe në volumin e tyre, të cilat arrijnë gati 9.5 % të totalit të tregut. Për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje për vitin 2025 ishte 1,648,354.22 MWh, krahasur me 1,132,284.04 MWh në vitin 2024, ndërkohë, oferta në shitje ka qenë 1,677,147.24 MWh e cila rezulton më e lartë se ajo e realizuar në vitin paraardhës prej 1,128,998.97 MWh, e ilustruar me grafikun në vijim.




Figura 46. Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet në Shqipëri për vitin 2025 ALPEX sh.a.

(Burimi ALPEX sh.a.)

Për bashkimin e tregut Shqipëri-Kosovë, oferta në blerje për vitin 2025 ishte 2,811,090.48 MWh krahasuar me 1,534,425.97 MWh në vitin 2024, ndërkohë oferta në shitje ka qenë 2,719,930.84 MWh e cila rezulton më e lartë se ajo e realizuar në vitin paraardhës 1,868,626.34 MWh e ilustruar me grafikun në vijim.




Figura 47. Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet në Shqipëri-Kosovë ALPEX sh.a., për vitin 2025

(Burimi ALPEX sh.a.)

Pozicioni i tregut të Shqipërisë në këtë bashkim tregu për vitin 2025 ka qenë **eksportues** në total volume **209,779.02 MWh** kundrejt **141,373.92 MWh** si importues, kjo e ilustruar me grafikun në vijim.





Figura 48. Të dhëna mbi eksportet- importet e Shqipërisë në bashkimin e tregut për vitin 2025. (Burimi ALPEX sh.a.)

3.5. Operimi i tregtimit në Tregun Brenda së Njëjtës Ditë (IDA)

Për këtë segment tregu organizohen tre ankade në ditë CRIDA-1, CRIDA-2 dhe CRIDA-3. ALPEX sh.a. ka vënë në përdorim për Anëtarët e Bursës platformën e tregtimit ETSS dhe për Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit platformën EMCS. Këto platforma kanë qënë të aksesueshme gjatë gjithë kohës për përdoruesit përkatës dhe kanë performuar pa cënuar funksionimin normal të aktivitetit. Tregtimi dhe Klerimi është kryer çdo ditë sipas kalendarit përkatës.

Për bashkimin e tregut Shqipëri - Kosovë, oferta në blerje për vitin 2025 ishte 242,696.48 MWh

ndërkohë oferta në shitje ka qenë 170,127.63 MWh e ilustruar me grafikun në vijim.



- Të dhënat e Tregtimit dhe Klerimit për Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë si Bashkim Tregjesh Shqipëri-Kosovë

Volumet e tregtuar në MWh-IDA				
Periudha	CRIDA-1	CRIDA-2	CRIDA-3	Total IDA
Janar 2025	793.33	0	1	794.33
Shkurt 2025	62.76	78.57	349	490.33
Mars 2025	113.53	238	6	357.53
Prill 2025	0	195.05	0	195.05
Maj 2025	670.63	162	0.27	832.9
Qershor 2025	2,188.26	2.3	980.1	3,170.66
Korrik 2025	1,805.65	188	1.03	1,994.68
Gusht 2025	933.9	336.32	19.6	1,289.82
Shtator 2025	1,105.37	174.04	5.4	1,286.31
Tetor 2025	5,387.79	1,473.34	221.3	7,082.43
Nëntor 2025	6,063.96	2,631.92	479.1	9,174.98
Dhjetor 2025	1,606.29	732.5	433.77	2,772.56
Akumulative 2025	20,731.47	6,212.04	2,498.73	29,442.24

Figura 49. Të dhëna mbi ofertat dhe blerjet – shitjet për Tregun e Ankandeve brenda së njëjtës Ditë si Bashkim Tregjesh Shqipëri-Kosovë për vitin 2025




Figura 50. Të dhëna mbi çmimin mesatar klerues për Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë si Bashkim Tregjesh Shqipëri-Kosovë për vitin 2025




Figura 51. Të dhëna mbi çmimin mesatar klerues për Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë si Bashkim Tregjesh Shqipëri-Kosovë për vitin 2025

3.6. Klerimi

Aktiviteti i klerimit dhe transaksionet e shlyerjes kryhen në mënyrë periodike sipas kalendarit nga ALPEX sh.a. në bashkëpunim me Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit dhe Bankën për Shlyerje. Gjatë vitit 2025, aktivitetet e klerimit dhe shlyerjes nuk janë cënuar në asnjë rast nga pikëpamja teknike dhe janë kryer në përputhje me parashikimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.

Çmimet Mesatare Orar për Tregun e Ditës në Avancë – Viti 2025												
Ora/MTU	00-01	2-Jan	3-Feb	4-Mar	5-Apr	6-May	7-Jun	8-Jul	9-Aug	10-Sep	11-Oct	12-Nov
max	415	230	200	180.3	180	207.69	450	450	330	300	236.56	300
min	51.29	49.13	10	10	20	31.54	43.32	43.32	2	0.9	0.49	0.49
Base load	118.81	106.49	98.01	93.45	94.04	102.32	121.99	126.22	120.51	103.98	90.92	81.19
Ora/MTU	13-Dec	13-14	14-15	15-16	16-17	17-18	18-19	19-20	20-21	21-22	22-23	23-24
max	236.86	236.7	300	300	450	500	505.21	506.95	486.79	360.2	600	350
min	0.49	0.49	0.49	0.49	0.45	32.7	50	81.18	75.74	64.55	0.25	0.1
Base load	76.23	78.61	88.73	107.25	129.91	148.65	173.49	184.42	179.22	149.41	138.01	125.92

Tregu i Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë, ka nisur operimin më 11 Dhjetor 2024.

Klerimi i Transaksioneve në Tregun IDM në Zonën e Ofertimit Shqipëri viti 2025				
	Blerje		Shitje	
Periodha	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	3.29	350.06	795.62	225,653.08
Shkurt	8	960	485.72	24,549.62
Mars	181	21,220.32	176.53	17,326.78
Prill	195.05	15,459.85	0.05	0.25
Maj	701.19	61,739.18	328.34	38,691.27
Qershor	1,252.39	125,912.42	144.16	30,112.66
Korrik	1,892.33	297,002.53	11.06	1,609.36
Gusht	776.57	84,134.43	520.75	143,946.13
Shtator	1,181.21	125,176.32	426.32	89,857.56
Tetor	3,714.58	359,343.13	3,040.56	426,671.45
Nëntor	1,985.04	177,959.54	5,012.90	544,711.37
Dhjetor	111.38	13,555.75	940.37	170,510.58
Total 2025	12,002.03	1,282,813.53	11,882.38	1,713,640.13

Figura 52. Të dhëna mbi klerimin e transaksioneve në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë për vitin 2025

Të dhënat e Tregtimit dhe Klerimit për Tregun e Ditës në Avancë

Zona e Ofertimit e Shqipërisë

Të dhënat e Tregut të Ditës në Avancë				
Progresive 2025	Minimum	Maksimum	Mesatare	Total
Volumi në MWh	1,461.06	6,955.08	2,786.64	1,014,336.34
Çmimi ditore mesatare Klerues (€/MWh)	€ 44.78	€ 262.10	€ 118.23	-
Çmimi per MTU (€/MWh)	€ 0.10	€ 600.00	€ 118.23	

Tabela 28. Çmimi mesatar orar në €/MWh për Tregun e Ditës në Avancë 2025

Faturimet (blerje-shitje)				
Periudha	Min Ditor	Max Ditor	Mesatare Ditore	Total
VITI 2024	€ 106,672	€ 1,827,427	€ 469,831	€ 171,958,215
Janar 2025	€ 422,253	€ 967,069	€ 575,455	€ 17,839,114
Shkurt 2025	€ 428,084	€ 966,210	€ 630,458	€ 17,652,822
Mars 2025	€ 160,377	€ 615,168	€ 372,854	€ 11,558,460
Prill 2025	€ 193,353	€ 643,208	€ 384,232	€ 11,526,963
Maj 2025	€ 158,020	€ 575,663	€ 364,952	€ 11,313,533
Qershor 2025	€ 246,534	€ 810,541	€ 556,520	€ 16,695,617
Korrik 2025	€ 472,990	€ 1,353,050	€ 820,150	€ 25,424,668
Gusht 2025	€ 405,907	€ 1,215,697	€ 786,238	€ 24,373,399
Shtator 2025	€ 296,305	€ 867,988	€ 580,208	€ 17,406,241
Tetor 2025	€ 270,763	€ 1,518,103	€ 749,171	€ 23,224,317
Nëntor 2025	€ 483,472	€ 1,286,138	€ 790,691	€ 23,720,715
Dhjetor 2025	€ 197,899	€ 689,801	€ 389,940	€ 12,088,164
Akumulati ve 2025	€ 158,020	€ 1,518,104	€ 614,850	€ 224,420,327

Tabela 29. Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në zonën e ofertimit të Shqipërisë për Tregun e Ditës në Avancë.

Bashkimi i tregjeve të Ditës në Avancë Shqipëri-Kosovë

Të dhënat e Tregut të Ditës në Avancë Shqipëri-Kosovë pa përfshirë transaksionet ndërkufitare				
Progresive 2025	Minimum	Maksimum	Mesatare	Total Neto
Volumi në MWh	1,834.98	9,422.84	4,496.69	1,641,291.79
Çmimi mesatar ditore Klerues (€/MWh)	€ 44.78	€ 262.10	€ 118.24	-
Çmimi per MTU (€/MWh)	€ 0.10	€ 600.00	€ 118.24	

Bashkimi i Tregjeve të Ditës në Avancë Shqipëri-Kosovë-Volume në (MWh)						
Periudha	Urdhërporosi Blerje	Urdhërporosi Shitje	Totali i Tregtimeve	Tregtime (pa transaksionet ndërkufitare)	Eksport nga Shqipëria	Import në Shqipëri
Janar 2024	91,297.00	100,120.00	74,102.00	74,102.00	N/A	N/A
Janar 2025	179,152.71	152,848.13	115,264.30	100,820.97	10,908.46	3,534.87
Shkurt 2024	103,049.80	162,506.70	109,869.90	88,040.40	1,439.00	20,391.50
Shkurt 2025	169,930.36	131,591.14	97,884.56	82,734.45	13,965.42	1,184.69
Mars 2024	148,041.63	185,913.70	151,628.22	128,633.95	1,753.37	21,240.90

Mars 2025	173,269.89	166,366.16	108,600.66	96,006.39	5,496.03	7,098.24
Prill 2024	132,132.24	214,381.30	157,805.45	123,992.37	1,011.91	32,801.17
Prill 2025	193,930.19	203,625.50	141,295.54	127,831.47	8,787.88	4,676.19
Maj 2024	155,215.66	214,589.82	176,715.94	133,906.13	983.82	41,825.99
Maj 2025	175,247.22	193,072.32	139,599.25	124,512.43	6,560.81	8,526.01
Qershor 2024	128,989.99	161,677.10	145,539.65	103,298.59	381.21	41,859.80
Qershor 2025	191,012.72	203,889.78	170,944.19	135,590.77	22,697.84	12,655.58
Korrik 2024	128,003.95	139,088.91	106,612.31	84,919.85	4,351.68	17,340.78
Korrik 2025	274,660.49	235,007.76	212,283.71	172,675.47	18,822.39	20,785.85
Gusht 2024	123,871.60	134,100.51	101,754.26	77,544.23	4,569.95	19,640.08
Gusht 2025	299,995.41	270,774.89	216,602.20	175,121.52	11,467.25	30,013.43
Shtator 2024	107,503.93	124,551.29	93,935.58	78,484.27	4,496.17	10,975.39
Shtator 2025	230,069.69	232,572.13	161,325.31	127,516.20	10,696.18	23,112.93
Tetor 2024	115,737.69	134,606.64	101,049.79	86,571.31	1,742.54	12,735.95
Tetor 2025	312,119.00	275,360.84	199,411.62	159,513.02	20,100.46	19,798.14
Nëntor 2024	148,108.33	145,395.35	111,033.42	94,385.09	2,688.34	13,960.00
Nëntor 2025	278,902.47	346,828.84	219,593.73	170,332.80	42,624.90	6,636.00
Dhjetor 2024	153,101.24	152,069.13	111,427.07	98,702.39	4,398.95	8,325.73
Dhjetor 2025	332,800.33	307,993.35	209,639.69	168,636.37	37,651.40	3,351.99
Progresive Viti 2024	1,534,425.97	1,868,626.34	1,441,493.59	1,172,580.58	27,816.94	241,097.29
Progresive Viti 2025	2,811,090.48	2,719,930.84	1,992,444.76	1,641,291.86	209,779.02	141,373.92
Ndryshimi (%)	83.20%	45.56%	38.22%	39.97%	654.14%	-41.36%

Tabela 30. Tabela me transaksionet në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në zonën e ofertimit të Shqipërisë për Tregun e Ditës në Avancë.

(Burimi ALPEX sh.a.)

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX sh.a. në Zonën e Ofertimit Shqipëri viti 2025 për Tregun e Ditës në Avancë.

Tabela me klerimin e transaksioneve në shitje dhe në blerje të energjisë elektrike në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë për vitin 2025.

Klerimi i Transaksioneve në Tregun DAM në Zonën e Ofertimit Shqipëri viti 2025				
	Blerje		Shitje	
Periudha	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	49,555.68	7,150,583.28	57,027.21	8,498,085.52
Shkurt	40,924.58	6,557,544.31	53,609.79	8,639,306.65
Mars	52,636.21	5,087,914.87	51,092.72	5,115,897.28
Prill	63,209.13	4,739,985.95	66,522.97	5,264,049.74

Maj	64,549.53	5,045,050.13	63,400.01	4,905,709.77
Qershor	59,161.84	5,852,934.86	68,667.95	7,449,431.19
Korrik	84,706.12	10,156,276.74	82,325.69	10,315,674.43
Gusht	98,266.42	10,405,575.14	80,505.26	9,173,505.60
Shtator	78,221.68	7,787,995.11	65,002.03	6,339,348.49
Tetor	82,011.24	9,318,265.66	82,334.81	9,273,101.82
Nëntor	74,125.15	7,639,319.67	111,836.03	11,246,616.41
Dhjetor	60,899.55	7,237,552.75	96,812.18	11,740,348.44
Total 2025	808,267.13	86,978,998.46	879,136.65	97,961,075.35

Tabela 31. Klerimi i Transaksioneve në Tregun DAM në Zonën e Ofertimit Shqipëri viti 2025

(Burimi ALPEX sh.a.)

Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX në Zonën e Ofertimit Shqipëri 2025						
	Blerje		Shitje		Totali Blerje/Shitje	
Periudha	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro	Volumi për MWh	Vlera në Euro
Janar	49,558.97	7,150,933.34	57,822.83	8,723,738.60	107,381.80	15,874,671.94
Shkurt	40,932.58	6,558,504.31	54,095.51	8,663,856.27	95,028.09	15,222,360.58
Mars	52,817.21	5,109,135.19	51,269.25	5,133,224.06	104,086.46	10,242,359.25
Prill	63,404.18	4,755,445.80	66,523.02	5,264,049.99	129,927.20	10,019,495.79
Maj	65,250.72	5,106,789.31	63,728.35	4,944,401.04	128,979.07	10,051,190.35
Qershor	60,414.23	5,978,847.27	68,812.11	7,479,543.85	129,226.34	13,458,391.12
Korrik	86,598.45	10,453,279.27	82,336.75	10,317,283.80	168,935.20	20,770,563.07
Gusht	99,042.99	10,489,709.57	81,026.01	9,317,451.73	180,069.00	19,807,161.30
Shtator	79,402.89	7,913,171.43	65,428.35	6,429,206.05	144,831.24	14,342,377.49
Tetor	85,725.82	9,677,608.79	85,375.37	9,699,773.28	171,101.19	19,377,382.07
Nëntor	76,110.19	7,817,279.20	116,848.93	11,791,327.78	192,959.12	19,608,606.98
Dhjetor	61,010.93	7,251,108.50	97,752.55	11,910,859.02	158,763.48	19,161,967.52
Total 2025	820,269.16	88,261,811.99	891,019.03	99,674,715.48	1,711,288.19	187,936,527.46

Tabela 32. Klerimi i Transaksioneve në Tregjet e ALPEX sh.a. në Zonën e Ofertimit Shqipëri për të dyja tregjet

(Burimi ALPEX sh.a.)

Gjatë vitit 2025 kemi rritje për të gjithë treguesit krahasuar me vitin 2024.

Volumet në blerje janë rritur me 42,036 MWh dhe në vlerë janë rritur me 6,245,454 Euro.

Volumet në shitje janë rritur me 325,862 MWh dhe në vlerë janë rritur me 35,655,688 Euro.

Volumet në total janë rritur me 367,898 MWh dhe në vlerë janë rritur me 41,901,142 Euro.




Figura 53. Çmimi Klerues orar në €/MWh – 2025

(Burimi ALPEX sh.a.)




Figura 54. Volumet në MWh 2025

(Burimi ALPEX sh.a.)

Volumet ditore mesatare të tregtuara në ALPEX sh.a. për vitin 2025 jepen në grafikun e mëposhtëm.




Figura 55. Volumet ditore mesatare të tregtuara për vitin 2025
(Burimi ALPEX sh.a.)




Figura 56. Volumet në blerje të tregtuara për vitin 2025
(Burimi ALPEX sh.a.)

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat krahasimore të çmimeve mesatare të nxjerra në tregun vendas me ato të Bursës Hungareze HUPX dhe ato të HENEX.




Figura 57. Të dhënat krahasimore të çmimeve mesatare të nxjerra në tregun vendas me ato të Bursës Hungareze HUPX dhe ato të HENEX

ALPEX sh.a ka bërë gjithashtu analizën midis çmimeve mesatare të tij me ato të HUPX për të gjetur korrelacionin midis tyre. Nga të dhënat rezulton se në 64.4% të rasteve, çmimet ndjekin të njëjtin trend (rritës ose zbritës) ndërkohë çmimi mestar në HUPX rezulton më i ulët në 65.5% të rasteve ndërsa në ALPEX sh.a. 34.5% të rasteve ose 9.72 Euro/MWh mesatarisht më i lartë në ditë.

ALPEX sh.a ka bërë analizën midis çmimeve mesatare të tij me ato të HENEX për të gjetur korrelacionin midis tyre. Nga të dhënat rezulton se në 62.7% të rasteve, çmimet ndjekin të njëjtin trend (rritës ose zbritës) ndërkohë çmimi mestar në HENEX rezulton më i ulët në 74.2% të rasteve ndërsa në ALPEX në 25.8% të rasteve ose 14.63 Euro/MWh mesatarisht më i lartë në ditë

3.7. Masat e marra nga Operatorët në zbatim të Rregullores së Sigurisë Kibernetike

Shoqëritë të cilat janë subjekt i zbatimit të “Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126 datë 30.07.2020, i ndryshuar, kanë vijuar punën me marrjen e masave për zbatimin e kësaj rregulloreje, përfshirë dhe raportimin periodik në ERE.

Gjatë vitit 2025, në zbatim të vendimit nr. 79, datë 14.04.2025, u ndërmorën masa rregullatore për përditësimin e listës së operatorëve, me qëllim përfshirjen e të gjithë operatorëve kryesorë të sektorit të energjisë (përfshirë edhe gazin natyror) në rregulloren e sigurisë kibernetike.

Ky përditësim mundëson zgjerimin e listës së Operatorëve të Infrastrukturave Kritike të Informacionit (OIKI), duke përfshirë në këtë rregullore të gjithë operatorët që administrojnë asete të rëndësishme në fushën e energjisë. Përmes këtij vendimi sigurohet që çdo operator apo shoqëri me rëndësi kritike në tregun energjetik të zbatojë kërkesat e kësaj rregulloreje për sigurinë kibernetike, duke garantuar kështu qëndrueshmërinë dhe paprekshmërinë e infrastrukturës kritike.

Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit (OIKI) në sektorin e energjisë elektrike, në raportimet e paraqitura për vitin 2025, kanë evidentuar se gjatë periudhës së raportimit nuk janë raportuar incidente kibernetike që të kenë ndikuar në funksionimin e sistemeve apo në operimin e infrastrukturës kritike. Raportimet e paraqitura nga operatorët janë fokusuar kryesisht në masat teknike dhe organizative të ndërmarra për forcimin e sigurisë kibernetike, përfshirë hartimin dhe përditësimin e planeve për sigurinë kibernetike, ndjekjen e proceseve të certifikimit sipas standardit ISO/IEC 27001, si dhe rastet kur operatorët ndodhen në faza të ndryshme të implementimit ose përgatitjes për këtë certifikim.

Gjithashtu evidentohet bashkëpunimi institucional me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), në funksion të përmbushjes së kërkesave rregullatore dhe forcimit të kapaciteteve për menaxhimin dhe parandalimin e rreziqeve kibernetike në sektorin e energjisë elektrike.

Masat për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturave kritike të ndërmarra nga OST sh.a.

Në kuadër të përmirësimit të sigurisë kibernetike, OST sh.a. ka ndërmarrë një sërë masash teknike dhe organizative për të forcuar mbrojtjen e sistemeve dhe rrjeteve të saj. Fillimisht është zgjeruar sistemi i mbrojtjes antivirus dhe janë implementuar platforma të avancuara për zbulimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve si XDR (Extended Detection and Response) dhe XPR, të cilat mundësojnë monitorimin e vazhdueshëm të rrjetit dhe identifikimin e rreziqeve kibernetike në kohë reale. Në mjediset OST sh.a., përfshirë sistemet SCADA/EMS, pas implementimit të zgjidhjes Trellix është siguruar një nivel i avancuar mbrojtjeje kibernetike për mjediset industriale, duke mundësuar zbulimin e hershëm të kërcënimeve, monitorimin e vazhdueshëm dhe mbrojtjen ndaj malware dhe sulmeve kibernetike, pa ndikuar në operimin normal të sistemeve kritike. Gjithashtu është implementuar platforma FortiSIEM, e cila mundëson monitorimin e centralizuar, korelacion inteligjent të log-eve dhe zbulimin në kohë reale të incidenteve të sigurisë në rrjetet IT të OST sh.a.. Kjo platformë rrit dukshmërinë operacionale të sistemeve, mbështet

përputhshmërinë me kërkesat rregullatore dhe përmirëson reagimin proaktiv ndaj kërcënimeve kibernetike. Paralelisht, përdoren edhe platforma inteligjente për analizën e të dhënave, të cilat ndihmojnë në identifikimin e dobësive të sistemit dhe në reagimin e shpejtë ndaj incidenteve të mundshme të sigurisë.

Në të gjithë infrastrukturën e OST sh.a., përfshirë edhe infrastrukturën kritike SCADA/EMS, janë implementuar pajisje Next Generation Firewall me shërbime aktive të avancuara si IPS/IDS, Application Control, Malware Protection, Advanced Threat Protection dhe URL Filtering. Filtrimi, monitorimi dhe bllokimi i trafikut realizohet përmes këtyre sistemeve firewall, të cilat janë të instaluar dhe të konfiguruar në ambientet on-premise të organizatës. Për më tepër, për mbrojtjen e aplikacioneve web është implementuar edhe Web Application Firewall (WAF), ndërsa infrastruktura e rrjetit mbështetet edhe nga serverë të brendshëm DNS për rritjen e sigurisë së komunikimeve. Për të garantuar disponueshmërinë dhe vazhdimësinë e operimit të sistemeve, të gjitha pajisjet core-network, përfshirë firewall-et dhe core switch-et L3, janë konfiguruar në cluster high-availability (active/passive) ose në konfigurim switch stack. Në infrastrukturën kritike SCADA/EMS është implementuar gjithashtu replikimi i të dhënave në nivel storage në konfigurim Active/Active, duke siguruar redundancë dhe vazhdimësi të operimit edhe në rast të dështimeve të mundshme të sistemeve.

Për rritjen e kontrollit të aksesit në sistemet kritike janë implementuar mekanizma të avancuar sigurie si ZTNA (Zero Trust Network Access), MFA (Multi-Factor Authentication) dhe PAM (Privileged Access Management), të cilat mundësojnë një menaxhim më të sigurt të identitetit dhe të aksesit të përdoruesve. Arkitektura ZTNA përfshin edhe mekanizma autentikimi me 2FA, duke siguruar që aksesit në sistemet kritike të realizohet vetëm nga përdorues të autorizuar dhe të verifikuar.

Gjithashtu është implementuar një sistem për zbulimin e intruzioneve (IDS) për monitorimin e trafikut në rrjet dhe identifikimin e aktiviteteve të dyshimta, ndërsa platforma SIEM mundëson monitorimin dhe analizimin e ngjarjeve të sigurisë në mënyrë të centralizuar dhe në kohë reale. Për menaxhimin e përdoruesve dhe të identiteteve përdoret Active Directory, i cili ndihmon në administrimin e aksesit dhe në zbatimin e politikave të sigurisë në nivel organizate.

Në aspektin organizativ dhe të ndërgjegjësimit të stafit, gjatë vitit 2025 janë zhvilluar sesione informimi dhe ndërgjegjësimi me stafin e njësive operative dhe të aparatit qendror, me fokus në sigurinë e informacionit, rritjen e ndërgjegjësimit ndaj rreziqeve kibernetike, prezantimin e shembujve praktikë të sulmeve kibernetike – përfshirë sulmet phishing përmes email-it – si dhe theksimin e rëndësisë së mbrojtjes së informacionit për një operator të infrastrukturës kritike.

Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sigurisë së informacionit, zhvillohen gjithashtu auditime të brendshme në përputhje me standardin ISO/IEC 27001, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe identifikimin e përmirësimeve të nevojshme.

Sa i përket incidenteve të sigurisë kibernetike, gjatë periudhës së raportimit nuk janë evidentuar incidente që të kenë ndikuar në funksionimin e sistemeve. Është identifikuar vetëm një rast i pranishëm së një malware-i në nënstacionin Titan, në një nga pajisjet e sistemit, i cili është izoluar dhe menaxhuar menjëherë pa shkaktuar probleme apo ndërprerje në operimin e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025 raportohet vijimi i procesit të auditimit për certifikimin sipas standardit ISO/IEC 27001, i cili përbën një detyrim të përcaktuar në nenin 10 të Rregullores për Sigurinë Kibernetike.

Në përfundim, këto masa synojnë rritjen e nivelit të mbrojtjes së infrastrukturës kritike të OST sh.a. dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në vend, duke minimizuar rreziqet nga kërcënimet kibernetike dhe duke

siguruar vazhdimësinë e shërbimeve energjetike.

Masat për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturave kritike të ndërmarra nga KESH sh.a.

Nga analiza e dokumentacionit dhe procedurave të zbatuara rezulton se kërkesat e formatit të raportimit të ERE janë adresuar dhe dokumentuar në përputhje me standardin ISO/IEC 27001. KESH raporton se certifikimi ISO/IEC 27001, i cili ka përfunduar në fund të vitit 2024, ende nuk është rinovuar. Sipas informacionit të paraqitur, kjo lidhet me ndërprerjen e financimit të projektit të mbështetur nga USAID për sistemet e sigurisë kibernetike. Në raportimin për gjashtëmujorin e parë të vitit 2025 theksohet se janë ndërmarrë hapat për sigurimin e financimit nga burime të brendshme dhe se procesi i rinovimit të certifikatës ISO/IEC 27001 parashikohet të ndiqet me mbështetjen e fondeve të KESH sh.a., duke filluar nga viti 2026. Pavarësisht kësaj, politikat, procedurat dhe dokumentacioni për menaxhimin e sigurisë së informacionit vijojnë të zbatohen në përputhje me kërkesat e këtij standardi.

Nga analiza e sistemeve dhe proceseve të sigurisë kibernetike rezulton se infrastruktura e monitorimit dhe mbrojtjes së sistemeve të informacionit vijon të funksionojë normalisht, duke mundësuar identifikimin dhe analizimin në kohë reale të aktiviteteve të dyshimta në rrjet. Këto sisteme kontribuojnë në ruajtjen e integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së sistemeve të informacionit dhe të infrastrukturës kritike të operatorit të sistemit të transmetimit.

Gjatë periudhës së raportimit nuk janë raportuar incidente kibernetike që të kenë ndikuar në funksionimin e sistemeve apo në operimin e infrastrukturës kritike. Nga verifikimet e kryera rezulton se gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë disa masa shtesë për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike të infrastrukturës teknologjike, ndër të cilat përfshihen:

- Monitorimi i vazhdueshëm i funksionimit të sistemeve të sigurisë si Proxy, Next Generation Firewall, ESA dhe Trellix;
- Rinovimi i licencës së sistemit Proxy dhe përditësimi i konfigurimeve përkatëse;
- Përditësimi i sistemeve Next Generation Firewall me versionet dhe rregullat më të fundit të sigurisë;
- Rinovimi i platformave të sigurisë Trellix dhe ESA për mbrojtjen e sistemeve dhe komunikimeve;
- Realizimi i segmentimit të rrjetit (network segmentation) për rritjen e izolimit të sistemeve kritike dhe përmirësimin e kontrollit të trafikut në rrjet;
- Përditësimi i pajisjeve fundore me versionet më të fundit të softuerit dhe ndërmarrja e masave për zëvendësimin gradual të pajisjeve që kanë arritur fundin e ciklit të jetës (end-of-life), ku deri më tani janë zëvendësuar rreth 80 kompjutera;
- Zhvillimi i auditimeve të sigurisë dhe testeve të penetrimit në mënyrë periodike për identifikimin e dobësive të mundshme në infrastrukturën teknologjike;
- Organizimi i trajnimeve të rregullta për stafin mbi sulmet e mundshme phishing dhe rritjen e ndërgjegjësisë mbi praktikatat e sigurisë së informacionit.

Në përfundim, nga analiza e kryer rezulton se masat e ndërmarra kontribuojnë në forcimin e mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe në garantimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemeve të transmetimit të energjisë elektrike, duke reduktuar rreziqet që lidhen me kërcënimet kibernetike.

Masat për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturave kritike të ndërmarra nga OSHEE sh.a.

Në funksion të forcimit të sigurisë kibernetike, OSHEE sh.a. ka vijuar implementimin dhe përmirësimin e një sërë masash teknike dhe organizative për mbrojtjen e infrastrukturës së saj

teknologjike. Në këtë kuadër është implementuar një arkitekturë e integruar për menaxhimin dhe monitorimin e incidenteve të sigurisë, e cila përfshin sisteme dhe platforma të ndryshme si Endpoint Detection and Response (EDR), Identity and Access Management (IAM), Web Application Firewall (WAF), Database Firewall (DM), User and Entity Behavior Analytics (UEBA), Privileged Access Management (PAM), si dhe mekanizma të tjerë për monitorimin dhe analizimin e ngjarjeve të sigurisë.

Në drejtim të mbrojtjes së infrastrukturës së rrjetit dhe sistemeve të informacionit, janë ndërmarrë masa për përmirësimin e mekanizmave të filtrimit dhe mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike, përfshirë mbrojtjen ndaj sulmeve të tipit XSS, SQL Injection, Illegal Resource Access dhe sulmeve të tipit DDoS. Gjithashtu është realizuar konfigurimi dhe përforsimi i platformës Web Application Firewall (WAF), duke shtuar një shtresë të mëtejshme mbrojtjeje për shërbimet online.

Në kuadër të menaxhimit të vulnerabiliteteve, është kryer vlerësimi i vazhdueshëm i dobësive të mundshme në sistemet dhe aplikacionet kritike, me qëllim identifikimin dhe adresimin e rreziqeve që mund të çojnë në komprometimin e sistemeve të informacionit. Për këtë qëllim janë realizuar teste penetrimi dhe vlerësime të sigurisë për shërbimet online kritike.

Gjithashtu janë ndërmarrë masa për përmirësimin e menaxhimit të përditësimeve të sigurisë (patch management), përmes proceseve të automatizuara për aplikimin e përditësimeve në sistemet operative dhe pajisjet e rrjetit, përfshirë serverët, firewall-et dhe pajisjet e rrjetit. Paralelisht është realizuar edhe përditësimi i pajisjeve fundore dhe zëvendësimi gradual i pajisjeve që kanë arritur fundin e ciklit të jetës (end-of-life).

Në drejtim të menaxhimit të aksesit dhe kontrollit të privilegjeve, OSHEE sh.a. ka vijuar implementimin e një arkitekture të bazuar në parimet e Zero Trust, e cila përfshin mekanizma të kontrollit të aksesit si Privileged Access Management (PAM), Cisco Identity Services Engine (ISE), Active Directory dhe segmentim të rrjetit përmes VLAN dhe mikrosegmentimit.

Gjithashtu janë ndërmarrë masa për segmentimin e rrjetit dhe përmirësimin e arkitekturës së komunikimeve në rrjet përmes implementimit të teknologjive SD-WAN dhe DVVPN, të cilat mundësojnë komunikim më të sigurt ndërmjet pikave të ndryshme të rrjetit. Në funksion të garantimit të vazhdimësisë së operimit të sistemeve kritike janë përditësuar dhe testuar procedurat për Disaster Recovery dhe Cyber Recovery, të mbështetura nga mekanizmat e backup-it dhe testime periodike të rikuperimit të të dhënave. Në aspektin organizativ, OSHEE sh.a. ka vijuar kryerjen e auditimeve të brendshme të sigurisë së informacionit, si dhe zhvillimin e trajnimeve dhe sesioneve të ndërgjegjësimit për stafin lidhur me rreziqet kibernetike, përfshirë sensibilizimin ndaj sulmeve phishing dhe praktikave të sigurta në përdorimin e sistemeve të informacionit.

Megjithatë, nga shqyrtimi i raportimeve rezulton se OSHEE sh.a. gjatë vitit 2025 nuk ka informuar mbi ecurinë e procesit të certifikimit sipas standardit ISO/IEC 27001, i cili përbën një detyrim të përcaktuar në nenin 10 të Rregullores për Sigurinë Kibernetike. Gjatë periudhës së raportimit nuk janë raportuar incidente kibernetike që të kenë ndikuar në funksionimin e sistemeve apo në operimin e infrastrukturës kritike.

Në përfundim, nga analiza e kryer rezulton se OSHEE sh.a. ka ndërmarrë masa të vazhdueshme për përmirësimin e nivelit të sigurisë kibernetike të infrastrukturës së saj teknologjike, duke zbatuar mekanizma për monitorimin, parandalimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve kibernetike dhe duke forcuar kontrollin e aksesit dhe menaxhimin e rreziqeve në sistemet e informacionit.

4. LICENCIMI DHE DHËNIA E AUTORIZIMEVE GJATË VITIT 2025

4.1 Procedurat e Licencimit gjatë vitit 2025

Në zbatim të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, ligjit nr.102/2015 *“Për sektorin e gazit natyror”*, i ndryshuar, *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar, si dhe *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”*, çdo subjekt që kërkon të licencohet në një nga veprimtaritë/aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike apo të gazit natyror, si dhe çdo i licencuar që kërkon të rinovojë, modifikojë, transferojë licencën e tij, duhet të paraqesë në ERE aplikimin përkatës duke plotësuar të gjitha kërkesat sipas kuadrit ligjor e nënligjor të sipërcituar.

Viti 2025 është karakterizuar nga rritje e konsiderueshme e interesit për investime në sektorin e energjisë, veçanërisht në prodhimin nga burime të rinovueshme, ku janë trajtuar një numër i madh aplikimesh për licencimin e subjekteve në veprimtaritë/aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike, të cilat, përpos analizës së përmbushjes së kritereve të kuadri ligjor në fuqi, kanë kërkuar dhe zhvillimin e korrespondencës përkatëse dhe me institucione/organe të tjera të përfshira, si me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. etj.

Në trajtimin e secilit aplikim janë respektuar parimet e:

- Transparencës dhe publikimit të informacionit;
- Sigurisë juridike dhe trajtimit të barabartë të subjekteve;
- Zbatimit rigoroz të legjislacionit në fuqi.

ERE ka shqyrtuar të gjitha aplikimet e paraqitura për licencim dhe ka marrë vendimet përkatëse për fillimin ose jo të procedurës për licencim, ku për të gjitha rastet e fillimit të procedurës së licencimit, janë bërë publikimet në median e shkruar, në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe në rrjetet sociale të ERE-s, për marrjen e opinioneve apo objeksioneve të mundshme nga palët e interesuara.

Në rast të fillimit të procedurës për shqyrtimin e aplikimit, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit, ERE ka publikuar në median e shkruar (në dy gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë), në faqen e saj zyrtare të internetit dhe në rrjetet sociale, një njoftim për aplikimin e paraqitur. Në çdo njoftim të publikuar, është parashtruar:

- një informacion i shkurtër për aplikimin e paraqitur;
- të dhënat lidhur me kapacitetin e instaluar të centralit dhe vendodhjen ku kryhet veprimtaria (në rastin e aplikimeve për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike);
- të dhëna në lidhje me afatin dhe mënyrën e paraqitjes së komenteve apo objeksioneve të ndryshme mbi aplikimin.

Në referencë të përcaktimeve të nenit 40, pika 1 të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i ndryshuar; nenit 19, pika 1, gërma ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, ERE ka respektuar afatet e pritjes së komenteve apo objeksioneve të mundshme, përkatësisht:

- për një afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga data e parë e publikimit të njoftimit për aplikimet për veprimtarinë e prodhimit për centralet e lidhura me rrjetin e transmetimit.
- për një afat prej 10 (tridhjetë) ditësh, për aplikimet për veprimtarinë e prodhimit për centralet e lidhura drejtpërdrejt me rrjetin e shpërndarjes dhe për aplikimet e tjera (furnizim dhe tregtim).

Në kuadër të transparencës, për çdo aplikim dhe procedurë licencimi në proces, ERE publikon në faqen e saj zyrtare dhe në rrjetet sociale, në mënyrë periodike, një regjistër me informacion në lidhje me statusin dhe ecurinë e procesit të shqyrtimit.

Pas analizimit të secilit aplikim, verifikimit të përmbushjes së të gjitha kushteve dhe kriterëve sipas legjislacionit në fuqi dhe brenda afatit të përcaktuar, është vijuar me licencimin e subjekteve, sipas llojit të aplikimit. Për të gjitha subjektet janë përgatitur licencat përkatëse dhe njoftimi i licencimit për vetë të licencuarit, po ashtu dhe për institucionet apo organet e interesuara, ku për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike është njoftuar MIE, “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., operatori i rrjetit ku është i lidhur centrali prodhues (sipas rastit OST sh.a. apo OSSH sh.a.), ndërsa në rastet e veprimtarisë së furnizimit dhe asaj të tregtimit të energjisë elektrike njoftohet i licencuari, OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a.

Pas çdo vendimmarrjeje të Bordit të ERE-s për licencim, rinovim, modifikim, transferim apo njohje licence; për çdo ndryshim të vendimit të licencimit; si dhe në çdo rast të përfundimit të vlefshmërisë së licencës përkatëse për ato subjekte që nuk kanë aplikuar për rinovim, është përditësuar regjistri i licencimeve, i cili është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

4.1.1 Licencimet dhe kërkesat e trajtuara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 janë paraqitur gjithsej 21 (njëzet e një) aplikime për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, ndër të cilat:

- 4 aplikime për licencim në prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet;
- 1 aplikim për licencim nga TEC;
- 14 aplikime për licencim në prodhimin e energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike;
- 2 aplikime për licencim në prodhimin e energjisë elektrike nga centralet eolike;

Për 14 (katërmëdhjetë) aplikime është vijuar trajtimi nga viti 2024, ndër të cilat 9 (nëntë) aplikime për licencim në prodhim, 3 (tre) aplikime në tregtim dhe 2 (dy) aplikime në furnizim.

Kështu në total, rezulton se përgjatë vitit 2025 janë trajtuar 30 aplikime për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Të gjitha aplikimet i janë nënshtruar analizës së plotë juridike, teknike dhe financiare, ku procesi i shqyrtimit ka përfshirë:

- verifikimin e dokumentacionit administrativ dhe ligjor;
- analizën e kapacitetit teknik;
- vlerësimin e planit të biznesit dhe të dokumentimit të mbështetjes financiare për realizimin e investimit;
- verifikimin e marrjes së miratimit/autorizimeve përkatëse nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndërtimin dhe operimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike;
- verifikimin e marrjes së lejeve/autorizimeve mjedisore dhe vlefshmërisë së tyre;
- verifikimin e marrjes së lejeve për përdorimin e burimeve ujore (në rastin e prodhimit të

energjisë elektrike nga HEC dhe TEC);

- verifikimin e marrjes së miratimit përkatës nga operatori i rrjetit për lidhjen e centralit gjenerues me rrjetin, sipas rastit, të shpërndarjes ose transmetimit të energjisë elektrike.
- të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me veprimtarinë që subjektet kanë kërkuar të licencohen në ERE.

Përveç korrespondencës së ndjekur me aplikuesit, në të gjitha hapat procedurale të shqyrtimit dhe analizimit të aplikimit, si praktikë e një procedure licencimi, gjatë këtij viti janë zhvilluar 14 seanca dëgjimore me aplikuesit, me qëllim sqarimin e dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht në aplikim.

Pas shqyrtimit të aplikimeve të paraqitura, rezulton se janë marrë 21 (njëzet e një) vendime për fillimin e procedurës për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Në vijim të fillimit të procedurës dhe të analizës së aplikimeve përkatëse dhe pas verifikimit të përmbushjes së të gjitha kushteve e kriterëve sipas legjislacionit në fuqi, në vitin 2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike janë licencuar 24 subjekte, si vijon:

Nr.	Subjekti	Burimi gjenerues i energjisë elektrike	Kapaciteti i instaluar	Vendimi i ERE-s
1.	“3AD Energy” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 1, datë 06.01.2025
2.	“DESLA” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	3 MW	Vendimi nr. 2, datë 06.01.2025
3.	“Sunny Side Energy” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	100 MW	Vendimi nr. 13, datë 16.01.2025
4.	“SAMASOL” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 14, datë 06.01.2025
5.	“REBESOL” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 15, datë 16.01.2025
6.	“ZENINA” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 25, datë 27.01.2025
7.	“MER ENERGJI” sh.p.k.	HEC “Faqekuqi 3”	1300 kW	Vendimi nr. 29, datë 03.02.2025
8.	“EB ENERGY” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 40, datë 14.02.2025
9.	“GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 41, datë 14.02.2025
10.	“DRIBEN” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 50, datë 27.02.2025
11.	“Deliu 3D” sh.p.k.	HEC “Shiroku”	1,6 MW	Vendimi nr. 51, datë 03.03.2025
12.	“RENEW” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 68, datë 08.04.2025
13.	“SOLAR HORIZON” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 94, datë 28.04.2025

14.	“GREEN ENERGY” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 121, datë 09.06.2025
15.	“GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k.	HEC “Grabova 1”	14.9 MW	Vendimi nr. 161, datë 18.07.2025
16.	“EZ-5 ENERGY” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	30 MW	Vendimi nr. 171, datë 31.07.2025
17.	“KËLCYRA 2020” sh.p.k.	HEC “Klisyrë”	2 MW	Vendimi nr. 197, datë 15.08.2025
18.	“POWER ENERGY” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	25 MW	Vendimi nr. 197, datë 15.08.2025
19.	“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k.	Central Fotovoltaik	12 MW	Vendimi nr. 202, datë 01.09.2025
20.	“AMEL ENERGY” sh.p.k.	Centrali Fotovoltaik	2 MW	Vendimi nr. 207, datë 09.09.2025
21.	“Infotelecom-Albsolar sh.p.k. 4”	Centrali Fotovoltaik	35.6 MW	Vendimi nr. 287, datë 13.11.2025
22.	“IDI 2005” sh.p.k.	Centrali Fotovoltaik	8.8 MW	Vendimi nr. 289, datë 13.11.2025
23.	“NIKOLICA SKI RESORT” sh.p.k.	Central Eolik	3 MW	Vendimi nr. 301, datë 17.11.2025
24.	“SPITALLA SOLAR” sh.p.k.	Centrali Fotovoltaik	90 MW	Vendimi nr. 302, datë 17.11.2025

Tabela 33. Të licencuarit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike gjatë 2025

Sikurse rezulton nga tabela e mësipërme, në total gjatë vitit 2025, janë licencuar subjekte me një kapacitet total të instaluar prej 349.2 MW, nga të cilat 19.8 MW nga prodhimi i energjisë elektrike nga burimet hidrike, 326.4 MW nga prodhimi i energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike dhe 3 MW nga prodhimi i energjisë elektrike nga central eolik, e pasqyruar kjo dhe në grafikun në vijim:




Figura 88. Kapaciteti i instaluar sipas burimit

Këto të dhëna dëshmojnë orientimin strategjik të investimeve drejt energjiave të rinovueshme dhe konfirmojnë trendin e tranzicionit energjetik në Republikën e Shqipërisë.

Për krahasim, në vitin 2024, kapaciteti prodhues i energjisë elektrike i licencuar ishte 333.086 MW, nga të cilat 31.951 MW për burimet hidrike dhe 301.135 MW për burimet fotovoltaike. Pra, për vitin 2025, vihet re një rritje e kapacitetit total të instaluar dhe specifikisht të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike, ku risi për këtë vit është dhe licencimi i një shoqërie për prodhimin e energjisë elektrike nga central eolik, çka dëshmon dhe prirjen për diversifikimin e portofolit të energjisë elektrike. Për sa i përket centraleve fotovoltaike, rezulton se deri në fund të vitit 2025 ERE ka licencuar subjektet përkatëse për një kapacitet total të instaluar prej 980.624 MW, ndërsa kapaciteti total i instaluar që ka hyrë në prodhim deri në vitin 2025 është 631,07 MW.

4.1.2 Licencimi në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike

Përgjatë vitit 2025, ERE ka vijuar dhe me shqyrtimin e aplikimeve dhe licencimin e subjekteve në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, ku rezulton se janë licencuar 7 subjekte.

Të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike gjatë 2025

Nr.	Subjekti	Vendimi i ERE-s
1.	“MET Albania” sh.a.	Vendimi nr. 22, datë 20.01.2025
2.	“NAD INVESTMENT” sh.p.k.	Vendimi nr. 99, datë 12.05.2025
3.	“SPV BLUE 2” sh.p.k.	Vendimi nr. 153, datë 17.07.2025
4.	“GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” sh.p.k.	Vendimi nr. 203, datë 01.09.2025
5.	“GREEN VALUE” sh.p.k.	Vendimi nr. 249, datë 08.10.2025
6.	“Vivid Power” sh.p.k.	Vendimi nr. 262, datë 21.10.2025
7.	“GSA Energy” sh.p.k.	Vendimi nr. 272, datë 31.10.2025

Tabela 34. Të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike gjatë 2025

Ndërkohë gjatë vitit 2025 është paraqitur në ERE dhe është miratuar 1 (një) kërkesë për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shkak të përfundimit të afatit 5-vjeçar të vlefshmërisë së saj. Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 286, datë 13.11.2025, u rinovua licenca e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

4.2 Licencimi në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

Përgjatë vitit 2025, ERE ka vijuar të licencojë subjekte në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Në tabelën më poshtë jepen subjektet e licencuara nga ERE në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Sikurse evidentohet për vitin 2025 janë realizuar 12 licencime nga ERE në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Nr.	Subjekti	Vendimi i ERE-s
1.	“DESLA” sh.p.k.,	Vendimi nr. 03, datë 06.01.2025
2.	“Sunny Side Energy” sh.p.k.	Vendimi nr. 04, datë 06.01.2025
3.	“MET Albania” sh.a.	Vendimi nr. 21, datë 20.01.2025
4.	“VOLTON” sh.p.k.	Vendimi nr. 31, datë 03.02.2025

5.	“NAD INVESTMENT” sh.p.k.	Vendimi nr. 100, datë 12.05.2025
6.	“SPV BLUE 2” sh.p.k.	Vendimi nr. 154, datë 17.07.2025
7.	“POWER ENERGY” sh.p.k.	Vendimi nr. 180, datë 07.08.2025
8.	“Energovia.Albania” sh.p.k.	Vendimi nr. 190, datë 12.08.2025
9.	“GREEN VALUE” sh.p.k.	Vendimi nr. 246, datë 30.09.2025
10.	“Reytech Trading” sh.p.k.	Vendimi nr. 260, datë 21.10.2025
11.	“Vivid Power” sh.p.k.	Vendimi nr. 261, datë 21.10.2025
12.	“GSA Energy” sh.p.k.	Vendimi nr. 273, datë 31.10.2025

Tabela 35. Të licencuarit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike gjatë 2025

Gjatë vitit 2025 është paraqitur 1 (një) aplikim për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., aplikim i cili është miratuar me vendimin e Bordit nr. 71, datë 08.04.2025.

4.3 Njohja e licencave

ERE gjatë vitit 2025, në përputhje me përcaktimin e Ligjit të Sektorit dhe në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, ka vijuar punën për njohjen e licencave të lëshuara nga një autoritet rregullator i një vendi tjetër, Palë Kontraktore e Komunitetit të Energjisë, një shteti Anëtar të Bashkimit Evropian, ose një vend tjetër me të cilin është nënshkruar një marrëveshje dypalëshe.

Në tabelën e mëposhtme jepen licencat të cilat janë njohur, ku evidentohet dhe lloji i veprimtarisë së tyre.

Nr.	Subjekti	Autoriteti Rregullator që ka lëshuar licencën	Lloji i veprimtarisë	Vendimi i Bordit të ERE-S
1.	“Management & Development Associates”, degë e shoqërisë së huaj	Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)	Furnizim	Vendimi nr. 258, datë 21.10.2025
2.	“Interenergo D.o.o – Kosova”, degë e shoqërisë së huaj	Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)	Tregtim	Vendimi nr. 282, datë 06.11.2025

Në vijim, në mënyrë grafike paraqiten të dhënat ndër vite të licencimit të subjekteve në aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike.




Figura 58. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike




Figura 59. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike




Figura 60. Nr. i licencave të miratuara në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike




Figura 61. Nr. i licencave të miratuara për të gjitha veprimtaritë sipas viteve

4.4 Vendimet e ERE-s në lidhje me zgjatjen e afatit të vendimmarrjes për aplikimet e paraqitura, pezullimin e afateve të vendimmarrjes, refuzimin e aplikimeve për licencim dhe heqjen e licencave.

4.4.1 Zgjata e afatit të vendimmarrjes

Pas konstatimeve, në të cilat ka rezultuar se nuk është plotësuar në afat informacioni/dokumentacioni i munguar, në referencë të përcaktimeve të nenit 14, pika 3 të *Rregullores së Licencimit*, gjatë vitit 2025, Bordi i ERE-s ka marrë 14 (katërmëdhjetë) vendime për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes me 30 ditë për procedurat e licencimit dhe rinovimit në sektorin e energjisë, me qëllim analizimin e plotë të dokumentacionit përkatës. Konkretisht, procesi ka përfshirë 7 (shtatë) vendime për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (për shoqëritë “MER ENERGJI” sh.p.k., “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k., “GREEN ENERGY” sh.p.k., “Infotelecom-Albsolar 4” sh.p.k., “SunPro” sh.p.k. dhe “PROSOL” sh.p.k.), 5

vendime për aktivitetin e tregtimit, ku përfshihen aplikime të reja dhe rinovime (për shoqëritë “SPV BLUE 2” sh.p.k., “Energovia.Albania” sh.p.k. dhe “GEGA-G” sh.p.k.), si dhe 2 vendime për licencimin në veprimtarinë e furnizimit për shoqërinë “SPV BLUE 2” sh.p.k.

4.4.2 Pezullimi i afateve të vendimmarrjes

Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 14, pika 10, të “*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, ku parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij, në mbështetje dhe të përcaktimeve të nenit 67, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, duke qenë se ka rezultuar se pajisja me një dokument të caktuar të aplikimit është kompetencë e një organi tjetër, janë marrë 7 (shtatë) vendime për pezullimin e afatit të vendimmarrjes përfundimtare për aplikimet si vijon:

- Për aplikimet për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike është marrë 1 (një) vendim, për shoqërinë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k.
- Për aplikimet për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike janë marrë 6 (gjashtë) vendime për pezullimin e afatit të vendimmarrjes, përkatësisht për aplikimet e shoqërive “GRABOVA HYDROPOWER” sh.p.k., “SunPro” sh.p.k., “IDI 2005” sh.p.k., “FIER THERMOELECTRIC” sh.a., “ELENERGJI” sh.p.k. dhe “BUSHTRICA 2017” sh.p.k.

Bordi i ERE-s gjatë vitit raportues, ka nxjerrë vendime të ndërmjetme për shoqëritë “SunPro” sh.p.k. dhe “IDI 2005” sh.p.k., duke lënë në fuqi masën e pezullimit por duke reflektuar ndryshime specifike në kërkesat procedurale. Konkretnisht, për shoqërinë “SunPro” sh.p.k. janë rishikuar afatet e depozitimit të dokumentacionit të munguar, ndërsa për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. është ndryshuar dispozitivi lidhur me llojin e dokumentacionit të kërkuar për plotësimin e dosjes.

4.4.3 Refuzim i aplikimit për licencim

Gjatë vitit 2025, në referencë të përcaktimeve të *Rregullores së Licencimit*, është refuzuar kërkesa e shoqërisë “GET Solar Solution” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për arsye të mosplotësimit në afat të dokumentacionit thelbësor të aplikimit.

4.4.4 Ndjekja e procedurave për heqjen e licencave për shkak të mosshlyerjes së pagesës rregullatore

Në zbatim të nenit 42 të Ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, i ndryshuar, dhe *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave*, Bordi i ERE-s ka iniciuar procesin e heqjes së licencave për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet e pagesës rregullatore. Gjatë kësaj periudhe, janë marrë 4 (katër) vendime për fillimin e procedurës së heqjes së licencës për shoqëritë “SELISHTE” sh.p.k. (prodhim), “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k. (furnizim) dhe “ENERGY SUPPLY – AL” sh.p.k. (për licencat e furnizimit dhe tregtimit).

Pas njoftimit zyrtar, shoqëria “SELISHTE” sh.p.k. shleu detyrimin brenda afatit ligjor, duke sjellë marrjen e vendimit për përfundimin e procedurës dhe shfuqizimin e masës fillestare. Ndërkohë, për shkak të mosshlyerjes së debisë edhe pas përfundimit të afateve të lëna në dispozicion, Bordi i ERE-s vendosi heqjen përfundimtare të licencave për veprimtarinë e furnizimit për shoqërinë “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” sh.p.k., si dhe heqjen e licencave për furnizim dhe tregtim për shoqërinë “ENERGY SUPPLY – AL” sh.p.k.

4.4.5 Heqja e licencës me kërkesë të të licencuarit

Gjatë vitit 2025, Bordi i ERE-s ka miratuar kërkesën e shoqërisë “GREEN Energy Trading Albania” sh.p.k. për heqjen e licencës së saj në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak të mos ushtrimit të aktivitetit.

4.4.6 Rishikim i akteve nënligjore për procedurat e licencimit

Gjatë vitit 2025 ka filluar procedura për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar. Ky rishikim është vlerësuar i nevojshëm në kuadër të përmirësimit dhe saktësimit të dokumentacionit dhe afateve përkatëse për aplikimet për licencimin, rinovimin, modifikim, transferim, njohje licence.

4.5 Dhënia e Autorizimeve nga ERE për Vitin 2025

Në përputhje me nenin 44 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE ushtron autoritetin e saj rregullator mbi çdo transferim që përfshin asetet fikse të të licencuarve. Sipas kësaj dispozite, transferimi i aseteve që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes (përmes shitjes, dhënies me qira, hipotekimit apo çdo forme tjetër disponimi) kërkon autorizimin e ERE-s. Ky proces garanton që ndryshimet në pronësi apo menaxhim të aseteve të mos çënojnë sigurinë e furnizimit dhe vijimësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve. Përfshirje nga ky detyrim bëjnë vetëm asetet me vlerë minimale ose ato që nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e licencuar, siç përcaktohet në rregulloret përkatëse. Çdo subjekt i licencuar në sektorin e energjisë elektrike apo të gazit natyror është i detyruar të paraqesë aplikimin pranë ERE-s, duke dokumentuar përmbushjen e të gjitha kërkesave ligjore dhe teknike, përpara finalizimit të çdo veprimi juridik mbi asetet kryesore të veprimtarisë.

Subjektet e licencuara kanë detyrimin ligjor për të marrë autorizimin paraprak të ERE-s për transferimin e aseteve të paluajtshme, ndryshimin e statusit ligjor, ndryshimin e ortakut/aksionarit kontrollues, si dhe për vendosjen e kuotave/aksioneve si mjete garancie ndaj të tretëve. Ky proces kryhet në zbatim të kushteve të licencës dhe kuadrit rregullator në fuqi, konkretisht: “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021 dhe “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.07.2016.

Për shkak të kompleksitetit të aplikimeve, vendimmarrja e Bordit është paraprirë nga seanca dëgjimore dhe korrespondencë e vazhdueshme me palët dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Transparenca e procesit garantohej përmes përditësimit periodik në faqen zyrtare të ERE-s të “Regjistrimit të autorizimeve të ERE-s për transferimin e kuotave-aksioneve apo ndryshimin e ortakut/aksionarit” dhe seksionit “Procedurat e autorizimit në proces”.

Me qëllim lehtësimin e procedurave dhe orientimin e saktë të subjekteve, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 193, datë 12.08.2025, përcaktoi modalitete të reja që mundësojnë shkurtimin e afateve të trajtimit. Për të gjithë të licencuarit që plotësojnë saktë dokumentacionin konform nenit 7 të Rregullores (VBD nr. 119/2016) që në fazën e parë, ERE shprehet mbi kërkesën për autorizim brenda një afati prej 45 ditësh nga data e aplikimit.

Gjatë vitit 2025, janë marrë vendimet për dhënie autorizimi, nga të cilat 5 vendime për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë; 26 vendime për vendosjen e kuotave/aksioneve si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve; 8 vendime për transferimin e

aseteve të paluajtshme të të licencuarve (të detajuara si më poshtë vijon):

Vendime për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë

Nr.	Subjekti	Vendimi i ERE-s
1.	“AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k.	Vendimi nr. 85, datë 24.04.2025
2.	“ARIS ALBANIA” sh.p.k.	Vendimi nr. 142, datë 07.07.2025
3.	“NRG Power” sh.p.k.	Vendimi nr. 210, datë 09.09.2025
4.	“D I E Z E L A” sh.p.k.	Vendimi nr. 216, datë 18.09.2025
5.	“PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k.	Vendimi nr. 304, datë 17.11.2025

Vendime për barrësimin e kuotave/aksioneve si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve

Nr.	Subjekti	Vendimi i ERE-s
1.	“KALISI HYDROPOWER” sh.p.k.	Vendimi nr. 42, datë 14.02.2025
2.	“GREEN ENERGY BILISHTI” sh.p.k.	Vendimi nr. 55, datë 03.03.2025
3.	“DRINI BULQIZE” sh.p.k.	Vendimi nr. 60, datë 10.03.2025
4.	“Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k.	Vendimi nr. 75, datë 14.04.2025
5.	“M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k.	Vendimi nr. 78, datë 14.04.2025
6.	“DELIU 3D” sh.p.k.	Vendimi nr. 107, datë 23.05.2025
7.	“G.S.K” sh.p.k.	Vendimi nr. 108, datë 23.05.2025
8.	“GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k.	Vendimi nr. 109, datë 23.05.2025
9.	“INFO-Telecom” sh.p.k.	Vendimi nr. 110, datë 23.05.2025
10.	“PARISOL” sh.p.k.	Vendimi nr. 127, datë 24.06.2025
11.	“ZENINA” sh.p.k.	Vendimi nr. 140, datë 07.07.2025
12.	“ARIS ALBANIA” sh.p.k.	Vendimi nr. 141, datë 07.07.2025
13.	“SLR ALBANIA” sh.p.k.	Vendimi nr. 157, datë 17.07.2025
14.	“NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k.	Vendimi nr. 162, datë 18.07.2025
15.	“SPV Blue 1” sh.p.k.	Vendimi nr. 169, datë 31.07.2025
16.	“DIMAX ALBANIA” sh.p.k.	Vendimi nr. 174, datë 31.07.2025
17.	“CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” sh.p.k.	Vendimi nr. 175, datë 31.07.2025
18.	“HYDROPOWER” sh.p.k.	Vendimi nr. 176, datë 31.07.2025
19.	“REBESOL” sh.p.k.	Vendimi nr. 183, datë 07.08.2025
20.	“SAMASOL” sh.p.k.	Vendimi nr. 184, datë 07.08.2025
21.	“SPV Blue 2” sh.p.k.	Vendimi nr. 192, datë 12.08.2025
22.	“RENEW” sh.p.k.	Vendimi nr. 199, datë 15.08.2025
23.	“ERSEKA SOLAR PARK 2” sh.p.k.	Vendimi nr. 274, datë 31.10.2025
24.	“AGE ERZEN” sh.p.k.	Vendimi nr. 275, datë 31.10.2025

25.	“Klos Torrent Works” sh.p.k.	Vendimi nr. 303, datë 17.11.2025
26.	“GREEN ENERGY” sh.p.k	Vendimi nr. 336, datë 18.12.2025

Vendime për transferimin e asetëve të paluajtshme (fiksë) të të licencuarve

Nr.	Subjekti	Vendimi i ERE-s
1.	“M.C. ENERGJI GOJAN” sh.p.k.	Vendimi nr. 77, datë 14.04.2025
2.	“5GX ENERGY” sh.p.k.	Vendimi nr. 106, datë 23.05.2025
3.	“GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k.	Vendimi nr. 128, datë 24.06.2025
4.	“DIMAX ALBANIA” sh.p.k.	Vendimi nr. 155, datë 17.07.2025
5.	“CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” sh.p.k.	Vendimi nr. 156, datë 17.07.2025
6.	“SPV Blue 1” sh.p.k.	Vendimi nr. 168, datë 31.07.2025
7.	“SPV Blue 2” sh.p.k.	Vendimi nr. 194, datë 12.08.2025
8.	“Erseka Solar Park 1” sh.p.k.	Vendimi nr. 263, datë 21.10.2025

Gjatë vitit 2025, ERE ka trajtuar një sërë kërkesash procedurale që lidhen me autorizimet për transferim asetesh dhe ndryshime statusi, duke aplikuar me rigorozitet kuadrin ligjor mbi vlerat minimale të asetëve dhe rregullat e procedurës administrative. Në këtë kuadër, Bordi ka vendosur mosmarrjen në shqyrtim të kërkesave për shoqëritë “ZENINA” sh.p.k. dhe “GREEN ENERGY” sh.p.k., pasi vlera e asetëve ishte nën pragun ligjor të përcaktuar në Rregulloren përkatëse. Po ashtu, kërkesa e shoqërisë “SOLAR HORIZON” sh.p.k. u refuzua pasi marrëdhënia juridike e barrës siguruese ishte krijuar përpara marrjes së statusit të të licencuarit.

Në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative, ERE ka vendosur përfundimin e procedurave për shoqëritë “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k., për shkak të tërheqjes me vullnetin e palës, nga aplikimi, si dhe për shoqërinë “HYDROPOWER” sh.p.k., për mungesë të plotësimit të kushtit financiar mbi vlerën e asetëve. Për rastet kur dokumentacioni i përcjellë ka qenë i paplotë, si në aplikimet e shoqërive “5GX ENERGY” sh.p.k. dhe “AGE ERZEN” sh.p.k., Bordi ka vendosur zgjatjen e afateve të vendimmarrjes përfundimtare me qëllim garantimin e një procesi të rregullt shqyrtimi.

Procesi rregullator gjatë këtij viti ka përfshirë gjithashtu shfuqizimin e autorizimeve të mëparshme për shoqëritë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. dhe “D I E Z E L A” sh.p.k. Paralelisht, janë miratuar 6 rishikime të vendimeve të Bordit lidhur me vendosjen e kuotave të kapitalit apo ndryshimin e ortakëve, me qëllim reflektimin e saktë të këtyre ndryshimeve në regjistrin tregtar pas plotësimit të kushteve specifike nga subjektet.

5. AKTIVITETI I ERE-S NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR

Në zbatim të neneve 19, 20, 79 dhe 83 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, të neneve 16, 17, 32, 75 dhe 92 të Ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ERE ushtron kompetencat e tij si autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara dhe për subjektet e ngarkuara me detyrim të shërbimit publik në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Tarifave dhe çmimet përcaktohen në përputhje me metodologjitë respektive në fuqi. Edhe përgjatë vitit 2025, ERE ka vijuar të ushtrojë rolin rregullator në miratimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, përmes veprimtarive si më poshtë:

- a. Analiza e kostove dhe miratimi i tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për:
 - Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror;
 - Miratimin e listës e çmimeve të Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX sh.a.) për tregun e ditës në avancë dhe tregun brenda së njëjtës ditë, të aplikueshme në rolin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

5.1 Vlerësimi i aktiviteteve të shoqërive të rregulluara si dhe shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2025.

5.1.1. Mbi tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2025 – 2027.

Mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, si dhe “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 279, datë 16.12.2024 vendosi miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike në vlerën 0.85 lekë/kWh, të vlefshme për periudhën rregullatore 1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027.

Referuar treguesve ekonomikë, financiarë dhe teknikë të raportuar periodikisht nga shoqëria gjatë vitit 2025, evidentohet se OST sh.a. ka vijuar të operojë në kushte të qëndrueshme financiare. Bazuar në analizën e të dhënave të raportuara, evidentohet se kostot e realizuara nga shoqëria nuk kanë tejkaluar nivelet e kostove të parashikuara dhe të marra në konsideratë nga ERE në procesin e përllogaritjes së tarifës mesatare të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, duke garantuar në këtë mënyrë sigurinë e vazhdimësisë së shërbimit të transmetimit në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

5.1.2. Mbi tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Me qëllim garantimin e vijimit të operimit të aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, dhe në përmbushje të detyrave të saj rregullatore, ERE, gjatë vitit 2025, ka vlerësuar lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022, rregjim i cili do të vijojë të aplikohet për OSSH sh.a. deri në 30.04.2026. Analiza që çoi në këtë vendimarrje u mbështet në rrethanat e konstatuara që lidhen me të dhëna paraprake dhe të pamjaftueshme nga ana e OSSH sh.a. që do të lejonin kryerjen e një vlerësimi të plotë të komponentëve të të ardhurave të kërkuara për periudhën e ardhshme ushtrimore. Për vijimin e këtij procesi, ERE konsideroi të nevojshme që shoqëria të depozitonte pasqyrat financiare të audituara për vitet 2024 dhe 2025, së bashku me aplikimin për shqyrtimin e tarifave të shpërndarjes sipas afateve dhe kërkesave rregullatore.

Vendimmarrja për përcaktimin e tarifave të përkohshme të shpërndarjes, u diktua nga një sërë rrethanash rregullatore dhe teknike që lidhen kryesisht me mungesën e informacionit të plotë për aktivitetin e operatorit të shpërndarjes, përfshirë analizën e detajuar të kostove operative, planin e investimeve, nivelin e humbjeve në rrjet, sasinë e energjisë së shpërndarë sipas niveleve të tensionit si dhe parashikimet financiare për periudhën përkatëse.

Tregues të tillë si niveli i humbjeve në rrjet, sasia e energjisë së shpërndarë sipas niveleve të tensionit, struktura e konsumit dhe performanca operative e rrjetit përbëjnë baza thelbësore për llogaritjen e të ardhurave të kërkuara dhe për përcaktimin e tarifave të shpërndarjes. Në kushtet kur këta komponentë të të ardhurave të kërkuara (kostot operative, amortizimi, investimet dhe norma e kthimit mbi kapitalin), nuk ishin të plotë, u vlerësua lënia në fuqi e tarifave aktuale për periudhën e sipërcituar.

Tarifat në fuqi të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për periudhën e sipërcituar paraqiten në tabelën në vijim:

TARIFAT DHE ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR PËR VITIN 2025		
SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE		
Përshkrimi	Nr. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifat për periudhën 1 Janar 2025 - 31 Dhjetor 2025		
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 288, Datë 23.12.2024	1.55 Lekë/kWh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20/10/6 kV	Nr. 288, Datë 23.12.2024	3.99 Lekë/kWh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 04 kV	Nr. 288, Datë 23.12.2024	6.42 Lekë/kWh
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Lekë/Muaj)	Nr. 288, Datë 23.12.2024	200 Lekë
Çmimi i aplikueshëm për faturimin e energjisë reaktive	Nr. 288, Datë 23.12.2024	1.92 Lekë/kVArh

Figura 62. Tarifat dhe Çmimet e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror për vitin 2025

5.1.3. Mbi çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë për vitin 2025

Shoqëria FSHU sh.a. paraqiti pranë ERE-s një kërkesë për rivlerësimin e kostove që përcaktojnë çmimin e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e shërbimit universal, me efekt nga data 1 shkurt 2025. Në kuadër të kësaj kërkesë u propozua struktura e re e çmimeve të shitjes me pakicë për periudhën 1 shkurt – 31 dhjetor 2025, sipas së cilës çmimi për klientët familjarë me konsum deri në 700 kWh/muaj të përcaktohej në nivelin 8.5 lekë/kWh, ndërsa për klientët familjarë me konsum mbi 700 kWh/muaj çmimi të ishte 9.5 lekë/kWh për të gjithë sasinë e konsumuar, duke filluar nga kWh i parë. Në të njëjtën kohë, u propozua që çmimi për klientët jofamiljarë të mbetej i pandryshuar.

Në vijim të këtij propozimi, ERE realizoi vlerësimin e treguesve financiarë të shoqërisë për vitin ushtrimor 2025, duke analizuar të ardhurat e pritshme dhe kostot e furnizimit me energji elektrike për klientët e shërbimit universal. Nga analiza rezultoi se çmimet e propozuara siguronin të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e kostove dhe të ardhurave të kërkuara për periudhën përkatëse. Për rrjedhojë, Bordi i ERE vendosi miratimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 shkurt – 31 dhjetor 2025, duke përcaktuar çmimin 8.5 lekë/kWh për klientët familjarë me konsum deri në 700 kWh/muaj dhe 9.5 lekë/kWh për klientët familjarë me konsum mbi këtë nivel, ndërsa çmimet për klientët jofamiljarë mbetën të pandryshuara. Peshat specifike që zë kategoria e klientëve familjarë, konsumi i të cilëve është nën 700 kWh/muaj ka rezultuar rreth 87% e totalit të klientëve familjarë.

5.1.4. Mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW.

FSHU sh.a. paraqiti në ERE kërkesën për rivlerësimin e të ardhurave dhe miratimin e një çmimi të diferencuar për energjinë elektrike të përdorur në stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11 kW. Sipas shoqërisë, ishte e nevojshme krijimi i një kategorie të re të

konsumatoreë që përdorin pikat e karikimit të makinave elektrike, nisur nga fakti që struktura e konsumit të energjisë gjatë vitit 2025 kishte pësuar ndryshime të rëndësishme sa i takon rritjes së energjisë së konsumuar për karikimin e makinave elektrike, përdorimi i të cilave ka patur rritje nga viti në vit, nisur dhe nga fakti se numri i makinave të regjistruara sipas publikimeve zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor vijonte të kishte një rritje të shpejtë nga viti në vit.

Nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën janar – gusht 2025 rezultoi se shoqëria kishte ruajtur një performancë financiare pozitive, por kostoja e disbalancave ka qenë dukshëm më e lartë se ajo e parashikuar në planifikimin fillestar. Sipas FSHU sh.a., ky tejkalim lidhet edhe me rritjen e konsumit nga pikat dhe stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11 kW, si dhe me vështirësinë për të parashikuar me saktësi profilet e karikimit, për shkak të intensitetit të lartë të ngarkesës në fillim të procesit, variabilitetit në kohë dhe përdorimit paralel të më shumë se një automjeti. FSHU sh.a. propozoi çmimin 22 lekë/kWh për energjinë e konsumuar në stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11kW. Sipas shoqërisë, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW nga FSHU sh.a. rikuperon kostot e disbalancave që shkaktohen në vijim nga kjo kategori konsumatorësh. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në stacionet e karikimit u propozua të aplikohet vetëm për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me fuqi të instaluar mbi 11 kW, të cilët shfrytëzojnë kapacitetin e lejuar për karikimin e mjeteve elektrike në pika ose stacione karikimi. Ndërkohë, abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kW, të cilët përdorin pajisje karikimi me teknologji slow charge (AC) për nevojë vetjake, u propozua të vijohet tarifimi me çmimet aktuale të shitjes sipas kategorisë së konsumatorit.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 255, datë 15.10.2025 miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhura në nivelin e tensionit 04 kV, që filloi të aplikohet nga 1 nëntor 2025, ndërkohë që për abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kW FSHU sh.a., vijon aplikimi i çmimeve respektive të miratuara nga ERE. Më poshtë paraqiten çmimet e miratuara nga ERE për periudhën e sipërcituar:

TARIFAT DHE ÇMIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR PËR VITIN 2025		
ÇMIMET E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDORË QË SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL, MIRATUARA ME VENDIMIN NR.10, DATË 8.01.2025, PËR PERIUDHËN 1 SHKURT- 31 DHJETOR 2025		
Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive (Lekë/kWh)	**Çmimi i energjisë aktive në orar pik (Lekë/kWh)
Klientë të lidhur në 0.4 kV	14 Lekë/ kWh	16.1 Lekë/ kWh
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV:		
Kategoria I - Furra buke/ Prodhim mielli në 0.4 kV	7.6 Lekë/ kWh	8.74 Lekë/kWh
Kategoria II - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastigjeri në 0.4 kV	9.5 Lekë/kWh	10.93 Lekë/kWh
Kategoria III - Furrë buke, produkte mielli shoqëruese dhe pastigjeri, shërbim kafe në 0.4 kV	12 Lekë/kWh	13.80 Lekë/kWh
Objekte kulturi dhe bashkësi fetare	9.5 Lekë/kWh	
Familjarë:		
Konsumatorët familjarë që konsumojnë deri në 700 kwh në muaj	8.5 Lekë/kWh	
Konsumatorët familjarë që konsumojnë më shumë se 700 kwh në muaj	* 9.5 Lekë/kWh	
Çmimi për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (Ndriçim shkallë, pompë, ashensor,)	9.5 Lekë/kWh	
* Për konsumatorët familjarë të cilët konsumojnë 701 kWh në muaj e më tej, çmimi i energjisë elektrike do të jetë 9.5 lekë/kWh për të gjithë sasinë e konsumuar gjatë një muaji		
ÇMIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KARIKIMIN E MAKINAVE ELEKTRIKE NË PIKAT/STACIONET E KARIKIMIT ME FUQI TË INSTALUAR MBI 11 kW TË LIDHURA NË NIVELIN E TENSIONIT 04 kV TË MIRATUARA ME VENDIMIN NR.255, DATË 15.10.2025, NGA 1 NËNTOR 2025.		
Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive lekë/kWh	**Çmimi i energjisë aktive në pik lekë/kWh
Pika/stacione karikimi të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11kW	22 lekë/kWh	25.3 lekë/kWh
**Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është:		
Për periudhën 1 Nëntor -31 Mars nga ora 18:00 - 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 - 23:00		

5.1.5. Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025.

Në zbatim të nenit 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me vendimet e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019, Enti Rregullator i Energjisë ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), për kategoritë e klientëve si më poshtë:

- Klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit;
- Klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit;
- Shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime, të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Përlllogaritja e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit është kryer konform formulës së përcaktuar në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me anë të vendimit nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar.

- **Përlllogaritja e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e furnizuar në kushtet e mundësisë së fundit të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.**

Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për vitin 2025 rezulton të jetë 15.11 lekë/kWh, duke pësuar një rritje të lehtë prej rreth 0.2% krahasuar me çmimin mesatar të vitit 2024 prej 15.08 lekë/kWh. Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të dhënat mujore mbi çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për vitin 2025 si dhe vendimet respektive të Bordit të ERE-s. Për qëllime krahasimore, përbri të dhënave të vitit 2025 janë pasqyruar edhe të dhënat e vitit paraardhës sipas tabelës së mëposhtme:

Viti 2024	Vendimi i ERE	ERE (lekë/kWh) 2024	Viti 2025	Vendimi i ERE	ERE (lekë/kWh) 2025
Janar	Nr. 26, Datë 22.02.2024	13.80	Janar	Nr. 35, Datë 10.02.2025	18.16
Shkurt	Nr. 48, Datë 02.04.2024	11.83	Shkurt	Nr. 57, Datë 10.03.2025	19.76
Mars	Nr. 73, Datë 15.04.2024	11.07	Mars	Nr. 67, Datë 08.04.2025	13.41
Prill	Nr. 86, Datë 09.05.2024	9.84	Prill	Nr. 96, Datë 12.05.2025	11.51
Maj	Nr. 109, Datë 10.06.2024	10.73	Maj	Nr. 122, Datë 09.06.2025	11.88
Qershor	Nr. 137, Datë 10.07.2024	14.65	Qershor	Nr. 149, Datë 08.07.2025	13.97
Korrik	Nr. 161, Datë 15.08.2024	19.79	Korrik	Nr. 189, Datë 12.08.2025	16.06
Gusht	Nr. 180, Datë 12.09.2024	18.01	Gusht	Nr. 206, Datë 09.09.2025	14.70
Shtator	Nr. 275, Datë 13.12.2024	16.80	Shtator	Nr. 248, Datë 08.10.2025	14.76
Tetor	Nr. 240, Datë 14.11.2024	14.19	Tetor	Nr. 285, Datë 13.11.2025	16.60
Nëntor	Nr. 274, Datë 13.12.2024	21.53	Nëntor	Nr. 311, Datë 12.12.2025	14.52
Dhjetor	Nr. 11, Datë 08.01.2025	18.77	Dhjetor	Nr. 11, Datë 08.01.2025	15.98
Çmimi Mesatar Vjetor i Miratuar		15.08			15.11

Figura 63. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për klientët 35 kV për vitet 2024 – 2025.

Grafiku i mëposhtëm paraqet kurbën lëvizëse të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2025. Për efekt krahasimi, në grafik pasqyrohet gjithashtu kurba e çmimeve të shitjes për vitin 2024:




Figura 64. Kurba lëvizëse e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, për periudhën 2024-2025.
(Burimi: ERE)

Sikurse evidentohet në grafikun e mësipërm, kurba e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike të miratuara nga Bordi i ERE-s për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ka patur luhatje përgjatë muajve të vitit 2025. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025 ka patur këto ndryshime si pasojë edhe e luhatjes së çmimit të blerjes së energjisë elektrike në Bursë për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Vlera më e ulët e çmimit të shitjes për vitin 2025 rezultoi në muajin prill prej 11.51 lekë/kWh, ndërsa në muajin shkurt u regjistrua vlera më e lartë e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 19.76 lekë/kWh, për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Nga analizimi i të dhënave të raporteve periodike për vitin 2025, evidentohet se sasia e energjisë elektrike e shitur për klientët FMF, të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, ka qenë 19.9 GWh, me një vlerë të faturuar prej 205 milionë lekë, duke rezultuar në një çmim mesatar vjetor të realizuar prej 10.35 lekë/kWh. Në tabelën në vijim paraqiten diferencat e këtyre treguesve për vitin 2024 dhe 2025.

Periudha (klientët e lidhur në 35 kV)	Sasia (MWh)	Vlera (lekë)/1000	Çmimi mesatar i realizuar (Lekë/kWh)
2024	19,431	196,819	10.13
2025	19,907	205,951	10.35
Diferenca në %	2%	5%	2%

Figura 65. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2024-2025
(Burimi: ERE)

Çmimi mesatar i blerjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për vitin 2025 ka rezultuar të jetë 10.35 lekë/kWh. Ky çmim ka pësuar një rritje prej **2%** në krahasim me çmimin mesatar të blerjes së energjisë elektrike të vitit 2024, i cila ka rezultuar 10.13 lekë/kWh. Në tabelën në vijim janë paraqitur në formë tabelare të dhënat mujore mbi koston e blerjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Për qëllime krahasimore, përbri të dhënave të vitit 2025 janë pasqyruar edhe të dhënat e vitit paraardhës:

Muaji	ÇBEt (lekë/kWh) 2025	ÇBEt (lekë/kWh) 2024	Diferenca në përqindje
Janar	14.27	10.04	-42.1%
Shkurt	15.82	8.13	-94.6%
Mars	9.66	7.39	-30.7%
Prill	7.82	6.19	-26.3%
Maj	8.17	7.06	-15.7%
Qershor	10.20	10.86	6.1%
Korrik	12.23	15.85	22.8%
Gusht	10.92	14.12	22.7%
Shtator	10.97	12.95	15.3%
Tetor	12.76	10.42	-22.5%
Nëntor	10.74	17.54	38.8%
Dhjetor	12.15	14.86	18.2%
Mesatare	11.31	11.28	-0.22%

Figura 66. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për mbulimin e nevojës së klientëve FMF të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për periudhën 2024-2025.

(Burimi: ERE)

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet kurba lëvizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të mundësisë së fundit për klientët e lidhur në 35 kV, për vitet 2024-2025.




Figura 67. Kurba lëvizëse e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga FMF, për vitet 2024-2025.

(Burimi: ERE)

Nga sa evidentohet në tabelën e mësipërme, vlera më e ulët e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për vitin 2025 rezultoi në muajin prill, ku 1 kWh është blerë me 7.82 lekë/kWh, ose shprehur ndryshe 26.3% më e lartë se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë në muajin prill 2024. Nga krahasimi i mesatares vjetore të vitit 2024 (11.28 lekë/kWh) me mesataren vjetore të vitit 2025 (11.31 lekë/kWh), çmimi i energjisë elektrike të blerë në treg të lirë për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh FMF, ka qenë pothuajse i njëjtë.

• **Për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV**

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, i ndryshuar, klientët që plotësojnë kushtet teknike për daljen në treg të liberalizuar, nga data 1 janar 2022 mund të zgjedhin lirisht furnizuesin e tyre. Në pamundësi të sigurimit të një marrëveshjeje furnizimi me një nga subjektet e licencuara në këtë aktivitet, klientëve u lind e drejta e përdorimit të shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Referuar VKM-së nr. 456/2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji”, e ndryshuar, Shoqëria publike e prodhimit ka të drejtë që t’i shesë energji Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për furnizimin e kategorive të caktuara të klientëve të dalë në treg të lirë, sipas çmimit dhe sasisë së përcaktuar nga Asambleja e shoqërisë. Në rastin kur Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ushtrohet nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, kjo marrëdhënie pasqyrohet në kontratën që kanë palët.

Në zbatim të vendimit nr. 10121/1, datë 31.12.2024 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, shoqëria KESH sh.a. furnizoi edhe për vitin 2025 të gjithë sasinë e kërkuar të energjisë elektrike për klientët e FMF, të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV. Kosto e blerjes së sasisë së energjisë për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh, ishte 12 lekë/kWh ndërsa komponentët e

tjerë përlllogaritës të çmimit ishin konstant.

Bordi i ERE-s me vendimin nr.33, datë 10.02.2025, miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025 për klientët e FMF të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, prej 18.26 lekë/kWh.

Referuar raporteve periodike të ERE-s për vitin 2025, rezulton se sasia e energjisë së konsumuar nga klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV për këtë vit është 461 GWh me një vlerë të faturuar prej afro 7,538 milionë lekë.

Periodha (klientët e lidhur në 20/10/6 kV)	Sasia (MWh)	Vlera (lekë)/1000	Çmimi mesatar i realizuar (Lekë/kWh)
2024	590,319	9,898,069	16.77
2025	461,181	7,538,365	16.35
Diferenca në %	-22%	-24%	-3%

Tabela 36. Realizimi i treguesve të FMF për vitet 2024-2025, për klientët e lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV.

(Burimi: ERE)

5.1.6. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025 për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime të cilat furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. paraqiti në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF, Ujësjetllës Kanalizime të lidhur në nivelet e tensionit 20/10/6 kV dhe 35 kV.

Bazuar në pikën 1, neni 8 të VKM-së nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zabtohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcaktohet se shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve kanë status të veçantë, si shoqëri të cilat sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve. Më tej, referuar pikës 2, neni 8 të VKM-së së mësipërme, klientëve të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, u sigurohet furnizim i pandërprerë edhe në rast se kanë dalë në treg të liberalizuar dhe furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

Bazuar në të dhënat e aplikimit të shoqërisë FSHU sh.a. si dhe nenit 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, ERE kreu përlllogaritjen e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për këtë kategori klientësh, në varësi të nivelit të tensionit ku janë të lidhur, të cilat rezultuan si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime 2025				
Viti 2025			Nivelet e tensionit	
			35 kv	20/10/6 kV
ÇBET	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Njësia	Çmimi	Çmimi
		Lekë/kWh		
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.17	0.17
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85	0.85
TSht	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = ÇBET + Pr*ÇBET + TRr + TSht + CA		Lekë/kWh	9.33	11.77

Figura 68. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga FMF sipas nivelit të tensionit për vitin 2025, për shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime.

(Burimi: ERE)

Shoqëria KESH sh.a. me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, siguroi energjinë elektrike për FMF, me qëllim mbulimin e kërkesës për furnizimin e shoqërive të Ujësjellës Kanalizime, për vitin 2025, të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV si dhe 20/10/6 kV me një çmim prej 5.70 lekë/kWh.

Me vendimin nr. 34, datë 10.02.2025, Bordi i ERE-s vendosi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025 prej:

- **9.33 lekë/kWh** për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 kV.
- **11.77 lekë/kWh** për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

5.1.7. Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga Shoqëria Albga sh.a. për vitin 2025.

Në zbatim të nenit 17, pika 1, germa “e”, të ligjit nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, përcaktohet se “ERE ka të drejtë të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarje, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave”. Shoqëria kërkoi që për vitin 2025 të mbetej në fuqi tarifa e transmetimit, e miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 367, datë 15.12.2023, prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh.

Tarifa e shërbimit të transmetimit të gazit natyror është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë Albga sh.a., në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, si dhe direktivave të Komunitetit të Energjisë, ku aksesimi në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

5.1.8. Mbi miratimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun Brenda së Njëjtës Dite

Duke marrë në konsideratë shtyrjen e hyrjes në fuqi të Rregullores CACM deri më 1 korrik 2026, si dhe faktin që shoqëria ALPEX sh.a. vijon të ushtrojë funksionet e NEMO-s deri në përzgjedhjen e Operatorit të ri të Emëruar të Tregut, ERE vlerësoi të arsyeshme që shoqëria të vazhdojë ushtrimin e aktivitetit të NEMO-s me tarifat e miratuara me vendimin nr. 299, datë 30.12.2024. Bordi i ERE-s mori vendimin nr. 323, datë 15.12.2025 mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 299, datë 30.12.2024, për vitin 2026. Lista e tarifave të miratuara reflektohet në figurën më poshtë:

Lista e tarifave ALPEX, të cilat do të jenë të aplikueshme për Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun e Ditës së Njëjtë

Lista e Tarifave të ALPEX	Pagesa e Tarifës	Referenca në monedhën Euro	Paguhet nga
Tarifa Administrative	Një herë	200 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	Vjetore	10,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun e Ditës në Avancë	Vjetore	14,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	7,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	Vjetore	3,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun e Ditës në Avancë	Ditore	0.09 € / MWh	Anëtari i Klerimit
Tarifa Teknike	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	Vjetore	6,000 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	Transaksion	0.02 € / MWh	Anëtari i Bursës
Tarifa e Tregtimit në emër të dikujt tjetër	Urdhërporosi	20 €	Anëtari i Bursës
Tarifa për API përdorues	Vjetore	2,000 €	Anëtari i Bursës
Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin personal të Klerimit	Mujore	100 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa e Administrimit të Letër Garancisë Bankare	Kur depozitohet	50 €	Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore e Trajnimit	Vjetore	200 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Tarifa e Provimit	Vjetore	100 €	Agjenti Tregtar dhe Klerues
Certifikata digjitale për Përdorues	Vjetore	50 €	Anëtari i Bursës/Anëtari i Klerimit
Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Vjetore	8,000 €	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.14 € / MWh	Anëtari i Bursës
Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë	Ditore	0.04 € / MWh	Anëtari i Bursës

* Për tregun e Shqipërisë, të gjitha tarifat do të shlyhen në monedhën Euro për jo-rezidentët.

* Për tregun e Shqipërisë, të gjitha tarifat fikse do të shlyhen në monedhën Lekë, ekuivalent të referencës së përcaktuar në monedhën Euro, për rezidentët.

* Mbi tarifat do të aplikohet TVSH-ja.

5.1.9. Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2025

5.1.9.1. Kosto e blerjes së energjisë elektrike nga “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohet ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), ka detyrim për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti (KESH sh.a.). Shoqëria e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Furnizuesin e Shërbimit Universal me të gjithë sasinë e nevojshme, për qëllime të plotësimit të të gjithë kërkesës së Furnizuesit të Shërbimit Universal, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Sa më sipër, sasia e energjisë elektrike për furnizimin me shërbimin universal gjatë vitit 2025 është siguruar nga KESH sh.a. Në zbatim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 5, të VKM nr.456/2022, të ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit e shoqërisë KESH sh.a. miratoi me vendimin nr. 936/1, datë 14.02.2024, “Programin Ekonomik Financiar të KESH sh.a. për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2028”, duke përcaktuar furnizimin me të gjithë sasinë e nevojshme, të klientëve universalë, sipas çmimit për njësi të energjisë elektrike prej 2.6 lekë/kWh.

Të ardhurat e realizuara nga klientët familjarë rezultojnë rreth 0,56% më të ulëta krahasuar me vitin 2024. Po kështu, evidentohet se të ardhurat e realizuara prej klientëve jo familjarë, kanë pësuar një diferencë në rritje prej 2.85%.

Përshkrimi	Sasia (kWh)		Diferencë në sasi 2025-2024	Diferencë në % 2025-2024
	2025	2024		
Jo familjar	1,606,538,771	1,505,035,986	101,502,785	6.74%
Familjar	3,640,481,281	3,407,863,582	232,617,699	6.83%
Total	5,247,020,052	4,912,899,568	334,120,484	6.80%

Figura 69. Sasia e energjisë elektrike të shitur nga Furnizuesi i Shërbimit Universal.

5.2. Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE dhe çmimet e energjisë elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2025

5.2.1. Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite nga ERE

Në grafikun dhe tabelën në vijim paraqitet ecuria e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara ndër vite nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi.




Figura 70. Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara ndër vite për periudhën 2009 - 2025.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, për klientët e furnizuar në kushtet e shërbimit universal:




Figura 71. Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 2016 – 2025.

(Burimi: ERE)

Referuar analizës së strukturës së shitjes së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2025, çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike i realizuar për klientët fundorë ka rezultuar pothuajse në të njëjtin nivel me atë të përllogaritur nga ERE për periudhën përkatëse.

5.2.2. Çmimet e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2025

Në grafikun e mëposhtëm janë pasqyruar çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para tatimit (TVSH-së) për klientët jofamiljarë për vitin 2025. Sipas të dhënave të publikuara nga EuroStat, çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët jofamiljarë për vendet e rajonit për vitin 2025 ka rezultuar 17.43 lekë/kWh.




Figura 72. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jo-familjarë në vendet e rajonit për vitin 2025

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët familjarë për vitin 2025. Sipas të dhënave të publikuara nga EuroStat, çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët familjarë për vendet e rajonit për vitin 2025 ka rezultuar 13.16 lekë/kWh.

Krahasimi rajonal tregon se niveli i çmimeve në Shqipëri mbetet relativisht konkurrues krahasuar me vendet e rajonit, duke reflektuar politikën e stabilizimit tarifar dhe strukturën e tregut vendas.




Figura 73. Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2025

(Burimi: Eurostat)

6. SITUATA E GAZIT NË BOTË, EUROPË, RAJON DHE NË VENDIN TONË.

6.1. Problemet kryesore për gazin natyror.

Globalisht, lëndët djegëse të gazta zënë një pozicion gjithnjë e më kompleks në tranzicionin energjetik. Gazi natyror është përshkruar prej kohësh si një "lëndë djegëse tranzicioni" - ose edhe një "lëndë djegëse destinacioni" - sepse siguron energji të besueshme dhe ngrohje industriale me një intensitet më të ulët karboni sesa qymyri ose nafta.

Aftësia e gazit natyror për të ofruar fleksibilitet të shpejtë, e bën atë një plotësues kritik për zgjerimin në shkallë të gjerë të burimeve të rinovueshme e të ndryshueshme.

Megjithatë, tronditjet gjeopolitike, paqëndrueshmëria e çmimeve dhe politikat shtrënguese për klimën kanë ngritur pyetje të reja në lidhje me qëndrueshmërinë e rritjes së kërkesës për gaz përtej mesit të viteve 2030.

Në të njëjtën kohë, lëndët djegëse të gazta me karbon të ulët, siç janë biometani, hidrogjeni i rinovueshëm dhe lëndët djegëse sintetike të nxjerra nga hidrogjeni, po tërheqin vëmendje.

Megjithatë, vendosja e tyre mbetet e kufizuar nga kostot, kërkesat për infrastrukturë dhe nevoja për mbështetje të kornizave të politikave.

Modelimi i sistemit global të energjisë sugjeron gjithnjë e më shumë një evolucion strukturor: lëndët djegëse të gazta pritet të kalojnë nga të qenit burime kryesore primare të energjisë sot, në shërbimin si ofrues kryesorë të fleksibilitetit, ruajtjes sezonale dhe dekarbonizimit në sektorë të vështirë për t'u reduktuar - në varësi të një reduktimi të qëndrueshëm të intensitetit të karbonit të zinxhirëve të furnizimit.

Viti 2025 shënon një pikë kthese në pikëpamjet afatgjata të gazit natyror pas disa vitesh mungesë, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (IEA) ringjalli Skenarin e Politikave Aktuale (SPA) në Perspektivën e saj Botërore të Energjisë (PBE) ose (WEO) 2025.

SPA kishte qenë një skenar standard deri në vitin 2020, por u hoq gjatë periudhës së Covid-19 për shkak të ndryshimeve të shpejta të politikave dhe çrregullimeve të tregut.

Rivendosja e tij sinjalizon pasiguri në rritje mbi shpejtësinë e tranzicionit energjetik dhe interes të ripërtërirë për të kuptuar se si evoluon bota pa ndërhyrje të reja politike.

- SPA pasqyron vetëm politikat dhe rregulloret e miratuara tashmë. Ai supozon përparim të kujdesshëm duke vendosur teknologji të reja dhe ofron një pamje konservative të dekarbonizimit.
- Skenari i Politikave të Deklaruara (STEPS ose SPD në shqip) përfshin politika që janë shpallur, por që ende nuk janë zbatuar plotësisht, si dhe strategji zyrtare që tregojnë drejtimin e synuar të lëvizjes.

Ai supozon vendosje më të shpejtë të teknologjive me karbon të ulët dhe efikasitet më të madh të energjisë në krahasim me SPA, por nuk supozon se janë përmbushur objektivat aspiruese klimatike.

Në të kundërt, skenari i Emetimeve Zero Neto (NZE) 2050 përshkruan një rrugë normative për të përmbushur objektivat globale të klimës.

Kërkesa për energji elektrike rritet ndjeshëm më shpejt se përdorimi i përgjithshëm i energjisë në të gjitha skenarët e IEA-s, e mbështetur nga rritja e vazhdueshme e burimeve të rinovueshme dhe momenti i ripërtërirë për energjinë bërthamore. Megjithatë, skenarët ndryshojnë ndjeshëm në kombinimin e burimeve të energjisë që plotësojnë këtë kërkesë të viteve 2020.

- Në SPA përdorimi i naftës dhe gazit natyror vazhdon të rritet deri në vitin 2050, ndërsa qymyri arriti kulmin para fundit të viteve 2020;

- Në STEPS (SPD) kërkesa për qymyr arrin kulmin para vitit 2030 dhe nafta bie në nivel rreth vitit 2030; kërkesa për gaz natyror vazhdon të rritet, por me një ritëm më të ngadaltë se në SPA.

Kërkesa globale për gaz natyror rritet nga 4,254 miliardë metra kub në vitin 2024 në 5,596 miliardë metra kub (+32%) në SPA deri në vitin 2050 ose 4,645 miliardë metra kub (+9%) në STEPS deri në vitin 2050.

Si SPA, ashtu edhe STEPS (SPD) parashikojnë investime të vazhdueshme në të gjitha lëndët djegëse dhe teknologjitë.

Ato supozojnë të njëjtën rritje ekonomike dhe kërkesë përgjithësisht të ngjashme për shërbime energjetike deri në vitin 2050.

Megjithatë, ndryshimet në efikasitet, elektrifikim dhe përzierje lëndësh djegëse rezultojnë në trajektore të ndryshme të kërkesës për energji.

STEPS (SPD) parashikon një rritje më të ngadaltë të përgjithshme të energjisë për shkak të përdorimit më të ulët të lëndëve djegëse fosile në prodhimin e energjisë, rritjes së elektrifikimit të përdoruesve fundorë dhe përmirësimeve më të forta të efikasitetit të energjisë në të gjithë sektorët.

				Current Policies		Stated Policies	
	2010	2023	2024	2035	2050	2035	2050
World	3 317	4 138	4 254	5 044	5 596	4 770	4 645
North America	838	1 158	1 179	1 253	1 192	1 198	950
United States	678	925	942	1 022	943	975	733
Central and South America	151	154	157	188	222	177	177
Brazil	29	30	32	38	51	33	31
Europe	697	504	507	477	426	411	304
European Union	446	328	329	296	244	256	166
Africa	107	174	172	214	323	199	260
Middle East	370	582	596	837	1 077	773	870
Eurasia	578	633	660	693	713	690	684
Russia	467	503	526	529	507	529	490
Asia Pacific	575	931	982	1 330	1 565	1 274	1 345
China	110	397	428	632	724	584	606
India	64	68	75	137	209	139	187
Japan	95	90	91	97	93	87	67
Southeast Asia	149	176	184	238	285	244	272

Figura 74. Kërkesa e IEA-s për gaz natyror deri në vitin 2050 si për SPA ashtu edhe për (SPD) STEPS.

Burimi: IEA, WEO 2025

Problemi kryesor 1: Kërkesa në rritje për gaz

Tregtia e LNG-së u zgjerua për të 12-in vit radhazi, duke u rritur afërsisht në 600 miliardë metra kub, duke nënvizuar rolin e saj kyç në përmbushjen e kërkesës në rritje, duke rritur tregtinë globale të gazit natyror dhe përdorimin e tij aq të domosdoshëm.

Kërkesa për gaz natyror u rrit me 78 miliardë metra kub (1.9%) në vitin 2024, duke arritur në 4,122 miliardë metra kub. Rritja u nxit kryesisht nga fitimet e forta në Azi dhe Amerikën e Veriut. Kërkesa vazhdon të rritet në vitin 2025, me një rritje prej 71 miliardë metra kub (1.7%).

Gazi për energji mbeti një nxitës kryesor, së bashku me kërkesën në rritje nga sektorët e transportit dhe industrisë duke përmirësuar lidhjen e tregut pavarësisht pasigurive të vazhdueshme gjeopolitike.

Duke mbështetur këtë vrull në zhvillimin e infrastrukturës së LNG-së, 64 anije të reja transportuese të LNG-së u dorëzuan në vitin 2024, me 337 të tjera në ndërtim e sipër në fund të vitit 2025.

Viti 2025 filloi me divergjenca rajonale në tendencat e kërkesës. Rritja e kërkesës u përqendrua në Evropë dhe Amerikën e Veriut gjatë gjysmës së parë, e nxitur nga kërkesa për energji elektrike në Evropë dhe kërkesa e fortë për ngrohje në të dy rajonet.

Tregtia e LNG-së u rrit gjithashtu në gjysmën e parë të vitit 2025, me një rigjallërim të dukshëm të importeve evropiane, të cilat u rritën me 23.6% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2024.

Problemi kryesor 2: Rritja e pasigurisë energjetike.

Mes pasigurive në rritje që rrjedhin nga ndryshimet në teknologji, klimë dhe gjeopolitikë, tendenca e rritjes së kërkesës për energji mund të vërehet qartë. Nëse kjo trajektore vazhdon, ekziston rreziku i mospërputhjes midis vazhdimësisë së furnizimit dhe realitetit të kërkesës.

Trendet e fundit sugjerojnë se kërkesa globale për energji mund të vazhdojë të rritet gjatë dekadës së ardhshme, e nxitur nga Azia dhe e mbështetur nga rritja në Amerikën e Veriut. Megjithatë, pasiguritë nga ndryshimet globale po e bëjnë gjithnjë e më të vështirë parashikimin dhe planifikimin e kësaj rritjeje.

Zhvillimet gjeopolitike shtojnë më tej pasiguri në parashikimet e rritjes, me tarifatat e importit të SHBA-së që kërcënojnë të dobësojnë kërkesën globale për LNG për shkak të ngadalësimit të aktivitetit të përgjithshëm ekonomik, pavarësisht mbështetjes së fortë për sektorin e naftës dhe gazit në vend.

Problemi kryesor 3: Roli kyç i investimeve në furnizimin dhe infrastrukturën me Gaz Metan dhe LNG.




Figura 75. Bilanci global i kërkesës dhe furnizimit me gaz sipas skenarëve të ndryshëm, furnizimi i ndarë sipas ciklit jetësor

Gazi natyror është i pozicionuar mirë si një forcë elastike për të zbutur pasigurinë energjetike, duke shërbyer si një element kyç i një sistemi energjetik të besueshëm, fleksibël, të përballueshëm dhe të gatshëm për klimën.

Si një alternativë me karbon më të ulët ndaj qymyrit, veçanërisht me integrimin e teknologjive të kapjes së karbonit, gazi natyror mund të sigurojë qëndrueshmëri afatgjatë, duke ofruar sigurinë energjetike në ekonomitë në zhvillim.

Ai siguron besueshmërinë e sistemit, duke shërbyer si një sigurim për sistemet e energjisë dhe duke ofruar mbështetje të besueshme si ruajtje energjie afatshkurtër ashtu edhe afatgjatë kur prodhimi i burimeve të rinovueshme me ndërprerje bie në mungesë.

Gazi Metan dhe LNG-ja shfaqen gjithashtu si mjete gjeopolitike, jetësore për parandalimin e paqëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale përmes sigurimit të furnizimit të sigurt dhe të diversifikuar.

Problemi kryesor 4: Nevoja në rritje për energji elektrike e mbështetur nga roli balancues i gazit natyror.

Gazi natyror luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në stabilizimin e sistemeve të ardhshme të energjisë, në kushtet e rritjes së depërimit të energjisë së rinovueshme, të ndryshueshme dhe rritjes së incidencës së ngjarjeve ekstreme të motit.


Problemi kryesor 5: Roli i gazrave me përmbajtje të ulët karboni.

Industria globale e gazit po angazhohet gjithnjë e më shumë me sfidën e dekarbonizimit, duke ndjekur teknologji me karbon më të ulët përmes inovacionit dhe bashkëpunimit.

Investimet e synuara në molekula të dekarbonizuara janë të nevojshme për të zhbllokuar opsionet e dekarbonizimit, të tilla si rritja e biometanit dhe bio-LNG-së, dekarbonizimi i sistemit të gazit të

bazuar në CCS dhe integrimi i hidrogjenit dhe derivateve të tij.

LHS: Bcm; RHS: Përqindja



Biometani shquhet si gazi më premtues me karbon të ulët sot, i mbështetur nga teknologji të zhvilluara prodhimi, përputhshmëri me infrastrukturën ekzistuese të gazit natyror dhe potencial të fortë për vendosje në shkallë të gjerë.

Prodhimi global është rritur shtatëfish gjatë dekadës së fundit, duke arritur në mbi 10 miliardë metra kub në vitin 2025, i nxitur nga stimujt e ofertës, siç janë primet e furnizimit dhe tarifat e furnizimit që kanë ulur rreziqet e investimit për operatorët dhe investitorët.

Duke parë përpara, prodhimi global i biometanit parashikohet të rritet me 14% në vit deri në vitin 2040, i nxitur nga objektivat strategjike në Evropë.

Nga fundi i vitit 2024 deri në qershor të vitit 2025, tendencat e kërkesës për gaz natyror ndryshuan në tregjet kryesore.

Evropa përfjoi një rigjallërim të importeve të LNG-së, ndërsa rritja e kërkesës në Azi u ngadalësua, e rënduar nga çmimet relativisht më të larta të LNG-së në treg dhe kushtet e dobëta

makroekonomike që kufizuan aktivitetin e tregut. Importet e LNG-së në Evropë u rritën me 16 miliardë metra kub (23.6%) në gjysmën e parë të vitit 2025 krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2024. Ndërkohë, Kina, importuesja më e madhe e LNG-së në botë, regjistroi një rënie prej 19.4% në importet e LNG-së gjatë së njëjtës periudhë. Rritja e përgjithshme e kërkesës globale për gaz natyror në gjysmën e parë të vitit 2025 u nxit kryesisht nga Evropa dhe Amerika e Veriut, të cilat regjistruan rritje prej 6.1% dhe 1.5%, përkatësisht. Kjo u nxit kryesisht nga dimri 2024/2025 më i ftohtë, i cili rriti kërkesën për ngrohje në të dy rajonet.

Kërkesa e Evropës për gaz natyror u rrit me 13 miliardë metra kub 6.1% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar në gjysmën e parë të vitit, kryesisht e ndikuar nga modelet sezonale që ulën prodhimin e burimeve të rinovueshme dhe rritën kërkesën për ngrohje.




Figura 76. Prodhimi global i gazit natyror, i ndarë sipas rajonit

Gazi sot është një faktor kritik i sigurisë dhe stabilitetit të furnizimit me energji elektrike në Botë.

Në një mjedis ku disponueshmëria e energjisë është kufizimi përcaktues, gazi luan një rol të domosdoshëm. Turbinat moderne të gazit ofrojnë rritje të shpejtë, kapacitet të qëndrueshëm dhe stabilitet të sistemit, duke iu përgjigjur nevojave.

Raporti Global i Gazit 2025 i IGU-së thekson se gazi nuk është një "urë" kalimtare, por një komponent strukturor i sistemeve të energjisë së epokës së inteligjencës artificiale, duke ankoruar besueshmërinë së bashku me burimet e rinovueshme të energjisë.

Amerika e Veriut.

Revolucioni i shistit argjilor (Nxjerrja e Gazit nga Argjilat, ky është një lloj gazi jo-konvencional

i cili është më i pastër në krahasim me gazin konvencional dhe që ka një zhvillim të gjerë kohët e fundit) e transformoi SHBA-në nga një importues neto në prodhuesin kryesor të gazit në botë (1,033 miliardë metra kub në vitin 2024) dhe nga viti 2023, eksportuesin më të madh të LNG-së. Eksportet e gazit të SHBA-së arritën një nivel rekord në vitin 2025, duke e bërë vendin eksportuesin më të madh global të gazit në përgjithësi, një përmbysje e jashtëzakonshme nga pozicioni i tij i importit neto deri në vitin 2017.

Gazi i lëngshëm (LNG) fleksibël amerikan (i lidhur me qendrat dhe pa destinacione) ka ripërcaktuar tregtinë globale të gazit. Kërkesa globale për gaz të lëngshëm (LNG) arriti në 560 miliardë metra kub në vitin 2024 dhe mund të kalojë 725 miliardë metra kub deri në vitin 2030, me SHBA-në që do të shtojë 160 miliardë metra kub kapacitet të ri lëngëzimi. Në SPA, kërkesa për gaz e ekonomive të përparuara rritet me 50 miliardë metra kub midis viteve 2024 dhe 2035:

- Kërkesa e SHBA-së rritet me rreth 10% duke tejkaluar 1,000 bcm, e nxitur nga +50 bcm në energji dhe +15 bcm gaz natyral.

Në STEPS (SPD), kërkesa për gaz në ekonomitë e përparuara bie nga 1,850 bcm (2024) në 1,750 bcm (2025); Kërkesa e BE-së bie me 20% dhe konsumi në SHBA mbetet në një nivel të qëndrueshëm.

Sipas IEA-s, Gazi i LNG-së;

- Kërkesa e BE-së bie me mbi 10%, nën 300 miliardë metra kub;
- Japonia rritet nga 90 në 95 miliardë metra kub;
- Koreja e Jugut mbetet e qëndrueshme në 60 miliardë metra kub.

Amerika e Veriut, veçanërisht SHBA-të, janë në epiqendrën e rritjes në shkallë të lartë. Rajoni kombinon gaz natyror të bollshëm, burime të rinovueshme gjithnjë e më konkurruese dhe infrastrukturë të gjerë transmetimi dhe me tubacione, duke e pozicionuar atë si tregun kryesor global në këtë fushë. Gazi tashmë siguron rreth 40% të furnizimit me energji elektrike të SHBA-së, duke ankoruar besueshmërinë, me burimet e rinovueshme që ofrojnë rreth një të katërtën, energjinë bërthamore 15-20% dhe qymyrin që ende kontribuon, por në rënie.

Europë

Sfida e Evropës është zgjerimi i rrjetit, duke përfshirë vonesat në leje dhe pengesat në transmetim. Kjo vonon kërkesën e qendrave të të dhënave që kërkojnë mbështetje të përkohshme për gazin i cili është mjaft fleksibël. Pengesat administrative kanë qenë një nga problemet që për vitin në vazhdim kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

Azi-Paqësori (përveç Kinës)

Kërkesa për gaz natyror është rritur me afërsisht 80 miliardë metra kub në vit gjatë dekadës së fundit. Në SPA të IEA-s, ajo vazhdon të rritet me 70 miliardë metra kub në vit deri në vitin 2035, pikë në të cilën gazi bëhet karburanti i dytë më i madh në botë. Ekonomitë në zhvillim përbëjnë pothuajse të gjithë këtë zgjerim (+700 miliardë metra kub), ndërsa kërkesa në ekonomitë e përparuara mbetet përgjithësisht e qëndrueshme. Në Azinë në zhvillim, kërkesa rritet me 340 miliardë metra kub midis viteve 2024 dhe 2035, me sektorin e energjisë dhe industrinë që kontribuojnë secili me 35%. Rajoni shton 270 GW kapacitet të ri me gaz (+70%).

Rajoni karakterizohet nga rritje e shpejtë digjitale, përzierje të larmishme energjie dhe varësi në rritje nga LNG-ja. Në ekonomitë e përparuara të Azisë, energjia bërthamore dhe e rinovueshme po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në rrjetin elektrik, megjithatë qendrat e të dhënave vazhdojnë të mbështeten në lëndët djegëse fosile, veçanërisht në LNG, për gjenerim rezervë dhe të shpërndarshëm.

Në Japoni dhe Korenë e Jugut, LNG-ja përbën më shumë se një të katërtën e furnizimit me energji elektrike, duke siguruar fleksibilitetin e nevojshëm për të balancuar zgjerimin e parqeve të energjisë së erës dhe ato diellore në det të hapur. Të dy vendet po rinisin ose po vënë në punë njësi të reja bërthamore; Japonia që riaktivizon reaktorët sipas standardeve të rishikuara të sigurisë, dhe Koreja synon që energjia bërthamore të arrijë deri në 30% të përzierjes së saj të energjisë deri në vitin 2036.

Kinë

Kina drejton rritjen më të madhe: +200 miliardë metra kub, duke arritur në 630 miliardë metra kub deri në vitin 2035. Në Kinë, qymyri mbetet shtylla kurrizore e furnizimit me energji elektrike, veçanërisht në rajonet bregdetare lindore ku rreth 60-70% e energjisë ende vjen nga qymyri. Në të njëjtën kohë, vendi po përparon në ndërtimin më të shpejtë të energjisë së pastër në botë, duke instaluar më shumë kapacitet diellor në vitet 2023-2025 sesa pjesa tjetër e botës së bashku. Krahas kësaj rritjeje të burimeve të rinovueshme, Kina po zgjeron gjithashtu industrinë e saj bërthamore me më shumë se 30 reaktorë në ndërtim e sipër.

Importet e LNG-së dhe zgjerimet e tubacioneve pritet të mbështesin këtë rol, me gjenerimin me gaz të pozicionuar si një alternativë më e pastër ndaj qymyrit për grupet urbane.

Lindja e Mesme

Lindja e Mesme po shfrytëzon gazin natyror të bollshëm dhe energjinë diellore të klasit botëror për tu bërë një qendër kompjuterike e inteligjencës artificiale. Mega-projektet e mbështetura nga shtetet (p.sh., në Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA) dhe Arabia Saudite) bashkëvendosin qendrat e të dhënave me zonat industriale dhe pikat e vendosjes së kablllove, duke siguruar furnizim dhe lidhje të besueshme. Gazi mbetet karburanti dominues, me më shumë se 60% të gjenerimit rajonal të energjisë elektrike të furnizuar nga gazi natyror, dhe projekte të reja me cikël të kombinuar po porositen si për të zëvendësuar kapacitetin e naftës, ashtu edhe për të ankoruar kërkesën e qendrave të të dhënave. Në të njëjtën kohë, Emiratet e Bashkuara Arabe kanë lidhur njësitë e tyre të para bërthamore në Barakah, të cilat po fillojnë të ofrojnë ngarkesë bazë pa karbon që mund të plotësojë energjinë diellore dhe gazin në planin afatgjatë.

India

India pothuajse dyfishon kërkesën në 140 miliardë metra kub, e udhëhequr nga gazi urban dhe industria.

Përdorimi i gazit në Indi mund të katërfishohet, i mbështetur nga objektivat e përmirësuar të cilësisë së ajrit, integrimi i burimeve të rinovueshme, gazifikimi në rritje dhe përdorimi në rritje i gazit në lëvizshmëri.

Afrika

Infrastruktura digjitale e Afrikës mbetet e përqëndruar në Afrikën e Jugut, megjithëse mungesa e besueshme e rrjetit po nxit eksplorimin e projekteve të LNG-së për të prodhuar energji dhe projekte hibride të energjisë së rinovueshme.

Tregje të tjera po fillojnë të shfaqen; Kenia shfrytëzon energjinë gjeotermale, Egjipti kombinon burimet e rinovueshme të energjisë dhe gazin me ulje strategjike të kablllove nënujore dhe Nigeria dhe Mozambiku kërkojnë të monetizojnë rezervat e tyre të gazit natyror për të mbështetur qendrat rajonale.

Mbërritja e kablllove të reja nëndetëse si Africa dhe Equiano po riformëson lidhjen, por boshllëqet në infrastrukturë, stresi nga uji dhe pasiguria rregullatore vazhdojnë të kufizojnë shkallën e ndërtimit në shkallë të lartë.

Amerika Latine

Rritja e Amerikës Latine udhëhiqet nga Brazili, ku dominon energjia hidrike por ciklet e thatësirës nxisin një varësi më të madhe për burimet maksimale të LNG-së dhe burimet e rinovueshme plotësuese.

Sistemi i Kilit me energji diellore po shoqërohet gjithnjë e më shumë me LNG të importuar për forcim, ndërsa Kolumbia, Peruja dhe Argjentina po fillojnë të tërheqin interes si qendra dytësore.

Në të gjithë rajonin, burimet e bollshme diellore, të erës dhe të ujit krijojnë potencial afatgjatë, por paqëndrueshmëria politike, brishtësia e infrastrukturës dhe ligjet e lokalizimit të të dhënave formësojnë strategjitë dhe ritmin e investimeve.

Në të dy rajonet, gazi është kritik për kapacitetin e madh dhe zhvillimin e hershëm digjital, ndërsa burimet e rinovueshme (diellore, hidroenergji, era) ofrojnë furnizim të bollshëm, por të ndryshueshëm.

Qeveritë dhe Rregullatorët, Furnizuesit e Energjisë dhe Shërbimet duhet të kenë parasysh:

- Të përshtaten me një klasë të re klientësh të mëdhenj (sigurisht që konsumatorët e vegjël janë të detyruar t'u përshtaten kushteve të tregut) dhe që lëvizin me shpejtësi (hipershkallëzues), kërkesa e të cilëve ndryshon kapacitet;
- Gazi mbështet integrimin e burimeve të rinovueshme duke ofruar kapacitet të qëndrueshëm dhe fleksibël.

6.2. Dekarbonizimi

Investimet duhet të synojnë gazrat me karbon të ulët, reduktimin e emetimeve të kombinuara të karbonit dhe metanin në përputhje me objektivat klimatike, aty ku është e aplikueshme.

Përvoja e kaluar tregon rreziqet e parashikimeve të gabuara: në Kinë, kërkesa e vitit 2025 i tejkaloi parashikimet me rreth 25 përqind, ndërsa në SHBA, edhe kompanitë e shërbimeve publike kanë mbivlerësuar kostot nën supozime konservatore, prandaj:

- Të përshtaten afatet kohore të lejeve, ndërlidhjes dhe planifikimit me ritmin e infrastrukturës dixhitale në rritje.
- Të hartohen politika të tregu të energjisë elektrike që nxisin modele hibride të prokurimit (burime të rinovueshme + kapacitet të shpërndarshëm) duke mbrojtur njëkohësisht sigurinë e furnizimit.
- Të sigurohet që objektivat e sigurisë energjetike dhe dekarbonizimit të përparojnë paralelisht, pasi konkurrueshmëria kombëtare do të varet gjithnjë e më shumë nga qasja e besueshme në energji për rritjen e nxitur nga intelijenca artificiale nga ngarkesat tradicionale industriale.
- Të eksplorojnë mundësitë e bashkë-lokacionit me kampuset digjitale, projektet e LNG-së për t'u shndërruar në energji dhe furnizimin e dedikuar me gaz me karbon të ulët.
- Të formohen partneritete strategjike me hipershkallëzuesit për të ulur rrezikun e investimeve në sektorë fleksibël dhe më të pastër.

6.3. Masat e mara nga Europa për gjendjen e gazit pas ndërprerjes së gazit RUS.

Rreth gjendjes së gazit për në ditët e sotme, Këshilli European i është përgjigjur me masa të shpejta dhe mjaft efikase dhe këto kanë ndikuar në Europë, Rajon dhe në vendin tonë. Përfaqësuesit e Këshillit (PE) arritën një marrëveshje të përkohshme mbi rregulloren për të hequr gradualisht importet e gazit natyror rus.

Rregullorja prezanton një ndalim të detyrueshëm ligjërish, hap pas hapi, si për gazin natyror të

lëngshëm (LNG) ashtu edhe për importet e gazit të tubacioneve nga Rusia, me një ndalim të plotë përkatësisht nga fundi i vitit 2026 dhe vjeshta e vitit 2027.

- Për kontratat afatshkurtra të furnizimit të lidhura para 17 qershorit 2025, ndalimi i importeve të gazit rus do të zbatohet nga 25 prilli 2026 për LNG-në dhe 17 qershori 2026 për gazin e tubacionit. Për kontratat afatgjata për importet e LNG-së, ndalimi do të zbatohet nga 1 janari 2027.
- Ndalimi do të hyjë në fuqi më 30 shtator 2027, me kusht që objektivat e mbushjes së depozitave të parashikuara në rregulloren e depozitimit të gazit të jenë në përputhje me objektivat e përmbushjes, dhe më së voni më 1 nëntor 2027.
- Ndryshimet në kontratat ekzistuese do të lejohen vetëm për qëllime operacionale të përcaktuara ngushtë dhe nuk mund të çojnë në rritje të vëllimeve.

Rregulloret janë në përputhje me objektivat më të gjera të politikave të BE-së, siç janë sigurimi i konkurrencës evropiane dhe objektivat e dekarbonizimit.

“Rregullorja SoS (Sigurinë e Furnizimit) e Gazit” dhe “Rregullorja e Përgatitjes për Rrezikun e Energjisë Elektrike” kanë qenë dhe do të mbeten të rëndësishme për sfidat aktuale të sigurisë së furnizimit të BE-së.

Mësimet e nxjerra.

- **Thjeshtësimi:** Thjeshtësimi mund të arrihet përmes përmirësimit të detyrimeve të raportimit për autoritetet kombëtare, duke zvogëluar numrin e grupeve rajonale të rrezikut dhe duke thjeshtuar procedurën për të kërkuar një përjashtim nga detyrimi i dyanshëm.
- **Përshtatja:** Sistemi energjetik i BE-së në tërësi ka qenë i qëndrueshëm gjatë periudhës së vlerësimit, por sektori i energjisë elektrike tashmë po përjeton një transformim masiv. Kjo përfshin veçanërisht dekarbonizimin, digjitalizimin, elektrifikimin dhe integrimin sektorial të sistemit tonë energjetik. Mund të parashikohet që sistemi energjetik i BE-së në vitin 2030 dhe më pas në vitin 2040 do të jetë rrënjësisht i ndryshëm nga ai i vitit 2017 apo edhe i sotëm, me rritjen e depërimit të energjisë së rinovueshme dhe një rol më marginal për gazin natyror.
- **Integrimi:** Sektorët e gazit dhe energjisë elektrike janë shumë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe mund të integrohen edhe më shumë në të ardhmen. Ndërsa disa dallime të rëndësishme vazhdojnë midis dy tregjeve, ka hapësirë për të harmonizuar ndjeshëm dy Rregulloret.
- **Transparenca dhe mbikëqyrja:** Ky raport i kontrollit të përshtatshmërisë nënvizoi, si vlerën e shtuar të dispozitave të transparencës që nxisin koordinimin, ashtu edhe mungesën e të dhënave mbi fusha të caktuara të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe gaz (p.sh., transparenca dhe gjurmueshmëria e importeve të gazit, disponueshmëria në kohë e të dhënave kyçe).

Rregullorja (BE) 2024/1787 “Mbi zvogëlimin e emetimeve të metanit në sektorin e energjisë” (Rregullorja e BE-së për Metanin) hyri në fuqi më 4 gusht 2024 dhe përmban një numër kërkesash për importuesit e naftës bruto, gazit natyror dhe qymyrit të vendosur në tregun e BE-së.

Secili vend duhet veçanërisht të raportojë të dhëna dhe informacione të caktuara në lidhje me emetimet e metanit nga vendet dhe kompanitë që prodhojnë ose eksportojnë në BE dhe nga viti 2027, për kontratat e lidhura ose të rinovuara pas 4 gushtit 2024, ata duhet të demonstrojnë se nafta, gazi dhe qymyri janë nga prodhimi që i nënshtrohet matjes, monitorimit, raportimit dhe verifikimit (MRV) të emetimeve të metanit ekuivalente me ato të përcaktuara në Rregulloren e BE-së për Metanin.

Rezoluta legislative e Parlamentit Evropian e 17 dhjetorit 2025 mbi propozimin për një rregullore të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi heqjen graduale të importeve të gazit natyror rus,

përmirësimin e monitorimit të varësive të mundshme nga energjia dhe ndryshimin e Rregullores (BE) 2017/1938 (COM (2025)0828 – C10-0123/2025 –2025/0180(COD)).

6.3.1. Në vendin tonë.

Gjatë vitit 2025 në vendin tonë kanë ushtruar aktivitet TAP AG dhe Albgaz sh.a.. Faktikisht Shqipëria është përgatitur për hapjen e tregut të gazit dhe për këtë ka:

- Të gjitha aktet nënligjore të domosdoshme për të ushtruar hapjen e tregut;
- Përgatitur një sërë projektesh të gatshme të cilat presin aplikimin e tyre;
- Adoptuar të gjitha Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Evropian;
- Marrë vendime të përbashkëta me autoritetet e Italisë dhe Greqisë në lidhje me aktivitetin e TAP;
- Është pjesë e të gjitha Institucioneve dhe Shoqatave të Gazit në Europë, Rajon dhe në Botë, është bashkëautore në studime duke qenë koherente për situatën e gazit.
- Është bërë një punë e mirë për hapjen e tregut të gazit me projekte prioritare dhe në vazhdimësi dhe konkretisht:
 - Projekti i gazifikimit të qytetit të Korçës, është gati për të startuar së bashku me kompaninë kombëtare SOCAR të Azerbajxhanit dhe do të jetë hapi i parë për të shtrirë vazhdimin e projekteve të shpërndarjes në të gjithë vendin tonë;
 - Projekti i TEC-it Roskovec, 170 MW;
 - Tubacioni Terminalit Vlorë-TEC Vlorë;
 - Projekti i detajuar Fier-Vlorë-Fier (Interkonjeksioni me TAP);
 - Ionian Adriatik Pipelinë (IAP), seksioni Fier-Kashar, i cili do të jetë fillimi i tubacionit për rajonin por që do të gazifikojë Tiranën dhe Durrësin;
 - Projekti i depozitimit nëntoksor të gazit në Dumre, për momentin është i stopuar por ka një marrëveshje me kompaninë SNAM për ta zhvilluar atë;
 - Projekti i terminalit të LNG-së në Vlorë. Për momentin është i stopuar, pritët të zhvillohet nga kompanitë amerikane;
 - Projekti i tubacionit të lidhjes me Kosovën, ALKOGAP;
 - Projekti i tubacionit të lidhjes me Maqedoninë e Veriut.

Këto projekte janë në koherencë të plotë me Direktivat dhe Rregulloret e gazit të Bashkimit Evropian, të cilat kanë afatin e zbatimit sipas Sekretariatit të Energjisë në Vienë.

Për të gjithë vendet kandidate për në Bashkimin Evropian, Sekretariati Energjisë jep një ndihmë të jashtëzakonshme për mbështetjen dhe aplikimin e tyre në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

6.4. Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP)

Aksionerët e Kompanisë

Aksionerët e TAP AG janë: SOCAR (Azerbajxhan) me 20%, BP(Angli) me 20%, SNAM S.p.A (Itali) me 20%, Fluxys (Belgjikë) me 20%, Enagas (Spanja) me 20%.



Figura 77. Gazësjellësi TAP

Struktura e aksioneve të TAP-it mbetet e njëjtë edhe për vitin 2025, ku secili prej aksionerëve të TAP-it ka aksione të barabarta prej 20%.

Përditësime mbi Gazsjellësin Trans Adriatik AG (TAP) gjatë vitit 2025

6.4.1. Ekselencë gjatë 5 viteve të operacioneve të kryera nga TAP.

TAP është pjesa Evropiane dhe një pjesë kyçe e Korridorit Jugor të Gazit, një projekt me rëndësi strategjike dhe ekonomike për BE-në dhe Komunitetin e Energjisë, për vendin tonë, që kontribuon në mënyrë aktive në integrimin e tregut dhe sigurinë e furnizimit të Evropës, që nga fillimi i operacioneve të tij komerciale më 15 nëntor 2020. Kjo ishte një arritje historike pasi një burim i ri furnizimi me gaz dhe një rrugë e qëndrueshme, e besueshme dhe me kosto efektive që u vendos në funksion, filloi të kontribuonte materialisht në qëllimet e BE-së dhe Komunitetit të Energjisë për sigurinë e furnizimit, integrimin e tregut, konkurrueshmërinë dhe dekarbonizimin.

Më 15 nëntor 2025, TAP shënoi 5 vjet operacione tregtare, me arritje të rëndësishme tregtare, operacionale dhe në shëndetësi e siguri, të tilla si:

- Transportoi mbi 54 miliardë metra kub standard gaz (bcm) që nga fillimi i operacioneve tregtare dhe u bë gjatë vitit 2025, burimi i dytë i vetëm i gazit natyror për Italinë, duke përfaqësuar 16% të importeve totale dhe 25% të importeve të gazit përmes tubacioneve
- TAP ka ofruar Shërbime Transporti të vazhdueshme në të gjitha Pikat e Ndërlidhjes me sistemet kombëtare të transmetimit në Itali dhe Greqi, SRG, DESFA, dhe duke filluar nga 1 Tetori 2022, edhe me Ndërlidhësin Greqi-Bullgari (IGB) në Komotini, pa asnjë kufizim të kapacitetit;
- Numri i pjesëmarrësve të regjistruar u rrit nga 3 në 47;
- TAP regjistroi një kënaqësi të lartë të klientëve gjatë viteve (>8.6 pikë nga 10 çdo vit) dhe mori 0 ankesa nga klientët;
- Niveli i parë i zgjerimit të TAP-it u aktivizua si pjesë e Testit të Tregut 2021;
- 152,000 orë punë operative dhe mirëmbajtjeje (ekipi në vend dhe kontraktorët kryesorë DESFA, AGSCo dhe SNAM);

- Rinovimi i certifikatave ISO 45,001; 9,001; 14,001; si dhe EMAS në Itali;
- Plani i Menaxhimit të Karbonit 2022-2025 u përfundua me sukses. U zbatuan më shumë se 50 nisma, të tilla si ulja e emetimeve të gazrave serrë me 25% krahasuar me parashikimin vjetor; ulja me 54% e emetimeve të metanit krahasuar me parashikimin; ulja me 86% e emetimeve krahasuar me vitin bazë 2021;
- Në të njëjtën kohë, OGMP 2.0 mori certifikatën "Gold Standard Pathway" (pritet "Gold Standard Reporting" në vitin 2026).;
- U ofruan afër 35,000 orë trajnimi për Shëndetin dhe Mjedisin (HSE).

6.4.2. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve

Për të vazhduar të sigurojë përsosmëri operationale dhe besueshmëri komerciale dhe fizike të infrastrukturës, TAP vazhdoi të përditësojë kornizën e tij, nën mbikëqyrjen e NRA-ve shqiptare, greke dhe italiane, duke u përpjekur t'u ofrojë klientëve të tij sa më shumë fleksibilitet të jetë e mundur, në një mjedis tregu në ndryshim të vazhdueshëm.

Prandaj, TAP përditësoi Kodin e Rrjetit të tij tri herë gjatë vitit 2025 dhe fillimit të vitit 2026:

- Më 2 janar 2025, u publikua një Kod Rrjeti i rishikuar për të zbatuar produktin Brenda Ditës në TAP. Produkti u vu në dispozicion në të njëjtën ditë, duke ofruar një mjet shtesë fleksibiliteti për transportuesit, si dhe për OST-të fqinje në Greqi, Itali dhe Bullgari.
- Më 25 shtator 2025, u publikua një Kod Rrjeti i rishikuar më tej, për të zbatuar ndryshimet e nevojshme për të akomoduar dy drejtimëshë si në në Pikën e Ndërlidhjes së Nea Mesimvria në Greqi. Pas ndarjes së kapacitetit që rezultoi nga Testi i Tregut i vitit 2021, metodologjia e ndarjes së gazit për konsum vetjak u rishikua për të reflektuar futjen e një pike të dytë fizike hyrjeje në TAP. Ndryshimet në lidhje me këtë seksion do të hyjnë në fuqi më 1 tetor 2026. Përveç kësaj, versioni i Kodit të Rrjetit i publikuar më 25 shtator 2025 prezantoi një Portal Regjistrimi, që synonte thjeshtimin dhe automatizimin e mëtejshëm të procesit për regjistrimin e transportuesve të rinj potencialë, duke përmirësuar njëkohësisht përvojën e përgjithshme të përdoruesit për palët e regjistruara.
- Procesi i rishikimit të tretë të Kodit të Rrjetit, i përfunduar gjatë vitit 2025, u iniciua nga një konsultim publik i mbajtur nga 30 korriku deri më 15 shtator 2025 dhe u finalizua pas ratifikimit të vendimit për të miratuar Kodin e Rrjetit të rishikuar nga Autoritetet Rregullatore Kombëtare (NRA) të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë në fund të nëntorit 2025. Si pasojë, një Kod Rrjeti i rishikuar më tej u publikua më 13 janar 2026. Ky rishikim i fundit prezanton ndryshimet dhe amendamentet e nevojshme për të akomoduar:
 - **Një mekanizëm kalimi të koston për Energjinë Elektrike të Kompresorave**, ku koston e shkaktuara për prokurimin e energjisë elektrike të përdorur për të furnizuar me energji njësitë e kompresorëve të drejtuar elektrikisht (siç parashikohet në Projektet e Zgjerimit të Ardhshëm të TAP) bien brenda fushëveprimit të tarifave të përdorimit. Këto kosto ndahen dhe rikuperohen përmes një modeli të ponderuar sipas rrjedhës, të bazuar në distancë, të ngjashëm me metodologjinë e aplikuar për koston e Gazit të Konsumit Vetjak.
 - **Një mekanizëm kalimi të koston që lidhet me Rregulloren për Emetimet e Metanit**. Rregullorja (BE) 2024/1787 “*Mbi reduktimin e emetimeve të metanit në sektorin e energjisë*”, e miratuar në gusht 2024, futi disa detyrime për operatorët dhe parashikon një parim të neutralitetit të koston, i cili është i zbatueshëm për TAP. Prandaj, TAP ka futur në Kodin e Rrjetit një mekanizëm kalimi të koston për kosto të tilla, të cilat bien brenda fushëveprimit të tarifave të përdorimit dhe u ndahen të

gjithë transportuesve të TAP bazuar në Sasitë e tyre të Alokuar.

TAP po maksimizon kapacitetin shtesë të ofruar në treg duke zhvilluar ankande kapaciteti për produktet standarde të kapacitetit në përputhje me Kalendarin e Ankandëve të ENTSOG-ut në Platformën e Rezervimit të Kapacitetit PRISMA. Midis Datës së Operacioneve Komerciale të TAP-it dhe 31 Dhjetorit 2025, TAP zhvilloi ankandet e mëposhtme për rezervimin e kapacitetit të fiksuar përpara, të ndërprerë dhe të kundërt komercial në IP Kipoi, IP Komotini, IP Melendugno dhe IP Nea Mesimvria : 14030 ankande një ditë më parë; 380 ankande mujore; 318 ankande tremujore; 24 ankande vjetore. Duke filluar nga janari i vitit 2025, ka pasur edhe 34788 ankande brenda ditës.

6.4.3. Niveli i parë i zgjerimit të kapacitetit të TAP-it

Në përputhje me kuadrin specifik rregullator të TAP-it, TAP organizoi Testin e parë të Tregut në korrik 2019 dhe nisi një tjetër Test Tregu në korrik 2021. Testi i Tregut i vitit 2021 ka qenë i suksesshëm dhe rezultoi në hapin e parë të zgjerimit të TAP-it. **TAP përfundoi marrëveshje afatgjata të transportit të gazit për transportin e 1.2 bcma(miliardë metër kub gaz) shtesë nga 1 Janari 2026 e tutje, duke përfshirë rezervimin e parë afatgjatë dhe një Kërkesë për Lidhje në një pikë daljeje në Shqipëri (Roskovec). TAP do të përmbushë detyrimet e tij nga Marrëveshja Afatgjatë e Transportit të Gazit.**

Sasitë specifike të kapacitetit shtesë që u rezervuan pas Testit të Tregut 2021 tregohen më poshtë:

Interconnection Points	Exit DESFA	Entry TAP	Exit TAP	Entry SRG	Period
Kipoi		32.8 GWh/day 1 BCMA			1 January 2026 – 31 December 2028
Nea Mesimvria	5 GWh/day 0.2 BCMA	5 GWh/day 0.2 BCMA			1 October 2026 – 30 September 2033
Roskovec			5 GWh/day 0.2 BCMA		1 October 2026 – 30 September 2033
Melendugno			32.8 GWh/day 1 BCMA	32.8 GWh/day 1 BCMA	1 January 2026 – 31 December 2028

Figura 78. Sasitë specifike të kapacitetit shtesë që u rezervuan pas Testit të Tregut 2021

Për të vënë në dispozicion kapacitetin e kërkuar, në janar 2024, TAP filloi punimet për zgjerimin për të shtuar një Njësi Kompresori në stacionin ekzistues të kompresorëve në Kipoi dhe i përfundoi ato me sukses deri në fund të vitit 2025 përpara afatit, brenda buxhetit, në mënyrë të sigurt dhe pa ndërprerë rrjedhat e vazhdueshme të gazit. Ndërtimi i projektit të zgjerimit përfshiu 337,563 orë pune të ekzekutuara pa incidente dhe përfshinte:

- Ndërtimin e një ndërtese të re kompresorësh me një kompresor të drejtuar nga turbinë me gaz 15 MW, një Ndërtese të re të Kontrollit Elektrik, së bashku me instalimin e 125 km kablllove dhe 447 tonë pajisjeve.
- Lidhjet me sistemet ekzistuese të tubacioneve u përfunduan duke përdorur një kombinim prej 3 lidhjesh "Hot Tap" dhe 8 lidhjesh konvencionale të kryera me sukses

gjatë një bajpasi 10-ditor të stacionit GCS00, ndërsa i gjithë sistemi TAP mbeti në funksion.

Zgjerim i Mëtejshëm

Në korrik 2023, TAP hapi një tjetër Test Tregu, në bashkëpunim me OST-të fqinje. Ky Test Tregu u mbyll në dhjetor 2025, pa asnjë kapacitet të ndarë.

TAP hapi Testin e Tregut 2025, në korrik 2025, përsëri në koordinim me OST-të fqinje. Ky Test Tregu është duke vazhduar, me hapin tjetër që është publikimi i Raportit të Vlerësimit të Kërkesës (DAR) me SRG dhe DESFA që tregon informacionin e përmbledhur mbi ofertat jo-detyruese të marra në IP-të e TAP dhe një vendim nëse do të vazhdojë procesi apo jo në fazën e projektimit të koordinuar. DAR me ICGB për IP Komotini u publikua në tetor 2025 me një vendim për të mos vazhduar Testin e Tregut 2025 në këtë IP.

6.4.4. Elektrifikimi nëpërmjet zgjerimit dhe dekarbonizimit

Zgjidhjet teknike të përfshira në Propozimet e Projekteve të Testeve të Tregut bazohen në kërkesën jo-detyruese të marrë.

Për nivelet e ardhshme të zgjerimit, TAP ka zhvilluar zgjidhje teknike që kërkojnë instalimin e stacioneve dhe/ose njësive të kompresorëve elektrik, duke mbështetur një dekarbonizim më të lehtë. Stacionet e kompresorëve të elektrizuar kërkojnë lidhje me rrjetin e transmetimit me tension të lartë në Shqipëri.

Për këtë arsye, në Shqipëri, TAP kishte rënë dakord për një ofertë lidhjeje jo-detyruese me Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST sh.a.) të Shqipërisë. Kjo ofertë ka skaduar në qershor 2025. Duke pasur parasysh rezultatet nga testi i fundit i tregut, TAP nuk do të vazhdojë me një zgjerim dhe për këtë arsye TAP do të riaplikojë te OST sh.a. për një ofertë lidhjeje në rrjet në të ardhmen nëse do të ketë kërkesë për një zgjerim.

6.4.5. Zhvillime të tjera në Shqipëri

Bashkëpunimi me lojtarët kombëtarë

6.4.5.1. TAP - Albgaz sh.a.

Në Shqipëri, sipas kuadrit rregullator të TAP-it, TAP po bashkëpunon me Qeverinë Shqiptare dhe Albgaz sh.a. për zhvillimin e një pike hyrjeje/daljeje në vendndodhjen e Fierit. Në këtë drejtim dhe bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Dorëzimit për Objektin e Fierit Jugor, të nënshkruar më 6 korrik 2021 me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Albgaz sh.a., pas një periudhe pezullimi të lidhur me vlerësimin e nevojave të tregut shqiptar, dhe pas konfirmimit nga MIE, TAP filloi projektin.

TAP po përparon me punimet inxhinierike të këtij projekti me kontraktorin e tij të caktuar dhe parashikon që ndërtimi fillestar të fillojë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, me qëllim që të përfundojë në tremujorin e katërt të vitit 2027. Sipas marrëveshjes, sapo të përfundojë ndërtimi i Objektit të Fierit Jugor, ai do të dorëzohet shtetit Shqiptar.

TAP dhe Albgaz sh.a. po bashkëpunojnë bazuar në një Kërkesë për Lidhje në Korçë (Projekti Nur) të marrë nga Albgaz sh.a. gjatë Testit të Tregut 2023. Palët janë gati të përparojnë pas përcaktimit të kushteve përkatëse.

Si pjesë e AGSCo, Albgaz sh.a. vazhdon të ofrojë shërbime mirëmbajtjeje me cilësi të lartë për sistemin e tubacionit TAP dhe stacionet në Shqipëri. Kontrata skadon në fund të vitit 2026, megjithatë një zgjatje tjetër prej 5 vitesh është rënë dakord tashmë me AGSCo, ndërsa priten nënshkrimet e amendamentit të ri.

Vlera totale e faturuar deri në dhjetor 2025 është afërsisht 30 milionë euro.

Projektet e Investimeve Sociale dhe Mjedisore të TAP-it në Shqipëri.

- Në kuadër të Marrëveshjes së Përfitimeve Vendore, TAP ka angazhuar 14.000.000 euro në projekte Investimesh Sociale dhe Mjedisore.
- TAP ka investuar 12,901,553 euro në 56 projekte përgjatë gjurmës së gazsjellësit dhe në komunitete më të gjera.
- Fondet e mbetura të SEI-t janë 1.098.447 euro.
- TAP do të koordinohet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndarjen e fondeve të mbetura të SEI-t.

Marrëveshja e Angazhimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit (GMDCA).

Në kuadër të GMDCA-së, TAP është zotuar të:

- Pika e Daljes - Projektimi, prokurimi, financimi dhe ndërtimi i një Impianti Fillestar Dalës Shqiptar për në gazsjellësin TAP në Fier (për të cilin u nënshkrua COHA dhe është në proces zbatimi për dorëzimin e mëvonshëm të MIE dhe Albgaz sh.a.).
- Trajnime për të rritur kapacitetet dhe për të nxitur mundësitë ekonomike duke investuar një total prej 700,000 euro:
 - Investuar 69.697 euro
 - 630.303 euro të mbetura
- Hua për të dhënë ose mundësimi i një kredie 6. 300. 000 euro për OST-në shqiptare (Albgaz sh.a.)
 - Disbursuar 1.800.000 euro (shlyer plotësisht në gusht 2025)
 - Pjesa e mbetur (në varësi të nevojës dhe kërkesës së Albgaz) është 4.500.000 euro.

Përfitimet Sociale Unike për Shqipërinë (SBUTA) – Totali 11.000.000 EUR

Në kuadër të SBUTA-s, TAP është zotuar të:

- Mbështetje për Zhvillimin e Tregut të Gazit (ndërtimi i kapaciteteve, infrastruktura, etj.) EUR 6.000.000
 - Investuar 3.789.406 euro
 - Mbetur EUR 2.210.594
- Përmirësimi i infrastrukturës për të përmirësuar kushtet e infrastrukturës në dobi të komuniteteve lokale 5.000.000 euro
 - Investuar 3.613.899 euro
 - 1.386.101 euro të mbetura

6.4.6. TAP po lehtëson ndërlidhjen digjitale në Evropën Juglindore

Gazsjellësi Trans Adriatik AG (TAP), pjesë e Korridorit Jugor të Gazit që transporton gaz natyror nga Azerbajxhani në Evropë, dhe EXA Infrastructure, platforma më e madhe e dedikuar dixhitale e infrastrukturës që lidh Evropën dhe Amerikën e Veriut, kanë formuar një sipërmarrje të përbashkët - Trans Adriatic Express LTD, e cila u bë plotësisht funksionale më 30 nëntor 2023.

Kjo ka mundësuar ndërlidhjen me shpejtësi të lartë të Francës, Italisë, Bullgarisë, Greqisë, Shqipërisë dhe Turqisë. Ndërmarrja e Përbashkët përdor një kabllo rezervë me fibra optike të

instaluar tashmë nga TAP përgjatë tubacionit të gazit prej 878 kilometrash, duke krijuar të vetmen lidhje të drejtpërdrejtë midis Evropës Juglindore dhe asaj Perëndimore për të siguruar nivele të larta të redundancës mbi rrugët alternative ekzistuese me shumë faza.

Kjo përpjekje e TAP-it ka rezultuar tashmë e dobishme për Shqipërinë, pasi lehtëson vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe në këtë mënyrë lidhshmëri më të mirë në treg.

Në përputhje me këtë përpjekje, kompania e përbashkët (përmes EXA) tani ofron shërbime telekomunikacioni midis Tiranës dhe Milanos, Tiranës dhe Barit, Tiranës dhe Selanikut, Tiranës dhe Romës, Tiranës dhe Sofjes për klientë të ndryshëm.

TAP ka një rol strategjik dhe thelbësor për dekarbonizimin, sigurinë e furnizimit dhe ndërlidhjen në Shqipëri dhe Evropën Juglindore. TAP luan një rol thelbësor në sigurimin e aksesit të besueshëm në një burim të ri gazi natyror nga Deti Kaspik dhe në një rrugë të re. TAP kontribuon në diversifikimin e burimeve dhe rrugëve të furnizimit dhe mund të mundësojë gazifikimin dhe dekarbonizimin e Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, përfshirë atë të Shqipërisë. TAP nxit aksesin në energji më të pastër dhe të përbalueshme në Ballkanin Perëndimor dhe rrit depërtimin e gazit në tregjet e reja dhe/ose atyre ekzistuese. TAP mund të kontribuojë gjithashtu ndjeshëm në dekarbonizim duke lehtësuar dekarbonizimin e ekonomive evropiane duke përshpejtuar heqjen graduale të qymyrit, veçanërisht në Evropën Juglindore (EJL) dhe Ballkanin Perëndimor dhe të lejojë që gazi të zëvendësojë lëndët djegëse më ndotëse në rajon .

Përveç kësaj, duke instaluar vetëm stacione kompresorësh elektrikë në tubacionin TAP që do të mundësojnë zgjerimin deri në 20 bcm (miliardë metër kub gaz në vit) të tubacionit TAP. TAP po dëshmohej një partner i vendosur për objektivat e tranzicionit energjetik dhe dekarbonizimit të BE-së dhe në Ballkanin Perëndimor.

Duke qenë se qëndrueshmëria është një nga prioritetet kryesore të tij, TAP ka zhvilluar një strategji të tranzicionit energjetik për të adresuar objektivat klimatike të BE-së, duke siguruar njëkohësisht rolin e tij kritik në sigurinë e furnizimit me energji të BE-së.

Në përputhje me objektivat e Paktit të Gjelbër Evropian dhe objektivat e dekarbonizimit, është planifikuar që ndërlidhësi TAP të lejojë gjithashtu transportimin e burimeve të reja të gazit të rinovueshëm dhe/ose çdo gazi tjetër me karbon të ulët (përfshirë hidrogjenin dhe biometanin) nga vendet përgjatë SGC-së në Evropë, duke krijuar një mundësi për të lidhur vëllime të konsiderueshme me domosdoshmërinë e kërkesës në rritje në Evropë.

Së fundmi, dhe kjo është shumë e rëndësishme se duhet të theksojmë veçantinë e TAP-it nga një perspektivë rregullatore si një ndërlidhës pjesërisht i përjashtuar, që kalon juridiksionet e Shqipërisë, një Palë Kontraktuese në Komunitetin e Energjisë, e cila po transpozon dhe përafron në mënyrë aktive legjislacionin kombëtar me acquis Communautaire të energjisë, dhe të dy Shteteve Anëtare të BE-së (Italisë dhe Greqisë).

E rëndësishme është të theksojmë se vetë TAP bën vlerësimin për bashkëpunimin me ERE-n ku shkurtimisht thotë: “Do të ishim të nderuar të ndanim me ju se TAP ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë një bashkëpunim të suksesshëm me ERE-n për çështjet e mësipërme dhe do të sigurojë pajtueshmëri të vazhdueshme me kushtet e vendosura ndaj TAP-it në Licencën e Transmetimit të dhënë nga ERE”. TAP gjithashtu do të vazhdojë të përmbushë çdo detyrim tjetër që rrjedh nga vendimet e nxjerra nga ERE ose nga ligjet e miratuara nga Parlamenti i Shqipërisë”.

6.4.7. Vëllimet e Transportuara nga TAP

Deri në fund të vitit 2025, TAP ka transportuar afërsisht një total prej 54 miliardë metra kub nga kufiri greko-turk në Kipoi, me 43 miliardë metra kub të transportuara deri në Itali duke kaluar

nëpër Shqipëri, afërsisht 5 miliardë metra kub që dalin në Greqi dhe afërsisht 3 drejt Bullgarisë, siç tregohet më poshtë:

Nga COD (15/11/20) deri më 31 Dhjetor 2025	Totali i KWh	Totali Nm3	BCM totale
Hyrja TAP (Kipoi)	602,667,121,274	51,333,581,147	51.33
Dalje TAP (Nea Mesimvria - Greqi)	56,883,612,837	4,848,489,522	4.85
Dalja nga TAP (Komotini – IGB)	39,231,315,635	3,344,756,984	3.34
Dil nga TAP (Melendugno - Itali) duke kaluar tranzit në Shqipëri	501,294,013,338	42,751,058,906	42.75

Për një pamje të plotë të vitit 2025, theksojmë se sasitë e mëposhtme janë transportuar vetëm në vitin 2025:

1 Janar deri më 31 Dhjetor 2025	Totali i KWh	Totali Nm3	BCMA totale
Hyrja TAP (Kipoi)	127,282,403,094	10,833,208,762	10.83
Dilni TAP (Nea Mesimvria - Greqi)	11,068,575,580	943,126,805	0.94
Dalja nga TAP (Komotini – IGB)	9,945,376,635	847,184,439	0.85
Dil nga TAP (Melendugno - Itali) duke kaluar tranzit në Shqipëri	105,140,897,693	8,961,386,447	8.96

6.4.8. Aktet nënligjore të miratuara nga ERE për gazin natyror gjatë vitit 2025

Vendimi nr. 145, datë 08.07.2025, “Mbi miratimin e një ndryshimi në “Kodin e rrjetit TAP”.

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1 gërma "a"; nenit 108 të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përfundimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC ("Opinionit Përfundimtar i Përbashkët"), si dhe Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013; neneve 15 dhe 26 të "Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës, 08.07. 2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror me nr. 2012 prot, datë 03.07.2025, “Mbi miratimin e një ndryshimi në "Kodin e Rrjetit TAP" të propozuar nga TAP AG, më 12 maj 2025” dhe duke patur parasysh se në muajin qershor 2013, autoritetet kombëtare (këtu e në vijim: “Autoritetet”) – për Italinë: Ministria Italiane e Zhvillimit Ekonomik në bashkëpunim me ARERA, për Greqinë: RAE dhe për Shqipërinë: ERE – mori vendimin për përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik nga zbatimi i dispozitave të nenit 9 (Ndarja), nenit 32 (Aksesi i palëve të treta – TPA), si dhe të neneve 41(6), 41(8) dhe 41(10) (Tarifat e rregulluara) të Direktivës 2009/73/EC, një dokument i hartuar së bashku, i ndryshuar, për të qenë në përputhje me Vendimin e Komisionit [C(2013)2949 përfundimtar], datë 16 maj 2013, duke marrë parasysh gjithashtu opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 Maj 2013.

Në përputhje me nenin 4.7.1 të FJO-së, TAP AG është e detyruar të paraqesë për miratim tek

Autoritetet Rregullatorë, Kodin e Rrjetit TAP jo më vonë se 12 muaj përpara datës së funksionimit të tij tregtar.

Ky Kod u ndryshua më tej në vitin 2022, me vendimin e ARERA-s nr. 104/2022/R/gas, vendimin e ERE-s nr. 45, datë 18.03.2022, dhe vendimin e RAE-s nr. 265/2022, publikuar në Gazetën Zyrtare Greke B' 1768, datë 12.04.2022; në vitin 2023, me vendimin e ARERA-s nr. 127/2023/R/gas, vendimin e ERE-s nr. 115, datë 30.03.2023, dhe vendimin e RAE-s nr. 199/2023, publikuar në Gazetën Zyrtare Greke B' 2438, datë 12.04.2023; si dhe në vitin 2024, me vendimin e ARERA-s nr. 455/2024/R/gas, vendimin e ERE-s nr. 237, datë 05.11.2024, dhe vendimin e RAAEY nr. E-242/2024, publikuar në Gazetën Zyrtare Greke B' 6867, datë 16.12.2024.

Ndryshimet e propozuara në Kodin e Rrjetit TAP AG janë në përputhje me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (FJO), si dhe me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian në fuqi. Ndryshimet e propozuara nga TAP AG i janë nënshtruar diskutimeve mes të tre rregullatorëve të cilët dakordësuan si dokument të përbashkët *“Approval of an amendment to “TAP Network Code” proposed by TAP AG on 12 May 2025”*, Annex A i cili përmban ndryshimet e TAP Network Code të përcjella në Annex B dhe arsyet e këtyre modifikimeve; Ndryshimet në kodin e rrjetit TAP janë në përputhje me parimet në opinionin e përbashkët përfundimtar; Final Joint Opinion.

Vendimin nr. 146, datë 08.07.2025 “Mbi miratimin e dokumentit për “Udhëzimet për testimin e tregut të gazsjellësit Trans Adriatik”, propozuar nga TAP ag më 16 qershor 2025

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1; dhe 108, të ligjit nr. 102/2015 *“Për sektorin e gazit natyror”* i ndryshuar; *Dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë”* (Opinionit Përfundimtar i Përbashkët), Korrik 2013; *Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë*, datë 14 Maj 2013, *“Mbi përjashtimin e gazsjellësit TAP AG, nga kërkesa të caktuara sipas Direktivës 2009/73/EC nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë”*, Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/459 e datës 16 mars 2017 *“Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e Rregullores (BE) Nr. 984/2013”* (Mekanizmi për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit); vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 103, datë 26.06.2019, *“Mbi miratimin e Transpozimit të Rregullores 2017/459 të miratuar me vendimin nr.2018/06/PHGL-ENC “Mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”*; si dhe neneve 15 dhe 26 të *“Rregullores për organizimin, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2011 prot., datë 03.07.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, *“Mbi miratimin e dokumentit për “Udhëzimet për testimin e tregut të gazsjellësit Trans Adriatik” propozuar nga TAP AG më 16 qershor 2025”*, në përputhje me Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, *“Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror”*;

Direktivën (BE) 2019/692 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 prill 2019, *“Për ndryshimin e Direktivës 2009/73/EC për rregullat e tregut të brendshëm të gazit natyror”*;

Rregulloren (BE) 2017/459 të Komisionit, datë 16 mars 2017, *“Për vendosjen e një kodi rrjeti për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit”* (CAM NC);

Rregulloren (BE) 2019/942 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 qershor 2019, *“Për themelimin e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë”*;

Vendimin e Komisionit Evropian, nr. C (2013)2949 final, datë 16 maj 2013, “Për përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik nga detyrimet për aksesin e palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, sipas neneve 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/EC”;

Paragrafin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, sipas të cilit TAP AG duhet të kryejë rregullisht (të paktën çdo dy vjet) një testim tregu, me qëllim ofrimin e kapaciteteve shtesë për palët e interesuara deri në arritjen e kapacitetit maksimal të zgjerimit të tubacionit.

Testimi i Tregut, duhet të realizohet në përputhje me Udhëzimet e miratuara bashkarisht nga Autoritetet Rregullatore të energjisë të Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (ARERA)

Më datë 16 mars 2017, u miratua Rregullorja (BE) nr. 2017/459 e Komisionit, “Për krijimin e Kodit të Rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit” dhe për shfuqizimin e Rregullores (BE) nr. 984/2013. Kjo rregullore (në vijim: CAM NC) vendos kuadrin rregullator për mekanizmat e alokimit të kapacitetit në sistemet e transmetimit të gazit, duke përfshirë si kapacitetin ekzistues, ashtu edhe atë shtesë (në rritje).

“Udhëzuesi për Testimin e Tregut për Gazsjellësin Trans Adriatik 2023”, i paraqitur nga TAP AG më datë 6 qershor 2023, u miratua nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 212, datë 27.06.2023.

Më datë 16 qershor 2025, në përputhje me paragrafin 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP AG i paraqiti Autoriteteve dokumentin “Udhëzuesi për Testimin e Tregut të Gazsjellësit Trans Adriatik”

Dokumenti me datë 16 qershor 2025, i cili përmban “Udhëzimet 2025 e Testimit të Tregut” për ekzaminimin e ofertave të reja të mundshme për kapacitet në rritje, u dërgua nga TAP AG për miratim nga Autoritetet.

Autoritetet, pas shqyrtimit të “Udhëzimit për Testimin e Tregut 2025”, i cili në thelb bazohet në të njëjtat parime të zbatuara gjatë Testimit të Tregut 2023, hartuan në mënyrë të përbashkët një dokument që përmban vendimin për miratimin e udhëzimeve dhe arsyet përkatëse

Dokumenti i përbashkët është gjithashtu objekt miratimi dhe u miratua nga autoritetet rregullatore të Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

Vendim nr. 147, datë 08.07.2025 “Mbi kërkesën e TAP AG për përjashtimin nga zbatimi i standartit ISO 27001”

Në mbështetje të neneve 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenin 13 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar; ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 553, datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturës së informacionit kritik dhe të rëndësishëm” ndryshuar me VKM-në nr. 761, datë 12.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 553, datë 15.07.2020, të Këshillit të Ministrave”; Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 126, datë 30.07.2020; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.07.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1940/1 prot., datë 03.07.2025, të Sektorit të Sigurisë Kibernetike dhe IT-së “Mbi kërkesën e TAP AG për moszbatimin e standartit ISO 27001”, shoqëria TAP AG, me shkresën e saj nr. 1940 prot., datë 25.06.2025, i është drejtuar ERE-s me një kërkesë për moszbatimin e detyrimit për t’u certifikuar sipas standardit ISO/IEC 27001, të përcaktuar në “Rregulloren për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturës Kritike në Sektorin e Energjisë”.

TAP AG ka argumentuar se, për shkak të karakterit ndërkufitar të veprimtarisë së saj dhe klasifikimit të saj si subjekt thelbësor në kuadër të Direktivës (BE) 2022/2555 (NIS2), ajo i nënshtrohet mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente të Greqisë dhe Italisë, dhe zbaton të gjitha detyrimet që burojnë nga kjo direktivë, në përputhje edhe me garancitë ligjore të parashikuara në Marrëveshjen me Qeverinë e Vendit Pritës, ratifikuar me ligjin nr. 102/2013.

Duke marrë në konsideratë përputhshmërinë e sistemit të menaxhimit të sigurisë kibernetike të TAP AG me kërkesat e Direktivës NIS2, dhe në përmbushje të angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, pranojmë kërkesën e shoqërisë TAP AG dhe të vendosi:

“Miratimin e kërkesës së TAP AG për përjashtimin nga zbatimi i standardit ISO/IEC 27001, sipas Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturës Kritike në Sektorin e Energjisë.”

Vendimin nr. 170, datë 31.07.2025 mbi “Miratimin e propozimit të projektit të paraqitur nga TAP, SRG dhe DESFA, për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2023”

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i ndryshuar, nenit 13, gërma “a”, pika 1 e nenit 15, pika 25 e nenit 16, dhe nenit 108 të ligjit nr. 102/2015, *“Për sektorin e gazit natyror”*; bazuar në pikën 2 të nenit 28 të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/459 të datës 16.03.2017, transpozuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 103, datë 26.06.2019; si dhe neneve 15 të *“Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016; opinionet më të fundit të shprehura nga përfaqësuesit e autoriteteve rregullatore kombëtare të Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAAEY), lidhur me miratimin e *“Propozimit të Projektit”*, të paraqitur njëherësh nga TAP, SRG dhe DESFA më 20 korrik 2025, për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2023 – Faza e Lidhjes; vendimin e Bordit të ERE-s nr. 285, datë 05.10.2023, për miratimin e projektit të TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2021 – Faza 2 e Lidhjes; vendimin e Bordit të ERE-s nr. 270, datë 02.11.2022, për miratimin e propozimit të projektit të TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2021 – Tetor 2022; vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 11.05.2021, për miratimin e propozimit të projektit të TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2019; Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2171 prot., datë 25.07.2025, si dhe informacionin shtesë me nr. 2171/1 prot., datë 30.07.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror *“Mbi miratimin “Propozim Projektit nga TAP, SRG dhe DESFA, për Procesin e Rritjes së Kapacitetit të vitit 2023 –Faza e Lidhjes”, e paraqitur njëherësh më 28 korrik 2025”*.

ERE me vendimin nr. 27, datë 01.03.2013, miratoi përjashtimin e kushtëzuar të kompanisë TAP AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin *“Trans Adriatik Pipeline”* dhe dokumentin *“Opinion i Përbashkët i Rregullatorëve për Aplikimin e TAP AG për Përjashtime”*. Pas komenteve dhe sugjerimeve të bëra nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, dhe Vendimit të Komisionit Evropian (C (2013)2949, ERE me vendimin nr. 64, datë 13.06.2013, amendoi vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 27, datë 01.03.2013 dhe vendosi miratimin e dokumentit *“Opinion Përfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përjashtim”*.

Opinionin Përfundimtar mbi përjashtimin e TAP AG nga Rregullat e Aksesit të Palëve të Treta dhe parashikime të tjera të Paketës së Tretë të Energjisë, u miratua njëkohësisht edhe nga Rregullatorët Italian dhe Grek.

Paragrafi 4.1 i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar e kushtëzoi dhënien e përjashtimit nga përmbushja e kushteve të caktuara, duke përcaktuar që TAP AG të kryejë periodikisht një Testim Tregu me qëllim që tu ofrojë të gjitha palëve të interesuara kapacitet shtesë derisa të arrihet mundësia maksimale e zgjerimit të gazsjellësit (në vijim i referuar si Kapacitet Zgjerimi). Ky

testim duhet të kryhet sipas udhëzimeve të miratuara bashkërisht nga autoritetet rregullatore italiane të energjisë.

Në vitin 2019, Autoritetet rregullatore ARERA, ERE, dhe RAE miratuan “*Udhëzuesin për Testimin e Tregut 2019 të Gazsjellësit Trans Adriatik*” të paraqitura nga kompania TAP AG me 14 qershor 2019. (Vendimi i ERE nr.95 datë 17.06.2019);

Me vendimin nr. 122, datë 11.05.2021, Bordi i ERE-s miratoi propozimin e projektit të TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes të kapacitetit për vitin 2019”, siç shprehet në vendimin e përbashkët me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE;

Me Vendimin nr. 151, datë 29.06.2021, Bordi i ERE-s miratoi udhëzuesin për testimin e tregut për gazsjellësin Trans Adriatik Pipeline, ashtu si edhe shprehet në vendimin e përbashkët me Rregullatorët e Italisë dhe Greqisë, përkatësisht ARERA dhe RAE;

Më datë 06 tetor 2022, SRG, TAP dhe DESFA i paraqitën për shqyrtim tre autoriteteve rregullatore për energjinë – ERE, RAE dhe ARERA – Projektin “Proçesi i Rritjes së Kapacitetit 2021”. Me Vendimin nr. 270, datë 02.11.2022, Bordi i ERE-s, miratoi "Projekt propozimin e TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes së kapacitetit 2021 - Tetor 2022" siç dakordësuar në vendimin e përbashkët me Italinë dhe Greqinë, përkatësisht ARERA dhe RAE.

Pas fazës së parë të detyrueshme, u dha kapaciteti që korrespondonte me nivelin e parë të kapacitetit rritës të propozuar, domethënë 32,800 MWh/ditë në pikën e daljes së Melendugno-s për një periudhë trevjeçare (1 janar 2026 - 31 dhjetor 2028) dhe 5,000 MWh/ditë me pikën e hyrjes Nea Mesimvria (Greqi) dhe pika e daljes Roskovec (Shqipëri) për periudhën 1 tetor 2026 – 30 shtator 2033; pas fazës së dytë detyruese, të miratuar me rezolutën 438/2023/R/eel dhe të kryer në vitin 2024, nuk u caktua më kapacitet; Në shtator 2023, ERE, ARERA dhe RAE hartuan një dokument të përbashkët “Miratimi i Projektit të TAP AG., SRG dhe DESFA për procesin e kapacitetit rritës të vitit 2021- Faza 2 detyruese (ANEKS A)”, i cili është vlerësuar se është në përputhje me parimet e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzuesit të Testit të Tregut dhe të CAM NC si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar. Në vijim, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 285, datë 05.10.2023, vendosi të miratojë dokumentin e përbashkët të dakortësuar me rregullatorin e Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAAEY) bashkëlidhur si ANEKS A dhe vendosën:

“Të miratojnë “Propozimin e Projektit nga TAP, SRG dhe DESFA për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2023 – Faza e Lidhjes”, të paraqitur njëherësh më datë 28 korrik 2025, i bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca B, si dhe dokumentin e miratimit të përbashkët të tre autoriteteve rregullatore të energjisë – ERE, RAAEY dhe ARERA, të bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca A.

Vendim nr. 306, datë 21.11 .2025 “Mbi miratimin e një ndryshimi në “Kodin e Rrjetit TAP” propozuar nga TAP AG më 8 tetor 2025”

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1 germa "a"; dhe 108 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përrjashtimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC (“Opinionit Përfundimtar i Përbashkët”), si dhe Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës, 21.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror me nr. 2012/2 prot, datë 18.11.2025, “Mbi miratimin e një ndryshimi në "Kodin e Rrjetit TAP" të propozuar nga TAP AG, më 8 tetor 2025”, mbështetur në:

Direktivën (BE) 2024/1788 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 qershor 2024;

Rregulloren (BE) 2024/1789 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 qershor 2024;

Rregulloren (BE) 2019/942 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 qershor 2019, “Për themelimin e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER)”;

Rregulloren (BE) 312/2014 të Komisionit, datë 26 mars 2014, “Për krijimin e Kodit të Rrjetit për balancimin e gazit në rrjetet e transmetimit të gazit natyror”;

Rregulloren (BE) 2017/459 të Komisionit, datë 16 mars 2017, “Për vendosjen e Kodit të Rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit” (CAM NC);

Vendimin e Komisionit Evropian nr. C (2013)2949 final, datë 16 maj 2013, “Për përjashtimin e Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) nga kërkesat për akses të palëve të treta (TPA), rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, sipas neneve 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/EC”;

Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (Final Joint Opinion – FJO) të autoriteteve rregullatore të energjisë të Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAAEY) dhe Italisë (ARERA), datë 6 qershor 2013, mbi kërkesën e TAP AG për përjashtim, i rishikuar për t’u përputhur me Vendimin e Komisionit Evropian të 16 majit 2013;

Opinionin nr. 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013;

Vendimin e ERE nr. 97, datë 15.06.2020, Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit TAP;

Vendimin e ERE nr. 45, datë 18.03.2022, Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Kodin e Rrjetit TAP” me propozim të shoqërisë TAP AG, miratuar me vendimin nr. 97, datë 15.06.2020 të Bordit të ERE-s;

Vendimin e ERE nr. 115, datë 30.03.2023, Mbi miratimin e një ndryshimi në Kodin e Rrjetit TAP, propozuar nga TAP AG;

Vendimin e ERE nr. 237, datë 05.11.2024, Mbi miratimin e një ndryshimi në “Kodin e Rrjetit TAP” dhe “Kodin Tarifor të TAP” propozuar nga TAP AG, më 29 tetor 2024;

Vendimin e ERE nr. 145, datë 08.07.2025, Mbi miratimin e një ndryshimi në Kodin e Rrjetit TAP, propozuar nga TAP AG më 12 maj 2025;

Shkresën e shoqërisë TAP AG, datë 8 tetor 2025, me të cilën paraqiten propozimet për ndryshime në Kodin e Rrjetit TAP (TNC), në përputhje me nenin 22 të Kodit të Rrjetit TAP.

Në përputhje me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (FJO) dhe Vendimin e Komisionit Evropian të datës 16 maj 2013, përjashtimi nga akses i palëve të treta (TPA) zbatohet vetëm për kapacitetin fillestar të gazsjellësit, duke përjashtuar një kuotë prej 5% që duhet të jetë e rezervuar për tregtimin e produkteve afatshkurtra; çdo kapacitet shtesë i mundshëm (incremental capacity/ kapacitet i ri mbi kapacitetin ekzistues) që mund të rrjedhë nga zgjerimi i gazsjellësit nuk përfshihet në përjashtim.

Në përputhje me kërkesat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Kodi i Rrjetit TAP (TNC) duhet të jetë në përputhje me Kodet e Rrjetit të BE-së në çdo pjesë që nuk bie në kundërshtim me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët.

Ky dokument është miratuar nga autoritetet rregullatore përkatëse të Italisë (ARERA) dhe të Greqisë (RAAEY).

Për sa më sipër, u vlerësua e nevojshme miratimi i draftit të dokumentit të përbashkët “Miratimi i një ndryshimi në Kodin e Rrjetit TAP”, propozuar nga TAP AG më datë 8 tetor 2025, i

bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca A dhe Kodi i Rrjetit i ndryshuar si Shtojca B.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s vendosi:

Të miratojë dokumentin e përbashkët të tre autoriteteve rregullatore të energjisë – ERE, RAAEY dhe ARERA “Miratimi i një ndryshimi në Kodin e Rrjetit TAP, propozuar nga TAP AG më 8 tetor 2025”, i bashkëlidhur këtij vendimi si Shtojca A dhe ndryshimet e Kodit të Rrjetit si Shtojca B.

Vendim nr. 310, datë 12.12.2025 “Mbi miratimin e kërkesës së ALBGAS sh.a. për shtyrjen e procedurës së miratimit të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; pikës 12 të nenit 16, neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; pikës 3 të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3011 prot., datë 12.12.2025 të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, për “Shtyrjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s miratoi shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria Albgaz Sh.a.

Shoqëria Albgaz sh.a. ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Energjisë kërkesën për miratimin e Planit Dhjetëvjeçar të Investimeve (2023–2032), për të cilën Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 12.10.2023, ka vendosur fillimin e procedurës së shqyrtimit.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 277, datë, 13.12.2024 vendosi “Shtyrjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve nga shoqëria Albgaz sh. a” me afat deri në dhjetor 2025. Me shkresën nr. 2852 prot., datë 13.11.2025, ERE i është drejtuar shoqërisë Albgaz sh.a. me lëndë “Kërkesë për dorëzimin e dokumentacionit plotësues për vijimin e procedurës së miratimit të Planit Dhjetëvjeçar të Investimeve (2023–2032)”.

Në përgjigje, shoqëria Albgaz sh.a., në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror, me shkresën nr. 119/1 prot., datë 27.11.2025, protokolluar me nr. 2852/1 prot., ka kërkuar shtyrjen e procedurës së miratimit të Planit Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit deri në dhjetor 2026, duke informuar për problematika dhe procese ende në zhvillim lidhur me përmbushjen e kërkesave rregullatore të ERE-s.

Albgaz sh.a. është informuar nga KESH sh.a., me shkresën nr. 3933/2 prot., datë 28.08.2023, për një defekt në sistemin e ftohjes së asetit termik TEC Vlorë, i cili ndodhet jashtë gatishmërie dhe në konservim.

KESH sh.a., në cilësinë e shoqërisë kontrolluese, ka ndërmarrë procesin e vlerësimit teknik dhe planifikimit të ndërhyrjeve të nevojshme për rivënien në punë të asetit, në funksion të mundësisë së gjenerimit të energjisë përmes gazit natyror.

Gjithashtu Albgaz sh.a.: i) ka vënë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë lidhur me planifikimin e shpenzimeve dhe fondeve për projektet e shoqërisë (shkresa, nr. 106 prot., datë, 18.09.2023); ii) i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë si organi më i lartë vendimarrës, me kërkesën për t’iu drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me një kërkesë zyrtare për dhënie opinionimi në lidhje me Planin 10-vjeçar të Investimeve që shoqëria Albgaz sh.a. (shkresa nr. 132 prot. datë, 02.11.2023). Më datë 12 dhjetor 2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Albgaz sh.a. dhe SOCAR nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për zhvillimin e projektit të gazifikimit të qytetit të Korçës, si pjesë e zgjerimit të rrjetit kombëtar të gazit natyror.

Në vijim të këtij angazhimi, Albgaz sh.a., në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, ka marrë pjesë në Market Test-in e TAP AG për vitin 2025 për sigurimin e një pike dalje në tubacionin TAP për Korçën dhe, pas pagesës së tarifës përkatëse dhe nënshkrimit të Commitment Letter, është në pritje të përcaktimit të hapave të mëtejshëm të projektit.

Duke qenë se aktualisht Albgaz sh.a. është në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë luan një rol shumë të rëndësishëm të këtij zhvillimi, jo vetëm si institucion përgjegjës për politikën e zhvillimit të sektorit të gazit natyror, por edhe të mbikëqyrjes së ecurisë së projekteve të zhvillimit dhe të ndërtimit të sistemit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, Albgaz sh.a. bën me dije se do të përditësojë planin e saj dhjetëvjeçar të investimit duke reflektuar edhe zhvillimin e projektit NUR për gazifikimin e qytetit të Korçës, si një prioritet strategjik i parashikuar si i tillë edhe me VKM-në nr. 563, datë, 04.10.2023.

Nëpërmjet shkresës me nr. 2852/1 prot., datë, 27.11.2025 të cituar më sipër kërkon shtyrjen e afatit të dorëzimit të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit deri në muajin Dhjetor 2026.

Në pikën 3 të nenit 53, të ligjit nr. 44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: “Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”

Për gjithë sa më sipër, duke qenë se marrja e vendimeve/qëndrimeve të organeve kompetente si më sipër, është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga ERE, vlerësohet që të merret parasysh kërkesa për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve deri në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar dhe përgatitjen e një informacioni të plotë e të saktë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s vendosi:

Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës për miratimin e planit dhjetëvjeçar të investimeve deri në muajin dhjetor të vitit 2026.

Vendim nr. 313, datë 12.12.2025 “Mbi lënien në fuqi për vitin 2026 të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. miratuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, pika 1, 16 pika 2, 17 germa “e” dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 21 të ‘Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s’, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2392/1 prot., datë 10.12.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve dhe Drejtoria e Gazit Natyror “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të Gazit Natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për vitin 2026”.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga “Rregullorja për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, si dhe nga “Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 178, datë 08.11.2017, ERE i ka kërkuar shoqërisë “Albgaz” sh.a. paraqitjen e një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, të

shoqëruar me informacionin dhe dokumentacionin përkatës, jo më vonë se gjashtë muaj para hyrjes së tyre në fuqi, përmes shkresës nr. 2362 prot., datë 26.08.2025.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 96/1 prot., datë 01.09.2025, protokolluar pranë ERE-s me nr. 2392 prot., datë 02.09.2025, ka bërë me dije se, në rrethanat në të cilat zhvillon aktivitetin e saj të përditshëm si Operator i Sistemit të Transmetimit të gazit natyror, nuk ka pasur zhvillime domethënëse që do të ndikonin drejtpërdrejt në elementët përbërës të metodologjisë së tarifës së transmetimit dhe, për rrjedhojë, ka kërkuar që edhe për vitin 2026 të mbetet në fuqi tarifa aktuale e transmetimit, e miratuar nga Bordi i ERE-s.

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 12.10.2023, ka nisur procedurën për shqyrtimin e Planit Dhjetëvjeçar të Investimeve të “Albgaz” sh.a., ndërsa me vendimin nr. 277, datë 13.12.2024, ka shtyrë vendimmarrjen deri në dhjetor 2025.

Tarifa e transmetimit të gazit natyror përllogaritet, ndër të tjera, mbi bazën e investimeve të parashikuara në Planin Dhjetëvjeçar të Zhvillimit të Rrjetit të “Albgaz” sh.a.

“Albgaz” sh.a., në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, nuk ka paraqitur pranë ERE-s një aplikim për miratimin e një tarife të re transmetimi, sipas legjislacionit dhe metodologjisë në fuqi.

Në vijim të procedurës, ERE i është drejtuar “Albgaz” sh.a. me shkresën nr. 2852 prot., datë 13.11.2025, për dorëzimin e dokumentacionit plotësues për vijimin e procedurës së miratimit të Planit Dhjetëvjeçar (2023–2032).

Me shkresën nr. 119/1 prot., datë 27.11.2025, “Albgaz” sh.a. ka kërkuar shtyrjen e miratimit të Planit Dhjetëvjeçar deri në dhjetor 2026, duke sqaruar se ndodhet në një fazë të rëndësishme zhvillimi të sistemit të gazit natyror. Neni 17, germa “e”, i ligjit nr. 102/2015, parashikon kompetencën e ERE-s për miratimin e tarifave të përkohshme të transmetimit dhe vendosjen e masave kompensuese, në rast vonesash ose diferencash me tarifat përfundimtare.

Në mungesë të një aplikimi për tarifë të re, dhe duke qenë se tarifa e transmetimit është e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit dhe garantimin e aksesit në rrjet, vlerësohet e nevojshme shtyrja e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, edhe për vitin 2026, deri në miratimin e një tarife të re sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s vendosi:

“Lënien në fuqi për vitin 2026 të tarifës së transmetimit të gazit natyror miratuar me vendimin nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s”.

Vendim nr. 331, datë 18.12.2025 “Mbi vlerësimin e raportit vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë “Trans Adriatic Pipeline AG”, degë e shoqërisë së huaj, për zbatimin e programit të pajtueshmërisë rregullatore për vitin 2024”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 16 dhe 47, pika 5 germa “b” të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar; vendimit nr. 149, datë 10.09.2020 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), “Mbi miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” Paraqitur nga TAP AG në bazë të “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP”; vendimit të Bordit të ERE-s nr. 105, datë 29.06.2020, të ndryshuar me vendimin nr. 150, datë 10.09.2020, “Mbi miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) së TAP dhe Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë”, si dhe në zbatim të Direktivës 2009/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe për shfuqizimin e Direktivës 2003/55/EC”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për

organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s', miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator, me nr. 3085 prot., datë 17.12.2025, "Mbi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë Rregullatore për vitin 2024 të "TRANS ADRIATIC PIPELINE AG", degë e shoqërisë së huaj".

Në zbatim të nenit 47, pikat 5 gërma "b", të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 149, datë 10.09.2020, "Mbi miratimin e "Programit të Përputhshmërisë Rregullatore, dhe vendimit nr. 105, datë 29.06.2020, të ndryshuar me vendimin nr. 150, datë 10.09.2020, "Mbi miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) së TAP dhe Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë", Zyrtari i Përputhshmërisë është ngarkuar të paraqesë çdo vit pranë ERE një raport mbi monitorimin dhe zbatimin e programit përkatës. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 149, datë 10.09.2020, ka miratuar "Programin e Pajtueshmërisë Rregullatore" të shoqërisë "Trans Adriatic Pipeline AG", degë e shoqërisë së huaj, ndërsa me vendimin nr. 105, datë 29.06.2020, ndryshuar me vendimin nr. 150, datë 10.09.2020, ka miratuar Zyrtarin e Pajtueshmërisë së TAP AG dhe Kontratën për Ofrimin e Shërbimeve të tij.

Në zbatim të detyrimeve të Programit të Pajtueshmërisë, më datë 28.03.2025, Zyrtari i Pajtueshmërisë i TAP ka depozituar pranë ERE-s Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë për vitin 2024, në version konfidencial dhe jokonfidencial, në gjuhën shqipe dhe angleze, në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën 3.1.1.1(g) të Programit të Pajtueshmërisë. Vlerësohet se Zyrtari i Pajtueshmërisë i TAP AG ka përmbushur në mënyrë të rregullt dhe të plotë detyrimet e tij për vitin 2024, duke siguruar raportim vjetor pranë autoriteteve rregullatore dhe duke kontribuar në garantimin e pavarësisë funksionale, transparencës dhe trajtimit jo-diskriminues në tregun e gazit natyror.

Zbatimi i Programit të Pajtueshmërisë Rregullatore vlerësohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar, Direktivës 2009/73/EC, dhe akteve rregullatore në fuqi, ndërkohë që për periudhën pasardhëse mbetet e rëndësishme të sigurohet vazhdimësia e masave të transparencës, funksionaliteti i kanaleve të raportimit të brendshëm dhe administrimi i informacionit konfidencial sipas standardeve rregullatore. Vlen të theksojmë se dy autoritetet e tjera, ARERA në Itali dhe RAAEY në Greqi nuk e miratojnë me vendim por me një informim në Bordin Përkatës të tyre. Kjo do të thotë që ne për të ardhmen do të mjaftohemi me një informim në Bordin e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s vendosi:

Miratimin e Raporti Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë "Trans Adriatic Pipeline AG", degë e shoqërisë së huaj, për vitin 2024. Situata dhe Veprimtaria e ALBGAZ sh.a.

ALBGAZ sh.a. në përputhje me objektin e veprimtarisë së themelimit dhe më pas licensimit të saj, i cili është zhvillimi dhe operimi i infrastrukturës së transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri, ku krahas oportuniteteve që paraqet realizimi i objektit të veprimtarisë, përballet me disa sfida kryesore duke përfshirë por pa u kufizuar në:

- Bashkëpunimi me investitorë të huaj për të zhvilluar rrjetin e gazit në zona të caktuara brenda territorit të vendit.
- Përmirësimi i infrastrukturës aktuale të gazit natyror në Shqipëri, e cila është tejet e amortizuar, rehabilitimi i të cilës kërkon investime të konsiderueshme;
- Ngritja dhe zhvillimi i rrjetit të interkonjeksionit me vendet e rajonit;

ALBGAZ sh.a., që nga momenti i krijimit, mori barrën e zhvillimit të mëtejshëm të proceseve në përputhje me objektivat dhe strategjitë e përcaktuara, kështu që një nga detyrimet ishte edhe

përmbushja e angazhimeve ndaj shoqërisë TAP AG. Për këtë qëllim, u krijua shoqëria AGSCO - "Albanian Gas Service Company" sh.a. me objekt të veprimtarisë realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së gazsjellësit TAP AG. Kjo u bë e mundur nëpërmjet partneritetit me shoqërinë italiane SNAM S.p.A, një shoqëri lider në fushën e infrastrukturës së gazit natyror dhe njëkohësisht aksionar i shoqërisë TAP AG. Gjithashtu, në funksion të realizimit të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Mirëmbajtjes, janë financuar nga TAP AG dhe realizuar nga ALBGAZ sh.a., Qendra e Mirëmbajtjes në Korçë dhe Qendra e Mirëmbajtjes në Fier.

ALBGAZ sh.a. është aksionari mazhoritar në Shoqërinë AGSCO - "Albanian Gas Service Company" sh.a., zotërues i 75% të aksioneve dhe rrjedhimisht përfitues nga fitimet e shpërndara çdo vit në formën e dividendit duke zbutur dhe ndikuar në bilancin e shoqërisë.

Në përputhje me kushtet e tregut, ALBGAZ sh.a. ka pasur si klient të vetëm për ofrimin e shërbimit të transmetimit të gazit natyror, shoqërinë Albpetrol sh.a., e cila duke filluar me pandeminë COVID-19 uli në mënyrë të ndjeshme prodhimin e naftës dhe rrjedhimisht edhe sasinë e gazit shoqërues për transmetim, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe të ardhurat nga ky aktivitet. Në vijim dhe për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2025 shoqëria ALBGAZ sh.a. nuk ka pasur aktivitet në transmetimin e Gazit Natyror. Megjithatë, Albgaaz sh.a. ka vijuar të mbajë në funksion dhe gatishmëri linjat e transmetimit për nevojat e Albpetrol sh.a. në të ardhmen.

6.5.1. Zhvillimet e fundit

6.5.1.1. Projekti i Gazifikimit të Korçës

- Më datë 12 nëntor 2024, Socar Balkans nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërinë Albgaaz sh.a. mbi mundësinë e bashkëpunimit në fushat e projektimit, zhvillimit dhe ndërtimit të rrjetit të shpërndarjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe implementimin e Projektit në qytetin e Korçës.
- Shoqëria Albgaaz sh.a., është angazhuar në këtë Projekt, si Operatori i Sistemit të Transmetimit që lidh pikën dalëse në TAP me sistemin e shpërndarjes që do të furnizojë qytetin e Korçës me gaz natyror.

Për këtë qëllim, shoqëria ka marrë miratimin e nevojshëm nga organet vendimmarrëse për tu angazhuar financiarisht në etapat paraprake si vijojnë:

1. **Regjistrimi në Testin e Tregut 2023** në kuadër të alokimit të kapaciteteve në gazsjellësin TAP AG duke kryer një pagesë në vlerën 10,000 euro;
2. **Shpenzime për studime inxhinierike të TAP** në kuadër të kërkesës për modifikim/zgjerim të kapaciteteve infrastrukturore në pronësi të saj, vlera e të cilës është 150,000 euro.

Marrëveshja e Pikës Dalëse në Fier (TAP Exit)

Që prej datës 02.06.2025, TAP ka hyrë në fazën e ekzekutimit të kontratës EPC me kontraktorin e përzgjedhur, për stacionin e reduktimit dhe matjes së presionit (Fier South Facility), detyrim ky që rrjedh nga Marrëveshja e Dorëzimit të Pikës Dalëse Fier, nënshkruar ndërmjet TAP AG (Investitori) dhe MIE më 09.07.2021. Në kuadër të projektit të PRMS Fier, është caktuar Albgaaz sh.a. për ndjekjen e zbatimit të kontratës nga MIE.

Më datë 16 shtator 2025 u lançua takimi i parë teknik ndërmjet TAP AG dhe shoqërisë Albgaaz sh.a. për tu njohur me ecurinë e Projektit, objekteve që do të ndërtohen, standarteve dhe konfigurimit të përgjithshëm. Sipas projekt programit, parashikohet që ndërtimi i veprës të fillojë në mes të 2026 dhe të komisionohet në fund të vitit 2027, ku do të dorëzohet Albgaaz sh.a. në përputhje me objektin e Marrëveshjes.

6.4.9. Memorandume dhe Bashkëpunime me Palë të Treta

Ky memorandum merr parasysh marrëdhëniet që Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror kanë me pjesëmarrësit e tjerë të tregut, për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit të gazit natyror si dhe plotësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me gaz natyror të klientëve.

Meqenëse shumë projekte të mbuluara nga ky memorandum kanë për qëllim të forcojnë bashkëpunimin dhe integrimin rajonal, njëkohësisht ato kontribuojnë në krijimin e tregut të gazit të Ballkanit Perëndimor dhe sigurinë e furnizimit të tij (North Macedonia Interconnector, IAP, ALKOGAP). Në procesin e përgatitjes së prezantimit, Albgaz sh.a. është konsultuar me operatorë të tjerë, veçanërisht me TAP-in dhe OST-të e vendeve fqinje duke përfshirë: Plinacro, Snam, DESFA, dhe ka marrë parasysh dokumentet e tjera publike të rëndësishme për planet e ardhshme të zhvillimit të sektorit të gazit, të lëshuara nga autoritetet shtetërore të Malit të Zi, Kosovës etj. Në dokumentet e bëra publike nga OST-të e vendeve fqinje, përmenden projektet e mëposhtme të investimeve që kanë lidhje me planin e investimeve të Albgaz-it si për shembull:

- Gazsjellësi Adriatiko-Ionian (IAP) – përmendet në “Planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të Sistemit të Transmetimit të Gazit në Republikën e Kroacisë për 2021 – 2030” të Plinacro-s. IAP përmendet ndër dy projektet shumë të rëndësishme (së bashku me Terminalin Krk), me fillimin e transportit të gazit natyror përmes sistemit IAP të planifikuar për vitin 2026 me kapacitet 5 BCM. Ndërkohë, sipas diskutimeve të zhvilluara me përfaqësues të IAP-it, nuk pritet që fillimi i ndërtimit të ndodhë “më shpejt se viti 2027”, duke e vonuar kështu vënien në operacion.
- Gazsjellësi Nea Messimvria – Evzoni/ Gjevgjeli – i përmendur në “Planin e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar të Transportit të Gazit 2021-2030” të Desfa-s. Ky është seksioni grek i Interkonjeksionit Greqi - Maqedoni e Veriut (IGNM), me një gjatësi prej 55 km. Projekti, me kapacitet vjetor 1.5 BCM, synon ndërlidhjen e sistemeve të transmetimit të gazit natyror të Greqisë dhe Maqedonisë së Veriut, gjë që do të rrisë diversifikimin e burimeve të furnizimit për Maqedoninë e Veriut. Pala e Maqedonisë së Veriut mbulohet nga projekti “Gas Interconnector Greece – North Macedonia NMPART”. Tenderi për ndërtimin e këtij gazsjellësi ishte në vazhdim në vitin 2022. Në maj të vitit 2025 ky projekt mori miratimin për konstruksion, me kapacitet të zgjerueshëm deri në 3 bcm dhe i përshtatshëm për hidrogjen. Ky projekt nga njëra anë do të zvogëlojë shfrytëzimin potencial të kapaciteteve të interkonjeksionit Shqipëri – Maqedoni e Veriut, por nga ana tjetër, në rast se Kosova do të jetë e gatshme të konsumojë gaz në të ardhmen, kostot më të ulëta (72 milionë euro) për ndërtimin e një interkonjeksioni direkt Maqedoni Veriore – Kosovë në krahasim me Interkonjektorin Shqipëri – Kosovë mund të justifikojnë sasi shtesë të gazit të dërguar nga Shqipëria përmes Interkonjektorit Shqipëri – Maqedoni e Veriut.
- Megjithëse Nomagas, OST e Maqedonisë së Veriut, nuk publikoi një Plan 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit, mundësia e një ndërlidhjeje ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë përmendet në "Strategjinë për Zhvillimin e Energjisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040" të miratuar në 2018, si dhe në “Raportin Vjetor 2020” të publikuar nga Komisioni Rregullator i Shërbimeve për Energji dhe Ujë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Megjithatë, ky interkonjektor nuk duket të jetë prioritet për Maqedoninë e Veriut, ndërsa projektet kryesore nën shqyrtim janë Interkonjeksioni Greqi – Maqedoni e Veriut dhe zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së Shkupit.
- Drafti i “Strategjisë Energjetike të Kosovës 2022-2031” nuk e përmend gazin në mesin e burimeve potenciale të ardhshme të energjisë. Prandaj, ndërtimi i një ndërlidhësi ndërmjet

Shqipërisë dhe Kosovës (ALKOGAP) duket se nuk ka gjasa të ndodhë së shpejti, derisa Qeveria e Kosovës të vendosë ndryshimin e strategjisë.

- “Plani Strategjik 2022-2030” i Enagas përmend 600 milionë euro investime deri në vitin 2030 për Korridorin Mesdhetar: dyfishimi i kapacitetit të TAP në 20 BCM dhe zhvillimi i infrastrukturës në Greqi dhe në Shqipëri.
- Në maj 2022, Albgaz sh.a. dhe Overgas Inc. e Bullgarisë nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi (MoU) në Tiranë për të bashkëpunuar në projekte që do të diversifikojnë furnizimet me gaz natyror në Ballkan. Shqipëria u zotua të sigurojë akses në terminalin e planifikuar të GNL-së së Vlorës.
- Në maj 2022, operatori amerikan i GNL-së, Excelerate Energy, deklaroi synimin për të vendosur Floating Storage Regasification Unit (FSRU) e saj Excelsior për t'i shërbyer projektit të GNL-së së Vlorës në Shqipëri, fill pasi kjo njësi të përfundonte kontratën e saj në Izrael. Para kësaj, Excelerate nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi për të kryer një studim fizibiliteti për zhvillimin e mundshëm të një zgjidhjeje të integruar bashkë me Gaz Natyror të Lëngëzuar (GNL), duke përfshirë një terminal importi GNL-je në Portin e Vlorës në jug të Shqipërisë.
- Në korrik 2022, Excelerate Energy, Inc. dhe Overgas Inc. nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, në lidhje me shitjen e GNL-së të rigazifikuar nga terminali i GNL-së i Vlorës. Vëllimi i parashikuar arrin deri në 1.0 miliardë metër kub GNL të rigazifikuar në vit, për një periudhë dhjetëvjeçare, përmes gazsjellësit Vlorë - Fier.
- Në tetor 2022, Enagás nënshkroi një LoI me Albgaz sh.a. për blerjen e mundshme të aksioneve të shoqërisë dhe për t'u angazhuar në projekte të përbashkëta, më konkretisht projektin e Terminalit të GNL Vlorë dhe gazsjellësin Vlorë - Fier, por potencialisht edhe për shpërndarje të GNL në shkallë të vogël në Shqipëri, për ndërtimin e IAP dhe Depozitës Nëntokësore të Gazit (UGS) në Dumre.

6.5. Ndikimi i Hidrogjenit

Në nivele të ndryshme të institucioneve të Bashkimit Evropian, si dhe në industrinë e gazit dhe energjisë, ka një diskutim rreth rolit të hidrogjenit si një lëndë e parë dhe bartëse e qëndrueshme e energjisë dhe si dhe mbi përdorimin e tubacioneve ekzistues dhe të sapondërtuar të gazit natyror për transmetimin e hidrogjenit në të ardhmen. Shumë shoqëri, duke përfshirë këtu edhe disa operatorë të sistemeve të transmetimit Evropian, kryen sondazhe dhe teste për të vlerësuar përdorimin e mundshëm të tubacioneve ekzistuese të gazit natyror për hidrogjen. Këto hulumtime kanë treguar se tubacionet e ndërtuara së fundmi nuk mund të modifikohen teknikisht në mënyrë që të mundësojnë transmetimin e sigurt të hidrogjenit (ose minimalisht të gazit natyror me përmbajtje të lartë hidrogjeni), por mund të përdoret gjurma e këyre tubacioneve.

Megjithatë, duke qenë se ritmi i ndërtimit të instalimeve të prodhimit në shkallë të lartë të hidrogjenit si dhe shkalla e konvertimit të konsumatorëve nga gazi natyror në hidrogjen janë aktualisht të panjohura dhe të pasigurta, për të mbajtur opsionin e hidrogjenit ende të zbatueshëm për Shqipërinë, Albgaz sh.a. merr në konsideratë që tubacionet e reja të gazit do të ndërtohen të tilla për të pranuar hidrogjen dhe për të ndryshuar minimalisht/ose për të punuar në minimum në rast të një përmbajtje më të lartë hidrogjeni.

6.6.1. Zhvillime të tjera

Inicimin e ndryshimit të VKM nr. 87/2018 “Plani i zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe Identifikimi i Projekteve Prioritare”, ndryshim i cili u reflektua në VKM Nr. 563 datë 04.10.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 87 datë 14.02.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe

identifikimin e projekteve prioritare”, i cili në pikën 2 të tij amendon pikën 5.6, nëndarja e parë dhe shprehet për presionin maksimal të lejuar deri në 100 bar, për sistemin e transmetimit në Shqipëri kur IAP nuk ekziston. Në përputhje me ndryshimet ligjore, në themel të aktiviteteve të kryera nga Albgaz sh.a. ka qenë analizimi i projektit të detajuar të financuar nga WBIF dhe të dokumentave, mbi të cilat u bazua studio C&M Engineering e cila hartoi projektin e detajuar me qëllim mundësimin e realizimit të ndërtimit të këtij gazsjellësi, gjithnjë në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore. Nga kjo analizë rezultoi se, ky projekt, pavarësisht cilësisë së hartimit nga pikëpamja inxhinierike dhe dokumentacionit shoqerues të tij, nuk adresonte disa çështje kryesore si për shembull:

- Lidhjen e rrjetit të tubacioneve shqiptare me sistemet ndërshtetërore të transmetimit të gazit rajonal dhe evropian për shkak të projektimit të këtij tubacioni për transport gazi natyror vetëm me një drejtim, nga Pika e Interkonjeksionit TAP CP1 në drejtim të TEC Vlorë. Presioni i projektimit prej 55 barg i përdorur nga projektuesi për llogaritjet hidraulike dhe konstruktive të gazsjellësit Fier-Vlorë nuk lejon adoptimin e tij si gazsjellës bi-direksional për të injektuar gaz natyror në tubacionin e TAP për shkak se presioni i punës në tubacionin e TAP është mbi 82 barg.
- Mundësinë e përdorimit të këtij gazsjellësi të ri për transportimin gazit natyror nga Vlora në drejtim të TAP, në rastin e ndërtimit të një Terminali të Gazit të Lëngshëm në portin e Vlorës si një mundësi shumë e mirë për kompensimin e nevojave të tregut rajonal dhe evropian për gaz natyror për shkak të heqjes graduale nga përdorimi i qymyreve si dhe të nevojave për të kompensuar gazin natyror të munguar nga tregu rus.
- Mundësinë e përdorimit të këtij gazsjellësi të ri për transportimin e burimeve të gjelbërta të energjisë siç është hidrogjeni për shkak të zgjidhjes konstruktive të këtij tubacioni (materialeve e pajisjeve të projektuara vetëm për gaz natyror).

Në ndryshimet ligjore, konkretisht VKM 563/2023, ndër të tjera përcakton se në listën e prioriteteve me terma afatshkurtër shtohet nëndarja 2/1 me përmbajtje “Zhvillimi i pikës së daljes dhe rrjetit të shpërndarjes Bashkia Korçë” dhe “Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së gazit të lëngshëm natyror”. Me këto ndryshime, Albgaz sh.a. ndjek me prioritet mundësitë për realizimin e projektit të gazifikimit të qytetit të Korçës, duke hyre në negociata të drejtpërdrejta me shoqërinë publike Azere SOCAR, për zbatimin e projektit NUR, i cili do të mundësonte krijimin e një rrjeti të ri gazi për qytetin e Korçës.

Për këtë qëllim, më datë 12.11.2024, Albgaz sh.a. së bashku me MIE dhe SOCAR kanë nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi (MoU) me objekt:

- a. Palët do të studiojnë mundësitë e ndryshme të bashkëpunimit në fushën e projektimit, zhvillimit dhe ndërtimit të rrjetit të shpërndarjes së gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe zbatimin e projektit NUR në qytetin e Korçës, Shqipëri;
- b. Palët do të studiojnë projekte specifike të identifikuara nga Palët në bazë të interesit të balancuar dhe të ndërsjellë;
- c. Pas nënshkrimit të këtij memorandumi, Palët do të shqyrtojnë dhe vlerësojnë mundësitë për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në mbështetje të Projektit si shkëmbimi i të dhënave, studime ose koncepte zhvillimi, lehtësimin e procedurave, me qëllim vlerësimin e zhvillimit të projektit ose të ndonjë projekti tjetër në fushën e OST/OSSH-G ose furnizimit me gaz natyror, ndikimin e tij në mjedis, zhvillimin e nevojshëm të infrastrukturës së transmetimit si dhe rishikimin e mundshëm financiar dhe ligjor të elementeve të projektit etj.

Albgaz sh.a. ka dorëzuar pranë ERE-s Planin 10-vjeçar të Investimeve. Ky Plan aktualisht është në proces plotësimi nga ana e Albgaz sh.a. të disa kërkesave teknike, të kërkuara nga ERE, për uniformizimin e tij me parashikimet e tjera ligjore dhe nënligjore. Parimet e ndjekura në hartimin e Planit të Investimeve janë në harmoni të plotë me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sektorit të gazit natyror, të miratuara me VKM-në nr. 87/2018 *“Për miratimin e Planit Kombëtar për Sektorin e Gazit”* (Master Planit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë, e ndryshuar me VKM-në nr. 563, datë 04.10.2023, të parashikuara në nenin 6, gërmat “a” dhe “b” të *“Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror”*.

Albgaz sh.a., ka të nevojshme dhe të domosdoshme, mbështetje financiare por edhe teknike, me qëllim optimizimin dhe realizimin e projekteve dhe sipërmarrjeve tregtare. Mbështetje e tillë, do të duhet të sigurohet nëpërmjet partneritetit me kompani ndërkombëtare, me eksperiencë të zgjeruar në fushën e infrastrukturës së gazit natyror, jo vetëm sa i përket projektimit por edhe aktiviteteve pasuese sic janë operimi dhe mirëmbajtja e saj.

Bashkëpunimi me aktor të rëndësishëm ndërkombëtar do të sillte përmirësime në të gjitha aspektet e veprimtarisë duke përfshirë atë teknike, financiare sikurse përthithjen dhe sigurimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira në sektor, kjo edhe për aktivitetet pasuese të ndërtimit të infrastrukturës, sic janë operimi dhe mirëmbajtja, të cilat kërkojnë kapacitete financiare por edhe njerëzore me ekspertizë të thelluar në sektor.

6.6.2. Objektivat që Synohen të Arrihen në Sektorin e Gazit.

ERE ka një bashkëpunim me MIE-n dhe me Albgaz sh.a. në lidhje me:

- (i) rivënien në punë të TEC-it të Vlorës;
- (ii) krijimin e një terminali për shpërndarjen e gazit natyror të lëngshëm;
- (iii) ndërtimin e një tubacioni të gazit natyror nga Terminali i Vlorës në Fier, Albgaz sh.a. ka vënë në dispozicion të gjitha kapacitetet e saj për eksplorimin e mundësive të realizimit të projekteve.

Pozicioni gjeografik i Shqipërisë, sikurse dhe faktorë të tjerë janë kryesorë në krijimin e një momentumit për zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri :

- (i) përfundimi i ndërtimit të qendrës së gazit në Fier dhe fillimi i operacioneve në bashkëpunim me TAP;
- (ii) situata e vështirë ndërkombëtare e furnizimit me gaz prej agresionit rus në Ukrainë;
- (iii) nevoja për të diversifikuar burimet e furnizimit me energji;
- (iv) vendosmëria e Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur gazifikimin e vendit,

6.6.3. Projektet e Parashikuara nga Albgaz sh.a.

Albgaz sh.a., gjatë kësaj periudhe, ka operuar në një kohë kur gazi natyror nuk konsiderohej burim tranzitor drejt objektivit për sigurimin e energjisë së gjelbër dhe për rrjedhojë ishte jashtë agjendës evropiane, duke bërë që burimet për financimin e projekteve në fushën e transmetimit të gazit të kufizoheshin në mënyrë drastike, por siç theksuam më lart situata e vështirë ndërkombëtare e furnizimit me gaz prej agresionit rus në Ukrainë riktheu vëmendjen tek gazi natyror duke rikonsideruar atë si një burim tranzitor energjie, ky fakt lidhet ngushtësisht me nevojën tonë imediate të brendshme për diversifikim të burimeve energjitike dhe zvogëlimin e emetimeve të CO2 në natyrë.

Për këtë arsye, Albgaz sh.a. në ndërveprim me aktorë të tjerë të konsoliduar në Evropë e më gjërë, janë angazhuar në krijimin e një hub-i rajonal(nyje rajonale) në Vlorë. Synimi është bashkërendimi

i përpjekjeve dhe ndarja e roleve të secilit aktor në këtë konfigurim të sektorit të gazit i cili i përgjigjet jo vetëm sfidave energjitike në rang kombëtar por edhe në rang rajonal.

Në vijim po ju rendisim sipas prioritetit projektet, pjesë e të cilave është Albgaz sh.a., në rolin e tij si operator i kombinuar i gazit natyror, investitor apo edhe si partner strategjik.

Gazifikimi i qytetit të Korçës – Projekti NUR

Mbas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis Socar Balkans, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë Albgaz sh.a., projekti i Gazifikimit të Korçës është një hap më pranë realizimit dhe implementimit të tij. Shoqëria Albgaz Sh.a. është angazhuar në këtë Projekt, si operatori i sistemit të transmetimit që lidh pikën dalëse në TAP me sistemin e shpërndarjes që do të furnizojë qytetin e Korçës me gaz natyror. Shoqëria Albgaz sh.a. ka ndërmarrë hapat e nevojshëm me TAP për fillimin e realizimit të pikës së daljes (Exit Point), duke marrë pjesë në market test dhe duke paguar shpenzimet inxhinierike, që më pas të kemi koston e realizimit të pikës së daljes. Nga ana tjetër, paralel shoqëria SOCAR po vazhdon po projektin inxhinierik të detajuar për realizimin e shpërndarjes së gazit natyror në qytetin e Korçës dhe studimin e pikës ku do të lidhet me transmetuesin, në këtë rast Albgaz.

Tubacioni Fier-Vlorë-Fier (Interkonjeksioni me TAP)

Shoqëria Albgaz sh.a., në cilësinë e përfituesit, i është vënë në dispozicion projekti i detajuar për linjën e transmetimit të gazit natyror Fier-Vlorë, projekt i cili është vlerësuar si prioritar në përputhje me parashikimet e VKM nr. 87/2018 (Master Plani i Gazit Natyror për Shqipërinë). Në lidhje me këtë projekt, Albgaz sh.a. po merr masat e nevojshme mbi planifikimet tekniko - financiarë, sikurse edhe vlerësimin e kuadrit rregullator, në zbatim të legjislacionit në fuqi, për mundësinë e ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë-Fier.

Hub-i Vlorës parashikon që Terminali GNL të shërbejë si pikë furnizimi ndërmjet gazit të lëngëzuar dhe konsumatorëve. Për këtë qëllim, krahas pranisë së një konsumatori kyç siç është TEC-i i Vlorës, sasi të konsiderueshme gazi duhen të kontraktohen nga furnizues (*shippers*) nëpërmjet një tubacioni që lidh terminalin me një ndërlidhëse të TAP. Për të mundësuar këtë ndërlidhje, është projektuar tubacioni Vlorë-Fier, me gjatësi rreth 46 km, dhe që do të ridizenjohet përsa i përket parametrave teknikë të kapacitetit transmetues, për të akomoduar optimalisht volumet e furnizimit nga FSRU-ja. Albgaz sh.a. synon të zotërojë një pjesë të rëndësishme të kuotave në tubacion dhe do të operojë këtë aset së bashku me cilindo partner të dakordësuar sipas licencës së transmetimit, njohur dhe certifikuar nga Enti Rregullator i Energjisë.

Një aset infrastrukturor i lidhur ngushtë me tubacionin është edhe Pika e Daljes në Fier. Sipas Marrëveshjes HGA, TAP AG do të ndërtojë dhe dorëzojë nëpërmjet “Handover Agreement” Pikën e Daljes, e projektuar për një volum prej 0.7-1.8 bcm. Ndërkohë po punohet me dizajnin e detajuar të projektit të potencimit të kësaj Pike Dalëse, në mënyrë që të akomodohen kërkesat e reja që rrjedhin nga rritja e volumit të transmetimit deri në 5 bcm/vit.

Tubacioni Terminali Vlorë-TEC Vlorë.

Një tubacion me gjatësi 2 km do të lidhë pikën nga terminali me pikën hyrëse në TEC, për të furnizuar sipas modelit “Gas-to-Power”. Mbetet për tu përcaktuar nëse do të jetë një linjë më vete ose një degëzim i tubacionit Fier-Vlorë-Fier.

Ionian Adriatic Pipeline (IAP)

- **Seksioni i IAP: Fier-Kashar**

Tubacioni Ionian-Adriatic, i cili mbetet një prioritet kombëtar do lidhet me TAP në një ndërlidhëse në Fier, do të përshkojë rreth 170 km në territorin shqiptar për të vazhduar më tej në veri përmes Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës dhe për të përfunduar në Kroaci ku lidhet me sistemit

e transmetimit kroat, Plinacro. Kapaciteti do të projektohet për të transmetuar deri në 5 bcm. Parametrat teknikë janë: 32" (pol) për diametrin, 75-85 bar për presionin.

Në përputhje me MoU e nënshkruar midis qeverive të shteteve të cilat preken nga ky tubacion, aksionerët e këtij tubacioni do të jenë 4 (OST-G) operatorët e transmetimit përkatës të çdo vendi ku do të kalojë tubacioni, me kuota pronësie të barabartë, prej 25%. Aktualisht, angazhimi i secilit entitet është shprehur me anë të draftimit të Marrëveshjes Aksionare (Shareholder Agreement), e cila pritët që së shpejti të nënshkruhet, duke themeluar kështu Kompaninë Projekt "IAP".

Në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të nisë të projektohet seksioni Fier-Kashar, me gjatësi 84 km, dhe vlerë investimi rreth 150 Milionë Euro. Pre-FEED dhe FEED parashikohet të ndërmerren në 2025, dhe të konkludohet me komisionimin në 2030.

- **Seksioni i IAP: Kashar-Mali i Zi**

Ky seksion përshkon një gjatësi rreth 86 km, nga Kashari në pikën kufitare me Malin e Zi. Vlera e pritshme e investimit është 165 Milionë Euro. Studimi i Fizibilitetit është kryer, ndërsa në harkun kohor përgjatë viteve 2025 deri 2026 parashikohet të kryhen Pre-FEED dhe FEED, për të konkluduar me komisionimin e asetit në vitin 2030.

Depozita nëntokesore Dumrea.

Një projekt tjetër i rëndësishëm që lidhet me infrastrukturën e gazit është ai i ndërtimit të një vend-depozitimi të gazit natyror në zonën e Dumresë, i cili është parashikuar të realizohet në dy faza, bazuar tek bashkëpunimi mes ALBGAS dhe SNAM, i cili parashikohet të nisë me krijimin e një strukture të ndarë në dy vend-depozitime me kapacitet të kombinuar prej 260-280 mcm gaz, ndërsa faza e dytë parashikon zgjerimin e kësaj strukture deri në kapacitetin e 1.2 bcm, duke i dhënë kështu dimension rajonal.

6.7. Gazifikimi i qytetit të Korçës

Aktualisht, qyteti i Korçës, si një qytet me klimë relativisht të ftohtë ngrohet kryesisht me dru zjarri dhe një pjesë e vogël me energji elektrike. Duke konsideruar faktin që tubacioni i TAP kalon 7 km larg qytetit, përbën një premisë reale për ngrohjen me gaz të qytetit. Në projektin e TAP është parashikuar që një nga pikat e lidhjes (Connection Point CP) për rrjetin në Shqipëri do të jetë në afërsi të qytetit. Më tej, ndërtimi i rrjetit të presionit të lartë nga kjo pikë CP deri në hyrje të qytetit (PRMS) është detyrim i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit OST, (ALBGAS).

Sistemi perspektiv i shpërndarjes së gazit do të furnizohet nga stacionet e reduktimit dhe matjes së presionit (PRMS) të cilat janë planifikuar të vendosen në afërsi të qendrave të mëdha të konsumit në Shqipëri. Për qytetin e Korçës në Masterplanin e Gazit është parashikuar që furnizimi i tij me gaz të bëhet direkt nga PRMS-të, të cilat janë planifikuar si shtesa të ardhshme të objekteve mbitorësore të TAP-it siç parashikohet në Planin Kombëtar Sektorial për projektin TAP dhe VNMS për TAP-in në Shqipëri. Së bashku me PRMS Fier dhe Kuçovë, këto janë tri pikat dalëse të TAP-it. Referuar Masterplanit të Gazit - Seksioni 24: CP3 Korçë - PRMS Pogradec, Ky seksion është rreth 35.3 km i gjatë dhe në pjesën më të madhe kalon përmes fushës së Korçës.

Në vazhden e projektit inovativ të gazifikimit të Korçës, që do sjellë përfitime shumë planëshe për qytetin dhe komunitetin, ku ALBGAS ka zhvilluar takime konsultative me aktorët dhe palët e interesuara duke përfshirë përfaqësues të bizneseve lokale, shoqërisë civile dhe industrisë me synim koordinimin drejt përmbytjes së këtij objekti ambicioz. Në takime ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e SOCAR, liderit azer në fushën e naftës dhe gazit, që si partnerë strategjikë të ALBGAS sjellin ekspertizën dhe mbështjen e nevojshme për implementimin e këtij projekti të parë në llojin e tij, konform standarteve më të larta ndërkombëtare. Ecuria optimale e realizimit të këtij projekti dhe optimizmi me të cilin ai është pritur prej grupeve të interesit dhe komunitetit dëshmojnë për vullnetin e qeverisë shqiptare për ti dhënë prioritet zgjidhjeve afatgjata, që

garantojnë siguri energjitike dhe zhvillim të qëndrueshëm që nxit paralelisht edhe reduktimin e impaktit negative në mjedis.

Konkluzione

Për sa shpjeguar më lart, Albgaz sh.a. përballet me nevojë emergjente në përgjigje të dinamikave të fundit në kuadër të sigurisë energjitike, diversifikimit të burimeve dhe politikave të dekarbonizimit. Këto të fundit, sot më shumë se kurrë në optikën e ndryshimeve klimaterike që po ndodhin në planetin tonë, duke pranuar rolin thelbësor të gazit natyror si një *“transition fuel”* të domosdoshëm për ekonominë në mbarë botën. Për këtë arsye, Albgaz sh.a., në ndërveprim me aktorë të tjerë të sektorit, të konsoliduar në Europë e më gjërë, janë angazhuar në krijimin e një hub-i rajonal në Vlorë. Synimi është bashkërendimi i përpjekjeve dhe ndarja e roleve të secilit aktor në këtë konfigurim të sektorit të gazit i cili i përgjigjet jo vetëm sfidave energjitike në rang kombëtar por edhe ato në rang rajonal.

Rrjedhimisht, për realizimin e këtyre nismave kërkohet mobilizim i vlerave monetare dhe ekspertizës nëpërmjet kapaciteteve njerëzore, të cilat Albgaz sh.a. nuk mund ti disponojë nga të ardhurat nga aktiviteti i saj modest dhe në kushtet tejet të vështira të një rrjeti transmetimi shumë të amortizuar dhe disi jashtë funksioni dhe në mungesë të një tregu të brendshëm, gjithashtu edhe në aspektin e eksperiencës së pakët të burimeve të saj njerëzore, në një treg të hapur dhe të standardizuar sic është ai i gazit natyror.

Duke gjykuar që ky moment paraqet një mundësi të mirë për maksimizimin e interesit publik, jo vetëm nëpërmjet shfrytëzimit të pozicionit gjeostrategjik të Shqipërisë por edhe për të bërë të mundur zgjerimin e kapaciteteve të sigurisë energjitike nëpërmjet diversifikimit me një burim alternativ të besueshëm sic është gazi natyror, sikurse edhe partneriteti serioz me kompani ndërkombëtare me reputacion të padiskutueshëm në sektorin e gazit, Albgaz sh.a. mbetet i përkushtuar për të ndjekur me prioritet zbatimin e projekteve të parashikuara dhe mundësinë e përfshirjes në projekte të reja kombëtare dhe më gjerë.

6.8. Në lidhje me raportin e Pajtueshmërisë për Albgaz sh.a.

Në Raportin Vjetor të Përputhshmërisë, paraqitet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë për periudhën raportuese.

Kërkesat dhe parimet rregullatore të përcaktuara nga kuadri ligjor kombëtar dhe direktivat evropiane për sektorin e gazit natyror përbëjnë prioritet për Albgaz sh.a., dhe çdo strukturë e saj është e detyrueshme t'i zbatojë dhe të garantojë përputhshmërinë me to në të gjitha nivelet e veprimtarisë.

Në përputhje me Ligjin Nr. 102/2015 *“Për sektorin e gazit natyror”*, i ndryshuar, Albgaz sh.a. ka ndërmarrë një proces të plotë ndarjeje ligjore, funksionale dhe financiare, në mënyrë që aktivitetet e saj si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror të jenë të pavarura nga çdo aktivitet tjetër i licencuar brenda grupit.

Ky proces garanton që Albgaz sh.a. të funksionojë si shoqëri e pavarur dhe të përmbushë kërkesat ligjore për pavarësinë operationale, integritetin e tregut dhe trajtimin e barabartë të të gjithë përdoruesve të rrjetit.

Pavarësia e Albgaz sh.a. është e garantuar nga dispozitat e ligjit dhe statutit të shoqërisë, të cilat përcaktojnë se Albgaz sh.a. ka:

- të drejta të plota vendimmarrëse në lidhje me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të gazit;
- autonomi të plotë nga shoqëria mëmë për aktivitetet e përditshme operative;

- strukturë të veçantë organizative dhe menaxheriale, të ndarë nga çdo aktivitet tjetër tregtar.

Ky sistem i pavarur operativ është thelbësor për të siguruar integritetin dhe efikasitetin e funksionimit të sistemit të gazit, si dhe për të respektuar kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Në përputhje me nenin 11 dhe nenin 46 të Ligjit nr. 102/2015 “*Për sektorin e gazit natyror*”, Albgaz sh.a. është e pavarur ligjërisht nga çdo subjekt tjetër që zhvillon aktivitete konkurruese në sektorin e energjisë. Shoqëria është një person juridik më vete, me statut të miratuar dhe me të gjitha strukturat e nevojshme administrative dhe vendimmarrëse të përcaktuara qartë.

Kjo pavarësi ligjore siguron që asnjë palë e tretë të mos ketë kontroll ose ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen operacionale të shoqërisë, përveç kompetencave që i takojnë ligjërisht aksionerit të vetëm – Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë – në rolin e Asamblesë së Përgjithshme.

Zbatimi i këtij programi siguron që shoqëria:

- të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar, për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.
- të hartojë dhe të depozitojë në organet kompetente një program vjetor të detajuar.
- Albgaz sh.a. duhet të ndahet nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 “*Për Sektorin e Gazit Natyror*”.
- Albgaz sh.a. duhet të jetë një person juridik i ndarë që nuk është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara ose pjesë e strukturës së korporatës dhe nuk kryen dhe as nuk është e angazhuar në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të gazit natyror dhe energjisë elektrike.

Me Vendim nr. 179, datë 08.11.2017, shoqëria “Albgaz” sh.a. është çertifikuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror, në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68 dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015, “*Për sektorin e gazit natyror*”, si dhe me nenin 9, pika 6 të Direktivës 73/2009/EC. Certifikimi i lartpërmendur është aktualisht i kushtëzuar, si për transmetimin ashtu edhe për shpërndarjen e gazit natyror.

Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar si më poshtë:

- a) Pika 5.2 “*Deri në bërjen operativ të tregut të gazit natyror, shoqëria “ALBGAS” sh.a. duhet të depozitojë transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave.*”

Kjo është sepse ende nuk ka hapje të tregut të gazit, por edhe nëse do të kishte, në kushtet që ndodhet tregu i gazit në rajonin tonë, europë dhe në botë, nuk do të ndikonte në kontrollin e kompetencave nga Albgaz sh.a.. Minimumi i ndikimit do të ishte rreth njëqindëmbjete konsumatorë, që faktikisht është e pamundur.

- b) Pika 5.2.1 *Shoqëria “ALBGAS” sh.a. duhet të raportojë dhe të dokumentojë pranë ERE-s, brenda vitit 2026, hapat e ndërmarrë dhe statusin e procedurave për realizimin e ndryshimeve të sipërcituara, duke paraqitur informacionin dhe dokumentacionin përkatës mbështetës për realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar”.*

6.9. Objektiva për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror

Në kushtet dhe situatën e krijuar në tregun e gazit natyror në Europë dhe në Botë, vëndi jonë

po përgatitet për hapjen e tregut duke përfunduar një sërë projektesh prioritare dhe për të ardhmen. Ndër objektivat për vitin 2026 mund të përmenden:

- Bashkëpunimi me TAP AG dhe Entet Rregullatore të Italisë dhe Greqisë për përfundimin me sukses të Testimit të Tregut që filloj në vitin 2021, vazhdoi përgjatë vitit 2025 për zgjerimin e kapacitetit nga 10 miliard m^3 /vit në 20 miliard m^3 /vit. Përmirësimi i nevojshëm i akteve nënligjore për mospengimin e këtij projekti si dhe mundësia e përfitimit për vëndin tonë.
- Bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për transpozimin e ndryshimeve që po kryhen në Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU si dhe akteve të tjera në lidhje me sektorin e gazit natyror, biogazit, biometanit, hidrogjenit, përdorimit të gazit të lëngëzuar me shkallë të vogël (small scale), përdorimit të gazit metan të komprimuar(KGN) etj.
- Bashkëpunimi me Ministrinë së linjës (MIE) dhe Albgaz sh.a. për rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe mundësinë për rezervim të kapacitetit në Fier dhe Roskovec, i planifikuar për pikat e hyrjes dhe të daljes në përputhje me Testin e Tregut që përfundoj aktualisht nga TAP.
- Bashkëpunimi me MIE, Albgaz sh.a. dhe SOCAR për ndërtimin e rrjetit të shpërndarjes së gazit fillimisht në qytetin e Korçës dhe më pas në të gjithë vëndin sipas projekteve prioritare.
- Bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz sh.a. për ndërtimin e rrjetit të transmetimit dhe pikën e matjes për ndërtimin e TEC-it në Roskovec.
- Bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz sh.a. për ndërtimin e tubacionit IAP (Jonian Adriatik Pipeline) nga pika e kontaktit me TAP në Fier deri në Kroaci.
- Bashkëpunimi me MIE dhe Albgaz sh.a. për Seksionin e IAP: Kashar-Mali i Zi.
- Është një nga projektet prioritare sepse përveçse është pjesë e projektit IAP është edhe projekti që do të gazifikoj Tiranën dhe Durrësin.
- **Bashkëpunimi midis MIE dhe Albgaz sh.a. për Depozita nëntokësore Dumre.** Një projekt i rëndësishëm që lidhet me infrastrukturën e gazit për ndërtimin e një vend - depozitimi të gazit natyror në zonën e Dumresë, bazuar tek bashkëpunimi mes Albgaz sh.a. dhe SNAM. Ky projekt do të shërbej si depozitim të gazit natyror për të gjithë rajonin tonë.
- **Bashkëpunimi me MEI dhe Albgaz sh.a dhe TAP për periudhën e Testimit të Tregut të vitit 2025, për pikën e interkonjeksionit në Korçë, për pikën e interkonjeksionit në Fier dhe pikën e daljes Roskovec.**

6.10. Marrëdhëniet me Institucionet Ndërkombëtare

CEER (Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë). ERE është vëzhguese si vëndkandidat për në Bashkimin European dhe ku kemi kontributin tonë si pjesëmarrës në grupet e punës për ndryshimet ligjore, përmirësimin e direktivave dhe rregulloreve në sektorin e gazit, për ruajtjen afatgjatë të energjisë në kushtet e krizës, amendimin e direktivës së efijensës së energjisë, të konsumatorit, strategjinë e energjisë fotovoltaike.

ACER (Agency for the Cooperation of Energy Regulators) Agjencia për Kooperimin e Rregullatorëve të Energjisë për Europën. ERE është anëtare me të drejta të plota dhe njëkohësisht pjesëmarrëse në grupet e punës për; investimet, paqëndrueshmërinë e çmimit të energjisë, prioritetit për konsumatorin, furnizimit me pakicë dhe trajtimi të paqëndrueshmërisë së tregut,

dokumentit për shërbimin e LNG me shkallë të vogël etj.

GRI SSE, SOUTH SOUTH-EAST GAS REGIONAL INITIATIVE(GRI SSE, (Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje). Pjesëmarrjet në grupet e punës për; tregun e gazit me shumicë, tregun me pakicë, zbatimi i Kodit të Rrjetit, konjeksione, tarifatat në rrjetin e transmetimit , shpërndarjes dhe në kufij, planet 10-të vjeçare etj.

MEDREG, Working Group Gas Natural, Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut. Pjesëmarrja jonë në studimet rajonale si: infrastruktura e rajonit të mesdheut, integrimi i i infrastrukturës së mesdheut me atë evropian, çmimet me pakicë dhe shumicë, bashkëpunimi me studimet e ECBR në Vienë.

ENTSO-G (Observër në Shoqatën e Sistemit të Transmetimit European të gazit). Pjesëmarrja e ERE-s në grupet e punës për studime të përbashkëta.

IGU (Unioni Ndërkombëtar i Gazit). Pjesëmarës aktivë nëpërmjet grupeve të punës.

OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë) me qendër në Francë. ERE është anëtare me të drejta të plota dhe pjesëmarrës në studime rajonale që organizohen prej saj.

UfM (Unioni për rajonin e Mesdheut). ERE është anëtare me të drejta të plota dhe pjesëmarrëse aktive në grupet e punës të organizuar për probleme të tregut të gazit dhe kjo është pjesë e OME me qendër në Paris.

ECRB, Gas Working Group, Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë, marrja pjesë në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në Shqipëri.

IEA. Forumi i Inovacionit IEA Energy synon të mbledhë përfaqësues të qeverive, institucioneve rregullatore, industrisë së energjisë, investitorëve, akademisë dhe organizatave ndërkombëtare, për të diskutuar mbi rolin e inovacionit teknologjik në përballimin e sfidave aktuale të sektorit energjetik, përfshirë tranzicionin drejt energjive të pastra, sigurinë e furnizimit, digjitalizimin e sistemeve energjetike dhe mobilizimin e investimeve në teknologji të avancuara. Forumi shërben gjithashtu si platformë për prezantimin e analizave dhe raporteve strategjike të IEA-së mbi gjendjen dhe perspektivat e inovacionit energjetik në nivel global.

Pjesëmarrja e ERE në këtë aktivitet ka rëndësi të veçantë institucionale, pasi i mundëson institucionit të ndjekë nga afër zhvillimet më të fundit ndërkombëtare në fushën e inovacionit energjetik dhe të kuptojë ndikimin që këto zhvillime do të kenë në funksionimin e tregjeve të energjisë dhe në kuadrin rregullator në të ardhmen. Në një kontekst ku sektori energjetik po përballet me transformime të thella teknologjike dhe strukturore, njohja me politikat dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare është thelbësore për forcimin e rolit rregullator të ERE-s dhe për përshtatjen e tij me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

7. ZHVILLIMI I POLITIKAVE DHE MBIKËQYRJES SË BURIMEVE TË RINOVUESHME

7.1. Lidhur me përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet hidrike

Bazuar në nenin 10, të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 MW.

Pika 2, neni 31, e këtij ligji përcakton se, aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji (Ligjit 24/2023). Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, i ndryshuar, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”.

Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016.

Mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 273, datë 13.12.2024, vendosi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhej prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025, prej 10 lekë/kWh.

ERE gjithashtu ka kryer edhe përllogaritjen e çmimit për prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2026, duke u bazuar në komponentët e lartpërmendur:

Çmimi vjetori i blerjes (lekë/kWh) = Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (<https://hupx.hu/downloads>), u konsiderua çmimi mesatar i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2025, i cili rezultoi në vlerën 106.55 Euro/MWh.

Gjithashtu, bazuar në të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/Euro, kursi mesatar i këmbimit paraprak, te vitit 2025 rezultoi 98.05 Lekë/euro.

Nisur nga të dhënat paraprake të përcaktuara më sipër dhe në zbatim të formulës llogaritëse të pikës 3 të VKM-së 687/2017, i ndryshuar, çmimi rezultoi mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në metodologji prej 10 lekë/kWh. Në zbatim të ligjit nr. 24/2023, i cili parashikon se, kriteret e llogaritjes së çmimit, do të bazohen në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, bazuar në tregun shqiptar të organizuar të energjisë elektrike. Çmimi mesatar klerues paraprak i bursës shqiptare të energjisë ALPEX sh.a., rezultoi në vlerën 118.93 Euro/MWh, dhe u evidentua se çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike referuar tregut të ditës në avancë të ALPEX sh.a., ishte në vlerën 13.99 Lekë/kWh, përsëri mbi nivelin maksimal prej 10 lekë/kWh.

Bazuar në sa më sipër, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 324, datë 15.12.2025 vendosi miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 Lekë/kWh, për vitin 2026.

Me përfundimin e vitit 2025, u përditësuan të dhënat e marra në konsideratë për llogaritjen e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, si çmimi mesatar vjetor i bursës hungareze të

energjisë dhe kursi i këmbimit valutor dhe rezultoi se çmimi i miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 324, datë 15.12.2025 nuk ndryshon, për rrjedhojë ky vendim mbetet në fuqi për vitin 2026.

7.2 Lëshimi i Garancive të Origjinës

Në referencë të përcaktimeve të Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin nr. 300, datë 30.12.2024, dhe pas shqyrtimit të 2 aplikimeve të paraqitura, përgjatë vitit 2025 janë lëshuar Certifikata të Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, në sasinë totale prej 21,222 MWh, për të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat evidentohen si më poshtë vijon:

Nr.	Subjekti	Impianti	Vendimi i Bordit të ERE-s	Sasia (MWh)
1	“SPV BLUE 1” sh.p.k.	Impianti fotovoltaik “Blue 1”	Nr. 17, datë 16.01.2025	8,476
2	“NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k.	Impianti fotovoltaik “Nova Solar System”	Nr. 119, datë 09.06.2025	12,746

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 300, datë 30.12.2024, ERE ushtron funksionin e organit lëshues të garancive të origjinës dhe në këtë cilësi, transferon kostot e administrimit të regjistrimit elektronik të garancive të origjinës tek mbajtësit e certifikatave, përmes një tarife vjetore për njësi, e cila miratohet çdo vit nga Bordi i ERE-s jo më vonë se data 31 janar.

ERE është pjesë e sistemit rajonal të Komunitetit të Energjisë për garancitë e origjinës dhe ushtron funksionet e organit lëshues përmes regjistrimit elektronik të garancive të origjinës, i cili është krijuar dhe mirëmbahet nga ofruesi i përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, aktualisht European Energy Exchange AG (ish-Grexel Ltd) si dhe njëkohësisht është anëtare e Shoqatës së Organeve Lëshuese (AIB), e cila administron Sistemin Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS), duke siguruar përputhshmërinë dhe njohjen ndërkombëtare të garancive të origjinës të lëshuara në Republikën e Shqipërisë.

Në bazë të të dhënave të operatorëve të rrjetit, për prodhimin nga burimet e rinovueshme gjatë vitit 2025, si dhe kostove të administrimit të sistemit, në zbatim të nenit 21 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 15, datë 15.01.2026 ka miratuar vlerën e detyrimit për lëshimin e certifikatës së garancisë së origjinës për vitin 2026, prej 0.03 Euro/MWh.

7.3 Metodologjia e Përcaktimit të Detyrimit për Energjinë e Rinovueshme

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 284, datë 18.12.2024, ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të detyrimit për energjinë e rinovueshme”, e cila përcakton përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, mbështetur në përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Detyrimi për energjinë e rinovueshme.

Në dispozitat kalimtare të metodologjisë, konkretisht në nenin 10, parashikohet që, përjashtimisht për vitin 2025, Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER) ose çdo entiteti që ushtron detyrat e tij, i jepej mundësia të paraqiste kërkesë në ERE për miratimin e detyrimit të energjisë së rinovueshme vetëm nëse ishte përmbushur kushti i përcaktuar në nenin 4.2 të saj, që lidhet me lëvrimin e energjisë së blerë në tregun e organizuar të ditës në avancë dhe/ose brenda ditës. Duke qenë se gjatë vitit 2025 nuk është realizuar lëvrimi i energjisë në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX sh.a.), shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., që ushtron detyrat e OER-it sipas VKM nr. 696, datë 13.11.2024, nuk paraqiti kërkesë për miratimin e detyrimit për këtë vit.

Me shkresën nr. 3075 prot., datë 17.09.2025, protokolluar në ERE me nr. 2472 prot., datë 17.09.2025, shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (FTL) ka paraqitur një kërkesë lidhur me detyrimin e energjisë së rinovueshme, duke bërë me dije se vijon të gjendet në të njëjtat kushte edhe për vitin 2026. Në vijim të sa më sipër, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 267, datë 27.10.2025, vendosi se për aplikimin e parë të përcaktimit të detyrimit të energjisë së rinovueshme, OER apo çdo entitet i cili kryen detyrat e tij, do të paraqesë një kërkesë në ERE mbas plotësimit të kushtit të përcaktuar sa me sipër.

7.3.1 Metodologjia mbi Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut të Ditës në Avancë të Energjisë Elektrike

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 256, datë 02.12.2024, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë së ditës në avancë (DAM)”, në funksion të konvertimit të marrëveshjeve për blerjen e energjisë (MBE) në kontrata për diferencë (KpD), sipas ligjit nr. 24/2023.

Draft-metodologjia u publikua në faqen zyrtare të ERE-s, në seksionin “Konsultime”, me qëllim mbledhjen e komenteve nga palët e interesit si dhe nepermjet shkresës nr. 2473/1 prot., datë 11.12.2024, janë njoftuar palët e interesit si: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX sh.a.), Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a., si dhe palë të tjera të interesuara, me qëllim mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve të tyre në kuadër të procesit të miratimit të dokumentit. Gjithashtu draft-metodologjia ju përcollë me e-mail edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për komente, në kuadër të përfshirjes së tij si palë e interesuar në procesin e konsultimit ndërinstitucional. Në vijim janë zhvilluar seanca dëgjimore me palët e interesit si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke reflektuar dhe komentet e paraqitura nga ky i fundit.

Me vendimin nr. 279, datë 06.11.2025, Bordi i ERE-s miratoi “Metodologjinë mbi vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike”.

Kjo metodologji përcakton parimet dhe treguesit të cilët do të merren në konsideratë nga ERE për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, mbështetur në përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Vlerësimi i parë i gatishmërisë së tregut nga ERE do të kryhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e metodologjisë dhe do të vijojë të hartohet cdo 6 muaj deri në një vlerësim pozitiv mbi gatishmërinë e tregut.

7.4 Raportimet nga te Licencuarit ne Aktivitetin e Prodhimit te Energjise Elektrike

Gjatë vitit 2025, kanë raportuar periodikisht në ERE 129 subjekte të licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, lidhur me sasitë e energjisë elektrike të prodhuar si dhe problematikat përkatëse që këta subjekte kanë hasur. Konkretisht, janë 82 subjekte të licencuara, të cilat kanë raportuar mbi problematikat e hasura gjatë operimit për të paktën njëherë. Përsa i

përket subjekteve të cilat prodhojnë energji elektrike nga burimet hidrike, problematika kryesore e raportuar përgjatë vitit 2025 ka qenë niveli i ulët i prurjeve të cilat kanë qenë të pamjaftueshme, kryesisht gjatë periudhës verë-vjeshtë. Gjithashtu, janë raportuar dhe disa problematika mbi stakimet nga rrjeti i shpërndarjes për periudha të shkurtra për shkaqe defektesh apo dhe për shkak të remonteve të planifikuara dhe njoftuara nga operatorët e rrjetit.

Gjithashtu, subjekteve të licencuara në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike ju është kërkuar të raportojnë edhe lidhur me sigurimin e aseteve të prodhimit, si dhe jetës e shëndetit të punonjësve, në përputhje me përcaktimet e pikës 2.5 të licencës së prodhimit, ku parashikohet detyrimi i të licencuarve për të siguruar jetën dhe shëndetin e njerëzve, si dhe asetet që shërbejnë për ushtrimin e aktivitetit, jo më vonë se 30 ditë nga lëshimi i licencës. Ky detyrim është parashikuar gjithashtu edhe në kontratat e nënshkruara ndërmjet subjekteve prodhuese dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve gjeneruese të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025, kanë raportuar në ERE 81 subjekte lidhur me sigurimin e aseteve dhe jetës. Në këtë kuadër, u vlerësua e nevojshme përcaktimi i një afati të unifikuar për raportimin pranë ERE-s të informacionit lidhur me përmbushjen e detyrimit për sigurimin, me qëllim disiplinimin e praktikës së raportimit, rritjen e transparencës dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të zbatimit të kushteve të licencës. Në këto kushte, me vendimin nr. 344, datë 23.12.2025, Bordi i ERE-s miratoi që data 31 janar e çdo viti, do të jetë afati për raportimin në ERE lidhur me sigurimin sipas përcaktimeve të kontratës për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve gjenerues të energjisë elektrike dhe kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike. Me miratimin e vendimit të lartpërmendur, gjatë muajit janar 2026 është konstatuar një përmirësim i procesit të raportimeve dhe sigurimit të aseteve dhe jetës nga subjektet përkatëse.

Përgjatë vitit 2025 janë rishikuar rreth 50 vendime të Bordit të ERE, lidhur me plotësimin e kushteve të përcaktuara në licencat përkatëse të prodhimit të energjisë elektrike, të cilat kanë patur kryesisht si objekt afatet, saktësime të tjera, hyrjen në operim të kapaciteteve të reja prodhuese nga burimet e rinovueshme, sipas kontratës bazë me autoritetin kontraktor si dhe testimin përkatës të këtyre impianteve.

8. AKTIVITETI I ERE-S NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONAR DHE NDRYSHIME TË TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2025

Në vitin 2025, ERE ka vijuar forcimin e kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke miratuar akte nënligjore të rëndësishme në zbatim të Ligjeve nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Gjatë vitit, Bordi i ERE-s ka zhvilluar 53 mbledhje, ku janë shqyrtuar dhe miratuar 353 vendime. Këto vendime kryesisht kanë pasur si objekt rishikimin ose ndryshimin e akteve ekzistuese, fillimin e procedurave për licencimin dhe miratimin e licencave për prodhimin, tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike, si dhe rinovimin e licencave për subjektet që operojnë në tregtimin, prodhimin, furnizimin dhe tregtimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Më poshtë, në formë krahasuese, paraqiten vendimet e ERE për vitin 2025, të krahasuara me ato të vitit 2024, duke përfshirë numrin total të vendimeve, aktet rregullatore dhe zgjidhjet e mosmarrëveshjeve.

Gjatë viti 2025, ERE ka shqyrtuar ndër të tjera dhe aplikimet e shoqërive OST sh.a., OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimeve të tyre. Kështu, janë shqyrtuar dhe miratuar tarifat e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a. për vitin 2025, tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2025, si dhe çmimi i shërbimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2025. ERE ka organizuar seanca dëgjimore dhe konsultime publike për shqyrtimin e këtyre tarifave, duke garantuar një proces të hapur dhe gjithëpërfshirës.




Figura 79. Vendimet e ERE për vitin 2025 në raport me vitin 2024

Gjithashtu, ERE ka miratuar një sërë vendimesh kryesore të cilat kanë kontribuar në përmirësimin dhe konsolidimin e kuadrit rregullator, duke përfshirë edhe akte të orientuara drejt përafrimit të legjislacionit vendas me acquis të Bashkimit Evropian. Këto zhvillime reflektojnë angazhimin e vazhdueshëm të institucionit për harmonizimin e tregut energjetik shqiptar me standardet evropiane, si dhe për garantimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe transparent të tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në kuadër të përafrimit me standardet e BE-së, janë ndërmarrë hapa për harmonizimin me acquis-in evropian dhe integrimin e Shqipërisë në tregun rajonal të energjisë, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e sektorit.

8.1. Vendimet kryesore të ERE-s në sektorin e energjisë elektrike për vitin 2025

Vendimi nr. 47, datë 27.02.2025 - Miratimi i shtesave dhe ndryshimeve në metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni Shqipëri–Kosovë

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 47, datë 27.02.2025, miratoi disa shtesa dhe ndryshime në “Metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni i energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës”, miratuar fillimisht me vendimin nr. 100, datë 27.05.2024. Ndryshimet synojnë zgjerimin e fushës së zbatimit të metodologjisë, duke përfshirë jo vetëm tregun e ditës në avancë (AL-KS DAC), por edhe tregun brenda ditës (AL-KS IDA).

Nëpërmjet këtij vendimi u saktësua se shpërndarja e të ardhurave neto nga kongjestioni do të vijojë të kryhet në raport 50% me 50% ndërmjet OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., për të dy segmentet e tregut. Vendimi forcon bazën rregullatore për funksionimin e tregut të përbashkët Shqipëri–Kosovë dhe garanton menaxhimin e unifikuar të të ardhurave nga kongjestioni në të gjitha intervalet kohore të tregut.

Vendimi nr. 79, datë 14.04.2025 – Përditësimi i rregullores për sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 79, datë 14.04.2025, miratoi disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”, me qëllim përafrimin e saj me kuadrin e ri ligjor për sigurinë kibernetike dhe zgjerimin e fushës së zbatimit edhe në sektorin e gazit natyror. Si pasojë, ndryshoi edhe titulli i rregullores në “Rregullorja për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë”.

Në kuadër të kësaj procedure, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 27, datë 27.01.2025, vendosi fillimin e procedurës për ndryshimin e rregullores në fuqi, ndërsa drafti i ndryshimeve u publikua në faqen zyrtare të ERE-s, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe nenin 12 të “Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE”, miratuar me vendimin nr. 162, datë 20.10.2020. Brenda afatit të parashikuar nuk u paraqitën komente nga palët e interesuara.

Ndryshimet përfshijnë përditësimin e referencave ligjore sipas ligjit nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, zëvendësimin e autoritetit kompetent me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), zgjerimin e listës së infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, si dhe detyrimin e operatorëve për pajisjen me certifikimin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve. Vendimi forcon kuadrin rregullator për mbrojtjen e sistemeve kritike energjetike nga rreziqet kibernetike dhe garanton rritjen e nivelit të sigurisë në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Vendimi nr. 48, datë 27.02.2025 - Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë”

Me këtë vendim, Bordi i ERE-s miratoi disa shtesa dhe ndryshime në “Procedurat Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë”, me qëllim zgjerimin e fushës së zbatimit edhe për tregun e energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë (IDA).

Ndryshimet kryesore konsistojnë në:

- Ndryshimin e titullit të procedurave, duke përfshirë edhe bashkimin e tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë Shqipëri–Kosovë;
- Zgjerimin e zbatimit të procedurave rezervë edhe për IDA, krahas tregut të ditës në avancë;
- Parashikimin e një sistemi të përbashkët komunikimi rezervë për të dy tregjet;
- Saktësimin e disa referencave teknike në pjesën hyrëse të dokumentit.

Ky vendim synon të sigurojë vazhdimësinë e funksionimit të tregut të përbashkët Shqipëri–Kosovë edhe në rast të mosfunksionimit të mekanizmave kryesorë të bashkimit të tregut.

Vendimi nr. 93, datë 28.04.2025 - Për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (CACM)”

Me këtë vendim, Bordi i ERE-s miratoi “Rregulloren për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve (CACM)”, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/1222, në zbatim të vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Në kuadër të kësaj procedure, draft-rregullorja u njoftua dhe u publikua në faqen zyrtare të ERE-s për konsultim publik, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe nenin 12 të “Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE”, miratuar me vendimin nr. 162, datë 20.10.2020. Gjithashtu, u zhvillua një seancë dëgjimore me palët e interesuara për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me afatet e zbatimit dhe transpozimin e dispozitave përkatëse.

Vendimi përcakton rregullat për alokimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe menaxhimin e kongjestioneve në tregun e energjisë elektrike, në funksion të garantimit të funksionimit të sigurt dhe efikas të tregut të ditës në avancë dhe brenda ditës, si dhe të integritetit të tregut shqiptar me tregun rajonal dhe atë europian.

Vendimi nr. 133, datë 07.07.2025 - Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën TIP midis KESH sh.a. dhe FSHU sh.a.

Bordi i ERE-s miratoi shtesat dhe ndryshimet e propozuara në kontratën TIP për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik (KESH sh.a.) dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU sh.a.), për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.

Në kuadër të kësaj procedure, drafti i kontratës u publikua në faqen zyrtare të ERE-s në rubrikën “Konsultime”, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe nenin 12 të “Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE”, miratuar me vendimin nr. 162, datë 20.10.2020. Gjatë procesit të konsultimit u paraqit një qëndrim nga shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k., shqetësimet e së cilës u vlerësuan si çështje me natyrë strategjike dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë në vlefshmërinë apo përmbajtjen e kontratës për vitin përkatës.

Ndryshimet e miratuara përfshijnë përditësime ligjore dhe rregullatore, saktësime teknike të lidhura me hapjen graduale të tregut dhe përcaktimin e niveleve të tensionit për klientët universalë dhe ata me status të veçantë, sipas urdhrit përkatës të Ministrit për Energjinë. Vendimi synon garantimin e vazhdimësisë së furnizimit dhe përafrimin e marrëdhënieve kontraktore me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Vendimi nr. 255, datë 15.10.2025 - Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 KW

Bordi i ERE-s vendosi të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW, i cili do të aplikohet nga data 1 Nëntor 2025. Vendimi synon krijimin e një kategorie të veçantë konsumatorësh për karikimin e makinave elektrike mbi 11 kW dhe reflekton kostot reale të disbalancave që shkaktohen nga ky segment i konsumit, duke garantuar transparencë, kosto-reflektim dhe trajtim jodiskriminues. Çmimi i miratuar për këtë kategori është 22 lekë/kWh, ndërsa abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kW do të tarifohen sipas çmimeve aktuale të miratuara nga ERE.

Vendimi parashikon gjithashtu që të ardhurat që realizohen mbi ose nën nivelin e lejuar të korrigjohen nga ERE, në përputhje me Metodologjinë për përcaktimin e çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët që furnizohen nga FSHU sh.a. Ai bazohet në analizat e konsumit të energjisë në stacionet e karikimit, rritjen e numrit të automjeteve elektrike dhe profilet e ndryshueshme të karikimit, duke siguruar një zgjidhje të qëndrueshme për balancimin e rrjetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut të energjisë elektrike.

Vendimi nr. 290, datë 13.11.2025 - Mbi Miratimin e Rregullores “Për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata”

Bordi i ERE-s vendosi të miratojë “Rregulloren për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata”, të propozuar nga OST sh.a., e cila përbën transpozim të drejtpërdrejtë të Rregullores (BE) 2016/1719 (FCA Guideline), në përputhje me Vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë. Vendimi synon krijimin e një kuadri të qartë dhe të harmonizuar për alokimin e kapaciteteve afatgjata në sistemin elektrik, duke siguruar integritetin e tregut, konkurrencën efektive, funksionimin e duhur të mekanizmave rajonale dhe respektimin e detyrimeve për OST, NEMO dhe autoritetet rregullatore kombëtare dhe rajonale.

Në kuadër të procedurës, palët e interesuara u njoftuan me shkresë zyrtare, ndërsa vendimi për fillimin e procedurës dhe draft-rregullorja në gjuhën shqipe dhe angleze u publikuan në faqen zyrtare të ERE-s në rubrikën “Konsultime”, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe nenin 12 të Rregullores përkatëse të ERE-s. Gjatë afatit të konsultimit publik nuk u paraqitën komente nga palët e interesuara.

Rregullorja do të hyjë në fuqi më 1 Nëntor 2026, për të mundësuar përgatitjen e strukturave përgjegjëse dhe infrastrukturës teknologjike të nevojshme. OST sh.a. duhet të raportojë çdo tre muaj mbi ecurinë e përgatitjes dhe zbatimit të metodologjive të përcaktuara në nenet 10-18 të rregullores. Vendimi reflekton angazhimin e ERE-s për një zbatim transparent dhe të koordinuar të rregulloreve, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kuadrin e Komunitetit të Energjisë.

Vendimi nr. 279, datë 06.11.2025 - Mbi miratimin e Metodologjisë për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut Shqiptar të Energjisë së Ditës në Avancë

Bordi i ERE-s vendosi të miratojë “Metodologjinë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë së ditës në avancë (DAM)”, në funksion të kalimit nga marrëveshjet për blerjen e energjisë (MBE) në kontrata për diferencë (KpD), sipas Ligjit nr. 24/2023. Vendimi synon të sigurojë një vlerësim të qartë dhe të besueshëm të gatishmërisë së tregut, duke përfshirë faktorët kryesorë si disponueshmëria e çmimeve për periudha 10-mujore, faktori i qarkullimit sipas metodologjisë së ACER, integriteti dhe transparencja e tregut (REMIT), si dhe trajtimi i tregut të bashkuar Shqipëri–Kosovë si një treg i vetëm kur nuk ka kongjestione.

Në kuadër të procedurës, draft-metodologjia u publikua në faqen zyrtare të ERE-s për konsultim publik dhe u njoftuan palët e interesuara, përfshirë institucionet dhe subjektet kryesore të tregut, si dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Në vijim u zhvillua një seancë dëgjimore me përfaqësues të tregut, ku u diskutuan çështje lidhur me raportimin 6-mujor dhe përlogaritjen e faktorit të qarkullimit sipas metodologjisë së ACER. Komentet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë u reflektuan në tekstin përfundimtar, veçanërisht sa i takon referencave ligjore dhe forcimit të kriterëve për integritetin dhe transparencën e tregut.

Metodologjia përfshin përdorimin e treguesve shtesë si diferenca ofertë-kërkesë dhe thellësia e tregut, kur të dhënat janë të disponueshme, dhe përcakton procedurat e raportimit të ERE-s. Raporti periodik 6-mujor do të hartohet vetëm në rastet kur vlerësimi i gatishmërisë rezulton negativ, duke mundësuar monitorim efektiv dhe ruajtje të krahasueshmërisë ndërkombëtare. Vendimi siguron një bazë të qëndrueshme ligjore dhe teknike për operimin e tregut DAM dhe për kalimin e kontratave në CfD.

Vendimi nr. 291, datë 13.11.2025 - Mbi miratimin e “Një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”

Bordi i ERE-s vendosi të miratojë “Udhëzuesin për Balancimin e Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga OST sh.a., në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/2195 dhe vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë. Vendimi synon të krijojë një kuadër të qartë për zbatimin e metodologjive të balancimit, duke siguruar koordinim ndër-institucional dhe harmonizim me standardet ndërkombëtare.

Në kuadër të procedurës, palët e interesuara u njoftuan me shkresë zyrtare, ndërsa vendimi për fillimin e procedurës dhe draft-udhëzuesi në gjuhën shqipe dhe angleze u publikuan në faqen zyrtare të ERE-s në rubrikën “Konsultime”, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe nenin 12 të Rregullores përkatëse të ERE-s. Gjatë afatit të konsultimit publik nuk u paraqitën komente nga palët e interesuara.

Udhëzuesi përcakton detyrimet dhe procedurat për operimin e sistemit të balancimit, duke lejuar një afat përgatitor deri më 1 tetor 2026, me qëllim funksionim të sigurt, integrim të tregut dhe respektim të transparencës dhe integritetit.

Vendimi nr. 293, datë 13.11.2025 – Mbi një ndryshim në vendimin nr. 93, datë 28.04.2025 “Mbi miratimin e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM)”

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 13.11.2025, vendosi ndryshimin e vendimit nr. 93, datë 28.04.2025, duke shtyrë hyrjen në fuqi të Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM) deri më 1 korrik 2026. Ky ndryshim u ndërmor në kushtet e zhvillimeve ligjore që lidhen me procesin e miratimit të ligjit të ri “Për sektorin e energjisë elektrike”, me qëllim sinkronizimin e hyrjes në fuqi të rregullores me kuadrin e ri ligjor dhe garantimin e koherencës juridike.

Vendimi synon të sigurojë zbatim të qëndrueshëm dhe efektiv të Rregullores CACM mbi një bazë ligjore të përditësuar, duke reflektuar gjithashtu rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Shtyrja e afatit nuk përbën ndryshim material të përmbajtjes së rregullores, por harmonizim të efekteve të saj juridike, në funksion të sigurisë juridike dhe përputhshmërisë me procesin e integritetit të tregut.

Vendimi nr. 294, datë 13.11.2025 - Mbi miratimin e Udhëzimit “Për mënyrën e pasqyrit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore dhe identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse”

Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 294, datë 13.11.2025, vendosi miratimin e “Udhëzimit Për mënyrën e pasqyrit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore, identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse”.

Vendimi synon të sigurojë pasqyrimin e saktë të konsumit sipas kategorive të konsumatorëve, të rrisë transparencën në faturim dhe të garantojë zbatimin korrekt të çmimeve të miratuara nga ERE, duke mundësuar kontroll efektiv dhe mbrojtje të konsumatorëve.

Vendimi nr. 299, datë 17.11.2025 - Mbi miratimin e “Strategjisë së ERE-s për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative, 2025–2030”

Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 299, datë 17.11.2025, vendosi miratimin e “Strategjisë së ERE për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative 2025–2030”.

Strategjia synon të rrisë ndërgjegjësimin e konsumatorëve për përdorimin eficient të energjisë, të promovojë burimet e rinovueshme dhe teknologjitë e pastra, si dhe të forcojë bashkëpunimin ndërinstucional me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë. Ajo parashikon gjithashtu krijimin e një platforme digjitale për informacion, edukim dhe monitorim të përdorimit të energjisë, si dhe raportimin periodik të progresit përmes indikatorëve të matshëm.

Vendimi nr. 300, datë 17.11.2025 – Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 300, datë 17.11.2025, vendosi fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në

sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, si dhe në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e transmetimit. Propozimet përfshijnë rishikimin e treguesve AIT, ENS dhe SAIDI në përputhje me performancën e arritur nga OST sh.a. gjatë viteve të fundit, përshtatjen e parametrave të cilësisë së tensionit (VQ) sipas Kodit të Transmetimit, si dhe ndryshime dhe shfuqizime të disa dispozitave që kanë humbur aktualitetin ose kërkojnë përditësim.

Vendimi synon reflektimin e përmirësimeve të konstatuara në cilësinë e shërbimit të transmetimit, harmonizimin e rregullores me Kodin e Transmetimit dhe forcimin e kuadrit rregullator në përputhje me rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit për rritjen e standardeve të cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

Vendimi nr. 323, datë 15.12.2025 – Mbi përcaktimin e listës së tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2026

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 323, datë 15.12.2025, vendosi të shtyjë fuqinë juridike të vendimit nr. 299, datë 30.12.2024, duke vijuar zbatimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) edhe për vitin 2026. Vendimi u mor pasi, gjatë shqyrtimit të aplikimit të paraqitur nga ALPEX sh.a., u konstatua se nuk është realizuar ndarja e plotë e llogarive sipas aktivitetit të shfrytëzimit NEMO dhe aktivitetit të bursës, në përputhje me metodologjinë në fuqi, çka nuk mundëson një vlerësim të plotë të kostove dhe të ardhurave specifike të aktivitetit NEMO.

Në kushtet kur aktiviteti i NEMO-s ka qenë i kufizuar gjatë vitit 2025 dhe duke marrë në konsideratë edhe shtyrjen e hyrjes në fuqi të Rregullores CACM deri më 1 korrik 2026, u vlerësua e nevojshme vijimi i zbatimit të tarifave ekzistuese për të garantuar vazhdimësinë e funksionimit të tregut. Vendimi parashikon që, në momentin e paraqitjes së një aplikimi të plotë dhe në përputhje me metodologjinë përkatëse, të kryhen korrigjimet dhe kompensimet e nevojshme në rast diferencash në të ardhurat e realizuara.

Vendimi nr. 338, datë 23.12.2025 – Mbi fillimin e procedurës për rishikimin e Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 338, datë 23.12.2025, vendosi fillimin e procedurës për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar.

Vendimi synon përmirësimin dhe saktësimin e mëtejshëm të dokumentacionit, afateve dhe procedurave të aplikimit për licencat, në funksion të rritjes së qartësisë, unifikimit të praktikave administrative dhe përmirësimit të zbatueshmërisë së rregullores, duke reflektuar ndryshimet përkatëse edhe në shtojcat udhëzuese sipas llojit të aplikimit.

Vendimi nr. 343, datë 23.12.2025 – Mbi Planin e Investimeve të shoqërisë OST sh.a. për periudhën rregullatore 2025–2027

Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 343, datë 23.12.2025, vendosi përfundimin e procedurave për shqyrtimin e Planit të Investimeve të shoqërisë OST sh.a., për vitin 2025 - 2027. Gjithashtu, shoqëria OST sh.a. duhet të depozitojë në ERE, jo më vonë se muaji dhjetor 2026, Planin e Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për Periudhën 2026 – 2035.

Duke qenë se viti 2025 shënon dhe fundin e Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2015-2025, vlerësohet se shoqëria duhet të paraqesë në ERE një raport mbi realizimin faktik të investimeve të parashikuara për këtë periudhë 10-vjeçare, në të cilin të përfshihen dhe sqarimet përkatëse mbi projektet e shtyra ose të përealizuara, në rast se ka të tilla. OST sh.a. duhet

të vijoje me përgatitjen dhe paraqitjen pranë ERE-s të Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2026–2035, në përputhje të plotë me ligjin nr. 43/2015 dhe Rregulloren nr. 135/2017.

Vendimi nr. 346, datë 29.12.2025 – Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 346, datë 29.12.2025, vendosi fillimin e procedurës për rishikimin e treguesve të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe për ndryshimin e disa dispozitave të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar.

Vendimi synon përshtatjen e treguesve teknikë (ENS, SAIDI, SAIFI dhe parametrat e tjerë të cilësisë) me performancën e arritur nga OSSH sh.a., reflektimin e rekomandimeve të Kuvendit për përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, si dhe harmonizimin e mekanizmit të kompensimit me marrëveshjen përkatëse ndërmjet OSSH sh.a. dhe Furnizuesit, me qëllim rritjen e qartësisë juridike dhe koherencës rregullore.

Vendimi nr. 347, datë 29.12.2025 – Për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen”

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 29.12.2025, miratoi “Kodin e Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen”, i cili transpozon Rregulloren (BE) 2017/2196, në zbatim të vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Në kuadër të kësaj procedure, draft-kodi u njoftua dhe u publikua në faqen zyrtare të ERE-s për konsultim publik, në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe nenin 12 të “Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga ERE”, miratuar me vendimin nr. 162, datë 20.10.2020. Vendimi për fillimin e procedurës u botua në Fletoren Zyrtare dhe drafti u publikua në gjuhën shqipe dhe angleze, ndërsa gjatë procesit të konsultimit publik nuk u paraqitën komente nga palët e interesit. Kodi përcakton rregullat dhe detyrimet për menaxhimin e situatave të emergjencës dhe proceset e rivendosjes së sistemit elektroenergjetik, me qëllim garantimin e sigurisë së furnizimit, funksionimit të qëndrueshëm të sistemit dhe harmonizimin e kuadrit kombëtar me standardet e Komunitetit të Energjisë.

Vendimi nr. 348, datë 29.12.2025 – Për miratimin e “Udhëzuesit mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 348, datë 29.12.2025, miratoi “Udhëzuesin për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, i cili transpozon Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/1485, në zbatim të vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Në kuadër të kësaj procedure, draft-udhëzuesi u njoftua dhe u publikua për konsultim publik në faqen zyrtare të ERE-s, në përputhje me kuadrin ligjor për njoftimin dhe konsultimin publik dhe rregulloren përkatëse të ERE-s. Vendimi për fillimin e procedurës u botua në Fletoren Zyrtare dhe drafti u publikua në gjuhën shqipe dhe angleze në rubrikën “Konsultime”. Gjatë procesit të konsultimit publik nuk u paraqitën komente nga palët e interesit. Udhëzuesi përcakton rregullat, termat, kushtet dhe metodologjitë për operimin e sigurt dhe të koordinuar të sistemit të transmetimit, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar, miratimin e termave dhe metodologjive përkatëse, si dhe raportimin dhe mbikëqyrjen rregullore, me qëllim garantimin e sigurisë së furnizimit dhe harmonizimin e kuadrit kombëtar me standardet e Komunitetit të Energjisë.

8.2. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 20, shkronja “ë”, parashikon të drejtën e ERE-s për të zgjidhur mosmarrëveshjet lidhur me ankesat e paraqitura nga klientët dhe ato midis të licencuarve. Po ashtu, neni 24 përcakton se ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, duke zbatuar rregulloren përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve dhe trajtimin e ankesave. Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, në nenin 16, pika 16, neni 17, pika 1, shkronja “ë” dhe neni 98, pika 1 dhe 2, gjithashtu ka përcaktuar autoritetin e ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve dhe klientëve, si dhe për miratimin e rregullores për procedurat e zgjidhjes së tyre. Në përputhje me këtë, Bordi i ERE-s miratoi me vendimin nr. 114, datë 08.07.2016, “Rregulloren për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”.


Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 345, datë 29.12.2025, ka pranuar të shqyrtojë kërkesën e paraqitur nga shoqëria “VOLTON” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes “TONA ALB/6390”, dhe fillimin e procedurës për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje. Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve trajtohet nga ERE në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114/2016.

8.3 Proceset Gjyqësore në të Cilat ERE ka Qenë Palë Gjatë Vitit 2025

Gjatë vitit 2025, ERE ka qenë e përfshirë në 16 procese gjyqësore, të cilat janë iniciuar, vazhduar ose përfunduar gjatë këtij viti. Në këto procese, ERE ka marrë pjesë si palë paditëse, e paditur apo si person i tretë, në çështje të trajtuara në të gjitha shkallët e gjyqësorit në Tiranë, Lezhë, Durrës dhe Sarandë.

Si palë e paditur, ERE ka qenë e angazhuar në 16 çështje, nga të cilat 2 janë hapur gjatë vitit 2025 dhe 14 janë trashëguar nga vitet e mëparshme. Në rolin e palës së tretë, ERE ka qenë pjesë e 27 proceseve gjyqësore të nisura më herët dhe 8 proceseve të cilat janë hapur në 2025, ndërsa si palë paditëse ka ndërmarrë veprime ligjore në 6 raste të reja. Gjithashtu, evidentohet se gjatë vitit 2025, ERE nuk ka pasur asnjë çështje të lidhur me kallëzime penale, duke mos rezultuar të regjistruar apo ndjekur procedime të tilla përgjatë kësaj periudhe.

Për të garantuar një administrim të saktë dhe të përditësuar të të gjitha proceseve, duke përfshirë ndryshimet në objektin e padive, përbërjen e palëve dhe lëvizjen e çështjeve midis shkallëve të gjykimit, është mbajtur dhe përditësuar rregullisht Regjistri i Proceseve Gjyqësore, ku ERE figuron palë.



8.3.1 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë Gjatë Vitit 2025

Sa i përket proceseve gjyqësore ku ERE është thirrur si palë e tretë, numri i përgjithshëm arrin në 35 (tridhjetë e pesë). Këto çështje kanë si objekt kryesor: pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë

(faturave tatimore), shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., pezullimin e ekzekutimit të faturave të shitjes së energjisë elektrike, anulimin e faturave tatimore, ankesat e konsumatorëve ndaj OSHEE Group sh.a., si dhe sigurimin e padisë për të parandaluar ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga OSHEE sh.a., ndër të tjera.

8.3.2 ERE në Cilësinë e Palës Puditëse Gjatë Vitit 2025

ERE ka iniciuar 20 procese gjyqësore ndaj shoqërive debitoare për mospagimin e pagesave rregullatore, që për çdo subjekt të licencuar në sektorin e energjisë elektrike përbëjnë detyrim ligjor sipas Ligjit nr. 43/2015. Bordi i ERE-s ka miratuar dhe publikuar këto pagesa çdo vit në Fletoren Zyrtare dhe faqen zyrtare të internetit të institucionit, duke i komunikuar me njoftime zyrtare subjekteve të licencuara.

Në mungesë të shlyerjes së debive dhe përgjigjes nga disa shoqëri, ERE ka ndërmarrë masa ligjore dhe administrative për mbledhjen e detyrimeve, duke nisur edhe procedurat për heqjen e licencave të debitorëve. Pavarësisht afateve të dhënë për sqarime dhe shlyerje të detyrimeve të prapambetura, disa shoqëri nuk ndërmorën asnjë veprim, çka çoi në vendimin përfundimtar për heqjen e licencave, pa përjashtuar detyrimin për shlyerjen e pagesave rregullatore.

Në vitin 2025, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar kërkesë-paditë e ERE-s kundrejtë shoqërive debitoare, dhe ka vendosur 2 çështje në favor të ERE-s për detyrimet e papaguara dhe 10 procese mbeten ende në vazhdim.




Figura 80. Proceset gjyqësore ndaj shoqërive debitoare 2025

8.3.3 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur Gjatë Vitit 2025

ERE është përfaqësuar në 16 procese gjyqësore gjatë periudhës raportuese, 14 prej të cilave të mbartura nga vitet e mëparshme dhe 2 procese të iniciuara gjatë vitit 2025. Vendimmarrjet e ERE-s janë zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Deri më tani, gjykata ka dhënë 2 vendime në favor të ERE-s në proceset ku ajo është palë e paditur.

Gjatë vitit 2025 mund të përmendim 3 çështje për të cilat Gjykatat janë shprehur me vendim si: Në çështjen Arapi, Haxhiraj etj. kundër AKM, MMT dhe ERE, Gjykata vendosi nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke konstatuar se kërkimi nuk i nënshtrohej kompetencës së gjykatës; Në procesin Asqeri Spahiu kundër OSSH sh.a. dhe ERE, u vendos pushimi i gjykimit, çka nënkupton ndërprerjen e shqyrtimit pa hyrë në themel të çështjes; Në padinë e AREA-s kundër ERE, Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë, duke




Figura 81. Proceset gjyqësore ere palë e paditur 2025

konfirmuar se pretendimet e palës paditëse nuk gjetën mbështetje ligjore.

8.4. Transparenca

Në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ERE ka përgatitur Programin e Transparencës për vitin 2024, i cili përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së institucionit në zbatim të këtij ligji. Ky program synon të rrisë transparencën në veprimtarinë institucionale të ERE, në përputhje me kërkesat e ligjit, dhe do të përditësohet periodikisht sipas nenit 5, pika 2, të ligjit sipërcituar. Informacioni i bërë publik përmes këtij programi ofron një pasqyrë të detajuar mbi veprimtarinë e ERE-s dhe është i aksesueshëm si në faqen zyrtare www.ere.gov.al, ashtu edhe në mjediset e pritjes së publikut, ku çdo dokument është i disponueshëm edhe në formë skematike.

8.4.1 Seancat dëgjimore për aktet e ERE

Në kuadër të legjislacionit në fuqi, gjatë vitit 2025, ERE ka zhvilluar 90 seanca dëgjimore, ku kanë marrë pjesë subjekte të licencuara, palë të treta, si dhe palë të tjera të interesuara. Këto seanca dëgjimore përfaqësojnë një mekanizëm të rëndësishëm për garantimin e transparencës dhe përfshirjes së palëve në procesin e vendimmarrjes. Për më tepër, në zbatim të parimit të transparencës dhe proporcionalitetit, si dhe në mbështetje të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e ERE-s, janë zhvilluar konsultime publike. Këto konsultime përbëjnë një pjesë thelbësore të procesit të hartimit dhe miratimit të akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike, duke siguruar përfshirjen dhe adresimin e qëndrimeve të palëve të interesuara.

8.5 Ndryshimet që i janë bërë kuadrit rregullator gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, kuadri nënligjor i miratuar dhe i rishikuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka ardhur si rrjedhojë e një faze transformimi të sektorit elektroenergjitë shqiptar, ku ndërhyrjet rregullatore nuk kanë qenë thjesht teknike apo formale, por kanë ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si funksionon tregu, si operohet sistemi dhe si shpërndahen përgjegjësitë ndërmjet aktorëve. Në thelb, këto zhvillime reflektojnë një zhvendosje drejt një modeli më të integruar me tregun evropian, më të standardizuar teknikisht dhe më të orientuar drejt fleksibilitetit dhe sigurisë.

Në këtë kontekst, miratimi i metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë (Vendimi nr. 279, datë 06.11.2025) sjell një risi të rëndësishme në mënyrën se si matet dhe monitorohet funksionimi i tregut. Për herë të parë institucionalizohet një qasje e bazuar në indikatorë konkretë dhe të verifikueshëm për të përcaktuar nëse tregu është i aftë të operojë sipas standardeve të kërkuara për integrim në mekanizmat rajonalë dhe evropianë si një instrument që rrit transparencën, përgjegjshmërinë dhe parashikueshmërinë për operatorët dhe pjesëmarrësit në treg, duke ulur hapësirat për vlerësime subjektive.

Në të njëjtën linjë, rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve (Vendimi nr. 93, datë 28.04.2025) përfaqëson një ndryshim thelbësor në trajtimin e kufizimeve të rrjetit. Duke kaluar nga mekanizma më administrativë në mekanizma të bazuar në treg, kjo rregullore ndikon drejtpërdrejt në eficiencën e përdorimit të kapaciteteve ndërkufitare dhe në formimin e çmimeve të energjisë. Si rezultat, krijohen kushte për një alokim më racional të burimeve dhe për një reflektim më të saktë të kostove reale në treg, çka në afat mesëm pritet të ndikojë pozitivisht edhe në interesin e konsumatorit përmes çmimeve më efikase.

Një zhvillim me rëndësi të veçantë për integrimin rajonal është miratimi i procedurave rezervë për market coupling Shqipëri–Kosovë (Vendimi nr. 48, datë 27.02.2025). Ky akt nuk kufizohet vetëm në krijimin e një mekanizmi të ri, por njëkohësisht përditëson dhe harmonizon procedurat ekzistuese, duke përbërë në praktikë një rishikim më funksional të kuadrit të mëparshëm. Efekti kryesor i tij është garantimi i vazhdimësisë së tregut edhe në raste dështimi të platformave të coupling-ut, duke reduktuar rrezikun operacional dhe financiar për pjesëmarrësit dhe duke rritur besueshmërinë e mekanizmit të integritetit.

Në planin teknik, miratimi i Kodit të Rrjetit mbi emergjencën dhe rivendosjen (Vendimi nr. 347, datë 29.12.2025) shkon përtej një akti të ri formal, pasi në substancë ai rikonfiguron strukturën ekzistuese të kodeve të rrjetit. Ky Kod adreson situatat e jashtëzakonshme dhe rikthimin e sistemit në gjendje pune, pas ndërprerjeve të mëdha, dhe përbën një amendim sistematik të kuadrit teknik, duke e afruar atë me standardet evropiane për menaxhimin e krizave energjetike. Si pasojë, rritet ndjeshëm niveli i sigurisë së furnizimit dhe aftësia e sistemit për të reaguar në mënyrë të koordinuar dhe të strukturuar ndaj emergjencave.

Ky zhvillim plotësohet nga miratimi i udhëzuesit për operimin e sistemit të transmetimit (Vendimi nr. 348, datë 29.12.2025), i cili konkretizon në nivel praktik kërkesat e kodeve të rrjetit. Nëpërmjet standardizimit të procedurave operacionale, ky udhëzues redukton hapësirat për interpretim të ndryshëm nga operatorët dhe rrit uniformitetin në zbatimin e rregullave, duke kontribuar në një operim më të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të sistemit.

Një nga ndërhyrjet më me ndikim në funksionimin e përditshëm të tregut është implementimi i intervalit 15-minutësh në tregun e balancimit (Vendimi nr. 327, datë 18.12.2025). Ky ndryshim prek drejtpërdrejt parametrat kohorë të tregtimit dhe mënyrën e operimit të tregut, duke e bërë atë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në kohë reale dhe më të përshtatshëm për integrimin e burimeve të rinovueshme. Në praktikë, ky vendim modifikon rregullat ekzistuese dhe metodologjitë operative, duke përbërë një rishikim me efekt normativ të drejtpërdrejtë mbi funksionimin e tregut.

Në të njëjtën kohë, vendimi për detyrimet e raportimit për sigurimin e aseteve dhe punonjësve (Vendimi nr. 344, datë 23.12.2025) sjell një zgjerim të kuadrit rregullator në drejtim të monitorimit dhe menaxhimit të riskut. Duke vendosur kërkesa të reja raportimi, ky akt përditëson në praktikë kuadrin ekzistues të mbikëqyrjes, duke rritur nivelin e transparencës dhe përgjegjshmërisë së operatorëve dhe duke forcuar dimensionin e sigurisë në sektor.

Një ndërhyrje me natyrë më sektoriale, por me rëndësi në rritje, është përcaktimi i çmimit për karikimin e automjeteve elektrike mbi 11 kW (Vendimi nr. 255, datë 15.10.2025). Ky akt vendos bazat për rregullimin e një segmenti të ri të tregut, duke krijuar një referencë për çmimet dhe duke synuar parandalimin e praktikave abuzive në një fazë të hershme të zhvillimit të infrastrukturës së mobilitetit elektrik.

Në dimensionin strategjik, miratimi i Strategjisë për kursimin e energjisë 2025–2030 (Vendimi nr. 299, datë 17.11.2025) tregon një zgjerim të rolit të ERE-s përtej rregullimit klasik, duke përfshirë edhe orientimin e politikave të sjelljes së konsumatorit. Edhe pse nuk është një akt normativ në kuptimin klasik, ajo prodhon efekte rregullatore nëpërmjet orientimit të politikave dhe masave që ndikojnë në kërkesën për energji dhe në eficiencën e përdorimit të saj.

Sa i përket ndryshimeve të mirëfillta në akte ekzistuese, ndërhyrja në metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni (Vendimi nr. 47, datë 27.02.2025) përfaqëson një rast tipik amendamenti, ku teksti ekzistues modifikohet për të përmirësuar mënyrën e shpërndarjes së këtyre të ardhurave. Ky ndryshim ka ndikim të drejtpërdrejtë në balancimin e interesave ndërmjet operatorëve dhe në krijimin e stimuljeve për investime në rrjet, duke reflektuar një qasje më të drejtë dhe më eficiente ekonomike.

Në të njëjtën kohë, vetë procedurat rezervë për market coupling (Vendimi nr. 48) funksionojnë edhe si një amendament funksional, pasi përditësojnë dhe harmonizojnë mekanizmat ekzistues, duke i përshtatur me modelin aktual të integritetit të tregut. Kjo tregon se një pjesë e ndërhyrjeve të vitit 2025 nuk janë të kufizuara në ndarjen formale “akte të reja” dhe “akte të ndryshuara”, por kanë një natyrë hibride që kombinon të dyja.

Në vijim të këtij kuadri, Vendimi nr. 146, datë 08.07.2025 mbi testimin e tregut për gazsjellësin TAP përfaqëson një ndërhyrje të rëndësishme në zhvillimin e tregut të gazit natyror. Nëpërmjet

këtij vendimi krijohet një mekanizëm për të matur kërkesën reale të tregut dhe për të orientuar përdorimin e kapaciteteve të infrastrukturës mbi baza transparente dhe konkurruese. Efekti i tij shkon përtej segmentit të gazit, pasi kontribuon në diversifikimin e burimeve energjetike dhe në rritjen e sigurisë së furnizimit në tërësi.

Nga ana tjetër, Vendimi nr. 294, datë 13.11.2025 mbi mënyrën e pasqyrit të konsumit në faturën mujore ndërhyr drejtpërdrejt në marrëdhënien me konsumatorin, duke vendosur standarde më të qarta për strukturën dhe transparencën e faturimit. Ky akt rrit kuptueshmërinë e faturës, lehtëson verifikimin e saj nga konsumatori dhe forcon përgjegjshmërinë e furnizuesve, duke adresuar një nga problematikat më të shpeshta në praktikë lidhur me mungesën e transparencës në faturim.

Një element që meriton vëmendje është edhe fillimi i procedurës për rishikimin e rregullores së licencimit (Vendimi nr. 338, datë 23.12.2025), i cili, megjithëse nuk prodhon ende efekte juridike të drejtpërdrejta, synon një reformatim të rëndësishëm. Ky hap procedural tregon se procesi i rishikimit të kuadrit rregullator nuk është i përfunduar, por vijon në mënyrë të strukturuar.

Vendimi nr. 79 për sigurinë kibernetike vendos kërkesa specifike për mbrojtjen e sistemeve të energjisë nga sulmet dhe incidentet digjitale, duke forcuar qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike. Po ashtu, Vendimi nr. 290 për alokimin e kapaciteteve afatgjata formalizon mekanizmat për shpërndarjen e kapaciteteve për periudha më të gjata, duke mbështetur planifikimin dhe investimet. Vendimi nr. 291, udhëzuesi për balancimin, standardizon operimin e tregut të balancimit dhe përcakton përgjegjësitë e pjesëmarrësve, duke rritur efikasitetin operativ. Vendimi nr. 293 ndryshon vendimin nr. 93, duke përmirësuar mekanizmat e alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongestionëve, si një rafinim i kuadrit ekzistues. Vendimi nr. 300 për fillimin e procedurës për cilësinë e transmetimit shënon një hap proaktiv drejt monitorimit dhe rishikimit të standardeve teknike. Vendimi nr. 323 përcakton tarifat e NEMO 2026, duke siguruar transparencë në kostot e operimit të tregut. Vendimi nr. 343 prezanton Planin e investimeve të OST, duke orientuar prioritete dhe kapacitete financiare për zhvillim të qëndrueshëm të rrjetit. Ndërsa Vendimi nr. 346 adreson cilësinë e shërbimit në shpërndarje, duke vendosur standarde minimale për ofrimin e energjisë ndaj konsumatorëve dhe duke përforcuar mbrojtjen e tyre.

Në konkluzion, të gjitha ndërhyrjet e mësipërme, qoftë përmes miratimeve të akteve të reja, ndryshimeve në akte ekzistuese apo fillimit të procedurave për rishikime, janë të orientuara drejt të njëjtit qëllim strategjik të ERE-s: garantimin e një sistemi energjetik të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Në këtë kuadër, ERE jo vetëm ka harmonizuar kuadrin rregullator me standardet evropiane, por gjithashtu synon të sigurojë që sistemi të mund të reagojë në mënyrë efektive ndaj emergjencave, të përshtatet ndaj nevojave të reja të tregut dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit energjetik në të ardhmen.

9. RAPORT MBI VEPRIMTARINË E ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR PAJTUESHMËRINË DHE VLERËSIMIN E IMPAKTIT RREGULLATOR VITI 2025

Gjatë vitit 2025, ERE në ushtrim të kompetencave si autoritet rregullator i pavarur, ka ushtruar funksionin e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi pajtueshmërinë rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Aktiviteti i ERE-s është fokusuar në zbatimin korrekt të legjislacionit primar dhe sekondar, si dhe të detyrimeve që burojnë nga acquis i Bashkimit Evropian, me qëllim garantimin e funksionimit të një tregu energjetik të qëndrueshëm, transparent, jodiskriminues dhe konkurrues.

Në këtë kuadër, ERE ka ushtruar mbikëqyrje mbi pajtueshmërinë e operatorëve të sistemeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror duke u mbështetur në mekanizmat rregullatorë të raportimit periodik dhe në strukturat e dedikuara të pajtueshmërisë (Zyrtarëve të Pajtueshmërisë së operatorëve) si dhe në kuadrin ligjor si në vijim:

- Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përcakton kuadrin ligjor për organizimin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, duke garantuar ndarjen dhe pavarësinë e aktiviteteve të transmetimit dhe shpërndarjes nga prodhimi dhe furnizimi.
- Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, i cili përcakton kuadrin ligjor për organizimin dhe funksionimin e tregut të gazit natyror, duke vendosur kërkesa të qarta për ndarjen dhe pavarësinë e operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes.
- Rregullores për Certifikimin e Operatorëve, e cila përcakton kriteret dhe procedurat për vlerësimin e pajtueshmërisë së operatorëve me kërkesat për ndarje (unbundling) dhe pavarësi funksionale. Në këtë kuadër, ERE ka mbikëqyrur zbatimin nga operatorët e certifikuar si OST sh.a., OSSH sh.a., Albgaz sh.a. dhe TAP sh.a., me qëllim garantimin e një tregu të drejtë, transparent dhe konkurrues.
- Përafrimin me legjislacionin dhe standardet e Bashkimit Evropian, si një ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së ERE. Në këtë kuadër, është mbikëqyrur zbatueshmëria e kërkesave që rrjedhin nga Direktiva 2009/72/EC për energjinë elektrike dhe Direktiva 2009/73/EC për gazin natyror të cilat kanë si qëllim sigurimin e një tregu të hapur dhe konkurrues, duke ndarë operatorët e transmetimit nga prodhuesit dhe furnizuesit si dhe programeve të pajtueshmërisë (*Programi synon të parandalojë sjelljet diskriminuese, të garantojë funksionimin e ndarë dhe të pavarur të operatorëve dhe të përcaktojë detyrimet e punonjësve për respektimin e kërkesave ligjore, duke përfshirë ndarjen funksionale e ligjore të operatorëve, pavarësinë e menaxhimit dhe monitorimin nga Zyrtari i Pajtueshmërisë*), të miratuara nga Bordi i ERE-s, për operatorët e certifikuar dhe licencuar në sektorin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe gazit natyror, si Albgaz sh.a., OSSH sh.a., OST sh.a. dhe TAP sh.a.

ERE, gjatë aktivitetit të saj në vitin 2025, ka analizuar dhe vlerësuar raportimet vjetore të dorëzuara nga Zyrtarët e Pajtueshmërisë të operatorëve, të cilët ushtrojnë funksionin në mënyrë të pavarur nga operatorët. Këto raporte kanë të bëjnë me monitorimin e zbatimit të pajtueshmërisë në përputhje me detyrimet dhe përcaktimet ligjore të sipërcituara, dhe duke dale me vendimet, si më poshtë vijon:

9.1. Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sh.a.

Me vendimin nr. 187, datë 07.08.2025 “Mbi Vlerësimin e Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Shoqërisë “Operatori i Sistemit Të Shpërndarjes” sh.a. për vitin 2024”, Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2024.

Duke ushtruar funksionin mbikëqyrës dhe vlerësues mbi zbatimin e Programit të Pajtuëshmërisë nga operatori i sistemit të shpërndarjes, në përputhje me parimet e ndarjes funksionale, ligjore dhe organizative, si dhe mbi bazën e raportimit të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë lidhur me monitorimin e zbatimit të këtij programi, ERE për vitin 2024 ka vlerësuar se Zyrtari ka respektuar afatet dhe kërkesat për hartimin dhe dorëzimin e Raportit Vjetor pranë ERE-s, duke e publikuar atë në gjuhën shqipe dhe angleze në faqen zyrtare të OSSH sh.a. Operatori OSSH sh.a. ka përmbushur detyrimet për ndarjen funksionale dhe organizative nga strukturat e tjera të integruara vertikalisht, duke miratuar një organigramë të re, e cila garanton pavarësinë në vendimmarrje dhe menaxhim. Gjithashtu, vlerësohet se janë zbatuar rekomandimet e lëna nga ERE në vitin paraardhës, duke sjellë përmirësime të dukshme në transparencë, në aksesin në informacion, si dhe në ofrimin e shërbimeve online për konsumatorët. OSSH sh.a. ka bërë progres të konsiderueshëm në ofrimin e një qasjeje transparente dhe jodiskriminuese për përdoruesit e rrjetit të shpërndarjes. Gjatë vitit 2025 janë evidentuar përmirësime të mëtejshme në komunikimin publik, në forcimin e identitetit vizual, si dhe në ofrimin e shërbimeve inovative, të cilat kanë lehtësuar aksesin dhe kanë përmirësuar cilësinë e shërbimeve për konsumatorët.

Gjithashtu në funksion të përmirësimit të zbatimit të Programit të Pajtuëshmërisë, për periudhën pasardhëse (vitin 2025) Bordi i ERE-s ka lënë dhe rekomandime për Zyrtarin e Pajtuëshmërisë të OSSH sh.a dhe operatorin, duke sugjeruar një përqendrim të mëtejshëm në zbatimin e dispozitave të këtij programi dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit mbi proceset kritike dhe raportimin e detajuar mbi transferimin e punonjësve, zbatimin e projekteve të matësve inteligjentë, funksionimin e platformave për furnizuesit, proceset e ndërrimit të furnizuesit, si dhe përmbushjen e detyrimeve rregullatore për sigurinë kibernetike.

Këto rekomandime synojnë të forcojnë më tej transparencën dhe trajtimin e barabartë të palëve të interesuara në sistemin e shpërndarjes.

9.2. Raportin Vjetor të Pajtuëshmërisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike “OST” sh.a.

Me vendimin nr. 337, datë 18.12.2025 “Mbi Vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtuëshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për vitin 2024” Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë pjesërisht Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së shoqërisë “OST” sh.a., për vitin 2024 të hartuar nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST sh.a.

Në kuadër të ushtrimit të funksionit të saj mbikëqyrës, dhe vlerësues mbi zbatimin e Programit të Pajtuëshmërisë nga operatori i transmetimit, si dhe monitorimit e raportimin nga Zyrtari mbi zbatimin e këtyre detyrimeve, ERE për vitin 2024 ka vlerësuar se OST sh.a. ka vijuar të ruajë ndarjen dhe pavarësinë institucionale, financiare dhe operacionale, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, pa evidentuar shkelje të Programit të Pajtuëshmërisë për vitin 2024. Gjithashtu, ERE ka vlerësuar përmbushjen e detyrimeve që lidhen me garantimin e pavarësisë së audituesit financiar dhe me transparencën në procesin e njoftimit dhe përzgjedhjes së tij në funksion të kushteve të certifikimit të OST sh.a. si operator i pavarur i sistemit të transmetimit. Operatori ka zbatuar masat e qëndrueshme mbi kontrollin dhe mbrojtjen, në aspektin e sigurisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike.

Në këtë vendimmarrje e në funksion të përmirësimit të zbatimit të Programit të Pajtuëshmërisë, për periudhën pasardhëse (vitin 2025) dhe me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të standardeve të pajtuëshmërisë rregullatore dhe garantimin e një funksionimi të qëndrueshëm e transparent të operatorit në përputhje me kërkesat ligjore dhe me praktikat më të mira rregullatore, Bordi i ERE-s, ka rekomanduar që Zyrtari i Pajtuëshmërisë të sigurojë një raportim më të qartë dhe të përditësuar mbi strukturën organizative të OST sh.a. dhe mbi ndryshimet eventuale që kanë ndodhur. Gjithashtu, operatori duhet të përmbushë tërësisht detyrimet e Programit lidhur me të dhënat dhe platformat e informacionit për publikun, përfshirë raportimin mbi arkivimin e

informacionit konfidencial, depozitim prapë ERE-s të informacionit të detajuar mbi përdorimin e të ardhurave nga rrjeti OPGW, duke përfshirë analizën e kryer nga Drejtoria Teknike dhe vlerësimin e pavarur të Zyrtarit të Pajtuësshmërisë mbi ndikimin në pavarësinë financiare të OST sh.a., në përputhje me kërkesat e Programit Programin e Pajtuësshmërisë të miratuar nga ERE me vendimin e Bordit nr. 149, datë 10.09.2020. Gjithashtu, ERE ka rekomanduar dhe forcimin e mëtejshëm të mekanizmave për dokumentimin dhe gjurmueshmërinë e rasteve të mundshme të shkeljeve të Programit të Pajtuësshmërisë, si trajnimet, udhëzimet dhe konsultimet e realizuara për stafin, me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë institucionale dhe monitorimin më efektiv të zbatimit të kërkesave rregullatore mbi pajtuësshmërinë.

9.3. Raportin Vjetor të Pajtuësshmërisë për Operatorin e TAP (Trans Adriatic Pipeline)

Me vendimin nr. 331, datë 18.12.2025 “Mbi Vlerësimin e Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtuësshmërisë së Shoqërisë “Trans Adriatic Pipeline Ag”, Degë e Shoqërisë së Huaj, Për Zbatimin e Programit të Pajtuësshmërisë Rregullatore për Vitin 2024”, Bordi i ERE-s ka vendosur të miratojë Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtuësshmërisë së shoqërisë “Trans Adriatic Pipeline AG”, degë e shoqërisë së huaj, për vitin 2024.

Në kuadër të ushtrimit të funksionit të saj mbikëqyrës, dhe vlerësues mbi zbatimin e Programit të Pajtuësshmërisë nga operatori Trans Adriatic Pipeline AG”, degë e shoqërisë së huaj, për vitin 2024, si dhe monitorimin dhe raportimin nga Zyrtari mbi zbatimin e këtyre detyrimeve, ERE ka vlerësuar se Zyrtari i Pajtuësshmërisë ka përmbushur detyrimet ligjore, duke siguruar raportim periodik brenda afateve dhe kërkesave prapë autoriteteve rregullatore, në përputhje me kërkesat e Programit të Pajtuësshmërisë dhe me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Gjatë vitit 2024 nuk janë raportuar dhe nuk janë evidentuar raste shkeljeve të statusit ITO, të primeve të ndarjes funksionale, të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues, si dhe të mbrojtjes së informacionit të ndjeshëm tregtar. Në bazë të raportimit, veprimet dhe proceset e zbatuara nga TAP AG kanë rezultuar në përputhje me Programin e Pajtuësshmërisë, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të shoqërisë dhe përfshin edhe mekanizmat e raportimit dhe adresën elektronike të dedikuar për çështjet e pajtuësshmërisë rregullatore.

ERE ka vlerësuar se Zyrtari i Pajtuësshmërisë ka marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e TAP-it dhe ka ofruar përditësime periodike për strukturat e Bordit, duke siguruar mbikëqyrje të vazhdueshme dhe transparencë në zbatimin e Programit. Po ashtu, Zyrtari nëpërmjet mekanizmave të kontrollit ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtën për akses në të dhënat e shoqërisë, duke mundësuar monitorim efektiv mbi zbatimin e detyrimeve ligjore dhe programore, si dhe ka ofruar rekomandime dhe asistencë profesionale për përmirësimin e proceseve të brendshme. ERE ka vlerësuar përdorimin e mekanizmave, raportimin e shkeljeve potenciale tek autoritetet dhe organet drejtuese të TAP-it, përmes përdorimit të adresës elektronike të dedikuar për pajtuësshmërinë rregullatore regulatorycompliance@tap-ag.com. Më tej, ERE ka vlerësuar dhe proceset e zbatuara nga TAP AG të cilat gjenden në përputhje me detyrimet e Programit të Pajtuësshmërisë të miratuar nga ERE. Programi gjendet i publikuar në faqen zyrtare të TAP-it, duke siguruar transparencë dhe mundësi verifikimi për palët e interesuara mbi respektimin e kërkesave ligjore nga operatori. Operatori vlerësohet edhe mbi zbatimin e rregullave për trajtimin e informacionit të ndjeshëm tregtar, duke shmangur çdo rrezik të shpërndarjes së paautorizuar dhe duke ruajtur integritetin e të dhënave konfidenciale.

Në kuadër të vlerësimit të zbatimit të Programit të Pajtuësshmërisë, ERE për periudhën pasardhëse **2025, ka theksuar vazhdimin në rritjen e përqendrimit mbi** Zbatimin e Programit të Pajtuësshmërisë Rregullatore në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar, me Direktivën 2009/73/EC dhe me aktet rregullatore në fuqi nga operatori dhe mbi monitorimin e Zyrtarit.

9.4. Raportin Vjetor të Pajtuësshmërisë në sektorin e Gazit Natyror nga “Albgaz” sh.a.,

Me vendimin nr. 24, datë 30.01.2026 “Mbi Vlerësimin e Raportit Vjetor të Zyrtarit të

Pajtuëshmërisë së Shoqërisë “Albgaz” sh.a. për zbatimin e programit të pajtuëshmërisë për Vitin 2024” Bordi i ERE-s ka vendosur të miratoipjesërisht Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së shoqërisë “Albgaz” sh.a., për vitin 2024.

Në kuadër të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës dhe vlerësues mbi zbatimin e Programit të Pajtuëshmërisë nga operatori “Albgaz” sh.a., për vitin 2024 si dhe monitorimin dhe raportimin nga Zyrtari mbi zbatimin e këtyre detyrimeve ERE, ka dalë me vlerësime mbi nivelin e përmbushjes së detyrimeve dhe rekomandime konkrete për përmirësime në periudhën pasardhëse, në funksion të forcimit të standardeve të pajtuëshmërisë rregullatore për Zyrtarin dhe Operatorin Albgaz sh.a., kyesisht lidhur me raportimin mbi pavarësinë e audituesit financiar dhe përmbushjen e kushteve të certifikimit, duke përfshirë procedurat e ndjekura për përzgjedhjen e audituesit, deklaratat e pavarësisë dhe verifikimin e respektimit të kërkesave rregullatore që garantojnë ruajtjen e statusit të operatorit të pavarur. ERE ka dhënë rekomandime në lidhje me pasqyrimin e ndryshimeve në strukturën organizative të shoqërisë, përfshirë aktet vendimmarrëse të organeve drejtuese dhe ndikimin e tyre në ndarjen funksionale, si dhe identifikimin dhe dokumentimin e masave që sigurojnë ndarjen ligjore dhe funksionale dhe pavarësinë menaxheriale, duke përfshirë linjat e raportimit dhe mekanizmat që parandalojnë ndikimin e papërshtatshëm nga subjekte të tjera të integruara.

Në përmbushje të detyrimeve të programit, ERE ka rekomanduar për Zyrtarin përmirësimin e monitorimit dhe raportimit mbi përmbushjen e detyrimeve për publikim dhe transparencën, përfshirë aksesueshmërinë e dokumenteve dhe vendimeve, si dhe respektimin e standardeve të transparencës institucionale. Po ashtu, ka dhënë rekomendime në lidhje me raportimin mbi masat e marra nga operatori për garantimin e konfidencialitetit të informacionit tregtar të ndjeshëm, përmes përshkrimit të procedurave për administrimin dhe mbrojtjen e tij, kontrollin e aksesit dhe mekanizmat e mbikëqyrjes së brendshme. Një tjetër element i rekomanduar lidhet me detajimin e metodologjisë së monitorimit dhe evidencave të ndjekjes së proceseve vendimmarrëse, duke përfshirë dokumentimin e pjesëmarrjes në mbledhje, njoftimet zyrtare dhe procesverbalet përkatëse.

ERE, në vijim të rekomandimeve për palët, por edhe me qëllim përmirësimin e raportimeve pasardhëse, thekson rëndësinë e respektimit të afateve dhe kërkesave të raportimit vjetor pranë ERE-s nga Zyrtari, sipas përcaktimeve dhe detyrimeve të Programit të Pajtuëshmërisë. Gjithashtu, kërkohet evidentimi i masave të ndërmarra për përmirësimin e disiplinës raportuese, statusi i zbatimit të rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga ERE në periudhat raportuese, duke paraqitur progresin e arritur, masat e ndërmarra dhe veprimet e planifikuara për adresimin e çështjeve të mbetura, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të pajtuëshmërisë rregullatore. Në vijim të zbatimit të karakterit detyrues të Programit të Pajtuëshmërisë, operatori duhet të sigurojë e të garantojë në të gjitha strukturat dhe nivelet organizative, njoftimin paraprak dhe në kohë të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë për çdo mbledhje ku trajtohen çështje që lidhen me zbatimin e Programit, duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe duke dokumentuar pjesëmarrjen e tij, si dhe të sigurojë bashkëpunim të plotë përmes garantimit të aksesit në informacion, dokumentacion dhe strukturat e nevojshme për ushtrimin efektiv të funksionit monitorues.

Këto rekomandime synojnë konsolidimin e mëtejshëm të standardeve të pajtuëshmërisë rregullatore dhe garantimin e një funksionimi të qëndrueshëm e transparent të operatorit në përputhje me kërkesat ligjore.

10. VEPRIMTARIA E ERE PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

10.1. Veprimtaria e ERE për Mbrojtjen e Konsumatorit për Vitin 2025

Mbrojtja e konsumatorit përbën një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së ERE-s dhe një prioritet të vazhdueshëm institucional, i cili kërkon vëmendje të vazhdueshme dhe angazhim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore dhe administrative. Garantimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorëve u siguron atyre trajtim të drejtë, të përgjegjshëm dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit e shërbimit të energjisë elektrike, si dhe u krijon atyre kushtet e nevojshme për të marrë vendime objektive dhe të mirëinformuara mbi shërbimet që përfitojnë.

Në këtë kuadër, qëllimi kryesor i veprimtarisë së ERE-s është mbrojtja e interesave të konsumatorëve të energjisë elektrike përmes sigurimit të çmimeve të drejta, ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme dhe garantimit të zbatimit të rregullave dhe praktikave transparente nga operatorët dhe pjesëmarrësit e tregut. Njëkohësisht, ERE siguron që konsumatorët të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe jo-diskriminuese, në përputhje me të drejtat dhe garancitë që parashikon legjislacioni në fuqi. Përtej këtij dimension, mbrojtja e konsumatorit, përfshin edhe promovimin e përfitimeve afatgjata që vijnë nga një mjedis energjitik i pastër dhe më i qëndrueshëm, në funksion të mbrojtjes së mjedisit dhe interesit publik.

Në ushtrimin e kompetencave të saj në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, ERE ka ndërtuar dhe konsoliduar një kuadër të plotë rregullator, të përbërë nga rregullore, metodologji dhe akte të tjera nënligjore, të cilat rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve të sektorit të energjisë. Paralelisht, ERE ka zhvilluar edhe një strukturë informuese, me qëllim që konsumatorët të kenë akses në informacion objektiv, të saktë dhe të kuptueshëm mbi shërbimet që marrin dhe mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, strukturë e cila përditëson informacion të dobishëm për konsumatorin në mënyrë periodike në të gjitha mediumet e komunikimit publik.

Gjatë vitit 2025, ERE ka vlerësuar si thelbësore nevojën që konsumatorët e energjisë elektrike të jenë të mirëinformuar mbi të drejtat e tyre, për disa arsye kryesore. Së pari, njohja e të drejtave shërben si mekanizëm mbrojtës ndaj praktikave abuzive ose zbatimit të pasaktë të legjislacionit në fuqi nga ana e furnizuesve dhe operatorëve të rrjetit. Së dyti, informacioni i plotë dhe i qartë u mundëson konsumatorëve të marrin vendime të informuara, duke krahasuar alternativat e furnizimit, duke kuptuar strukturën e tarifave dhe duke zgjedhur shërbimin më të përshtatshëm për nevojat e tyre. Në këtë drejtim, ERE ka ndërtuar dhe vënë në funksion platformën e krahasimit të çmimeve, e cila ofron një pasqyrë të ofertave të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët që operojnë në tregun e lirë. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 241, datë 14.11.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 43, datë 14.02.2025, ka vendosur detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike në Platformën e Krahasimit të Çmimeve (PCT), për të licencuarit, që janë aktivisht të angazhuar në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë, për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë të vegjël me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kWh. Kjo platformë, e krijuar nga ERE e cila është bërë e aksesueshme në faqen zyrtare të ERE: <https://pct.ere.gov.al/>, shërben si një mjet për informimin e konsumatorëve mbi ofertat e furnizuesve të licencuar në tregun e lirë. Për rrjedhojë, konsumatorët që janë të lidhur në tensionin e mesëm, kanë të drejtën për të zgjedhur furnizuesin e tyre të energjisë në tregun e lirë. Përgjatë vitit 2025, Platforma ka pasur një pjesëmarrje aktive nga furnizuesit, të cilët kanë publikuar oferta të ndryshme me çmime dhe periudha të ndryshme vlefshmërie, sipas niveleve të tensionit. Më konkretisht, kanë paraqitur ofertat e tyre në Platformën PCT, 7 Furnizues të energjisë elektrike. Këto furnizues kanë ofruar një gamë ofertash me çmime dhe nivele tensioni të ndryshme, që ofron mundësi zgjedhjeje për konsumatorët në tregun e lirë. Çmimi për kWh ndryshon varësisht nga niveli i tensionit dhe fasha e konsumit, duke reflektuar kushte të ndryshme të furnizimit. Aktualisht, janë 40 subjekte të licencuar dhe nga 17 Furnizues që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, përgjatë vitit 2025, rezulton se 10 prej tyre që plotësojnë kriteret kanë publikuar ofertat në platformën e

krahasimit të çmimeve PCT.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i informimit lidhet me nxitjen e përdorimit efikas të energjisë elektrike. Përmes informimit mbi praktikën e kursimit dhe rritjes së eficiencës energjetike, konsumatorët mund të ulin kostot e faturimit dhe, njëkohësisht, të kontribuojnë në reduktimin e ndikimit mjedisor. Në funksion të këtij objekti, ERE ka zhvilluar periodikisht fushata informuese në rrjetet sociale dhe kanale të tjera komunikimi, duke promovuar praktikën më të mira për menaxhimin racional të konsumit të energjisë elektrike.

Informimi i konsumatorëve luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e shpejtë dhe efektive të ankesave. Konsumatorët e ndërgjegjësuar mbi të drejtat dhe procedurat përkatëse janë më të aftë të veprojnë në rast të ndërprerjeve të pajustifikuara të furnizimit, faturimeve të pasakta apo problematikave të tjera që lidhen me shërbimin. Nga analiza e ankesave të regjistruara pranë ERE, është konstatuar se një pjesë e konsumatorëve paraqesin ankesa jashtë afateve ligjore të parashikuara për kundërshtimin e faturimeve ose për ushtrimin e të drejtave të tyre, çka nënvizon edhe një herë rëndësinë e informimit të vazhdueshëm. Përveç veprimtarive informuese dhe rregullatore, një fokus i veçantë i punës së ERE-s mbetet trajtimi i shpejtë, i drejtë dhe efektiv i ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025, pranë ERE janë paraqitur gjithsej 244 ankesa dhe kërkesa për informacion ose orientim, që lidhen me çështje dhe shqetësime të konsumatorëve. Prej tyre, 161 janë regjistruar dhe trajtuar si ankesa, ndërsa 83 kanë qenë kërkesa për orientim ose parashpresa të paplota, të cilat nuk plotësonin kriteret minimale për çeljen e një hetimi administrativ.

Në të gjitha rastet, ERE ka orientuar konsumatorët për plotësimin e kriterëve minimale ligjore të nevojshme për trajtimin e një ankimi administrativ, përfshirë paraqitjen e të dhënave të kontratës, faturës së kontestuar dhe provës së adresimit paraprak të ankesës pranë furnizuesit përkatës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në rastet kur këto kriterë janë plotësuar, ERE ka çelur hetimin administrativ dhe ka vijuar me shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesës.

Nga totali i ankesave dhe kërkesave të paraqitura, rreth 75 janë adresuar përmes kanaleve digjitale, përfshirë faqen zyrtare të ERE-s dhe formularin online për depozitim të ankesave. Konkretisht, 11 ankesa janë dorëzuar përmes formularit online “Bëj një ankesë”, 64 ankesa përmes postës elektronike, ndërsa 169 prej tyre përmes postës tradicionale ose dorëzimit fizik në zyrat e EREs.

Gjatë vitit 2025, si pjesë e forcimit të transparencës dhe të drejtave të konsumatorëve në tregun e energjisë elektrike, Bordi ERE-s, miratoi Vendimin nr. 294, datë 13.11.2025, përkatësisht Udhëzimin “Për mënyrën e pasqyrit të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore dhe identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse”. Ky akt rregullator, i nxjerrë në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenet 16 dhe 81 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar si dhe akteve të tjera rregullatore të

Ankesa dhe kërkesa të regjistruara në ERE- Vitit 2025



ERE-s, ka për qëllim të sigurojë një nivel më të lartë transparence, qartësie dhe drejtësie në faturimin e energjisë elektrike për konsumatorët fundorë. Vendimi detajon mënyrën e pasqyrimin të konsumit sipas kategorive tarifore, identifikimin e qartë të kategorisë së konsumatorit në faturë dhe detyrimet e furnizuesve e operatorëve të sistemit për zbatimin e këtyre rregullave, duke kontribuar në mbrojtjen efektive të konsumatorit përmes informimit dhe zbatimit të drejtë të çmimeve të miratuara. Miratimi i këtij udhëzimi përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së faturimit dhe adresimit të shqetësimeve të konsumatorëve lidhur me paqartësitë e faturimit dhe zbatimin e tarifave të energjisë elektrike.

Ndryshon dhe bëhet: Gjatë vitit 2025, si pjesë e forcimit të transparencës dhe të drejtave të konsumatorëve në tregun e energjisë elektrike, nisur nga mbikëqyrja e vazhdueshme e shërbimit që furnizuesit i ofrojnë konsumatorit, lidhur ngushtësisht me elementin e transparencës në faturim, Bordi ERE-s, miratoi Vendimin nr. 294, datë 13.11.2025, përkatësisht Udhëzimin “*Për mënyrën e pasqyrimin të konsumit të energjisë elektrike në faturën mujore dhe identifikimin e ndarë të kategorive të konsumatorëve dhe zbatimin e çmimeve përkatëse*”. Ky akt rregullator, i nxjerrë në zbatim të kompetencave të përcaktuara në Ligjin nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar si dhe akteve të tjera rregullatore të ERE-s, u miratua për të përmirësuar shërbimin e faturimit transparent, pas evidentimit të nevojës që faturat e konsumit të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, duhet të reflektojnë qartësisht kategorinë së cilës konsumatori i përket e për rrjedhojë për të garantuar transparencë më të madhe në aplikimin e tarifës përkatëse të miratuar nga ERE për çdo kategori. Vendimi detajon mënyrën e pasqyrimin të konsumit sipas kategorive tarifore, identifikimin e qartë të kategorisë së konsumatorit në faturë dhe detyrimet e furnizuesve e operatorëve të sistemit për zbatimin e këtyre rregullave, duke kontribuar në mbrojtjen efektive të konsumatorit përmes informimit dhe zbatimit të drejtë të çmimeve të miratuara. Miratimi i këtij udhëzimi përbën një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së faturimit dhe adresimit të shqetësimeve të konsumatorëve lidhur me paqartësitë e faturimit dhe zbatimin e tarifave të energjisë elektrike.

Dhe po ashtu është duke u punuar në drejtim të hartimit të një udhëzimi lidhur me rregullimin e marrëdhënieve të Konsumatorëve për kompensimin financiar në rastet e mbifaturimit në përfundimet e kontratës së furnizimit apo kur furnizimi i është kaluar në një titullar tjetër kontrate. Me këtë akt synohet të adresohen element që kanë të bëjnë me modalitetet e kompensimit në terma afatesh, mënyrat e likuidimit apo transferimit të krediteve që vijnë si pasojë e keqfaturimit, etj.


ERE po ashtu, zhvillon procedura të formalizuara për pranimin, regjistrimin dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve, duke siguruar procedura të njëjta, transparente dhe jodiskriminuese për zgjidhjen e konflikteve midis konsumatorëve dhe furnizuesve/operatorëve të rrjetit. Në funksion të adresimit të ankesave por edhe transparencës mbi trajtimin e tyre, ERE publikon në një kohë që varion nga 24 - 48 orë regjistrin publik të ankesave të përditësuar me qëllim që çdo konsumator, të ndjekë në kohë sa më të shpejtë ecurinë e trajtimit të ankesës së tij.

Rregullimi i tregut të energjisë në Shqipëri, përfshirë procesin e liberalizimit dhe njoftimin e konsumatorëve për mundësitë e tyre të lidhjes me furnizues të ndryshëm të licencuar nga ERE, është në linjë me parimet e tregut të brendshëm të energjisë që kërkojnë mundësi të lira të zgjedhjes dhe konkurrencë të drejtë midis furnizuesve. Për këtë qëllim, platforma PCT e ndërtuar nga ERE por edhe promovimi i vazhdueshëm i saj si një mundësi shumë e mirë për të hetuar, përzgjedhur e vlerësuar ofertat e furnizimit në treg të lirë, implementon tërësisht këtë detyrim që buron nga legjislacioni evropian por edhe ai vendas.

Ankesat e pranuar në ERE për zgjidhje alternative

Siç edhe cituar më sipër, gjatë vitit 2025, në ERE janë adresuar 244 kërkesa dhe ankesa për zgjidhje alternative të tyre, nga të cilat kriteret ligjore për çeljen e hetimit administrativ kanë

plotësuar 161 prej tyre. Në vijim po eidentojmë kategoritë kryesore të ankesave të ndara sipas problematikave.



Made with Napkin

10.2 Ankesat për dëm ekonomik

Ankesat që lidhen me dëmin ekonomik kanë të bëjnë me rastet kur operatori i rrjetit të shpërndarjes faturon konsumatorin për dëme të konstatuara si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e matjes së energjisë elektrike. Këto ndërhyrje përfshijnë, ndër të tjera, manipulimin e pajisjeve matëse, realizimin e lidhjeve të paautorizuara në rrjet ose çdo formë tjetër ndërhyrjeje në sistemin e matjes, e cila synon shmangien ose uljen e pasqyrimin të saktë të konsumit real të energjisë elektrike. Në këto raste, operatori i rrjetit, në përputhje me rregullat dhe metodologjinë përkatëse të miratuar nga ERE, aplikon faturimin përkatës me qëllim kompensimin e dëmit ekonomik të shkaktuar, duke reflektuar vlerën e energjisë së konsumuar dhe të paregjistruar për shkak të ndërhyrjes së paligjshme. Përlllogaritja e sasisë së energjisë që përbën dëmin ekonomik bëhet duke identifikuar sasinë e energjisë elektrike të konsumuar pa autorizim nga përdoruesi i rrjetit, si pasojë e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e matjes (si manipulime të matësit, lidhje të paautorizuara ose rilidhje të paautorizuara). Sasia e energjisë që kërkohet si dëm ekonomik përcaktohet sipas një table standardë kategorish të matësve dhe konsumatorëve, e cila përlllogarit konsumet mesatare për një periudhë të caktuar (6 muaj), duke i lidhur ato me llojin e matësit dhe kategorinë e përdoruesit. Kjo sasi shprehet në kWh dhe përfaqëson vlerën e energjisë së konsumuar pa regjistrim të ligjshëm. Llogaritja e kundërvleftës në lekë të dëmit ekonomik bëhet duke shumëzuar sasinë e energjisë së përlllogaritur me çmimin, i cili përfshin komponentë të ndryshëm të kostos së energjisë: (i) çmimin mesatar të energjisë aktive për njësi kWh të blerë për mbulimin e humbjeve nga OSSH sh.a.; (ii) kostot e transmetimit; dhe (iii) kostot e rrjetit në nivelin ku është lidhur përdoruesi i rrjetit. Kjo shumë, e paraqitur si kundërvlera monetare në faturë, pasqyron dëmin ekonomik real të shkaktuar dhe përfshihet në faturë si detyrim i përdoruesit ndaj OSSH sh.a..

Në bazë të kësaj metodologjie, OSSH sh.a. siguron edhe njoftimin e konsumatorit dhe furnizuesit për faturën e dëmit ekonomik brenda ciklit të faturimit (30 ditë) dhe ka të drejtë të kërkojë pagesën e shumës në përputhje me kushtet e kontratës dhe legjislacionin në fuqi. Konsumatorit i njihet e drejta për të paraqitur ankesë ndaj faturës së vendosur në rast mosdakordësie ose shkeljeje të rregullave procedurale, si pranë OSSH-së ashtu edhe pranë ERE-s.

Gjatë vitit 2025, ERE ka trajtuar 12 ankesa që lidhen me dëmin ekonomik, të cilat përbëjnë rreth 7.5% të totalit të ankesave të trajtuara nga ERE. Ky numër paraqet një ulje të ndjeshme krahasuar me vitin e kaluar, kur u regjistruan 21 ankesa për dëm ekonomik. Ankesat janë paraqitur kryesisht nga konsumatorë familjarë, të cilët kanë pretenduar dëm ekonomik si pasojë e faturimeve ose penaliteteve të aplikuara. Nga totali i rasteve të shqyrtuara, vetëm në 2 ankesa ka rezultuar se dëmi ekonomik është faturuar gabimisht nga ana e OSSH sh.a. dhe është proceduar me anulimin e tij. Tendenda vjetore tregon një rënie të numrit të ankesave për dëm ekonomik gjatë vitit 2025. Për 5

nga këto raste, ERE ka konkluduar se aplikimi i dëmit ekonomik ka qenë në përputhje me Metodologjinë e miratuar nga ERE për këtë qëllim. Sa i përket 5 ankesave të tjera, ERE ka vijuar hetimin e thelluar me qëllim kryerjen e të gjitha verifikimeve të nevojshme apo edhe dokumentimin e plotë të procedurave të ndjekura me qëllim konstatimin dhe faturimin e dëmit ekonomik.

E njëjta panoramë vihet re edhe tek të dhënat e përcjella nga shoqëria OSSH sh.a.. Në total, gjatë vitit 2025, rezultojnë 344 raste (kontrata) të faturuara për dëm ekonomik. Ndërkohë, gjatë vitit 2024 numri i rasteve ka qenë 507 kontrata të faturuara me dëm ekonomik. Pasqyra e shpërndarjes territoriale tregon një përqëndrim të theksuar të dëmit ekonomik në disa zona specifike. Veçanërisht, qyteti i Shkodrës paraqitet si zona me ndikimin më të madh në totalin e dëmit ekonomik, duke përfaqësuar rreth 38% të energjisë së faturuar si dëm, me 130 raste.

Shkaqet kryesore që kanë çuar në paraqitjen e ankesave për dëm ekonomik, lidhen kryesisht me mospranimin nga ana e konsumatorëve të vlerës së faturuar të dëmit ekonomik, si dhe me mungesën e prezencës së konsumatorit në momentin e konstatimit dhe vendosjes së këtij dëmi. Në shumicën e rasteve, konsumatorët kanë kundërshtuar mënyrën e përlogaritjes së dëmit ekonomik, duke e konsideruar vlerën e faturuar si të lartë dhe të pajustificuar. Gjithashtu, mosprezenca e konsumatorëve gjatë kryerjes së verifikimeve nga ana e operatorit ka ndikuar në krijimin e mosmarrëveshjeve, pasi ata kanë pretenduar se nuk janë informuar në kohë për këto veprime. ERE në çdo rast verifikon që kur një konsumator i nënshtrohet procesit të verifikimit të matësit të lidhur me kontratën e tij, ose të jetë prezent gjatë verifikimit ose në mungesë, të jetë garantuar prezenca e forcave ligjzbatuese.

10.3 Ankesat për vlera referuese

Vlera referuese është një mekanizëm i përkohshëm faturimi që aplikohet në rastet kur të dhënat reale të matjes së energjisë elektrike nuk janë të disponueshme ose nuk mund të aksesohen për një periudhë më të gjatë se një muaj. Kjo situatë konstatohet pas njoftimit zyrtar të Furnizuesit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) dhe lidhet, ndër të tjera, me raste kur matësi është i dëmtuar, jashtë funksionit teknik, nuk regjistron saktë konsumin ose kur mungon aksesit në të dhënat e matjes për shkak të mosfunksionimit të sistemit të leximit apo aksesit në leximin e të dhënave në vend.

Në përputhje me Metodologjinë e miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 104, datë 23.06.2016, i ndryshuar, vlera referuese përlogaritet duke marrë si bazë konsumin e energjisë elektrike të të njëjtit muaj të vitit paraardhës. Faturimi mbi këtë bazë ka karakter të përkohshëm dhe nuk mund të aplikohet për një periudhë më të gjatë se tre muaj. Brenda këtij afati, OSSH sh.a. është e detyruar të eliminojë shkakun e mosfunksionimit, të riparojë ose zëvendësojë matësin dhe të realizojë faturimin përfundimtar mbi bazën e të dhënave reale të konsumit të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2025, në ERE janë paraqitur 9 ankesa lidhur me faturimin mbi bazën e vlerës referuese. Këto ankesa kanë të bëjnë me faturime të aplikuara gjatë viteve 2022 – 2025, dhe në shumicën e rasteve lidhen me mungesë aksesit në të dhënat e matjes ose mosfunksionim të matësit të energjisë elektrike. Nga totali i 9 ankesave të trajtuara, 5 raste u sistemuan pas verifikimeve dhe ndërhyrjes së ERE-s, duke siguruar që për këta konsumatorë të lëshohet fatura sistemuese për korrigjimin e faturimeve të pasakta.

Sistemimi në vetvete është parim i vetë metodologjisë e cila parashikon se, periudha e faturimit me vlerë referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj. Gjithashtu, është përgjegjësi e furnizuesit të lëshojë faturën sistemuese, të bazuar në të dhënat reale të matësit, kur është e mundur të gjenerohen. Në raste të tjera, vlera referuese është anuluar, pasi është konstatuar se është aplikuar gabimisht për periudha më të gjata se ajo 3 mujore e lejuar nga Metodologjia e miratuar nga ERE.

Gjatë vitit 2025, në zbatim të metodologjisë së sipërcituar, FSHU sh.a. ka trajtuar 1,231 ankesa për aplikimin e vlerave referuese në konsumatorë.

10.4 Ankesat për Lidhje të Re

Kur një konsumator apo aplikant kërkon një lidhje të re me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, Rregullorja për lidhjet e reja në rrjetin e shpërndarjes e miratuar nga ERE për këtë qëllim, përcakton se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) duhet të vlerësojë kërkesën në përputhje me kriteret teknike, afatet, dhe procedurat. Refuzimi i një kërkesë për lidhje të re ndodh vetëm në rastet kur aplikanti rezulton debitor, nuk plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në rregullore, nuk siguron akses në objekt për vlerësimin teknik, ose kur ka mungesa të dokumentacionit të nevojshëm sipas procedurave të parashikuara. Refuzimi, gjithashtu mund të lidhet me mosrespektimin e kodit të matjes ose të sigurisë elektrike, nga ana e konsumatorit si dhe me mungesën e përputhshmërisë me standardet e rrjetit të shpërndarjes.

Referuar ankesave të adresuara në ERE, konsumatorët ose aplikantët adresojnë ankesë në drejtim të mosmarrjes së një përgjigjeje pozitive për lidhjen e re, duke pretenduar se refuzimi është bërë në mënyrë jo transparente, jashtë afateve kohore të parashikuara, ose pa një arsyetim të qartë dhe objektiv. Rastet e tilla zakonisht përfshijnë edhe mosinformim të mjaftueshëm mbi arsyet e refuzimit, raste në të cilat ERE ka kërkuar nga OSSH sh.a. marrjen e masave për informimin e konsumatorit si dhe garantimin e aksesit në rrjet për aplikantët që kanë plotësuar kriteret ligjore. Gjatë vitit 2025, në ERE janë regjistruar vetëm 6 ankesa për mosmiratim ose vonesë të miratimit të lidhjes së re kundrejt 132 ankesave të regjistruara në OSSH sh.a.. Nga këto ankesa 3 janë mbyllur, pasi është dokumentuar nga OSSH sh.a. që konsumatori nuk ka plotësuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm, ndërsa për 2 prej tyre, është proceduar me miratimin e lidhjes së re. Vetëm 1 ankesë e regjistruar në javët e fundit të vitit ka qenë në proces deri në dhjetor 2025. Gjatë shqyrtimit të këtyre rasteve ka rezultuar se problematika kryesore e evidentuar gjatë këtij viti ka qenë mungesa e informacionit në lidhje me ecurinë e aplikimit nga ana e konsumatorit duke pretenduar vonesa në trajtimin e kërkesave nga ana e OSSH sh.a..

ERE do të monitorojë gjatë vitit 2026, ecurinë e procesit të digjitalizimit të aplikimeve për lidhje të reja në rrjetin e shpërndarjes, me qëllim vlerësimin e performancës, procedurave, afateve dhe dhënien e rekomandimeve të nevojshme, në përputhje me gjetjet dhe vlerësimet e monitorimit.

Në një panoramë më të përgjithshme, referuar të dhënave të përcjella nga FSHU sh.a., rezulton se gjatë vitit 2025 numri i aplikimeve për të cilat është hapur kontrata në sistemin e faturimit është 25,960. Po ashtu, nga ana e operatorit të rrjetit të shpërndarjes, OSSH sh.a., rezulton se gjatë vitit 2025 ka patur gjithsej 20,629 aplikime për lidhje të reja në rrjetin e shpërndarjes, referuar aplikimeve të kryera për periudhën janar – dhjetor 2025, nga të cilat 19,811 i përkasin kategorisë TU dhe 818 kategorisë TM, çka tregon një dominim të qartë të kërkesës nga përdoruesit e tensionit të ulët. Rajoni i Tiranës kryeson ndjeshëm për nga numri i lidhjeve të reja me 6,723 lidhje, i ndjekur nga Durrësi me 3,479 dhe Shkodra me 1,980 lidhje.

10.5 Ankesat për mbifaturim

Ankesat për mbifaturim lidhen me rastet kur konsumatori është faturuar për më shumë energji sesa ajo që ka përdorur realisht. Gjatë vitit 2025, rezultojnë 43 ankesa për mbifaturim të cilat zënë rreth 26.7 % të totalit të ankesave të trajtuara. Rezulton se për 16 raste, ankesa është pranuar dhe është proceduar me korrigjimin e tyre, ndërsa për 19 raste të tjera, të cilat përfshijnë ato të dokumentuara nga FSHU sh.a. si dhe rastet kur ankesat nuk janë paraqitur brenda afatit, kërkesa nuk është miratuar dhe ankesat e konsumatorëve nuk janë gjetur të drejta. Ankesat e tjera, 8 të tilla, janë adresuar në javët e fundit të muajit dhjetor dhe kanë rezultuar në proces shqyrtimi, që shpesh kërkon korrespondenca dhe seanca dëgjimore teknike për të kuptuar rrethanat e qarta të problematikës.

10.6. Ankesa për keqtarifimin

Ankesat për keq-tarifim i referohen situatave kur konsumatorët pretendojnë se çmimi i faturuar për energjinë elektrike nuk përputhet me çmimet dhe tarifat e miratuara nga ERE për kategorinë së cilës i përket konsumatori apo periudhën përkatëse. Kur konsumatorët paraqesin një ankesë të tillë, ata pretendojnë se furnizuesi ka faturuar një çmim të energjisë që nuk përputhet me vlerat e përcaktuara nga ERE, duke aplikuar një çmim më të lartë sesa ai i miratuar për kategorinë e tyre, mosndarjen e tarifave sipas niveleve të konsumit (siç është çmimi bazë dhe çmimi në orar pik apo ai për fashën e konsumit deri në 700 kWh në muaj) apo edhe mbi aplikimin e çmimit për energjinë aktive apo atë reaktive.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 72, datë 15.04.2024, ka miratuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike për kategorinë e klientëve furra buke dhe/ose prodhim mielli, me qëllim plotësimin e kriterëve specifike për çdo kategori konsumatorësh. Në disa raste, ankesat lidhen me keqtarifimin për shkak të pretendimeve të konsumatorëve se i përkasin një kategorie të ndryshme nga ajo e çmimit të aplikuar. Pas verifikimeve nga ERE, një pjesë e këtyre ankesave janë zgjidhur në favor të konsumatorëve duke çuar në korrigjimin e çmimit të aplikuar sipas kategorive të miratuara nga ERE.

Gjatë vitit 2025, në ERE janë regjistruar gjithsej 11 ankesa për korrigjimin e çmimit të aplikuar, që përbëjnë rreth 6.8% të totalit të ankesave të adresuara, 5 nga këto ankesa janë gjetur të drejta dhe ERE ka vendosur që FSHU sh.a. të procedojë me sistemimin e tyre. Nga ana e OSSH sh.a. janë ndërmarrë masat e nevojshme për trajtimin e këtyre ankesave nëpërmjet verifikimeve në terren, me qëllim sigurimin e një faturimi të saktë dhe të drejtë nga furnizuesi.

10.7. Ankesa për keqfaturim

Keqfaturimi i energjisë elektrike konstatohet kur konsumatorët marrin fatura që nuk përputhen me konsumin e tyre real, zakonisht si pasojë e leximeve të gabuara të matësit të energjisë apo edhe përcjelljes së të dhënave të matjes për periudha më të gjata se ato 30 ditore dhe në disa raste edhe përlllogaritjen e gabuar të faturimit për ambjentet e përbashkëta, konsumi i të cilave në disa raste ka rezultuar i pa shpërndarë në mënyrë proporcionale. Gjatë vitit 2025, në ERE janë paraqitur 16 ankesa me objekt keqfaturim, ku ERE ka vijuar komunikimin shkresor me të licensuarit me qëllim zgjidhjen e tyre, ku 6 prej këtyre ankesa janë gjetur të drejta dhe ERE ka urdhëruar sistemimin e tyre.

10.8. Ankesa të Ndryshme

Përveç ankesave që lidhen drejtpërdrejtë me tarifimin dhe faturimin e energjisë elektrike, gjatë vitit raportues ERE ka trajtuar edhe një gamë tjetër ankesash, të cilat prekin aspekte të marrëdhënies së konsumatorit me operatorët e tregut, si cilësia e shërbimit, saktësi e procesit të matjes, transparenca kontraktore dhe ligjshmëria e marrëdhënieve juridike ndërmjet palëve.

Një peshë të veçantë zënë ankesat që lidhen me matjen jashtë kushteve teknike, ku konsumatorët pretendojnë për funksionim jo të saktë të aparateve matëse, mosregjistrim korrekt të konsumit apo defekte teknike të matësit. Një tjetër grup ankesash lidhet me modifikim të panjoftuar të titullarit të kontratës së funizimit, duke regjistruar në shumicën e rasteve qiramarrësin e një ambjenti në përdorim si titullar, pa njoftuar qiradhënësin për këtë veprim. ERE i ka kërkuar të licensuarit që në çdo rast të njoftojë titullarin e kontratës për çdo ndryshim që afekton kontratën e furnizimit.

Gjithashtu, gjatë vitit janë adresuar ankesa që lidhen me moskreditimin e pagesave të kryera nga konsumatorët, kur pagesat nuk janë reflektuar në mënyrë të saktë në faturat pasuese, duke krijuar detyrime financiare të pajustificuara. Një kategori tjetër përfshin ankesat për kolaudimin e aparatit matës, në rastet kur konsumatorët kërkojnë verifikim zyrtar të saktësisë dhe funksionimit të pajisjes matëse, për shkak të dyshimeve mbi korrektësinë e regjistrimit të konsumit të energjisë elektrike. Së fundmi, janë adresuar edhe ankesa që lidhen me kontrata fiktive, ku konsumatorët

ngrenë pretendime për mungesë të një kontrate të vlefshme ose pasaktësi në të dhënat kontraktore. Duke vlerësuar rëndësinë e transparencës dhe sigurisë juridike në marrëdhënien kontraktore ndërmjet konsumatorit dhe subjekteve të licencuara, ERE i ka kërkuar të licencuarit përgjegjës që në çdo rast që një konsumator adresohet për çfarëdo problematike pranë furnizuesit, të përditësojnë të dhënat e tyre kontraktore, me qëllim shmangien e problematikave të ngjashme në të ardhmen.

10.9. Seancat Dëgjimore dhe Efikasiteti

Në kuadër të veprimatrisë së tij, si entiteti me instrumentat e nevojshëm ligjorë për zgjidhjen alternative e pa kosto të ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike, ERE luan një rol të rëndësishëm. Në këtë kontekst, Rregullorja për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve dhe Trajtimin e Ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike, e miratuar nga ERE, përcakton kushtet, parimet dhe procedurat për trajtimin e ankesave të paraqitura nga konsumatorët, si dhe mënyrën e zgjidhjes së konfliktëve mes konsumatorëve dhe subjekteve të licencuar. Sipas kësaj Rregulloreje, qëllimi kryesor i procedurave të trajtimit të ankesave është që të ofrojë një mekanizëm të qartë dhe të drejtë për adresimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke siguruar në të njëjtën kohë respektimin e të drejtave të të gjitha palëve dhe qëndrimin në përputhje me legjislacionin e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Seancat dëgjimore janë një instrument kyç brenda këtij mekanizmi. Ato shërbejnë si një dritare dialogu midis palëve në konflikt, konsumatorit dhe subjektit të licencuar, ku secila palë ka mundësinë të paraqesë argumentet, provat dhe shpjegimet e saj para organit rregullator.

Gjatë vitit 2025, ERE ka zhvilluar rreth 40 seanca dëgjimore, të cilat kanë shërbyer si një instrument i rëndësishëm për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve. Seancat janë zhvilluar me praninë e palëve të përfshira dhe janë vlerësuar si një mënyrë efektive për të adresuar çështje të ndryshme të ngritura nga konsumatorët, veçanërisht në rastet kur dokumentacioni i paplotë ka shkaktuar vonesa në shqyrtimin përfundimtar të ankesave. Përmes këtij mekanizmi, ERE ka mundur që palët të japin shpjegime të drejtpërdrejta dhe të paraqesin prova shtesë, duke lehtësuar procesin e vendimmarrjes dhe duke rritur transparencën dhe llogaridhënien në trajtimin e ankesave.

10.10. Veprimtaria e FSHU sh.a.

Trajtimi efektiv i ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve është një komponent kyç i ofrimit të një shërbimi të besueshëm dhe të drejtë nga çdo furnizues që e ofron këtë shërbim në Republikën e Shqipërisë e po ashtu në mënyrë të veçantë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a.) në cilësinë e furnizuesit me nurmin më të madh të konsumatorëve të furnizuar

10.10.1. Kërkesat dhe Ankesat në FSHU sh.a.

Referuar Standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit, të miratuara me vendimin nr. 60, datë 25.02.2021 të Bordit të ERE-s, FSHU sh.a. ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për pranimin, rregjistrimin, kategorizimin dhe zgjidhjen e çdo ankese apo kërkesë të klientit, duke garantuar që çdo shqetësim trajtohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore.


FSHU sh.a. ka detyrimin të ofrojë një komunikim të qartë dhe të rregullt me klientin, duke informuar për procesin e trajtimit të ankesës, masat e ndërmarra dhe veprimet korrigjuese nëse ka. Kjo veprimtari është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të furnizimit dhe për sigurimin e besueshmërisë së marrëdhënive midis klientëve dhe operatorit. Standardet e parashikuara në rregulloren e sipërcituar, përcaktojnë gjithashtu se FSHU sh.a. duhet të monitorojë dhe analizojë shkaqet kryesore të ankesave, të identifikojë problemet që përsëriten dhe të ndërmarrë masa për parandalimin e situatave të ngjashme në të ardhmen, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e vazhdueshëm të

shërbimit.

ERE ka analizuar ankesat dhe kërkesat e trajtuara nga FSHU sh.a. gjatë periudhës vjetore, duke vlerësuar përputhshmërinë me standardet e miratuara nga legjislacioni në fuqi, natyrën e shqetësimeve të konsumatorëve dhe efektivitetin e masave të ndërmarra nga furnizuesi për adresimin e tyre. Nisur nga raportimet e këtij viti, rezulton se FSHU sh.a. ka bërë për herë të parë një ndarje evidente midis praktikave që ka trajtuar si kërkesa dhe atyre të regjistruara me statusin e ankesës. Gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2025, FSHU sh.a. ka trajtuar gjithsej 125,250 ankesa dhe kërkesa të regjistruara nga klientët fundorë, si një detyrim që buron nga kërkesat e Rregullores për standardet e trajtimit të ankesave nga të licencuarit në furnizim. Nga kjo analizë rezulton se pjesën më të madhe të çështjeve të adresuara në FSHU sh.a. e zenë kërkesat që lidhen kryesisht me ndryshimin e të dhënave të kontratës, kërkesa për verifikimin e matësit si dhe kërkesa që lidhen me cilësinë e shërbimit, që në total janë 106,307 kërkesa kundrejt 18,943 ankesave të trajtuara. Referuar ankesave dhe kërkesave totale të regjistruara gjatë vitit 2024 në masën 133,706, rezulton se ka një rënie të numrit të ankesave/kërkesave të regjistruara gjatë vitit 2025, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Ankesa/Kërkesa FSHU SH.A/OSSH SH.A..		
Të ardhura (NR)	2024	2025
Ankesa për pagesa/kreditime	355	215
Ankesa për faturim	21,490	18,728
Kërkesa: Ndryshim i të dhënave të kontratës	71,294	62,836
Kërkesa: Cilësi shërbimi	2,626	2,934
Kërkesa: Meter reeated complaints	37,941	40,537
GRAND TOTAL	133,706	125,250

Analiza e evidencës së raportuar nga ana e FSHU sh.a. tregon se ndërveprimi i konsumatorëve me furnizuesin dominohet nga kërkesa administrative dhe kontraktore, ndërsa ankesat në kuptimin e mirëfilltë të kontestimit përbëjnë një pjesë më të kufizuar të totalit të regjistruar gjatë vitit 2025.



Rezulton se kërkesat për ndryshime në të dhënat e kontratës përbëjnë kategorinë kryesore, me 62,836 raste, kundrejt 71,294 kërkesave të regjistruara në të njëjtën kategori gjatë vitit 2024, duke zënë pjesën më të madhe të volumit total të rasteve të trajtuara nga FSHU sh.a. Brenda kësaj kategorie, kërkesat për saktësim të të dhënave kontraktore, ndryshime të emrit familjar dhe ndryshim të përdoruesit të pronës përfaqësojnë peshën më të lartë, çka reflekton një nevojë të vazhdueshme për korrigjim dhe përditësim të të dhënave të

klientëve në marrëdhënien kontraktore me furnizuesin. Pasaktësitë në të dhënat kontraktore ndikojnë në korrektësinë e faturimit, në ushtrimin e të drejtave kontraktore dhe në përgjegjësitë ligjore që rrjedhin nga kontrata e furnizimit, e për këtë qëllim ERE edhe gjatë vitit 2025 ka kërkuar

nga FSHU që në çdo rast të informojë konsumatorët mbi detyrimet e tyre ligjore për përfitësim të të dhënave të kontratave të furnizimit, qoftë edhe me iniciativën e tyre.

Ndërkohë, 18,728 ankesat për faturimin dhe 215 ankesat për pagesa/kreditime, megjithëse rezultojnë në numra më të ulëta krahasuar me kërkesat administrative, përbëjnë një kategori tjetër me ndjeshmëri për konsumatorin, pasi lidhen drejtpërdrejt me saktësinë e faturimit dhe barrën financiare që u ngarkohet konsumatorëve.

Raportit ankesa-kërkesa, nga të dhënat e vitit 2025, konfirmon se veprimtaria e FSHU sh.a. në trajtimin e ndërveprimeve me klientët karakterizohet nga më shumë se gjysma e këtyre praktikave që lidhen me saktësimin e të dhënave të kontratave. Megjithatë, volumni i lartë i kërkesave për ndryshime kontraktore nënvizon nevojën për përmirësim të cilësisë së rregjistrimit fillestar të të dhënave, forcim të mekanizmave të vetëkontrollit nga ana e furnizuesit dhe rritje të informimit të konsumatorëve, me qëllim uljen e ngarkesës administrative.

Gjatë vitit 2025, analiza krahasimore ndërmjet ankesave dhe kërkesave të ardhura dhe atyre të zgjidhura nga të licencuarit tregon nivele të ndryshme zgjidhshmërie sipas natyrës së çështjes dhe kompleksitetit të trajtimit, me ndikim të drejtpërdrejtë në përvojën e konsumatorit dhe në eficiencën e mekanizmave të shërbimit ndaj klientit. Për kategoritë e administruara nga FSHU sh.a., rezulton se ankesat për pagesa dhe kreditime janë trajtuar me një nivel zgjidhshmërie në raportin 215 ankesa për kreditime të rregjistruara kundrejt 184 prej tyre të zgjidhura brenda vitit kalendarik.

Në të njëjtën kohë, kërkesat për ndryshime në të dhënat e kontratës, të cilat përbëjnë edhe kategorinë me volumnin më të lartë të rasteve të rregjistruara, paraqesin nivelin më të lartë të zgjidhshmërisë, ku nga 62,836 kërkesa, janë adresuar 59,817 prej tyre. Sa i përket kategorive të lidhura me aspektet teknike të shërbimit, që çdo konsumator adreson pranë FSHU sh.a. në cilësinë e furnizuesit me të cilin ka marrëdhënien kontraktuale, kërkesat për çështje të cilësisë së shërbimit të furnizimit, paraqesin një nivel zgjidhshmërie që rezulton në raportin 2934 të rregjistruara kundrejt 57 të trajtuara.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar gjithsej 8,453 sisteme faturimi me statusin “të aprovuara”, të lidhura me fatura të gjeneruara gjatë vitit 2025 dhe me ankesa të rregjistruara brenda të njëjtë vit.

Gjatë vitit 2025, FSHU sh.a. ka trajtuar një total prej 203 rasteve të raportuara nga institucione të ndryshme publike lidhur me shkeljen e të drejtave të konsumatorëve dhe zbatimin e vendimeve rregullatore. Ndërveprimi më i madh, sigurisht që është regjistruar me ERE, duke pasur një pjesëmarrje dominuese në raportimin e problematikave të konsumatorëve. Një numër i konsiderueshëm rastesh është referuar gjithashtu nga Avokati i Popullit (60 raste), ndërsa institucionet e tjera si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (15 raste), Prefekturat (12 raste) dhe Bashkitë e ndryshme (6 raste) kanë kontribuar në identifikimin e çështjeve të konsumatorëve.

10.10.2. Shërbimi i Konsumatorit

Gjatë vitit 2025 i është ofruar shërbim një numri prej 1,377,204 konsumatorësh prej të cilëve 1,180,012 janë konsumatorë familjarë dhe gati 197 mijë konsumatorë jofamiljarë.

Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga “Plani i masave për Furnizuesin e Shërbimit Universal për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, miratuar me vendimin e ERE nr. 201, datë 03.09.2018, i ndryshuar, gjatë vitit raportues rezulton se Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) raporton se ka ndërmarrë disa masa organizative dhe teknike në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj konsumatorëve. Nga raportimet rezulton gjithashtu se FSHU sh.a. ka ndërmarrë masa për përmirësimin e informimit të konsumatorëve në ambientet ku ofrohet shërbimi i klientit, duke afishuar informacion të përfitësuar mbi afatet, procedurat, të

drejtat e ankimimit dhe shërbimet e ofruara.

FSHU sh.a., po ashtu ka garantuar informimin e klientëve mbi trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, përfshirë Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit si dhe sistemet elektronike të menaxhimit të ankesave, duke njoftuar klientët si në rastet e pranimit, ashtu edhe të refuzimit të kërkesave të tyre. Gjatë vitit, është vënë theks i veçantë në rritjen e transparencës dhe aksesueshmërisë së shërbimit, përmes përmirësimit të platformave të komunikimit elektronik dhe përdorimit të sistemeve të automatizuara për informimin e klientëve mbi statusin e ankesave. Paralelisht, FSHU sh.a. deklaron se, ka zhvilluar trajnime për stafin e Qendrave të Kujdesit ndaj Klientit, me fokus në komunikimin me konsumatorin dhe zbatimin e procedurave të trajtimit të ankesave, si dhe ka aplikuar mekanizma monitorimi të cilësisë së shërbimit përmes kontakteve të drejtpërdrejta me klientët.

Në funksion të trajtimit korrekt të çështjeve që lidhen me faturimin, tarifimin dhe marrëdhëniet kontraktore, është vijuar bashkëpunimi me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes. Po ashtu janë përmirësuar edhe elementët logjistikë që lidhen me aksesin fizik të konsumatorëve, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara, në Qendrat e Kujdesit ndaj Klientit. Në tërësi, masat e raportuara synojnë forcimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe përmirësimin e standardeve të shërbimit universal, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

10.10.3. FSHU sh.a. si Furnizues i Mundësisë së Fundit

Edhe gjatë vitit 2025, FSHU sh.a. ka vijuar furnizimin e klientëve në kushtet e mundësisë së fundit si FMF, duke garantuar energji elektrike për një total prej rreth 3,500 klientësh, referuar muajt dhjetor 2025. Numri i klientëve të transferuar në FMF ka qëndruar relativisht konstant gjatë vitit, me rritje të lehta në muajt qershor (3708 klientësh) dhe korrik (3729 klientësh), ndërsa në fund të vitit, veçanërisht në muajt nëntor dhe dhjetor, është shënuar një ulje e numrit të klientëve nga 3450 në 3482 klientë. Ndarja sipas nivelit të tensionit tregon se shumica e klientëve furnizohen në nivelin 6/10/20 kV, ndërsa një pjesë më e vogël furnizohet në nivelin 35 kV. Kjo kategori më shumti e siguron furnizimin nga Furnizuesit në treg të lirë, e përfiton shërbimin e mundësisë së fundit vetëm në kushtet e parashikuara në kuadrin ligjit në fuqi, për një periudhë jo më të gjatë se 2 mujore kur nuk arrin të marrë më shërbimin nga furnizuesi aktual dhe nuk arrin të gjejë një furnizues të ri në treg të lirë. Përgjatë vitit është në përputhje me parashikimet e VKM nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, këtë shërbim vijnë ta marrin të pandërprerë kategoritë e konsumatorëve, subjektet shtetërore, që sigurojnë shërbimin e shëndetit publik (spitalet dhe qendrat e urgjencës) shoqëri, që sigurojnë furnizimin me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe institucione shtetërore të ekzekutimit të vendimeve penale dhe institucione shtetërore, të cilat mbulojnë sigurinë kombëtare dhe rendin publik.

Gjatë vitit 2025, ERE zhvilloi sërish procedurën për përzgjedhjen e Furnizuesit të mundësisë së fundit, duke shpallur çeljen e konkursit me kriteret e afatet e parashikuara në legjislacionin në fuqi. Në fund të afatit rezultoi se vetëm një aplikues, konkretisht FSHU sh.a. aplikoi për marrjen e statusit të FMF, ç’ka në kuptim të “Rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 141, datë 15.06.2021, përbënte shkak për mbylljen e procedurës pa fitues. Në të tilla rrethana edhe në vijim iu la sërish Furnizuesit të shërbimit universal funksioni i Furnizuesit të mundësisë së Fundit, në përputhje me parashikimet e VKM nr. 449, datë 15.6.2016 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”.

10.10.4. Konsumatorët dhe Furnizuesit në Treg të Lirë

Të licencuarit që operojnë në tregun e lirë kanë përgjegjësinë për të ofruar shërbime të qëndrueshme dhe procedura të besueshme të trajtimit të konsumatorëve, duke përfshirë raportimin

periodik të ankesave dhe kërkesave. Në këtë kuadër, ERE ndjek ecurinë dhe kryen verifikim të vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara, për të garantuar standard të lartë shërbimi, shmangien e çdo forme diskriminimi dhe adresimin e çdo shqetësimi që mund të lindë gjatë furnizimit. Rregullorja për standardet e trajtimit të ankesave si dhe ajo mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit parashikon që furnizuesit duhet të dorëzojnë raporte të detajuara çdo tre muaj, duke përfshirë informacion mbi natyrën e ankesave, kohën e trajtimit dhe zgjidhjet e dhëna, masat e marra për dhënien e shërbimit cilësor si dhe rritjen e veprimtarisë informuese të konsumatorëve. Ky mekanizëm lejon që ERE të bëjë vlerësim të vazhdueshëm të performancës së operatorëve, identifikimin e problematikave dhe përcaktimin e masave për përmirësimin e shërbimeve.

Rezulton se gjatë vitit 2025 kanë qenë 17 furnizues që kanë ushtruar shërbimin e furnizimit (12 për klientë të lidhur në Shpërndarje dhe 5 për klientë të lidhur në transmetim) në 4,372 konsumatorë në total në treg të lirë, nga të cilët 4,331 të lidhur në Shpërndarje dhe 41 të lidhur në rrjetin e Transmetimit.

Gjatë vitit 2025 është evidentuar një rritje e numrit të furnizuesve që operojnë në tregun e lirë të energjisë elektrike. Konkretisht, numri i furnizuesve është rritur nga 13 në vitin 2024, në 17 në vitin 2025, duke shënuar një rritje prej 30.77%. Kjo rritje reflekton një zhvillim pozitiv të konkurrencës në treg, zgjerim të ofertës për konsumatorët dhe një interes më të lartë të subjekteve për të operuar në kushtet e tregut të liberalizuar të energjisë elektrike.

Nga ana e Operatorit të Shpërndarjes është bërë me dije se gjatë vitit 2025, numri i konsumatorëve që furnizohen në treg të lirë është 4,331, të kategorizuara sipas niveleve të tensionit dhe kategorive të konsumatorëve. Nga të dhënat rezulton se niveli i tensionit 10 kV përfaqëson nivelin dominues të konsumatorëve me 2,337 konsumatorë, që përbën rreth 54% të totalit, e ndjekur nga 1,886 konsumatorë (43.5%) në nivelin 20 kV. Rajonet me rritjen më të lartë të numrit të konsumatorëve në treg të lirë janë Tirana me 1,021 konsumatorë, ose rreth 24% e totalit, e ndjekur nga Durrësi (710), Korça (479), Gjirokastra (388) dhe Elbasani (366).

10.11. Standardet e Cilësisë në Rrjetin e Transmetimit

Standardet e cilësisë së transmetimit përfaqësojnë tërësinë e kërkesave teknike, rregullatore dhe operative që duhet të përmbushë sistemi i transmetimit të energjisë elektrike, me qëllim garantimin e një furnizimi të sigurt, të qëndrueshëm dhe me parametra teknike brenda kufijve të përcaktuar. Këto standarde lidhen kryesisht me elementë të tillë si vazhdimësia e furnizimit, niveli dhe stabiliteti i tensionit, frekuenca, besueshmëria e rrjetit, si dhe aftësia e sistemit për të përballuar ngarkesa, defekte apo situata të jashtëzakonshme pa shkaktuar ndërprerje të gjera apo dëmtime në pajisjet e përdoruesve. Në këtë kuadër, standardet e cilësisë së transmetimit kanë një rol thelbësor edhe nga pikëpamja rregullatore, pasi ato shërbejnë si instrument matës për vlerësimin e performancës së operatorit të transmetimit, për vendosjen e detyrimeve konkrete ligjore dhe kontraktuale, si dhe për nxitjen e investimeve që synojnë rritjen e besueshmërisë dhe efikasitetit të rrjetit. Për këtë qëllim është përgjegjësi e rregullatorit jo vetëm të përcaktojë kriteret bazë të treguesve të cilësisë së shërbimit të transmetimit por edhe të mbikëqyrë realizimin e tyre apo të shtrëngojë të licencuarit përgjegjës drejt përmirësimit të vazhdueshëm të tyre. Kështu, sa i përket standardeve të rrjetit të transmetimit të ato aktualë, rezultojnë si vijon:

Tabela e mëposhtme paraqet një pasqyrë të përmbledhur dhe të strukturuar të treguesve kryesorë të cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe performancës së sigurisë së rrjetit për vitin 2025. Në të janë përfshirë të dhënat vjetore mbi ndërprerjet e furnizimit, energjinë e pafurnizuar, cilësinë e frekuencës dhe të tensionit, si dhe respektimin e afateve procedurale për shërbimet ndaj përdoruesve të rrjetit. Gjatë vitit 2025, OST sh.a. ka përmbushur standardet e cilësisë së furnizimit të përcaktuara me Vendimin nr. 244, datë 02.12.2021 të Bordit të ERE-s.

Parametrat e Cilësisë së Furnizimit OST sh.a.	Njësia matëse	Vlerat e realizuara 2025	Treguesit e Cilësisë sipas Vendimit Nr. 244, datë 02.12.2021 të ERE
AIT (Koha mesatare e ndërprerjes)	Min	24.78 min	35 min
ENS (Energji e pafurnizuar)	MWh	339.143 MWh	467 MWh
FQ (Cilësia e frekuencës)	mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz
Koha e njoftimit mbi ndërprerjet e Planifikuara	Orë	72 orë	72 orë
Koha e përgjigjes për lidhjen e re	Ditë	41 ditë	Brenda 60 ditëve
SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve)	Min	26.65 min	100 min
VQ (Cilësia e Tensionit)		Brenda diapazonit: -10%; 0.90 pu 1.118.	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.
% e ankesave për cilësinë e tensionit		Nuk ka	0%

Tabela 37. Treguesit kryesorë të cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe performancës së sigurisë së rrjetit për vitin 2025

Treguesi AIT (koha mesatare e ndërprerjes) ka rezultuar për vitin 2025 ndjeshëm nën kufirin maksimal prej 35 minutash. ENS (energji e pafurnizuar), gjithashtu ka qenë nën kufirin e miratuar prej 467 MWh në bazë vjetore. Cilësia e frekuencës (FQ) është ruajtur gjatë vitit brenda diapazonit ± 200 mHz, ndërsa koha e njoftimit për ndërprerjet e planifikuara ka respektuar standardin prej 72 orësh.

SAIDI (indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve) ka qenë ndjeshëm nën kufirin maksimal prej 100 minutash, duke reflektuar një nivel të qëndrueshëm të performancës operacionale. Cilësia e tensionit (VQ) ka rezultuar brenda diapazonit të lejuar (-10% deri +11.8%), dhe gjatë vitit nuk janë regjistruar ankesa për cilësinë e tensionit.

Në përfundim, performanca e OST sh.a. për vitin 2025 vlerësohet në përputhje me standardet e miratuara të cilësisë së furnizimit, me një devijim të izoluar për vitin 2025 lidhur me afatin e trajtimit të kërkesave për lidhje të reja.

Gjatë 5 vjeçarit të fundit (2020–2025), siç paraqitet në tabelën e mëposhtme, performanca e furnizimit me energji elektrike në rrjetin e transmetimit është karakterizuar nga përmirësime të dukshme duke pasqyruar një reduktim të ndërprerjeve, krahasuar me vitin bazë 2020. Analiza e parametrave kryesorë tregon një menaxhim më të efektshëm të rrjetit dhe qëndrueshmëri në cilësinë e shërbimit për konsumatorët.

Krahasimi I Performancës së Rjetit të transmetimit (2020 - 2025)						
	2025	2024	2023	2022	2021	2020
AIT (Koha mesatare e ndërprerjes)	24.78 min	25.96 min	28.87 min	29.58 min	28.76 min	35 min
ENS (Energji e pafurnizuar)	339.143 MWh	365.997 MWh	383.687 MWh	392.731 MWh	433.035 MWh	463.53 MWh
FQ (Cilësia e frekuencës)	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz
Koha e njoftimit mbi ndërprerjet e Planifikuar	72 orë	72 orë	72 orë	72 orë	72 orë	72 orë
Koha e përgjigjes për lidhjen e re	41 ditë	25 ditë	25 ditë	26 ditë	32 ditë	60 ditë
SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve)	26.65 min	39.48 min	42.21 min	50.43 min	70.31 min	71 min
VQ (Cilësia e Tensionit)	Brenda diapazonit: -10%; 0.90 pu 1.118.	Brenda diapazonit: -10%; 0.90 pu 1.118.	Brenda diapazonit: -10%; 0.90 pu 1.118.	Brenda diapazonit: -10%; 0.90 pu 1.118.	Brenda diapazonit: -10%; 0.90 pu 1.118.	Brenda diapazonit: -10%; 0.90 pu 1.118.
% e ankesave për cilësinë e tensionit	Nuk ka	1 Ankesë	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Figura 82. Performanca e furnizimit me energji elektrike në rrjetin e transmetimit 2020 - 2025

Koha mesatare e ndërprerjes për vitin 2020 ishte 35 minuta. Gjatë pesë viteve vijuese, vihet re një përmirësim gradual, duke arritur në 24.78 minuta në vitin 2025, që përfaqëson një reduktim total prej rreth 10.22 minutash, ose rreth 29% ulje. Energjia totale e furnizuar ka pësuar një ulje progresive gjatë periudhës së analizuar. Nga 463.53 MWh në vitin 2020, ajo ka rënë në 339.143 MWh në vitin 2025, duke shënuar një rënie prej rreth 27%. Të gjithë vitet e periudhës 2020–2025 kanë ruajtur frekuencën brenda diapazonit të lejuar ± 200 mHz. Indeksi SAIDI ka shënuar një përmirësim të vazhdueshëm nga 71 minuta në vitin 2020 në 26.65 minuta në vitin 2025, një rënie prej 44.35 minutash (62%). Ky indikator tregon një reduktim të ndjeshëm të kohës që një konsumator mesatar është pa energji elektrike gjatë një viti. Tensioni ka mbetur brenda diapazonit të parashikuar (-10%; 0.90 pu – 1.118 pu) gjatë gjithë periudhës, duke reflektuar një nivel të lartë të stabilitetit të furnizimit.


10.12. Standardet e Matjes për Cilësinë e furnizimit dhe performancën në Rrjetin e Shpërndarjes

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 97/2021 ka miratuar Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes për vitin 2021. Nga ana e OSSH sh.a. janë përcjellë në ERE raportet periodike në lidhje me treguesit për cilësinë e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sikurse përcaktohet në Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar me vendimin nr. 181/2017 të ERE-s, ashtu si dhe vendimit nr. 97/2021, sa i përket vitit 2025. Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit së rrjetit të shpërndarjes mbeten të pandryshuara për vitin 2025 me treguesit në fuqi të miratuara me vendimin nr. 97/2021 të Bordit të ERE-s. Më poshtë paraqiten në formë tabelare treguesit e cilësisë së furnizimit në TL+TM+TU për vitin 2025:

Treguesit e Cilësisë së Furnizimit (TL+TM+TU)	Njësia Matëse	Vlerat e realizuara 2025		
a- Energjia e Pa- furnizuar (ENS)	MWh	33,873		
b- Cilësia e Frekuencës (FQ)		Kufiri nominal I operimit 49.8 - 50.2 Hz		
c- Cilësia e Tensionit (VQ)	V	Nominal	I Ulët	I Lartë
		230 V	N/A	N/A
		400 V	N/A	N/A
		6000 V	-10%	+10%
		10000V	-9%	+10%
		20000V	-6%	+8%
		35000V	-9%	+11%
		110000V	-6%	+7.3%
d- Koha e Nevojshme për Kërkesat për Lidhje të Reja	ditë			
0-10 kW TU		20		
10-20 kW TU		20		
21-50 kW TU		20		
51-100 kW TU		60		
TM		60		
e- Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Shpërndarjes	orë	72		
f- Indeksi i Kohëzgjatjes së Ndërprerjeve Mesatare (SAIDI)	orë	37.77		
g- Indeksi i Frekuencës së Ndërprerjeve Mesatare (SAIFI)	numër	22.62		
h- Koha e nevojshme për Riparimin e shërbimit pas një difekti në sistemin e shpërndarjes	orë	Tot Rrjetin Shpërnd urbane rurale		
TM+TU		1.64		
TM 35kV		1.54 1.96		
20 kV		1.27 1.61		
6-10 kV		2.32 2.86		
0.4 kV		0.95 1.11		
i- Koha e Nevojshme për kryerjen e kontrollit të sistemit të matjes me kërkesë të klientit	ditë	5		
j- Koha e Nevojshme për të rilidhur Klientëve të cilëve u është ndërprerë energjia elektrike	ditë	5		
k- Koha e Nevojshme për të Rilidhur Klientëve të cilëve u është ndërprerë Energjia Elektrike	orë	48		
l- Zgjidhja e Ankesave për Cilësinë e Tensionit	ditë	30		
m- Përqindja e Klientëve Aktualisht me Matës	%	99.90%		

Figura 83. Treguesit e cilësisë së furnizimit në TL+TM+TU për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike në rrjetin e shpërndarjes kanë shënuar përmirësime, duke rezultuar brenda kufijve të përcaktuar nga kuadri rregullator në fuqi, të tilla si: Energjia e pa-furnizuar (ENS) ka arritur vlerën 33,873 MWh, e cila është ndjeshëm më e ulët krahasuar me kufirin rregullator prej 51,246 MWh. Ky rezultat reflekton rritje të vazhdimësisë së furnizimit dhe reduktim të ndikimit të ndërprerjeve të konsumatorët. Indeksi i kohëzgjatjes së ndërprerjeve mesatare (SAIDI) është regjistruar në nivelin 37.77 orë, ndërsa indeksi i frekuencës së ndërprerjeve mesatare (SAIFI) në nivelin 22.62, duke qenë respektivisht më të ulëta se kufijtë e miratuar nga ERE. Këta tregues pasqyrojnë përmirësim të performancës operative.



Koha e nevojshme për riparimin e shërbimit pas defekteve në sistemin e shpërndarjes ka rezultuar më e ulët se kufijtë e përcaktuar për të gjitha nivelet e tensionit, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, siç pasqyrohet në tabelën më poshtë. Në tensionin e mesëm (TM) dhe të ulët (TU), koha mesatare e riparimit është regjistruar 1.64 orë, kundrejt kufirit rregullator prej 2.78 orësh, duke reflektuar reagim më të shpejtë dhe eficiencë më të lartë në menaxhimin e defekteve.

Vërehen se disa tregues që lidhen me nivelin e tensionit, duhet të përmirësohen në vijim. Kjo sepse një pjesë e investimeve të filluara nga ana e OSSH sh.a. në rrjetin e shpërndarjes që lidhen me këta tregues, janë në vijim dhe pritet të përfundojnë vitet e ardhshme. Investime të tilla si Nënstacioni 110/20 kV Fier, Kuçovë, Kafaraj, Akerni, Lanabregas, Shkodër 1, Lozhan etj, janë në projektet 3 vjeçare.

1. SAIFI (Indeksi i Frekuencës mesatare të ndërprerjeve)

Ky tregues, për vitin 2025 është (22.62) më i ulët se ai i vitit 2024 (27), e cila tregon një reduktim të numrit mesatar të ndërprerjeve për konsumatorët fundore.

2. SAIDI (Indeksi i Kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve)

Ky tregues, për vitin 2025 është (37.77) më i ulët se në vitin 2024 (45.12), fakt që tregon një përmirësim të kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve. Rezultatet e vitit 2025 konfirmojnë një përmirësim të disa treguesve të cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Krahasim i Performances se OSSH sh.a ne TL+TM+TU 3 mujori i I 2024-2025 Lidhur me Treguesit Kryesore SAIFI, SAIDI		
Treguesit e Cilësisë	2024	2025
SAIFI	26.99	22.62
SAIDI	45.12	37.77

10.13. Konsumatorët Vetëprodhues

Ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, parashikon mundësinë për konsumatorët e energjisë elektrike që të prodhojnë vetë energjinë e nevojshme për përdorim personal, duke kontribuar në uljen e kostove të faturës mujore dhe në rritjen e pavarësisë energjitike. Ky instrument ka për qëllim të nxisë përdorimin e energjisë nga burimet diellore dhe era, duke siguruar një zgjidhje të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin për konsumatorët. Sipas Udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3/2019, konsumatorët që kërkojnë të marrin statusin e vetëprodhuesit mund të instalojnë një kapacitet deri në 500 kW, i cili mund të përdoret për mbulimin e nevojave të tyre energjitike për konsum personal. Konsumatori ka të drejtë të injektojë energjinë e tepërt në rrjetin e shpërndarjes, duke kontribuar indirekt në efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit energjistik, por fokusi mbetet tek përfitimet dhe përdorimi i energjisë për nevojat e veta.

ERE ndjek zhvillimin e këtij segmenti, duke marrë të dhëna periodike OSSH sh.a.. Ky informacion paraqet numrin e konsumatorëve vetëprodhues, si dhe shpërndarjen e tyre sipas kategorive të konsumatorëve, duke mundësuar analizë të vazhdueshme të orientimit të konsumatorëve drejt energjisë së rinovueshme. Gjatë vitit 2025, OSSH sh.a. ka miratuar aplikimet për statusin e vetëprodhuesit për 1135 konsumatorë, nga 1,261 që kanë aplikuar, e cila përfaqëson një rritje prej 27.96 % krahasuar me vitin 2024 dhe e ka çuar numrin total të konsumatorëve me statusin e vetëprodhuesit në masën 3,551. Sa i përket konsumatorëve që kanë marrë statusin e vetëprodhuesit, rezulton se rreth 67 % e tyre janë të kategorisë private, 31% familjare dhe rreth 2% buxhetore/jobuxhetore. Kjo tendencë reflekton interesin e rritur të konsumatorëve për të

investuar në energji të rinovueshme dhe për të përdorur energjinë e prodhuar për nevoja personale, duke ulur varësinë nga furnizimi tradicional dhe ulur kostot e konsumit personal familjar apo jofamiljar qoftë ai.

Sipas kategorive të konsumatorëve, shpërndarja e statusit të vetëprodhuesve deri në fund të vitit 2025 rezulton si më poshtë:

- Institucionet publike (bashki, ministri, institucione arsimore): 69 vetëprodhues;

Konsumatorët sipas kategorisë



Jofamiljarët dhe familjarët përbëjnë shumicën dërrmuese të konsumatorëve.

- Familjarë: 1089 vetëprodhues;
- Institucionet jo-buxhetore (ujësjellësa, poliklinika, qendra shëndetësore etj.): 16 vetëprodhues; si dhe,
- Jofamiljarë: 2377 vetëprodhues.

Për më tepër, të dhënat historike tregojnë një rritje të qëndrueshme, dhe dëshmojnë vijimin e rritjes të numrit të konsumatorëve që kanë marrë statusin e vetëprodhuesit në 5 vjeçarin e fundit, nga 175 konsumatorë vetëprodhues në vitin 2021 në 1,135 konsumatorë të rinj në fund të vitit 2025.

Në vijim, për qëllime raportimi, është pasqyruar paraqitja grafike e numrit të konsumatorëve

Vetëprodhues sipas nivelit të tensionit 2025



vetëprodhues gjatë vitit 2025 sipas nivelit të tensionit, duke dhënë një pasqyrë të qartë të përqindjes dhe shpërndarjes së konsumatorëve që përdorin energji të rinovueshme për vetëkonsum.

Nga të dhënat e raportuara nga OSSH sh.a. vërehet se peshën më të madhe

të konsumatorëve vetëprodhues e zënë ato konsumatorë të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV, duke pasuar ato në nivel tensioni 20/35 kV, 6 kV dhe 10 kV. Kjo tregon një përqendrim më të madh të vetëprodhuesve në nivelin e tensionit 0.4 kV, ndërsa nivelet më të larta të tensionit kanë një numër më të vogël vetëprodhuesish.

11. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE

11.1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Ndër prioritetet e ERE-s është dhe mbetet përfaqësimi sa më dinjitoz dhe aktiv i punës së Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ato ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të rajonit dhe BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit dhe bashkëpunimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj.

Për vitin 2025, ERE ka vijuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë së Vjenës nëpërmjet ECRB dhe grupeve të punës të saj si ato të REMIT, Elektriciteti, Gazi dhe marrëdhëniet e konsumatorit apo dhe shoqatave si, Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë të Mesdheut (MEDREG); Shoqata Rajonale e Rregullatorëve të Energjisë (ERRA); Këshilli i Rregullatorëve Evropiane të Energjisë (CEER); Unioni Ndërkombëtar i Gazit (IGU); Unioni për Mesdheun (UfM); Observatori Mesdhetar i Energjisë (OME) etj. Gjatë vitit të kaluar i është kushtuar një rëndësi e veçantë pjesëmarrjes në konferenca, trajnime, seminare, takime, seminare dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare në shumë raste punonjës të ERE-s kanë qenë pjesëtarë në tryeza të ndryshme të organizuara nga këto shoqata po dhe tavolina të tjera po dhe duke marrë pjesë në panele për të prezantuar rolin e rregullatorit apo dhe sfidat që i dalin këtij të fundit në tranzicionin energjetik.

Përfaqësues të ERE-s janë kryesues të disa prej grupeve të punës të këtyre shoqatave apo organizmave apo dhe i task force të tyre të ngritura për çështje të veçanta.

11.2. Pjesëmarrja Aktive si Anëtare në Organizma Ndërkombëtare

ERE vijon të jetë anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA) e cila këtë vit ka përvjetorin e 25-të të themelimit dhe përmbledh 34 rregullatorë anëtarë me të drejta të plota si dhe 14 anëtarë vëzhgues të saj. Përgjatë vitit të kaluar ERE ka ndjekur rregullisht takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të saj, seminareve të presidentëve, takimeve të Komiteteve dhe grupeve të punës të përhershme të saj si dhe në konferencën e përvitshme të investimeve përgjatë muajit maj apo dhe seminareve të përbashkëta të ERRA me shoqatat e tjera si MEDREG dhe ECRB.

ERE është anëtare e MEDREG, e cila përfshin 29 Rregullatorë nga 23 vende të Mesdheut, të cilët përbëhen nga 9 rregullatorë të Bashkimit Evropian, 5 vendeve të Ballkanit dhe 9 të vendeve të Afrikës së Veriut. Është vijuar pjesëmarrja rregullisht dhe gjatë vitit 2025 në takimet e grupeve të punës përfshirë dhe drejtimin e grupit të punës së konsumatorit apo dhe marrjen pjesë aktive në grupet e punës së marrëdhënieve institucionale, atij për energjitë e rinovueshme, gazit, të grupit të punës së elektricitetit si dhe asambleve të përgjithshme të kësaj shoqate apo dhe seminareve të Presidentëve të organizuar nga kjo shoqatë. Një pjesë të rëndësishme të punës së kësaj shoqate ka zënë dhe trajnimet e Rregullatorëve me praktikantë të mira Evropiane apo dhe të vendeve të Evropës Juglindore.

ERE, ka po ashtu statusin e vëzhguesit pranë CEER (Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë), status i cili mundëson fuqizimin dhe marrjen e njohurive të stafit të ERE-s gjatë pjesëmarrjes në grupet e punës dhe takimeve të asamblesë së Përgjithshme apo konferencave që zhvillohen nga kjo e fundit.

ERE është pjesëmarrëse në takimet e UfM (Unioni për Mesdheun), i cili përbëhet nga 43 shtete anëtare, pjesë e Mesdheut dhe ka për qëllim të rrisë dhe forcojë bashkëpunimin rajonal si dhe implementimin e projekteve dhe iniciativave që do ti shërbenin rajonin. Në kuadër të bashkëpunimit në sektorin energjetik, UfM-së ka të hartuar platformën për sektorin e gazit natyror si dhe dy platforma të tjera në sektorin e energjisë elektrike, lidhur me burimet e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë në të cilat stafet e rregullatorëve shkëmbejnë eksperiencën midis tyre.

ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit të kaluar ka marrë pjesë në Forumin e përvitshëm të Energjisë Elektrike si dhe Forumin e Gazit apo dhe aktivitetet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë si forume të ndryshme apo dhe seminare.

Gjithashtu, ERE ka marrë pjesë në aktivitete duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatit e Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për vendimmarrjet të cilat i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës, me të cilët janë realizuar dhe takime për të përmirësuar vendimmarrjen. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës të ECRB-se dhe takimet plenare të kësaj të fundit.

Në Dhjetor të vitit 2022 në bashkëpunim dhe me rregullatorët e Italisë, Bosnje Hercegovinës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut është krijuar me qendër në Milano shkolla Ballkanike e Energjisë e cila ka për qëllim kryesor shkëmbimin e eksperiencave midis rregullatorëve. Përgjatë vitit 2025 janë zhvilluar seminare midis rregullatorëve të kësaj shkolle, aktivitete të cilat do të vijojnë dhe përgjatë vitit 2026 e në vijim.

Gjatë vitit të kaluar mori pjesë, në takimet e shoqatës RETA (Regulatory Energy Transition Accelerator) me seli në Paris e ngritur nga Rregullatorët, Shoqata e Burimeve të Rinovueshme IRENA dhe e financuar nga Banka Botërore e cila ka për qëllim organizimin e seminareve apo dhe tryezave të punës të përbashkëta midis Rregullatorëve për të mundësuar shkëmbimin e eksperiencave mbi tranzicionin energjetik apo dhe sfidat që i dalin Rregullatorëve në vijim për përballimin me sukses të këtij tranzicioni.

Në maj të vitit 2024 ERE u bë anëtare me të drejta të plota e shoqatës AIB (Shoqata e lëshimit të garancive të origjinës), me seli në Bruksel, e cila përmbledh në të institucionet përgjegjëse për lëshimin e garancive të origjinës në vendet e BE-se dhe më gjerë. Duke filluar nga ajo datë, ERE ka qenë pjesëmarrëse në grupet e punës të ngritura nga kjo e fundit apo dhe në takimet e Asamblesë së kësaj të fundit, të cilët kanë pasur në fokus kryesor të tyre, pranimin e pjesëtareve të rinj apo dhe sfidat që i dalin përpara institucioneve për njohjen e garancive të origjinës në BE.

11.3. Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s

Gjatë vitit 2025 janë intensifikuar në mënyrë të mëtijshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (ARERA) si dhe atë Grek (RAE) apo dhe me Rregullatorin e Maqedonisë së Veriut apo dhe atë të Kosovës ku janë mbajtur mbledhje të përbashkëta për miratimin e vendimeve që lidhen me bashkimin e tregjeve të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë pjesë e projektit për bashkimin e tregjeve të këtyre 4 vendeve.

11.4. Marrëdhëniet me Publikun

Strategjia e komunikimit në ERE ka për qëllim informimin dhe promovimin me grupet e interesit dhe publikun e gjerë në lidhje me objektivat, nismat, progresin, impaktin dhe arritjet që ka ky institucion gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Me qëllim përmbushjen e këtyre objektivave, përgjatë vitit 2025, është punuar nëpërmjet krijimit dhe publikimit të materialeve ndihmëse dhe informuese, të aksesueshme lehtësisht në faqen zyrtare të ERE-s www.ere.gov.al, si dhe në rrjetet sociale të institucionit, në të cilat, sipas rastit dhe duke gjykuar mbi target grupet specifike, janë përshtatur në kontekst dhe në formë. Ka qenë me rëndësi bashkëpunimi me disa nga sektorët apo grupet e punës të krijuara me qëllim përpunimin e materialeve të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e ecurisë së punës së përditshme por dhe informimin e gjerë të publikut. Është miratuar po ashtu Strategjia e ERE-s për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative 2025 - 2030, e cili do të shërbejë si udhëzues për edukimin e konsumatorit në përmirësimin e menaxhimit të energjisë dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve për përdorimin racional dhe eficient të saj.

Vlen për t'u përmendur që disa nga publikimet qoftë në web dhe në rrjetet sociale, kanë patur në fokus kryesor informimin e konsumatorit dhe ndërgjegjësimin e këtij të fundit mbi kursimin e energjisë.

Gjatë vitit 2025 janë kryer mbi 150 publikime në rrjetet sociale të ERE-s, dhe ndër to përmendim:

11.4.1 Buletin e përmuajshëm – përmbledhje e aktiviteteve, vendimeve të marra, apo dhe

ndryshimeve të bëra në rregullore të ndryshme.

- 11.4.2 Publikime të ndryshme informuese si: Informacion mbi skemat e kompensimit për mbrojtjen e shtresave në nevojë; Si të bëni një lidhje me rrjetin e shpërndarjes; Çfarë kuptimi ka vlera referuese në faturën tuaj të energjisë; Kur dhe si duhet të paguani faturën e energjisë elektrike; Metodat e pagesës së energjisë elektrike; Si mund të lidhni një kontratë energjie elektrike; Dita botërore e të drejtave të konsumatorit; Procedura për ndryshimin e furnizuesit; Ndërprerja e furnizimit nga furnizuesi dhe rilidhja; Përfundimi i kontratës me kërkesë të klientit; Çfarë duhet të bëni për të qenë vetëprodhues; Si të bësh një lidhje me rrjetin e shpërndarjes etj. Përmbledhja e vendimeve të marra për t'u publikuar në rrjetet sociale, si dhe gjithashtu është bërë publikimi i njoftimeve për fillimin e procedurave për licencim të subjekteve, apo për materiale të nxjerra për konsultim, së bashku me ftesën për palët e interesit për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre me shkrim.
- 11.4.3 Njoftimet në rrjetet sociale mbi fillimin e procedurës për licencim e subjekteve.
- 11.4.4 Njoftime mbi materiale në fazë konsultimi, me qëllim përfshirjen sa më të gjerë të palëve të interesit.
- 11.4.5 Azhurnimi i regjistrave të procedurave të licencimit, autorizimeve, të subjekteve të licencuara, të ankesave; tabelave me tarifat dhe çmimet e miratuara nga ERE, si dhe të dhënat e tregut të energjisë.

ERE aktualisht është aktive në tre rrjete sociale, Instagram, Facebook dhe LinkedIn, ku të gjitha të dhënat publikohen, duke patur në konsideratë informimin e publikut sa më të gjerë dhe faktin që rrjetet sociale shpesh herë krijojnë lehtësi në aksesin e informacionit.

Pjesë e strategjisë së komunikimit së ERE është dhe Programi i Transparencës i cili është përditësuar sipas rastit, me të njëjtin intensitet siç dhe vitet e mëparshme. Sipas përcaktimeve të nenit 8 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, autoriteti publik, në këtë rast ERE, krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet periodikisht dhe sipas nevojës dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Në këtë kuadër, Koordinatorin e të Drejtës për Informimit, të ERE-s, ka adresuar kërkesat e ardhura në adresë të koordinatorit, brenda afateve dhe përcaktimeve të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përgjigjet e të cilave i gjeni të reflektuara në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në programin e transparencës në faqen tonë zyrtare (*linku për akses të shpejtë <https://ere.gov.al/sq/transparenca/regjistri-i-kerkesave-dhe-pergjigjeve>*). Në këtë adresë janë paraqitur 11 kërkesa për periudhën janar – dhjetor 2025. Ky program mbikëqyret dhe rifreskohet vazhdimisht me të dhëna të nevojshme nga Koordinatorin për të Drejtën e Informimit.

Për sa i përket Programit të Transparencës, ndërtuar mbi standardet e përcaktuara në Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, i ndryshuar, ERE për vitin 2025 është vlerësuar për të disatin vit rresht si një autoritet me transparencë proaktive të lartë.

Qëllimi i Programit të Transparencës është garantimi i aksesit sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës në informacionin/dokumentacionin me karakter publik dhe kjo qasje ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e llogaridhënies si brenda strukturës hierarkike të AP, si dhe përballë qytetarëve apo grupeve të interesit.

12. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ERE-S

Gjatë vitit 2025, ERE ka vijuar funksionimin mbi bazën e Strukturës Organizative të miratuar me vendimin nr. 198, datë 20.09.2024, duke ruajtur të njëjtën strukturë të përbërë nga 9 drejtori dhe 15 sektorë. Kjo strukturë ka garantuar vijimësinë institucionale dhe stabilitetin organizativ, në përmbushje të detyrave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Funksionimi i ERE-s vazhdon të mbështetet në një ndarje të qartë të përgjegjësi dhe kompetencave ndërmjet drejtorive dhe sektorëve përkatës, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe rregullatore të institucionit.


ERE drejtohet nga Bordi i Komisionerëve, i përbërë nga Kryetari dhe katër anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe ushtrojnë një mandat 5-vjeçar. Bordi mbetet organi më i lartë vendimmarrës dhe përgjegjës për drejtimin strategjik të institucionit, duke garantuar pavarësinë, paanshmërinë dhe profesionalizmin e Institucionit.

Zhvillimi organizativ është fokusuar në konsolidimin e mëtejshëm të praktikave të brendshme administrative dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përbërëse, me synim rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e cilësisë së proceseve të punës. Kjo qasje ka kontribuar në ruajtjen e një mjedisi pune të strukturuar, profesional dhe të orientuar drejt performancës.

Politikat e rekrutimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore vijnë të mbështeten në legjislacionin në fuqi, përfshirë ligjin “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, duke garantuar transparencë, barazi mundësish dhe respektim të parimit të meritokracisë në të gjitha proceset e përzgjedhjes, vlerësimit dhe avancimit të stafit.

Në figurën më poshtë jepet skema organizative e ERE-s për vitin 2025, e cila është rishikuar në vitin 2026, si nevojë për të reflektuar dinamikën e reja të tregut të energjisë dhe për t'u përafruar me kërkesat e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, veçanërisht lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë kibernetike sipas standardeve REMIT.

Ky riorganizim synon adresimin e rekomandimeve të raporteve të auditimit për forcimin e kapaciteteve teknike dhe ndarjen e qartë të funksioneve rregullatore nga ato mbikëqyrëse, duke konsoliduar monitorimin e burimeve të rinovueshme, analizën statistikore dhe licencimin. Përmes këtij rishpërndarjeje të burimeve njerëzore ekzistuese, institucioni synon rritjen e efikasitetit, transparencës dhe përmbushjen e objektivave strategjike për një tranzicion energjetik të qëndrueshëm dhe një mbrojtje më efektive dhe struktura të dedikuara për informim të konsumatorit.



12.1. Pjesëmarrja gjinore në ERE

Në zbatim të detyrimeve ligjore, struktura e menaxhimit të burimeve njerëzore ka hartuar, si çdo vit, planin vjetor të rekrutimit të punonjësve. Në kuadër të politikave të saj, institucioni ka vijuar të orientohej drejt integritit gjinor në ushtrimin e veprimtarisë, me synim parandalimin dhe eliminimin e çdo forme diskriminimi për shkak të gjinisë, në përputhje me parimin e barazisë gjinore. Aktualisht, përfaqësimi gjinor në totalin e punonjësve aktivë është 61% gra dhe 39% burra. Ndërsa në nivelet drejtuese, raporti paraqitet 40% gra dhe 60% burra.

Në funksion të përmirësimit dhe konsolidimit të këtij statusi, ERE ka marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në trajnime dhe grupe pune të organizuara nga organizata kombëtar apo ndërkombëtare, ku theksi është vendosur në rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore. Po ashtu, nën iniciativat për promovimin e grave në pozita drejtuese në sektorin e energjisë, është synuar adresimi i normave sociale të padrejta në vendin e punës si dhe nxitja e ndryshimeve në politikat dhe procedurat e komisioneve përkatëse.

12.2. Rekrutimi dhe Trajnimi i Stafit në ERE

Në zbatim të detyrimeve ligjore, gjatë vitit 2025 ERE ka përgatitur dhe miratuar planin vjetor të trajnimeve, i hartuar mbi bazën e nevojave konkrete të çdo njësie organizative, si dhe në përputhje me objektivin për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit. Programi i zhvillimit profesional është realizuar në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, si dhe me institucione dhe organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë këtij viti është garantuar pjesëmarrja e punonjësve në trajnime të karakterit specifik dhe të përgjithshëm, si edhe në formate online, me synim përditësimin e njohurive dhe rritjen e efikasitetit në ushtrimin e funksioneve. Njëkohësisht, stafi ka qenë pjesë aktive e aktiviteteve, takimeve dhe workshop-eve të organizuara në kuadër të projekteve ku ERE është palë, duke kontribuar në shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira.

Gjithashtu, ERE ka marrë pjesë në tryeza ndër-institucionale me fokus zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit të energjisë në vend. Kontributi i institucionit është përqendruar në mbështetjen e politikave që nxisin tranzicionin drejt energjisë së pastër, forcimin e sigurisë së furnizimit me energji dhe gaz, rritjen e mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe promovimin e digjitalizimit përmes integritit të matëseve dhe rrjeteve inteligjente. Po ashtu, është thelluar bashkëpunimi rajonal për adresimin e përbashkët të sfidave që lidhen me transformimin energjetik.

Me qëllim përshtatjen me zhvillimet e tregut të energjisë dhe përfshirjen e teknologjive të reja, në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor të sektorit, ERE ka vijuar forcimin e kapaciteteve institucionale dhe konsolidimin e strukturës organizative, duke rishikuar funksionet dhe përgjegjësitë për të garantuar një mbikëqyrje më efektive dhe një analizë më të thelluar të impaktit rregullator.

Sa i përket administrimit të burimeve njerëzore, gjatë vitit 2025 ka vijuar zbatimi rigoroz i legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e kontrollin e pasurive dhe detyrimeve financiare të zyrtarëve publikë, duke respektuar afatet ligjore për plotësimin e deklaratave periodike/vjetore të interesave private nga subjektet përkatëse, si dhe është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin, në përputhje me kërkesat ligjore.

13. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE GJATË VITIT 2025

13.1. Administrimi i burimeve financiare të ERE-s gjatë vitit 2025

14.1. Në zbatim të pikës 1,2,3,4, të paragrafit të dytë të pikës 6, të nenit 17, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, të nenit 14, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të nenit 22, të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2000 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore financiare në fuqi, ERE ka miratuar buxhetin për vitin 2025 me vendimin e Bordi nr. 62, datë 27.03.2025. Ky buxhet mori në konsideratë kërkesat për funksionimin e ERE-s përgjatë vitit 2025. ERE ka autonomi në përdorimin e buxhetit të tij. Burimet financiare të ERE-s përbëhen nga pagesat rregullatore, pagesat e aplikimeve për licencë dhe shërbime të tjera sipas legjislacionit në fuqi. Administrimi i burimeve financiare përgjatë vitit 2025 është realizuar duke u mbështetur në legjislacionin e mësipërm.

13.2. Zërat kryesorë të shpenzimeve të ERE-s

Ndër zërat kryesorë të shpenzimeve të ERE-s për vitin 2025 mund të përmendim:

- Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni i ERE-s ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nga sistemi elektronik “Detyrimet në kohë reale” nuk rezulton debitor apo me gjoba.
- Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve të domosdoshme për mbarëvajtjen e funksionimit të punës në institucion, për të cilat institucioni nuk është debitor.
- Publikimet për informim të opinionit publik janë realizuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar.
- Pagesat me qëllim përmbushjen e angazhimeve në cilësinë e vendit anëtar në një sërë organizatash të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit të energjisë të tillë si MEDREG, ERRRA, IGU, CEER, AIB, BES, për platformën për realizimin e shërbimit të mbajtjes dhe emetimit të garancive të origjinës etj.

13.3. Auditimi i ERE-s

Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në nenin 17, pika 7, përcaktohet se “Auditimi i veprimtarisë financiare të ERE-s” kryhet nga ekspertë të miratuar kontabël, të cilët përzgjidhen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Veprimtaria ekonomiko - financiare e ERE-s për vitin 2025, sipas parashikimeve të legjislacionit të sipërcituar është audituar nga një grup ekspertësh kontabël të regjistruar dhe të licencuar për këtë aktivitet bazuar në Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Në shtojcën 1 të këtij raporti paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël që lidhet me ecurinë financiare të ERE-s gjatë vitit 2025, si dhe shtojcën 2 gjendet Raporti i auditimit të performancës.

Me vendim të Bordit nr. 352, datë 29.12.2025 është miratuar PBA për vitet 2026-2028 dhe buxheti për vitin 2026. Ky buxhet merr në konsideratë kërkesat për funksionimin e ERE-s përgjatë vitit 2026.

Në mënyrë të detajuar ky buxhet paraqitet në tabelën e mëposhtme.

13.4 Buxheti për vitin 2026

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Paga personeli	330,000,000
2	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	32,000,000
3	Shërbime dhe mallra	182,488,000
4	Investime	18,500,000
Nevoja për arkëtim nga pagesa rregullatore 2026		405,624,599

14. MBI RAPORTIMIN E ERE NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË “REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ERE PËR VITIN 2025”

Në vijim të miratimit të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së ERE për vitin 2025, në datë 09.10.2025, me vendimin nr. 276/2025, ERE ka miratuar ‘Planin e masave për zbatimin dhe ndjekjen e plotësisht të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit’, duke detajuar aktivitetet dhe duke angazhuar strukturat përgjegjëse për implementimin e këtyre rekomandimeve.

Rekomandimi nr. 1, ku është parashikuar që ERE: Të mundësojë implementimin e një platforme digjitale për trajtimin e ankesave dhe gjurmimin e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve, duke e bërë më të thjeshtë verifikimin online të statusit të ankesës dhe më të aksesueshme (user-friendly) për konsumatorët si dhe në mënyrë të vazhdueshme të ketë prioritet të punës së tij trajtimin me përgjegjësi të ankesave si një instrument i drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe për përmirësimin e shërbimeve të operatorëve të energjisë.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 1

Për të përmbushur këtë detyrë të Rezolutës, ERE ka përfunduar draftimin e termave të referencës së platformës digjitale të ankesave, është realizuar testimi i tregut dhe është parashikuar në buxhet fondi për realizimin e këtij shërbimi. Platforma është konceptuar si një sistem i regjistrimit, ndjekjes dhe gjurmimit të vazhdueshëm të ecurisë së trajtimit të ankesave. Në këtë platformë, konsumatorët jo vetëm që do të adresojnë online ankesat e tyre për një eficiencë më të madhe kohe, por edhe do të mund të ndjekin në çdo kohë procesin e shqyrtimit nga ERE, adresimit të kërkesave të kësaj të fundit tek të licencuarit, përgjigjen e dokumentacionin e vënë në dispozicion nga të licencuarit që do t’i shërbejë zgjidhjes së ankesës si dhe së fundmi, zgjidhjen e dhënë nga ERE. Pritet që platforma të jetë efiçiente brenda vitit 2026.

Rekomandimi nr. 2, ku është parashikuar që ERE: Të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe palët e tjera të interesit për të adresuar sfidat që lidhen me promovimin dhe integrimin e projekteve për impiantet e prodhimit të energjisë elektrike për vetëprodhuesit. Rritja e prodhimit të energjisë nga impiantet fotovoltaike përmirëson sigurinë energjetike të vendit duke diversifikuar burimet e energjisë dhe duke e bërë sistemin më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve klimatike.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 2

ERE ka përmbushur detyrën e lenë nga rezoluta duke përgatitur programet edukuese për orientimin e konsumatorëve drejt investimeve në impiante vetëprodhuese, përfshirë hartimin e broshurave informuese mbi procedurat dhe dokumentacionin përkatës. Gjatë vitit 2025, ERE ka ndërmarrë një fushatë të mirëfilltë promovimi në rrjetet sociale me qëllim reklamimin e benefiteve që vijnë nga investimi në impiantet fotovoltaike si dhe garancinë e pavarësisë nga rrjeti që kjo energji të ofron. Gjatë vitit 2025, janë lidhur në rrjet 1139 vetëprodhues të rinj, ç’ka përfaqëson një rritje prej 27.96 % krahasuar me vitin 2024 duke çuar numrin total të vetëprodhuesve në 3,551. Po ashtu, në kuadër të detyrave për ndërgjegjësimin e konsumatorit, janë publikuar në rrjetet sociale broshura të cilat kanë pasur në fokus tematika të tilla si; Instalimin e paneleve fotovoltaike, Procedurat e lidhjes me rrjetin, Të drejtat dhe detyrimet e vetëprodhuesve, Mekanizmin e kompensimit (net-metering). Edhe përgjatë vitit 2025, një pjesë të rëndësishme ka vijuar ta zërë prodhimi nga impiantet fotovoltaike. Rritja e kapacitetit gjenerues nga këto impiante kontribuon në diversifikimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbulimin e nevojave energjetike të vendit.

Kapaciteti i instaluar i impianteve fotovoltaike për vitin 2025 arrin në 631,07 MW duke përbërë rreth 18 % të kapacitetit total të centraleve të instaluara në vend, ndërsa prodhimi i realizuar prej tyre është 832.3 GWh duke përfaqësuar 11 % të prodhimit total vendas për vitin 2025. Për vitin

2025 përlllogariten gjithsej 53 centrale fotovoltaike në prodhim me një rritje progresive që prej vitit 2020. Po ashtu, gjatë vitit 2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impiantet fotovoltaike janë licencuar 19 subjekte. Gjatë vitit 2025 kanë hyrë në prodhim për herë të parë gjithsej 13 centrale fotovoltaike me një prodhim vjetor total rreth 90 GWh.

Rekomandimi nr. 3, ku është parashikuar që ERE: Me miratimin e rregullores së rishikuar, ndryshimet e së cilës synojnë rritjen e nivelit të mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në furnizimin e pandërprerë të energjisë dhe gazit natyror, ERE-ja të kërkojë me rigorozitet nga operatorët e përfshirë hartimin dhe zbatimin e planeve përkatëse për sigurinë kibernetike.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 3

Nga ana e ERE-s kjo detyrë është përmbushur, duke ndërmarrë një proces komunikimi zyrtar me operatorët përkatës të infrastrukturave kritike, të përcaktuar sipas listës së miratuar me VKM, në kuadër të zbatimit të planit të masave për forcimin e sigurisë kibernetike në sektorin e energjisë. Në këtë kuadër, ERE ka përmbushur detyrimin e tij institucional për iniciimin dhe koordinimin e procesit të raportimit dhe monitorimit të operatorëve.

Konkretisht, përmes këtij komunikimi janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga operatorët lidhur me disa elemente kyçe të menaxhimit të sigurisë kibernetike, duke përfshirë:

- statusin e certifikimit sipas standardeve ndërkombëtare ISO për menaxhimin e sigurisë së informacionit;
- njoftimin mbi çdo incident të mundshëm të sigurisë kibernetike të evidentuar gjatë vitit 2025;
- nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionin përgjegjës për sigurinë kibernetike, AKSK;
- raportimin mbi zbatimin e rregullores për sigurinë kibernetike për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025.

Në këtë mënyrë, institucioni ka vijuar me administrimin e informacionit të nevojshëm për monitorimin e zbatimit të masave të sigurisë kibernetike nga operatorët e sektorit.

Paralelisht me këtë proces, bazuar në raportimet e paraqitura nga shoqëritë publike të sektorit të energjisë, si KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSSH sh.a., ERE ka ndërmarrë gjithashtu hapa për përmirësimin e mëtejshëm të praktikave të sigurisë kibernetike, duke përcjellë rekomandime konkrete lidhur me forcimin dhe përditësimin e procedurave përkatëse.

Rekomandimi nr. 4, ku është parashikuar që ERE: Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të transparencës së rregullatorit, të marrë masa për publikimin e të gjitha vendimeve të Bordit në faqen zyrtare online, si dhe t'i kushtojë vëmendje të shtuar përditësimit të informacionit në faqen zyrtare të Entit.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 4

Në përputhje me detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 43/2025, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, konkretisht neni 16, pika 4, ERE ka publikuar në Fletoren Zyrtare të gjitha vendimet e Bordit, përveç atyre me karakter të brendshëm organizativ të ERE-s. Paralelisht ERE ka publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe njoftimin për shtyp për çdo vendim, që publikohet njëkohësisht edhe në rrjete sociale.

Po ashtu në kuadër të rritjes së transparencës ERE ka vijuar punën e saj për përditësimin periodik të Regjistrit të licencimeve në proces, atë të autorizimeve në proces, të dhënat periodike të tregut, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në kuadër të programit të transparencës, regjistrin e REMIT

si dhe atë të ankesave të konsumatorëve. Sa i përket publikimeve të tjera, ERE edhe gjatë vitit 2025 ka siguruar transparencë proaktive të lartë, fakt i cili është certifikuar edhe nga Raporti i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili në raportin për Indeksin e transparencës proaktive të autoriteteve publike për vitin 2025, ERE-n e ka renditur ndër 10 Institucionet Qendrore me transparencë proaktive të lartë, duke marrë pikët e plota të 15 nga 16 treguesit e marrë në vlerësim. Në zbatim të Urdhrit nr. 280, datë 30.12.2025 “Për miratimin e programit model të transparencës për autoritetet publike”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Bordi i ERE-s miratoi me vendimin nr. 25, datë 30.01.2026 “Rishikimin e Programit të Transparencës së Entit Rregullator të Energjisë”.

Publikimi i informacioneve në rrjetet sociale është realizuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës raportuese, edhe sa i përket njoftimeve periodike mbi mbledhjet e Bordit të ERE-s, njoftimet e vendimmarrjeve të mbledhjeve të ERE-s, të cilat janë publikuar brenda 24 orëve nga vendimmarrja si dhe njoftimin e çdo procedure publike e cila i nënshtrohet vendimmarrjes apo vlerësimit të ERE-s.

Rekomandimi nr. 5, ku është parashikuar që ERE: Të vijojë të tregojë vëmendje të shtuar gjatë procesit të shqyrtimit të planeve të investimeve të OSSH sh.a. dhe OST sh.a., duke siguruar që ato të jenë në përputhje me objektivat e politikave energjetike kombëtare si dhe të rishikojë periodikisht planifikimin afatgjatë të investimeve për të adresuar zhvillimet e reja dhe nevojat e konsumatorëve me fokus të veçantë zonat turistike.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 5

Në këtë kuadër, shoqëria OSSH sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s informacion të përditësuar lidhur me realizimin dhe planifikimin e investimeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për zonat me potencial të lartë turistik. Ky informacion është strukturuar sipas zërave të investimeve dhe Drejtorive Rajonale përkatëse, duke përfshirë investimet e realizuara përgjatë periudhës 2023–2025, si dhe planifikimin e tyre për vitin 2026. Investimet e raportuara fokusohen kryesisht në ndërtimin dhe rikonstruksionin e nënstacioneve, përforcimin dhe zgjerimin e rrjetit të linjave të shpërndarjes, me qëllim rritjen e sigurisë, cilësisë dhe vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike në rajonet Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë, Kukës dhe Gjirokastrë, të cilat karakterizohen nga zhvillim i ndjeshëm i aktivitetit turistik dhe rritje sezonale e ngarkesës në rrjet.

Në të njëjtën linjë, edhe shoqëria OST sh.a., në kuadër të hartimit të planit të zhvillimit dhe investimeve për periudhën 2025–2027, ka parashikuar realizimin e një sërë projektesh investuese në rrjetin e transmetimit, të orientuara drejt ndërtimit dhe rikonstruksionit të nënstacioneve dhe linjave të transmetimit. Këto ndërhyrje synojnë rritjen e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e fleksibilitetit operacional të sistemit elektroenergjetik dhe garantimin e një furnizimi të qëndrueshëm në zonat me intensitet të lartë zhvillimi, përfshirë edhe zonat turistike.

Rekomandimi nr. 6, ku është parashikuar që ERE: Pas miratimit të akteve përkatëse për vendosjen e detyrimit të përdorimit të Platformës së Krahasimit të Çmimeve (PCT) në tregun e lirë, një hap i rëndësishëm i cili synon të sigurojë transparencë dhe konkurrencë në treg, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve, ERE të zhvillojë fushata promovuese mbi modalitetet e funksionimit të kësaj platforme.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 6

Me vendimin nr. 241, datë 15.11.2024, të ndryshuar, ERE ka vendosur detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike në Platformën e Krahasimit të Çmimeve (PCT), të krijuar nga ERE, për të licencuarit, që janë aktivisht të angazhuar në veprimtarinë e furnizimit në tregun e lirë, për konsumatorët familjarë dhe jofamiljarë të vegjël me një konsum vjetor të pritshëm më pak se 100,000 kWh. Pas miratimit të kuadrit rregullator për publikimin e ofertave të furnizimit

në platformën PCT, i cili vlerësohet se rrit transparencën dhe konkurrencën në treg, si dhe mbron interesat e konsumatorëve, ERE ka vijuar me zhvillimin e aktiviteteve informuese dhe promovuese për përdorimin e kësaj platforme. Në këtë drejtim, përmes kanaleve të komunikimit publik, përfshirë publikimet në rrjetet sociale, ERE ka shpërndarë materiale informuese dhe edukative mbi rëndësinë dhe mënyrën e përdorimit të Platformës së Krahasimit të Çmimeve. Këto publikime kanë pasur për qëllim të informojnë konsumatorët dhe bizneset mbi mundësinë që ofron platforma për të krahasuar ofertat e furnizuesve të licencuar dhe për të zgjedhur furnizuesin më të përshtatshëm në tregun e lirë të energjisë. Në vijim të këtij procesi janë përgatitur dhe përdorur materiale të ndryshme promovuese dhe informuese, duke përfshirë prezantime informuese, materiale vizuale me përmbajtje edukuese të përshtatura për publikun e gjerë dhe për furnizuesit e energjisë. Publikimet në rrjetet sociale kanë shërbyer si një instrument i rëndësishëm komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin mbi procesin e liberalizimit të tregut të energjisë dhe mbi rolin e platformës PCT, si një mjet që mundëson krahasimin transparent të ofertave të furnizimit me energji elektrike. Përmes këtyre publikimeve, ERE ka orientuar konsumatorët që kanë dalë në treg të lirë, drejt përdorimit të platformës për të identifikuar ofertat më të favorshme dhe për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes së furnizuesit. Në këtë mënyrë, mund të konstatohet se ERE ka ndërmarrë hapa konkretë për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në rekomandim, duke zhvilluar aktivitete promovuese dhe informuese mbi funksionimin e Platformës së Krahasimit të Çmimeve. Aktualisht rezulton se janë 7 furnizues të cilët publikojnë dhe përditësojnë ofertat e tyre në platformën e krahasimit të çmimeve.

Rekomandimi nr. 7, ku është parashikuar që ERE: Të vijojë monitorimin e Bursës ALPEX dhe kontributin e tij si rregullator për funksionimin e një tregu transparent, i bazuar në bursën ALPEX, i cili nxit investimet në Energjinë e Rinovueshme, rrit konkurrencën e ndershme si dhe rit mundësinë që Shqipëria të integrohet në platforma evropiane të tregtimit të energjisë.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 7

Janë mbledhur dhe analizuar të dhënat për tregun e ditës në avancë (Day-Ahead Market) dhe tregun brenda ditës (Intra-Day Market) për periudhën 12-mujore të vitit 2025 dhe ALPEX sh.a. ka raportuar mbi baza mujore mbi të dhënat e tregut. Në vijim të detyrave të lëna nga ana e Rezolutës, ERE ka përpunuar këto të dhëna në baza mujore si dhe ka publikuar të dhëna në lidhje me transaksionet në ALPEX sh.a..

Numri i përgjithshëm i Anëtarëve të Bursës në ALPEX sh.a. në fund të vitit 2025, arriti në 41 (dyzet e një), 26 në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 15 në Zonën e Ofertimit të Kosovës. Gjatë vitit 2025 u rrit aktiviteti i tregtimit si në numër të ofertave ashtu dhe në volumn e tyre, të cilat arrijnë në gati 9.5 % të totalit të tregut (për zonën e Shqipërisë). Për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë, oferta në blerje për vitin 2025 ishte rreth 1.7 TWh, krahasuar me 1.1 TWh në vitin 2024. Për tregun e bashkuar Shqipëri-Kosovë, oferta në blerje për vitin 2025 ishte në vlerën 2.8 TWh krahasuar me 1.5 TWh në vitin 2024.

Rekomandimi nr. 8, ku është parashikuar që ERE: Në vijim të akteve që duhen miratuar si detyrim i Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE të marrë masat për miratimin e “Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë të ditës në avancë”, metodologji e cila synon të vlerësojë kapacitetin dhe fleksibilitetin e tregut shqiptar për të operuar në përputhje me praktikën më të mira të tregut të lirë të energjisë, duke siguruar kushte të favorshme për pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemin energjetik.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 8

ERE ka përmbushur detyrimin që buron nga kjo detyrë e rezolutës, duke miratuar me Vendimin nr. 279, datë 06.11.2025, metodologjinë mbi vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë

të energjisë elektrike. Kjo metodologji përcakton parimet dhe treguesit të cilët do të merren në konsideratë nga ERE për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Vlerësimi i parë i gatishmërisë së tregut nga ERE do të kryhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e metodologjisë dhe do të vijojë të hartohet çdo 6 muaj deri në një vlerësim pozitiv mbi gatishmërinë e tregut.

Rekomandimi nr. 9, ku është parashikuar që ERE pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, krahas adresimit të çështjeve të rëndësishme si, përmirësimin e kuadrit rregullator për eficiencën e energjisë, rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e eficiencës energjetike, etj, të ketë në vëmendje edhe hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme për adresimin e çështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit eficient të energjisë.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 9

Në kuadër të zbatimit të Rekomandimit nr. 9, i cili parashikon që pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë të ndërmerren hapa të përbashkët për përmirësimin e kuadrit rregullator, rritjen e ndërgjegjësimit dhe hartimin e një strategjie afatmesme për përdorimin eficient të energjisë nga konsumatorët, ERE ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete për përmbushjen e këtij rekomandimi.

ERE ka punuar për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve lidhur me rëndësinë e eficiencës së energjisë, përmes përgatitjes së materialeve informuese dhe udhëzuesve praktikë mbi mënyrat e kursimit të energjisë dhe përdorimin më efikas të saj në familje dhe biznes. Këto materiale synojnë të ofrojnë këshilla praktike për konsumatorët, duke i orientuar ata drejt praktikave më të qëndrueshme të përdorimit të energjisë. Në funksion të rritjes së aksesit në informacion, ERE është duke punuar ende për zhvillimin e një seksion të dedikuar në faqen zyrtare të institucionit, ku publikohen materiale informuese dhe udhëzuese për eficiencën e energjisë. Ky seksion synon të shërbejë si një vitrinë informimi për publikun dhe aktorët e tregut, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe në promovimin e praktikave të mira për përdorimin racional të energjisë.

Paralelisht me këto masa, ERE ka ndërmarrë edhe hapa për hartimin e një strategjie afatmesme që adreson çështjet me interes për konsumatorët në lidhje me eficiencën energjetike. Në këtë drejtim, me Vendimin nr. 299, datë 17.11.2025, është miratuar dokumenti strategjik “Strategjia e ERE për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative për vitet 2025–2030”. Kjo strategji përcakton objektivat, masat dhe instrumentet që do të përdoren për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi kursimin e energjisë dhe për të promovuar përdorimin e burimeve alternative të energjisë. Miratimi i kësaj strategjie përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të institucionalizimit të politikave të ndërgjegjësimit dhe edukimit të konsumatorëve në fushën e eficiencës së energjisë, si dhe krijon një bazë të qëndrueshme për bashkëpunimin ndërinstitucional me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë dhe aktorë të tjerë të sektorit.

Rekomandimi nr. 10, ku është parashikuar që ERE: Në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë për konsumatorët të marrë masa për rishikimin e rregullave dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët e rrjetit.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 10

Në kuadër të zbatimit të Rekomandimit nr. 10, ERE ka përmbushur këtë detyrë të Rezolutës së Kuvendit, duke ndërmarrë një sërë hapash konkretë në drejtim të përditësimit dhe përmirësimit të kuadrit rregullator në këtë fushë. ERE në vijim të vendimit të Bordit, nr. 300, datë 17.11.2025, për fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe

performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, pas kryerjes së procesit të konsultimit, me vendimin nr. 81, datë 12.03.2026, miratoi ndryshimet në standardet e cilësisë së shërbimit për sistemin e transmetimit. Këto përditësime përfshijnë treguesit që lidhen me performancën dhe sigurinë e rrjetit të transmetimit të operuar nga OST sh.a.. Ato përmirësojnë treguesit e performancës së cilësisë së furnizimit në rrjetin e transmetimit, duke vendosur nivele të reja standarde për treguesit kryesorë, si: AIT (Koha mesatare e ndërprerjes) – nga 35 minuta në 26 minuta; ENS (Energjia e pafurnizuar) – nga 467 MWh në 366 MWh; SAIDI (Indeksi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve) – nga 100 minuta në 39.5 minuta.

Paralelisht me rishikimin e standardeve në sistemin e transmetimit, ERE ka filluar procedurën për përmirësimin e standardeve të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me vendimin nr. 346, datë 29.12.2025. Ky vendim shënon nisjen e procesit për rishikimin dhe përditësimin e treguesve të performancës që lidhen me cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve në rrjetin e shpërndarjes, duke synuar rritjen e standardeve të furnizimit dhe përmirësimin e besueshmërisë së shërbimit të ofruar.

Rekomandimi nr. 11, ku është parashikuar që ERE: Të marrë masa për përgatitjen e standardeve të lëshimit të certifikatave të garancisë së origjinës, në përputhje me standardet e Sistemit Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS), si dhe të vijojë adresimin e çështjeve me të cilat ballafaqohen konsumatorët e energjisë dhe pjesëmarrësit e tregut në tërësi, të cilat kërkojnë ndërhyrjen e rregullatorit.

Masat e Marra për Zbatimin e Rekomandimit nr. 11

Në mbështetje të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE si autoritet përgjegjës për lëshimin e garancive të origjinës dhe si pjesë e sistemit rajonal të garancive të origjinës të krijuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka krijuar regjistrin elektronik të GO-ve, i cili mirëmbahet nga European Energy Exchange AG (ish-Grexel Ltd), si ofrues i përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Ky regjistër është teknikisht në përputhje me standardet e Sistemit Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS). Gjithashtu, ERE ka vijuar punën me asistencën e AIB (Shoqata e organeve lëshuese) për anëtarësimin në skemën e energjisë elektrike të AIB, e cila do të garantojë përputhshmërinë e plotë me sistemin EECS.

Për sa i përket rekomandimit nr. 12, ku është parashikuar që ERE: Pas miratimit të metodologjisë përkatëse nga Këshilli i Ministrave të marrë masat e nevojshme për miratimin në kohë të çmimit të energjisë elektrike të gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme, bëjmë me dije se:

Drafti i VKM-së përkatëse është përcjellë për komente më datë 19.12.2025 dhe ndodhet në fazën e miratimit përfundimtar nga ana e Këshillit të Ministrave. Pas miratimit të VKM-së, i cili parashikon, ndër të tjera, çmimin tavan dhe çmimin dysHEME për vetëprodhuesit, do të miratohet nga ana e ERE-s çmimi përfundimtar i shitjes së energjisë elektrike nga impiantet vetëprodhuese.

15. ECURIA E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË BE-së PËR VITIN 2025

Në Progres Raportin e Bashkimit Evropian për vitin 2025, në Kapitullin 15, Energjia, sa i përket ecurisë së përmbushjes së detyrimeve në sektorin e energjisë rezulton sa vijon:

Lidhur me tregun e brendshëm të energjisë, përafrimi me Paketën e Integritetit të Energjisë Elektrike mbetet ende për t'u përfunduar plotësisht. Procesi i hartimit të ligjit të ri “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është në vijim e sipër, ku Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka kryer rishikimin e draft-ligjit në korrik të vitit 2025. Ndërkohë sa i takon veprimtarisë së ERE-s, në këtë raport evidentohet: Miratimi nga Bordi i ERE-s, në maj 2025, të Rregullores për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Interkonjeksionit (CACM); përditësimi rregullave të tregut të energjisë elektrike (ALPEX) për t'i përafruar ato me Rregulloren e Tregut të Energjisë Elektrike dhe vendimet e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER), lidhur me tregjet e bashkuara të një dite më parë (SDAC) dhe ato brenda së njëjtës dite (SIDC). Këto ndryshime u miratuan nga ERE në dhjetor 2024. Një hap historik ishte zhvillimi i ankandit të parë “intraday” (brenda së njëjtës dite) nga ALPEX sh.a. në dhjetor 2024, i cili shënoi zyrtarisht bashkimin e tregjeve (market coupling) Shqipëri-Kosovë. Po ashtu ky raport evidenton edhe ndryshimet strukturore të ERE-s, përfshirë stafin të dedikuar për energjinë e rinovueshme dhe përputhshmërinë rregullatore (compliance), duke përmirësuar aftësinë e saj për të përmbushur nevojat e sektorit. Struktura e re, e cila përfshin sektorë dhe departamente të reja, paraqet sfida të shtuara për ERE-n dhe kërkon trajnimin e vazhdueshëm të stafit të ri.

Në fushën e energjisë së rinovueshme, në këtë Raport evidentohet miratimi nga ERE i “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhura nga burimet e rinovueshme (GOs)”. Gjithashtu, shërbimet për ofrimin e Garancive të Origjinës në format elektronik, janë të aksesueshme për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

Në këtë kuadër, puna e ERE-s është vlerësuar gjithashtu në raportin vjetor të Sekretariatit të Traktatit të Energjisë, me seli në Vjenë. Ky raport, i publikuar në dhjetor të vitit 2025, e vlerëson Entin me një performancë prej 82%, duke e renditur mbi mesataren e vendeve të rajonit, e cila është 80%.

Raporti ka vlerësuar pavarësinë dhe organizimin e ERE-s, si dhe aktivitetin përgjatë vitit 2025, duke përfshirë edhe ndërveprimin e ERE-së me institucionet e tjera, si Autoriteti i Konkurrencës, Instituti i Statistikave etj.

16. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE 2024-2026

Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40/2024, janë miratuar Objektivat Strategjike të ERE-s për periudhën 2024-2026. Këto objektiva i janë nënshtruar vlerësimit dhe rishikimit në dhjetor të vitit 2025. Nga analiza e ecursisë së zbatimit të objektivave për vitin 2024-2025, rezultoi sa vijon:

Objektivi 1 - Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë dhe fuqizimi i konsumatorëve

Plani i veprimit në këtë drejtim përfshinte:

- Informimi nëpërmjet të gjitha mjeteve që lehtësojnë komunikimin me konsumatorët, me qëllim që ata të marrin pjesë në mënyrë efektive në treg.
- Mbështetje dhe mbrojtje për konsumatorët e energjisë, përmes përpunimit të informacioneve që lidhen me konsumatorët në tregun e energjisë, për të vijuar më tej me përgatitjen e informacioneve lehtësisht të kuptueshëm të konsumatorëve të energjisë.
- Zhvillim i pyetësorëve me qëllim që të kuptojmë drejtë mungesat në informacion apo natyrën e informacionit që konsumatorët kanë nevojë, apo sa besim kanë konsumatorët në shërbimet që atyre ju ofrohen dhe në informacionet që marrin.

Realizimi:

- Gjatë vitit 2025, janë ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete për mbrojtjen e konsumatorëve, duke kombinuar instrumentet rregullatore, mekanizmat e trajtimit të ankesave dhe komunikimin publik përmes kanaleve tradicionale dhe rrjeteve sociale, përfshirë Instagramin. Konkretisht veprimet apo iniciativat e marra sipas Planit të Veprimit për çdo objektiv kanë konsistuar në:

Për Mbrojtjen e Konsumatorit:

1. Informimi i konsumatorëve dhe nxitja e pjesëmarrjes efektive në treg

Janë përdorur të gjitha mjetet e komunikimit institucional për të informuar konsumatorët mbi zhvillimet në tregun e energjisë, vendimet rregullatore dhe të drejtat e tyre si konsumatorë. Informimi është realizuar përmes faqes zyrtare të internetit, publikimeve periodike, njoftimeve për shtyp, si dhe përmes rrjeteve sociale, veçanërisht Instagram-it, ku informacionet komplekse janë paraqitur në formë të thjeshtuar dhe vizuale.

Gjatë vitit 2025, ERE ka vijuar me publikimin e njoftimeve dhe sqarimeve mbi çmimet e energjisë për konsumatorët familjarë, ndryshimet në faturim dhe vendimet që ndikojnë drejtpërdrejt interesat e konsumatorit fundor, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së tyre më të informuar në treg.

2. Mbështetja dhe mbrojtja e konsumatorëve të energjisë

Në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve, ERE ka garantuar funksionimin e mekanizmave administrativë për trajtimin e ankesave dhe kërkesave për orientim. Regjistrat e ankesave janë publikuar dhe përditësuar periodikisht edhe për vitin 2025, duke rritur kështu transparencën me synim besimin e konsumatorëve ndaj institucionit.

3. Përpunimi dhe ofrimi i informacionit të kuptueshëm për konsumatorët

ERE ka vijuar përpjekjet për përpunimin e informacionit teknik dhe rregullator në gjuhë të kuptueshme për konsumatorët. Kjo është reflektuar në publikimin e materialeve informuese, pyetjeve të shpeshta (FAQ), udhëzimeve për procedurat e ankesave dhe shpjegimeve mbi faturimin e energjisë elektrike.

Përdorimi i Instagramit si kanal komunikimi ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, duke mundësuar shpërndarjen e informacionit në formë të thjeshtë, të aksesueshme dhe të përshtatshme

për një audiencë më të gjerë, përfshirë konsumatorët e rinj dhe ata që nuk ndjekin kanalet tradicionale institucionale siç edhe raportuar në kuadër të zbatimit të strategjisë së komunikimit.

4. Identifikimi i nevojave, mungesave në informacion dhe niveli i besimit të konsumatorëve

Në kuadër të këtij objekti, ERE ka përdorur analizën e ankesave, kërkesave për orientim dhe komunikime të drejtpërdrejta me konsumatorët për të identifikuar boshllëqet në informacion dhe nevojat reale të tyre. Paralelisht, janë vënë në dispozicion instrumente si anketa e konsumatorit, e cila shërben për të kuptuar më mirë perceptimin, nivelin e besimit dhe pritshmëritë e konsumatorëve ndaj shërbimeve energjetike dhe informacionit të ofruar. Së fundmi është përditësuar anketa e publikuar tanimë në rrjetet sociale.

5. Bashkëpunimi institucional për forcimin e mbrojtjes së konsumatorit

ERE ka vlerësuar bashkëpunimin me institucionet e tjera përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit si një element thelbësor për realizimin e objektivave strategjikë. Në këtë kuadër, është theksuar rëndësia e koordinimit me institucione publike, autoritete dhe organizata të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Ky bashkëpunim ka synuar shkëmbimin e informacionit, harmonizimin e ndërhyrjeve dhe zhvillimin e fushatave të përbashkëta të informimit dhe edukimit të konsumatorëve, me qëllim rritjen e nivelit të mbrojtjes dhe ndërgjegjësimit të tyre në tregun e energjisë.

Gjatë muajit nëntor u zhvillua nga Milieukontakt Albania e mbështetur nga Fondacioni Federal Gjerman për Mjedisin, tavolina e rrumbullakët për Politika mbi Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme me drejtësi gjinore në Shqipëri e cila shënoi një hap të rëndësishëm drejt avancimit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme me drejtësi gjinore dhe gjithë përfshirje sociale në Shqipëri. Gjatë aktivitetit, ekipi i projektit prezantoi Dokumentin e Politikave “Komunitete të Energjisë me Barazi Gjinore dhe Sociale në Shqipëri”, i ndjekur nga një shkëmbim frymëzues i praktikave më të mira ndërkombëtare dhe një diskutim dinamik politikash. ERE prezantoi perspektiva kyçe mbi kornizat rregullatore për nxitjen e modeleve të qëndrueshme dhe të drejtuara nga komuniteti.

Së fundmi në kuadër të angazhimit për mbrojtjen e konsumatorit dhe forcimin e dialogut institucional me shoqërinë civile, ERE mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Qendra ALERT, një aktivitet me temë “Konsumatorët dhe zgjidhja e ankesave nga Linja e Gjelbër – prezantimi i rezultateve të një viti dhe pyetësi për konsumatorët”. ERE vlerësoi ftesën dhe nismën e Qendrës ALERT, si një mekanizëm i rëndësishëm komunikimi dhe orientimi për konsumatorët, si dhe faktin që ALERT ka vendosur një urë bashkëpunimi edhe me institucionin e ERE-s, duke krijuar premisat për një bashkëpunim afatgjatë, në të njëjtën linjë me marrëdhëniet e vazhdueshme dhe konstruktive që ERE ka ndërtuar ndër vite me shoqata të tjera të konsumatorëve, të cilat ishin gjithashtu pjesë e këtij aktiviteti.

Po ashtu Plani i Veprimit në Objektivat Strategjik parashikon që Politika e ERE-s në mbrojtjen e konsumatorit *të marrë në konsideratë edhe promovimin e politikës me fokus grupe* në përgatitjen e informacioneve të tilla, si ato për përdorimin eficient të energjisë, programet e veçanta për të përfutur nga skemat qeveritare apo dhe ato të shoqatave me fokus mbështetjen e konsumatorit.

Aktivitetet e ERE-s për politikën e mbrojtjes së konsumatorit me fokus grupe dhe përdorim eficient të energjisë kanë përfshirë:

1. Promovimi i përdorimit eficient të energjisë

ERE ka publikuar materiale edukative për konsumatorët familjarë dhe bizneset e vogla, duke shpjeguar mënyrat për të përdorur energjinë në mënyrë eficiente. Postimet në Instagram përfshijnë këshilla praktike, infografikë dhe materiale vizuale që tregojnë konsum racional të energjisë,

nxisin reduktimin e humbjeve dhe konsumit të panevojshëm, si dhe janë më përputhje me programet qeveritare për eficiencë energjetike.

2. Promovimi i skemave qeveritare dhe përfitimeve për konsumatorët

ERE ka informuar publikisht për programet qeveritare që ofrojnë stimuj për përdorimin eficient të energjisë ose për të përfituar mbështetje financiare.

Postimet përfshijnë udhëzime se si konsumatorët mund të aplikojnë për këto programe dhe të marrin përfitimet përkatëse. Për shembull, materiale që shpjegojnë si të përfitojnë nga subvencionet për energjinë e rinovueshme ose për pajisje eficiente energjetike.

3. Edukimi dhe pjesëmarrja në Komunitetet e Energjisë

ERE ka promovuar pjesëmarrjen e konsumatorëve dhe organizatave lokale në Komunitetet e Energjisë.

4. Fokus grupe dhe segmente të veçanta konsumatorësh

Përveç konsumatorëve familjarë, ERE ka targetuar grupet vulnerabël, duke i orientuar drejt programeve të eficiencës energjetike dhe skemave të mbështetjes financiare.

Këto informacione shpërndahen përmes postimeve vizuale në Instagram, ku jepen:

- udhëzime të thjeshta,
- kontakte për pyetje të drejtpërdrejta,
- informacione dhe fushata të ndërgjegjësimit.

Po ashtu në funksion të këtij objekti ERE duhet të zhvillonte Strategjinë e saj për mbrojtjen e Konsumatorëve.

ERE ka bashkëpunuar me Ministrinë e Ekonomisë duke dhënë kontributin e saj përmes komenteve dhe propozimeve konkrete në kuadër të draftimit të ligjt për mbrojtjen e konsumatorit, pasqyruar kjo edhe në relacionin shoqëruar të prezantimit të projekt-ligjit. Po ashtu është punuar për draftimin e Strategjisë së ERE për mbrojtjen e konsumatorit në përputhje me strategjinë kombëtare të mbrojtjes së konsumatorit, finalizimi i së cilës është parashikuar brenda vitit 2026.

Një tjetër objektivi është plotësimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator si politikë e mbrojtjes së konsumatorit për t'iu përgjigjur mjedisit të ndryshëm, nevojave dhe pritjeve të konsumatorëve.

Plani veprimit:

ERE është gjithashtu e fokusuar në zhvillimin e kuadrit rregullator për të adresuar qasjen e duhur në çështjet që janë shumë të rëndësishme për konsumatorët në këtë treg dinamik të energjisë. Për periudhën 2024–2025, është punuar me qëllim për të rishikuar rregulloret kyçe që adresojnë çështje thelbësore për konsumatorët në tregun e energjisë, veçanërisht në fushën e ankesave, cilësisë së furnizimit dhe marrëdhënieve kontraktuale, si dhe duke miratuar udhëzime të posaçme që adresojnë marrëdhënien furnizues konsumator.

ERE nisi procedurat për ndryshimin e Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit të transmetimit dhe atë të shpërndarjes, gjatë vitit 2025 me qëllim përmirësimin e standardeve të furnizimit dhe uljen e kohës së ndërprerjeve të energjisë.

Pjesë e planit të veprimit për mbrojtjen e konsumatorit është edhe përgatitja e informacioneve ose përfshirja e video-mesazheve apo quizeve, me qëllim vlerësimin e nivelit të njohurive të tyre mbi të drejtat që kanë, veçanërisht lidhur me ndryshimin e furnizuesit dhe arsyet pse ushtrimi i kësaj të drejte është në interes të tyre. Në funksion të edukimit është parashikuar edhe promovimi i Platformës Pct të krahasimit të çmimeve. Për realizimin e detyrës së përgatitjes së informacioneve

edukative, përfshirë video-mesazhe, quiz-e dhe promovimin e Platformës së Krahimit të Çmimeve (PCT).

Informacion edukativ mbi të drejtat e konsumatorit, përfshirë ndryshimin e furnizuesit

Në kuadër të seksionit Pyetjet më të shpeshta (FAQ) në faqen e ERE-s, ofrohen sqarime të qarta mbi të drejtën e konsumatorit për të zgjedhur dhe ndryshuar furnizuesin e energjisë elektrike; mundësitë për të krahasuar furnizuesit dhe ofertat e tyre, hapat dhe procedurat që duhet ndjekur për ndryshimin e furnizuesit.

ERE ka përdorur newsletter-at mujore të transparencës dhe publikimet e faqes zyrtare për të promovuar funksionimin dhe rëndësinë e Platformës Krahuese të Çmimeve (PCT), duke e shpjeguar rolin e saj në rritjen e transparencës dhe konkurrencës në treg, si dhe mjet për edukim të konsumatorëve.

2. Vendimmarrjet e tarifave për periudhën 2024–2025

Në janar 2025 u miratua një strukturë e re tarifore për konsumatorët familjarë, e cila parashikon ulje të çmimit në 8.5 ALL/kWh për konsum deri në 700 kWh/muaj dhe mbajtjen e çmimit 9.5 ALL/kWh për konsumin mbi këtë nivel. Kjo skemë synon të lehtësojë barrën financiare për shumicën e familjeve, duke reflektuar një qasje më të drejtë sipas nivelit të konsumit. Gjithashtu, për të garantuar stabilitet dhe parashikueshmëri, u vendos mbajtja në fuqi e tarifave ekzistuese të shpërndarjes për fillimin e vitit 2026, duke shmangur rritje të menjëhershme për konsumatorët dhe bizneset e vogla. Në tetor 2025 u miratua edhe një tarifë e re për karikimin e automjeteve elektrike, e cila reflekton kostot reale të sistemit dhe përdorimin e infrastrukturës, duke u përafruar me parimet e tarifimit të bazuar në kosto dhe eficiencë.

Elemente të tjera rregullatore që ndikojnë në tarifa të drejta për konsumatorët

a) Transparenca dhe informacioni publik mbi tarifën,

Është siguruar publikimi i listës së tarifave dhe çmimeve aktuale të energjisë elektrike dhe gazit natyror për periudha të ndryshme (p.sh., 1 janar – 31 dhjetor 2024, 2025).

ERE ka vendosur si pjesë integrale të Objektivave Strategjike 2024–2026 nevojën për siguri dhe furnizim të pandërprerë të energjisë, duke e lidhur këtë qëllim direkt me interesin e konsumatorit për shërbim të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Plani i veprimit përfshin vendimmarrje të kujdesshme për investime që lidhen me sigurinë e furnizimit, dhe që fuqizojnë me tej rrjetin dhe janë të hapur ndaj zhvillimeve teknologjike. Gjatë vitit 2025 ERE filloi procedurat e shqyrtimit dhe në fillim të vitit 2026 ERE miratoi ndryshimin dhe rishikimin e rregullores që përcakton standardet e cilësisë së furnizimit dhe sigurisë së rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike.

Objektivi 3

Të përdorim ekspertizën tonë për të informuar mbi zhvillimet e tregut të energjisë dhe për të mbështetur tranzicionin energjitik.

Plani i veprimit për realizimin e këtij objektivi ka përfshirë, Raportet vjetore dhe katër mujore të tregut të energjisë elektrike të cilat ofrojnë të dhëna mbi prodhimin, importin, eksportin, konsumatorët dhe performancën e sistemeve.

ERE ka përdorur kanalet e komunikimit digjital, përfshirë faqen zyrtare dhe Instagram, për të publikuar grafikë, statistika dhe mesazhe të thjeshta edukative mbi ndryshimet në treg dhe praktikën më të mira të përdorimit të energjisë. Në seksionin “Studime” të faqes zyrtare të ERE-s për periudhën 2024–2025. Këto studime janë pjesë e ekspertizës së ERE-s për informim mbi zhvillimet e tregut të energjisë dhe sfidat e tij. Gjatë periudhës 2024–2025, ERE ka kryer Vlerësim mbi politikën rregullatore për mbrojtjen e klientëve në nevojë në sektorin e energjisë elektrike, si:

Studim i fokusuar në politikat që mbrojnë konsumatorët; Gjetjet paraprake dhe studimi mbi konsumin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe sjellja konsumatorë dhe Analizë për teknologjitë e ngarkimit të automjeteve elektrike dhe rregullimet tarifore.

Objektiva të tjerë - Zhvillimi i Burimeve të Rinovueshme

Veprimtaria e ERE-s, referuar edhe rekomandimeve në rezolutën e Kuvendit, për promovimin e programeve për zhvillimin e burimeve të rinovueshme, eficiencën e energjisë ka përfshirë:

Planin e veprimit

Politikat e promovimit të Burimeve të Rinovueshme - ERE do të vijojë punën për miratimin e akteve rregullatore të percaktuara në ligjin për burimet e rinovueshme. Në mbështetje të Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE si autoritet përgjegjës për lëshimin e garancive të origjinës, dhe si pjesë e sistemit rajonal të garancive të origjinës të krijuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ka krijuar regjistrin elektronik të GO-ve, i cili mirëmbahet nga European Energy Exchange AG (ish-Grexel Ltd), si ofrues i përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Ky regjistër është teknikisht në përputhje me standardet e Sistemit Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS). Gjithashtu, ERE ka vijuar punën me asistencën e AIB (Shoqata e organeve lëshuese) për anëtarësimin në skemën e energjisë elektrike të AIB, e cila do të garantojë përputhshmërinë e plotë me sistemin EECS.

Objektivat e përditësuara për vitin 2026, synojnë që të arrijnë përmbushjen e detyrave sa vijon:

1. Vijimi i Liberalizimit dhe monitorimit të tregut

Forcimi i transparencës dhe integritetit në tregun me shumicë të energjisë.

2. Zhvillimi i burimeve të rinovueshme (BRE)

Integrimi dhe promovimi i energjisë së rinovueshme në treg.

3. Përmirësimi i kuadrit teknik dhe rregullator

Përshtatja e rrjeteve me zhvillimet e reja në treg dhe BRE.

4. Integrimi evropian dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

Përafrimi me kuadrin dhe institucionet e BE.

5. Barazia gjinore dhe përfshirja

Krijimi i një mjedisi pune të barabartë dhe gjithëpërfshirës.

6. Vlerësimi i metodologjive aktuale të Tarifave të operatorëve të Rrjetit

Vlerësimi i metodologjive që të garantojnë reflektimin e nevojat e kohës.

7. Përcaktimi i Operatorit të nominuar të tregut të energjisë elektrike (NEMO-s)

Përzgjedhja e NEMO-s sipas CACM

8. Rishikimi i Kodeve të rrjetit në harmoni

Shqyrtimi i propozimeve të operatorëve në përputhje me zhvillimet e legjislacionit në fuqi

9. Rishikimi i Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Përditësim sipas kërkesave të kohës

10. Draftimi i Strategjisë së ERE-s për mbrojtjen e konsumatorit

Harmonizimi i strategjisë në përputhje me strategjinë kombëtare të mbrojtjes së konsumatorit

Aneks 1: Raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare

PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2025
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)

NIPT: K517170241
Adresa: Rruga Irfan Tomini,
Njesia nr.7
Tiranë, Shqipëri
e-mail: erealb@ere.gov.al

Tiranë, më 19/03/2026

Enti Rregullator i Energjisë -ERE
 Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2022
 (Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

Përmbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar	2
Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet)	3
Pasqyra e ndryshimit të Fodeve	4
Pasqyra e flukseve monetare	5
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare	6
A. Informacion i përgjithshëm	6
B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare	6
C. Politikat kontabile	7
1. Transaksionet në monedhë të huaj	7
2. Instrumentat financiare	8
3. Inventaret	10
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t)	10
5. Qiratë	11
6. Transaksionet me palët e lidhura	11
7. Grantet qeveritare	11
8. Të Ardhurat dhe shpenzimet	11
9. Përfitimet e punonjësve	12
10. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara	12
11. Korrigjimi i gabimeve	12
12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare	12
D. Shënimet për Pozicionet Financiare	13
1. Mjetet monetare	13
2. Të arkëtueshme	13
3. Inventarët	14
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM) dhe Jo Materiale (AAJM)	14
5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	14
6. Të ardhurat nga aktiviteti	15
7. Shpenzimet për personelin	15
8. Shpenzimet për amortizimin dhe zhvlerësimi	15
9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi	15
10. Shpenzime financiare	16
11. Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve	16
12. Teprica e Fondeve më 31.12.2022	16
13. Palet e lidhura	16
14. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	16
15. Kontrolle tatimore	16
16. Ngjarje pas datës së bilancit	17

Enti Rregullator i Energjisë -ERE
Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbylltur 31 Dhjetor 2022
(Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	1	139,586,147	175,067,371
Investime		-	-
Te drejta te arketueshme			
Nga aktiviteti i shfrytezimit	2	53,557,073	13,535,166
Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te tjera		241,351	214,803
Inventaret		-	-
Inventar i konsumueshem për aktivitetin	3	1,021,719	1,212,094
Shpenzime te shtyra		-	-
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		194,406,290	190,029,434
Aktive afatgjate			
Aktive financiare		-	-
Aktive materiale		-	-
Mjete Transporti	4	2,292,851	3,041,878
Mobilje dhe pajisje zyre	4	7,106,097	4,198,845
Pajisje informatike	4	23,092,837	16,200,396
Aktive jo materiale		-	-
Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te naiashme	4	48,485,782	66,511,873
Parapagime per AAJM		-	-
Aktivet tatimore te shtyra		-	-
Totali i aktiveve afatgjate		80,977,567	89,952,993
Totali i Aktiveve		275,383,858	279,982,427
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	5	13,191,925	10,293,155
Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve	5	19,771,173	3,736,134
Te pagueshme per detyrime tatimore	5	7,562,049	7,205,063
Te tjera te pagueshme	5	1,895,001	2,970,101
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		42,420,147	24,204,453
Detyrime afatgjate			
Totali i detyrimeve afatgjate		-	-
Detyrime Totale		42,420,147	24,204,453
Fondet të akumuluar - ERE		255,777,973	214,044,707
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	11	(22,814,263)	41,733,266
Shuma		232,963,710	255,777,973
Totali i Detyrimeve dhe i Fondeve		275,383,858	279,982,426

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Diana Alibali



Kryetar
Petrit Ahmeti



2

Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet)

		Viti 2025	Viti 2024
Te ardhura te shfrytezimit			
Te ardhurat nga Faturimi i Operatoreve	6	392,349,154	368,757,289
Te ardhurat nga Licensimi	6	18,200,000	25,720,000
Te tjera te ardhura te shfrytezimit	6	1,236,952	3,432,984
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	-
Shpenzime te personelit		-	-
Paga dhe shperblime	7	(297,897,765)	(242,966,527)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsores	7	(26,403,538)	(22,041,261)
Shpenzimet per pensionet dhe sigurim privat	7	(16,537,931)	(19,764,500)
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(25,173,148)	(25,585,596)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	9	(68,697,114)	(46,021,099)
Te ardhura te tjera		-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe		-	-
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	10	-	379,209
Shpenzime te tjera financiare	10	109,127	(177,234)
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga		-	-
Fitimi/(humbja) para tatimit	11	-22,814,263	41,733,266
Tatimi mbi fitimin			-
Tatimi mbi fitimin e periudhes			-
Tatim fitimi i shtyre			
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve		-22,814,263	41,733,266

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Diana Alibali

Diana Alibali

Kryetar
Petrir Ahmeti



Pasqyra e ndryshimit të Fodeve

	Fondet Të Akumuluar - ERE	Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	Totali
Pozicioni financiar ne fillim 01.01.2024	196,267,004	20,958,749	217,225,753
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile			-
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	196,267,004	20,958,749	217,225,753
Rezultati viti paraardhes	20,958,749	(20,958,749)	-
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit		41,733,266	41,733,266
Korrigjim për periudhat e mëparshme	(3,181,046)		(3,181,046)
Pozicioni financiar ne fund 31.12.2024	214,044,708	41,733,266	255,777,973
Rezultati viti paraardhes	41,733,266	(41,733,266)	-
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	-	(22,814,263)	(22,814,263)
Korrigjim për periudhat e mëparshme	-		
Pozicioni financiar ne fund 31.12.2025	255,777,973	- 22,814,263	232,963,710

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Diana Alibali



Kryetar
Petrit Ahmeti



Pasqyra e flukseve monetare

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	- 22,814,263	41,733,266
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	25,173,148	25,585,596
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketveshme dhe te tjera	- 40,048,454	- 5,278,826
Renie/(Rritje) ne inventar	190,374	3,261,976
Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme	18,215,694	6,043,832
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	- 19,283,500	71,345,844
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	- 16,197,723	- 362,880
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	- 16,197,723	- 362,880
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	-	-
Ndryshimi i Fondit te akumuluar per periudha te meparshme	-	- 3,181,046
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	-	- 3,181,046
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	- 35,481,223	67,801,919
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	175,067,371	107,265,452
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	139,586,148	175,067,371

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Diana Alibali

Kryetar
Petrir Ahmeti

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

A. Informacion i përgjithshëm

ERE është person juridik publik, i pavarur nga interesat e industrisë së energjisë dhe nga organet shtetërore. ERE është krijuar në vitin 1995 dhe aktualisht funksionon në bazë të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".

Misioni i Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë është:

- Garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.
- Rregullimi i marrëdhënieve në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, i cili vendos rregullat lidhur me:
 - a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
 - b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
 - c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
 - ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;
 - d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike.

Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë është Z. **Petrit Ahmeti**

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2025-31.12.2025.

B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKKP) dhe Ligjin Nr. 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike. Pasqyrat financiare të datës 31 Dhjetor 2025 janë përgatitur në programin e kontabilitetit Financa 5.

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të Entit në 31 Dhjetor 2024.

Qëndrueshmëria e Paraqitjes

Një njësi ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Enti do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar gjatë.

Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-t kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

- Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve apo debitorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve apo debitorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së tyre. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël nëse ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

- Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Enti vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste Enti provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

C. Politikat kontabile

Enti ka aplikuar politikat e mëposhtme kontabël për periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare individuale.

1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivët dhe pasivët monetarë në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të perdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

	31.12.2025	31.12.2024
Kurse e kembimit		
Euro/Leke	96.77	98.15
USD/ Leke	82.46	94.26

2. Instrumentat financiare

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër. Instrumentat financiarë të Entit përbëhen nga: mjetet monetare; depozita pa afat dhe depozita me afat fiks ku njësia ekonomike është depozituesi [psh llogaritë bankare]; letra tregtare dhe kambiale tregtare; llogari, dëftesa dhe hua të arkëtueshme dhe të pagueshme; obligacione dhe instrumenta të ngjashme borxhi; zotim për të marrë një hua nëse zotimi nuk mund të paguhet në mjete monetare mjetet monetare.

Aktivitet financiar çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur Enti transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivitet financiar në një transaksion në të cilin të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitet financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën Enti angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse Enti bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të Instrumentave financiar kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Enti angazhohet të blejë apo të shesë Instrumentin financiar. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe, për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Vlerësimi i mëpasshëm

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

Llogaritë e arkëtueshme, tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Enti e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen apo përfundojnë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Enti nuk ka hua të marra ose të dhëna deri më 31 dhjetor 2025.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël, Enti nuk ka aplikuar vlerë të drejtë.

Netimi i instrumentave financiarë

Aktivet dhe pasivet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivet njëkohësisht.

Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvlerësime të aktiveve jo - financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo- financiare të , rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Ç`regjistrimi i instrumentave financiarë

Aktivitetet financiare së bashku me fondin rezerve të zhvlerësimit ç`regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Enti transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Entit perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Inventaret

Inventaret regjistrohen në konatbilitet me kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e inventarit në vendin e përcaktuar. Për përcaktimin e koston të inventareve është zgjedhur metoda e koston mesatare.

4. Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM-t)

Njohja dhe Matja: Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja Mepashme: AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston të elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe nëse ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjesë minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësia jone ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit të AAM-ve metodën linear ndërsa normat e amortizimit janë përdorur normat menaxherial si më poshtë që janë të njëjta me normat fiskale:

Llojet e Aktiveve Afatgjata	Normat e aplikuara	Metoda e aplikuar
Materiale		
Ndertesa	5%	Lineare
Makineri dhe pajisje	20%	Lineare
Mjete transporti	20%	Lineare
Mobilje dhe Orendi	20%	Lineare
Të tjera	20%	Lineare
Pajisje Informatike	25%	Lineare
Jomateriale		
Konçesione, patenta, licenca etj.	20%	Lineare

Tokat dhe Investimet në proçes nuk amortizohen.

*Ç`regjistrimi:* Një zë i aktiveve afatgjatë materiale ç`regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjatë materiale përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Enti vlerëson në datën raportimi nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Aktivët Afatgjatë Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivët afatgjatë jomateriale përfshijnë licencat, të drejtat për përdorim dhe emri i mire.

Njohja dhe Matja: Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga Enti paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Amortizimi: Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar (SKK 5) të aktiveve të patrupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Enti e vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

5. Qiratë

Qiratë klasifikohen si qira financiare ose qira operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me më të voglën midis vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivitetit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kohëzgjatjes së qirasë me norma interesi të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Enti nuk ka qira financiare.

6. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influence të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

7. Grantet qeveritare

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se grantet qeveritare do të merren dhe Enti do të jetë në përputhje me konditat që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të , njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të njëjtën periudhë në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të , njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

8. Të Ardhurat dhe shpenzimet

Të Ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në Entin dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerë të drejtë të shërbimit të shitur pa TVSH. Dy burimet e të ardhurave janë pagesat e të liçensuarve për tarifën e licensës për ushtrimin e aktivitetit në tregun e energjisë dhe Tarifën vjetore për rregullatorin bazuar në vendimet e bordit të ERE-s.

Shpenzimet

Enti njeh shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me kryerjen e tyre në datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshem nga drejtimi i .

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

9. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Enti paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute.

Kontributet e në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Enti njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të çmuara lidhur me lejen vjetore për tu paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

10. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten vetëm në shënimet shpjeguese, për sa kohë që mundësia e një daljeje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënime kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundur. Vlera e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që, një detyrim ka lindur në datën e raportimit financiar, dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

11. Korrigjimi i gabimeve

Gabimet mund të shfaqen në njohjen, matjen, prezantimin ose paraqitjen e zërave të pasqyrave financiare. Paraqitjet e gabuara materiale në pasqyrën e pozicionit financiar janë materiale nëse ato, individualisht ose të grupuara, mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që përdoruesit marrin bazuar në pasqyrat financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e konstatimit të gabuar ose të gjykimit të gabuar për shkak të rrethanave. Madhësia ose natyra e zërit financiar, ose një kombinim i të dyjave, mund të jetë faktor përcaktues.

12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare

Ngjarjet pas datës së bilancit që përmbajnë informacion shtesë të, në datën e bilancit kontabel (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

D. Shënimet për Pozicionet Financiare

1. Mjetet monetare

Veprimet e lëvizjeve monetare në librat e arkës dhe bankës, janë veprime të autorizuar, mbështeten në dokumenta që justifikojnë pagesat dhe arkëtimet, regjistrimet janë kronologjike. Për gjëndjen në valutë është bërë rivlerësimi me kursin fikse të bankës Shqipërisë në datën 31.12.2025 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e Entit.

Llogarite Bankare Sipas bankave	Monedha	31 Dhjetor 2025		31 Dhjetor 2024	
		Ekuivalenca në lek	Vlefëta në Monedhe	Ekuivalenca në lek	Vlefëta në Monedhe
Banka Kombetare Tregtare	lek	96,939,775		168,672,703	
Raiffaisen Bank Lek	lek	36,236,659		231,514	
Union Bank	lek	1,100,868		293,684	
American Bank of Investments	lek	480,191			
Banka Kombetare Tregtare	euro	2,701,012	27,911.67	3,719,269	37,893.72
Union Bank Euro	euro	1,198,455	12,384.57	1,054,082	10,739.50
Union Bank Cards	euro	(193,737)	(2,002.04)	62,875	640.60
American Bank of Investments E	euro	710,695	7,344.17		
Banka Kombetare Tregtare	usd	86,140	1,044.63	54,156	574.54
Totali		139,260,059		174,088,283	

Mjete monetare banke	Monedha	31 Dhjetor 2025		31 Dhjetor 2024	
		Ekuivalenca në lek	Vlefëta në Monedhe	Ekuivalenca në lek	Vlefëta në Monedhe
Llogari Rrjedhëse	lek	134,757,493		169,197,901	
Llogari Rrjedhëse	euro	4,416,425	45,638	4,836,225	49,274
Llogari Rrjedhëse	usd	86,140	1,045	54,156	575
Totali		139,260,059		174,088,283	

Mjete monetare në arke	Monedha	31 Dhjetor 2025		31 Dhjetor 2024	
		Ekuivalenca në lek	Vlefëta në Monedhe	Ekuivalenca në lek	Vlefëta në Monedhe
Arka në Lek	lek	13,669		19,813	
Arka në Euro	euro	294,773	3,046	865,204	9,003
Arka në USD	usd	17,646	214	94,071	998
Totali		326,088		979,088	

2. Të arkëtueshme

Te drejta te arkëtueshme

	Dt.31.12.2025	Dt.31.12.2024
Kliente pa arkëtuar viti ushtrimor	53,907,309	13,885,403
Kreditor ndër vite më shumë se 360 ditë	- 350,236	- 350,236
Shuma	53,557,073	13,535,166

Shënim: Në periudhën janar – shkurt 2026 është arkëtuar vlera 50,051,760 leke nga pagesa rregullatore 2025

Të tjera të arkëtueshme

	Dt.31.12.2025	Dt.31.12.2024
Te tjera te arkëtueshme nga punonjësit	241,351	214,803
Shuma	241,351	214,803

Shënim: Në këtë zë, në vitin 2024 ishte klasifikuar gabim vlera 3,949,699 lekë, që i perket detyrimeve për pensionet private

3. Inventarët

	Dt.31.12.2025	Dt.31.12.2024
Inventar i konsumueshëm për aktivitetin	1,021,719	1,212,094
Shuma	1,021,719	1,212,094

4. Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM) dhe Jo Materiale (AAJM)

Aktive Afatgjatë Materiale

	Studime zhvillimi	Mjete Transporti	Paisje Zyresh	Te tjera paisje dhe Informatike	Total
Vlera bruto e AAM me 31.12.2023	122,434,894	27,592,000	17,446,259	50,637,948	218,111,101
Shtesa gjatë 2024 Pakesime			58,000	304,880	362,880
Vlera bruto e AAM me 31.12.2024	122,434,894	27,592,000	17,504,259	50,942,828	218,473,981
Shtesa gjatë 2025 Pakesime	(188,604)	-	4,004,740 (1,298,092)	12,448,790 (2,800,470)	16,453,530 (4,287,166)
Vlera bruto e AAM me 31.12.2025	122,246,290	27,592,000	20,210,907	60,591,147	230,640,345
Amortizimi i akumuluar 31.12.2023	37,557,787	23,789,652	12,260,537	29,327,417	102,935,392
Shtesa gjatë 2024 Pakesime	18,365,234	760,470	1,044,878	5,415,015	25,585,596
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2024	55,923,021	24,550,121	13,305,415	34,742,432	128,520,989
Shtesa gjatë 2025 Pakesime	17,986,013 (148,526)	749,027	1,037,913 (1,238,517)	5,400,195 (2,644,317)	25,173,148 (4,031,359)
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2025	73,760,508	25,299,148	13,104,811	37,498,310	149,662,777
Vlera neto e AAM 2024	66,511,873	3,041,879	4,198,844	16,200,396	89,952,993
Vlera neto e AAM 2025	48,485,782	2,292,852	7,106,096	23,092,837	80,977,567

5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

Detyrime të pagueshme afatshkurtra

	Dt.31.12.2025	Dt.31.12.2024
Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	13,191,925	10,293,155
Paga e shperblime	15,998,660	135,736
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	3,772,513	3,600,398
Pensione private	1,895,001	2,970,101
Tatim mbi te ardhurat e personale	7,562,090	7,182,743
Tatimi ne burim	(41)	22,320
Shuma	42,420,147	24,204,453

Në zërin pensione private në vitin 2024 ishte klasifikuar gabim vlera 3,949,699 lekë në zërin "të drejta të tjera të arkëtueshme. Janë rriklasifikuar në zërat e duhur si vlera krahasuese të pasqyrave financiare të vitit 2025

6. Të ardhurat nga aktiviteti

	Viti 2025	Viti 2024
Te ardhurat nga Faturimi I Operatoreve	392,349,154	368,757,289
Te ardhurat nga Licensimi	18,200,000	25,720,000
Te tjera te ardhura te shfrytezimit	1,236,952	3,432,984
Shuma	411,786,106	397,910,274

7. Shpenzimet për personelin

	Viti 2025	Viti 2024
Paga dhe shperblime	- 297,897,765	-242,966,527
	- 26,403,538	
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore		- 22,041,261
Shpenzimet per pensionet dhe sigurim privat	- 16,537,931	- 19,764,500
Shuma	- 340,839,234	-284,772,288

Bazuar në nenin 11 pika 7 te ligjit 43/2015, bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit. Në përcaktimin e masës së pagës dhe trajtimeve financiare apo jofinanciare të personelit, bordi merr parasysh kushtet e tregut dhe nivelin e pagave në shoqëritë që kontrollohen në sektorin që mbulon.

8. Shpenzimet për amortizimin dhe zhvlerësimi

	Viti 2025	Viti 2024
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	- 25,173,148	- 25,585,596
Shuma	- 25,173,148	- 25,585,596

9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	Viti 2025	Viti 2024
Kosto e inventarit te shpenzuar	- 2,700,210	- 2,324,714
Sherbime te ndryshme nga te trete	- 4,483,938	- 3,409,543
Qera	- 19,544,380	- 1,785,600
Sherbim roje godine	- 11,030,094	- 11,030,094
Shpenzime uje energji	- 711,389	- 752,406
Mirmbajtje, automjete e taksa te lidhura me to	- 761,441	- 871,206
Publikime ne media	- 621,500	- 770,400
Udhetime dieta J.vendit; kuotizacion	- 20,371,188	- 15,708,797
Poste telefon etj	- 1,231,441	- 1,169,712
Anetaresime ne Organizmat nderkombetare te Energji:	- 3,439,156	- 3,003,984
Sherbimi per plaformen G.O.	- 3,051,408	
Taksa dhe tarifa vendore	- 103,274	- 94,445
Kosto e inventareve te nxjerra jashte perdorimit	- 255,807	
Te tjera	- 391,887	- 5,100,198
Shuma	- 68,697,114	- 46,021,099

10. Shpenzime financiare

	Viti 2025	Viti 2024
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	-	379,209
Humbje nga kembimet valutore	- 85,014	(233,591)
Fitim nga kembimet valutore	1,350	-
Shpenzime te tjera financiare	192,791	56,357
Shuma	109,127	201,975

11. Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve

	Viti 2025	Viti 2024
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	- 22,814,263	41,733,266
Shuma	- 22,814,263	41,733,266

12. Teprica e Fondeve më 31.12.2025

	Viti 2025	Viti 2024
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve	- 22,814,263	41,733,266
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	25,173,148	25,585,596
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve - e korrigjuar (pa amortizimin)	2,358,885	67,318,862

Gjendje Mjete Monetare ne fund	139,586,147	175,067,371
Furnitorë papaguar	- 13,191,925	- 10,293,155
Klientë pa-arkëtuar	53,557,073	13,535,166
Të tjera të arkëtueshme / pagueshme neto	- 28,986,872	- 13,696,494
Të arkëtueshme/pagueshme neto 31.12.2025	11,378,276	- 10,454,483
Teprice e fondeve transferuar ne vitin pasardhes	150,964,423	164,612,888

13. Palët e lidhura

Palët quhen të lidhura kur njëra prej tyre ka mundësinë të kontrollojë palët e tjera ose të ushtroje ndikim domethënës në vendim-marrjen financiare dhe operacionale të tyre.

14. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Shoqëria ka ndjekur procedura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët. Në datën e raportimit, situata paraqitet si më poshtë:

Me 31 Dhjetor 2025 çështjet gjyqësore të përfunduara në favor të shoqërisë janë në vlerën 800,000 lekë. Këto shuma janë njohur si të ardhura dhe si të arkëtueshme, pasi vendimet gjyqësore janë në favor të shoqërisë. Megjithatë, arkëtimi i tyre mbetet subjekt i procedurave të ekzekutimit.

Ndërsa çështjet gjyqësore në proces janë në vlerën totale prej 1,080,000 lekë, për të cilat rezultati përfundimtar nuk është ende i sigurt në momentin e raportimit.

Shoqëria nuk ka krijuar provigjione për humbje të mundshme në lidhje me këto çështje, pasi menaxhimi vlerëson se:

-Për çështjet e përfunduara në favor, nuk ekziston një detyrim që kërkon njohjen e provigjionit; këto shuma përfaqësojnë aktive financiare, për të cilat rreziku kryesor lidhet me arkëtueshmërinë dhe jo me ekzistencën e detyrimit.

-Për çështjet në proces, në mungesë të një vendimi përfundimtar dhe duke qenë se nuk plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e njohjes së provigjioneve (ekzistenca e një detyrimi aktual dhe probabiliteti i daljes së burimeve ekonomike), Shoqëria nuk ka njohur provigjione në pasqyrat financiare.

Menaxhimi monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e këtyre rasteve dhe do të reflektojë çdo zhvillim të rëndësishëm në periudhat pasuese.

15. Kontrollë tatimore

Librat e Entit nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 31.12.2025. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.


16. Ngjarje pas datës së bilancit

Me 31 Dhjetor 2025 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Diana Alibali



Kryetar
Petrît Ahmeti



Tiranë, më 19/03/2026

ERE-ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
PREZANTIMI I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË VITIT 2025 (ML)

QËLLIMI I AUDITIMIT PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2025

Qëllimi auditimit	Pasqyrat financiare
Auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Pasqyrave Financiare	Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, pasqyrat janë përgatitur nga ERE në përputhje me "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuar) (SKKP), Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT

Përgjegjësitë e audituesit	- Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe auditimin e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-të. Ne kemi shqyrtuar mbi bazën e testimeve të transaksioneve dhe të ekzistencës të zotërimit dhe vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve të cilat audituesit i konsiderojnë të nevojshme në shqyrtimin e evidencave që mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. - Audituesi është përgjegjës për formimin dhe shprehjen e një opinionit mbi pasqyrat financiare që janë përgatitur nga menaxhimi i Entit. Për të arritur këtë, ne kemi planifikuar dhe kryer auditimin për të siguruar një siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë të lira nga gabimet materiale. - Ne kemi marrë një kuptim të sistemeve të kontabilitetit dhe të kontrollit të brendshëm financiar në masën e nevojshme për të konsideruar përshtatshmërinë e tyre si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
-----------------------------------	---

Përgjegjësitë e menaxhimit	▪ Pasqyrat financiare • Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar. ▪ Kontrolli i brendshëm: • Kontrollët e brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare. ▪ Asistimi grupit të auditimit: • Dhënia e informacioneve dhe aksesit për audituesit: • Qasja në të gjitha informacionet që menaxhimi është i vetëdijshëm se është i rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare. • Informacione shtesë që audituesit mund të kërkojnë nga menaxhimi për qëllime të auditimit. • Akses i pakufizuar për personat brenda njësisë nga të cilët ne e përcaktojmë të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.
-----------------------------------	--

OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Për Menaxhimin dhe palët e interesuara	Opinion dhe raporte të pavarura që shtojnë besueshmërinë e informacionit financiar të paraqitur.
Për menaxhimin	Vëzhgime dhe këshilla për raportimin financiar, çështje të tatimeve nga profesionistë të lartë që kanë një kuptim të thellë të veprimtarisë tuaj. Ne gjithashtu ndajmë përvojën e praktikave më të mira për Entet Rregullatore.

QASJA E AUDITIMIT

Shkurt Mars 2026	Kryerja dhe finalizimi i punës pranë zyrave të klientit, kryerja e procedurave thelbësore. Procedurat finale të auditimit, konkluzionet dhe raportimi.
-------------------------	--

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	1	139,586,147	175,067,371
Investime		-	-
Te drejta te arketueshme		-	-
Nga aktiviteti i shfrytezimit	2	53,557,073	13,535,166
Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te tjera		241,351	214,803
Inventaret		-	-
Inventar i konsumueshem për aktivitetin	3	1,021,719	1,212,094
Shpenzime te shtyra		-	-
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		194,406,290	190,029,434
Aktive afatgjate			
Aktive financiare		-	-
Aktive materiale		-	-
Mjete Transporti	4	2,292,851	3,041,878
Mobilje dhe pajisje zyre	4	7,106,097	4,198,845
Pajisje informatike	4	23,092,837	16,200,396
Aktive jo materiale		-	-
Konsensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te naishme	4	48,485,782	66,511,873
Parapagime per AAJM		-	-
Aktivet tatimore te shtyra		-	-
Totali i aktiveve afatgjate		80,977,567	89,952,993
Totali i Aktiveve		275,383,858	279,982,427
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	5	13,191,925	10,293,155
Te pagueshme ndaj punonjeseve dhe sigurimeve	5	19,771,173	3,736,134
Te pagueshme per detyrime tatimore	5	7,562,049	7,205,063
Te tjera te pagueshme	5	1,895,001	2,970,101
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara		-	-
Te ardhura te shtyra		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		42,420,147	24,204,453
Detyrime afatgjate			
Totali i detyrimeve afatgjate		-	-
Detyrime Totale		42,420,147	24,204,453
Fondet të akumuluar - ERE		255,777,973	214,044,707
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	11	(22,814,263)	41,733,266
Shuma		232,963,710	255,777,973
Totali i Detyrimeve dhe i Fondeve		275,383,858	279,982,426

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

		Vili 2025	Vili 2024
Te ardhura te shfrytezimit			
Te ardhurat nga Faturimi I Operatoreve	6	392,349,154	368,757,289
Te ardhurat nga Licensimi	6	18,200,000	25,720,000
Te tjera te ardhura te shfrytezimit	6	1,236,952	3,432,984
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	-
Shpenzime te personelit		-	-
Paga dhe shperblime	7	(297,897,765)	(242,966,527)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetesore	7	(26,403,538)	(22,041,261)
Shpenzimet per pensionet dhe sigurim privat	7	(16,537,931)	(19,764,500)
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(25,173,148)	(25,585,596)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	9	(68,697,114)	(46,021,099)
Te ardhura te tjera		-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe		-	-
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	10	-	379,209
Shpenzime te tjera financiare	10	109,127	(177,234)
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga		-	-
Fitimi/(humbja) para tatimit	11	-22,814,263	41,733,266
Tatimi mbi fitimin			
Tatimi mbi fitimin e periudhes			-
Tatim fitimi i shtyre			
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve		-22,814,263	41,733,266

Entit Rregullator të Energjisë (ERE)
Letra e manaxhimit për periudhën
Janar-Dhjetor 2025

Të nderuar zotërinj,


Grupi ynë i auditimit ka ekzaminuar kontrollin e brendshëm dhe pasqyrat financiare të Entit Rregullator të Energjisë. Sistemet e kontabilitetit dhe ato të kontrollit janë verifikuar deri në masën e nevojshme që lejon përcaktimi i procedurave të auditimit për raportim në pasqyrat financiare.

Gjatë auditimit kemi evidentuar disa problematika për të cilat kemi bashkëngjitur rekomandimet tona, në mënyrë për të ndihmuar në përmirësimin e proceseve dhe për të arritur efikasitet operacionale.

Komentet dhe rekomandimet e bashkëngjitura kanë si qëllim të vetëm informimin dhe përdorimin e drejtuesve të institucionit dhe palëve të interesuara.

Faleminderit juve dhe stafit tuaj për bashkëpunimin dhe ndihmën e vazhdueshme gjatë procesit të auditimit.

Auditues Ligjor (Partner Angazhim)


Ermir Veipi


CONSULTING PARTNERS sh.p.k
License: Nr.261; 27.08.2012
Adresa: Komuna e Parisit, Pallati i Niku
Konstruktion, Kati 7, Ap. 61
consultingpartnersshpk@gmail.com

Auditues Ligjor


Kondor Çeka


License: Nr. 480; 16.09.2021
Adresa: Nj.8, nr.2, Rruga Luigj
Gurakuqi, P.18, Hyrja 4, Ap.21, Tirane
e-mail: dori.ceka@viar.al

Tiranë, më 25.03.2026

Aneks 1. Letra e menaxhimit

Gjetje	Rekomandime	Komentet e drejtimit
Përgatitja e Pasqyrave Financiare Gjatë procesit të auditimit kemi konstatuar se në pasqyrat financiare të ERE ekzistojnë të drejta të arkëtueshme në vlerën 53,798,424 lekë, nga të cilat ref. shënim nr. 2 të Pasqyrave Financiare 50,051,760 lekë janë arkëtuar në periudhën Janar-Shkurt 2026. Pjesa e mbetur prej 3,746, 664 lekë lidhet me detyrime që janë në proces gjyqësor ose pritjet të ndjekin procedura ligjore për arkëtim. ERE ka miratuar një metodologji për provigjionimin e të drejtave të arkëtueshme, nr. 350, dt. 29.12.2025	Rekomandojmë që ERE: -Të rishikojë dhe dokumentojë në mënyrë më të plotë vlerësimin e arkëtueshmërisë për shumën prej 3,746, 664 lekë, duke marrë në konsideratë jo vetëm ngjarjet pas datës të raportimit, por edhe probabilitetin e suksesit në procedurat gjyqësore dhe kohëzgjatjen e pritshme të arkëtimit, në përputhje me kërkesat e standardeve përkatëse (SKK). -Të vlerësojë nevojën për krijimin e provigjioneve (ose zhvlerësimeve) për këto ekspozime, në rast se ekzistojnë indikacione për pasiguri në arkëtim. -Të analizojë në mënyrë të detajuar çdo rast pavarësisht materialitetit të shifrës, për të minimizuar rreziqet ligjore dhe reputacionale. -Të fillojë zbatimin e metodologjisë së re të provigjionimit, duke siguruar që ajo të aplikohet në mënyrë konsistente dhe të mbështetet në evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme.	Marrim në konsideratë rekomandimin e audluesve.



Aneks 1. Letra e menaxhimit

Shtojcë

Kërkesat e Ligjit nr. 43/2015, Nenin 11 pika 7

Auditesit Audituesit kanë konstatuar se ERE ka përcaktuar pagën dhe strukturën me anë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198 datë 20.09.2024 "Miratimi i strukturës organizative dhe organizatës së ERE-s", të Vendimit të Bordit nr. 199/2024 "Rregullorja për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në ERE", i ndryshuar me Vendim të Bordit nr. 205/2024 në përputhje me ligjin nr. 35/2023, datë 25.5.2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi" dhe me sa përcaktuar në Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" nën 11 pika 7 dhe Ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".

Përgjegjësia e Drejtimit për Objektivat dhe Kufizimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm

Komentet e mëposhtme u referohen përgjegjësisë së Drejtimit për sistemin e brendshëm të kontrolleve, ku objektivat dhe kufizimet e qenësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm janë marrë nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve.

Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontrolleve të brendshme. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Drejtimi duhet të vlerësojë përfitimet dhe kostot e pritura përkatëse të politikave dhe procedurave për kontrollet e brendshme.

Objektivat

Objektivat e sistemit të kontrollit të brendshëm janë që të japin siguri drejtimi, sa më shumë të jetë e mundur, që asetet të jenë të mbrojtura nga perdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi, dhe se transaksionet janë ekzekutuar në përputhje me politikat e drejtimit dhe të regjistruhen saktë, në mënyrë që të mundësohet përgatitja në kohë e informacionit të besueshëm financiar në përputhje me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

Kufizimet

Për shkak të kufizimeve të qenësishme në çdo sistem të kontrollit të brendshëm, gabimet apo parregullsitë, mund të ndodhin dhe të mbeten të pazbuluara. Gjithashtu, parashikimi i çdo vlerësimi të sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme është subjekt i rrezikut që politikat dhe procedurat mund të bëhen të papërshtatshme për shkak të ndryshimeve të kushteve ose efektiviteti i hartimit dhe i zbatimit të politikave dhe procedurave mund të përkeqësohet.

RAPORT I AUDITUESEVE TE PAVARUR -ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)
[AUDITIM PËR PASQYRAT FINANCIARE TE VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2025]
[ADRESA: RRUGA IRFAN TOMINI, NJËSIA NR 7, TIRANË; e-mail: erealb@ere.gov.al
TIRANË, SHQIPËRI

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR**Për: Petrit Ahmeti****Kryetarit i Entit Rregullator të Energjisë***Rruga Irfan Tomini, Njësia nr. 7, Tiranë, Shqipëri***Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2025.****Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Entit Rregullator të Energjisë-ERE, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2025, pasqyrën e performancës financiare (burimeve dhe përdorimit), pasqyrën e ndryshimeve për fondet e akumuluar dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më datën 31 Dhjetor 2025, përfshirë shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar më datën 31 Dhjetor 2025, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuar) (SKKP)", Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike" [neni3 (pika 52 dhe 53); neni 11,7 ; neni 17)].

Baza për opinionin

Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKKP dhe Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" e Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike" (neni 17) dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Entitetit për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfshin opinionin e audituesit. Siguria e arsyeshme megjithëse është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Raporti i audituesve të pavarur është i vlefshëm vetëm për pasqyrat financiare 2025 bashkëlidhur.



Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritët, që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon që ne si auditues të ushtrojmë gjykimin profesional dhe të ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:


- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Entiteti të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e institucionit, përveç se çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Auditues Ligjor (Partner Angazhimi)

Ermir Veipi
 CONSULTING PARTNERS sh.p.k
 License: Nr.261; 27.08.2012
 Adresa: Komuna e Parisit, Pallati Niku
 Konstruksion, Kati 7, Ap. 61
 consultingpartnersshpk@gmail.com



Auditues Ligjor

Kondor Çeka

 License: Nr. 480; 16.09.2021
 Adresa: Nj.8, nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi,
 P.18, Hyrja 4, Ap.21, Tirane
 e-mail: dori.ceka@viar.al

Tiranë më 25/03/2026

Raporti i audituesve të pavarur është i vlefshëm vetëm për pasqyrat financiare 2025 bashkëlidhur.

Aneks 2: Raporti i Performancë

Adresa: Rr. "L. Gurakuqi", Ndëtesa 18, H.4; K.6; Ap.21,
Tiranë, Albania
T: 04 56 28 875
Web: www.viar.al



Letra për Drejtimin

Enti Rregullator i Energjisë (ERE)

24 mars 2026

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

Përmbajtja

LETET REKOMANDIMI E PROFESIONISTËVE TË PAVARUR.....	2
I. REKOMANDIME TË AUDITUESVE TË PAVARUR PËR VLERËSIMIN E PËRFORMANCËS 2025	3
1. Automatizimi i Mënyrës së Raportimit të Licensuarve Pranë ERE	3
2. Roli Proaktiv në Promovimin dhe Integrimin e Projekteve të Vetëprodhuesve të Energjisë	4
3. Forcimi i Zbatimit të Kërkesave për Sigurinë Kibernetike nga Operatorët e Sektorit.....	5
4. Përmirësimi i Transparencës Përmes Publikimit të Vendimeve dhe Përditësimit të Faqes Zyrtare të ERE-së	6
5. Forcimi i Procesit të Vlerësimit dhe Monitorimit të Planeve të Investimeve të OSSH Dhe OST	7
6. Promovimi dhe Ndërgjegjësimi për Përdorimin e Platformës së Krahasimit të Çmimeve (PCT-Price Comparison Tool).....	8
7. Forcimi i Monitorimit të Bursës ALPEX dhe Funkcionimit të Tregut të Organizuar të Energjisë	9
8. Miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut të Energjisë së Ditës në Avancë	10
9. Hartimi i Një Strategjie të Përbashkët Afatmesme për Eficiencën e Energjisë në Bashkëpunim me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë.....	11
10. Rishikimi i Rregullave dhe Standardeve të Cilësisë së Shërbimit të Ofruar nga Operatorët e Rrjetit.....	12
11. Përgatitja e Standardeve për Lëshimin e Garancive të Origjinës dhe Adresimi i Çështjeve të Konsumatorëve dhe Pjesëmarrësve të Tregut	13
12. Miratimi në Kohë i Çmimit të Energjisë Elektrike të Prodhuar nga Vetëprodhuesit e Burimeve të Rinovueshme	14
13. Implementimin e një platforme digjitale për trajtimin e ankesave.....	15
II. TABELA PËRMBLEDHËSE E 13 GJETJEVE DHE REKOMANDIMEVE.....	16
1. Ankesat konsumatore per periudhën 2008-2011	18
2. Sistemet informative dhe rreziku i sulmit kibernetik	19
III. REKOMANDIME TE TJERA.....	20

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

LETER REKOMANDIMI E PROFESIONISTËVE TË PAVARUR

Drejtuar: Kryetarit dhe Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Gjatë planifikimit dhe kryerjes së procedurave tona për shqyrtimin e informacionit jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 ("të dhëna të zgjedhura"), kemi marrë në konsideratë strukturën e kontrollit të brendshëm të Entit me qëllim përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të duhura të angazhimit. Procedurat janë planifikuar dhe kryer në përputhje me kërkesat dhe udhëzimet e Standardit Ndërkombëtar SNAS 3000 "Angazhimet e Dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet ose Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike", i cili parashikon një nivel sigurie të kufizuar.

Qëllimi ynë ka qenë të shprehim një opinion me siguri të kufizuar në lidhje me:

- **Verifikimin e informacionit shpjegues cilësor dhe sasior të paraqitur nga strukturat organizative të ERE-s në Raportin Vjetor 2025, lidhur me gjendjen dhe zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në raport me kriteret e zbatueshme ("Kriteret e Performancës") të përcaktuara në Ligjin nr. 43/2015, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 102/2015, i ndryshuar.**

Gjatë angazhimit kemi raportuar vetëm ato çështje që dolën në vëmendjen tonë, përfshirë vlerësimin e elementeve të kontrollit të brendshëm në masën e nevojshme për planifikimin e procedurave të mëtejshme, siç kërkohet nga SNAS 3000 për angazhimet me siguri të kufizuar.

Angazhimi ynë **nuk ka pasur si synim** identifikimin e dobësive të kontrollit, mashtrimeve apo parregullsive, dhe nuk duhet interpretuar si provë se të tilla nuk ekzistojnë.

Kjo letër paraqet vetëm çështjet që u identifikuan gjatë rrjedhës së punës së angazhimit dhe që, sipas vlerësimit tonë profesional, meritojnë t'i sillen në vëmendje drejtimit dhe Bordit. Ajo **nuk synon** të listojë të gjitha rreziqet apo dobësitë e mundshme të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe **nuk zëvendëson** një shqyrtim të plotë të kontrollit të brendshëm.

Ky raport lëshohet ekskluzivisht për Drejtimin dhe Bordin e ERE-s dhe **nuk është i transferueshëm** për përdorim nga palë të tjera.

Dëshirojmë të shprehim vlerësimin tonë për bashkëpunimin dhe mbështetjen e ofruar nga stafi dhe drejtimi i ERE-s gjatë gjithë procesit të angazhimit

Nexia-Albania sh.p.k
Orjana Kalaja

Auditues Ligjor
License Nr.284



Viar-Consulting

Fatime Alliu

Auditues Ligjor
License Nr.166



2

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

I. REKOMANDIME TË AUDITUESVE TË PAVARUR PËR VLERËSIMIN E PËRFORMANCËS 2025

1. Automatizimi i Mënyrës së Raportimit të Licensuarve Pranë ERE

Çështje

Gjatë procedurave tona për shqyrtimin e informacionit jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025, u konstatua se përpunimi i të dhënave të lidhura me Bilancin Energjetik vijon të kryhet në formate Excel pranë departamentit të monitorimit, bazuar në raportimet e operatorëve të licencuar.

Formatet e paraqitjes së të dhënave ndryshojnë ndërmjet operatorëve, duke kërkuar konsolidim manual nga ERE. Kjo rrit ngarkesën operative dhe ekspozimin ndaj gabimeve të përpunimit.

Impakti

Mungesa e një mjeti të unifikuar raportimi kufizon efikasitetin, saktësinë dhe konsistencën e të dhënave të përdorura për përgatitjen e Raportit Vjetor, i cili përgatitet në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.

Proceset manuale e bëjnë të vështirë garantimin e cilësisë së informacionit, si dhe cenojnë kapacitetin e ERE për të kryer inspektime të plota, të thelluara dhe rastësore ndaj operatorëve të licencuar, duke rritur rrezikun e pasaktësive në raportim.

Rekomandimi

Rekomandohet zhvillimi dhe implementimi i një **mjeti të standardizuar raportimi**, i cili të përdoret nga të gjithë operatorët e licencuar për paraqitjen e të dhënave të bilancit energjetik.

Ky mjet duhet të mundësojë raportimin dhe dokumentimin në format të unifikuar, të reduktojë nevojën për përpunim manual dhe të rrisë efikasitetin e konsolidimit të të dhënave nga ERE.

Përdorimi i një strukture të standardizuar raportimi do të mbështesë edhe përmirësimin e cilësisë së inspektimeve, duke krijuar një bazë të dhënash më të saktë dhe më të qëndrueshme për analizë.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Për të përmbushur këtë, ERE ka përfunduar draftimin e termave të referencës së platformës digjitale të ankesave, është realizuar testimi i tregut dhe është parashikuar në buxhet fondi për realizimin e këtij shërbimi. Platforma është konceptuar si një sistem i regjistrimit, ndjekjes dhe gjurmimit të vazhdueshëm të ecurisë së trajtimit të ankesave. Në këtë platformë, konsumatorët jo vetëm që do të adresojnë online ankesat e tyre për një eficiencë më të madhe kohe, por edhe do të mund të ndjekin në çdo kohë procesin e shqyrtimit nga ERE, adresimit të kërkesave të kësaj të fundit tek të licencuarit, përgjigjen e dokumentacionin e vënë në dispozicion nga të licencuarit që do t'i shërbejë zgjidhjes së ankesës si dhe së fundmi, zgjidhjen e dhënë nga ERE. Pritet që platforma të jetë efiçiente brenda vitit 2026.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

2. Roli Proaktiv në Promovimin dhe Integrimin e Projekteve të Vetëprodhuesve të Energjisë

Çështje

Gjatë procedurave tona u konstatua se procesi i koordinimit ndërmjet ERE-së dhe aktorëve të ndryshëm të sektorit energjetik në lidhje me promovimin, integrimin dhe vlerësimin e projekteve të vetëprodhuesve të energjisë elektrike (prosumers) nuk është plotësisht i strukturuar dhe i harmonizuar.

Mungesa e një platforme të unifikuar bashkëpunimi ndërinstytucional dhe mungesa e një procesi të standardizuar për trajtimin e çështjeve teknike, rregullatore dhe operative mund të ngadalësojë përfshirjen e vetëprodhuesve në tregun energjetik.

Impakti

Përfshirja e pakët e projekteve të vetëprodhuesve në sistemin energjetik mund të kufizojë ritmin e rritjes së kapaciteteve të energjisë nga burimet e rinovueshme. Kjo ndikon në diversifikimin e burimeve të energjisë, zvogëlon potencialin për uljen e varësisë nga prodhimi konvencional dhe e lë sistemin më të ekspozuar ndaj ndryshimeve të kushteve klimatike. Një koordinim jo i mjaftueshëm midis institucioneve përkatëse mund të krijojë vonesa në miratimin, implementimin dhe monitorimin e projekteve të vetëprodhuesve.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të luajë një rol më proaktiv dhe të intensifikojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe palët e interesit — përfshirë institucionet qeveritare, operatorët e sistemit, komunitetin e investitorëve dhe shoqërinë civile — me qëllim adresimin e sfidave që lidhen me promovimin dhe integrimin e projekteve të vetëprodhuesve. Duhet të krijohen mekanizma të qartë koordinimi dhe shkëmbimi informacioni, të përditësohen udhëzimet dhe të standardizohen proceset për lehtësimin e integritetit të impianteve fotovoltaike dhe të burimeve të tjera të rinovueshme në rrjet. Një qasje e tillë do të mbështesë rritjen e prodhimit nga vetëprodhuesit, duke kontribuar në rritjen e sigurisë energjetike dhe uljen e ekspozimit të sistemit ndaj variabilitetit klimatik.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Draft VKM për vetëprodhuesit është percjelle në dhjetor 2025 për komente nga ana ERE-s me qëllim adresimin e sfidave që lidhen me promovimin dhe integrimin e projekteve të vetëprodhuesve. Pas miratimit të VKM, ERE do vijojë me marrjen e masave për miratimin e cmimit për vetëprodhuesit në përputhje me ligjin 23/2024. ERE ka përbushur detyrën e lenë nga rezoluta duke përgatitur programet edukuese për orientimin e konsumatorëve drejt investimeve në impiante vetëprodhuese, përfshirë hartimin e broshurave informuese mbi procedurat dhe dokumentacionin përkatës. Gjatë vitit 2025, ERE ka ndërmarrë një fushatë të mirëfilltë promovimi në rrjetet sociale me qëllim reklamimin e benefiteve që vijnë nga investimi në impiantet fotovoltaike si dhe garancinë e pavarësisë nga rrjeti që kjo energji të ofron. Po ashtu, në kuadër të detyrave për ndërgjegjësimin e konsumatorit, janë publikuar në rrjetet sociale broshura të cilat kanë pasur në fokus tematika të tilla si; Instalimin e paneleve fotovoltaike, Procedurat e lidhjes me rrjetin, Të drejtat dhe detyrimet e vetëprodhuesve, Mekanizmin e kompensimit (net-metering).

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

3. Forcimi i Zbatimit të Kërkesave për Sigurinë Kibernetike nga Operatorët e Sektorit

Çështje

Gjatë procedurave tona u vërejt se, pas miratimit të rregullores së rishikuar për sigurinë kibernetike, e cila synon rritjen e nivelit të mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike për operatorët e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, procesi i harmonizimit të operatorëve me këto kërkesa mbetet sfidues.

Disa operatorë ende nuk kanë përgatitur në mënyrë të plotë planet e detajuara të sigurisë kibernetike, dhe niveli i zbatimit praktik të masave mbrojtëse paraqet diferenca ndërmjet tyre.

Impakti

Mungesa e planeve të standardizuara dhe të dokumentuara për sigurinë kibernetike rrit ekspozimin e operatorëve ndaj incidenteve që mund të cenojnë furnizimin e pandërprerë me energji elektrike dhe gaz natyror.

Një sulm kibernetik i paadresuar në kohë ose i menaxhuar në mënyrë jo të koordinuar mund të shkaktojë ndërprerje të shërbimeve, rritje të kostove operative, dëmtim të infrastrukturës kritike dhe ulje të besueshmërisë së tregut energjetik. Mospërputhja me kërkesat e rregullores së rishikuar redukton efektivitetin e kuadrit rregullator dhe kufizon kapacitetin e ERE për të garantuar standardet e detyrueshme të sigurisë.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të kërkojë, në mënyrë rigoroze dhe të dokumentuar, që të gjithë operatorët e përfshirë të hartojnë, përditësojnë dhe zbatojnë **planet përkatëse të sigurisë kibernetike**, në përputhje me kërkesat e rregullores së rishikuar. Gjithashtu, sugjerohet forcimi i mekanizmave të monitorimit përmes kërkesave për raporte periodike, inspektimeve tematike dhe vlerësimeve të pavarura të gatishmërisë kibernetike.

Kjo qasje do të forcojë mbrojtjen e infrastrukturës kritike energjetike, duke minimizuar rrezikun e ndërprerjeve të furnizimit dhe duke rritur rezistencën e sistemit përballë sulmeve kibernetike.

Komentet e Drejtimin (ERE)

Ndryshimet e fundit në Rregulloren përkatëse përfshijnë përditësimin e referencave institucionale, zgjerimin e fushës së zbatimit të rregullores në sektorin e gazit natyror, përfshirjen e infrastrukturave të reja kritike dhe forcimin e masave të sigurisë kibernetike. Gjithashtu, ato synojnë të harmonizojnë rregullon me detyrimet kombëtare, duke përmbushur rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe duke siguruar një treg të sigurt dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Një aspekt i rëndësishëm i ndryshimeve është edhe detyrimi i operatorëve për certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001, duke rritur mbrojtjen efektive ndaj rreziqeve kibernetike. Për këto arsye, miratimi i këtyre shtesave dhe ndryshimeve është thelbësor për funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Për më tepër, ne fuqi dhe marrevseshja e Bashkëpunimit ndërmjet Enti Rregullator i Energjisë dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, e miratuar me vendim të Bordit të ERE-s dhe e publikuar në faqet zyrtare të të dy institucioneve. Nderkohe nën 5 germa b) i rregullores së kibernetikës Identifikimi dhe hartimi i planit të masave duke pasur parasysh rreziqet e mundshme dhe të identifikuar, përcakton se; Pas procesit për paraqitjen e Vetëvlerësimit të përcaktuar më lart, OIKI duhet të propozojnë planet e tyre të masave tek autoritetet kompetente. OIKI mund të kërkojë bashkëpunim me ERE siç përcaktohet më lart.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

4. Përmirësimi i Transparencës Përmes Publikimit të Vendimeve dhe Përditësimit të Faqes Zyrtare të ERE-së

Çështje

Gjatë shqyrtimit të proceseve të raportimit dhe transparencës institucionale u konstatua se publikimi i vendimeve të Bordit në faqen zyrtare të ERE-së nuk është gjithmonë i plotë dhe i përditësuar.

Gjithashtu, disa seksione të faqes zyrtare nuk pasqyrojnë në mënyrë konsistente ndryshimet e fundit rregullatore, informacionet operative ose dokumentet mbështetëse për publikun dhe palët e interesit.

Impakti

Mospublikimi në kohë ose mungesa e përditësimeve të rregullta redukton transparencën institucionale dhe kufizon aksesin e palëve të interesuara në informacionin zyrtar dhe vendimmarrës të rregullatorit.

Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në perceptimin e publikut për llogaridhënien e institucionit dhe të krijojë pasiguri për operatorët dhe konsumatorët në lidhje me rregullat dhe vendimet në fuqi.

Në nivel funksional, mungesa e informacionit të përditësuar vështirëson proceset e monitorimit, raportimit dhe pajtueshmërisë në sektorin energjetik.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të marrë masa konkrete për **publikimin e plotë dhe të pandërprerë të të gjitha vendimeve të Bordit** në faqen zyrtare online, si dhe të forcojë proceset e brendshme të menaxhimit të informacionit për të siguruar përditësimin në kohë të të gjitha materialeve institucionale.

Krijimi i një procedure të standardizuar të publikimit dhe miratimi i një kalendarit të brendshëm të përditësimeve do të përmirësonte transparencën, qasjen e palëve të interesit dhe besueshmërinë e institucionit.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Në përputhje me detyrimet që burojnë nga Ligji nr 43/2025, 'Për Sektorin e Energjisë Elektrike', i ndryshuar, konkretisht neni 16, pika 4, ERE ka publikuar në Fletoren Zyrtare të gjitha vendimet e bordit, përveç atyre me karakter të brendshëm organizativ të ERE-s. Paralelisht ERE ka publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe njoftimin për shtyp për çdo vendim, që publikohet njëkohësisht edhe në rrjete sociale.

Për më tepër, fakti që sipas raportit të transparencës institucionale është vlerësuar me 15 nga 16 pikë të mundshme përbën tregues objektiv se mekanizmat ekzistues të publikimit dhe menaxhimit të informacionit funksionojnë në nivel shumë të lartë përputhshmërie.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

5. Forcimi i Procesit të Vlerësimit dhe Monitorimit të Planeve të Investimeve të OSSH Dhe OST

Çështje

Gjatë procedurave tona u vërejt se procesi i shqyrtimit të planeve të investimeve të OSSH-së dhe OST-së kërkon një vëmendje të vazhdueshme për të siguruar përputhjen e tyre me objektivat strategjike të politikave energjetike kombëtare.

Investimet afatgjata të operatorëve të rrjetit shpesh kërkojnë rishikim periodik, sidomos në drejtim të zhvillimeve të reja teknologjike, ndryshimeve të kërkesës së konsumatorëve dhe dinamikave të tregut.

Është identifikuar gjithashtu nevoja për një fokus të posaçëm në zonat turistike, ku konsumi energjetik paraqet variacione të ndjeshme sezonale dhe kërkon investime të targetuara për të garantuar cilësi dhe siguri furnizimi.

Impakti

Mungesa e vlerësimit të rregullt dhe të thelluar të planeve të investimeve mund të çojë në moskoordinim midis objektivave kombëtare dhe prioriteteve të operatorëve të rrjetit. Kjo situatë mund të rezultojë në investime joeficiente, kapacitete të pamjaftueshme të rrjetit, rritje të rrezikut të mbingarkesave sezonale — veçanërisht në zonat turistike — dhe në reduktim të cilësisë së furnizimit.

Një rrjedhojë e mundshme është ulja e stabilitetit të sistemit, rritja e kostove operacionale dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave afatgjata të zhvillimit të sektorit energjetik.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të vazhdojë të tregojë vëmendje të shtuar në shqyrtimin e planeve të investimeve të OSSH-së dhe OST-së, duke siguruar që ato të jenë në përputhje të plotë me politikat energjetike kombëtare, prioritetet strategjike dhe objektivat e zhvillimit të sektorit. Sugjerohet gjithashtu që planifikimi afatgjatë i investimeve të rishikohet periodikisht për të adresuar zhvillimet e reja, trendet teknologjike, ndryshimet në profilin e konsumit dhe nevojat e veçanta të zonave turistike.

Përdorimi i analizave të riskut, projeksioneve të kërkesës dhe modeleve të performancës së rrjetit do të forcojë efektivitetin e këtij procesi.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Bordi i ERE-s, me Vendimin nr. 308, datë 21.11.2025, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit 5-vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes. Po ashtu, janë zhvilluar korrespondenca me operatorin e shpërndarjes lidhur me vlerësimet mbi këtë plan, me fokus të veçantë investimet në zonat rurale dhe turistike. Në vijim të këtij procesi, është zhvilluar seancë teknike me operatorët e rrjetit për diskutimin e çështjeve që lidhen me planin në fjalë. Në të njëjtin kuadër, me Vendimin nr. 343, datë 23.12.2025, Bordi i ERE-s vendosi përfundimin e procedurave për shqyrtimin e planit 3-vjeçar të OST sh.a. për vitet 2025–2027, duke i ngarkuar OST sh.a. detyrën për të përcjellë planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2026–2035.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

6. Promovimi dhe Ndërgjegjësimi për Përdorimin e Platformës së Krahimit të Çmimeve (PCT- Price Comparison Tool)

Çështje

Pas miratimit të akteve përkatëse që vendosin detyrimin për përdorimin e Platformës së Krahimit të Çmimeve (PCT) në tregun e lirë, është vërejtur se niveli i informimit dhe ndërgjegjësimin të konsumatorëve dhe operatorëve për funksionimin, përfitimet dhe mënyrat e aksesimit të kësaj platforme mbetet i kufizuar.

Platforma PCT përfaqëson një instrument të rëndësishëm rregullator për transparencën e tregut, por mungesa e fushatave të dedikuara informuese mund të kufizojë efektivitetin e saj në praktikë.

Impakti

Përdorimi i kufizuar i PCT mund të reduktojë transparencën e tregut të energjisë në segmentin e konsumatorëve të tregut të lirë dhe të dëmtojë konkurrencën midis furnizuesve. Kjo mund të rezultojë në mungesë informacioni për konsumatorët, duke bërë që ata të mos përfitojnë nga ofertat më të mira të tregut, dhe të kufizojë rolin e ERE-së në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme. Një nivel i ulët përdorimi i platformës komprometon qëllimin për të krijuar një mjedis të hapur, transparent dhe të krahasueshëm midis operatorëve.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të zhvillojë **fushata informuese dhe promovuese** të strukturuar, të cilat sqarojnë modalitetet e funksionimit të PCT, mënyrat e aksesimit nga konsumatorët, si dhe përfitimet e përdorimit të saj.

Këto fushata duhet të synojnë rritjen e ndërgjegjësimin të publikut dhe operatorëve të tregut të lirë, duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi, materiale udhëzuese dhe takime informuese.

Një komunikim i tillë proaktiv do të mbështesë rritjen e transparencës në treg dhe do të forcojë mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Komentet e Drejtimin (ERE)

Me vendimin nr. 241, datë 15.11.2024, të ndryshuar, ERE ka vendosur detyrimin për publikimin e ofertave të furnizimit me energji elektrike në Platformën e Krahimit të Çmimeve (PCT), të krijuar nga ERE, për të licencuarit.

Janë përgatitur materialet promovuese dhe informuese për Platformën e Krahimit të Çmimeve (PCT), përfshirë prezantimet informuese, agjendën e takimit me shoqatat e konsumatorëve dhe materialet mbështetëse për fushatat e ndërgjegjësimin. Janë hartuar gjithashtu përmbajtje edukuese për konsumatorët dhe furnizuesit. Fushatat informuese do të vijojnë në mënyrë të vazhdueshme, me synim rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin mbi mundësitë që ofrojnë furnizuesit në tregun e lirë.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

7. Forcimi i Monitorimit të Bursës ALPEX dhe Funkcionimit të Tregut të Organizuar të Energjisë

Çështje

Gjatë procedurave tona u vërejt se, megjithëse ERE ka rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e funksionimit të Bursës ALPEX, dinamika e zhvillimit të tregut të organizuar të energjisë kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe të thelluar.

Funksionimi efektiv i ALPEX-it është thelbësor për sigurimin e transparencës së çmimeve, krijimin e sinjaleve të qarta të tregut dhe nxitjen e konkurrencës ndërmjet pjesëmarrësve të tregut.

Rritja e pjesëmarrjes së aktorëve dhe volumi në rritje i tregtimit kërkojnë vlerësime më të shpeshta mbi respektimin e rregullave, mekanizmave të ofrimit të ofertave dhe funksionimin e platformës së tregtimit.

Impakti

Një nivel i pamjaftueshëm monitorimi mund të kufizojë efektivitetin e ALPEX-it si bursë energjetike dhe të ulë transparencën e çmimeve në treg.

Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në:

- aftësinë e tregut për të tërhequr investime të reja në energjinë e rinovueshme,
- konkurrencën e ndershme midis pjesëmarrësve,
- përgatitjen e Shqipërisë për t'u integruar në platforma evropiane të tregtimit të energjisë.

Mungesa e mbikëqyrjes së vazhdueshme mund të krijojë rreziqe për funksionimin e tregut, përfshirë mospërputhje me parimet rregullatore, devijime të sjelljes në treg dhe paqartësi në sinjalet e çmimeve.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të vijojë dhe të forcojë monitorimin e Bursës ALPEX, duke intensifikuar analizat periodike të funksionimit të tregut, të sjelljes së aktorëve dhe të pajtueshmërisë me kuadrin rregullator.

Duhet të vlerësohen rregullisht indikatorët e transparencës, konkurrencës dhe efikasitetit të tregut, si dhe të ndërmerren veprime rregullatore kur identifikohen devijime nga standardet.

Një mbikëqyrje e tillë e strukturuar dhe proaktive do të nxisë funksionimin e një tregu transparent dhe konkurrues, do të mbështesë investimet në energjinë e rinovueshme dhe do të rrisë mundësinë e integritetit të Shqipërisë në tregjet rajonale dhe evropiane të energjisë.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Janë mbledhur dhe analizuar të dhënat për tregun e ditës në avancë (Day-Ahead Market) dhe tregun brenda ditës (Intra-Day Market) për periudhën 12-mujore të vitit 2025, dhe i është kërkuar ALPEX raportim mujor mbi të dhënat e tregut. Po ashtu, nga ana e ERE-s realizohen publikime në faqen zyrtare të të dhënave periodike 4-mujore, ku përfshihen informacionet mbi ecurinë e tregut, si volumet e tregtuara, prodhimi, konsumi, humbjet, arketimet etj.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

8. Miratimi i Metodologjisë për Vlerësimin e Gatishmërisë së Tregut të Energjisë së Ditës në Avancë

Çështje

Ligji nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” parashikon miratimin e disa akteve nënligjore, ndër të cilat edhe metodologjia për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë së ditës në avancë (Day-Ahead Market Readiness Assessment).

Gjatë procedurave tona u vërejt se miratimi i kësaj metodologjie është ende në proces dhe kërkon angazhim të shtuar nga ERE për të siguruar që strukturat dhe mekanizmat e tregut të energjisë të jenë të gatshme për zbatimin e modeleve të tregtimit të avancuar, sipas praktikave të tregjeve evropiane.

Impakti

Vonesat në miratimin e metodologjisë dhe në vlerësimin e gatishmërisë së tregut mund të ndikojnë në:

- aftësinë e tregut shqiptar për të operuar sipas standardeve të tregut të lirë,
- integrimin efektiv të burimeve të rinovueshme,
- rritjen e transparencës dhe efikasitetit të formimit të çmimeve në tregun e ditës në avancë,
- përgatitjen e Shqipërisë për pjesëmarrje në platforma rajonale dhe evropiane të tregtimit.

Mungesa e vlerësimit të plotë të kapaciteteve teknike, operacionale dhe institucionale të tregut rrit rrezikun e mosfunksionimit optimal të një tregu të avancuar energji

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të ndërmarrë masat e nevojshme për miratimin sa më të shpejtë të metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të energjisë së ditës në avancë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 24/2023. Metodologjia duhet të vlerësojë kapacitetin, fleksibilitetin dhe gatishmërinë e aktorëve të tregut për të operuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, duke siguruar kushte të favorshme për pjesëmarrjen e operatorëve dhe integrimin e burimeve të rinovueshme në sistemin energjetik. Zbatimi i kësaj metodologjie do të mbështesë zhvillimin e një tregu modern, të qëndrueshëm dhe të harmonizuar me standardet e BE-së.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Konkretisht, Vendimi nr. 256, datë 02.12.2024 i Bordit të ERE-s është për: “Fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë për vlerësimin e gatishmërisë së tregut shqiptar të energjisë së ditës në avancë”, dhe me Vendimin nr. 279, datë 06.11.2025, me të cilin u miratua Metodologjia mbi vlerësimin e tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike e publikuar edhe në faqen web të ERE -s. Kjo metodologji përcakton parimet dhe treguesit të cilët do të merren në konsideratë nga ERE për vlerësimin e gatishmërisë së tregut të ditës në avancë të energjisë elektrike, mbështetur në përcaktimet e Ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”. Vlerësimi i parë i gatishmërisë së tregut nga ERE do të kryhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e metodologjisë dhe do të vijojë të hartohet çdo 6 muaj deri në një vlerësim pozitiv mbi gatishmërinë e tregut.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

9. Hartimi i Një Strategjie të Përbashkët Afatmesme për Eficiencën e Energjisë në Bashkëpunim me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë

Çështje

Pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet ERE-së dhe Agjencisë së Eficiencës së Energjisë, janë adresuar disa çështje të rëndësishme që lidhen me përmirësimin e kuadrit rregullator për eficiencën e energjisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e përdorimit eficient të energjisë.

Megjithatë, gjatë procedurave tona u konstatua se mungon ende një **strategji e përbashkët afatmesme**, e cila të udhëheqë qasjen institucionale në trajtimin e çështjeve me interes për konsumatorët në lidhje me përmirësimin e eficiencës energjetike.

Impakti

Mungesa e një strategjie të integruar mund të çojë në:

- fragmentim të përpjekjeve institucionale,
- mungesë koherence në iniciativat që synojnë eficiencën energjetike,
- rezultate të paqëndrueshme për konsumatorët,
- vështirësi në matjen e progresit dhe efektivitetit të politikave të eficiencës së energjisë.

Kjo situatë mund të ngadalësojë përfitimet që lidhen me përdorimin eficient të energjisë, përfshirë uljen e kostove për konsumatorët dhe rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit energjetik.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE, në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, të marrë në konsideratë **hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme**, e cila të adresojë çështjet prioritare në fushën e eficiencës së energjisë dhe interesat e konsumatorëve.

Strategjia duhet të përfshijë objektiva të matshëm, mekanizma monitorimi dhe plane të qarta veprimi, duke siguruar një qasje të unifikuar, koherente dhe të qëndrueshme për iniciativat e eficiencës së energjisë.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Janë përgatitur materiale informuese dhe udhëzues praktikë për konsumatorët mbi eficiencën e energjisë, dhe është krijuar një seksion i dedikuar në faqen zyrtare të ERE-s. Ka nisur përgatitja e elementeve informuese për faturat e energjisë dhe hartimi i strategjisë afatmesme. Po ashtu, me Vendimin nr. 299, datë 17.11.2025, është miratuar "Strategjia e ERE për ndërgjegjësimin mbi kursimin e energjisë dhe përdorimin e burimeve alternative për vitet 2025–2030", e cila gjendet e publikuar në faqen e web-it të ERE-s. Miratimi i kësaj strategjie përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të institucionalizimit të politikave të ndërgjegjësimit dhe edukimit të konsumatorëve në fushën e eficiencës së energjisë, si dhe krijon një bazë të qëndrueshme për bashkëpunimin ndërinstitutional me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë dhe aktorë të tjerë të sektorit.

Enti Rregulator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

10. Rishikimi i Rregullave dhe Standardeve të Cilësisë së Shërbimit të Ofruar nga Operatorët e Rrjetit

Çështje

Gjatë procedurave tona u vërejt se rregullat dhe standardet në fuqi për cilësinë e shërbimit të ofruar nga operatorët e rrjetit kërkojnë rishikim periodik për t'u përshtatur me ndryshimet në kërkesën e konsumatorëve, zhvillimet teknologjike dhe objektivat kombëtare për përmirësimin e cilësisë së furnizimit.

Disa indikatorë ekzistues të performancës së operatorëve mund të mos pasqyrojnë plotësisht realitetin aktual të ngarkesave të rrjetit, qëndrueshmërinë e furnizimit dhe pritshmëritë e konsumatorëve për cilësi më të lartë të shërbimit.

Impakti

Mungesa e rishikimit të përditësuar të standardeve të cilësisë së shërbimit mund të çojë në:

- performancë të pakoordinuar të operatorëve të rrjetit,
- mungesë transparence në matjen e cilësisë së shërbimit,
- vështirësi në monitorimin dhe vlerësimin e performancës së operatorëve,
- dhe pakënaqësi të konsumatorëve për shkak të mosadresimit të problematikave të shërbimit.

Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në sigurinë, besueshmërinë dhe cilësinë e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të ndërmarrë masa për **rishikimin e rregullave dhe standardeve aktuale të cilësisë së shërbimit**, duke i përshtatur ato me nevojat aktuale të tregut, kërkesat e konsumatorëve dhe praktikat e mira ndërkombëtare.

Rishikimi duhet të përfshijë:

- identifikimin e indikatorëve të rinj të performancës,
- përditësimin e kriterëve të matjes së cilësisë,
- forcimin e mekanizmave të monitorimit,
- dhe vendosjen e kriterëve të qarta për ndërhyrjet korrigjuese nga operatorët.

Një qasje e tillë do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Bordi i ERE-së miratoi Vendimin nr. 300/17.11.2025, vendosi fillimi i procesit të rishikimit të rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë në sistemin e transmetimit, duke përfshirë edhe përditësimin dhe permiresimin e disa prej treguesve të standardeve dhe mekanizmave të monitorimit. Ndërkohë me Vendimin nr. 346/29.12.2025, pas kryerjes së procesit të konsultimit, me vendimin nr. 81 të datës 12.03.2026, miratoi ndryshimet në standardet e cilësisë së shërbimit për sistemin e transmetimit, filloi dhe procedura për rishikimin dhe permiresimin e disa indikatorëve dhe kriterëve të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes. Ky akt vendosi kalimin në fazën e konsultimit publik, duke mundësuar që palët e interesuara të japin komente dhe sugjerime para miratimit përfundimtar të rregullores së re.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

11. Përgatitja e Standardeve për Lëshimin e Garancive të Origjinës dhe Adresimi i Çështjeve të Konsumatorëve dhe Pjesëmarrësve të Tregut**Çështje**

Gjatë procedurave tona u vërejt se procesi përgatitor për hartimin e standardeve të lëshimit të **certifikatave të garancisë së origjinës (GO)** ende kërkon zhvillim të mëtejshëm për t'u harmonizuar me kërkesat e **Sistemit Evropian të Certifikatave të Energjisë (EECS)**. Përveç kësaj, disa çështje të ngritura nga konsumatorët dhe pjesëmarrësit e tregut që lidhen me transparencën, aksesin në informacion, zgjidhjen e ankesave dhe operacionalizimin e tregut kërkojnë ende trajtim të vazhdueshëm rregullator.

Impakti

Mungesa e standardeve të qarta dhe të harmonizuara për lëshimin e garancive të origjinës mund të:

- kufizojë besueshmërinë dhe pranueshmërinë e certifikatave të lëshuara në tregun ndërkombëtar,
- pengojë pjesëmarrjen e Shqipërisë në mekanizmat evropianë të tregtimit të energjisë së gjelbër,
- ndikojë në transparencën e tregut të energjisë së rinovueshme dhe në investimet e mundshme në këtë sektor.

Gjithashtu, mosadresimi i plotë i çështjeve të ngritura nga konsumatorët dhe aktorët e tregut mund të krijojë:

- pasiguri rregullatore,
- vështirësi në pjesëmarrjen efektive në treg,
- dhe reduktim të besimit ndaj operatorëve të sektorit dhe ndaj rregullatorit vetë.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të përshpejtojë procesin e **hartimit dhe miratimit të standardeve për lëshimin e garancive të origjinës**, duke siguruar që ato të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat dhe strukturën e EECS.

Standardet duhet të përfshijnë procedura të qarta për:

- verifikimin e burimit të prodhimit,
- certifikimin dhe lëshimin e garancive,
- monitorimin e përdorimit dhe transferimit të tyre.

Në të njëjtën kohë, ERE duhet të vazhdojë adresimin sistematik të çështjeve të ngritura nga konsumatorët dhe pjesëmarrësit e tregut, duke ndërmarrë ndërhyrjet e nevojshme rregullatore për garantimin e transparencës, aksesit të drejtë dhe funksionimit të qëndrueshëm të tregut.

Komentet e Drejtimin (ERE)

Me Vendimin nr. 378/28.12.2023 bordi i ERE-s Vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e rregullores që rregullon lëshimin, transferimin, anulimin dhe menaxhimin e garancive të origjinës për energjinë e rinovueshme; dhe Vendimin nr. 300/30.12.2024, u miratua përfundimisht rregullorja për garancitë e origjinës, duke konkretizuar kriteret dhe procedurat për verifikimin e burimit të prodhimit, certifikimin dhe lëshimin e certifikatave. Më tej, në kuadër të zbatimit praktik të kësaj rregulloreje, ERE ka miratuar edhe Vendimin nr. 15/2026, me të cilin u përcaktua tarifa për lëshimin e garancive të origjinës, duke vendosur një masë të qartë tarifore (p.sh. një shumë fikse për njësinë e energjisë) që aplikon për operatorët që kërkojnë certifikata, e cila siguron funksionimin praktik të sistemit të certifikatave dhe harmonizimin me kuadrin rregullator. Nderkohe po vijojnë diskutimet me AIB (shoqata për GO) për emertimin e garancive të origjinës sipas EECS.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

12. Miratimi në Kohë i Çmimit të Energjisë Elektrike të Prodhuar nga Vetëprodhuesit e Burimeve të Rinovueshme

Çështje

Pas miratimit të metodologjisë përkatëse nga Këshilli i Ministrave për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme, vërehet nevoja që ERE të ndërmarrë masa të koordinuara për të siguruar miratimin në kohë të këtij çmimi.

Vonesat në këtë proces ndikojnë në funksionimin praktik të skemave të vetëprodhimit, si dhe në pritshmëritë financiare të investitorëve dhe konsumatorëve.

Impakti

Mospërcaktimi në kohë i çmimit mund të krijojë:

- pasiguri për vetëprodhuesit dhe investitorët,
- vështirësi në planifikimin financiar të projekteve të rinovueshme,
- rrezik për ngadalësim të ritmit të investimeve në sektorin e vetëprodhimit,
- dhe vonesa në integrimin e kapaciteteve të reja në sistemin energjetik.

Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në objektivat kombëtare për rritjen e pjesës së energjisë së rinovueshme në konsumin final të vendit.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar miratimin në kohë të çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga vetëprodhuesit, menjëherë pas miratimit të metodologjisë nga Këshilli i Ministrave.

Ky proces duhet të kryhet në mënyrë transparente, të parashikueshme dhe në përputhje me kuadrin rregullator, duke u siguruar që vetëprodhuesit dhe investitorët të kenë qartësi të plotë mbi skemat dhe mekanizmat ekonomikë që u aplikohen.

Miratimi i shpejtë i çmimit do të mbështesë zhvillimin e tregut të vetëprodhuesve dhe do të nxisë integrimin e energjisë së rinovueshme në sistem.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Drafti i VKM-së përkatëse është përcjellë për komente më datë 19.12.2025 dhe ndodhet në fazën e miratimit përfundimtar nga ana e Këshillit të Ministrave. Pas miratimit të VKM-së, i cili parashikon, ndër të tjera, çmimin tavan dhe çmimin dysHEME për vetëprodhuesit, do të miratohet nga ana e ERE-s çmimi përfundimtar i shitjes së energjisë elektrike nga impiantet vetëprodhuese.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

13. Implementimin e një platforme digjitale për trajtimin e ankesave

Çështje

Gjatë procedurave tona u vërejt se procesi i trajtimit të ankesave të konsumatoreve procesohet rast pas rasti dhe ndiqet nga strukturat e ERE, por ky proces nuk është i aksesueshem online nepermjet nje platforme dixhitale. Aktualisht keto ankesa mund të bëhen drejtpërdrejt pranë ERE, në platformën online, përmes email-it apo nëpërmjet postës.

Impakti

Mungesa e një platforme digjitale për trajtimin e ankesave dhe gjurmimin e zgjidhjes së ankesave mund të:

- vështirësojë verifikimin në kohë reale të statusit të ankesës,
- zvogëlojë aksesueshmërinë për konsumatorët,
- reduktojnë trajtimin me përgjegjësi të ankesave,
- reduktojnë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve,
- dhe reduktojnë shërbimet e operatorëve të energjisë.

Rekomandimi

Rekomandohet që ERE të mundësojë implementimin e një platforme digjitale për trajtimin e ankesave dhe gjurmimin e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve, duke e bërë më të thjeshtë verifikimin online të statusit të ankesës dhe më të aksesueshme.

Kjo platformë përveç se do të lehtësojë verifikimin e statusit të ankesës nga konsumatorët do të mundësojë gjithashtu edhe trajtimin me përgjegjësi të ankesave si një instrument i drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Komentet e Drejtimit (ERE)

Në kuadër është parashikuar në buxhetin e vitit 2026 me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të mekanizmave të mbrojtjes së konsumatorëve, ERE do të vazhdojë të zhvillojë dhe përmirësojë platformat online për regjistrimin dhe ndjekjen e ankesave, duke ofruar më shumë lehtësi dhe efikasitet për konsumatorët, si dhe do të zgjerojë bashkëpunimin me organizatat e mbrojtjes së konsumatorëve për të marrë feedback mbi përditësimet e mundshme në sektorin e energjisë.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

II. TABELA PËRMBLEDHËSE E 13 GJETJEVE DHE REKOMANDIMEVE

Më poshtë paraqet një përmbledhje e strukturuar të 13 gjetjeve dhe rekomandimeve të identifikuar gjatë angazhimit tonë për dhënien e sigurisë së kufizuar, në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar SNAS 3000.

Tabela¹ shërben si një instrument referimi të shpejtë, duke sintetizuar për secilën gjetje: **çështjen kryesore të konstatuar, impaktin e vlerësuar dhe rekomandimin përkatës.** Qëllimi i saj është të ofrojë një panoramë të qartë dhe gjithëpërfshirëse të fushave që kërkojnë vëmendje nga Drejtimi dhe Bordi i ERE-së, si dhe të mbështesë procesin e monitorimit dhe ndjekjes së masave të përmirësimit.

Nr.	Çështja	Impakti	Rekomandimi
1	Mospërdorimi i një mjeti të unifikuar raportimi nga operatorët e licencuar.	Rrezik për gabime, ngarkesë operative, vështirësi në inspektime.	Zhvillimi i një mjeti të standardizuar raportimi për të gjithë operatorët.
2	Mungesa e koordinimit të strukturuar për integrimin e vetëprodhuesve.	Ngadalësim i integritetit të RES (<i>Renewable Energy Sources</i>), pasiguri teknike dhe rregullatore.	Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe standardizimi i proceseve.
3	Mospërputhje në hartimin dhe zbatimin e planeve të sigurisë kibernetike.	Rrezik i lartë për incidente që cenojnë furnizimin.	Kërkimi rigoroz për plane të plota dhe monitorim periodik i zbatimit.
4	Mospublikim i plotë dhe në kohë i vendimeve dhe informacionit zyrtar.	Ulje e transparencës, pasiguri për operatorët dhe konsumatorët.	Standardizimi i procesit të publikimit dhe përditësime të rregullta online.
5	Nevoja për rishikim të vazhdueshëm të planeve të investimeve OSSH/OST	Investime joeficiente, mbingarkesa sezonale, cilësi e ulët furnizimi.	Vlerësim periodik i planeve dhe përdorim analizash tekniko-ekonomike.
6	Nivel i ulët ndërgjegjësimi për përdorimin e PCT	Transparencë e kufizuar dhe konkurrencë e dobët në treg.	Fushata promovimi dhe materiale udhëzuese për përdoruesit.
7	Nevoja për monitorim më të thelluar të ALPEX.	Rrezik për devijime në treg, sinjale të pasakta çmimesh.	Analiza periodike, vlerësim i pajtueshmërisë dhe ndërhyrje rregullatore.
8	Vonesë në miratimin e metodologjisë së gatishmërisë së tregut të ditës në avancë.	Rrezik për mosharmonizim me tregjet evropiane.	Miratim urgjent i metodologjisë dhe vlerësim gjithëpërfshirës i tregut.
9	Mungesë strategjie të përbashkët për eficiencën e energjisë me AEE.	Fragmentim institucional dhe rezultate të paqëndrueshme.	Hartimi i një strategjie të përbashkët afatmesme me objektiva të matshëm.

¹ Tabela nuk zëvendëson përshkrimet e detajuara të gjetjeve nga 1-12, por i plotëson ato duke lehtësuar identifikimin dhe adresimin e prioritetëve institucionale.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

Nr.	Çështja	Impakti	Rekomandimi
10	Rregulla dhe standarde të papërditësuara të cilësisë së shërbimit.	Monitorim i vështirë dhe pakënaqësi e konsumatorëve.	Përditësim i indikatorëve, forcim monitorimi dhe ndërhyrje korrigjuese.
11	Mungesa e standardeve të harmonizuara për Garancitë e Origjinës.	Rrezik për mospranim ndërkombëtar dhe pasiguri rregullatore.	Hartim i standardeve në përputhje me EECS (<i>European Energy Certificate System</i>) dhe adresim i çështjeve të konsumatorëve.
12	Vonese në miratimin e çmimit të energjisë së vetëprodhuesve.	Pasiguri investimi dhe ngadalësim i zhvillimit të RES (<i>Renewable Energy Sources</i>).	Miratim në kohë i çmimit dhe proces transparent për aktorët.
13	Mungesa e nje platforme digjitale për trajtimin e ankesave	Vështiresi në ndjekjen e statusit të ankesave dhe mungese aksesit për konsumatorët	Implementimi i një platforme digjitale për trajtimin e ankesave dhe gjurmimin e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

1. Ankesat konsumatore per periudhën 2008-2011

Çështje

Përgjatë viteve 2008-2011 ankesat e konsumatorëve kanë qënë të larta dhe kanë mbetur pa zgjidhje akoma edhe në ditët e sotme. Kryesisht përgjatë këtyre viteve konsumatorët janë ankuar ndaj CEZ shpërndarje, për mungesën e energjisë elektrike, mosdorëzim faturash, ose gabim faturimi por të dhëna të shumta ende mungojnë.

Impakti

Ekziston pasiguria lidhur me evidentimin e këtyre ankesave dhe pranimi i tyre si “dëm ekonomik” dhe “energji e pamatur”, ka vijuar me mozgjidhje ende në ditët e sotme pasi nuk janë ende të mirëpërcaktuara. Ende mungon një zgjidhje konkrete nëse këta konsumatorë do të dëmshpërblehen apo do të jepet një zgjidhje e pëlqyeshme nga të dy palët. Problematikë qëndron fakti se në ato vite numri i kontratave me klientët në mënyrë të rregullt ka qënë i ulët dhe informaliteti më i lartë. Në ditët e sotme është e vështirë të vërtetohet nëse kanë qënë të rregullta apo jo për shkak të hendeut të madh të kohës.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë që ERE në rolin e rregullatorit të japë një zgjidhje përfundimtare për zgjidhjen e ankesave në bashkëpunim me 3 shoqëritë duke bërë të mundur krijimin e një plani të përbashkët në mënyrë që numri i klientëve të ankuar të vijë duke u ulur. Përcaktimi i një standardi të përbashkët për zgjidhjen e ankesave të klientëve nëse do të jepet zgjidhje apo do të mbyllet si çështje përfundimisht.

ERE të vijojë të ndjekë në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të shoqërisë FSHU sh.a. deri në zgjidhjen përfundimtare çështjen e ankesave të klientëve, të cilët janë faturuar nën emërtimet “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008 – prill 2011.

Komentet e Drejtimit

ERE do të veprojë si garantues i procesit, duke siguruar që operatorët të zbatojnë rregulloret dhe të raportojnë progresin, por implementimi operativ dhe kompensimet mbeten përgjegjësi e shoqërive.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

2. Sistemet informative dhe rreziku i sulmit kibernetik

Çështje

Gjatë vitit 2020, me miratimin nga ERE të strategjisë për infrastrukturën kritike në ektorin e energjisë elektrike, ajo duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë implementimit të kësaj strategjie në përputhje me direktivën e BE-së "Për sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike".

Impakti

Strategjitë e rregullores për sistemin informativ dhe mbrojtjen ndaj sulmeve kibernetike do të sillnin parandalimin e humbjeve të të dhënave në kushtet e një sulmi kibernetik. Vetëm OST deri më tani ka dërguar rregulloren e përcaktuar për informatizimin e tyre. Mungesa e një specialist IT të trajnuar mbi sigurinë e informacionit tek ERE do të sillte problematika në shqyrtimin e rregulloreve të sjella nga ana e shoqërive. Mungesa e raportimeve periodike nga ana e shoqërive tregon rrezikshmëri për rënien në kontakt të tyre me sulmet kibernetike sepse vëmendje kushtuar ndaj tyre mund të jetë më e vogël.

Rekomandimi

Ne rekomandojmë ERE të ndërmarrë masat e nevojshme dhe të vazhdueshme për të marrë rregulloret nga ana e 3 shoqërive KESH sh.a., OST sh.a, dhe OSHEE sh.a duke vendosur theksin tek sistemi i parandalimit të vjedhjes dhe humbjes së të dhënave.

Komentet e Drejtimit

Në këtë kuadër, duhet të kemi parasysh që ERE ka rol rregullator dhe garantues, duke monitoruar përputhshmërinë dhe duke kërkuar plane veprimi për përmirësime. Ndryshimet e fundit në Rregulloren perkatese kanë përfshirë përditësimin e referencave institucionale (emertimet), zgjerimin e fushës së zbatimit të rregullores duke përfshirë dhe sektorin e gazit natyror, infrastrukturave të reja kritike dhe forcimin e masave të sigurisë kibernetike. Gjithashtu, keto ndryshime synojnë të harmonizojnë rregulloren me detyrimet kombëtare, duke përbushur rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe duke siguruar një treg të sigurt dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Në fundi AKSK gjatë muajit dhjetor 2025 ka dërguar një marreveshje të bashkëpunimit për të cilën po vijojnë diskutimet.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025**III. REKOMANDIME TE TJERA**

- Transpozimi dhe zbatimi i rregullores CACM (Alokimi i Kapaciteteve dhe Menaxhimi i Konxhestioneve) sipas vendimit të Këshillit të ministrave të vendeve antare të Komunitetit të Energjisë.
- Transpozimi i rregullores të FCA, (foreword capacity allocation)
- Berjen funksionale të sistemit rajonal të garancive të origjines

Lidhur me keto transpozime dhe miratime të akteve rregullatore që lindin si detyrime nga pjesëmarrja në tregun vendas dhe rajonal të energjisë është e nevojshme që ERE të ketë konsulence të jashtme të specializuara në keto fusha.

Komentet e Drejtimit

Vendimi nr. 93, datë 28.04.2025 - Për miratimin e “Rregullores për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve (CACM)” Me këtë vendim, Bordi i ERE miratoi “Rregulloren për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve (CACM)”, e cila transponon Rregulloren (BE) nr. 2015/1222, në zbatim të Vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Vendimi nr. 290, datë 13.11.2025 - Mbi Miratimin e Rregullores “Për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata” Bordi i ERE vendosi të miratojë “Rregulloren për Alokimin e Kapaciteteve Afatgjata”, të propozuar nga OST sh.a., e cila përbën transpozim të drejtpërdrejtë të Rregullores (BE) 2016/1719 (FCA Guideline), në përputhje me Vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë. Vendimi synon krijimin e një kuadri të qartë dhe të harmonizuar për alokimin e kapaciteteve afatgjata në sistemin elektrik, duke siguruar integritetin e tregut, konkurrencën efektive, funksionimin e duhur të mekanizmave rajonalë dhe respektimin e detyrimeve për OST, NEMO dhe autoritetet rregullatore kombëtare dhe rajonale.

Vendimi nr. 291, datë 13.11.2025 - Mbi miratimin e “Një udhëzuesi për balancimin e energjisë elektrike”

Bordi i ERE vendosi të miratojë “Udhëzuesin për Balancimin e Energjisë Elektrike”, të përgatitur nga OST sh.a., në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/2195 dhe Vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë. Vendimi synon të krijojë një kuadër të qartë për zbatimin e metodologjive të balancimit, duke siguruar koordinim ndër-institucional dhe harmonizim me standardet ndërkombëtare.

Vendimi nr. 293, datë 13.11.2025 – Mbi një ndryshim në vendimin nr. 93, datë 28.04.2025 “Mbi miratimin e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM)”

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 293, datë 13.11.2025, vendosi ndryshimin e vendimit nr. 93, datë 28.04.2025, duke shtyrë hyrjen në fuqi të Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM) deri më 1 korrik 2026. Ky ndryshim u ndërmor në kushtet e zhvillimeve ligjore që lidhen me procesin e miratimit të ligjit të ri “Për sektorin e energjisë elektrike”, me qëllim sinkronizimin e hyrjes në fuqi të rregullores me kuadrin e ri ligjor dhe garantimin e koherencës juridike.

Vendimi nr. 347, datë 29.12.2025 – Për miratimin e “Kodit të Rrjetit mbi Emergjencën dhe Rivendosjen” Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 29.12.2025, miratoi “Kodin e Rrjetit mbi

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025

Emergjencën dhe Rivendosjen”, i cili transponon Rregulloren (BE) 2017/2196, në zbatim të Vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Vendimi nr. 348, datë 29.12.2025 – Për miratimin e “Udhëzuesit mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 348, datë 29.12.2025, miratoi “Udhëzuesin për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”, i cili transponon Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/1485, në zbatim të Vendimit nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë.

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE) Letra për Drejtimin – Raporti Vjetor 2025**Shtojcë****Përgjegjësia e Drejtimit për Objektivat dhe Kufizimet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm**

Komentet e mëposhtme u referohen përgjegjësise së Drejtimit për sistemin e brendshëm të kontroleve, ku objektivat dhe kufizimet e qënësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm janë marrë nga Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve.

Përgjegjësia e Drejtimit

Drejtimi është përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të kontroleve të brendshme. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, Drejtimi duhet të vlerësojë përfitimet dhe kostot e pritura përkatëse të politikave dhe procedurave për kontrollet e brendshme.

Objektivat

Objektivat e sistemit të kontrollit të brendshëm janë që të japin siguri drejtimi, sa më shumë të jetë e mundur, që asetet të jenë të mbrojtura nga përdorimi i paautorizuar ose keqpërdorimi, dhe se transaksionet janë ekzekutuar në përputhje me politikat e drejtimit dhe të regjistrohen saktë, në mënyrë që të mundësohet përgatitja në kohë e informacionit të besueshëm financiar në përputhje me parimet e zbatueshme të kontabilitetit.

Kufizimet

Për shkak të kufizimeve të qënësishme në çdo sistem të kontrollit të brendshëm, gabimet apo parregullsitë, mund të ndodhin dhe të mbeten të pazbuluara. Gjithashtu, parashikimi i çdo vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme është subjekt i rrezikut që politikat dhe procedurat mund të bëhen të papërshtatshme për shkak të ndryshimeve të kushteve ose efektiviteti i hartimit dhe i zbatimit të politikave dhe procedurave mund të përkeqësohet.



Adresa: Rr. "L.Gurakuqi", Ndëtesa 18, H.4, K.6: Ap.21,
Tiranë, Albania
T: 04 56 28 875
Web: www.viar.al



RAPORT I SIGURISË SË PROFESIONISTIT TË PAVARUR

Drejtuar: Kryetarit dhe Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Enti Rregullator i Energjisë ("ERE" ose "Enti") angazhoi audituesit e pavarur Shoqërinë VIAR-Consulting shpk me Audituese Ligjore Znj. Fatime Alliu me Licensë Nr.166 dhe Shoqërinë Nexia Albania shpk, me Audituese Ligjore Znj. Orjana Kalaja me Licensë Nr.284 (referuar më tej si "Audituesit"), për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025 ("të dhëna të zgjedhura"), me qëllim dhënien e sigurisë së kufizuar sipas kritereve të përshkruara më poshtë (Qëllimi i punës). Për qëllimet e këtij raporti, të dhënat e zgjedhura kanë të bëjnë me veprimtarinë e Entit në Shqipëri dhe nuk përfshijnë informacione që kanë të bëjnë me palë të tjera bashkëpunuese ose aktivitete / performanca të palëve të treta.

Qëllimi i punës

Angazhimi i dhënies së sigurisë është planifikuar dhe kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar SNAS 3000, "Angazhimet e Dhënies së Sigurisë ("SNAS 3000") që ndryshojnë nga Auditimet ose Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike", me qëllim që të japim një opinion për dhënie sigurie të nivelit të kufizuar për:

- Verifikimin e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore të paraqitura në Raportin Vjetor 2024 në mënyrë specifike për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në krahasim me kriteret e zbatueshme ("Kriteret e Përformances", të ilustruara në Raportin Vjetor), mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.

STUDIO
"VIAR - CONSULTING" sh.p.k.Adresa: Rr. "L. Gurakuqi", Ndëtesa 18, H.4, K.6: Ap.21,
Tiranë, Albania
T: 04 56 28 875
Web: www.viar.al

Përgjegjësitë e drejtimit

Drejtimi i të Entit Rregullator të Energjisë është përgjegjës për përgatitjen, prezantimin, tërësinë dhe saktësinë e të dhënave jofinanciare të dhëna për ne, siç paraqiten në Raportin Vjetor 2024. Për më tepër, drejtimi i ERE është përgjegjës për regjistrimet e mbajtura dhe kontrollet e brendshme të përshtatshme që janë krijuar për të mbështetur procesin e raportimit dhe të përputhshmerisë ligjore. Në mënyrë të veçantë, drejtimi është përgjegjës për hartimin e kontrolleve të brendshme dhe zbatimin e tyre për të parandaluar që Raporti të ketë anomali materiale.

Përgjegjësitë e Audituesve

Ne kemi kryer një shërbim dhënie sigurie të kufizuar. Përgjegjësia jonë është të shprehim konkluzionin tonë bazuar në procedurat e kryera, për të dhënat e zgjedhura, siç përshkruhet më sipër në seksionin "Qëllimi i punës".

Përgjegjësia jonë është e kufizuar në informacionin shpjegues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2025, të prezantuar në Raportin Vjetor për vitin 2025.

Në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi, ne nuk pranojmë dhe nuk marrim asnjë përgjegjësi për angazhimin tonë, ndaj kujt do tjetër përveç ERE, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar, me pëlqimin tonë paraprak.

Ne kemi kryer punën tonë duke mbledhur gjithë të dhënat, dokumentacionin përkatës, informacionin dhe shpjegimet që ne i konsideruam të nevojshme për të dhënat e zgjedhura të përshkruara, në seksionin "Qëllimi i punës". Procedurat e ndjekura në lidhje me të dhënat e zgjedhura përfshijnë:

- Intervistat me drejtimin dhe personelin përgjegjës për informacionin dhe supozimet përkatëse.
- Vizita në ambientet e Entit Rregullator të Energjisë.

STUDIO
"VIAR - CONSULTING" sh.p.kAdresa: Rr. "L. Gurakuqi" Ndëtesa.18; H.4; K.6: Ap.21,
Tiranë, Albania
T: 04 56 28 875
Web: www.viar.al

- Rishikimit dhe vlerësimit të proceseve dhe kontrolleve të përdorura për mbledhjen, grumbullimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave;
- Teste me zgjedhje mbi të dhënat e mbledhura dhe formulat, kur kërkohen.

Niveli i Dhënies së Sigurisë

Procedurat që kemi kryer janë hartuar për të ofruar siguri të kufizuar, siç specifikohet në SNAS 3000, mbi të cilat ne u bazuam për të arritur në konkluzione për angazhimin tonë. Këto procedura nuk janë aq të zgjeruara sa ato që kërkohen për dhënien e sigurisë së arsyeshme, për pasojë, merret një nivel më i ulët i sigurisë.

Kufizimet

Për të kryer punën tonë, ne u mbështetëm ekskluzivisht në informacionin e dhënë nga drejtuesit e Drejtorive të Entit Rregullator të Energjisë, të cilin ne e pranuam me mirëbesim si informacion të plotë, të saktë, të vërtetë dhe jo mashtrues.

- Si rrjedhim, ne nuk kemi kryer procedura verifikimi shtesë, përveç procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë në Raportin tonë në seksionin, Përgjegjësitë e Audituesve, të cilat rrjedhin nga metodologjia e rënë dakort reciprokisht.
- Asnjë punë nuk është kryer për të dhënat të periudhave të raportimeve të mëparshme, si dhe mbi të dhënat në lidhje me objektivat dhe parashikimet.
- Asnjë punë nuk është kryer për asgjë tjetër përveç qëllimit të rënë dakord dhe për rrjedhojë, konkluzioni ynë është i kufizuar për këtë qëllim.

Pavarësia

Audituesit zbatojnë kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilesisë nr.1 (SNMC nr. 1). Bazuar në këtë, mbajmë një sistem të menaxhimit të integruar të cilësisë që përfshin politikat dhe procedurat për respektimin e parimeve morale, standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse ligjore dhe rregullatore. Ne jemi në përputhje me kërkesat e pavarësisë dhe



Adresa: Rr. "L. Gurakuqi", Ndëtesa.18; H.4; K.6: Ap.21,
Tiranë, Albania
T: 04 56 28 875
Web: www.viar.al



standardet e tjera etike të Kodit Etikes së IFAC për profesionistët të Bordit të Standardeve Ndërkombetare të Etikes për Audituesit (IESBA), i cili bazohet në parimet themelore të integritetit, paanshmerisë, përshtatshmerisë profesionale, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale. Në këtë kontekst, ekipi Audituesve për dhënien e sigurisë është i pavarur nga Enti Rregullator të Energjisë dhe nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2024.

Konkluzione

Bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e marrë, asgjë nuk na ka tërhequr vëmendjen tonë që të na bëjë të besojmë se ka ndonjë gabim ose anomali që do të ndikonte materialisht në dhënien e informacioneve rreth përputhshërisë ligjore të aktivitetit (përfshirë shënimet shpjeguese dhe referencat përkatëse) sic paraqiten në Raportin Vjetor të Entit Rregullator të Energjisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025. Për më tepër, asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen tonë që të bëjë të besojmë se të dhënat e paraqitura, nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përmendura më lart, në seksionin "Qëllimi i punës".

Nexia-Albania sh.p.k

Orjana Kalaja

Auditues Ligjor

License Nr.284



Viar-Consulting

Fatime Alliu

Auditues Ligjor

License Nr.166



Tiranë, 24 mars 2026